



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Gjykata Supreme

Vrhovni Sud - Supreme Court

PËRMBLEDHJE NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS NË ÇËSHTJE CIVILE DHE PENALE



Prishtinë, 2024



PËRMBLEDHJE NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS NË ÇËSHTJE CIVILE DHE PENALE

Prishtinë, 2024

Nëntor 2024

Shtypur në Prishtinë

Hartimi, botimi dhe shtypja e materialit udhëzues: “Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështje civile dhe penale” është mundësuar nga Akademia e Drejtësisë, ndërkaq shtypja dhe printimi nga Projekti: Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI) Chemonics.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje nga praktika gjyqesore në çështje civile

Hyrje.....	8
1. KONTESTET NGA MARRDHËNIET E PUNËS BAZUAR NË DISKRIMINIM	9
1.1 Diskriminimi sipas legjislacionit të vendit tonë dhe atij ndërkombëtar	9
1.2 Kategoritë e diskriminimit	11
1.3 Mbrojtja gjyqësore në rastet e diskriminimit në punë.....	15
1.4 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin në punë.....	19
1.5 Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastet e diskriminimit në punë	26
1.6 Të gjeturat nga praktika gjyqësore për raste e tilla	28
2. SHËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL	32
2.1 Shqyrtime të përgjithshme lidhur me shpërblimin e dëmit	32
2.2 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore për shpërblimin e dëmit	33
2.3 Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial-Shqyrtime të përgjithshme lidhur me shpërblimin në të holla	35
2.4. Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore, lidhur me shpërblimin në të holla	37
2.5 Rastet e shpërblimit në të holla të dëmit jomaterial	38
2.6. Shpërblimi në të holla, për shkak të cenimit të së drejtës së personalitetit	38
2.7. Shpërblimi në të holla, për shkak të cenimit të autoritetit dhe nderit.....	40
2.8 . Shpërblimi në të holla, për shkak të dëmtimit të shëndetit dhe lëndimit trupor	42
2.9. Shpërblimi në të holla, për shkak të dhembjes fizike.....	42
2.10 . Shpërblimi në të holla, për shkak frikës së përjetuar	44
2.11. Shpërblimi në të holla, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ...	45
2.12. Shpërblimi në të holla, për shkak të shëmtimit trupor	46
2.13. Shpërblimi në të holla në rast vdekjeje të personave të afërm	48
2.14. Shpërblimi në të holla, lidhur me dhembjet shpirtërore për shkak të invaliditetit tejet të rendë ose shëmtimit në shkallë të lartë të personave të afërt	49
2.15. Shpërblimi në të holla, me rastin e heqjes së lirës pa bazë ligjore	50
2.16. Shpërblimi në të holla në raste të veçanta (cenimi i dinjitetit).....	52
2.17. Shpërblimi në të holla i dëmit të ardhshëm	53
2.18. Shpërblimi në të holla, për personin juridik	53
2.19. Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jomaterial	54
2.20. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës.....	55

2.21. Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës	57
3. PROCEDURË JOKONTESTIMORE -KUSHTET DHE MËNYRA E SHITJES SË BANESAVE NË PRONËSI SHOQËRORE DHE PUBLIKE	81
3.1 Korniza ligjore.....	81
3.2 Banesa si përcaktim ligjor.....	81
3.3 E drejta Banesore - Historiku	81
3.4 Periudha pas Qershorit 1999- Juridiksioni përjashtues	82
3.5 Transaksiont joformale para 24.03.1999	85
3.7 Periudha pas shkurtit 2008- Kthimi i pjesshëm i juridiksionit tek gjykata vendore.	87
3.8 Kush ka të drejtë ta blejë banesën në kushte e këtij Ligji?	87
3.9 Nga kush kerkohet blerja e baneses?.....	87
3.10 Kërkesa për blerjen e banesës i paraqitet:	88
3.11 Afati i paraqitjes së propozimeve.....	89
3.12 Procedura e shitjes.....	89
3.13 Kur bartësi i pronësis e aprovon kërkesën	89
3.14 Kur bartësi i pronsisë nuk e aprovon kërkesën	90
3.15 Gjetjet e Gjykatës Supreme në praktikën gjyqësore	91
3.16 Pretendimet për të drejtat e fituara nga dhënesit e banesave pas 24 marsit 1999 sidomos në organe paralele apo të pasluftës.....	91
3.17 Konstatimi i ekzistimit të drejtës banesore me vendim të KKPB	92
3.18 Praktika gjyqësore	92
3.19 Konkluzione dhe rekomandime	106
4. VËSHTRIM I ASPEKTEVE JURIDIKE PROCEDURALE DHE MATERIALE NË KONTESTET PËR SHKAK TË PENGIM POSEDIMIT	107
4.1. Kuptimi, fitimi, mbrojtja, shuarja dhe çështjet tjera rreth posedimit	107
4.2 Objekti i Posedimit.....	108
4.3 Subjekti i Posedimit	108
4.4 Posedimi ligjor dhe jo ligjor.....	108
4.5 Posedimi me mirëbesim dhe jo me mirëbesim.....	109
4.6 Posedimi i drejtë dhe me të meta	109
4.7 Mbrojtja e posedimit – paditë posedimore.....	109
4.8 Aspekte ligjore dhe procedurale juridike përkitazi me pengim posedimin- Disa çështje rreth kompetencës në kontestet për shkak pengimit të posedimit.....	110
4.9 Procedura në kontestet për shkak të pengimit të Posedimit.....	111
4.10 Mjetet e goditjes së aktvendimit.....	112

4.11 Aspekte rreth kontesteve për shkak të pengimit të posedimit nga paraktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës.....	112
5. SHPRONËSIMI DHE SHPRONËSIMI FAKTIK.....	130
5.1 Koncepti i shpronësimit	130
5.2 Shpronësimi formal dhe faktik.....	130
5.3 Shpronësimi formal - Procedura e shpronësimit.....	131
5.4 Shpronësimi faktik	134
5.5 Juridiksioni aktual i gjykatës.....	138
5.6 Shpronësimi faktik dhe vendosja e servitutit në bazë të ligjit.....	138
5.7 Parashkrimi.....	139
5.8 Në vend të një përfundimi.....	140
6. PROCEDURA E GJYKATËS SUPREME NË NJË SITUATË KUR REVIZIONI TREGON DËSHTIMIN E GJYKATËS SË APELIT PËR TU PËRGJIGJUR NDAJ TË GJITHA PRETENDIMEVE ANKIMORE.....	142
6.1 Gjetje nga praktika e Gjykatës Supreme	154
7. KTHIMI I ÇËSHTJEVE NË RIGJYKIM	161
Përmbledhje nga praktika gjyqësore në çështje penale	
Pjesa e I-rë	161
7.1 Shqyrtime të përgjithshme në lidhje me kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet penale	161
7.2 Arsyet për kthimin e çështjes në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë	164
7.3 Arsyet për kthimin e çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.....	166
7.4 Të dhënat statistikore lidhur me kthimin e çështjeve në rigjykim	168
7.5 Nëse aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 të KPP-së	172
7.6 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e dispozitivit të aktgjykimit	182
7.7 Arsyetimi i aktgjykimit	189
7.7 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e arsyetimit të aktgjykimit	194
7.8 Komente përmbledhëse	203
Pjesa e II-të	204
7.9 Pjesëmarrja në shqyrtim gjyqësor e gjyqtarit i cili është dashur të përjashtohet	204
7.10 Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura.....	205
7.11 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e pjesëmarrjes në shqyrtimin e rastit të gjyqtarit i cili është dashur që të përjashtohet.....	209
7.12 Komente përmbledhëse	213

7.13 Mos sigurimi i përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilën i akuzuari nuk e kupton	214
7.14 Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura	215
7.15 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos sigurimit të përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilën i akuzuari nuk e kupton.....	217
7.16 Komente përmbledhëse	221
7.17 Mbajtja e shqyrtimit gjyqësor pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj.....	222
7.18 Komentim i shkurtër i dispozitës ligjore të lartcekur	222
7.19 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj	226
7.20 Komente përmbledhëse	228
Pjesa e III-të.....	229
7.21 Gjykimi në mungesë (“Trial in Absentia”)	229
7.22 Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura	230
7.23 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe e Gjykatës së Apelit të Kosovës në lidhje me gjykimin në mungesë.....	236
7.24 Komente përmbledhëse	241
7.25 Mos njoftimi lidhur me seancën e kolegjit në Gjykatën e Apelit të Kosovës	242
7.26 Komentim i shkurtër i dispozitës së lartcekur ligjore	242
7.27 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos njoftimit për seancën e kolegjit në Gjykatën e Apelit të Kosovës	245
7.28 Komente përmbledhëse	252
7.29 Mos dërgimi i kopjes së ankesës palëve të tjera për të paraqitur përgjigje në ankesë ..	252
7.30 Komentim i shkurtër i dispozitave të lartcekura ligjore	253
7.31 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos dërgimit të kopjes së ankesës palëve të tjera për të paraqitur përgjigje në ankesë	256
7.32 Komente përmbledhëse	260
7.33 Mos vendosja në lidhje me të gjitha ankesat e paraqitura	261
7.34 Komentim i shkurtër i dispozitës së lartcekur ligjore	261
7.35 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos vendosjes së të gjitha ankesave me një vendim	261
8. DISA ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME NË LIDHJE ME SISTEMIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR	264
Pjesa e I-rë	264
8.1. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me sistemin e drejtësisë për të mitur	264
8.2 Karakteristikat e dënimit me burgim për të mitur	266

Pjesa II-të	267
8.3 Disa raste të të miturve nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe aspekte të rëndësishme lidhur e procedurën ndaj të miturve	267
9. NDRYSHIMI I AKTGJYKIMEVE TË INSTANCAVE ME TË ULËTA	296
9.1 Institutet “beneficium cohaesionis” dhe “reformatio in peius”	296
9.2 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me ndalesën “reformatio in peius” dhe zbatimin e institutit “beneficium cohaesionis”	299
9.3 Konfiskimi i pasurisë që është dobi pasurore e veprës penale dhe mjetit të veprës penale	308
9.4 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me konfiskimi i pasurisë që është dobi pasurore e veprës penale dhe mjetit të veprës penale.....	311
9.4 Parashkrimi.....	323
9.5 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me parashkrimin	325
9.6 Konkluzionet	328

Hyrje

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në përmbushje të misionit të saj, harton përmbledhjet e praktikës gjyqësore për të arritur unifikimin e praktikës dhe zbatimin konsistent të ligjit. Këto përmbledhje shërbejnë si një burim thelbësor për adresimin e variacioneve në interpretimin dhe aplikimin e ligjit nga gjykatat e instancave më të ulëta, duke garantuar një standard të përbashkët për të gjitha vendimet gjyqësore.

Po ashtu, qëllimi i hartimit të kësaj përmbledhjeje është të ofrojë zgjidhje për çështjet dhe dilemat me të cilat përballen gjyqtarët e instancave më të ulëta. Ajo gjithashtu synon t'i udhëzojë ata në veprimin e duhur në situata të ngjashme, duke siguruar respektimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare.

Përmbledhja trajton praktikën gjyqësore në dy lëmi, atë civile dhe penale. E para përfshinë aspekte materiale dhe procedurale në fushën civile me theks te kontestet banesore, kontestet për shkak të pengim posedimit, kontestet për shkak të shpronësimit të pronës së paluajtshme, çështja e përgjegjësisë civile për shkak të deklaratave të bëra në media, në çështjet e shpërbërimit të dëmit jo material dhe çështjet e konfliktit të kompetencës

Pjesa e dytë përfshinë aspekte materiale dhe procedurale në fushën penale me fokus te kthimi i çështjeve në rigjykim, pjesëmarrjes së gjyqtarit në shqyrtimin gjyqësor i cili është dashur të përjashtohet, gjykimi në mungesë, ndryshimi i aktgjykimeve të instancave më të ulëta, për aspekte të ndryshme të dënimit me burgim të të miturve si dhe çështje tjera me rëndësi nga lëmi penal.

Falenderojmë autorët dhe të gjithë kontribuesit që mundësuan botimin e kësaj përmbledhjeje nga Praktika Gjyqësore e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në çështjet penale dhe civile, për përkushtimin dhe angazhimin e tyre, me theks të veçantë Akademinë e Drejtësisë dhe projektin Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI) Chemonics.

Fejzullah Rexhepi

Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës

Zenel Leku

1. KONTESTET NGA MARRDHËNIET E PUNËS BAZUAR NË DISKRIMINIM

1.1 Diskriminimi sipas legjislacionit të vendit tonë dhe atij ndërkombëtar

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, akti më i lartë juridik dhe politik i vendit, ajo respekton dhe promovon parimet e barazisë, që janë të pranuar edhe ndërkombëtarisht. Për më tepër, Kushtetuta ndalon çdo formë të diskriminimit. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit gjendet në Nenin 24, i cili thotë se:

- *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- *Parimet e mbrojtjes se barabarte ligjore nuk parandalojnë vënien e masave te nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e te drejtave te individëve dhe grupeve qe janë ne pozite te pabarabarte. Masat e tilla do te zbatohen vetëm derisa te arrihet qëllimi për te cilin janë venë ato”.*

Mbrojtja nga diskriminimi gjendet i parashikuar specifikisht edhe në nenin 14 të KEDNJ-së, i cili shprehimisht parashihet: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirisë të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër. Kjo mbrojtje përforcohet edhe nga neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili ndalon në çdo rast diskriminimin edhe në gëzimin e të drejtave të parashikuara nga ligji.*

Në nivel evropian, parimi i mosdiskriminimit përmendet edhe Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së. Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) ndalon diskriminimin në bazë të kombësisë. Gjithashtu, i mundëson Këshillit të Bashkimit Evropian të ndërmerr veprime të duhura për luftimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, racës ose origjinës etnike, fesë ose besimit, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual. Për më tepër, në vitin 2000, dy direktiva u miratuan: Direktiva për Barazinë në Punësim (Direktiva 2000/78/KE), e cila ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual, besimit fetar, moshës dhe aftësisë së kufizuar në punësim. Direktiva për Barazinë Racore (Direktiva 2000/43/KE), e cila ndalon diskriminimin në bazë të racës ose përkatësisë etnike, në fushën e punësimit, por edhe në fusha të tilla si arsimi, mbrojtja sociale, duke përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, përfitimet sociale, si dhe qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, përfshirë strehimin. Në vitin 2009, Traktati i Lisbonës prezantoi një klauzolë horizontale me synim të integritet të luftës kundër diskriminimit në të gjitha politikat dhe masat e BE-së (neni 10 TFEU). Këto standarde ndërkombëtare dhe rajonale janë përfshirë në nivelin kombëtar të mbrojtjes ligjore përmes

Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Është me rëndësi të theksohet edhe ekzistenca e diskriminimit të shumëfishtë, ku ndodh në bazë të më shumë se një karakteristike të perceptuar. Si i tillë, një person mund të diskriminohet jo vetëm për shkak të përkatësisë së tij etnike, por gjithashtu mund të përfshin elemente të diskriminimit në bazë të gjinisë, orientimit seksual, kombësisë, statusit social, fesë, aftësisë së kufizuar etj. Sipas ligjit të BE-së, diskriminimi i shumëfishtë përmendet ende në përmbledhjet e Direktivës për Barazinë Racore (2000/43/KE) dhe Direktivës për Barazinë në Punësim (2000/78/KE), duke deklaruar se “gratë janë shpesh viktimat të diskriminimit të shumëfishtë”. Prandaj, ndërsa diskriminimi vërtet mund të bazohet në disa baza të mbrojtura, në përputhje me ligjin e BE-së, megjithatë Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJED) konsideron se nuk mund të ketë një kategori të re diskriminimi që përbëhet nga kombinimi i më shumë se një prej këtyre bazave.

Ligj për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Ligji Nr. 05/L -021) në nenin 3 ka rregulluar konceptin e diskriminimit, dhe atë me paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cילו nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji”* Ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se: *“Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlefësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës”*

Me nenin 4 të këtij ligji janë përcaktuar llojet e trajtimit të pabarabartë:

- Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji;
- Diskriminimi i tërthortë konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme;

Nga ana tjetër, Ligji i Punës (Ligji nr. 03/L-212) ofron disa garanci për mbrojtjen nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës. Kështu me nenin 3, pika 1.7 e këtij ligji është bërë përkufizimi i diskriminimit, dhe atë: *“Diskriminimi - çdo dallim që përfshin përjashtim ose dhënie të përparësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjuhës ose anëtarësisë sindikale, që e ka fuqinë e anulimit ose mosdhënies së mundësive të barabarta për punësim apo profesion apo ngritje profesionale. Ndërsa me nenin 5 të këtij ligji është ndaluar çdo formë e diskriminimit, dhe atë: “1.Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen*

e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi. 2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuatë. 3. Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuar që kërkohen për atë vend pune. 4. Punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kritere dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj”

1.2 Kategoritë e diskriminimit

Qëllimi i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi është të krijojë për të gjithë individët një perspektivë të drejtë dhe të barabartë për pasjen e mundësive të disponueshme në një shoqëri. Në aspektin personal ne bëjmë zgjedhje çdo ditë për çështje si p.sh. me kë shoqërohem, ku blejmë apo ku punojmë. Preferojmë disa gjëra dhe disa njerëz dhe jo disa të tjerë, megjithëse të shprehurit e preferencave tona subjektive është e zakonshme dhe normale, mirëpo në kontekste jo-personale, ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndërhyr në zgjedhjet që bëjmë në dy mënyra:

Së pari, parashikon se ata individë që janë në situata të ngjashme duhet të marrin trajtim të ngjashëm dhe jo të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një tipari të caktuar “të mbrojtur” që kanë. Kjo njihet si diskriminim “i drejtpërdrejtë”. Në kontekstin e KEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë është subjekt i një mbrojtjeje të përgjithshme me justifikim objektiv; megjithatë, sipas të drejtës së BE-së mbrojtja kundër diskriminimit të drejtpërdrejtë është disi e kufizuar.

Së dyti, ligji për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon se ata individë që janë në situata të ndryshme duhet të marrin trajtim të ndryshëm deri në masën që nevojitet për t’i lejuar të gëzojnë mundësi të caktuara njësoj si të tjerët. Pra, po këto “shkaqe të mbrojtura” duhet të merren në konsideratë gjatë kryerjes së praktikave të caktuara ose krijimit të rregullave të veçanta. Kjo gjë njihet si diskriminim “i tërthortë”. Të gjitha format e diskriminimit të tërthortë janë subjekt i një mbrojtjeje bazuar në një justifikim objektiv pavarësisht nëse pretendimi bazohet në KEDNJ-në ose në të drejtën Evropiane.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë

Diskriminimi i drejtpërdrejtë përkufizohet më nënë mënyrë të ngjashme nga KEDN-ja dhe e drejta e BE-së. Neni 2(2) i Direktivës së BE-së për Barazinë Raciale thotë se diskriminimi i drejtpërdrejtë “ndodh kur një person trajtohet, është trajtuar ose do të trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një tjetër, në një situatë të krahasueshme për shkak të racës dhe përkatësisë etnike”¹. GJEDNJ përdor formulimin se duhet të ekzistojë një “diferencë në trajtimin e personave në

¹ Direktiva për Barazinë në Punësim, Neni 2(2)(a); Direktiva për Barazinë Gjinore (E rishikuar), Neni 2(1)(a); Direktiva për Trajtimin e Barabartë Gjinor në aksesin dhe ofrimin e Mallrave dhe Shërbimeve, Neni 2(a).

situata analoge ose përkatësisht të ngjashme, e cila “bazohet në një karakteristikë të identifikueshme”²

Diskriminimi i drejtpërdrejtë ndodh kur:

- një individ trajtohet në mënyrë të pafavorshme;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë është një karakteristikë të veçantë që kanë, e cila përfshihet në një “shkak të mbrojtur”.

Trajtimi i Pafavorshëm

Në thelb të diskriminimit të drejtpërdrejtë është trajtimi ndryshe i individit. Pra, elementi i parë i diskriminimit të drejtpërdrejtë është të provuarit e trajtimit të pafavorshëm. Kjo mund të jetë më e lehtë për tu identifikuar të rastet e diskriminimit të drejtpërdrejtë në krahasim me diskriminimin e tërthortë. Disa shembuj kur kemi të bëjmë me trajtim ndryshe, përkatësisht ekzistimin e elementit të diskriminimit të drejtpërdrejtë: marrja e një pensioni më të vogël ose page më të ulët, ndalimi i ushtrimit të një profesioni të caktuar, përjashtimi nga sistemi shkollor publik, dëbimi, moslejimi i mbajtjes së simboleve fetare, refuzimi ose revokimi i pagesave të sigurimeve shoqërore.

Krahasimi

Trajtimi i pafavorshëm do të përcaktohet si diskriminim në rastet kur ai është i pafavorshëm si rezultat i krahasimit të një personi në një situatë të ngjashme. Një padë për pagë më të ulët nuk është pretendim për diskriminim po të mos dëshmohet se paga është më e ulët sesa paga e dikujt të punësuar për kryerjen e një detyre të ngjashme nga i njëjti punëdhënës. Pra në raste të tilla, nevojitet një “krahasues”: d.m.th, një person në rrethana materialisht të ngjashme, me ekzistencën e ndryshimit kryesor ndërmjet dy personave që është “shkak i mbrojtur. P.sh: në çështjen *Ellënbi (Allonby)*, kërkueses, e cila punonte si lektore për një kolegji, kolegji nuk i kishte rinovuar kontratën. Më pas ajo filloi të punonte për një kompani që ofronte lektorë për institucione arsimore. Kjo kompani e dërgoi kërkuesen të punonte në kolegjin e saj të mëparshëm, me detyrën që kishte pasur më parë aty, por e pagoi më pak sesa e kishte paguar kolegji. Ajo pretendoi diskriminim për shkak të gjinisë, duke thënë se lektorët meshkuj që punonin për kolegjin paguheshin më shumë. GJED-ja vendosi se lektorët meshkuj të punësuar nga kolegji nuk ishin në një situatë të krahasueshme. Kjo sepse kolegji nuk ishte përgjegjës për përcaktimin e nivelit të pagesës edhe për lektorët meshkuj që i punësonte drejtpërsëdrejti edhe për kërkuesen, e cila ishte punësuar nga një kompani e jashtme. Për rrjedhim, ato nuk ishin në një situatë mjaftueshmërisht të ngjashme³.

² GJEDNJ, *Karsën dhe të tjerët kundër MB* [GC] (Nr. 42184/05), 16 Mars 2010; paragraf 61 (ECtHR, *Carson and others v. UK* [GC] (No. 42184/05), 16 March 2010). Po kështu, GJEDNJ *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 175 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007);

³ GJED, *Ellënbi kundër Kolegjut Ekringtën dhe Rozëndejll*, Çështja C-256/01 [2004], GJED I-873, 13 Janar 2004 (ECJ, *Allonby v. Accrington and Rossendale College*, Case C-256/01 [2004] ECR I-873, 13 January 2004).

Ekzistimi i karakteristikës së veçantë -shkaku i mbrojtur

Si në ligjin vendor por edhe atë Evropian ekziston lista e “shkaqeve të mbrojtura” për mbrojtjen nga diskriminimi, e që konkretisht përfshinë: gjininë, orientimi seksual, aftësia e kufizuar, moshën, racën, përkatësinë etnike, kombësinë dhe besimin fetar. Që do të thotë se në përbushjen e këtij elementi të diskriminimit paraqitet nevoja e të ekzistojë lidhja kauzale-një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur. Për të përbushur këtë kriter, mund të bëhet një pyetje e thjeshtë: a do të ishte trajtuar në mënyrë më pak të favorshme personi, sikur të ishte i një gjinie tjetër, i një race tjetër, i një moshe tjetër, ose në ndonjë pozitë të kundërt për shkaqe të tjera të mbrojtura? Nëse përgjigjja është po, atëherë trajtimi më pak i favorshëm po shkaktohet nga shkakut në fjalë. Shembull: në çështjen *Kollmen (Coleman)*, një grua pretendonte se ishte trajtuar në mënyrë të pafavorshme në punë, për shkak të faktit se i biri i saj ishte i paafet fizikisht. Invaliditeti i të birit të saj bënte që ajo të vonohej në punë me raste dhe të kërkonte leje që orari t’i përshtatej nevojave të birit të saj. Kërkesat e kërkuësës u refuzuan dhe u kërcënua me pushim nga puna, si dhe merre komente abuzive në lidhje me gjendjen e të birit të saj. GJED-ja pranoi si krahasues kolegët e saj në vende pune të ngjashme dhe me fëmijë, duke konstatuar se atyre u ishte krijuar nga puna fleksibiliteti që kërkonin. Gjykata pranoi gjithashtu se kjo përbënte diskriminim për shkak të paafetësisë fizike të fëmijës së saj⁴

Diskriminimi i Tërthortë

Edhe e drejta e BE-së edhe jurisprudenca e KEDNJ-së pranojnë se diskriminimi mund të rezultojë jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i njerëzve në situata të njëjta, por gjithashtu duke ofruar të njëjtin trajtim për njerëzit në situata të ndryshme. Ky i fundit quhet diskriminim “i tërthortë”, sepse nuk është trajtimi që ndryshon por janë më tepër pasojat e atij trajtimi, që do të ndjehen ndryshe nga njerëzit me karakteristikë të ndryshme. Neni 2(2)(b) i Direktivës për Barazimë Raciale thotë se “diskriminimi i tërthortë do të çmohet se ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë në dukje neutrale do t’i vendoste personat me përkatësi etnike ose raciale në një disavantazh të veçantë në krahasim me persona të tjerë”.⁵ GJEDNJ-ja është bazuar në këtë përkufizim të diskriminimit të tërthortë për disa prej vendimeve të saj të fundit, duke deklaruar se “një ndryshim në trajtim mund të marrë formën e efekteve disproporcionalisht paragjyquese të një politike ose mase të përgjithshme që, megjithëse e mbështjellë me terma neutrale, diskriminon kundër një grupi”.⁶

Elementët e diskriminimit të tërthortë janë si më poshtë:

- një rregull, kriter apo praktikë neutrale;

⁴ GJED, *Kollmen kundër Studiove Ligjor Attridge dhe Steve*, Çështja C-303/06 [2008] I-5603, 17 Korrik 2008 (ECJ, *Coleman v. Attridge Laë and Steve Laë*, Case C-303/06 [2008] I-5603, 17 July 2008).

⁵ Direktiva për Barazimë në Punësim, Neni 2(2)(b); Direktiva për Barazimë Gjimore (e Rishikuar), Neni 2(1)(b); Direktiva e trajtimit të Barabartë Gjitor në Lidhje me aksesin dhe ofrimin e Mallrave dhe Shërbimeve, Article 2(b).

⁶ GJEDNJ, *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 184 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007); GJEDNJ, *Opuz kundër Turqisë* (Nr. 33401/02), 9 Qershor 2009, paragrafi 183 (ECtHR, *Opuz v. Turkey* (No. 33401/02), 9 June 2009); GJEDNJ, *Zarb Adami kundër Maltrës* (Nr. 17209/02), 20 Qershor 2006, paragrafi 80 (ECtHR, *Zarb Adami v. Malta* (No. 17209/02), 20 June 2006).

- që prek një grup të përcaktuar nga një “shkak i mbrojtur” në një mënyrë shumë më negative;
- duke krahasuar të tjerët në një situatë të ngjashme.

Një rregull, kriter ose praktikë neutrale

Kriteri i parë i identifikueshëm është që të ekzistojë një rregull, kriter ose praktikë neutrale, pra duhet të ketë një kriter që zbatohet për të gjithë. Në lidhje me këtë kriter të diskriminimit të tërthortë në vijim është paraqit shembulli: në çështjen *Shënhaite (Schönheit)*, pensionet e punonjësve me kohë të pjesshme u llogaritën duke përdorur një normë të ndryshme nga ajo e punonjësve me kohë të plotë. Kjo normë e ndryshme nuk bazohej tek ndryshimet e kohës së kaluar në punë. Pra, punonjësit me kohë të pjesshme morën një pension më të vogël sesa punonjësit me kohë të plotë, edhe duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e ndryshme të shërbimit, efektivisht nënkuptonte se punonjësit me kohë të pjesshme po paguheshin më pak. Ky rregull neutral për llogaritjen e pensioneve zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë punonjësit me kohë të pjesshme. Megjithatë, për shkak se 88 për qind e punonjësve me kohë të pjesshme ishin gra, efekti i rregullit ishte disproporcionalisht negativ për gratë në krahasim me burrat.⁷ Shembull: në çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (D.H. and others v. the Czech Republic)*, u përdorën një seri testesh për të përcaktuar inteligjencën dhe përshtatshmërinë e studentëve me synimin për të përcaktuar nëse ata duhet të zhvendoseshin nga institucionet e zakonshme arsimore dhe të kalonin në shkollë të posaçme. Këto shkollë të posaçme ishin ngritur për studentët me aftësi të kufizuara inteligjence dhe burime të tjera me vështirësi për të mësuar. I njëjti test u zbatua për të gjithë studentët që shqyrtoheshin për t’u zhvendosur në shkollë të posaçme. Megjithatë, në praktikë testimi ishte krijuar për popullsinë e zakonshme Çeke me pasojën se studentët Rom kishte më shumë të ngjarë të dilnin keq – gjë e cila ashtu ndodhi, me pasojën se nga 50 deri 90 për qind e fëmijëve Rom u arsimuan jashtë sistemit kryesor shkollor. GJEDNJ-ja vendosi se ky ishte një rast i diskriminimit të tërthortë.⁸

Shumë më negative në efektet e tij mbi një grup të mbrojtur

Kriteri i dytë i identifikueshëm është se dispozita, kriteri ose praktika neutrale e vendos një “grup të mbrojtur” në një disavantazh të caktuar. Ja përse diskriminimi i tërthortë ndryshon nga diskriminimi i drejtpërdrejtë sepse e zhvendos fokusin larg nga trajtimi i ndryshëm për të parë efektet e ndryshme.

Gjatë shqyrtimit të provave statistikore që grupi i mbrojtur ndikohet disproporcionalisht në mënyrë negative në krahasim me ata që janë në një situatë të ngjashme, GJED-ja dhe GJEDNJ-ja do të kërkojnë prova se një pjesë veçanërisht e madhe e atyre që preken negativisht përbëhet nga ai “grup i mbrojtur”

Krahasuesi

⁷ GJED, *Hilde Shënhaite kundër Qytetit Frankfurt am Main dhe Silvia Beker kundër Landit Hessen*, Bashkim çështjesh C-4/02 and C-5/02 [2003] ECR I-12575, 23 Tetor 2003 (ECJ, *Hilde Schönheit v. Stadt Frankfurt am Main and Silvia Becker v. Land Hessen*, Joined Cases C-4/02 and C-5/02 [2003] ECR I-12575, 23 October 2003).

⁸ GJEDNJ, *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragraf 79 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007, para. 79)

Si me diskriminimin e drejtpërdrejtë, një gjykatë prapë do të ketë nevojë për një krahasues me qëllimin për të përcaktuar nëse efekti i rregullit, kriterit ose praktikës të caktuar është shumë më negativ sesa ato të provuara nga individët e tjerë në një situatë të ngjashme. Qasja e gjykatave nuk ndryshon në këtë drejtim nga qasja për diskriminimin e drejtpërdrejtë.

1.3 Mbrojtja gjyqësore në rastet e diskriminimit në punë

Ligji për mbrojtje nga diskriminimi në kuadër të fushëveprimit të tij parasheh mbrojtje gjyqësore për personat qoftë fizik apo juridik në rastet kur u janë shkelur të drejta e që kanë të me kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet, pastaj kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës⁹ Nga kjo rezulton se çdo person që pretendon që është viktimë e diskriminimit, sipas dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të parashtrijë padi kundër të paditurit dhe t'i ndërmarrë të gjitha veprimet juridike në gjykatën kompetente, pastaj gjykata në bazë të provave nëse vërteton se i padituri i ka kryer veprime apo mosveprimeve diskriminuese ndaj paditësit mund të vendos që:

- t'i ndalojë të paditurit kryerjen e veprimeve diskriminuese të cilat shkelin ose mund të shkelin të drejtën e paditësit, apo ta detyrojnë të paditurin që t'i eliminojë të gjitha veprimet diskriminuese ndaj paditësit;
- të kompensojë dëmin material ose jomaterial të shkaktuara nga shkelja e të drejtave të mbrojtura me këtë Ligj, sipas padisë për dëmshpërblim¹⁰

Ky ligj mbron punëmarrësit në lidhje me të drejtën e tyre për punësim, pra gjatë procedurës së rekrutimit (shpalljen e vendeve të lira të punës, kriteret e rekrutimit dhe përzgjedhjen e tyre), pastaj mbron punëmarrësit gjatë marrëdhënieve të punës, në lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës; shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfutur nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi, ndalimin e çdo lloj ngacmimi (shqetësimi), përfshirë edhe ngacmimin seksual, nga punëdhënësi përkundrejt një punëmarrësi ose midis punëmarrësve.

Në kuadër të nenit 16 par 4 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Kërkesat nga paragrafi një (1) i këtij neni, mund të paraqiten së bashku me kërkesat për mbrojtjen e të drejtave tjera, për të cilat vendoset në procedurë kontestimore, nëse të gjitha kërkesat janë në lidhje të ndërsjellë dhe nëse gjykata e njëjtë ka kompetencë lëndore për to, pa marrë parasysh nëse për ato kërkesa është përcaktuar vendimmarrje në procedurë të përgjithshme ose të veçantë kontestimore”* Ndërsa me nenin 5 par.4 të Ligjit të Punës është përcaktuar se Dispozitat e Ligjit Kundër Diskriminimit, do

⁹ Shih nenin 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

¹⁰ Shih nenin 16 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të punësuarit dhe punëdhënësit.

Nga dispozitat e sipër theksuara rezulton se pala kërkesën për diskriminim mund ta paraqes krahas ndonjë kërkesë tjetër, ndërsa nga rastet e praktikës gjyqësore rezulton se pala kërkon mbrojtje gjyqësore në lidhje me ndonjë të drejtë të shkelur nga marrëdhënia e punës, p.sh anulim vendimi për ulje të gradës, ku me të rast me padi kërkohet evitohet shkelja apo parregullsia që i është bërë në raport me vendin e punës, por që krahas kësaj pretendohet se është diskriminuar qoftë në aspektin e kushteve të plotësuara për punësim, pagës apo në ndonjë mënyrë është trajtuar në mënyrë të pabarabartë. Çka do të thotë se pala që ngrit pretendime për ekzistim të diskriminimit mbi ndonjë bazë, gjykatat ka për obligim që këtë pretendim ta trajtoj sipas dispozitave të ligjit kundër diskriminimit. Pra mbrojtje gjyqësore të punësuarit i ipet edhe sipas dispozitave të ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, ndërsa në raport me barrën e provës gjykatat duhet që të kenë kujdes që në të gjitha rastet kur pala paditëse pretendon me prova se është diskriminuar nga punëdhënësi mbi ndonjë bazë, atëherë barra e provës i kalon palës së paditur që të provojë të kundërtën e asaj që pretendon pala paditëse në lidhje me diskriminimi.

Në praktikë gjyqësore ndodh që pala paditëse krahas pretendimeve për kundërligjshmëri të vendimit për ndërprerje të kontratës së punës, lartësisë së pagës apo rekrutimit në një vend të caktuar të punës, ngrit edhe çështjen e diskriminimit mbi ndonjë bazë, mirëpo kur gjykatat vendosin lidhur me kërkesëpadinë e paditësit nuk trajtojnë fare pretendimin për diskriminim apo japin arsye në formë të përgjithësuar, shpesh herë me formulim të përgjithshëm si p.sh “ nga rrethanat e rastit nuk rezulton se paditësi është diskriminuar në ndonjë formë”.

Kur pala ngrit pretendime për trajtim të pabarabartë, përkatësisht për ekzistim të diskriminimit qoftë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, atëherë gjykatat kanë për obligim që këtë pretendim ta trajtojnë, ndërsa Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë¹¹ Në këtë pikë, aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (*viktima e diskriminimit*) te punëdhënësi (*autori i diskriminimit*) lidhet me gjendjen e të diskriminuarit, andaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Ndërsa gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se ndërprerja e marrëdhënies së punës, ulja në pozitë, paga etj. nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.

¹¹ Shih nenin 20 të Ligjit që ka përcaktuar barrën e provës.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk e njeh shprehimisht dispozitën për kalimin e barrës së provës. Kur GJEDNJ-ja i shqyrton rastet nga aspekti i provave, Gjykata zakonisht e zbaton parimin “affirmanti incumbit probation” përkatësisht se parashtruesi ose parashtruesja duhet të provojë pohimin e tij/saj. Gjykata zbaton standardin e provës “jashtë dyshimit të arsyeshëm” si standard i zakonshëm për të gjitha të drejtat e përcaktuara me Konventën. Në procedurën para GJEDNJ-së, nuk ekzistojnë pengesa procedurale për pranueshmërinë e provave apo për formula paraparakishtë të paracaktuara mbi të cilat bazohet vlerësimi i tyre. Gjykata i miraton konkluzionet të cilat, sipas saj, mbështeten nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave, përfshirë edhe konkluzionet që mund të rezultojnë nga faktet dhe ankesat e palëve në procedurë. Megjithatë, barra e provës zbatohet nga GJEDNJ-ja, gjë që shihet edhe nga praktika gjyqësore e saj. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit të çështjeve ku është ngritur pretendimi për diskriminim, ka përcaktuar se, pasi kërkuesi ka treguar një ndryshim në trajtim, i takon shtetit përgjegjës të tregojë se trajtimi i ndryshëm ishte i justifikuar¹² Kur Gjykata, bazuar në rrethanat konkrete, pranon që ka një çështje *prima facie* diskriminimi, atëherë barra e provës kalon te shteti përgjegjës për të siguruar justifikimin e tij. Rrethanat specifike të fakteve dhe natyra e pretendimeve në disa raste e bëjnë jashtëzakonisht të vështirë në praktikë për kërkuesin të provojë diskriminimin, ndaj bëhet i nevojshëm kalimi i barrës së provës tek autoritetet përgjegjëse¹³.

Ligji i Punës ofron mbrojtje gjyqësore lidhur me çështjen e diskriminimit, ndërsa në pjesën e përkufizimit të shprehjeve e ka dhen edhe kuptimin e shprehjes diskriminimi duke e përkufizuar si: “*Diskriminimi - çdo dallim që përfshin përjashtim ose dhënie të përparësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjuhës ose anëtarësisë sindikale, që e ka fuqinë e anulimit ose mosdhënies së mundësive të barabarta për punësim apo profesion apo ngritje profesionale*”. Përkufizimi i diskriminimit si shprehje në këtë rast është i ngjashëm me përkufizimin që i bën diskriminimit Ligji kundër Diskriminimit, por duke u kufizuar në specifikat e natyrës së çështjeve që rregullon Ligji i Punës.

Me ligjin e punës është i ndaluar çfarëdo lloj diskriminimi. Kështu me dispozitën e nenit 5 paragrafi 1, të Ligjit të Punës përcaktohet se: “*Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi*”, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet se: “*Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate*” Këto dy dispozita janë bazë e garantimit të mbrojtjes gjyqësore për të gjitha çështje që lidhën me marrëdhëniet e punës duke e përfshirë konkursin për punësimi, kriteret e konkursit, të drejta nga marrëdhënia e punës si: paga, pushimi, sigurimet etj.

Ligji i punës lidhur me çështjen e mos diskriminimit përmban dispozita të veçanta edhe për konkursin publik ku me nenin 8 par 2 të këtij ligji është përcaktuar që: “*Konkursi duhet të jetë i*

¹² Shih Timishev kundër Ruisisë, datë 13.12.2005

¹³ shih Çinçja kundër Rumanisë, datë 18.02.2020

barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe akte tjera në fuqi”.

Mbrojtja gjyqësore e të punësuarve kur i referohet diskriminimit sipas dispozitave të Ligjit të Punës i jep mundësi gjykatës për rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës sipas diskriminimit të kthej të punësuarin në vendin e punës dhe ta detyrojë punëdhënësin në pagesën e pagave. Ligji i punës me dispozitën e nenit 80 paragrafi 1, pika 1.2, përcakton se: *“nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna”.* Nga kjo rezulton se në çdo rast kur gjykatat konstatojnë rrethanë e diskriminimit si shkak i mohimit apo cenimit të ndonjë të drejtë nga marrëdhënia e punës, atëherë duhet që të punësuarit t’i ofrojnë mbrojtjen maksimale dhe adekuate.

Në praktikë rastet me të shpeshta janë rastet e rekrutimit për një vend të caktuar të punës, pastaj rastet e diskriminimit në pagë, pozitë dhe të drejta terja nga marrëdhënia e punës si dhe rastet e procedurave disiplinore. Në praktikën gjyqësore bëhen gabime nga ana e gjykatave kur në procedurën e rekrutimit për ndonjë vend pune kandidati i cili nuk është përzgjedhur kërkon mbrojtje gjyqësore dhe gjykatat anulojnë në tërësi procesin e rekrutimit për atë vend pune. Është me rëndësi që edhe në rastet kur ndonjë person është trajtuar në mënyrë të pabarabartë mbrojtja gjyqësore të ofrohet deri në masë që e mënjanon shkeljen, për shembull nëse në mënyrë të kundërligjshme nuk është përzgjedh personi që kërkon mbrojtje gjyqësore, atëherë nuk është e nevojshme të anulohet konkursi por procesi i përzgjedhjes, e forma të tilla. Pra evitohen shkelje deri në masën që palës i ofrohet garancioni i trajtimit të barabartë. Në procedurë e shkeljeve të ndonjë të drejtë nga marrëdhënia e punës gjykata duhet të analizojnë dhe shqyrtojnë me kujdes çdo kërkesë sipas një baze të tillë. Zakonisht këto kërkesa për trajtim të pabarabartë vlerësohen në relacion me të drejtat e garantuara me ligj dhe aktet tjera nën ligjore si dhe në relacion me të drejta e që gëzojnë punëtorët tjerë për pozita të njëjta apo për punë të njëjta. Në raste e procedurave disiplinore po ashtu është me rëndësi që trajtimi i punonjësve të jetë i barabartë dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjykata gjen se ka bazë për të kualifikuar veprimin e punëdhënësit si veprime që konsumojnë elementët e diskriminimit, atëherë duhet të ofrohet mbrojtja gjyqësore e kërkuar.

Mbrojtja nga diskriminimi gjendet i parashikuar specifikisht edhe në nenin 14 të KEDNJ-së, i cili ndalon shprehimisht kufizimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga kjo Konventë për shkaqe të ndryshme, ku përfshihen edhe pikëpamjet politike dhe prejardhja sociale. Kjo mbrojtje përforcohet edhe nga neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili ndalon në çdo rast diskriminimin edhe në gëzimin e të drejtave të parashikuara nga ligji. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka theksuar se neni 14 i KEDNJ-së gjen zbatim edhe kur shtetet, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, nuk i trajtojnë ndryshe personat situatat e të cilëve janë thelbësisht të ndryshme¹⁴. Sipas *GJEDNJ*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një

¹⁴ *Shih Eëeida dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 15.01.2013*

përkufizim, diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet si “*dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme*” dhe “*bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm*”¹⁵

1.4 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin në punë.

Çështja e diskriminimit në punë ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas mjetit juridik të jashtëzakonshëm Revizioni.

Kështu, në vijim do të paraqiten tri (3) raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë çështja e diskriminimit në pagë, ndërsa njëri prej këtyre rasteve është prish nga Gjykata Kushtetuese.

Aktvendimi Rev.nr.511/23, datë 25.01.2024

Paditësja M. G., nga P., pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë ka paraqitur padi kundër të paditurit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës në P., për kompensim të diferencës së pagës.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1135/20 të datës 15.04.2021, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses M. G., nga P., me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës në P., që në emër të kompensimit të diferencës së pagës të paguaj shumën prej 7,168.35 €, ndërsa në emër të kontributit pensional për diferencën e pagës të paguaj shumën prej 838.40 €, si dhe në emër të tatimit për diferencën e pagës të paguaj shumën prej 796.48 €, si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditëses me aktgjykimin Ac.nr.5934/2021 të datës 10.08.2023, ka vendosur që të refuzoj të pa themeltë ankesën e paditëses M. G., nga P., ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1135/20 të datës 15.04.2021.

Vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes dhe pas administrimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, mori aktgjykimin C.nr.1135/20, të datës 15.04.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

¹⁵ *Shih Biao kundër Danimarkës [DhM], datë 24.05.2016*

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit mes tjerash ka theksuar se, pas vlerësimit të deklarimeve të palëve dhe shqyrtimit të secilës provë, ka gjetur se kërkesëpapia e paditëses është e pa bazuar, ashtu që ka gjetur se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është e punësuar tek e paditura sipas Akt Emërimit të datës 18.03.2013, në pozitën ..., në Klinikën e Pulmologjisë me koeficient H-56 apo 5.4, sikurse nuk ishte kontestuese as rritja e koeficientit të paditëses sipas kontratës së re të punës me nr..., të datës 20.01.2020, me koeficient të ngritur sipas Kodit të Postit H-30 apo 7.2.

Më tej gjykata ka theksuar se nga procedimi gjyqësor ka rezultuar se kontestuese mes palëve ndërgjyqëse në këtë çështje juridike ishte fakti lidhur me pagesën e paditëses nga e paditura në mënyrë retroaktive të diferencës së pagës, për periudhën nga data 03.12.2014 deri më datë 15.01.2020 së bashku me shtesat tjera të pagës bazë. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga vendimi i Inspektoratit të Punës 01 Nr.60-62/19 të datës 13.05.2019, në të cilin është bazuar kërkesëpapia e paditëses, askund nuk përcaktohet se e paditura ka për obligim që në mënyrë retroaktive të paguaj diferencën e pagës për paditësen. Në këtë vendim vetëm se është obliguar që e paditura të ngris koeficientin e paditëses për periudhën e ardhme gjë e cila edhe ka ndodhur sipas kontratës nr..., të datës 20.01.2020. Për më tepër, paditësja në të gjitha kërkesat e saja parashtruar tek e paditura dhe tek inspektorati ka kërkuar nivelizimin - rritjen e koeficientit, mirëpo askund nuk ka kërkuar që të kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e pagave bazë përfshirë edhe shtesat tjera.

Gjykata vlerëson se Akt Emërimi i lëshuar nga e paditura me të cilin ndër të tjera është përcaktuar edhe grada e paditëses është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës, përkatësisht me dispozitat e nenit 11 paragrafi 1, pika 1.8 të Ligjit të Punës, me të cilin është paraparë se: “kontrata e punës duhet të përmbajë “lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër”, në rastin konkret paditësja në tërësi është pajtuar me kushtet e punësimit dhe pozitën përkatëse duke përfshirë edhe lartësinë e pagës bazë të përcaktuar prej 5.4. Pra, lidhur me kushtet e marrëdhënies së punës të parapara me Akt Emërim të lidhur mes paditëses dhe të paditurës, duke përfshirë edhe lartësinë e pagës, përkatësisht gradën sipas së cilës do të paguhet paga e paditëses, është pajtuar edhe vet paditësja me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës tek e paditura. Bazuar në nenin 55 paragrafi 2 të Ligjit të Punës është përcaktuar: “Të drejtën për pagë, pagën shesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës”, në këtë kontekst paditësja duhet të argumentoj me prova materiale ndryshimin e gradës nga punëdhënësi për periudhën kontestuese për të cilën pretendon se ka të drejtë ta realizoj.

Vlerësimet e Gjykatës së Apelit

Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpandinë e paditëses për arsye se në rastin konkret paditësja me të paditurën kanë themeluar marrëdhënie pune, pra në atë kohë paditësja ka pasur Akt Emërim i cili ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore, paditësja është pajtuar me kushtet e punës, e ka pranuar edhe koeficientin që ka qenë i përcaktuar si dhe me këto edhe pagën e caktuar. Neni 55 paragrafi 2 i Ligjit të Punës

përcakton se: “Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës”. Duke pasur parasysh se paditësja me vullnet të plotë e ka nënshkruar akt emërimit dhe është pajtuar me kushtet e kontratës, nuk mund të qëndrojnë pretendimet se të njëjtës i takon diferenca në pagë për periudhën e caktuar. Fakti se paditësja ka nënshkruar më pas kontratë me koeficient të ri, nuk nënkupton se paditëses i takon diferenca në pagë, sepse e njëjta deri më datë 20.01.2020 ka qenë me koeficient tjetër, Akt Emërimi fillestar ka qenë në fuqi deri me këtë datë si dhe nuk është kontestuar asnjëherë ligjshmëria e tij. Pra, kjo gjykatë gjen se pretendimet se e paditura i ka mohuar paditëses kompensimin e pagës nuk qëndrojnë dhe kjo për arsye se paditësja asnjëherë nuk ka theksuar se nuk ka pranuar pagën për punën që ka qenë duke e kryer në pajtim me Akt Emërimin, por çështja ka qenë tek nivelizimi i koeficientit, që pas lidhjes së kontratës së re është caktuar edhe paga tjetër.

Vlerësimi i kolegjit civil të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatare të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë si rezultat i aplikimit të gabuar të drejtës materiale, për çka aktgjykimet patjetër është dashur të prishen dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në këtë rast gjykata e shkallës së parë e as gjykata e shkallës së dytë nuk kanë trajtuar pretendimet e ngritura nga pala paditëse në të gjitha fazat e procedurës e që kanë të bëjnë me diskriminim në pagë, kjo pasi që paditësja pretendon se ka qenë e diskriminuar brenda QKUK, bazuar në akt emërimin e datës 18.03.2013, sipas të cilit akt ka realizuar pagë me koeficient H-56 apo 5.4, ndërsa në klinika tjera brenda QKUK-së, për pozitë të njëjtë, kolegët e saj janë paguar me koeficient më të lartë. Pala paditëse gjatë gjithë procesit gjyqësor ka pretenduar se ka qenë e diskriminuar, duke paraqitur si prova kërkesat e saj të vazhdueshme në Drejtorinë e SHSKUK-së dhe krahasimin e pozitës së saj me kolegët e tjerë në klinika tjera brenda QKUK.

Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë si bazë për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses kanë marrë faktin që paditësja me vullnet ka nënshkruar akt emërimit dhe është pajtuar me kushtet e kontratës përfshirë edhe lartësinë e pagës dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ekziston baza juridike për kompensim të diferencës së pagave. Të dy gjykatat kanë interpretuar nenin 11 paragrafi 1, pika 1.8 dhe nenin 55 paragrafi 2 të Ligjit të Punës, që kanë përcaktuar se çka duhet të përmbajë kontrata e punës dhe çështjen e realizimit të pagës dhe beneficioneve të tjera ashtu siç është përcaktuar me kontratën e punës, mirëpo çështja e paditëses nuk është trajtuar dhe fare nuk janë marrë për bazë dispozitat nga neni 5 i Ligjit të Punës që i referohet ndalimit të gjitha llojeve të diskriminimit dhe po ashtu nuk është marrë për bazë Ligji Kundër Diskriminimit (Ligji Nr.2004/3), që në këtë rast ka qenë obligim ngase pretendimet e ngritura nga paditësja kanë të bëjnë me këtë çështje.

Është i vërtetë fakti se paga, lartësia e saj dhe benificionet tjera punëdhënësi dhe punëtori i përcaktojnë me kontratën e punës, kjo pasi që marrëdhënia e punës konsiderohet si raport kontraktues, mirëpo përveç kësaj është detyrim i punëdhënësit i cili ofron kontratën për nënshkrim për punëtorin që të paguaj punëmarrësit në mënyrë të barabartë, për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, pa diskriminuar. Puna e barabartë ose puna me vlerë të barabartë mbështetet në gjithë kriteret përkatëse, veçanërisht në natyrën e punës, cilësinë dhe sasinë e saj, kushtet e punës, formimin profesional dhe vjetërsinë në punë, përpjekjet fizike dhe intelektuale, përvojën dhe përgjegjësitë.

Nga këto arsye janë prishë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, në mënyrë që në rivendosje të evitohen shkeljet e paraqitura dhe nëse pala ka ngritur çështjen e diskriminimit në pagë në raport me të tjerët, gjykata duhet të fokusohet në trajtimin e fakteve që japin përgjigje në atë se ka apo jo diskriminim sipas ndonjë baze të përcaktuara me ligjet e sipërcituara, pra a ka pasë dallim në trajtim me kolegët e tjerë dhe kategoria e të punësuarve të cilëve u është referuar paditësja, a janë në situata të “ngjashme dhe/ose analoge”. Nëse paditësja pretendon se për periudhën 03.12.2014 deri më datën 15.01.2020 është diskriminuar në pagë pasi që për pozitën e njëjtë në këtë periudhë është paguar me koeficient më të ulët se kolegët e saj që kanë punuar në të njëjtën pozitë, atëherë gjykata është dashur të jep përgjigje lidhur me këtë se a kemi të bëjmë me punën e njëjtë, kualifikimin e njëjtë dhe në të njëjtën periudhë kolegët e paditëses çfarë koeficienti kanë pas.

Aktvendimi Rev.nr.110/24, datë 27.08.2024

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja Xh.R nga Prishtina, në gjykatën e shkallës së parë, më datë 07.07.2016, ka ushtruar padi kundër të paditurit Telekom i Kosovës, Sh.a., me seli në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e vendimeve nr. 01-4145/69/15 të datës 02.09.2015, si dhe nr. 05-1950/16 të datës 17.05.2016 dhe pagesën e diferencës së pagës, kërkesë kjo e precizuar me parashtrësën e datës 01.10.2019 ku është kërkuar vetëm kompensimi i diferencës në pagë, për periudhën kontestuese prej datës 10.05.2016 deri më datë 31.07.2019.

Vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë

Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar në tërësi kërkesëpandinë e paditëses, me arsyetim se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësja ka qenë e punësuar te e paditura si udhëheqëse e shpërndarëseve me gradë 10. Me dy aktvendimet e të paditurës, nr. 01-4145/69/15 të datës 02.09.2015 dhe nr. 05-1950/16 të datës 17.05.2016, e paditura është risistemuar me gradë 10. Kjo çështje është kundërshtuar nga paditësja, ndaj dy vendimeve të të paditurës, me arsyetim se është palë e dëmtuar, sepse stafi si ajo me punë te e paditura paguhen me pagë grada 11. Kjo gjykatë më tej ka shtuar se pala e paditur nuk ka sjellë kurrfarë provash që kishin me kontestuar këtë çështje sipas kontestit. Po ashtu është vlerësuar se dy vendimet mbi risistemazim të paditëses, të vitit 2015 dhe 2016 nga e paditura janë nënshkruar vetëm nga pala e paditur, e jo edhe nga paditësja. Paditësja e pakënaqur të dyja vendimet i ka kundërshtuar dhe për këtë pasi nuk ka marrë përgjigje pozitive, ka paraqitur padi në gjykatë.

Vlerësimet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurit, ka aprovuar të themeltë ankesën e të paditurit dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë duke e refuzuar në tersi kërkesëpadinë e paditëses. Sipas kësaj gjykate paditësja nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar faktin e kunderligshmërisë së aktvendimeve nr. 01-4145/69/15 të datës 02.09.2015, si dhe nr. 05-1950/16 të datës 17.05.2016, me të cilin është risistemuar paditësja në vendet e punës, pasi që marrja e një aktvendimi të tillë është në kompetenca të punëdhënësit - të paditurës, e cila varësisht nga nevoja në punë bënë risistemimin e punëtorëve në pozita të punës, gjë që edhe në rastin konkret ka vepruar edhe me paditësen, ku e njëjta fillimisht është pajtuar me risistemimin nga punëdhënësi ku ka dhënë edhe pëlqimin e saj për risistemim, e po ashtu e njëjta me vullnet të plotë ka nënshkruar edhe kontratën e punës me gradën 9, por edhe më vonë me gradën 10. Andaj, lidhja dhe nënshkrimi i kontratës së punës nga paditësja dhe deklarimi i saj rreth pajtimit për risistemim, për Gjykatën e Apelit paraqet shprehje e vullnetit të paditëses për të lidhur kontratë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara si në këtë kontratë.

Pretendimet e paditëses të parashtruara me padi dhe të potencuara në shqyrtim gjyqësorë në gjykatën e shkallës së parë, në lidhje me diskriminim për shkak të pagës "për punë të njëjtë, pagë të njëjtë", Gjykata e Apelit nuk i morri për bazë, pasi që paditësja me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetojë faktin se ka qenë e diskriminuar nga e paditura në lidhje me këtë fakt, kjo pasi që në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë provë që vërteton faktin e diskriminimit, por përkundrazi, Gjykata Apelit ka vërtetuar se e paditësja është pajtuar me nënshkrimin e kontratës së punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ajo kontratë dhe në raste të tilla nuk mund të pretendohet në diskriminim, pasi që e njëjta që në fillim të risistemimit ka mundur të kundërshtoj risistemimin. E që në rastin konkret paditësja ka dështuar të paraqes prova për vërtetimin e faktit se e njëjta ka qenë e detyruar të nënshkruaj kontratën e punës, apo edhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për risistemim, por edhe të diskriminimit, pasi që e njëjta në këtë drejtim nuk ka ofruar asnjë provë të vetme, ashtu siç përcaktohet me nenit 7.1 të LPK-së.

Për bazë ligjore gjykata i është referuar neneve 10, 11, 17 paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 450 të LPK-së.

Vlerësimet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta, si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2, n) të LPK-së dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 204 të LPK-së, për çka aktgjykimet patjetër është dashtë të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Sipas kësaj gjykate nga arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe ai shkallës së dytë nuk mund të kuptohet arsyeja e pranimit dhe e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses. Fillimisht është e paqartë se cila është kërkesa e palës paditëse në këtë rast, pra a kemi të bëjmë vetëm me kërkesën për kompensim të diferencës së pagës nga grada 10 në atë 11, siç është kërkuar me parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë të datës 01.10.2019, apo kemi edhe kërkesë për anulim të vendimeve të të paditurës, me të cilat është vendosur lidhur me çështjen e pozitës së punës dhe lartësisë së kompensimit. Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye në lidhje me aprovimin e kërkesës dhe anulimin e këtyre vendimeve, siç nuk ka dhënë arsye as gjykata e shkallës së dytë për refuzimin e kërkesës në këtë aspekt.

Nëse kërkesa ka qenë për anulim të këtyre vendimeve, atëherë të dy gjykatat është dashur të deklarohen në lidhje me kundërshtimin e të paditurës rreth afatshmërisë së padisë, kjo pasi që me këto vendime nuk është prek vetëm çështja e kompensimit por se është prekur edhe pozitiva-vendi i punës që është përcaktuar me kontratën bazë. Andaj është më se e nevojshme të qartësohet në këtë rast se a kemi kërkesë për anulim të vendimeve, apo vetëm kërkesë për kompensim të diferencës së pagës sipas gradave. Nëse këto vendime janë cilësuar të paligjshme, atëherë cili është efekti i anulimit të tyre në raport me pozitën dhe lartësinë e pagës, pastaj cila pozitë dhe cila lartësi e pagës duhet të merret për bazë në këtë rast referuar kërkesës së padisë.

Gjykata e Apelit ka dhënë arsye të paqarta dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës në lidhje me çështjen e themelimit të marrëdhënies së punës sipas kontratës së punës dhe vendimit nr. 01-4145/69/15, të datës 02.09.2015, kjo pasi që gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se e paditura njëherë ka marrë vendimin e sipër theksuar e më pas ka lidhur kontratën e punës nr. 01-4145/69/2015, datë 02.09.2015. Një konstatim i tillë është i paqëndrueshëm ngase nga vendimi i sipër theksuar rezulton se paditëses i është ndërruar pozita e përcaktuar me kontratë dhe atë nga pozita e përcaktuar me kontratë si Analiste për Rrezik dhe Mashtime është sistemuar në pozitën Udhëheqës i fillshpërndarësve (MDF, ndërsa në pikën IV të vendimit është konstatuar se vendimi është pjesë përbërëse e kontratës nr. 01-4145/69/2015, datë 02.09.2015. Nga kjo rezulton se paditësja ka vazhduar të jetë në marrëdhënie pune sipas kontratës së vitit 2015, por që me vendim që mban të njëjtën datë si të kontratës i është ndërruar vetëm pozita, ndërsa grada ka mbet e njëjtë si në kontratë - grada 9.

E paditura ndërkohë merr vendimin me numër 05-1950/2016 të datës 17.05.2016, me të cilin sërish paditëses i ndërrohet vendi i punës nga pozita Udhëheqës i fillshpërndarësve (MDF) në Udhëheqës MDF, Regjioni i Prishtinës - Departamenti Teknik, por që në këtë rast i caktohet kompensimi i pagës sipas gradës 10, ku edhe në këtë vendim, përkatësisht pikën IV të tij është cekur se ky vendim është pjesë përbërëse e kontratës nr. 01-4145/69/2015, datë 02.09.2015. Që rezulton se kontrata është e njëjtë, por vetëm është ndërruar pozita dhe koeficienti.

Të dy gjykatat janë marrë me ligjshmërinë e aktvendimit të parë nr. 01-4145/69/15, të datës 02.09.2015, ndërsa paditësja në procesverbalin e datës 06.05.2019 ka deklaruar se periudha kontestuese për të është ajo prej datës 10.05.2016 që ka të bëjë me aktvendimin e dytë dhe se për këtë periudhë kërkon kompensimin e diferencës mes gradës 10 dhe asaj 11. Nga kjo rezulton se

vendosja nga dy gjykatat është e paqartë dhe në kundërshtim me atë që është kërkuar dhe deklaruar nga pala paditëse në proces gjyqësor.

Sipas kësaj gjykate të dy gjykatat e instancës më të ulët kanë dështuar me trajtuar kërkesën e paditëses në raport me pretendimet e saj në diskriminim në pagë, kjo pasi që paditësja në të gjitha fazat e procedurës ka deklaruar se është diskriminuar në pagesë pasi që kolegët e saj për punën e njëjtë paguhen me gradë 11 ndërsa ajo është paguar me gradën 10. Pala paditëse për këtë si provë ka prezantuar ankesat drejtuar të paditurës, por që për ankesat e tilla nuk ka marrë përgjigje.

Gjykata e shkallës së parë nuk e ka trajtuar fare çështjen e diskriminimit, ndërsa ajo e shkallës së dytë si bazë për refuzimin e kërkesëpadsisë së paditëses kanë marrë faktin që paditësja është pajtuar me risistemimin ku e njëjta fillimisht është pajtuar me risistemimin nga punëdhënësi ku ka dhënë edhe pëlqimin e saj për risistemim, e po ashtu e njëjta me vullnet të plotë ka nënshkruar edhe kontratën e punës me gradën 9 por edhe më vonë me gradën 10. Gjykata e shkallës së dytë ka interpretuar nenin 11 paragrafi 1, pika 1.8 dhe nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, që kanë përcaktuar se çka duhet të përmbajë kontrata e punës dhe çështjen e realizimit të pagës dhe beneficioneve të tjera ashtu siç është përcaktuar me kontratën e punës, mirëpo çështja e paditëses nuk është trajtuar dhe fare nuk janë marrë për bazë dispozitat nga neni 5 i Ligjit të Punës që i referohet ndalimit të gjitha llojeve të diskriminimit dhe po ashtu nuk është marrë për bazë Ligji Kundër Diskriminimit (Ligji Nr.2004/3), që në këtë rast ka qenë obligim ngase pretendimet e ngritura nga paditësja kanë të bëjnë me këtë çështje.

Është i vërtetë fakti se paga, lartësia e saj dhe beneficionet tjera punëdhënësi dhe punëtori i përcaktojnë me kontratën e punës, kjo pasi që marrëdhënia e punës konsiderohet si raport kontraktues, mirëpo përveç kësaj është detyrim i punëdhënësit i cili ofron kontratën për nënshkrim për punëtorin që të paguaj punëmarrësit në mënyrë të barabartë, për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, pa diskriminuar. Puna e barabartë ose puna me vlerë të barabartë mbështetet në gjithë kriteret përkatëse, veçanërisht në natyrën e punës, cilësinë dhe sasinë e saj, kushtet e punës, formimin profesional dhe vjetërsinë në punë, përpjekjet fizike dhe intelektuale, përvojën dhe përgjegjësitë.

Nga këto arsye janë prishë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, në mënyrë që në rivendosje të evitohen shkeljet e paraqitura ku fillimisht duhet të qartësohet se cila është kërkesa e palës paditëse dhe nëse pala ka ngritur vetëm çështjen e diskriminimit në pagë në raport me të tjerët, gjykata duhet të fokusohet në trajtimin e fakteve që japin përgjigje në atë se ka apo jo diskriminim sipas ndonjë baze të përcaktuara me ligjet e sipërcituara, pra a ka pas dallim në trajtim me kolegët e tjerë dhe kategoria e të punësuarve të cilëve u është referuar paditësja, a janë në situata të "ngjashme dhe/ose analoge". Nëse paditësja pretendon se për periudhën e caktuar është diskriminuar në pagë pasi që për pozitën e njëjtë në këtë periudhë është paguar me gradë më të ulët se kolegët e saj që kanë punuar në të njëjtën pozitë, atëherë gjykata është dashur të jep përgjigje lidhur me këtë se a kemi të bëjmë me punën e njëjtë, kualifikimin e njëjtë dhe në të njëjtën periudhë kolegët e paditëses në çfarë grade kanë marrë kompensimin.

Aktgjykimi Rev.nr.451/2022, datë 23.11.2022

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2906/12 dt. 28.04.2015, është refuzuar si e pabazuar kërkesë padia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura të nënshkruaj apo të lidh një kontratë të rregullore të punës me paditësin, i cili tashmë ka kontratë të lidhur me të paditurën të datës 01.07.2009. T'ia paguaj paditësit diferencën në koeficientin në pagën bazë me koeficientin e kolegëve të tij respektivisht të aktorëve, dhe atë nga fillimi i periudhës diskriminuese 01.07.2011 në shumë prej 4201 euro (deri më datën 31.01.2015, ku pas kësaj date për shkak të vazhimit të diskriminimit do të paguhet plus 101 euro në muaj), si dhe në emër të demit jo material të shkaktuar gjatë periudhës kohore diskriminuese (përfshirë shkeljet e dinjitetit, presionit psikik, humbjen e kohës dhe energjisë, shqetësimet shpirtërore, ankthin, mospërmbushjen e planeve profesionale, si dhe efektet anësore që kanë ndikuar në jetën familjare), e paditura ti paguaj kompensimin në shumën monetare prej 8.000 €, që në total i bie $8000+4201 = 12201\text{€}$, me kamatë vjetore sipas përqindjes së mjetëve të deponuara në bankë që nga data 1.07.2011. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur poashtu, që secila pale t'i bart shpenzimet e veta të procedurës.

Duke vepruar sipas ankesës së parashtruar të paditësit, Gjykata e Apelit në Prishtinë ka nxjerrë aktgjykimin Ac.nr.3544/15 dt. 15.11.2019, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme ka mbështetur qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulët, ndërsa ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e paditësit të paraqitura në revizion e që kanë të bëjnë me diskriminimin, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe precizë ka arsyetuar se paditësi nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme në raport me kolegët tjerë aktorë që kanë qenë në situatë të njëjtë si paditësi në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar pretendimet e përsëritura në revizion, se parashtruesi i revizionit, respektivisht paditësi ka qenë i diskriminuar në veçanti në raport me aktorin Sh.K, mirëpo duke marrë parasysh dispozitat e nenit 3 pika a) dhe b) të Ligjit kundër diskriminimit (Ligji nr. 2004/3), si dhe vendimet e gjykatave të instances më të ulët, Gjykata Supreme nuk ka konstatuar se parashtruesi i revizionit është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të disfavorshme në raport me kolegun e përmendur këtu.

1.5 Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastet e diskriminimit në punë

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në disa nga vendimet e saj ka trajtuar çështjet që janë ngritur në lidhje me diskriminimin në punë.

Në rastin *Jurjiy kundër Kroacisë*¹⁶, çështja ishte ngritur nga parashtruesja me pretendim të ekzistimit të diskriminimit të pajustificuar, i drejtpërdrejtë gjinor për shkak të refuzimit të

¹⁶ Rasti Jurjiy kundër Kroacisë, datë 4 shkurt 2021

përfitimit lidhur me punësimin për gruan shtatzënë që iu nënshtrua fekondimit *in vitro*. Kërkesja kishte lidh kontratë pune dhjetë ditë pasi ajo i ishte nënshtruar fekondimit *in vitro*. Kur më pas ajo shkoi në pushim mjekësor për shkak të komplikimeve të lidhura me shtatzëninë, autoriteti përkatës administrativ rishqyrtoi statusin e saj të sigurimit shëndetësor dhe refuzoi kërkesën e saj për sigurim si person i punësuar, duke arritur në përfundimin se punësimi i saj kishte qenë fiktiv. Kërkesja u ankuar se ajo ishte diskriminuar, si një grua shtatzënë që ishte nënshtruar fekondimit *in vitro*, për shkak të revokimit të statusit të saj si punonjëse e siguar, në kundërshtim me nenin 14 të Konventës, të lexuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 i Konventës.

GJEDNJ ketë rast e ka trajtuar bazuar në atë se:

A ka pasur një ndryshim në trajtim e kërkeses

Gjykata vëren se kërkesja u ankuar se ajo ishte trajtuar ndryshe si në bazë të gjinisë së saj ashtu edhe për shkak të mënyrës në të cilën ajo kishte mbetur shtatzënë.

Sipas Gjykatës vetëm gratë mund të trajtohen ndryshe për shkak të shtatzënisë, dhe për këtë arsye një ndryshim i tillë në trajtim do të çojë në diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të seksit nëse nuk justifikohet. Në çështjen në fjalë, kërkeses iu refuzua statusi i një punonjësi të siguar dhe, në këtë kontekst, një përfitim në lidhje me punësimin (kompensim për humbjen e pagës gjatë pushimit mjekësor), për shkak të punësimit të saj, i cili ishte shpallur fiktiv për shkak të shtatzënisë së saj.

Gjykata vëren se një vendim i tillë mund të merret vetëm për gratë, pasi vetëm gratë mund të mbeten shtatzënë. Prandaj, ajo konstaton se në rastin e ankuesit, ai vendim përbënte një ndryshim në trajtim për shkak të gjinisë.

Nëse ndryshimi në trajtim ishte i justifikuar

Gjykata vëren se, në vendosjen e çështjes së ankuesit, autoritetet vendase u kufizuan në përfundimin se, për shkak të *in vitro* fekondimi, ajo kishte qenë e papërshtatshme nga pikëpamja mjekësore për të marrë punën në fjalë, duke nënkuptuar kështu se ajo duhej të përmbahej nga kjo derisa të konfirmohej shtatzënia e saj. Gjykata vëren se ky përfundim ishte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare. Për më tepër, ishte e barabartë me dekurajimin e kërkeses nga kërkimi i punësimit për shkak të një shtatzënie të mundshme.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se autoritetet Kroate nuk kanë arrit me argumentu se kishte ndonjë arsye për ta trajtuar ndryshe kërkesen. Andaj, si përfundim, Gjykata konstaton se një refuzim për të punësuar ose dhënë një përfitim në lidhje me punësimin për një grua shtatzënë për shkak të shtatzënisë së saj përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë, i cili nuk mund të justifikohet nga interesat financiare të shtetit. Në bazë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se ndryshimi në trajtimin ndaj kërkeses, si një grua që kishte mbetur shtatzënë me anë të *in vitro*

fekondimi, nuk ishte objektivist i justifikuar ose i nevojshëm në rrethanat. Rrjedhimisht, ka pasur një shkelje të nenit 14 të pranuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në disa prej vendimeve ka trajtuar çështjen e diskriminimit, duke konstatuar shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, që parasheh Parimin e barazisë dhe mos diskriminimit në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

Në rastin nr. KI04/12, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga gjykata që të ekzekutoj vendimin e KPM-se me të cilin punëdhënësi ishte i obliguar që atë ta kthej në vendin e punës. Gjykatat kishte refuzuar kërkesën për ekzekutim, me arsyetim se vendimi nuk është titull përmbarues, ndërsa për raste të njëjta e njëjta gjykatë vendimet e natyrës së njëjtë i ka trajtuar si titull përmbarues. Mbi këtë bazë paraqitësi i kërkesës ka pretenduar se me vendosje në këtë mënyrë nga gjykata janë shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit i Kushtetutës, si dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt dhe neni 14 [Ndalimi i diskriminimit i KEDNJ-se).

Gjykata Kushtetuese në trajtimin e këtij rasti ka gjetur se ka pasur shkelje të nenit nenin 24 (Barazia para Ligjit) të Kushtetutës, duke konstatuar që dallim diskriminues në trajtim përbën shkelje të së drejtës për trajtim të barabartë para ligjit. Ekzistimin e diskriminimit në trajtim të rastit të parashtruesit kjo gjykatë e ka mbështetur në atë se e njëjta gjykatë në disa nga vendimet e saj vendimet e KPM-se i ka konsideruar përfundimtare dhe të ekzekutueshëm në procedurë administrative, ndërsa në rastin e parashtruesit e njëjta gjykatë vendosi ndryshe. Gjykata ka konstatuar se Gjykatë e Qarkut nuk i ka marrë parasysh vendimet e veta të mëparshme për ta kualifikuar dhe gjykuar rastin e parashtruesit në përputhje me vendimet e veta duke u bazuar në parimin e të drejtës për trajtim të barabartë, si kishte vendosur me parë në raste me rrethana plotësisht të ngjashme si të rastit të parashtruesit.

Në ndërlidhje me këtë rast, gjykata ka konstatuar se GJEDNJ ka vlerësuar se neni 14 i KEDNJ-se i mbron personat që janë venë në situata të ngjashme nga dallimet diskriminuese në trajtim. Përveç kësaj, GJEDNJ theksoi në rastin Fredrin, në mënyrë që kërkesa e parashtruesit të jetë e suksesshme, duhet të konstatohet, ndër të tjera, që situata në të cilën gjendet viktimi e supozuar mund të konsiderohet e ngjashme me situatën e personave që kanë pasur trajtim me të mirë¹⁷ GJEDNJ ka theksuar se është obligim i gjykatave ose organeve lokale të tregojnë dhe dëshmojnë se trajtimi i një rasti ndryshe nga rastet e tjera me rrethana të ngjashme duhet të mbështetet me prova, të jetë bindes dhe i arsyetuar mirë.

1.6 Të gjeturat nga praktika gjyqësore për raste e tilla

Nga praktika e deritanishme gjyqësore për raste të tilla, Gjykata Supreme ka vërejtur se gjykatat e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë trajtojnë çështje të kontesteve të punës, në të cilat palët mbi bazën e diskriminimit kërkojnë anulimi të ndonjë vendimi, me të cilin pretendohet se u janë cenuar të drejta nga marrëdhënia e punës, apo kompensimi i pagave, mirëpo çështja e

¹⁷ Shih Fredrin kunder Suedise, Aktgjykimi i 18 shkurtit 1991, Seria A, nr. 192; (1991) 19 EHRR 784).

diskriminimit nuk trajtohet fare, apo ipet një arsyetim i përgjithshëm se në këtë rast nuk ka diskriminim, pa u dhënë arsye konkrete dhe në baza të dispozitave ligjore që rregullojnë çështjen e diskriminimit, qoftë atij drejtpërdrejt apo të tërthortë.

Në rastin e parë të paraqitur Rev.nr.511/23, datë 25.01.2024, Gjykata Supreme ka vlerësuar se as gjykata e shkallës së parë e as gjykata e shkallës së dytë nuk kanë trajtuar pretendimet e ngritura nga pala paditëse në të gjitha fazat e procedurës e që kanë të bëjnë me diskriminim në pagë, kjo pasi që paditësja ka pretenduar se ka qenë e diskriminuar brenda QKUK, bazuar në akt emërimin e datës 18.03.2013, sipas të cilit akt ka realizuar pagë me koeficient H-56 apo 5.4, ndërsa në klinika tjera brenda QKUK-së, për pozitë të njëjtë, kolegët e saj janë paguar me koeficient më të lartë. Pala paditëse gjatë gjithë procesit gjyqësor ka pretenduar se ka qenë e diskriminuar, duke paraqitur si prova kërkesat e saj të vazhdueshme në Drejtorinë e SHSKUK-së dhe krahasimin e pozitës së saj me kolegët e tjerë në klinika tjera brenda QKUK.

Në këtë rast asnjëra nga gjykatat nuk ka trajtuar çështjen e diskriminimit, ndërsa në raport me lartësinë e pagës kanë vlerësuar se paditësja me vullnet ka nënshkruar akt emërimin dhe është pajtuar me kushtet e kontratës përfshirë edhe lartësinë e pagës dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ekziston baza juridike për kompensim të diferencës së pagave. Një konstatim i tillë është vlerësuar i papranueshëm nga Gjykata Supreme, me vlerësim se është e saktë që paga, lartësia e saj dhe beneficionet tjera punëdhënësi dhe punëtori i përcaktojnë me kontratën e punës, kjo pasi që marrëdhënia e punës konsiderohet si raport kontraktues, mirëpo përveç kësaj është detyrim i punëdhënësit i cili ofron kontratën për nënshkrim për punëtorin që të paguaj punëmarrësit në mënyrë të barabartë, për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, pa i diskriminuar.

Në këtë rast Gjykata Supreme ka prishë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, duke kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që: nëse pala ka ngritur çështjen e diskriminimit në pagë në raport me të tjerët, gjykata duhet të fokusohet në trajtimin e fakteve që japin përgjigje në atë se ka apo jo diskriminim sipas ndonjë baze të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligji i Punës, pra a ka pas dallim në trajtim me kolegët e tjerë dhe kategoria e të punësuarve të cilëve u është referuar paditësja, a janë në situata të “ngjashme dhe/ose analoge”.

Edhe në rastin e dytë Rev.nr.110/24, datë 27.08.2024, Gjykata Supreme ka konstatuar se të dy gjykatat e instancës më të ulët kanë dështuar me trajtuar kërkesën e paditëses në raport me pretendimet e saj në diskriminim në pagë, kjo pasi që paditësja në të gjitha fazat e procedurës ka deklaruar se është diskriminuar në pagesë pasi që kolegët e saj për punën e njëjtë paguhen me gradë 11 ndërsa ajo është paguar me gradën 10. Pala paditëse për këtë si provë ka prezantuar ankesat drejtuar të paditurës, por që për ankesat e tilla nuk ka marrë përgjigje.

Në të dy rastet e paraqitura rezulton se për gjykatat e instancës më të ulët e mjaftueshme ka qenë që pala paditëse me vullnet ka nënshkruar kontratën e punës, në të cilën është parapa edhe lartësia e pagës, duke interpretuar vetëm nenin 11 paragrafi 1, pika 1.8 dhe nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit të Punës (që kanë përcaktuar se çka duhet të përmbajë kontrata e punës dhe çështjen e realizimit të pagës dhe beneficioneve të tjera ashtu siç është përcaktuar me kontratën e punës), por që fare nuk është trajtuar çështja e ngritur që ka të bëjë me diskriminim në pagë, përkatësisht a ekziston detyrimi i punëdhënësit i cili ofron kontratën për nënshkrim për punëtorin që të

paguaj punëmarrësit në mënyrë të barabartë, për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, pa diskriminuar. Puna e barabartë ose puna me vlerë të barabartë mbështetet në gjithë kriteret përkatëse, veçanërisht në natyrën e punës, cilësinë dhe sasinë e saj, kushtet e punës, formimin profesional dhe vjetërsinë në punë, përpjekjet fizike dhe intelektuale, përvojën dhe përgjegjësitë.

Në rastin e tretë Rev.nr.451/2022, rezulton se që nga fillimi i procedurës, ishin shtruar dy çështje: (i) kalimi i kontratës mbi vepër, në kontratë të rregullt të punës, bazuar në ndryshimet e mëvonshme të legjislacionit, dhe (ii) kompensimi i dëmit material, të shkaktuar si pasojë e diskriminimit në koeficient dhe pagë. Padiësi kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore, duke i ngritur si kontestuese këto dy çështje. Gjykata Themelore përkitazi me të parën, e kishte refuzuar padinë, me arsyetimin se nuk ishte plotësuar kriteri ligjor për ndryshim të kontratës. Ndërsa sa i përket të dytës, kishte konstatuar se nuk ka diskriminim në vendin e punës, në raport me kolegët tjerë aktorë të TKK-së. I pakënaqur me këtë konstatim, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e Cila i kishte dhënë të drejtë gjetjeve të Gjykatës Themelore, duke vërtetuar kështu aktgjykimin e saj. Padiësi, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, kishte ushtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, dhe kjo e fundit e kishte trajtuar kërkesën e tij në dy aspekte, e para sa i përket kërkesës për legalizimin të vendit të punës, dhe e dyta për sa i përket diskriminimit në vendin e punës, në raport me kolegët e tij aktorë, ashtu siç kishin konstatuar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë.

Në raport me çështjen e diskriminimit në këtë rast, Gjykata Suprem ka vlerësuar të pabazuara pretendimin për diskriminim me konstatim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe precizë ka arsyetuar se padiësi nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme në raport me kolegët tjerë aktorë që kanë qenë në situatë të njëjtë si padiësi në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Bazuar në dispozitat e nenit 3 pika a) dhe b) të Ligjit kundër diskriminimit (Ligji nr. 2004/3), si dhe vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, Gjykata Supreme nuk ka konstatuar se parashtruesi i revizionit është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të disfavorshme në raport me kolegun e përmendur.

Ky rast është trajtuar në Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin nr. KI137/23 ka prish aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje, me vlerësim se Gjykata Suprem ka shkelur të drejtën e palës për me pas vendim të arsyetuar, si një nga komponentët e të drejtës së përgjithshme për një gjykim të drejtë që garanton drejtësi procedurale të mishëruar në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

Kjo gjykatë mungesën e arsyetimit e ka ndërlidhur me mos adresim të pretendimeve të padiësit për diskriminim në pagë, e cila kishte mbetur si çështje kontestuese mes palëve. Kjo gjykatë ka obliguar Gjykatën Supreme që në rigjykimin e kësaj çështjeje, në mënyrë të saktë dhe pa dykuptimësi të konstatojnë nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, referuar periudhës kohore 1 korrik 2011 - 30 prill 2015, ekziston diskriminim në page. Në këtë rast gjykata nuk është lëshuar sa i përket pretendimit për ekzistim të diskriminimit në kuptim të nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së, pasi që Gjykatës Supreme i është dhënë mundësia që në procedurën e rigjykimit të trajtojë specifikisht çështjen e diskriminimit.

Nga vendimet e sipër theksuara rezultojnë se në kontestet e punës kur ngritët çështja e diskriminimit mbi cilën do bazë, gjykatat e të gjitha instancave kanë për obligim që këtë pretendim ta adresojnë dhe të japin arsye të qarta se ekziston apo jo diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, qoftë në pikëpamje të pranimit ose largimit nga puna, ndryshimit të vendit të punës, kompensimit të pagës etj. Mos adresimi i pretendimit për diskriminim nga gjykata e shkallës së parë përbën shkelje esenciale të dispozitave procedurale, që për pasoj mund të vë deri të prishja e aktgjykimit të shkallës së parë. Ndërsa mos adresimi i pretendimeve ankimore për diskriminim nga Gjykata e Apelit, përbën shkak për anulim të vendimit nga Gjykata Supreme. Një gjë e tillë tashmë është konstatuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, ku mos adresimin e pretendimeve të paditësit për ekzistim të diskriminimit në pagë e ka vlerësuar si shkelje e të drejtës për me pas vendim të arsyetuar.

Si përfundim, në çdo rast kur pala ngrit pretendime për ekzistim të diskriminimit mbi ndonjë bazë, gjykatat kanë për obligim që këtë pretendim ta trajtojnë dhe mbrojtje gjyqësore të punësuarit i ipet edhe sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Në raport me barrën e provës gjykatat duhet që të kenë kujdes që në të gjitha rastet kur pala paditëse pretendon me prova se është diskriminuar nga punëdhënësi mbi ndonjë bazë, atëherë barra e provës i kalon palës së paditur që të provojë të kundërtën e asaj që pretendon pala paditëse në lidhje me diskriminimi. Në rast të trajtimit ndryshe të një rasti është obligim i gjykatave të tregojnë dhe dëshmojnë se trajtimi i një rasti ndryshe nga rastet e tjera me rrethana të ngjashme duhet të mbështetet me prova, të jetë bindes dhe i arsyetuar mire.

Rrustem Thaqi

2. SHËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL

2.1 Shqyrtime të përgjithshme lidhur me shpërblimin e dëmit

Ligji i aplikueshëm:

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare Nr.16, datë 19.05.2012 (tani e tutje LMD), i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 dhjetor 2012, ka rregulluar marrëdhëniet e detyrimeve, respektivisht bazën e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar dhe shpërblimin e dëmit, si dhe çështjet tjera që ndërlihen më të. Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, ekzistojnë dy lloje të shpërblimit të dëmit, shpërblimi i dëmit material dhe shpërblimi i dëmit jomaterial.

Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar edhe rastet ku është aplikuar Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr. 29, datë 26.05.1978, si ligj i aplikueshëm. Duhet theksuar se dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr.29, dt.26.05.1978, dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës Nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare Nr.16, datë 19.05.2012, sa i përket dispozitave për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial kanë përmbajtje pothuaj identike, me përjashtim të disa risive të ligjit të ri, dhe atë: neni 163 - përgjegjësia për zotëruesin e kafshës, neni 164 - përgjegjësia e zotëruesit të ndërtesës, neni 165 - përgjegjësia për shembjen e ndërtimit, dhe neni 187- shpërblimi në të holla për personin juridik.

Në gjykatat e Republikën së Kosovës, janë paraqitur një numër i konsiderueshëm i rasteve me kërkesa, për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial, veçanërisht dëmit të shkaktuar në aksidente të komunikacionit, në vendin e punës, si dhe burgimin pa bazë ligjore.

Në këto raste tani kemi një praktikë gjyqësore të konsoliduar, mirëpo dinamika e rritjes së numrit të rasteve të paraqitura për shpërblimin e dëmit, ka ndikuar që të ketë praktikë jo unike lidhur me bazën, lartësinë dhe vlerësimin e kriterëve, për përcaktimin e lartësisë së dëmit, përveç tjerash edhe për shpërblimin e dëmit jomaterial - shpërblimin në të holla.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “1. Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. 2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. 3. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj”.

Me nenin 137 të këtij ligji, përcaktohet se: “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jomaterial)”.

Me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”.

Me nenin 159 të këtij ligji, përcaktohet se: “1. Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit. 2. Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet

për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre. 3. Në qoftë se nuk ka fajësi në asnjërën anë, zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet në pjesë të barabarta, në qoftë se rregullat e drejtshmerisë nuk kërkojnë diç tjetër. 4. Për dëmin që e pësojnë personat e tretë zotëruesit e mjeteve motorike përgjigjen solidarisht”.

Me nenin 169 të këtij ligji, përcaktohet se: “1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme”.

Me nenin 176 të këtij ligji përcaktohet se: “1. I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar. 2. Për paragrafin paraprak vihen përshtatshmërisht në zbatim dispozitat për përgjegjësinë për përfaqësuesin ligjor dhe ndihmësin. 3. Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do të gjykojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit. 4. Dëmtuesi dhe i dëmtuari mbajnë barrën e provës për kontributin e atij tjetrit në shkaktimin dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe lartësinë e tij”.

2.2 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore për shpërblimin e dëmit

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore të LMD-së, rezulton se: dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jomaterial). Për të fituar të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit duhet të ekzistojë dëmi real, apo zvogëlimi i pasurisë të dëmtuarit, ose pengimi i rritjes së pasurisë, që nënkupton fitimin e humbur. Tek dëmi real apo i zakonshëm vlen parimi i kthimit në gjendje të mëparshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e LMD-së. Ndërsa, te fitimi i humbur duhet të vlerësohet se sa do të rritej ajo pasuri nëse nuk do të paraqitej pengesa.

Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t’ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto

parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia deliktore; dhe e) të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në këto raste duhet plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e shkaktarit të dëmit, për kompensimin e dëmit, të dëmtuarit.

Nga përmbajtja e nenit 136 paragrafi 1 të LMD-së, rezulton se është obligim i secilit që të përgjigjet për dëmin që e shkakton, që nënkupton se fajësia për dëmin supozohet për deri sa nuk vërtetohet e kundërta, përndryshe dëmtuesi nuk mund të lirohet nga përgjegjësia. Sipas kësaj dispozite ligjore barra e të provuarit se kush e ka shkaktuar dëmin, i takon atij që pretendon se i është shkaktuar dëmi, ndërsa personi përgjegjës për dëmin e ka barrën e të provuarit se dëmi është shkaktuar pa fajn e tij.

Nga përmbajtja e paragrafit 2 të këtij neni, rezulton se për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin, nuk kërkohet fajësia, por përgjegjës për dëmin është zotëruesi i sendit apo personi që merret me këtë veprimtari.

Ndërsa nga përmbajtja e paragrafi 3 të këtij neni, rezulton se për dëmin pavarësisht nga faji, në rastet tjera, të cilin ky ligj e ka paraparë, p.sh., përgjegjësishë së prindërve për fëmijët, e kujdestarit për të miturin, e punëdhënësit për punëmarrësin...,etj.

Nga dispozitat e cituara rezulton se LMD-ja, si baza të përgjegjësishë ka përcaktuar përgjegjësishë sipas fajit (përgjegjësia subjektive) dhe përgjegjësishë objektive (baza e përgjegjësishë pa faj ose sipas fajit të supozuar).

Nga përmbajtja e nenit 137 të LMD-së rezulton se, në rastet kur kërkohet shpërblimi i dëmit material, duhet të ekzistojë dëmi real, apo zvogëlimi i pasurisë së dikujt, dhe forma tjetër është pengimi i rritjes së pasurisë, që nënkupton fitimin e humbur. Në rastet të dëmi real apo i zakonshëm vlen parimi i kthimit në gjendje të mëparshme, ashtu siç përcaktohet të shpërblimi i dëmit material. Ndërsa, të fitimi i humbur duhet të vlerësohet se sa do të rritej ajo pasuri nëse nuk do të paraqitej pengesa. Kurse të shpërblimi i dëmit jomaterial nuk është i mundur kthimi në gjendje të mëparshme, mirëpo me këtë synohet që të bëhet kthimi në gjendje të mëparshme i gjendjes shpirtërore të çrregulluar me rastin e pësimit të dëmit jo-material.

Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia. Nga përmbajtja e nenit 140 të LMD-së, rezulton se: Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia. Në këtë kontekst kërkohet që veprimet apo mosveprimet e kryesit të dëmit në raport me dëmin e shkaktuar të jenë me dashje apo nga pakujdesia. Dashja nënkupton se dëmi është shkaktuar në mënyrë të qëllimshme apo thënë ndryshe kur dëmtuesi i dëshiron pasojat, ndërsa pakujdesia ekziston kur kryesi nuk ka qenë i kujdesshëm në ndërmarrjen e veprimeve të tij apo nuk ka vepruar, ndonëse është dashur të veprojë.

Me nenin 159 të LMD-së, përcaktohet , “1. Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësishë në bazë të fajit. 2. Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishtëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre. 3. Në qoftë se nuk ka fajësi në ansjërën anë, zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet në pjesë të barabarta, në qoftë se rregullat e drejtëshmërisë nuk kërkojnë diçka tjetër. 4. Për dëmin që e pësojnë

personat e tretë zotëruesit e mjeteve motorike përgjigjen solidarisht”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga mjetet motorike në rast aksidenti, për shkak të vet specifikave se ky lloj i dëmit në të shumtën e herëve shkaktohet me fajin e dy pjesëmarrësve ndonëse me paragrafin 1 të kësaj dispozite është përcaktuar parimi i fajësisë për dëmin e shkaktuar. Në paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar që secili zotërues i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre, që do të thotë se sipas kësaj dispozite i mbetet gjykatave që me rastin e vendosjes ta vërtetojnë shkallën e fajësisë dhe kontributin eventual të pjesëmarrjeve në aksident dhe në bazë të shkallës së fajësisë dhe kontributit eventual të vendosin edhe për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar.

Nga përmbajtja e nenit 169 të LMD-së, rezulton se: është detyrim i personit përgjegjës për rivendosjen e gjendjes e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi, pra qëllim primar i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes para shkaktimit të dëmit. Pastaj nëse kjo nuk është e mundur, e që zakonisht është e pamundur të bëhet rikthimi i plotë i gjendjes së mëparshme, atëherë personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblim në të holla. Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit.

Nëse i referohemi nenit 176 të LMD-së, rezulton se: që askush të mos përgjigjet jashtë përgjegjësisë së vet, por kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do ta caktojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit. Këto kritere vlejné edhe për përgjegjësinë e përfaqësuesit ligjor dhe ndihmësin. Dëmtuesi dhe i dëmtuari mbajnë barrën e provës për kontributin eventual të tjetrit në shkaktimin dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe lartësinë e tij, që do të thotë se të njëjtit në një formë duhet ta vërtetojnë pafajësinë e tyre, apo kontributin e tyre sa më të vogël në shkaktimin e dëmit, si dhe të provojnë se dëmi është shkaktuar me fajësinë e tjetrit, apo se pikërisht veprimet apo mosveprimet e tjetrit i kanë sjellë pasojat e dëmshme, nga të cilat është shkaktuar dëmi.

Me nenin 170 të LMD-së, është përcaktuar se: “Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit.” Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se: arritshmëria e kërkesës për pagesën e shpërblimit të dëmit, që ka rendësi sidomos me rastin e llogaritjes së kamatës, pasi nga dita e arritjes së detyrimit të shpërblimit të dëmit duhet të llogaritet edhe kamata. Përfundim nga kjo dispozitë bënë praktika gjyqësore e krijuar në gjykatat e vendit tonë, ku llogaritja e kamatës për dëmin jo-material llogaritet nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, për arsye se nga dita e marrjes së aktgjykimit pala e dëmtuar ka mësuar për dëmin dhe lartësinë e tij dhe nga ky moment konsiderohet se dëmtuesi ka rënë në vonesë në përbushjen e kërkesës

2.3 Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial-Shqyrtime të përgjithshme lidhur me shpërblimin në të holla

Baza ligjore:

Me nenin 182 të LMD-së, përcaktohet se: “Në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit, përkatësisht të përmirësimit me shpenzim të

dëmtuesit, ose të urdhërojnë që dëmtuesi ta tërheqë deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ose diç tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me shpërbllim.”

Me nenin 183 të LMD-së, përcaktohet se: “1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirisë ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërbllimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërbllimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërbllimin e dëmit jo-material, si dhe për lartësinë e shpërbllimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërbllim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.”

Me nenin 184 të LMD-së, përcaktohet se: “1. Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t’ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve) shpërbllimin e drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore. 2. Ky shpërbllim mund t’u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme. 3. Në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund t’ia caktojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërbllimin e drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore. 4. Shpërbllimi nga paragrafi 1 dhe 3, i këtij neni mund t’i caktohet edhe bashkëshortit jashtë martesor, nëse ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.”

Me nenin 185 të LMD-së, përcaktohet se: “E drejta e shpërbllimit të dëmit në të holla për shkak të dhembjeve shpirtërore të pësuar i takon personit, i cili me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtimi ose varësie, është shtytur në marrëdhënie të dënueshme seksuale ose në veprim të dënueshëm seksual të panatyrshëm, si dhe personi ndaj të cilit është kryer ndonjë vepër tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit.”

Me nenin 186 të LMD-së, përcaktohet se: “Gjykata, me kërkesën e të dëmtuarit, do të caktojë shpërbllimin edhe për dëmin e ardhshëm jomaterial në qoftë se sipas rrjedhës së rregullt është e sigurt se ai do të vazhdojë edhe në të ardhmen”.

Me nenin 187 të LMD-së, përcaktohet se: “Gjykata i jep shpërbllim të drejtë në të holla personit juridik për denigrim të reputacionit ose emrit të mirë, pavarësisht dëmshpërbllimit të dëmit material, në rast se gjen se rrethanat e arsyejnë këtë, qoftë edhe nëse nuk ka dëm material”.

Me nenin 188 të LMD-së, përcaktohet se: “1. Kërkesa e shpërbllimit të dëmit jomaterial i kalon trashëgimtarit vetëm në qoftë se është caktuar me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim. 2. Nën kushte të njëjta kjo kërkesë mund të jetë objekt cedimi, kompensimi dhe i përbarimit të dhunshëm.”

Me nenin 189 të LMD-së, përcaktohet se: “Dispozitat për përgjegjësinë e ndarë dhe për zvogëlimin e shpërbllimit që vlejnë për dëmin material përshtatshëmrisht zbatohen edhe për dëmin jomaterial”.

2.4. Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore, lidhur me shpërblimin në të holla

Shpërblimi i dëmit jomaterial është mënyra e shpërblimit të personit të dëmtuar, për shkak të cenimit të të mirave personale dhe e të drejtave të njeriut. Cenimi i këtyre të mirave personale ose i të drejtave të njeriut sipas rregullave të së drejtës objektive ekziston kur dikush me veprim të kundërligjshëm, i cenon tjetrit të drejtat e theksuara. Cenimi i këtyre të drejtave mund të paraqitet në rastet të cenimit të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, kur përhapen faktet e pavërteta ndaj dikujt, kur cenohet e drejta në jetë, integriteti trupor i njeriut, shëndeti i tij, dukja e jashtme e personit të dëmtuar, interesi personal i të dëmtuarit, të drejtat e njeriut ose dëmtimi i sendit ndaj të cilit i dëmtuari ka dashuri të veçantë, etj.

Në këto raste shkaktohen ose mund të shkaktohen pasoja (dëm jomaterial) të dëmtuarit, sepse cenimi i nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekja e të afërmit, invaliditeti i rëndë, shëmtimet trupore, frika për pasoja, janë gjera të cilat i lënë gjurmë të thella personit të dëmtuar në momentin e shkakimit të dëmit, por edhe për pasoja në të ardhmen të personit të dëmtuar.

Sipas dispozitave të LMD-së, janë përcaktuar parakushtet për shpërblimin në të holla dhe atë: a) që dëmi i shkaktuar t'i cenoj vlerat personale të njeriut, b) të ekzistoj faji i dëmtuesit, c) të ekzistoj intensiteti dhe kohëzgjatja e përjetimit të dhembjeve (shpirtërore, fizike), si dhe e) gjendja materiale e dëmtuesit.

Shpërblimi i dëmit jo material që i gjykohet të dëmtuarit është një shpërblim i drejtë në të holla. Ky dëm gjykohet në të gjitha rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial si satisfaksion i të dëmtuarit, që në një mënyrë ai t'i zbusë atë që ka përjetuar duke pësuar dhembje fizike, vuajtje psikike ose frikë. Ky satisfaksion nuk është shpërblim adekuat i dëmit, por është tentim i zbutjes së situatës së krijuar të të dëmtuarit me shkaktimin e ndonjërit prej rasteve të shpërblimit të dëmit jomaterial. Në këto raste të paraqitura duhet me kujdes të zbatohen rregullat e shpërblimit të dëmit jomaterial, të vërtetohen faktet relevante për zbatimin e tyre dhe gjithnjë të kërkohet ndihmë nga ekspertët gjyqësor në rast nevojë.

Te shpërblimi i dëmit jomaterial, pa marrë parasysh se për cilat raste gjykohet i dëmtuari, duhet të ketë edhe lartësinë e caktuar në çdo rast konkret. Kjo lartësi e këtij dëmi nuk është e njëjtë në rastet e ndryshme të shpërblimit të dëmit jomaterial. Kjo është e kuptueshme, sepse nuk kemi vlera të njëjta që cenohen, as që pesha e tyre në vuajtjen psikike, në frikën e shkaktuar dhe në dhembjen fizike është e njëjtë.

Me nenin 183 paragrafi 3 të LMD-së, janë përcaktuar rrethanat të cilat gjykata duhet t'i ketë parasysh kur të caktojë se sa do të jetë lartësia e shpërblimit të dëmit. Pra, sipas kësaj dispozite gjatë vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial si dhe për lartësinë e këtij shpërblimi, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e vlerës së cenuar dhe qëllimit për çka i shërben ky shpërblim, si dhe për faktin se ky shpërblim të mos përkrahë tendencat të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e këtij shpërblimi dhe me qëllimin shoqëror të tij. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se gjykata gjithnjë duhet të ketë parasysh se çka është cenuar nga vlera e të drejtave të njeriut ose nga vlerat e dinjitetit të tij.

Shpërblimi i dëmit jomaterial në parim nuk mund ta ketë lartësinë e shpërblimit të plotë të këtij dëmi, për arsye se kjo formë e shpërblimit është satisfaksion për të dëmtuarin. Ky satisfaksion përmes kompensimit të dëmit jomaterial, ka qëllimin e mbrojtjes së të dëmtuarit dhe zbutjen e pasojave që ka pësuar.

2.5 Rastet e shpërblimit në të holla të dëmit jomaterial

Në praktikën gjyqësore të vendit, si raste më të shpeshta paraqiten kërkesat për shpërblimin e demit jomaterial: për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, të lirisë, frikës, dhembjeve fizike, shëmtimit trupor, zvogëlimi i aktivitetit jetësor, vdekja e të afërmit, invaliditetit të rëndë ose shëmtimit të lartë të ndonjë personi.

2.6. Shpërblimi në të holla, për shkak të cenimit të së drejtës së personalitetit

Dëmi jomaterial i pësuar për shkak të dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktiviteteve jetësore, shëmtimit, cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së të afërmit dhe frikës nuk mund të riparohet me rivendosje të gjendjes që ka ekzistuar para se të shkaktohej dëmi, siç veprohet si rregull me dëmin material.

I dëmtuari, pavarësisht nëse është person fizik apo juridik, ka të drejtën e riparimit të dëmit jomaterial të shkaktuar me cenimin e integritetit moral, kur kjo është e mundur, por ka edhe të drejtën e shpërblimit të drejtë të dëmit që shfaqet në formë të dhimbjeve fizike dhe shpirtërore si dhe me rastin e cenimit të ndjenjave të të dëmtuarit, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material, nëse ka ekzistuar, e kjo e drejtë ekziston edhe në rastet kur nuk ka dëm material. Kështu, në mënyrë kumulative mund të kërkohet riparimi i dëmit material dhe shpërblimi i drejtë në emër të dëmit jomaterial. Në anën tjetër, edhe në rastet kur i dëmtuari për shkak të cenimit të të drejtave personale (nderit, reputacionit, lirisë ose të drejtave të tjera personale) ka përjetuar dhimbje shpirtërore, gjykata, përveç sanksionit të përcaktuar me nenin 182 të këtij ligji, mund ta gjykojë edhe shpërblimin e drejtë, në qoftë se, varësisht nga rrethanat e rastit, vetëm në këtë mënyrë mund t'i jepet të dëmtuarit një satisfaksion i plotë në kuptim të qëllimit të cilit i shërben shpërblimi i dëmit jomaterial.

Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, për shkak të cenimit të së drejtës së personalitetit të njeriut është përcaktuar me nenin 182, e lidhur me nenin 183 të LMD-së.

Nëse i referohemi dispozitave të cituara të LMD-së, dëm jomaterial përfaqëson shkaktimi tjetrit i dhembjeve fizike, i vuajtjeve psikike ose i frikës. Në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit, gjë që zakonisht ndodhë me shpifje dhe ofendim, i dëmtuari ka të drejtën në shpërblim të dëmit material, si dhe shpërblim të dëmit jomaterial të rregulluar me dispozitat e këtij ligji.

Se çfarë përfaqëson cenim i së drejtës së personalitetit dhe si do të cenohet ai, ky ligj nuk e përcakton, pasi që fjala është për të mira personale të cilat janë të shumta dhe mënyra e cenimit mund të jetë e ndryshme.

Në jetën e përditshme mund të ndodhë dhe ndodh që dikush ndaj dikujt të përhapë fakte të pavërteta, të bëjë intrigë apo ofendime të ndryshme. Në këto raste ekziston mundësia që të kërkohej shpërblimi i dëmit jomaterial. Ky shpërblim zakonisht bëhet me kthimin në gjendjen e mëparshme.

Nëse i referohemi nenit 182 të LMD-së, rezulton se: në qoftë se bëhet cenimi i së drejtës së personalitetit të njeriut, me kërkesë të dëmtuarit gjykata mund të urdhërojë që me shpenzime të dëmtuesit të publikohet aktgjykimi ose të publikohet përmirësimi ose gjykata do të urdhërojë që dëmtuesi të tërheqë deklaratën me të cilën është bërë cenimi ose diç tjetër me të cilën mendon se me anë të shpërblimit të dëmit mund të realizohet qëllimi.

Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, për shkak të cenimit të dinjitetit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta ka të bëjë me cenimin e dinjitetit që mund t'i shkaktohet personit tjetër me përhapjen e fakteve të pavërteta. Kështu ndodh kur dikush fyhet, kur dikujt i bëhen shpifje të ndryshme, kur dikujt i rrëfëhen të dhëna të pavërteta për nderin e tij, për autoritetin e tij, për aftësinë e tij punuese, për jetën e tij, për marrëdhëniet e tij në familje...etj. Të gjitha këto veprime duhet të vërtetohen gjatë shqyrtimit gjyqësor, e po ashtu duhet të vërtetohen edhe se si janë manifestuar ato tek i dëmtuari. Këto veprime duhet të shkaktojnë çrregullim psikik në jetën e të dëmtuarit. Ky çrregullim duhet të jetë me intensitet të caktuar dhe të ketë pasoja në pengimin e kryerjes së punëve si duhet të të dëmtuarit etj.

Për të ekzistuar mundësia e shpërblimit të dëmit jomaterial, me këtë rast duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet dëmi jomaterial, b) dëmi të shkaktohet duke cenuar dinjitetin e dikujt ose duke përhapur fakte të pavërteta, c) të ekzistojë lidhja kauzale midis cenimit të dinjitetit, përhapjes së fakteve të pavërteta dhe dëmit jomaterial të shkaktuar.

Kjo do të ndodhë në rast të cenimit të integritetit trupor të të dëmtuarit apo të dëmtimit të shëndetit të tij, me të cilin rast dhe për të cilën arsye edhe shkaktohen dhembjet fizike, dhembjet shpirtërore dhe frika. Ato, nëse ekzistojnë, përfaqësojnë fakte mbi bazën e të cilave, në rast se plotësohen edhe kushtet e tjera të parashikuara me ligj, do të caktohet një shpërblim i drejtë në të holla. Vetëm fakti që personi fizik ka pësuar dhembje fizike, dhimbje shpirtërore dhe frikë, nuk do të thotë vetvetiu se ai edhe e ka të drejtën e shpërblimit. Nëse do të caktohet shpërblimi apo jo varet, nga intensitetit dhe kohëzgjatja e këtyre dhimbjeve për çdo rast konkret.

Në rastet kur cenimi i të drejtave të personalitetit është i një intensiteti të ulët dhe të parëndësishëm, shikuar objektivisht, edhe nëse në këtë rast dëmi material ekziston, të dëmtuarit nuk do t'i përkiste e drejta e shpërblimit të drejtë në të holla, nëse intensiteti dhe kohëzgjatja e tyre nuk e arsyetojnë mundësinë e vendosjes të baraspeshës psikike të cenuar tek i dëmtuari. Shpërblimi i gjykatës në të holla për dhimbjet fizike dhe psikike të përjetuara duhet t'i sigurojë të dëmtuarit përfitim e të mirave dhe satisfaksioneve të tjera të cilat do t'i ndihmonin në tejkalimin e krizës fizike dhe psikike ose të frikës së përjetuar si pasojë e dëmit të shkaktuar, gjë që nënkupton se shpërblimin në të holla nuk duhet kuptuar si ekuivalent i së mirës së humbur apo të dëmtuar, por vetëm si satisfaksion.

Me nenin 183 paragrafi 1 të LMD-së, janë përcaktuar format e mundshme të dëmit jomaterial për të cilat i dëmtuari, varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret, nëse përmbushen edhe kushtet tjera të parashikuara me ligj, ka të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla. Kur është fjala për

cenimin në të njëjtën kohë të disa të drejtave personale, shpërblimi i drejtë në të holla do të caktohet për çdo formë të dëmit jomaterial të pësuar, ngase në këtë rast kemi të bëjë me disa baza juridike të veçanta, për shpërblim të drejtë në të holla, për çdo formë të dëmit të përcaktuar si në nenin 183 paragrafi 1 të LMD-së.

2.7. Shpërblimi në të holla, për shkak të cenimit të autoritetit dhe nderit

Në doktrinën juridike dhe posaçërisht praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, vërehet influenca e të drejtave themelore në sferën e të drejtës private. Pra, ky ndikim i të drejtave themelore në të drejtën private shihet në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e personalitetit, konkretisht me shpërblimin e dëmit jomaterial në rastin e mbrojtjes së të drejtave të personalitetit, dinjitetit dhe reputacionit. Koncepti i *dignitas hominis* në mendimin klasik romak ka nënkuptuar kryesisht "statusin." Në fakt, *dignitas* nuk kufizoj vetëm për njerëzit por aplikohet për institucionet dhe vetë shtetin. Ky koncept i dinjitetit prej kohesh është përfshirë në disa sisteme juridike në kontekstin e së drejtës private, si bazë për sigurimin e mbrojtjes së dinjitetit në kuptimin e "statusit" "reputacionit" dhe "privilegjeve."

Në sistemet juridike të bazuara në të drejtën romake, dinjiteti shihet si e drejtë e personalitetit, dhe në rast të cenimit të tij, ofrohen mjete juridike të karakterit civil.

Në vendin tonë, dinjiteti i njeriut është ngritur në rang kushtetues, dhe paraqet një prej vlerave themelore mbi të cilën mbështetet rendi juridik kushtetues. Në këtë mënyrë, Kushtetuta ka përcaktuar se, "Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut". Si i tillë, dinjiteti i njeriut hynë në kategorinë e të drejtave absolute dhe se shmangia nga kjo e drejtë nuk justifikohet në asnjë rrethanë, madje edhe rrethana të jashtëzakonshme qofshin ato.

Sa i përket mbrojtjes së ofruar nga KEDNJ, edhe pse në dispozitat e saj (përveç preambulës) dinjitetin njerëzor nuk e përmend shprehimisht, megjithatë, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, është riafirmuar koncepti se respektimi i dinjitetit të njeriut është vet thelbi i konventës.

Në të drejtën moderne është përfshirë koncepti i përgjegjësisë për demin jomaterial, i njohur si koncepti objektiv i demit jomaterial i cili bazohet në parimin e mbrojtjes së të drejtave të personalitetit. Me saktësisht, koncepti objektiv i demit jo pasuror bazohet në rregullin se çdo shkelje e të drejtave të personalitetit përbën në vetvete një dëm jo pasuror.

Në këtë mënyrë, kur vjen në shprehje cenimi i dinjitetit të njeriut, GJEDNJ ka përcaktuar *inter alia* se kushdo që është ndaluar në kushte që nuk respektojnë dinjitetin personal të individit duhet të jetë në gjendje të marrë shpërblim adekuat. Lidhur me këtë, qëndrimi i praktikës gjyqësore të GJEDNJ në rastet e cenimit të dinjitetit njeh si mjet juridik, shpërblimin e demit jomaterial.

Në raste të caktuara, vende të ndryshme parashohin krahas kompensimit jomaterial edhe masat preventive si mjet juridik në rastet e cenimit të dinjitetit. Mirëpo, në rast se masat preventive nuk janë efektive në sanimin e shkeljes, atëherë, është detyrim i institucioneve që t'i sigurojnë individit kompensim adekuat për shkeljen e ndodhur.

Në anën tjetër, GJEDNJ në praktiken e saj gjyqësore, mbrojtjes se reputacionit i ka kushtuar kujdes të veçantë, dhe atë përmes sigurimit të mjetit efektiv juridik në rastet e cenimit të reputacionit. Në këtë mënyrë, sipas praktikës gjyqësore, e drejta për mbrojtjen e reputacionit është e drejtë e mbrojtur sipas nenit 8 të KEDNJ, si pjesë e të drejtës për respektimin e jetës private. Dhe, në mënyrë që të vjen në shprehje efekti i këtij neni, sulmi ndaj reputacionit të ndonjë personi duhet të arrij një nivel të caktuar të seriozitetit, dhe të behet në një mënyrë që shkakton paragjykim ndaj gëzimit personal të së drejtës për respektimin e jetës private, (*Libicki v. Poland*).

Humbja e reputacionit vjen shprehje në shumicën e rasteve kur ndodh publikimi i informacioneve rreth jetës private të ndonjë personi, dhe atë përmes artikujve të të përditshmëve apo edhe në ndonjë formë tjetër. Mirëpo, në mënyrë që gjykata të marr në shqyrtim çështjen për cenimin e reputacionit, fillimisht aplikuesi duhet të dëshmoj se shteti nuk i ka ofruar mbrojtje të mjaftueshme, dhe se kjo ka rezultuar në shkeljen e të drejtës për mbrojtjen e reputacionit.

Në rastin, *Mas Gavarró v. Spain*, shteti spanjoll kishte theksuar se, pala është dashur që të parashtrij padi me kërkesë për korrektimin e publikimit brenda afatit ligjor, apo të inicioj procedurë të veçantë për mbrojtjen e nderit të tij, me qëllim të sigurimit të shpërblimit, për dëmtimin e reputacionit. Megjithatë, duke zgjedhur vetëm rrugën penale, i njëjti kishte privuar vetveten nga mundësia e sigurimit të shpërblimit, për shkeljen e pretenduar në procedurë civile.

Një tjetër aspekt që vlen të theksohet sa i përket mbrojtjes se reputacionit, është edhe pyetja se a mundet një person i cili ka kryer një veprë penale të thirret në mbrojtjen e ofruar nga neni 8 i KEDNJ. Lidhur me këtë, GJEDNJ në rastin, *Faludy-Kovacs v. Hungary*, është shprehur se, një person nuk mund të thirret në nenin 8, për tu ankuar për humbjen e reputacionit, që është pasojë e parashikueshme e veprimeve të tij, siç është p.sh., kryerja e veprës penale. Kjo situatë përjashton të drejtën për tu thirrur në garancinë e ofruara nga ana e konventës. Sikurse edhe në rastet e tjera të mbrojtjes se të drejtave të personalitetit, praktika gjyqësore e GJEDNJ edhe tek cenimi i reputacionit njeh të drejtën e zbatueshme të shpërblimit në formë të demit jo material.

Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se: shpërblimi në të holla i demit jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit dhe nderit është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së

Ky rast i shpërblimit të demit jomaterial është një prej rasteve të veçanta të shpërblimit të demit. Cenimi i dinjitetit ekziston kur me ofendim, me rrëfim të rrethanave familjare, me nënçmim ose me kryerjen e veprës penale siç është akti i dhunimit, me rrëfim për paaftësinë punuese të njeriut, të aftësisë profesionale të tij, në krijimin e atmosferës rreth kualiteteve të një personi, rreth afarizmit të tij dhe rreth autoritetit të tij në jetën e përditshme.

Për të ekzistuar mundësia e shpërblimit të këtij demit duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet cenimi i autoritetit, nderit të njeriut, b) të shkaktojë vuajtje psikike të i dëmtuari, c) kjo vuajtje të ketë intensitet të caktuar dhe kohëzgjatje të caktuar, d) të jetë shkaktuar me fajin e dëmtuesit, e) të ekzistojë lidhja kauzale midis këtij cenimi dhe demit të shkaktuar, dhe f) nga ky cenim të shkaktohet demit jomaterial.

2.8 . Shpërblimi në të holla, për shkak të dëmtimit të shëndetit dhe lëndimit trupor

Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, për shkak të dëmtimit të shëndetit dhe lëndimit trupor është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 dhe 184 paragrafi 3 të LMD-së.

Ky rast i shpërblimit të dëmit jomaterial është një prej kategorive të shpërblimit të dëmit siç përcaktohet me nenin 183 paragrafi 1 dhe 184 paragrafi 4 të LMD-së. Për t'u realizuar ky shpërblim i dëmit jomaterial duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet dëmtimi i shëndetit apo lëndimi trupor, b) nga dëmtimi i shëndetit apo lëndimi trupor të shkaktohet dëm jomaterial në kuptim të shkakimit të vuajtjes psikike ose dhembjeve fizike, të ekzistojë lidhja kauzale midis dëmtimit të shëndetit apo lëndimit trupor dhe vuajtjes psikike ose dhembjeve fizike të dëmtuarit, c) nga kjo vuajtje psikike apo dhembje fizike t'i shkaktohet dëm personit të dëmtuar, dhe d) të ekzistojë faj i dëmtuesit.

Përveç të cekurave të për të realizuar ky shpërblim i dëmit jomaterial duhet të plotësohen të gjitha këto parakushte në mënyrë kumulative siç përcaktohen me dispozita ligjore të LMD-së. Po ashtu edhe nga interpretimi i paragrafit 1 të nenit 183 të LMD-së, rezulton se për dhimbjet e përjetuara shpirtërore do të gjykohet kompensimi, por në çdo rast dhimbjet shpirtërore duhet të jenë pasojë e një rrethane që e shkakton dhembjen siç mund të jetë shkelja e nderit, e lirisë, e vdekjes së të afërmit, etj. Pra nuk mund të gjykohet shpërblimi për dhimbje shpirtërore-vuajtje psikike pa qenë dhimbje shpirtërore-vuajtja psikike e ndërlidhur me një rrethanë që e shkakton dhembjen.

2.9. Shpërblimi në të holla, për shkak të dhembjes fizike

Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, për shkak të dhembjes fizike është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së.

Për t'u realizuar shpërblimi i dëmit jomaterial, për shkak të dhembjes fizike të pësuar, duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet lëndim trupor me pasojat e shkakimit të dhembjeve fizike, b) dhembja fizike të ketë intensitet dhe kohëzgjatje të caktuar, c) të ekzistojë lidhja kauzale midis dhembjes fizike të shkakuar dhe pasojave që konkretisht i ka i dëmtuari, e) dhembja fizike të jetë shkakuar me veprim të kundërligjshëm, dhe e) të ekzistojë faj i dëmtuesit.

Dhimbjet fizike janë dhembje të cilat paraqiten te personat e lënduar në momentin e lëndimit dhe vazhdojnë deri në ditën kur ato ndërpriten, e më së largu deri në përfundimin e mjekimit dhe shërimit.

Kriteret të cilat shërbejnë për përcaktimin e lartësisë së shpërblimit (satisfaksioni) të dëmit jomaterial në emër të dhembjeve fizike janë:

- lloji i lëndimeve, paraqet fakt me rëndësi për caktimin e lartësisë së dëmit, pasi prej llojit të lëndimit varet edhe lartësia e shumës së gjykuar në emër të dëmit të pësuar. Varësisht prej llojit të lëndimit varet edhe intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve. Te lëndimet e lehta intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve zakonisht janë më të lehta dhe më të shkurta. Te lëndimet e rënda intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve është më e rëndë dhe zgjatim më shumë, po ashtu këto

lëndime kanë edhe pasoja jetësore, të cilat po ashtu duhet të merren për bazë, me rastin e vlerësimit të lartësisë së shumës së gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial.

- vendi i lënduar në trupin e njeriut, në praktikë nuk i është kushtuar vëmendje e duhur vendit të lënduar, ndonëse ka një rëndësi të veçantë, me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit. Varësisht prej vendit të lënduar varen edhe pasojat në të ardhmen, si dhe vuajtjet e pësuarat gjatë shërimit, p.sh., lëndimet e organeve të brendshme të cilat janë jetike për funksionimin e organizmit të njeriut, paraqesin arsye për të gjykuar një shumë më të lartë sesa kur lëndohet një ekstremitet, p.sh., dora, ndonëse sipas mendimit të ekspertit mund të jenë të dy lëndime të rënda dhe intensiteti dhe kohëzgjatja të jenë të njëjta, për faktin se dora ndonëse e ka rëndësinë e saj, ne kemi mundësinë që ta trajtojmë më lehtë në aspektin mjekësor, por edhe të shohim gjendjen e saj, ndërsa te organet e brendshme këto mundësi janë më të kufizuara dhe si rezultat shërimi është më i ndërlikuar. Po ashtu vendi i lëndimit ka rëndësi kur kryhen intervenime kirurgjike apo të imobilizimit.

- moshja e personit të lënduar, moshja ka rëndësi të veçantë, pasi që dhimbja paraqet edhe aspekt psikik, i cili aspekt ndryshon varësisht prej moshës. Të fëmijët shpesh edhe lëndimet e lehta shkaktojnë dhimbje të cilat ata nuk i përballojnë lehtë, e po ashtu këto dhembje rriten edhe me faktin se fëmijët shpesh nuk e kuptojnë edhe procesin e shërimit dhe gjendjen e tyre të lëndimit e përjetojnë më rëndë.

- vështirësitë dhe situatat e pa-lakmueshme të cilat janë përcjell gjatë mjekimit, e veçanërisht shtrirja e gjatë në gjendje të palëvizshme, kryerja e nevojave fiziologjike në shtrat, vështirësitë gjatë marrjes së ushqimit, lloji dhe numri intervenimeve kirurgjike, përdorimi i aparateve invalidore – paterica ose karroca, etj., ndikojnë në rritjen e vëllimit të dhembjeve fizike.

- shqetësimet që ndodhin gjatë trajtimit mjekësor, humbje të vetëdijes afatshkurtër, lloje të ndryshme të imobilizimit dhe fiksimit, incizime të shpeshta me rëntgen, shtrirje afatgjatë në shtrat, vështirësi në qëllitje, numri dhe llojet e ndërhyrjeve kirurgjikale, infuzionet, transfuzione, injeksione etj, ndikojnë në rritjen e vëllimit të dhembjeve fizike.

Nisur nga praktika gjyqësore, përkritazi me intensitetin e dhembjeve fizike, ato karakterizohen: a) intensiteti i lartë, b) i mesëm dhe c) i ulët. Varësisht nga shkalla e intensitetit dhe kohëzgjatja e dhembjeve fizike, duhet caktuar edhe shuma e shpërblimit për çdo lloj të dhembjeve të sipërpërmendura. Shuma e shpërblimit për dhembjet fizike të pësuarat nuk varet vetëm nga shkalla e intensitetit dhe kohëzgjatja e tyre, siç janë përcaktuar me ligj.

Përveç këtyre dy elementeve me rëndësi, në caktimin e shumës së shpërblimit të dëmit duhen marrë parasysh edhe të gjitha rrethanat e tjera të rastit, veçanërisht përjetimet e ndryshme të pakëndshme dhe komplikimet e mundshme gjatë mjekimit. Se cilat janë të gjitha rrethanat e tjera, varet nga çdo rast konkret.

Caktimin e shpërblimit të drejtë për dhembjet fizike të pësuarat ligjvënësi e ka kushtëzuar, në radhë të parë, me arsyetimin e tij nga rrethanat e rastit, veçanërisht intensiteti dhe kohëzgjatja e tyre. Në këtë mënyrë, për dhimbje fizike të parëndësishme nuk do të caktohet shpërblimi. Se cilat dhimbje fizike janë të parëndësishme dhe në cilat raste i dëmtuari nuk do të ketë të drejtën e shpërblimit, duke pasur parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, sipas praktikës gjyqësore,

konkludohet në rast se i dëmtuari nuk ka pësuar dhembje fizike të intensitetit të lartë, ndërsa ato të intensitetit të mesëm dhe të ulët kanë zgjatur vetëm disa ditë.

Marr në përgjithësi, në bazë të praktikës gjyqësore, i dëmtuari, si rregull, nuk ka të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhembjet fizike të shkaktuara me lëndim të lehtë trupor. Përrjashtimisht, i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhembjet fizike të shkaktuara me lëndim të lehtë trupor, vetëm nëse ato janë të intensitetit të lartë dhe të mesëm dhe kanë zgjatur për një kohë më të gjatë.

2.10 . Shpërblimi në të holla, për shkak frikës së përjetuar

Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, për shkak të frikës së përjetuar është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së.

Për t'u realizuar shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të frikës së pësuar duhet të plotësohen këto kushte: a) të shkaktohet frika, b) frika të shkaktojë vuajtje psikike te i dëmtuari, të ekzistojë lidhja kauzale midis frikës së pësuar dhe vuajtjeve psikike të shkaktuara si pasojë e veprimtimit të dëmtuesit, dhe d) të ekzistojë faji i dëmtuesit.

Frika paraqet formë të dëmit jomaterial, të pranuar në aspektin juridik dhe se me rastin e pranimit dhe caktimit të shpërblimit është e mjaftueshme të konstatohet se frika ka qenë e evidente në momentin e aksidentit/incidentit, si dhe ka vazhduar të shfaqet te personi i cili kërkon shpërblim për këtë formë të dëmit, dhe të vërtetohet fakti nëse frika ka qenë primare apo sekondare, si dhe të përcaktohet intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, dhe varësisht nga këto rrethanat si dhe rrethanat tjera, duke marrë parasysh natyrën e lëndimit, moshën e të lënduarit, nëse frika ka lënë pasojë të përhershme, të caktohet edhe shuma e shpërblimit. Natyra e lëndimit ka rëndësi, për faktin se varësisht prej natyrës së lëndimit, mund të varet edhe intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës. Disa lloje të lëndimeve shërimi i përcjell me frikën, për pasojat eventuale shëndetësore që mund të mbesin edhe pas përfundimit të shërimit. Moshë e të lënduarit apo personit që ushtron kërkesë për shpërblim të dëmit, për shkak të frikës së pësuar, po ashtu është e rëndësishme, për faktin se të fëmijët, frika mund të shkaktohet më lehtë, dhe mund të jetë me pasojë më të gjatë të përjetimit në mënyrë të vazhdueshme në formë të ndryshme, që mund të ndikojë edhe të zhvillimi i tij. Ndërsa të personat e shtyrë në moshë frika mund të jetë në formë tjera, p.sh., frika nëse do të mund të shërohet plotësisht nga lëndimet e marra.

Lartësia e dëmit, për frikën e pësuar caktohet varësisht prej rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen dhe intensitetin e frikës së pësuar. Frika sipas intensitetit mund të jetë primare dhe sekondare. Frika mund të jetë e intensitetit të lartë edhe nëse ajo është afat shkurtë, respektivisht mund të jetë frikë afatgjatë, por e intensitetit të ulët.

Frika zakonisht përcillet dhe është ekuivalente me lëndimet e marra trupore, ndonëse në rastet e frikës primare, kur është frikë për jetën (frika nga vdekja), mund të përjashtohet kjo rregull, dhe frika mund të ekzistojë pavarësisht nga fakti se mungojnë lëndimet trupore.

2.11. Shpërblimi në të holla, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor

Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së.

Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është një bazë e veçantë për shpërblimin e dhimbjes shpirtërore të pësuar dhe përfshin të gjitha kufizimet në aktivitetin jetësor të personit të dëmtuar që ai tashmë ka përjetuar, ose që ai do të vazhdojë të përjetojë rregullisht në të ardhmen. Me zvogëlim të aktivitetit jetësor, nënkuptohet gjithashtu edhe nevoja që për kryerjen e aktiviteteve të caktuara jetësore duhen përpjekje të shtuara ose në kushte të veçanta.

Si rregull, kjo formë e dëmtimit është e një natyre të përhershme, por kompensimi në të holla mund të jepet edhe kur zvogëlimi i veprimtarisë jetësore është i përkohshëm, nëse është me intensitet më të madh, ose nëse e justifikojnë rrethana tjera të veçanta.

Në rastin kur zvogëlimi i aktivitetit jetësor është i përkohshëm, por edhe në rastet kur aktiviteti i përgjithshëm jetësor është i natyrës së përhershme, shpërblimi në të holla jepet si një shumë e vetme, pavarësisht faktit se kemi të bëjmë me dëm në të ardhmen, në këto raste mjafton konstatimi i ekspertit që pasojat janë edhe për të ardhmen, se sa do të zgjasë gjendja, dhe nëse pasojat janë të përhershme dhe kemi të bëjmë me gjendje të pa përmirësueshme.

Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të këtij lloji të dëmit duhet të marrë për bazë kriteret që merren parasysh gjatë përcaktimit të lartësisë së shpërblimit të dhimbjes shpirtërore për shkak të aktivitetit të zvogëluar jetësorë, e që janë: shkalla e zvogëlimit të aktivitetit jetësor, e shprehur në përqindje nga eksperti, moshja e të dëmtuarit, profesioni i të dëmtuarit, intensiteti dhe kohëzgjatja e pasojave, kufizimet në lidhje me aktivitetet familjare dhe shoqërore të personit të dëmtuar, kufizimet në lidhje me rekreacionin dhe sportet që praktikoheshin më parë, dhe të gjitha kufizimet e tjera të aktivitetit jetësor të dëmtuarit.

Shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të shprehur në përqindje e përcakton eksperti i lëmisë përkatëse, varësisht prej natyrës së lëndimeve, duke u bazuar në kritere shkencore mbi zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, të cilin fakt gjykata duhet ta marrë si të mirëqenë dhe ta ketë parasysh me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit.

Moshja e të dëmtuarit - ka një rëndësi të veçantë me rastin e përcaktimit të lartësisë së shpërblimit të këtij lloji të dëmit, pasi varësisht prej moshës i dëmtuari kushtimisht, për një kohë të caktuar është i detyruar që ti bartë edhe pasojat e zvogëlimit të aktivitetit jetësor, nëse është i moshës së re pasojat do të i bartë për tërë jetën e tij, andaj në këto raste është e arsyeshme që shuma e shpërblimit të dëmit të jetë më e lartë, pasi edhe pasojat i dëmtuari është i detyruar ti bartë për një kohë më të gjatë.

Profesioni - kufizimet në ushtrimin e profesionit të dëmtuarit, është kriter të cilin gjykata duhet ta marrë parasysh me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit, për faktin se mos ushtrimi i profesionit shkakton dhimbje shpirtërore duke e bërë të dëmtuarin të ndjehet i pa vlerë. Fakti se i dëmtuari shpërblehet për dëmin material të fitimit të humbur, nuk ndikon dhe nuk duhet të jetë pengesë për marrjen e këtij kriteri në vlerësim, pasi kemi të bëjmë me dy baza të ndryshme të shpërblimit të dëmit. Për të marrë parasysh kriterin e profesionit duhet të jetë kusht që i dëmtuari të jetë duke e ushtruar profesionin e caktuar, apo ka qenë duke u shkolluar, duke

ndjekur mësimet apo studiuar për profesionin e caktuar, me qëllim për ushtrimin e atij profesioni, me kusht që për shkak të zvogëlimit të përgjithshëm jetësor i dëmtuari të jetë bërë i pa aftë për ushtrimin e profesionit përkatës plotësisht, pjesërisht, apo me kufizime në ushtrimin e profesionit.

Intensiteti dhe kohëzgjatja e pasojave - gjykata duhet me rastin e shpërblimit të dëmit të marrë parasysh edhe faktin se cili është intensiteti dhe kohëzgjatja e pasojave të cilat i ka shkaktuar te i dëmtuari zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor. E rëndësishme është se nga cilat të mira është i kufizuar i dëmtuari në jetën e tij të përditshme, nëse atij i duhet përcjellja e personit të tretë, për sa kohë i nevojitet kjo përcjellje, nëse përcjellja dhe ndihma i duhet vetëm për disa aktivitete apo i nevojitet për çdo aktivitet jetësor. Nëse i dëmtuari është i detyruar të përdorë paterica për lëvizje, apo karrocë lëvizëse, dhe për sa kohë është i detyruar ti përdorë. Në vlerësim të këtij kriteri mund të hyjë çdo veprim që ka ndikuar që i dëmtuari si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të jetojë më keq se para lëndimit të tij.

Kufizimet në lidhje me aktivitetet familjare dhe shoqërore të personit të dëmtuar - Aktivitet familjare dhe shoqërore, janë aktivitete të cilat në të shumtën e rasteve njerëzit gjejnë kënaqësinë e tyre, andaj kufizimi në këto aktivitete për pjesëmarrje për shkak se i dëmtuari ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor është një nga kriteret që duhet të merret parasysh nga gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit, për këtë lloj të dëmit. Aktivitete familjare dhe shoqërore për të gjithë njerëzit janë shumë të rëndësishme, dhe mos mundësia e ushtrimit të këtyre aktiviteteve të dëmtuarit i shkakton dhimbje shpirtërore, psh, pamundësia e prindit që ta mbajë në krahë fëmijën e tij, paraqet kufizim të një aktiviteti i cili do të shkaktonte dhimbje të secili prind.

Kufizimet në lidhje me rekreacionin dhe sportet që praktikoheshin më parë, dhe të gjitha kufizimet e tjera - Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit duhet të marrë parasysh edhe kriterin nëse i dëmtuari si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka kufizime në ushtrimin e aktiviteteve të rekreacionit dhe aktiviteteve sportive, por edhe të aktiviteteve tjera jetësore të përditshme, të cilat do të mund ti kryente sikur të mos ishte lënduar. Te kufizimi i këtyre aktiviteteve nuk është kusht që i dëmtuari t'i ketë ushtruar këto aktivitete para lëndimit, por mjafton që në të ardhmen nuk mund t'i ushtroj, dhe duke marrë parasysh rrethanat tjera është e pritshme që këto aktivitete do t'i ushtronte, p.sh., po të mos ishte lënduar do të mund të notonte në mënyrë normale.

12.12. Shpërblimi në të holla, për shkak të shëmtimit trupor

Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, për shkak të shëmtimit trupor, është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së.

Shëmtimi trupor është një bazë e veçantë për shpërblimin e dëmit jomaterial, për shkak të dhimbjes shpirtërore të pësuar dhe përfshin të gjitha ndryshimet/deformimet në aspektin fizik të pamjes trupore të personit të dëmtuar, si pasojë e aksidentit/incidentit, e të cilat ndryshime të dëmtuarit i kanë shkaktuar dhimbje që ai tashmë i ka përjetuar, ose që ai do të vazhdojë të përjetojë rregullisht edhe në të ardhmen.

Për t'u realizuar shpërblimi i dëmit, për shkak të shëmtimit trupor duhet të plotësohen këto kushte: a) të shkaktohet shëmtimi ose deformimi i personit të caktuar, b) ky deformim ose shëmtim të shkaktojë vuajtje psikike, c) të ekzistojë lidhja kauzale midis shëmtimit të shkaktuar dhe vuajtjes psikike të shkaktuar në raport me veprimet e dëmtuesit, dhe d) shëmtimi të shkaktohet me fajin e dëmtuesit.

Për të përcaktuar shumën e lartësisë së këtij lloji të dëmit, gjykata duhet të marrë parasysh disa kriteret: shkalla e shëmtimit, dukshmëria e shëmtimit, moshja e të dëmtuarit, profesioni i të dëmtuarit, manifestimi i shëmtimit, etj.

Shkalla e shëmtimit – Shkallën e shëmtimit e përcakton eksperti i lëmisë përkatëse, varësisht prej natyrës së lëndimeve, duke u bazuar në kriteret shkencore mbi ndryshimet të cilat i ka pësuar i dëmtuari, në bazë të cilave përcaktohet nëse shëmtimi është i shkallës së lartë, të mesme apo të ulët, të cilin fakt gjykata duhet ta marrë si të mirëqenë dhe ta ketë parasysh me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit.

Dukshmëria e shëmtimit - Gjykata me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit për këtë lloj të dëmit, duhet të marrë parasysh faktin nëse shëmtimi është i dukshëm dhe i ekspozuar gjatë gjithë kohës, apo është në vende të cilat vetëm kur ekspozohen pjesët e caktuar të trupit mund të shihen, p.sh. disa pjesë të trupit ekspozohen në publik vetëm kur bëhet plazh, ndërsa fytyra ekspozohet gjatë tërë kohës dhe shëmtimet në fytyrë mund të shihen nga secili në çdo kontakt. Shëmtimi mund të mos jetë i dukshëm në shikim të parë, p.sh. për shkak të lëndimeve të marra në pjesën e nofullës i dëmtuari ka pësuar pengesa në të folur, e cila vërehet vetëm kur i dëmtuari flet apo këndon, por jo edhe vetëm me shikim vizuel.

Moshja e të dëmtuarit - Moshja e të dëmtuarit i cili ka pësuar shëmtim ka rëndësi të veçantë me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit të këtij lloji të dëmit, kjo pasi varësisht prej moshës i dëmtuari kushtimisht për një kohë të caktuar është i detyruar që t'i bartë edhe pasojat e shëmtimit, nëse është i moshës së re, pasojat do t'i bartë për tërë jetën e tij, që rezulton se dhimbjet shpirtërore do të jenë të vazhdueshme, andaj në këto raste është e arsyeshme që lartësia e shpërblimit të dëmit të jetë më e lartë, pasi edhe pasojat i dëmtuari është i detyruar t'i bartë për një kohë më të gjatë. Po ashtu nëse i dëmtuari është i moshës së re apo fëmijë, këto dhimbje shpirtërore do të jenë shumë më të larta, pasi gjendja e tij shpirtërore e ka shumë më të vështirë pranimin e realitetit të ri, pamjes së ndryshuar, për faktin se më lehtë ju nënshtrohen paragjytimeve të personave të tretë, dhe shumë lehtë mund të ndihen të lënduar dhe të pa dëshiruar dhe jo të pranueshëm në mesin ku jetojnë. Ndonëse në praktikë nuk ka ndonjë qëndrim të prerë nëse gjinia mund të jetë kriter për vlerësim, prapëseprapë konsiderojmë që kjo në raste të caktuara varësisht prej rrethanave mund të merret si kriter për përcaktimin e lartësisë së shpërblimit të këtij lloji të dëmit.

Profesioni i të dëmtuarit - kufizimet në ushtrimin e profesionit të dëmtuarit, është kriter të cilin gjykata duhet ta marrë parasysh me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit, për faktin se mos ushtrimi i profesionit shkakton dhimbje shpirtërore, duke e bërë të dëmtuarin të ndjehet i pa vlerë. Fakti se i dëmtuari shpërblehet për dëmin material për fitimin e humbur, nuk ndikon dhe nuk duhet të jetë pengesë për marrjen e këtij kriteri në vlerësim, pasi kemi të bëjmë me baza të ndryshme të shpërblimit të dëmit. Për të marrë parasysh kriterin e profesionit duhet të jetë

kusht që i dëmtuari të jetë duke e ushtruar profesionin e caktuar, apo ka qenë duke u shkolluar, duke ndjekur mësimet apo studiuar për profesionin e caktuar, apo duke ndjekur kurs për aftësim për këtë profesion, me qëllim për ushtrimin e atij profesioni, me kusht që për shkak të shëmtimit i dëmtuari të jetë bërë i pa aftë për ushtrimin e këtij profesioni plotësisht, apo pjesërisht, apo me kufizime në ushtrimin e profesionit, p.sh, një balerinë për shkak të shëmtimit - çalimit nuk mund të ushtroj profesionin e saj, si para dëmtimit, po ashtu edhe një futbollist, apo një prezantuese televizive për shkak të problemeve në të folur, apo pamjes së saj nuk mund të ushtroj profesionin e saj, pasi mund ti duket vetja e pa pranueshme në publik.

Manifestimi i shëmtimit - Manifestimi i shëmtimit është po ashtu kriter të cilin gjykata duhet ta marrë parasysh me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të këtij lloji të dëmit, kjo për faktin se mënyra se si manifestohet shëmtimi bënë që i dëmtuari të vuaj për gjendjen e tij, p.sh., nëse ka shëmtim me deformim të fytyrës, vuajtja e tij mund të jetë shumë më e madhe se sa kur ka një vrage në fytyrë, ndonëse të dy shëmtimet mund të hynë në shkallën e lartë të shëmtimit.

2.13. Shpërblimi në të holla në rast vdekjeje të personave të afërm

Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, në rast vdekjeje të personave të afërm, është përcaktuar me nenin 184 paragrafi 1 dhe 2 i LMD-së.

Një nga format e shpërblimit të dëmit jomaterial është edhe shpërblimi i dëmit në rast vdekjeje të ndonjë personi, ku gjykata mund t'ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit, si dhe bashkëshorti jashtëmartesor në qoftë se ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme) shpërblim të drejtë në të holla për dhimbjen e tyre shpirtërore. Ky shpërblim mund t'ua caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme. Sa i përket bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve, mjafton që të vërtetohet lidhjen familjare me të vdekurin, në mënyrë që të kenë legjitimitetin e palës paditëse në procedurë. Ndërsa sa i përket vëllezërve dhe motrave të vdekurit, përveç të vërtetuarit të faktit të lidhjes familjare me të vdekurin, duhet të provojnë edhe faktin se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme. Se çka paraqet bashkëjetesë të vazhdueshme ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve nuk ka ndonjë definicion, andaj për të definuar çka paraqet bashkëjetesë duhet të marrë si referencë Ligjin për Familjen.

Për t'ua realizuar shpërblimi i dëmit duhet të plotësohen këto kushte: a) të shkaktohet vdekja e të afërmit, b) vdekja të shkaktojë vuajtje të të afërmeve, c) të ekzistojë lidhja kauzale midis vdekjes së shkaktuar dhe vuajtjes psikike të shkaktuar në raport me veprimet e dëmtuesit, dhe d) vdekja të shkaktohet me fajin e dëmtuesit.

Kriteret të cilat duhet t'i marrë gjykata parasysh me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit për këtë lloj të dëmit jomaterial, janë: se çfarë moshe ka pasur i vdekuri në momentin e vdekjes si pasojë e aksidentit, statusi martesor, nëse i vdekuri ka lënë fëmijë të vegjël pas vete, nëse ka qenë fëmija i vetëm i prindërve, nëse ka qenë mbajtës i familjes, lidhjet emocionale me të vdekurin, mënyra se si ka ndodhur aksidenti si dhe kriteret tjera, të cilat duhet gjykata t'i ketë në vëmendje me rastin e caktimit të shpërblimit të dëmit.

Në këtë kontekst, duke ju referuar të cekurave, praktika gjyqësore duke marr për bazë nenin 184 paragraf 1, 2 dhe 4 të LMD-së, në të cilën janë të numëruara në mënyrë taksative personat që kanë të drejtën e shpërblimit jomaterial, në rast të vdekjes të ndonjë të afërmi të tyre, ka përcaktuar se, kjo e drejtë ju takon anëtareve të ngushtë të familjes e siç është përcaktuar me dispozita ligjore, dhe nëse një person i caktuar ka të drejtën e shpërblimit në të holla, për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar në rast vdekje ose invaliditeti të rëndë ose shëmtimi trupor të të afërmit të tij, për caktimin e lartësisë së kompensimit nuk ka nevojë të caktohen ekspertiza mjekësore, për arsye se duke marrë për bazë lidhjet ekzistuese familjare në rast të vdekjes apo invaliditetit të rëndë ose shëmtimi të lartë trupor të anëtarit të familjes, dhimbjet shpirtërore janë evidente të pakontestueshme dhe nuk nevojë të vërtetohet ekzistimi i tyre. Në këto raste gjykata ka në diskrecionin e saj autorizimin të vendose në bazë njohurive dhe përvojës që ka duke marrë për bazë të gjitha rrethanat e cekura si më lartë, ndërsa vëllezërve dhe motrave si dhe bashkëshortes jashtëmartesore kjo e drejtë i njihet vetëm me kushte, nëse në mes tyre ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.

2.14. Shpërblimi në të holla, lidhur me dhembjet shpirtërore për shkak të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të personave të afërt

Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial, lidhur me dhembjet shpirtërore për shkak të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të personave të afërt, është përcaktuar me nenin 184 paragrafi 3 dhe 4 i LMD-së.

Gjykata me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit të dëmit jomaterial në rastet e invaliditetit tejet të rëndë, ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, mund tu caktojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore.

Çka paraqet invaliditet tejet të rëndë, nuk ka ndonjë rregull të shkruar, por praktika e ka pranuar që invaliditet tejet i rëndë është në rastet kur i dëmtuari ka të paktën 50 % të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, e cila në çdo rast përcaktohet nga eksperti përkatës. Ndërsa shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi nënkupton që shëmtimi të jetë i shkallës së lartë, dhe ky shëmtim të jetë i caktuar nga eksperti përkatës. Shpërblimi i këtij dëmi jomaterial mund t'i caktohet edhe bashkëshortit jashtë martesor në qoftë se ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.

Këto raste në praktikën gjyqësore janë të shpeshta kur invaliditeti është tejet i rëndë si pasojë e lëndimeve trupore ose shëmtimit në shkallë të lartë të personave të afërm të cilat shkaktohen në aksidente/incidente në komunikacion, në punë dhe në lidhje me punën dhe në raste të tjera.

Për të ekzistuar mundësia për shpërblimin e dëmit, duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet lëndimi trupor me pasojat e invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtim në shkallë të lartë të personave të afërt, b) invaliditeti tejet i rëndë ose shëmtimi në shkallë të lartë të personave të afërt, t'iu shkaktojë vuajtje psikike të dëmtuarit dhe anëtarëve të tij të afërm, c) të ekzistojë lidhja kauzale midis invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimi në shkallë të lartë të personave të afërt dhe vuajtjes psikike të shkaktuar lidhur me veprimet e dëmtuesit, dhe d) invaliditeti tejet i rëndë ose shëmtimi në shkallë të lartë të personave të afërt të shkaktohet me fajin e dëmtuesit.

2.15. Shpërblimi në të holla, me rastin e heqjes së lirës pa bazë ligjore

Nga perspektiva e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta e shpërblimit të demit jomaterial lidhur me arrestimin dhe privimin e kundërligjshëm duhet të jetë e vlefshme si në aspektin teorik, po ashtu edhe në atë praktik. Në këtë drejtim, GJEDNJ, në rastin *Dubovik v. Ukraine*, ka konstatuar mungesë të mundësisë teorike nga ana e aplikuesit, për të kërkuar shpërblimin, për privim nga liria para autoriteteve vendore. Ndërsa, sa i përket vlefshmërisë së shpërblimit nga aspekti praktik, GJEDNJ, në rastin *Chitayev v. Russia*, ka ripërsëritur se, mos përfundimi i procedurës, përkatësisht pezullimi i saj, i ka pamundësuar efektivisht palës që të kërkojë shpërblimin, për kohën e kaluar në paraburgim. Pra, në secilin rast autoritetet kompetente duhet t'i sigurojnë shpërblim individit i cili në ndonjë rast është subjekt i arrestimit ose paraburgimit të pabazë, dhe kjo mundësi duhet të jetë e vlefshme si në teori, po ashtu edhe në praktikë. Dhe për me tepër, gjatë shqyrtimit të kërkesave për shpërblimin e demit, për paraburgim të paligjshëm, autoriteteve u kërkohet që të interpretojnë dhe zbatojnë të drejtën e brendshme në frymën e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin mëtejme: KEDNJ), pa formalizëm të tepruar, dhe çdo veprim në kundërshtim më këtë kërkesë, rezulton në shkelje të dispozitave të KEDNJ, përkatësisht nenit 5.

Sidoqoftë, KEDNJ ka për qëllim të garantojë jo të drejtat të cilat janë teorike dhe iluzore, por të drejtat të cilat janë praktike dhe efektive, (*Cumber v. The United Kingdom*). Lidhur me këtë, GJEDNJ në raste të caktuara ka hasur në mungesë të së drejtës, për shpërblim të demit jomaterial, për shkak të demit të pësuar si rezultat i paraburgimit të paligjshëm. Në këtë mënyrë, në rastin *Khachatryan and Others v. Armenia* është konstatuar se, shtetet e caktuara në dispozita të ligjeve civile [Kode Civile], e kanë kufizuar këtë të drejtë vetëm sa i përket shpërblimit të demit material, pa përfshirë edhe shpërblimin për demin jomaterial, për shkak të stresit dhe ankthit të përjetuar nga ana e personit si pasojë e mbajtjes në paraburgim pabazë ligjore.

Në këtë mënyrë, mos njohja e së drejtës, për shpërblim të demit jomaterial nga ana e autoriteteve në strukturën e tyre ligjore, ka për pasojë shkeljen e dispozitave të KEDNJ. Nga kjo perspektive e GJEDNJ, duhet të merret për bazë fakti se në çdo rast të demit të drejtave të subjektit, për arsye të arrestit apo privimit të paligjshëm, e drejta për shpërblim të demit jomaterial, për ankthin dhe stresin e përjetuar duhet të jetë një e drejtë e garantuar, kjo paraqet një garancion të mishëruar në dispozitat e nenit 5.5 të KEDNJ, përndryshe çdo veprim në kundërshtim me këtë garancion, paraqet shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Përveç dispozitave të KEDNJ, e drejta e shpërblimit, për arrestim dhe privim të paligjshëm është përcaktuar edhe me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Pra, Kushtetuta garanton të drejtën e shpërblimit pa përmendur apo kategorizuar format e demit të cilat pala mund t'i kërkojë, para organeve/institucioneve shtetërore.

Ky garancion është përcaktuar me nenin 29 paragrafi 5 të Kushtetutës, ku përcaktohet se: “Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligji”.

Siç edhe u theksua me lartë, kjo normë kushtetuese garanton të drejtën e shpërblimit, për ndalim apo arrestim të paligjshëm, pa përmendur format e shpërblimit të demit, të cilat pala mund t'i kërkojë në procedure gjyqësore. Dhe, për me tepër, duke pas parasysh faktin se, Kushtetuta me

nenit 53, ka përcaktuar se: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Andaj, në ushtrimin e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, institucionet duhet t’i marrin për bazë vendimet gjyqësore të GJEDNJ. Kjo është e evidente në një masë si në praktiken gjyqësore të gjykatave të rregullta, ashtu edhe në atë të Gjykatës Kushtetuese. Ky rregullim i dyfishtë në rendin tonë juridik lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve, padyshim se paraqet një mënyrë efektive për sigurimin e realizimit të së drejtës, për shpërblim të demit, në rrethanat kur atyre u është mohuar apo pakësuar një e drejtë e tillë, siç mund të ndodhë në rastet e arrestimit apo privimit të paligjshëm.

Vlerësimi i shumës së demit në rastet e shpërblimit të demit jomaterial, nuk është një detyrë e lehtë, veçanërisht kur objekt i padisë është vuajtja personale, qoftë fizike apo psikike. Kjo, ngjashëm vlerësohet edhe nga perspektiva e GJEDNJ, e cila në rastin *Vasilevskiy and Bogdanov v. Russia*, ka theksuar se, nuk ka asnjë standard me të cilin dhimbja dhe vuajtja, përkatësisht shqetësimi fizik dhe ankthi psikologjik mund të maten në terma parash. Meqenëse, nga vlerësimi i GJEDNJ nuk ka një standard strikt sa i përket njohjes së shumës se shpërblimit, si mënyrë që ka marr parasysh është standardi i jetesës në vendin e caktuar, duke përfshirë, pagën minimale, mesataren e pensionit të pleqërisë, dhe pagën mesatare bruto, (*Nikitin and Others v. Estonia*). Në rastet kur një individ i njihet shuma e shpërblimit, ajo nuk duhet të jetë tepër e ultë sa që të minojë esencën e së drejtës për shpërblim sipas nenit 5.5 të KEDNJ. Pra, nuk duhet të jetë paarsyeshmerisht e ulët, dhe jo në konformitet me standardin e jetesës, përndryshe do të kualifikohet si shkelje e të drejtës së garantuar me këtë dispozitë.

Siç është theksuar edhe me lartë, e drejta për shpërblim lidhet kryesisht me kompensimin financiar. Në fakt, ky shpërblim nuk përcakton të drejtën për të siguruar lirimin e personit të ndaluar, e cila e drejtë rregullohet nga paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ. Pra, neni 5.5 i KEDNJ, përfshin të drejtën e shpërblimit jo vetëm sa i përket demit material, por edhe shpërblimin lidhur me stresin, ankthin dhe vuajtjen shpirtërore që një person mund t’i ketë përjetuar si rezultat i shkeljes së dispozitave tjera të nenit 5 të KEDNJ, (*Sahakyan v. Armenia*). Në rastet e paraqitjes së padisë, për shpërblimin e demit jomaterial, i cili derivon nga një situatë e privimit të kundërligjshëm, është e nevojshme që një procedurë e tillë e shpërblimit të zhvillohet nga institucionet shtetërore pa formalizëm të tepruar, dhe në këtë mënyrë t’i mundësohet palës qasje e lehtë në realizimin e të drejtave të tij subjektive. Dhe, ky shpërblim në mënyrë që të jetë në përputhje me garancitë e përmbajtura në dispozitat e KEDNJ, nuk duhet kufizuar në shpërblimin vetëm të demit material, por duhet në çdo rast të jetë e zbatueshme e drejta e shpërblimit të demit jomaterial.

Nëse i referohemi dispozitave ligjore të LMD-së, rezulton se: shpërblimi në të holla i demit jomaterial, me rastin e heqjes së lirës pa bazë ligjore, është përcaktuar me nenin 183 paragrafi 1 i LMD-së.

Shpërblimi i demit jomaterial mund të realizohet edhe kur shkaktohet cenimi i lirisë-gjegjësisht heqja e lirisë pa bazë ligjore. Këto raste të shpërblimit të demit janë të shpeshta në praktikën gjyqësore të vendit, sepse janë të shpeshta rastet kur cenohet liria për shkak të heqjes së saj, pa bazë ligjore. Andaj, kur këto raste ekzistojnë në kushte të caktuara, i dëmtuari ka të drejtë të

kërkojë realizimin e shpërblimit të dëmit, për shkak të vuajtjes psikike të pësuar si pasojë e heqjes së lirisë pa bazë ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës tashmë ka ndërtuar praktikën gjyqësore se mbi cilat kritere do të vendoset për shpërblimet e dëmit të tillë jomaterial, ndërsa rol në këtë ka edhe praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me seli në Strasburg, që ka përcaktuar se caktimi i kompensimit për këto kategori duhet të trajtohet si satisfaksioni i të dëmtuarve dhe në asnjë mënyrë pasurimi i tyre.

Për t'u realizuar e drejta në shpërblimin e dëmit jomaterial, me rastin e heqjes së lirisë pa bazë ligjore duhet të plotësohen këto kushte: a) të hiqet liria, b) me heqjen e lirisë të shkaktohet vuajtja psikike e të dëmtuarit, c) të ekzistoj lidhja kauzale midis heqjes së lirisë dhe shkakimit të vuajtjes psikike, dhe d) heqja e lirisë të shkaktohet me fajin e dëmtuesit.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se me rastin e gjykimit të shpërblimit për këtë lloj të dëmit, nuk ka arsye për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë, pasi vuajtjet janë evidente dhe nuk ka nevojë të provohen përmes ekspertizës. Përgjithësisht ekspertiza mund të caktohet nëse i dëmtuari ka histori mjekësore të trajtimit mjekësor të aspektit psikiatrik, dhe atë me qëllim të vlerësimit të dokumentacionit mjekësor dhe dhënies së mendimit nëse ekziston lidhja kauzale në mes dokumentacionit mjekësor dhe privimit nga liria

Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit për këtë lloj të dëmit jomaterial, duhet të marrë parasysh moshën e të dëmtuarit, personalitetin e tij, profesionin, jehonën mediatike që i është dhënë rastit me rastin e arrestimit të dëmtuarit dhe gjatë kohës së heqjes nga liria, kohëzgjatjen e privimit nga liria, nëse heqja e lirisë ka konsistuar vetëm në arrest shtëpiak apo qëndrim në paraburgim, natyrën e veprës për të cilën është mbajtur në heqje lirie, si dhe kritere tjera.

2.16. Shpërblimi në të holla në raste të veçanta (cenimi i dinjitetit)

Me nenin 185 të LMD-së, është përcaktuar se e drejta e shpërblimit të drejtë në të holla edhe për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar me rastin e cenimit të dinjitetit personal dhe moralit, si formë e veçantë e cenimit të integritetit personal. Duke pasur parasysh faktin se, edhe në rast të cenimit të dinjitetit personal dhe moralit, dëmi i shkaktuar nuk mund të riparohet duke u kthyer gjendja që ka ekzistuar para shkakimit të tij, siç mund të bëhet në rast të cenimit të integritetit personal me shpifje dhe ofendim, edhe për këtë lloj të veçantë të dëmit është parashikuar e drejta e shpërblimit të drejtë në të holla.

E drejta e shpërblimit të dëmit në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar i takon personit, i cili me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtimi ose varësie, është shtytur në marrëdhënie të dënueshme seksuale ose në veprim të dënueshëm seksual të panatyrshëm, si dhe personi ndaj të cilit është kryer ndonjë veprë tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit.

Për të pasur të drejtën e shpërblimit të këtij lloji të veçantë të dëmit, i dëmtuari duhet të jetë shtyrë në veprime të dënueshme penale me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtimi ose varësie. Mirëpo, dhënia e pëlqimit të personit të dëmtuar për këto

veprime të dëmshme dhe ofenduese e përjashton përgjegjësinë për dëmshpërblimin për veprat ku dhuna, mashtrimi, shpërdorimi i ndonjë raporti të nënshtrimit apo varësie nuk janë elemente të veprës penale.

Edhe pse është fjala për raste të veçanta të shpërblimit të dëmit, edhe te këto vlejnjë rregullat e përgjithshme të LMD-së, për shpërblimin e dëmit, gjë që nënkupton se ai do të pranohet vetëm në rast se cenimi i të drejtës së caktuar personale ka shkaktuar tek i dëmtuari dhimbje shpirtërore të një shkalle dhe kohëzgjatje të caktuar. Pra, për ta caktuar shpërblimin e drejtë në të holla për këto raste, paraprakisht duhet të jetë kryer vepra penale kundër dinjitetit të personit dhe moralit me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie dhe nga kjo i dëmtuari të ketë pësuar dhimbje shpirtërore në shkallë dhe kohëzgjatje të caktuar.

Prandaj, për të pasur të drejtën e shpërblimit duhen plotësuar këto parakushte: a). të ekzistojë marrëdhënia e dënueshme seksuale ose veprimi i dënueshëm seksual i panatyrshëm apo ndonjë veprë tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit; b). që vepra të jetë kryer me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie dhe c). i dëmtuari të ketë pësuar nga kjo dhimbje shpirtërore në shkallë dhe kohëzgjatje të caktuar.

2.17. Shpërblimi në të holla i dëmit të ardhshëm

Shpërblimi në të holla i dëmit të ardhshëm jomaterial, është përcaktuar me nenin 186 i LMD-së.

Sipas kësaj dispozite ligjore gjykata me kërkesë të dëmtuarit do të gjykojë shpërblimin e dëmit edhe për dëmin jomaterial, në qoftë se sipas rrjedhës së rëndomtë me siguri ai do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Në këtë mënyrë mundësohet që i dëmtuari në mënyrë sa më adekuate të marrë ose të realizojë satisfaksionin që atij i takon në raste të ndryshme të shpërblimit të dëmit jomaterial.

Për t'u realizuar ky shpërblim i dëmit duhet të plotësohen këto kushte: a) të shkaktohet ndonjë nga rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial, b) të vërtetohet me siguri se i dëmtuari do të pësojë edhe në të ardhmen dëm jomaterial për një kohë të caktuar, si dhe c) duhet të kihet parasysh edhe rrjedha të tjera lidhur me kushtet e përcaktuara sipas dispozitave të LMD-së, për shpërblimin e dëmit jomaterial në raste dhe në situata të ndryshme.

Ky dëm jomaterial duhet të shkaktohet në të ardhmen dhe duhet të ketë kontinuitetin e rrjedhës së shkaktit të dëmit jomaterial. Ky dëm i ardhshëm është i pavarur prej dëmit material të mëparshëm. Varësisht nga koha kur mund të paraqitet dhe mundësia e paraqitjes, dëmi jomaterial i ardhshëm mund të shfaqet në tri mënyra, si: a). dëm i ardhshëm i pavarur, b). dëm i ardhshëm në kontinuitet dhe c). dëm i ardhshëm eventual.

2.18. Shpërblimi në të holla, për personin juridik

Shpërblimi në të holla, për personin juridik, është përcaktuar me nenin 187 i LMD-së.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton se gjykata i jep shpërblim të drejtë në të holla personit juridik për denigrim të reputacionit ose emrit të mirë, pavarësisht dëmshpërblimit të

dëmit material, në rast se gjen se rrethanat e arsyejnë këtë, qoftë edhe nëse nuk ka dëm material. Në këtë kontekst rezulton se përveç dëmit material, personit juridik mund t'i shkaktohet edhe dëm jomaterial.

Sipas nenit 187 të LMD-së, është përcaktuar se, edhe personi juridik ka të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për shkak të dëmit jomaterial. Këtë shpërblim gjykata i'a pranon personi juridik vetëm në rastet kur, me veprimin ose mosveprimin e tjetrit, është cenuar reputacioni ose emri i mirë i personit juridik.

Zakonisht ndodh që, për shkak të dëmtimit të reputacionit ose emrit të mirë, t'i shkaktohet dëm material personit juridik, mirëpo pavarësisht nga dëmi material, në rast të denigrimit të reputacionit ose emrit, personi juridik ka të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla, në qoftë se këtë e arsyejnë rrethanat e rastit. Në këtë aspekt, në rastet e këtylla i mbetet gjykatës të konstatojë gjendjen ekzistuese të reputacionit dhe emrit që e ka pasur personi juridik para faktit dëmtues, cili ka qenë veprimi apo mosveprimi që ka mundur të ketë ndikim në uljen e reputacionit dhe emrit të mirë dhe nëse ka ndodhur denigrimi i reputacionit ose emrit të mirë të dëmtuarit. Në bazë të të gjitha rrethanave të rastit, pavarësisht nëse ka ose jo dëm material, dhe nëse ka marr shpërblim ose jo, gjykata mund ta caktojë shpërblimin në të holla varësisht nga shkalla dhe pasojat e shkaktoara për të dëmtuarin.

2.19. Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jomaterial

Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jomaterial, është përcaktuar me nenin 188 i LMD-së.

Nëse i referohemi kësaj dispozite ligjore rezulton se: kërkesa e shpërblimit të dëmit jomaterial i kalon trashëgimtarit vetëm në qoftë se është caktuar me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim. Nën kushte të njëjta kjo kërkesë mund të jetë objekt cedimi, shpërblimi dhe i përbarimit të dhunshëm.

E drejta e shpërblimit të drejtë në të holla në emër të dëmit jomaterial, është e drejtë personale, që nënkupton se është e lidhur për personin të cilit i takon ajo. Kjo veçanërisht ndodh në rast të cenimit të ndjenjave personale. Në raste të tilla të drejtën e shpërblimit e ka vetëm personi ndjenjat e të cilit janë cenuar. Përkritazi me të drejtat personale vlen parimi i përgjithshëm se ato nuk mund të barten e as të trashëgohen. I njëjti parim përcaktohet edhe me nenin 188 të LMD-së, me përjashtimet e parashikuara sipas këtij neni.

Sipas nenit 188 të LMD, si rregull, e drejta e shpërblimit të drejtë të dëmit jomaterial nuk mund të bartet te trashëgimtarët e të dëmtuarit. Kjo është rregull e përgjithshme e cila rrjedh edhe nga kjo dispozitë ligjore. Duke u nisur nga fakti që me këtë dispozitë ligjore përcaktohen vetëm rastet kur përjashtimisht kërkesa e shpërblimit të dëmit jomaterial u kalon trashëgimtarëve, rrjedh konstatimi se, si rregull, kjo e drejtë nuk bartet, pasi nuk ka bazë juridike për bartjen e saj dhe nuk trashëgohet, ngaqë është e lidhur për personin, ashtu që, me vdekjen e të dëmtuarit, shuhet edhe ajo.

Me këtë dispozitë ligjore lejohet mundësia e bartjes së kërkesës për shpërblimin e dëmit jomaterial të trashëgimtarët vetëm në rast se gjatë jetës së të dëmtuarit është vendosur për të me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim.

Në këtë kontekst për të kaluar një kërkesë e shpërblimit të dëmit jomaterial të trashëgimtarët, duhet të jetë e gjykuar me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim. Kjo nënkupton se në rastin kur aktgjykimi nuk ka marrë formën e prerë apo nuk ka marrëveshje me shkrim për shpërblimin e dëmit, kërkesat për shpërblimin e dëmit jomaterial nuk mund të barten të trashëgimtarët. Nëse gjatë procedurës apo pa filluar procedura vdes i dëmtuari, trashëgimtarët nuk mund të vazhdojnë procedurën apo të parashtrajnë padi për shpërblimin e dëmit jomaterial.

Mirëpo nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rezulton edhe e drejta e trashëgimtarit të dëmtuarit, si e drejtë e pa cenushme e trashëgimit dhe realizimit të saj, në procedurën përbarimit, për shpërblimit të dëmit jomaterial, vetëm atëherë kur në momentin e vdekjes së të dëmtuarit, lidhur me këtë të drejtë, shpërblimi është vendosur me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim të arritur ndërmjet të dëmtuarit dhe personit përgjegjës për shpërblimin e dëmit.

n) Përgjegjësia e ndarë dhe zvogëlimi i shpërblimit

Përgjegjësia e ndarë dhe zvogëlimi i shpërblimit të dëmit jomaterial, është përcaktuar me nenin 189 të LMD-së, sipas së cilës: “Dispozitat për përgjegjësinë e ndarë dhe për zvogëlimin e shpërblimit që vlejné për dëmin material përshtatshëmrisht zbatohen edhe për dëmin jomaterial.” Mirëpo, në këtë pjesë nuk do të trajtohet përgjegjësia e ndarë dhe zvogëlimi i shpërblimit të dëmit jomaterial, për arsye se e njëjta është elaboruar në pjesën hyrëse, ku është trajtuar aspekti i përgjithshëm i shpërblimit të dëmit.

2.20. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e shpërblimi të dëmit jomaterial, për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, të lirisë ose të të drejtave të personalitetit, frikës, dhembjeve fizike, shëmtimit trupor, zvogëlimi i aktivitetit jetësor, vdekja e të afërmit, invaliditetit të rëndë ose shëmtimit të lartë të ndonjë personi, ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me vlerësimin se cilat kushte duhet të plotësohen për të fituar të drejtën, për të kërkuar shpërblimin e dëmit jomaterial, për këto forma të dëmit, si dhe caktimin e lartësisë së shpërblimit në të holla të dëmit jomaterial.

Këtu do të fokusohemi vetëm sa i përket shkeljeve të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe zbatimit të drejt ose të gabuar të së drejtës materiale, me theks të veçantë tek mënyra e të provuarit, nxjerrja e provës me ekspertizë, plotësimin e kushteve ligjore për të fituar të drejtën, kërkesa për shpërblimin e dëmit jomaterial në të holla, për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, të lirisë ose të të drejtave të personalitetit, frikës, dhembjeve fizike, shëmtimit trupor, zvogëlimi i aktivitetit jetësor, vdekja e të afërmit, invaliditetit të rëndë ose shëmtimit të lartë të ndonjë personi si dhe caktimin e lartësisë së shpërblimit në të holla të dëmit jomaterial.

Në këtë kontekst në praktikën gjyqësore janë paraqitur dilema dhe ka pasur vendimmarrje ndryshe përveç tjerash edhe për faktin se gjykatat e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit jomaterial, gjatë procedurës nuk e kanë vërtetuar në tërësi gjendjen faktike.

Ka raste kur Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën sipas revizionit ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe për këtë arsye nuk kanë ekzistuar kushtet për ndryshimin e aktgjykimeve të goditura, për të cilin shkak aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë janë prishur,

Në disa raste është konstatuar se aktgjykimet e gjykatave të instancave me të ulëta nuk kanë vlerësim dhe arsyetim, se si është aplikuar e drejta materiale, respektivisht mungon arsytimi sa i përket ndarjes së përgjegjësisë dhe kontributit të pjesëmarrësve në shkaktimin e dëmit, me rastin e vendosjes nuk kanë arsytim nëse gjykatat e kanë vlerësuar kontributin e paditësit-të dëmtuarit në shkaktimin e dëmit dhe nëse ky kontribut është llogaritur me rastin e aprovimit/refuzimit të kërkesëpadisë lidhur me lartësinë e dëmit.

Ka raste kur gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që të vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket shpërblimit të dëmit jomaterial, edhe pse në këtë rast gjykata e shkallës së parë, ka nxjerr provën me ekspertim nga lëmia mjekësore, mirëpo në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ka ftuar ekspertin/et e lëmisë mjekësore, për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e tij/tyre profesional, edhe pse kanë pasur kërkesë nga palët ndërgjyqëse që ekspertet të ftohen në seancë për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e tij profesional, ndërsa mendimi i ekspertit i dhënë në ekspertizë ka qenë i mangët dhe jo i plotë.

Në disa raste gjykata e shkallës së parë dhe të dytë në dispozitiv të aktgjykimit, e kanë detyruar të paditurit në kompensimi e dëmit në mënyrë solidare, mirëpo nuk ka dhënë arsye se në ato raste përgjegjësia e të paditurve a mundet me qenë solidare.

Në disa raste gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsytim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht ose në tërësi të bazuara/pabazuara.

Për caktimin e lartësisë së kompensimit gjykata e shkallës së parë ka caktuar ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë dhe psikologjisë, për të përcaktuar dhimbjet psikike që i kanë pësuar të dëmtuarit, në rast vdekjeje të personave të afërm, për shkak të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të personave të afërt, si pasojë e shpifjes dhe fyerjes, etj, mirëpo në këto raste por edhe në raste të ngjashme gjykata ka në diskrecionin e saj autorizimin të vendos në bazë të njohurive dhe përvojës që ka duke marrë për bazë të gjitha rrethanat siç përcaktohet

me dispozitat e LMD-së, dhe se nxjerrja e këtyre ekspertizave është pa ndikim në mënyrën e vendosjes.

Në disa raste mënyra si është vlerësuar kërkesa e palës nga gjykatat e instancës më të ulët është në kundërshtim me dispozitat materiale, duke ju referuar nenit 183 paragrafi 1 të LMD-së, me të cilën është përcaktuar se: “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirisë ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyejnë këto, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”. Kjo pasi që gjykatat e instancës më të ulët kërkesën e palës e kanë trajtuar në këtë mënyrë duke formuluar dispozitivin e aktgjykimit: “padiçës t’ia kompensoj dëmin jomaterial në emër të vuajtjeve shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë, si dhe frikës së përjetuar si pasojë e privimit të kundërligjshëm nga liria...”, mirëpo siç rezultojnë nga mospërputhja mes asaj që kanë vendosë gjykatat, kategorive të dëmit dhe llojeve të kërkuara nga pala padiçës.

2.21. Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

Aktvendim Rev.nr.339/23, i datës 29.11.2023

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi

”Vendimet e gjykatës në secilin rast që i referohen shpifjes apo fyerjes, duhet të jenë në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e assesit përmes këtyre vendimeve të krijohet klima e frikës apo presionit të cenimit apo kufizimit të lirisë së shprehjes në raport me gazetarët.

Gjykata në secilin rast të gjykimit në raport me shpifjen apo fyerjen duhet të balancojë që në njërin anë të kujdeset që të mbrohet dinjiteti dhe personaliteti i individit, që gazetarët dhe të gjithë personat tjerë që ushtrojnë veprimtari mediale të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore dhe akteve nënligjore duke respektuar në maksimum kodin e etikës gazetareske, mirëpo në anën tjetër duhet të ketë në konsideratë interesin publik për figura publike, nevojën e informimit dhe lirisë së shprehjes në atë mënyrë që asnjë vendim të mos ndikojë në cenimin e funksionimit të lirisë së shprehjes si një e drejtë po ashtu e garantuar me Konventë.

Vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rekomandojnë që lehtësisht në një masë mund të tejkalohet liria e shprehjes edhe në dëm të individit (personaliteti publik), por kjo duhet të përbën me të vërtetë interes publik, pra nevojën që publiku të informohet, por duhet me qenë të qartë që kjo assesit nuk nënkupton cenim dhe degradim të rëndë të personalitetit.

Arsyetimi

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, pasi që

aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare, për të cilat shkaqe aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Me nenin 215 të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur me revizion dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësim të rregullt”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika k) e lidhur me nenin 73 dhe 76 të LPK-së, për faktin se gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar duke iu referuar gjendjes së theksuar më lartë nuk ka verifikuar identitetin e palëve në procedurë, në kuptimin procedural - cilësinë e palës së paditur, në fakt përveç të dhënave në padi të theksuara nga i autorizuari i paditëses, në shkresat e lëndës nuk ka prova të verifikuara lidhur me identitetin e palëve - gjegjësisht nuk ka të dhëna të pa kontestuara se pala e paditur NGB “K. S.”, në P., me pronar R. K. dhe kryeredaktoren M. K. dhe I. R. C. G. “K. S.”, në P., te Zona Industriale, me pronar R. K. dhe Kryeredaktoren M. K. nga P., në kohën kur pretendohet se është krijuar raporti juridik (kur pretendohet se ka ndodhur shpifja dhe fyerja) a kanë qenë si një subjekt juridik apo dy subjekte të ndara, nëse kanë qenë si subjekt i vetëm juridik kur janë ndarë dhe çfarë ka ndodhur me të drejtat dhe detyrimet e këtij subjekti. Po ashtu në shkresat e lëndës ekziston certifikata e regjistrimit me numër të biznesit dhe numër fiskal e datës 11.03.2019, nga e cila rezulton se NGB “K.S.” SH.P.K., është asgjësuar/shuar në mënyrë vullnetare, mirëpo e njëjta me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është përfshirë si palë e paditur. Ndërsa gjykata gjatë tërë procedurës duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën pa zotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë kur ai është i nevojshëm siç përcaktohet me nenin 76 të LPK-së.

Në këtë rast nga provat prezentë në lëndë nuk mund të konstatohet në mënyrë të qartë se e paditura NGB “K. S.”, në P., me pronar R. K. dhe kryeredaktoren M. K. dhe I. R. C. G. “K.S.”, në P., te Zona Industriale, me pronar R. K. dhe Kryeredaktoren M. K. nga P., është i njëjti subjekt juridik, apo kanë qenë dy subjekte të pavarura nga njëra - tjetra. Po ashtu në këtë rast nga provat prezentë në lëndë nuk mund të konstatohet në mënyrë të qartë se e paditura NGB “K. S.”, në P., me pronar R. K. dhe kryeredaktoren M. K., gjatë zhvillimit të procedurë në gjykatën e shkallës së parë ka ekzistuar si palë-subjekt juridik, siç u theksuar me lartë.

Me padi të precizuar si në parashtrësit për precizimin e padisë, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë, nuk është përfshirë si palë e paditur pronari dhe kryeredaktorja e saj, e nga përmbajtja e aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë nuk mund të kuptohet se a kemi një të paditur apo tre të paditur, a janë të paditur NGB “K. S.”, në P., apo janë të paditur edhe pronari dhe kryeredaktorja e saj.

Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë në dispozitiv të aktgjykimit, e kanë detyruar të paditurit në kompensimi e dëmit në mënyrë solidare, mirëpo nuk ka dhënë arsye se në rastin konkret përgjegjësia e të paditurve a mundet me qenë solidare, sepse sipas vlerësimit të Gjykatës së Supreme të Kosovës, këtu përgjegjësia nuk mundet me qenë solidare, pasi veprimet duhet të jenë të individualizuara, dhe shkalla e përgjegjësishë nuk mundet me qenë e njëjtë, andaj edhe kompensimi duhet me qenë i individualizuar sikurse veprimi i tyre. Përveç kësaj pronari dhe kryeredaktorja në këtë rast me padi të precizuar si në parashtresat për precizimin e padisë, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk janë të përfshirë si palë e paditur.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, 182 paragrafi 2 pika k) e lidhur me nenin 73 dhe 76 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Në këtë kontekst Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se sipas Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se ligji në fjalë interpretohet në mënyrë e cila siguron se aplikimi i dispozitave të tij, maksimalizon parimin e lirisë së shprehjes dhe do të jetë në pajtim me Kushtetutën si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç zbatohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Vendimi në fjalë duhet të jetë në përputhje të plotë me frymën e vendimeve/praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me seli në Strasburg, sipas të cilës praktikë gjykatat vendore në çdo rast që kanë të bëjë me mediat, në raport me shpifjet apo fyerjet e pretenduara, kërkon kujdes maksimal të shqyrtimit para vendosjes, për arsye se kundër efekti i masave në raport me mediat nënkupton cenimin e frymës së lirisë së shprehjes dhe operimit të tyre.

Për caktimin e lartësisë së kompensimit gjykata e shkallës së parë ka caktuar ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë dhe psikologjisë për të përcaktuar dhimbjet psikike që i ka pësuar paditësjja si pasojë e shpifjes dhe fyerjes, mirëpo në këtë rast por edhe në raste të ngjashme gjykata ka në diskrecionin e saj autorizimin të vendos në bazë të njohurive dhe përvojës që ka duke marrë për bazë të gjitha rrethanat dhe atë: mënyrën e kryerjes së shpifjes apo fyerjes, pastaj veprimet e ndërmarrura nga pala e paditur me qëllim të zvogëlimit të dëmit, demanti apo tërheqja e informacionit nëse është bërë, kërkim falja nëse është shprehur, të ardhurat e personave që pretendohet se kanë kryer veprën e shpifjes, dhe krejt në fund të ketë kujdes që kompensimi më tepër duhet me qenë satisfacion moral.

Vendimet e gjykatës në secilin rast që i referohen shpifjes apo fyerjes, duhet të jetë në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e assesi përmes këtyre vendimeve të

krijohet klima e frikës apo presionit të cenimit apo kufizimit të lirisë së shprehjes në raport me gazetarët, për arsye se kjo bie në kundërshtim me praktikën e GJEDNJ-së.

Me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, përcaktohet se: “ Për shpifjen ose fyerjen e kryer përmes subjekteve mediale, personat që vijojnë janë bashkëpërgjegjës ose përgjegjës individual: autori, redaktori, ose publikuesi apo dikush që ndryshe nga ata ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e saj ”.

Në këtë kontekst fakti që duhet të merren parasysh të hyrat financiare të paditurve me rastin e caktimit të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga shpifja apo fyerja, vërteton faktin se përgjegjësia nuk mundet me qenë solidare, por individuale, edhe pse personat e theksuar në nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, munden me qenë bashkëkryes, mirëpo nuk mund të kenë përgjegjësi solidare.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë arsyetuar lartësisë e kompensimit në raport me secilin të paditur, pra sa kanë qenë të hyrat e gazetës, pastaj kompensimi a është adekuat, por jo të arsyetohet në raport me lartësinë vetëm duke iu referuar njëri të paditur, kur kemi më shumë se një të paditur. Asnjë arsyetim nuk është dhënë në raport me lartësinë e kompensimit për pronarin dhe kryeredaktoren, sa kanë qenë të hyrat e tyre në kohën e shkrimit, lartësia me të njëjtin a është adekuate, si do të mund të ndikon lartësia e të njëjtit në cenimin apo kufizimin e lirisë së shprehjes, interesit publik të informimit nga ana e gazetarëve, dhe se vet konstatimi se ka pasur shpifje apo fyerje dhe një kompensim më tepër moral a do të mund të arriente efektin e synuar dhe a është në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së.

Gjykata në secilin rast të gjykimit në raport me shpifjen apo fyerjen duhet të balancojë që në njërin anë të kujdeset që të mbrohet dinjteti dhe personaliteti i individit, që gazetarët dhe të gjithë personat tjerë që ushtrojnë veprimtari mediale të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore dhe akteve nënligjore duke respektuar në maksimum kodin e etikës gazetareske, mirëpo në anën tjetër duhet të ketë në konsideratë interesin publik për figura publike, nevojën e informimit dhe lirisë së shprehjes në atë mënyrë që asnjë vendim të mos ndikoj në cenimin e funksionimit të lirisë së shprehjes si një e drejtë po ashtu e garantuar me Konventë. Në rastet që i referohen mbrojtjes së personalitetit/dinjtetit të individit dhe lirisë së shprehjes, në një masë të caktuar vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rekomandojnë që lehtësisht në një masë mund të tejkalohet liria e shprehjes edhe në dëm të individit (personaliteti publik), por kjo duhet të përbën me të vërtetë interes publik, pra nevojën që publiku të informohet, por duhet me qenë të qartë që kjo assesi nuk nënkupton cenim dhe degradim të rëndë të personalitetit.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, udhëzohet që ti evitohet shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, duke vlerësuar të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit (për gjykatën, për palët, për objektin e kontestit dhe për padinë) dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktotë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore) t'i administrojë provat e nevojshme për vërtetimin e fakteve vendimtare, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me

kërkesëpadinë e paditëses. Me rastin e vendosjes meritorë, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitoje shkeljet procedurale të konstatuara si me lart nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragraf 2, e lidhur me nenin 215 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktgjykimi Rev.nr.138/2021, i datës 14.04.2021

Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi

”Gjykata Supreme me rastin e vendosjes në këtë rast ka marrë për bazë edhe praktikën e krijuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me seli në Strasburg, e cila në praktikën e saj të vendosjes lidhur me shkeljet nga neni 5 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, që kanë të bëjnë shkeljet e dispozitave të këtij neni, ka caktuar shumta të përafërta me ato të gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me rastin e vendosjes lidhur me këto raste lidhur me nenin 5 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, ka pasur parasysh shkeljen e të drejtave të përcaktuara me këtë nen, që është e drejta për liri dhe siguri, volumin e të drejtave të cenuara dhe dhimbjeve shpirtërore të cilat janë shkaktuar si pasojë e këtyre shkeljeve subjektive të caktuara, dhe se shumta e gjykuara në këto raste nuk janë shumta të larta, pasi qëllimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka qenë satisfaksioni i të dëmtuarve me rastin e gjykitimit të shumave për dëmin jomaterial, dhe në asnjë mënyrë pasurimi i tyre.

Andaj duke marrë parasysh praktikën e kësaj gjykate, dhe faktin se kërkesa e paditësit paraqet bazë për shpërblim në bazë të nenit 5.5, të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, dhe duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, se kemi të bëjmë me vendim lirues, me të cilin tani paditësi është liruar nga përgjegjësia penale, për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit, për të cilën ishte akuzuar, me çka drejtësia është vërë në vend, dhe se paditësi asnjëherë nuk është shpallur fajtorë për veprën për të cilën është akuzuar, por edhe duke marrë parasysh faktin se paditësi ka qëndruar në paraburgim për 30 ditë, kohë kur paditësit i është cenuar e drejta e lirisë në kundërshtim me nenin 5 të Konventës, dhe ndaj tij procedura penale ka zgjatur nga 25.03.2008, kur është arrestuar, dhe deri me përfundimin e kësaj procedure me aktgjykim të formës së prerë më datë 03.04.2012, pasi që është një periudhë relativisht e gjatë, gjatë së cilës periudhë ka qenë i cenuar nderi i paditësit, dhe për këto arsye është e natyrshme që ka përjetuar dhimbje shpirtërore, të cilat fakte janë marrë parasysh me rastin e gjykitimit të shumës prej 3,600.00 €, që është shumë më e lartë, se shumta e gjykuara edhe sipas praktikës së krijuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut për këto raste“.

Arsyetimi

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të gjykatës së shkallë së parë për kërkesat për të cilat është refuzuar revizioni, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim

të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa në pjesën që është ndryshuar vlerëson se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimet e paraqitura në revizion nga pala paditëse se aktgjykimet e lartpërmendura të instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Pretendimi se aktgjykimet nuk përmbajnë arsye për faktet vendimtare me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dëmit jomaterial, është pretendim i pa bazuar, ngase aktgjykimet në strukturë dhe përmbajtje janë në përputhje me dispozitat e nenit 160, të LPK-së, ndërsa dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt dhe arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve dhe mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar gjendja faktike e konstatuar dhe e vërtetuar në përputhje me të drejtën materiale.

I padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës në revizionin e paraqitur nuk i është referuar si bazë për parashtrimin e revizionit shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore.

Gjykata Supreme sa i përket shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, përveç atyre të pretenduara nga palët, ka detyrim të kujdeset sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitën e nenit 215 të LPK-së, me ç'rast ka gjetur se aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

Baza juridike sa i përket detyrimit të paditurit Këshillit Gjyqësor të Kosovës që paditësit ti paguaj dëmin, për shkak të privimit të lirisë dhe qëndrimit në paraburgim në mënyrë të pa ligjshme, nuk ka qenë kontestuese, prandaj Gjykata Supreme në këtë pjesë sa i përket zbatimit të dispozitave materiale juridike është kufizuar, duke qenë se deklarimi për bazën është çështje që i referohet disponibilitetet të kërkesave për të cilën palët mund të disponojnë lirish në këtë rast.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimeve të atakuara sa i përket dëmit jomaterial që paditësit në emër të dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, Gjykata Supreme duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe sipas pretendimeve në revizion për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimeve në kuptim të dispozitës së nenit 224 paragrafi 1, i LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjendja faktike për dëmin jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, e për të cilat është vendosur si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse gjykata e shkallës së parë me ekspertizë mjekësore të punuar nga eksperti i psikiatrisë, ka gjetur se paditësi si pasojë e arrestimit dhe qëndrimit në paraburgim dhe kohëzgjatjes së procesit në procedurën penale të zhvilluar ndaj tij, deri në shpalljen e aktgjykimit dhe deklarimit si të pafajshëm, ka pësuar dhimbje shpirtërore, e cila dhimbje gjatë periudhës së paraburgimit ka qenë e intensitetit posaçërisht të lartë për 30 ditë, duke filluar nga moment i arrestimit mediatik duke ju ekspozuar opinionit publik, me lajme duke përshkruar në detaje prangosjen e cila situatë denigruese ka ndikuar në dëmtimin e rend të imazhit dhe integritetit të tij e duke marrë parasysh se i njëjti është

figurë publike. Ky moment te i njëjti ka ndikuar negativisht duke humbur imazhin dhe respektin tek të gjithë njerëzit të cilët i ka njohur. Kjo situatë ka ndikuar edhe në familjen e tij tek fëmijët dhe bashkëshortja në raport me njerëzit të cilët i kanë njohur në shkollë, shok e shoqe. Pas lirimit nga paraburgimi te i njëjti kanë vazhduar dhimbjet shpirtërore, duke përjetuar anktetë, pa gjumësi, gjendje reaktive emocionale si pasojë e dëmtimit të ekuilibrit dhe dinamikës psikike. Pastaj i njëjti ka qenë nën stresin e vazhdueshëm për shkak të ecurisë së procesit gjyqësor kundër tij duke qenë i pa sigurt për të ardhmen e tij, për fëmijët e tij, periudhë kur është ndier i stigmatizuar nga shoqëria të cilët i kanë ikur dhe ju kanë shmangur kur është takuar me ta, duke vlerësuar këtë përfundim të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata Supreme vlerëson se shuma e gjykuar nuk ishte në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimit, andaj edhe u vendos që për këtë kërkesë të ndryshohen aktgjykimet.

Në rastin konkret në kontekstin e dispozitës nga paragrafi 1, i nenit 200 të LMD-së, paditësit i takon kompensimi për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë, dhe formulimi si në kërkesëpadi nga pala paditëse për këtë formë të dëmit në vete paraqet kërkesën për të dy këto kategori të cilat i ka njohur ligji si bazë për shpërblim të dëmit jomaterial, ndonëse janë paraqitur si një kërkesë e vetme monetare, andaj kjo gjykatë ka pasur parasysh këtë rrethanë me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit jomaterial, duke vlerësuar se paditësit i është cenuar e drejta e lirisë, dhe po ashtu për shkak të zhvillimit të procedurës penale e cila ka përfunduar me aktgjykimin lirues, i është cenuar edhe nderi, në kuptim të kësaj dispozite. Ndërsa formulimi si në kërkesëpadi “të dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, dhe të drejtave të personalitetit,” ligji nuk i njeh si kategori të veçanta të shpërblimit të dëmit, por të njëjtat hynë në kuadër të dy kategorive të lartë cekura për të cilat ligji njeh të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë, ndërsa duke marrë parasysh se nuk ka pasur kërkesë të veçantë monetare për këto kërkesa, gjykata i ka vlerësuar, si jo ekzistente si të pa varura, dhe të njëjtat i ka vlerësuar se hynë në kuadër të dy kërkesave për të cilat paditësit i është njohur e drejta për shpërblimin e dëmit jomaterial për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë.

Po të kishte kërkesë edhe mund të gjykonte ndaras kërkesën për cenim të shkeljes së nderit dhe po ashtu ndaras kërkesën për cenim të lirisë, por kurrsesi nuk mund të qëndroj si e veçantë kërkesa për dhimbje shpirtërore pa u ndërlidh me ndonjërin nga rrethanat që e shkakton dhimbjen shpirtërore e cila gjithashtu duhet të jetë e përcaktuar apo përmbajtje e dispozitës ligjore e cila e parasheh mbrojtjen e të drejtës subjektive.

Me këtë rast Gjykata Supreme, vlerëson se për çdo kërkesë lidhur me dëmin jomaterial gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'i shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfakcioni për të dëmtuarin.

Mbi këtë bazë duke e pasur parasysh natyrën e përjetimeve, të dhimbjeve të aspektit psikik të shkaktuara paditësit, gjykata vlerësojë posaçërisht rrethanat se natyra e veprës penale për të cilën ishte akuzuar paditësi ishte e rëndë shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit, dhe rrjedhimisht dhimbjet shpirtërore për shkak të akuzës kanë qenë të mëdha, ashtu siç edhe eksperti ka konstatuar me ekspertizë, po ashtu duke marrë parasysh kohëzgjatjen e qëndrimit në paraburgim për 30 ditë, pozitën të cilën e ka pasur në shoqëri para arrestimit, jehonën mediatike që ka pasur

arrestimi i tij, si dhe praktikën e mirë gjyqësore të krijuar për këtë formë të dëmit jomaterial, vendosi që kompensimi të jetë në lartësi prej 3.600,00 Euro, duke vlerësuar se me këtë shumë paditësi do të ketë një satisfaksion për përjetimet e marra si rezultat i privimit të lirisë dhe procedurave të zhvilluara.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për këtë formë të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, Gjykata Supreme vlerëson se shuma e gjykuar nuk është në harmoni me pasojat e krijuara dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të nderit dhe lirisë, duke vendosur të aprovohet dhe refuzohet kërkesa si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka pasur parasysh edhe praktikën e krijuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me seli në Strasburg, e cila në praktiken e saj të vendosjes lidhur me shkeljet nga neni 5 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, që kanë të bëjnë shkeljet e dispozitave të këtij neni ka caktuar shuma të përafërta me ato të gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me seli në Strasburg, me rastin e vendosjes lidhur me këto raste lidhur me nenin 5 të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ka pasur parasysh shkeljen e të drejtave të përcaktuara me këtë nen, që është e drejta për liri dhe siguri, volumin e të drejtave të cenuara dhe dhimbjeve shpirtërore të cilat janë shkaktuar si pasojë e këtyre shkeljeve subjekteve të caktuara, dhe se shumata e gjykuara në këto raste nuk janë shumata të mëdha, pasi qëllimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka qenë satisfaksioni i të dëmtuarve me rastin e gjykimit të shumave për dëmin jomaterial, dhe në asnjë mënyrë pasurimi i tyre.

Andaj duke marrë parasysh praktikën e kësaj gjykate, dhe faktin se kërkesa e paditësit paraqet bazë për kompensim në bazë të nenit 5.5, të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, dhe duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, se kemi të bëjmë me vendim lirie, me të cilin tani paditësi është liruar nga përgjegjësia penale për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit, për të cilën ishte akuzuar, me çka drejtësia është vërë në vend, dhe se paditësi asnjëherë nuk është shpallur fajtorë për veprën për të cilën është akuzuar, por edhe duke e marrë parasysh faktin se paditësi ka qëndruar në paraburgim për 30 ditë, kohë kur paditësit i është cenuar e drejta e lirisë në kundërshtim me nenin 5 të Konventës, dhe ndaj tij procedura penale ka zgjatur nga 25.03.2008, kur është arrestuar, dhe deri me përfundimin e kësaj procedure me aktgjykim të formës së prerë më datë 03.04.2012, pasi që është një periudhë relativisht e gjatë, gjatë së cilës periudhë ka qenë i cenuar nderi i paditësit, dhe për këto arsye është e natyrshme që ka përjetuar dhimbje shpirtërore, të cilat fakte janë marrë parasysh me rastin e gjykimit të shumës prej 3600.00euro, që është shumë më e lartë, se shumata e gjykuara edhe sipas praktikës së krijuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut për këto raste

Duke marrë parasysh arsyet e lartë cekura çdo pretendim i palës paditëse sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit është i pa themeltë.

Sa i përket vendosjes si në aktgjykimin e shkallës së parë, që të aprovohet kërkesëpadinë për dëmin material, për angazhim të avokatit në procedurë penale në shumën prej 8.000,00€, i cili vendim

është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë, nga pala e paditur Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka pasur pretendime në revizion, ndërsa pala paditëse nuk ka interes që aktgjykimi të goditet në këtë pjesë, andaj aktgjykimi i atakuar me revizion në këtë pjesë ka mbetur i pa shqyrtuar.

Sa i përket vendosjes si në pikën V, të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ku është aprovuar tërësisht ankesa e të paditurit të dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës, dhe është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që është refuzuar si e pabazuar kërkesëpapia e paditësit që e paditura e dytë t'ia paguajë solidarisht paditësit për kompensim dëmi për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, dëmin material, kamatën dhe shpenzimet e procedurës, në mungesë të legjitimitetit pasiv të palës, nuk ka pasur pretendime sipas revizionit të palës paditëse dhe të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, andaj ka mbetur i pa shqyrtuar aktgjykimi i shkallës së dytë për këtë pikë të vendosjes.

Sa i përket vendosjes për kamatën, gjykata e shkallës së parë dhe të dytë ka vendosur drejtë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 277 të LMD, duke e llogaritur atë sipas mjeteve të deponuara në banka pa destinim të caktuar mbi një vit prej ditës së marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të datës 20.07.2017, e deri në pagesën definitive, me të cilin qëndrim pajtohet plotësisht edhe kjo gjykatë, andaj pretendimi si në revizion se duhet të aplikohet kamata prej 8%, është tërësisht e pa bazuar.

Kërkesa e të autorizuarit të paditësit si në revizion që ti kompensohen shpensimet e procedurës të krijuara sipas revizionit, në shumën prej 967.00€, është e pa themeltë, gjykata me rastin e vendosjes është bazuar në nenin 452.2 dhe 465.1, të LPK-së.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga i autorizuari i paditëses nuk janë vlerësuar pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 224.1 dhe 222 të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi Rev.nr.286/21, 14.03.2022

Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi

”Përveç të cekurave për hir të praktikës gjyqësore, Gjykata Supreme vlerëson se me nenin 184 paragraf 1, 2 dhe 4 të LMD-së, janë të numëruara në mënyrë taksative personat që kanë të drejtën e shpërblimit jomaterial, në rast të vdekjes të ndonjë të afërmi të tyre, me ligj është përcaktuar se kjo e drejtë ju takon anëtareve të ngushtë të familjes e siç është përcaktuar në këtë rast prindërve dhe fëmijëve tani të ndërjerit dhe se kjo e drejtë të njëjtëve ju takon pavarësisht nëse kanë jetuar ose jo në një bashkësi të vetme familjare, dhe nëse një person i caktuar ka të drejtën e shpërblimit në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar në rast vdekje ose invaliditeti të rëndë ose shëmtim trupor të të afërmit të tij për caktimin e lartësisë së kompensimit nuk ka nevojë të caktohen ekspertiza mjekësore, për arsye se duke marrë për bazë lidhjet ekzistuese familjare në rast të vdekjes apo invaliditetit të rëndë ose shëmtim të lartë trupor të

anëtarit të familjes, dhimbjet shpirtërore janë evidente të pakontestueshme dhe nuk nevojë të vërtetohet ekzistimi i tyre.

Në këtë rast por edhe në raste të ngjashme gjykata ka në diskrecionin e saj autorizimin të vendose në bazë njohurive dhe përvojës që ka duke marrë për bazë të gjitha rrethanat e cekura si më lartë, ndërsa vëllëzërve dhe motrave si dhe bashkëshortes jashtëmartesore kjo e drejtë i njihet vetëm me kushte nëse në mes tyre ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme, ndërsa personat e tjerë si në këtë rast siç janë gjyshi dhe gjyshja janë të përjashtuar nga e drejta për një kompensim të tillë“.

Arsyetimi

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të gjykatës së shkallës së parë për kërkesat për të cilat është refuzuar revizioni, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa në pjesën që është ndryshuar vlerëson se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

I autorizuari i palës paditëse në revizionin e paraqitur nuk i është referuar si bazë për parashtrimin e revizionit shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj Gjykata Supreme sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në kuptim me nenin 215 të LPK-së, me ç’ rast ka gjetur se aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

Baza juridike nuk ka qenë kontestuese, prandaj Gjykata Supreme në këtë pjesë sa i përket zbatimit të dispozitave materiale - juridike është kufizuar, duke qenë se deklarimi për bazën është çështje që i referohet disponibilitetet të kërkesave për të cilën palët mund të disponojnë lirish në këtë rast.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjytimeve të atakuara sa i përket dëmit material për ngritjen e lapidarit, Gjykata Supreme duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe sipas pretendimeve në revizion për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 224 paragrafi 1, të LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për arsye se me nenin 177 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që ti kompensoj shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij ”, në këtë rast paditësve ju takon e drejta në kompensimin e këtij lloji të dëmit material. Përkundër faktit se paditësit për këtë kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave të Kosovës, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi dhe duke marrë për bazë rrethanat e pa planifikuara dhe gjendjen e rënduar emocionale është vështirë të argumentohet me prova konkrete, Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë rast paditësit i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe me vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kriterie orientuese, rezultojnë se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve

për këto kategori të dëmeve ju njohin të drejtën në kompensim, e të cilat shuma janë në nivelin e shpenzimeve mesatare që u krijohen familjeve me rastin e këtyre ceremonive.

Gjykata Supreme vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për pjesën e kërkesave për dëmin jomaterial për të cilat është refuzuar revizioni në raport me paditësit M.Sh. dhe M.Sh., përkatësisht gjyshi dhe gjyshja e tani të ndjerit, për arsye se me nenin 184 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Në rast vdekje të ndonjë personi, gjykata mund t’ ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhimbjen e tyre shpirtërore ”, me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “ Ky shpërblim mund ti caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme ”, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet se: “ Shpërblimi nga paragraf 1 dhe 3 i këtij neni mund t’ i caktohet edhe bashkëshortit jashtëmartesor në qoftë se ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme ”.

Përveç të cekurave për hir të praktikës gjyqësore, Gjykata Supreme vlerëson se me nenin 184 paragraf 1, 2 dhe 4 të LMD-së, janë të numëruara në mënyrë taksative personat që kanë të drejtën e shpërblimit jomaterial, në rast të vdekjes të ndonjë të afërmi të tyre, me ligj është përcaktuar se kjo e drejtë ju takon anëtarëve të ngushtë të familjes e siç është përcaktuar në këtë rast prindërve dhe fëmijëve tani të ndjerit dhe se kjo e drejtë të njëjtëve ju takon pavarësisht nëse kanë jetuar ose jo në një bashkësi të vetme familjare, dhe nëse një person i caktuar ka të drejtën e shpërblimit në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar në rast vdekje ose invaliditeti të rëndë ose shëmtim trupor të të afërmit të tij për caktimin e lartësisë së kompensimit nuk ka nevojë të caktohen ekspertiza mjekësore, për arsye se duke marrë për bazë lidhjet ekzistuese familjare në rast të vdekjes apo invaliditetit të rëndë ose shëmtim të lartë trupor të anëtarit të familjes, dhimbjet shpirtërore janë evidente të pakontestueshme dhe nuk nevojë të vërtetohet ekzistimi i tyre. Në këtë rast por edhe në raste të ngjashme gjykata ka në diskrecionin e saj autorizimin të vendose në bazë njohurive dhe përvojës që ka duke marrë për bazë të gjitha rrethanat e cekura si më lartë, ndërsa vëllezërve dhe motrave si dhe bashkëshortes jashtëmartesore kjo e drejtë i njihet vetëm me kushte nëse në mes tyre ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme, ndërsa personat e tjerë si në këtë rast siç janë gjyshi dhe gjyshja janë të përjashtuar nga e drejta për një kompensim të tillë.

Gjykata Supreme vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për pjesën e kërkesave për dëmin jomaterial për të cilat është refuzuar revizioni në raport me paditësit A.Sh., D.Sh., L.Sh., A.Sh., pasi që vlerësoj se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin të cilit i shërbenë kompensimi. Në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkëlqes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarit. Në këtë rast gjykata ka pasur parasysh raportin e paditësve me tani të ndjerin duke marrë për bazë rrethanën se raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve dhe vëllezërve dhe motrave janë shumë emocionale, të ndjeshme dhe shpirtërore, dhe në këtë vështrim Gjykata Supreme vlerëson se dhimbjet shpirtërore të paditësve për shkak të vdekjes së fëmijë, vëllait të tyre, në aksident kanë qenë të larta, e duke marrë parasysh edhe rrethanat familjare në Kosovë, veçanërisht rrethanën se si ka ndodhur aksidenti, për arsye se raportet në

mes të prindërve dhe fëmijëve, vëllezërve dhe motrave janë shumë emocionale dhe humbja e anëtarëve të familjes në aksident e veçanërisht humbja e fëmijës, vëllait si dhe rrethanave si ka ndodhur aksidenti, është manifestuar me dhimbje shpirtërore shumë të larta, dhe se këto dhembje nuk ka nevojë të vërtetohen me ekspertizë mjekësore sepse këto kanë qenë evidente tek paditësit, prandaj shumat e gjykuara për këtë aspekt të dëmit, nga ana e gjykatës është konsideruar se janë në pajtim me të mirën e shkelur dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi dhe se shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë për paditësit paraqesin një satisfaksion për ta. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket kësaj kategorie të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni me provat e administruara dhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë si dhe praktika gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimi të gabuar të së drejtës materiale që ka të bëjë me lartësinë e shumave të gjykuara paditësve në emër të dëmit jomaterial të gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë sipas aktgjykimit të atakuar, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet e revizionit të autorizuarit të palës paditëse për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykatat e instancave më të ulëta në përputhje me gjendjen faktike kanë aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, duke i'u referuar dispozitave nga neni 183 i LMD-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi Rev.nr.60/23, i datës 27.02.2023

Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi

”Nga interpretimi i dispozitave ligjore, si dhe nga vlerësimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkesëpadia e paditësve F.R. dhe R.R. është në tërësi e pabazuar. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë drejt kanë aplikuar dispozitat e LMD-së dhe KPPK-së, për arsye se me nenin 534 dhe 538 të KPPK-së, si dhe me dispozitat tjera të këtij kodi nuk iu është njohur e drejta, për kompensim familjarëve të personave të dënuar, arrestuar pa arsye, që janë mbajtur një kohë në paraburgim apo në një institucion korrektues për vuajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar.

Përveç të cekurave për hir të praktikës gjyqësore, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se me nenin 534 dhe 538 të KPPK-së, dhe 200 të LMD-së, janë të numëruar në mënyrë taksative personat që kanë të drejtën e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të shkeljes së lirisë, dhe se kjo e drejtë të njëjtëve ju takon ashtu siç është përcaktuar me dispozita ligjore, dhe nëse një person i caktuar ka të drejtën e kompensimit në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore të

pësuara, për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë, për caktimin e lartësisë së kompensimit nuk ka nevojë të caktohet ekspertiza mjekësore, për arsye se duke marrë për bazë dhimbjet shpirtërore-vuajtja psikike e ndërlidhur me rrethanën që e shkakton dhimbjen-gjegjësisht shkeljen e lirisë, dhimbjet shpirtërore janë evidente të pakontestueshme dhe nuk nevojë të vërtetohet ekzistimi i tyre.

Po ashtu edhe nga interpretimi i paragrafit 1 të nenit 200 të LMD-së, rezulton se për dhimbjet e përjetuara shpirtërore do të gjykohet kompensimi, por në çdo rast dhimbjet shpirtërore duhet të jenë pasojë e një rrethane që e shkakton dhimbjen siç mund të jetë shkelja e nderit, e lirisë, e vdekjes së të afërmit, etj. Pra nuk mund të gjykohet kompensimi për dhimbje shpirtërore-vuajtje psikike pa qenë dhimbje shpirtërore-vuajtja psikike e ndërlidhur me një rrethanë që e shkakton dhimbjen. Në këtë rast në kontekstin e dispozitës së cituar nga paragrafi 1, i nenit 200 të LMD-së, paditësve F.R. dhe R.R. nuk i takon kompensimi për dhimbje shpirtërore-vuajtjet psikike (vuajtjet psikike në literaturë përdoren si përjetim analog i dhimbjeve shpirtërore që i korrespondon dispozitës së cituar) për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë.

Arsyetimi

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të gjykatës së shkallë së parë për kërkesat për të cilat është refuzuar revizioni, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënë me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë edhe për zbatimin e drejt, të së drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për arsye se:

Me nenin 534 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, përcaktohet se: “ (1) Të drejtë në kompensim dëmi për dënim të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e re është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, përveç në këto raste: 1) Kur pushimi i procedurës ose aktgjykimi me të cilin akuza është refuzuar ka ndodhur për arsye se në procedurën e re paditësi subsidiar apo paditësi privat është tërhequr nga ndjekja ose i dëmtuari është tërhequr nga propozimi si rezultat i marrëveshjes me të pandehurin ose 2) Kur në procedurën e rishikimit me aktgjykim është refuzuar akuza për shkak të moskompetencës së gjykatës, e paditësi i autorizuar e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente. (2) I dënuari nuk ka të drejtë në kompensim dëmi në qoftë se me pohimin e tij të rremë ose në mënyrë tjetër ka shkaktuar me qëllim dënimin e tij, përveç kur për këtë ka qenë i shtrënguar. (3) Në rast të dënimit për vepra penale në bashkim, e drejta në kompensim dëmi ekziston për veprën penale për të cilën plotësohen kushtet për njohjen e kompensimit ”.

Me nenin 538 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, përcaktohet se: “ (1) E drejta në kompezim dëmi i takon gjithashtu: 1) Personit i cili ka qenë në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar; 2) Personit i cili ka vuajtur dënimin me heqje të lirisë dhe me rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i është shqiptuar dënim me burgim më të shkurtër nga dënimi të cilin e ka vuajtur, apo i është shqiptuar saksion penal që konsiston me heqje lirie ose është deklaruar fajtor dhe është liruar nga dënimi; 3) Personit i cili për shkak të gabimit ose veprimit të paligjshëm të një organi është arrestuar pa arsye ose është mbajtur një kohë në paraburgim apo në një institucion korrektues për vuajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar dhe 4) Personit i cili në paraburgim ka kaluar kohë më të gjatë se sa dënimi me burgim për të cilin është gjykuar. (2) Personi i cili sipas nenit 211 ose 212 të këtij Kodi është arrestuar pa bazë ligjore, i takon e drejta në kompensim dëmi në qoftë se kundër tij nuk është caktuar paraburgimi dhe koha e paraburgimit nuk i është llogaritur në dënimin e shqiptuar për veprën penale ose kundërvajtje. (3) Kompensim dëmi nuk i takon personit i cili me veprimet e tij të palejueshme ka shkaktuar heqjen e lirisë. Në rastet nga paragrafi 1, nënparagrafët 1 dhe 2 të këtij neni përjashtohet e drejta në kompensim dëmi kur ekzistojnë rrethanat nga neni 534, paragrafi 1, nënparagrafët 1 dhe 2 të këtij Kodi. (4) Në procedurën për kompenzimin e dëmit në rastet e parapara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, dispozitat e këtij kapitulli zbatohen përshtatshëm

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij “.

Me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia “

Me nenin 200 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetesës, të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm, si dhe për frikën, gjykata, po të konstatohet se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material ”, ndërsa me paragrafi 2 të këtij neni, përcaktohet se: “ Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave dispozitave ligjore, si dhe nga vlerësimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës sipas vlerësimit të Gjykata Supreme të Kosovës, kërkesëpadia e paditësve F.R. dhe R.R., është në tërësi e pabazuar. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë drejt kanë aplikuar dispozitat e LMD-së dhe KPPK-së, për arsye se me nenin 534 dhe 538 të KPPK-së, si dhe me dispozitat tjera të këtij kodi nuk iu është njohur e drejta, për kompensim familjarëve të personave të dënuar, arrestuar pa arsye, që janë mbajtur një kohë në paraburgim apo në një institucion korrektues për vuajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar.

Përveç të cekurave për hir të praktikës gjyqësore, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se me nenin 534 dhe 538 të KPPK-së dhe 200 të LMD-së, janë të numëruar në mënyrë taksative personat që kanë të drejtën e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të shkeljes së lirisë, dhe se kjo e drejtë të njëjtëve ju takon ashtu siç është përcaktuar me dispozita ligjore, dhe nëse një person i caktuar ka të drejtën e kompensimit në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar, për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë, për caktimin e lartësisë së kompensimit nuk ka nevojë të caktohet ekspertiza mjekësore, për arsye se duke marrë për bazë dhimbjet shpirtërore-vuajtja psikike e ndërlikur me rrethanën që e shkakton dhimbjen-gjegjësisht shkeljen e lirisë, dhimbjet shpirtërore janë evidente të pakontestueshme dhe nuk nevojë të vërtetohet ekzistimi i tyre.

Po ashtu edhe nga interpretimi i paragrafit 1 të nenit 200 të LMD-së, rezulton se për dhimbjet e përjetuara shpirtërore do të gjykohet kompensimi, por në çdo rast dhimbjet shpirtërore duhet të jenë pasojë e një rrethane që e shkakton dhimbjen siç mund të jetë shkelja e nderit, e lirisë, e vdekjes së të afërmit, etj. Pra nuk mund të gjykohet kompensimi për dhimbje shpirtërore-vuajtje psikike pa qenë dhimbje shpirtërore-vuajtja psikike e ndërlikur me një rrethanë që e shkakton dhimbjen. Në këtë rast në kontekstin e dispozitës së cituar nga paragrafi 1, i nenit 200 të LMD-së, paditësve F.R. dhe R.R. nuk i takon kompensimi për dhimbje shpirtërore-vuajtjet psikike (vuajtjet psikike në literaturë përdoren si përjetim analog i dhimbjeve shpirtërore që i korrespondojnë dispozitës së cituar) për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë.

Gjykata Supreme, e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale që ka të bëjë me bazën juridike të kërkesëpadisë në raport me paditësit F.R. dhe R.R., për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj

secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi. Në këtë kontekst nuk janë pranuar pretendimet sipas revizionit nga pala paditëse, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së dytë në përputhje me gjendjen faktike ka aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, duke i` u referuar nenit 154, 158 dhe 200 të LMD-së, e lidhur me nenin 534 dhe 538 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi Rev.nr.98/2023. i datës 04.04.2023

Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi

”Me vet faktin jo kontestues se për shkak të veprimeve të kundërligjshme të punëtorit të paditurës, paditësi në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) është vënë në listën e zezë të borxhlive dhe për pasojë emri i paditësit në këtë listë qëndron dhjetë vite dhe si shkak i saj paditësi klasifikohet si borxhli i keq për të cilën arsye asnjë bankë në Kosovë nuk i akordon lejon kredi paditësit, siç nuk i ka lejuar kredi as banka R., në Kosovë, kjo tregon mjaftueshëm se paditësit i është cenuar autoriteti dhe nderi për asgjë tjetër, si qytetarë i thjeshtë gjithsesi, vlerë kjo personale që është e çmueshme dhe e garantuar ligjërisht me nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e që për dhimbjet shpirtërore për cenimin e kësaj vlere personale me nenin 200 të LMD, parashihet kompensimi në formë të satisfacionit. Andaj, duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat e më sipërme, sidomos kohëzgjatjen e dhimbjeve shpirtërore për cenim të autoritetit dhe nderit të paditësit me faktin se për shumë vite emri i paditësit figuron në BQK, në listën e borxhlive të këqij, dhe për pasojë asnjë bankë në Kosovë atij nuk i aprovon asnjë lloj kredie, ndonëse saktësisht nuk mund të matet lartësia e këtij satisfacioni, Gjykata Supreme sipas vlerësimit të lirë në pajtim me nenin 323 të LPK, paditësit i aprovoi shumë prej 3,000.00 €, me të cilën sigurisht se do të arrihet qëllimi i këtij kompensimi, me bindje se kjo shumë për nga lartësia e saj nuk bie ndesh me qëllimin për të cilin me ligj është paraparë, pasi që si e tillë nuk mund të paraqet qëllime fitimprurëse për paditësin. Në shumën e aprovuar Gjykata Supreme paditësit i gjykoj edhe kamatën ligjore prej 8% si në dispozitiv, në kuptim të nenit 382 të LMD të Kosovës, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e jo kamatën e kërkuar nga paditësi në lartësi prej 12% nga se në këtë rast nuk bëhet fjalë për këtë kamatë të privilegjuar të cilën e njeht neni 26 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, nga se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me këtë lloj të dëmshpërblimit nga baza e këtij Ligji.

Arsyetimi

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon pjesërisht të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, duke ardhur në përfundim se aktgjykimet e sipër përmendura përveç në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë në emër të dhimbjeve shpirtërore për cenim të autoritetit dhe nderit, në pjesën tjetër nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale në të cilat gjykata e revizionit në kuptim

të nenit 215 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me ato në të cilat i autorizuari i paditësit thirret në revizion.

Me rastin e refuzimit në tërësi të kërkesëpadisë së paditësit gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale duke mos zbatuar fare nenin 170 paragrafi 1 dhe 172 paragrafi 1 të LMD të vjetër, me konstatimin se në rastin konkret e paditura nuk mban përgjegjësi fare për kompensimin e dëmit paditësit. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, përgjegjësia e paditësit për kompensimin e dëmit pa dyshim rezulton në bazë të nenit 170 dhe 172 të LMD të vjetër i cili ligj në rastin konkret zbatohet, meqë në kohën e tij paditësit i është shkaktuar dëmi kontestues dhe i cili ligj është i aplikueshëm në këtë rast në kuptim të nenit 1057 të LMD të Kosovës.

Në nenin 170 par.1 të LMD, parashihet që për dëmin të cilin punëtori në punë ose lidhur me punën i shkaktonte personit të tretë, përgjigjet organizata e punës së bashkuar ku ka punuar punëtori në momentin e shkaktimit të dëmit, përveç në qoftë se provon se punëtori në rrethanat konkrete ka vepruar ashtu si kundër është dashur. Ndërsa në nenin 172 par.1 të LMD, parashihet që personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia shkaktonte personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të veta.

Pas analizimit me kujdes të këtyre dy dispozitave ligjore, të cilat gjykata e shkallës së parë dhe e dytë fare nuk i ka zbatuar, Gjykata Supreme vjen në konkludim se në anën e të paditurës ekziston përgjegjësia ligjore për kompensimin e dëmit të shkaktuar paditësit kështu që mbi bazën e këtyre dy dispozitave ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës në pjesën e kërkesëpadisë së refuzuar në emër të dhimbjeve shpirtërore për cenimin e autoritetit dhe nderit i ndryshoi të dy aktgjykimet e lartpërmendura, pasi që në këtë pjesë e drejta materiale gabimisht është zbatuar.

Me vet faktin jo kontestues se për shkak të veprimeve të kundërligjshme të punëtorit të paditurës, paditësi në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) është vënë në listën e zezë të borxhlive dhe për pasojë emri i paditësit në këtë listë qëndron dhjetë vite dhe si shkak i saj paditësi klasifikohet si borxhli i keq për të cilën arsye asnjë bankë në Kosovë nuk i akordon-lejon kredi paditësit, siç nuk i ka lejuar kredi as banka R., në Kosovë, kjo tregon mjaftueshëm se paditësit i është cenuar autoriteti dhe nderi për asgjë tjetër, si qytetarë i thjeshtë gjithsesi, vlerë kjo personale që është e çmueshme dhe e garantuar ligjërisht dhe me nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e që për dhimbjet shpirtërore për cenimin e kësaj vlere personale me nenin 200 të LMD, parashihet kompensimi në formë të satisfacionit. Andaj, duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat e më sipërme, sidomos kohëzgjatjen e dhimbjeve shpirtërore për cenim të autoritetit dhe nderit të paditësit me faktin se për shumë vite emri i paditësit figuron në BQK, në listën e borxhlive të këqij, dhe për pasojë asnjë bankë në Kosovë atij nuk i aprovon asnjë lloj kredie, ndonëse saktësisht nuk mund të matet lartësia e këtij satisfacioni, Gjykata Supreme sipas vlerësimit të lirë në pajtim me nenin 323 të LPK, paditësit i aprovoi shumë prej 3,000.00 € me të cilën sigurisht se do të arrihet qëllimi i këtij kompensimi, me bindje se kjo shumë për nga lartësia e saj nuk bie ndesh me qëllimin për të cilin me ligj është paraparë, pasi që si e tillë nuk mund të paraqet qëllime fitimprurëse për paditësin. Në shumën e aprovuar Gjykata Supreme paditësit i gjykoi edhe kamatën ligjore prej 8% si në dispozitiv, në kuptim të nenit 382 të LMD të Kosovës, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e jo kamatën e kërkuar nga paditësi në lartësi prej 12% nga se në këtë rast nuk bëhet fjalë për këtë kamatë të privilegjuar të cilën e

njen neni 26 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia, nga se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me këtë lloj të dëmshpërblimit nga baza e këtij Ligji.

Përndryshe aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë nuk përfshihet me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore në asnjërën pjesë të tyre. Për më tepër në revizion është thënë vetëm se aktgjykimi goditet për këtë shkak, duke mos precizuar konkretisht se cilat dispozita të LPK, janë cenuar duke u zbatuar gabimisht apo duke mos u zbatuar fare, pa u sqaruar se cilat janë ato, kështu që pretendimet e tilla përkritazi me shkeljet thelbësore procedurale u refuzuan si të pabazuara.

Sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë të refuzuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, i cili është vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pretendimet e revizionit u refuzuan në tërësi si të pabazuara nga se të dy gjykatat në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme për refuzimin e kërkesave të caktuara të precizuara si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, e të cilat arsye dhe shkaqe janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit.

Pasi që në revizion i autorizuari i paditësit më tepër bënë përshkrimin e zhvillimit procedural të çështjes së tij, të cilat pretendimet si të tilla kanë të bëjnë më tepër me gjendjen faktike për të cilin shkak revizioni nuk mund të paraqitet në kuptim të nenit 214.2 të LPK, dhe për faktin se me pretendimet e revizionit nuk mund të vihen në pyetje arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë dhe e dytë, e as zbatimi i drejtë i së drejtës materiale nga ana e këtyre gjykatave, pretendimet e tilla si të përgjithshme, për arsyet e përshkruara më lart u refuzuan në tërësi si të pabazuara, ndër të tjera edhe se me të njëjtat nuk vihet në pyetje asnjëri nga aktgjykimet e sipër përmendura në aspektin material dhe procedural të tyre.

Sa i përket aprovimit të shpenzimeve të procedurës si në dispozitiv të aktgjykimit të sipër përmendur, Gjykata Supreme e Kosovës zbatoi nenin 454.1 të LPK, ku parashihet që pala ka për detyrë që, pavarësisht nga ajo se cili e ka fituar procesin gjyqësor, t'ia shpërblejë palës kundërshtare shpenzimet që i ka shkaktuar me faj të vetin ose me rastin që i ka ndodhur asaj. Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, Gjykata Supreme vlerëson se me rastin që i ka ndodh të paditurës me punëtorin e saj, palës kundërshtare këtu paditësit duhet kompensuar shpenzimet e shkaktuara, kështu që në këtë aspekt u aprovua shuma prej 1,719.00 €, të cilën e paditura detyrohet që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia kompensojë paditësit, e cila shumë përbënë, në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 €, për pagesën e taksës gjyqësore për padi 20 €, për ekspertizën e kryer nga shoqata e shkencave ligjore 500 €, ekspertizën psikiatrike 150 €, dhe për përfaqësimin në 7 seanca nga i autorizuari i tij për secilën seancë nga 135 €.

Për arsyet e dhëna më lart dhe në pajtim me nenin 222 dhe 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi Rev.nr.184/24, i datës 21.05.2024

Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi

”Me nenin 198 të LMD-së, përcaktohet se: “Kush e shkel nderin ose kush nxjerr apo përhapë thënie të rreme mbi të kaluarën mbi diturinë, mbi aftësinë e personit tjetër ose mbi ndonjë gjë

tjetër, ndërsa e di ose do të duhej ta dinte se janë të rreme, e në këtë mënyrë i shkakton dëm material ka për detyrë t'ia kompensojë atë”.

Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezultojnë se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë, sa i përket pjesës së ndryshuar me revizion, me rastin e shkakuar në incidentin e datës 21.07.2011 në fshatin G. e Ulët, për faktin se sulmi ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nënkupton cenim të nderit apo autoritetit, por nënkupton vepër penale, si pasojë e së cilës këtu paditësi ka pësuar lëndim të lehtë trupor, për çka edhe i takon e drejta për të kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial siç është gjykuar në këtë rast. Andaj në këtë rast nuk kemi të bëjmë me cenim të nderit dhe të autoritetit, ashtu siç përcaktohet me nenin 198 të LMD-së, e rrjedhimisht paditësit nuk i takon as e drejta në kompensim sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadisë.

Në këtë kontekst janë pranuar pjesërisht pretendimet sipas revizionit nga përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë dhe të dytë në përputhje me gjendjen faktike kanë aplikuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, në pjesën në të cilën është ndryshuar me anë të këtij aktgjykimi, duke i'u referuar nenit 198 dhe 200 të LMD-së.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga të paditurit nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Arsyetimi

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë, për kërkesat për të cilat është refuzuar revizioni, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa në pjesën që është ndryshuar vlerëson se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve në revizionin e paraqitur nuk është referuar si bazë për parashtrimin e revizionit shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me nenin 215 të LPK-së, me ç'rast ka gjetur se aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është të përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore (LPK-së), për pjesën e kërkesës për kompensimin e dëmit jomaterial për të cilat është refuzuar revizioni sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë

vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që të paditurit të jenë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjë në mbështetje në nenin 154, 158 dhe 192 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit të datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01 Tetor 1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë t’ia kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”, me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”, ndërsa me nenin 192 paragrafi 1, përcaktohet se: “Përcaktohet se i dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh nga sa do të ishte ka të drejtë vetëm për kompensim përpjesëtimisht të pakësuar”.

Baza juridike e kërkesëpadisë, sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë, në pjesën refuzuese të revizionit gjë në mbështetje në nenin 154 të LMD-së, për arsye se: Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e nenin 154 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t’ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në këtë rast janë plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurve, për kompensimin e dëmit, paditësit.

Baza juridike nuk ka qenë kontestuese sipas pretendimeve me revizion, prandaj kjo gjykatë në këtë pjesë sa i përket zbatimit të dispozitave materiale - juridike është e kufizuar, duke qenë se deklarimi për bazën është çështje që i referohet disponibilitetet të kërkesave, për të cilën palët mund të disponojnë lirisht në këtë rast.

Për pjesën e kërkesave për dëmin jomaterial për të cilat është refuzuar revizioni, kjo gjykatë vlerëson se në kuptim të dispozitave materiale - juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë e në përputhje me gjendjen faktike, drejt është zbatuar e drejta materiale, për arsye se në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, duke

u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarit. Mbi këtë bazë duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 200 të LMD-së, rezulton se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Në këtë rast vlerësohet se gjykata e shkallës së parë dhe të dytë kanë vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që kanë pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për të, dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave me të ulëta, me rastin e vendosjes, drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadiës rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 195 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lezoni trupor, ose ia prish shëndetin ka për detyrë t’i kompensojë shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit. Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloj dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë në kohëzgjatje prej 5 ditë dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 16 ditë, dhe të njëjtit i takon ky lloj kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe sipas pretendimeve në revizion, për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 224 paragrafi 1 të LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, prandaj duke vlerësuar se shumat e gjykuara sa i përket dhimbjeve shpirtërore në raport me cenimin e nderit dhe autoritetit nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimi, sepse në këtë rast nuk kemi të bëjmë me cenim të nderit dhe autoritetit, prandaj u vendos që sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadiës, të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, sa i përket dëmit jomaterial duke u vendosur që kjo pjesë e kërkesëpadiës të refuzohet si e pabazuar, për arsye se:

Me nenin 198 të LMD-së, përcaktohet se: “Kush e shkel nderin ose kush nxjerr apo përhapë thënie të rreme mbi të kaluarën mbi diturinë, mbi aftësinë e personit tjetër ose mbi ndonjë gjë tjetër, ndërsa e di ose do të duhej ta dinte se janë të rreme, e në këtë mënyrë i shkakton dëm material ka për detyrë t’ia kompensojë atë”.

Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezultojnë se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë, sa i përket pjesës së ndryshuar me revizion, me rastin e shkaktuar në incidentin e datës 21.07.2011 në fshatin G. e Ulët, për faktin se sulmi ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nënkupton cenim të nderit apo autoritetit, por nënkupton veprë penale, si pasojë e së cilës këtu paditësi ka pësuar lëndim të lehtë trupor, për çka edhe i takon e drejta për të kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial siç është gjykuar në këtë rast. Andaj në këtë rast nuk kemi të bëjmë me cenim të nderit dhe të autoritetit, ashtu siç përcaktohet me nenin 198 të LMD-së, e rrjedhimisht paditësit nuk i takon as e drejta në kompensim sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadisë.

Në këtë kontekst janë pranuar pjesërisht pretendimet sipas revizionit nga përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë dhe të dytë në përputhje me gjendjen faktike kanë aplikuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, në pjesën në të cilën është ndryshuar me anë të këtij aktgjykimi, duke i’u referuar nenit 198 dhe 200 të LMD-së.

Duhet theksuar se kjo gjykatë vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, në emër të dhimbjeve të përjetuara shpirtërore, për cenimin e nderit dhe autoritetit me rastin e sulmit fizik, fyerjeve dhe ofendimeve në vende publik gjatë orarit të punës, të pësuar në incidentin e datës 21.07.2011, vetëm shumë në lartësi prej 500 €, për arsye se gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e goditur sipas revizionit e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadisë, ndaj të cilit paditësi nuk ka paraqitur revizion, e nga kjo rezultojnë se kërkesa e paditësit, sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadisë ka mbetur vetëm shuma në lartë 500 €, të cilën kjo gjykatë e ka refuzuar në tërësi.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitura në revizion nga të paditurit nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të revizionit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 dhe 224 paragrafi 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktvendimi Rev.nr.297/2024, i datës 21.08.2024

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi

”Gjykata Supreme vlerëson se vendimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale nga neni 182.2, pika n), kjo pasi që dispozitivi i

aktgjykimit të shkallës së dytë dhe i shkallës së parë është i paqartë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna në lidhje me atë se çka është vendosë dhe çka ka kërkuar paditësi me kërkesëpadinë. Kjo gjykatë vlerëson se në mënyrën se si kanë vendosë gjykatat e instancës më të ulët është krijuar paqartësi në lidhje me atë se si është vendosë lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial dhe material, marrë për bazë kërkesën nga padia dhe atë të precizuar më vonë, pasi që në parashtresën për ndryshimin dhe zmadhimin e lartësisë së kërkesëpadisë është kërkuar kompensimi në emër të dëmit jomaterial për frikën, për dhimbjet shpirtërore, për humbjen e reputacionit në shoqëri dhe integritetit të tij personal dhe familjar si pasojë e publikimit të lajmeve të ndryshme në mediat e Kosovës, si dhe kompensimin në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm punues.

Në rrethana të tilla rezulton se aktgjykimet e atakuara duhet prishen dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, në mënyrë që në rivendosje nëse gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit është e paqartë atëherë atë ta kthej në plotësim apo përmirësim ose të njëjtën ta bëjë në seancë gjyqësore, varësisht nga kërkesa e paraqitur gjykata duhet që atë ta trajtoj për secilën kategori dhe formë të dëmit, duke dhënë arsye të qarta për të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me plotësimin e kushteve për kompensim të dëmit jomaterial dhe material si pasojë e privimit të kundërligjshëm të lirisë“.

Arsyetimi

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, si të drejtë dhe të ligjshëm ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 të LPK-së dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 204 të LPK-së, për çka aktgjykimet patjetër është dashur të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale nga neni 182.2, pika n), kjo pasi që dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë dhe i shkallës së parë është i paqartë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna në lidhje me atë se çka është vendosë dhe çka ka kërkuar paditësi me kërkesëpadinë. Kjo gjykatë vlerëson se në mënyrën se si kanë vendosë gjykatat e instancës më të ulët është krijuar paqartësi në lidhje me atë se si është vendosë lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial dhe material, marrë për bazë kërkesën nga padia dhe atë të precizuar më vonë, pasi që në parashtresën për ndryshimin dhe zmadhimin e lartësisë së kërkesëpadisë është kërkuar kompensimi në emër të dëmit jomaterial për frikën, për dhimbjet shpirtërore, për humbjen e reputacionit në shoqëri dhe integritetit të tij personal dhe familjar si pasojë e publikimit të lajmeve të ndryshme në mediat e Kosovës, si dhe kompensimin në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm punues.

Gjykata Supreme vlerëson se mënyra si është vlerësuar kërkesa e paditësit nga gjykatat e instancës më të ulët është në kundërshtim me dispozitat materiale, në këtë rast me dispozitën e nenit 183 paragrafi 1 të LMD-së, me të cilën është përcaktuar se: “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të

cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimi e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”. Kjo pasi që gjykatat e instancës më të ulët kërkesën e paditësit e kanë trajtuar në këtë mënyrë duke formuluar dispozitivin e aktgjykimit kësaj: “ paditësit t’ia kompensoj dëmin jomaterial në emër të vuajtjeve shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë, si dhe frikës së përjetuar si pasojë e privimit të kundërligjshëm nga liria për 120 ditë”, mirëpo siç rezultoi nga mospërputhje mes asaj që kanë vendosë gjykatat, kategorive të dëmit dhe llojeve të kërkuara nga pala paditëse.

I autorizuar i palës paditëse me parashtrësën e datës 21.01.2021 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ndërsa në fjalë përfundimtare ka mbetur pranë këtij precizimi, duke kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, për secilën kategori të dëmit, ndërsa gjykata e shkallës së parë, e as ajo e shkallës së dytë në aktgjykimet e tyre nuk kanë dhënë ndonjë arsye për këtë, mirëpo në mënyrë të përgjithësuar kanë caktuar vlera të ndryshme të kompensimit. Pra, është e paqartë se kompensimi i caktuar a është në emër të dëmit jomaterial apo material, çka është vepruar në raport me kërkesat tjera të paditësit, a janë trajtuar ato apo jo. Nga formulimi i bërë në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, rezultoi se gjykata e shkallës së parë ka trajtuar edhe kërkesën e paditësit për kompensim të dëmit material pasi që në këtë pikë është refuzuar kërkesa e paditësit në emër të dëmit material mbi shumën e gjykuar, por që as nga dispozitivi e as nga arsyetimi nuk mund të kuptohet çka është vendosë për dëmin material, pastaj gjykata e shkallës së dytë në aktgjykim – dispozitiv ka konstatuar se pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar refuzohet e pabazuar, mirëpo nuk ka përmend dëmin material ndërsa në arsyetim përmend çështjen e kompensimit të shpenzimeve të anëtarëve të familjes për vizita, që është plotësisht e paqartë se çka ka vendosë në këtë rast gjykata e shkallës së dytë. Gjithashtu në aktgjykimet e atakuara nuk ka asnjë arsye se në shumën e gjykuara a ka ndonjë ndikim çështja se paditësi ka qëndruar një periudhë në paraburgim dhe një periudhë tjetër në arrest shtëpiak dhe se a mund të trajtohen njëjtë këto periudha në aspektin e vlerësimit të lartësisë së dëmit jomaterial.

Në rrethana të tilla rezultoi se aktgjykimet e atakuara duhet prishen dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, në mënyrë që në rivendosje nëse gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit është e paqartë atëherë atë ta kthejë në plotësim apo përmirësim ose të njëjtën ta bëjë në seancë gjyqësore, varësisht nga kërkesa e paraqitur gjykata duhet që atë ta trajtojë për secilën kategori dhe formë të dëmit, duke dhënë arsye të qarta për të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me plotësimin e kushteve për kompensim të dëmit jomaterial dhe material si pasojë e privimit të kundërligjshëm të lirisë.

Kryerja e veprimeve të mësipërme, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të dalin gjatë rigjykimit, do ta lejojnë gjykatën e shkallës së parë që, në përputhje me kërkesat e ligjit procedural dhe material, të mund të arrijë në përfundime më të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes që është objekt shqyrtimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 224.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Beshir ISLAMI

3. PROCEDURË JOKONTESTIMORE -KUSHTET DHE MËNYRA E SHITJES SË BANESAVE NË PRONËSI SHOQËRORE DHE PUBLIKE

3.1 Korniza ligjore

Dispozita ligjore:

- Ligji mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 11/83, 29/86, 42/86).
- Ligji për Banimin ("Službeni glasnik RS", br. 50/92, 76/92, 84/92) me ndryshime deri në vitin 1999.
- UNMIK/REG/2000/60, datë 15 nëntor 1999 për Themelimin e Drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore
- UNMIK/REG/2000/60 Mbi Kërkesat Pronësore dhe Banesore dhe Rregullat e Procedurës dhe të provave të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore si dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, datë 31 tetor 2000
- Ligji nr. 04/l-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 01 / 12 janar 2012, Prishtinë
- Ligji nr. 08/l-011 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-247, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 10 / 22 mars 2022, Prishtinë

3.2 Banesa si përcaktim ligjor

Në përgjithësi, deri në vitin 1991, përveç ndërtimit individual, ndërtesat e dedikuara për bainim kanë qenë në pronësi shoqërore ose publike. Këto banesa janë ndërtuar nga fondi banesor i subjeteve përkatëse e më vonë nga fondi solidar i ndërtimit të banesave.

Banesa në kuptim të dispozitave të ligjeve të lartpërmendura, definohet si "një ose më tepër hapësira, të destinuara dhe të përshtatshme për banim, së bashku me hapësirat ndihmëse, të cilat sipas rregullit përbëjnë një tërësi dhe kanë hyrje të veçantë". Kjo i referohet vetëm trajtimit të banesave në pronësi shoqërore ose publike) nënkupto pronësi të subjekteve ekonomike ose të shtetit, organeve shtetërore dhe organizatave politike).

3.3 E drejta Banesore - Historiku

E drejta banesore në kuptimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 11/83, 29/86, 42/86), është një lloj servituti "Habitatio" që i njej të drejtë shfrytëzimi të shtepise së banimit të tjetrit pa e dëmtuar substancën. Si e tillë njihet që nga kohët e lashta. Shiqur nga të drejtat dhe obligimet dhe mbrojtja ligjore, që garantohet për personat fizik, e drejta e shfrytëzimit të banesave shoqërore ka qenë e drejta "e forte" e shfrytëzimit, me

garanci të forta ligjore, kohëzgjatje të pakufizuar ose reduktimit maksimal të të drejtave të pronarit. Kjo nënkupton se vetëm në kushte të caktuara me ligj dhe në rast të keqpërdorimit të shfrytëzimit të paracaktuara po me ligj, apo me një procedurë të paracaktuar ligjore, ka qenë e mundur të revokohet e drejta e shfrytëzimit e banesës shoqërore. Baza e ekzistimit të kësaj të drejte banesore është posedimi i banesës me të drejtë shfrytëzimi nga subjekti i ndarjes dhe të qiras në formë alokimi. Fillimisht e drejta banesore në shfrytëzimin e banesës ka qenë sipas kushteve të parapara mbi bazat e Ligji mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 11/83, 29/86, 42/86), neni 11 parasheh se qytetari e fiton të drejten banesore nëse atij apo asaj i është ndarë banesa, të ketë lidhë kontrate shfrytëzimi me Ndërmarrjen publike Banesore dhe të ketë hyrë në banesë. Që nga viti 1992 çështja banesore është trajtuar me Ligjin për Banimin të ish RFJ e më vonë të Serbisë ("Sluzbeni glasnik RS", br. 50/92, 76/92, 84/92) i cili këtë raport e shëndrroi në kontratë qiraje midis qiradhënësit – nënkupto pronari i banesë që e ka nda banesën personit fizik, dhe qiramarrësit, personit fizik, i cili e merr në shfrytëzim banesë mbi bazën e qirasë.

3.4 Periudha pas Qershorit 1999- Juridiksioni përjashtues

Misioni Civil i Kombeve të Bashkuara u instalua në Kosovë me Rezolutën 1244 (1999) e miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e vet të 4011-të, më 10 qershor 1999 dhe gjatë marrjes së mandatit instaloi administratën së përkohëshme në Kosovë deri me 17 Shkurt 2008 kur është shpallur pavarësia e Kosovës. Ky mision përveç qeverisjes në të gjitha aspektet, kishte obligime edhe në lëmin e strehimit dhe të mbrojtjes së pronës.

Në lëmin e banesave, u nxorren rregulloret me fuqi ligjore me të cilat parashihej zgjidhja e kontesteve pronësore e banesore. Kështu në nenin 1.2 të UNMIK/REG/1999/23 parashihet se "Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria merr dhe regjistron kategoritë e mëposhtme të kërkesve që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të dhe pas përpunimit ja referon Komisionit". Neni 2.1 UNMIK/REG/1999/23 përcakton se "Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("Komisioni") është organ i pavarur i Drejtorisë, i cili i zgjidh mosmarrëveshjet private jotregtare që kanë të bëjnë me pronën banesore të cilat ia parashtron Drejtoria. Neni 2.7 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parasheh se Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe **nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.**

Juridiksioni përjashtues (shterues) i Komisionit definohet në Rregulloren 2000/60 përmes dispozitave të nenit 3.1 që parasheh se "Asnjë kërkesë për rikthimin e pronës banesore të humbur ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe datës 24 mars 1999 si pasojë e diskriminimit nuk mund t'i parashtrohet asnjë gjyqi apo tribunali në Kosovë, me përjashtim të atyre kërkesave që janë në pajtim me Rregulloren 1999/23 të UNMIK-ut dhe Rregulloren 2000/60 të UNMIK-ut". (kriteret e nenit 1.2(a) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23). Duke u nisur nga mjetet ligjore në dispozicion të palëve dhe natyra e titujve pronësore që kanë konfirmuar vendimet e Komisionit më poshtë

do të sqarojmë përfundimet e Komisionit¹⁸ dhe shëndrrimi i tyre në tituj pronësore të ekzekutueshëm bazuar në numrin e kërkesave si: 1) *kthimin e pronës së humbur si pasojë e diskriminimit*, 2) *vertetimin e titujve pas kontratave joformale*, 3) *kthimin e posedimit dhe poashtu veprimet shoqeruese të vendimeve të komisionit si 4) administrimin e pronave të braktisura¹⁹ nga Drejtoria –Agjencia dhe 5) çështja e kompensimit të demit në përgjithësi dhe në veçanti demit të pësuar gjatë adminstrimit .*

Me Rregullorën e UNMIK-ut 2000/60 është pezulluar neni 3 i Ligjit mbi mardhënjet banesore dhe bartësit e të drejtës pronësore (dhënësit e banesave) nuk kanë mundur të disponojnë në asnjë mënyrë me banesat shoqerore pas hyrjes në fuqi të Rregullorës (nënkupto nuk kanë mundur të ndajnë apo të ndrojnë bartësit e të drejtës së shfrytëzimit). Kjo do të thotë se ka shkaktuar ngrirje të raporteve banesore në gjendjen egzistuese dhe asnjë e drejtë banesore nuk ka mundur të merret ose të rindahet nga dhënësi i banesës. Të drejtat e bartësve të drejtës së ndarjes janë reduktuar maksimalisht dhe si të tilla janë bartur tek Agjencia Kosovare e Mirbesimit-tani e Privatizimit për arsye se subjektet shoqerore janë shuar përmes privatizimit dhe likuidimit.

Duhet cekur se banesat shoqërore nuk janë marr në administrim nga kjo Agjenci sikur prona tjetër shoqërore dhe nëse kanë qenë të dhëna në shfrytëzim, nuk janë konsideruar asete të ndërmarrjeve -shoqërore - publike.

Neni 6 i Rregullorës së UNMIK-ut 2000/60 që ka të me të cilin definohet ndarja dhe shfrytëzimi i banesave shoqërore parasheh Përderisa Drejtoria e ka të drejtën ekskluzive mbi çështjet e parashtruara në paragrafin 1.2 të Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut, vlen dispozita e mëposhtme:

- a) Neni 3 i Ligjit mbi marrëdhëniet banesore pezullohet me anë të kësaj Rregulloreje;
- b) Pavarësisht nga dispozitat e çfarëdo ligji tjetër, asnjë e drejtë banimi në banesëshoqërore nuk mund të përfundojë:
 - (i) Pa pëlqimin e bartësit të së drejtës për banim ose të Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore; ose
 - (ii) Pa urdhëresën e Komisionit, siç parashtrohet me anë të kësaj Rregulloreje dhe
- c) Përkundër nenit 24 të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore, dhënia me qira e banesave

shoqërore është e lejuar në kushte të parapara me ligj.

Në kuptim të legjislacionit ekzistues dhe atij të kaluar si në nenin 103 i Ligjit 03/l-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore e definojnë posedimin si ushtrim faktik të pushtetit “*Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*”. Në Ligjin e

¹⁸ Shih Raporti Final i Punes Viti 2007 “Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore është organ i pavarur quasi-gjyqësor i themeluar nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në nëntor 1999”

¹⁹ UNMIK/REG/200/60 Neni 1-Perkufizimet “Ndërtesë banesore e braktisur” nënkupton çdo pronë, të cilën pronari apo poseduesi ligjor dhe anëtarët e familjes së tij/saj kanë pushuar ta përdorin përkohësisht ose përgjithmonë përveç mungesës së rastësishme dhe e cila është ose e zbratët ose e zënë në mënyrë joligjore

mëparshëm Jugosllav (Ligji mbi mardhënjet pronësoore juridike ("Gazeta Zyrtare SFRJ", br. 6/80 i 36/90, "Gazeta Zyrtare e RFJ", br. 29/96 i "Gazeta Zyrtare RS", br. 115/2005) neni 70 e definon se "*Posedimin e sendit e ka personi i cili ushtron drejtpërdrejtë pushtetin faktik mbi të (posedimi i drejtpërdrejtë)*". Drejtoria ka pranuar në tërësi 29.160 kërkesa të cilat i ka referuar Komisionit dhe ate të kategorisë C gjithësejtë 27.182 kërkesa ose 93.23% në esencë kanë instrumentin ligjor në këtë rregullore sepse "Çdo person me të drejtë në pronë më 24 mars 1999, i cili e ka humbur posedimin në atë pronë dhe nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta në pronë, ka të drejtë të marrë vendim nga Komisioni për riposedim të pronës". Nga këto kërkesa mbi 11.000 prona, kryesisht ndërtime individuale banesore të kërkuara, por edhe në pronësi shoqërore, është gjetur se janë shkatërruar në atë masë sa që nuk ka mundur të përdoret për banim dhe nuk ka pas aktivitet ilegal në truall. Këto janë zgjidhur në mënyrë deklarative me urdhër të Komisionit që konfirmon se në ditën shkatërrimit të pronës banesore paraqitësi i kërkesës i ka plotësuar kushtet që ti kthehet posedimi mbi pronën e kërkuar banesore por tani të shkatërruar. Pra këtu ka qenë e pamundur të urdhërohet kthimi i posedimit sepse prona e destinuar për banim ishte shkatërruar dhe komisioni ka mxjerr urdhër deklarativ konfirmues.

Kthimi i posedimit të pronave banesore të humbura si pasojë e konfliktit buron fillimisht nga Rezoluta e OKB-së 1244 ²⁰në pikën 9 nën-pika c) midis tjerash parasheh si obligim "*Krijimin e një ambienti të sigurisë në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur do të kthehen*" dhe të nenit 2.5 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/60 që parasheh se "Çdo refugjat ose person i zhvendosur, me të drejtë mbi pronën, gëzon të drejtën e kthimit të pronës ose të disponojë me të në pajtim me ligjin dhe në përputhje me këtë rregullore"²¹.

Nga praktika dhe vendimmarrja e Komisionit ishte me rendësi që të përcaktoi subjektet se kush mund të parashtrijë kërkesë? cilat kushte duhet plotësuar që paraqitësi i kërkesës për kategorinë C? kthimin e posedimit do të rezultoni të suksesshëm. Personat fizik duhej që kur paraqet kërkesë ai/ajo:

- *ka pasur të drejtë pronësore (d.m.th. të drejtën e pronësisë, të drejtën e banimit apo të drejtën e ligjshme të posedimit) mbi pronën e banimit para 24 Marsit 1999; dhe*
- *humbjen e posedimit të pronës në rrethanat e krijuara nga fushata ajrore e NATO-së; si dhe*
- *që ai apo ajo nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta e tij/saj pronësore.*

Rasti ilustrues ishte kur Komisioni e bazoi vendimin e tij në interpretimin e alineve 2.5 dhe 2.6 të rregullores 2000/60 që i garanton të drejtat e refugjatëve apo personave të zhvendosur që të heqin dorë nga të drejtat pronësore në pajtim me ligjin Pra posedimi do të ktheje përveç në rastet heqës dorë vullnetare me tjetërsim.

²⁰ Kjo rezolutë e përcakton statusin politik të Kosovë si protektorat të OKB-së, dhe jep administrimin e Kosovës po kësaj organizate ndërkombëtare.

²¹ Drejtoria e më vonë edhe Agjencia si pasardhëse kanë lëshuar mbi 15.000 Urdhra dëbimi dhe i kanë ekzekutuar forcërisht duke kthyer pronën tek titullarët e konfirmuar me vendim Komisioni

3.5 Transaksionet joformale para 24.03.1999

Me rëndësi për shitjen e bnesave sipas Ligjit në fuqi është edhe veshtrimi i trajtimit të Grupi i lëndëve të kategorisë B, të quajtura transaksione joformale²² ose 766 kërkesa apo 2.62%) janë rastet kur transaksionet e ndryshme ndërmjet personave fizik dhe subjekteve tjera të cilat përkundër vullnetit të shprehur në punë juridike nuk kanë mundur të legalizohen në gjykatë si pasojë e ligjit diskriminues që ndalonte qarkullimin midis etnive të ndryshme “Ligjit mbi kushtet e veçanta për qarkullimin e paluajtshmërive (Gazeta zyrtare e RSS 30/89, sipas ndryshimeve me ligjet e publikuara në Gazetën zyrtare të RSS nr. 42/89 dhe 22/91) ose të ndonjë ligji tjetër diskriminues qarkullimin në mes të nacionaliteteve të ndryshme apo për marrjen e pëlqimit nga Ministria e financës së Serbisë prej 23 Marsit 1989 e deri me 13 tetor 1999 bazuar në vullnetin e lirë të palëve. Edhe Ligji mbi kushtet dhe procedurat e dhënës në shfrytëzim të tokës bujqësore personave që deshrojnë të kthehen dhe të jetojnë në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, 43/91) ka qenë poashtu një ligj diskriminues në norma dhe në zbatim.

Midis ketyre kërkesave Komisioni ka pranuar edhe ato që lidhen me privatizimin e banesave para 24.03.2024 kur janë lidhur kontratat e blerjes midis dhenesit të banesës dhe shfrytëzuesit të banesës por nuk janë vërtetuar në gjykatë pa pëlqimin e Ministrisë së Financave të Serbisë. Në këtë drejtim Komisioni ka ardh në përfundim se Ligji për Banimin i Serbisë ka qenë diskriminues në zbatim sepse sipas statistikave zyrtare mbi 98% e kërkesave në të cilat Ministria nuk është përgjigjur kanë qenë të shqiptarve etnik. Prandaj Komisioni i ka legalizuar të gjitha ato kontrata ku është paguar çmimi blerës, por ka munguar vërtetimi në gjykatë, për shkak se nuk është dhënë pëlqimi nga Ministria e atëherëshme e Serbisë.

Këta persona fizik që kanë hyrë në marrdhënje kontraktuale me vetëdëshirë, në rastin e banesave me dhënësin e banesës, kanë të drejtë në urdhëresën e Drejtorisë ose të Komisionit për regjistrimin e pronësisë së vet në regjistrat përkatës publik.

3.6 Cfarë do të thotë Urdhri i Drejtorisë ose Komisionit dhe cilat kushte duhet përmbushur?

Sipas nenit 11.1 Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut, Për lëndët e kategorisë (b) të përkufizuara sipas Rregullores 1999/23 të UNMIK-ut, Drejtorja mund ta lëshojë një urdhër për regjistrimin e transaksionit jozyrtar të kërkuarit në regjistrin përkatës publik nëse:

(a) Kërkesa është e pakontestueshme dhe

(b) Drejtorja është e kënaqur se ka prova të mjaftueshme se kërkuari ka fituar të drejtën e posedimit nëpërmjet një transaksioni jozyrtar ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe 13tetor 1999²³.

²² Sipas perkufizimeve të RREGULLORES së UNMIK-ut 200/60 “Transaksion jozyrtar” nënkupton çdo transaksion të një prone të paluajtshme, i cili ka qenë joligjor në bazë të dispozitave të Ligjit të shpallur si diskriminues nga UNMIK ose diskriminues në dispozitë apo në zbatim

²³ Neni 73 i Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimeve Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 29/78 datë 30 Mars 1978 prashet se „Kontrata për lidhjen e së cilës kërkohet forma shkresore qubët e plotëfuqishme, megjithëse nuk është lidhur në këtë formë në qoftë se palët kontraktuese i kanë zbatuar ne

Këtu palët nënkuptohet se kishin kryer obligimet e kontratës siç është pagesa e çmimit dhe marrja në posedim e pronës.

Urdhëri i Drejtorisë në këtë fazë nuk është vendim ekzekutiv mbi të drejtën e pronës dhe nuk ndikon në të drejtat e cilitdo personi për t'i paraqitur Drejtorisë kundër-kërkesa të mëtejmenë afat prej 30 ditësh mbasi të jetë vënë në dijeni vendimi i Komisionit, por jo më vonë se një (1) vit nga data e vendimit të Komisionit²⁴. Palët me interes ligjore kanë mundur të paraqesin pretendimet lidhur me objektin e kërkesës, pranë Drejtorisë dhe Drejtoria të njejtat i ka referuar te Komsioni. Pasi të ketë kaluar ky afat nëse nuk ka të interesuar apo pasi të vendos Komisioni lidhur me pretendimet e reja Urdhërat e drejtorisë apo të Komisionit i janë dërguar në regjistrat publik²⁵ me obligim që ata persona fizik që e kanë blerë pronën përmes një transaksioni joformal të regjistruhen si pronarë²⁶.

Në këtë kategori janë përfshirë edhe rastet kur dhënësi i banesës shoqerore e ka shitur banesën tek bartësi i të drejtës së shfrytëzimit por formalizimi i kontratës në gjykatë është penguar sepse dispozitat e Ligjit kanë kërkuar që çdo kontratë mbi shitblerjen, qiranë dhe shitjen e patundshmërisë në Kosovë të aprovet nga Drejtorati për Çështjet e së Drejtës Pronësore në Ministrinë e Financave të Republikës së Serbisë. Ministria ka mundur të refuzoj për të aprovuar shitjen po të shqyrtonte se do të mund të ndikonte në *“strukturën nacionale të popullatës”* apo në *“emigrimin e anëtarëve të nacionalitetit të “caktuar”...* Ky ligj e kishte synim dhe qëllim të kufizoj shitjen e pronave nga Serbët e Kosovës tek Shqiptarët e Kosovës, që kishte për qëllim për t'u siguruar që numri i popullatës Serbe të mos zvogëlohet. Rreth 98% e transaksioneve të prezantuara Ministrisë së Financave raportohet të jenë refuzuar me këtë arsye²⁷.

Prandaj Komisioni i ka trajtuar përveç transaksioneve joformale të pronave për banim privat edhe privatizimin e banesave shoqerore si diskriminues sepse i njejtat ka rezultuar diskriminues në zbatim duke mohuar dhenjën e pëlqimit nga Ministria e financave të Serbisë për vërtetimin e kontratave në gjykatë. Juridiksioni ekskluziv i Komisionit del për arsye të kufuzimit kohor dhe për këtë shkak nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykatat e rregullta rastet e vendosura nga komisioni për kete kategori. Transaksioni jozyrtar (nënkupto i pa legalizuar në gjykatë) duhet të jetë kryer në periudhen kohore prej 23 mars 1989 deri me 17 tetor 1999 pra përkufuzimi kohor dhe branda kesaj pengesa e regjistrimit të pronës duhet të jetë pasojë e njerit nga ligjet Diskriminuese sipas rregullorës së UNMIK-ut 24/1999 apo ndonjë ligji i cili me dispozitat e tij apo me vetë zbatimin ka pas për qëllim diskriminimin e një grupi të caktuar personash fizik. Përfundimisht për këtë periudhe dhe llojë të kërkesave juridiksioni i Komisionit ka qenë ekskluziv (përrjashtues) **dhe nuk mund të merren rastet në shqyrtim nga Gjykatat e rregullta** dhe të formalizohen kontratat joformale mbi këtë bazë apo të ndryshohen ato vendime.

tërësi ose në pjesën predominuese detyrimet që dalin nga ajo, përveç në qoftë se nga qëllimi për të cilin është parashikuar forma është e qartë se nuk ekziston diçka tjetër”

²⁴ Shih neni 11 I Rregullorës së UNMIK-ut 2000/60

²⁵ Urdhërat janë përcjell drejtorive përkatëse të administrative në nivel komune të ngarkuara me kadra të azhurojnë titujt pronësor dhe tani ata janë të evidentuar si pronarë

²⁶ Shih memorandum i mirëkuptimit midis Agjencisë Kosovare të Kadastrit dhe Agjencisë Kosovare të pronave

²⁷ Shih raportin final i punës së Komisionit (HPCC) Prishtinë 2007 që referohet statistikave zyrtare te asaj kohe

3.7 Periudha pas shkurtit 2008- Kthimi i pjesshëm i juridiksionit tek gjykata vendore.

Konsiderohet se ky juridiksion ekskluziv i është kthyer gjykatave të rregullta në pjesën që ka të bëjë me mjetet juridike sipas Ligjit të për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore Nr. 04/L-061 i aprovuar me 21.12.2011 dhe i shpallur më datë 30.12.2011 dhe Ligji nr. 08/l-011 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-247, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 10 / 22 mars 2022, Prishtinë

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqërore dhe publike për të cilat ekziston e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pacaktuar, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës si dhe mënyra e përcaktimit të çmimit shitës të banesës dhe shuarja e së drejtës banesore. Kanë mbetur jashtë juridiksionit të gjykatave të rregullta çështja e diskriminimit dhe çështja e ndrrimit të bartësve të drejtës së shfrytëzimit ose qirasë.

3.8 Kush ka të drejtë ta blejë banesën në kushte e këtij Ligji?

Neni 7 pika 1 përcakton se "Çdo bartës i së drejtës banesore, përkatësisht shfrytëzues i banesës në pronësi shoqërore apo publike, përveç në rastet nga neni 11 i këtij ligj ka të drejtë ta blejë banesën.

Në nenin 11 parashihet se "Nga shitja, sipas dispozitave të këtij ligji, përjashtohet:

- 1.1 banesa e cila gjendet në ndërtesat ndaj të cilave është iniciuar procedura e rrënimit;
- 1.2 banesa e cila gjendet në ndërtesat administrative të cilat shfrytëzohen për ushtrimin e veprimtarisë së administratës shtetërore, gjyqësisë, shëndetësisë, si dhe ndërtesat tjera reprezentative të cilat shfrytëzohen për nevojat e institucioneve lokale dhe qendrore;
- 1.3 banesa e cila gjendet në institucionet bamirëse, respektivisht që i ka takuar institucionit bamirës dhe e cila mund ta vazhdojë edhe më tutje realizimin e qëllimeve për të cilat është themeluar, ndërtesës së ngritur ose të blerë nga mjetet e dhëna ose të mbledhura për bamirësi dhe qëllime tjera për interes publik;
- 1.4 banesa e cila shfrytëzohet për banim të pensionistëve dhe personave tjerë, në kuptim të mbrojtjes sociale.

2. Bartësit të së drejtës banesore duhet ti kompensohet në mënyrë ekuivalente.

Pra përfundimisht të drejtë për ta blerë banesën në kuptim të këtij Ligji ka vetëm bartësi i të drejtës së shfrytëzimit dhe anëtarët e familjës në kushtet e përcaktuara me Ligj

3.9 Nga kush kerkohet blerja e baneses?

Bartesi i te drejtës se shfrytëzimit, personi fizik ose anëtar i familjes së ngushtë të bartësit, duhet të paraqesë kërkesë me shkrim për blerjen e banesës.

Sa i përket kuptimit të anëtarit të familjes në kuptim të nenit 3.1.7 të Ligjit definohet se "Anëtarë të ngushtë të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës banesore - bashkëshorti, fëmijët e lindur në martesë dhe jashtë martese, të adaptuarit, thjeshtrit, njerka, adaptuesi, si dhe personat e tjerë të cilët bartësi i së drejtës banesore ka për detyrë t'i mbajë sipas ligjit, apo këta persona sipas ligjit, kanë për detyrë të ushqejnë bartësin e së drejtës banesore, e të cilët bashkëjetojnë; Kontestime ose mosmarrëveshjet eventuale në mes anëtarëve të familjes zgjidhen ose me ujdj ose në procedurë tjetër

Anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës banesore kanë të drejtë banimi në banesën e cila shitet sipas dispozitave të këtij ligji. Kur të drejtën banesore e ka fituar njeri nga bashkëshortët të cilët jetojnë në familjen e përbashkët, bartësi i së drejtës banesore është edhe bashkëshorti tjetër

Bashkëshortët mund ta blejnë bashkërisht banesën, kurse njëri nga ata vetëm me pajtim të tjetrit. Në rastet kur bashkëbanuesit janë bartës të së drejtës banesore, ata e blejnë banesën bashkërisht, secili për pjesën në të cilën është bartësi i së drejtës banesore, në qoftë se ata nuk arrijnë marrëveshje tjetër. Në rast kur një ose më shumë bashkëbanues nuk dorëzojnë kërkesë për blerjen e pjesës së tij/saj të banesës brenda afatit të paraparë në dispozitat e paragrafit 3. të nenit 7 të këtij ligji, në ato raste bashkëbanuesit tjerë fitojnë të drejtën të blejnë banesën në tërësi.

Sipas nenit 9. 5 të këtij Ligji marrëveshja në mes të anëtarëve të familjes, bëhet në formë të kontratës me shkrim dhe vërtetohet në Institucionin kompetent. Ndërsa sipas paragrafit 6 në rast të mosmarrëveshjeve, vendoset në procedurë gjyqësore se kujt i takon e drejta e blerjes.

3.10 Kërkesa për blerjen e banesës i paraqitet:

2.1 Agjencisë Kosovare për Privatizim, për banesat që bartësi i të drejtës së disponimit është në pronësi shoqërore është nen administrim te Agjencse, ka kaluar ne proces te privatizimit permes shitjes apo likuidimit,

2.2.Institucionit publik i cili e ka ndarë banesën, përkatësisht i cili është bartësi i të drejtës së disponimit të banesës, për banesat që bartësi i të drejtës së disponimit është në pronësi publike.

Neni 10.par 1 parasheh se " 1.Banesat, për të cilat është vërtetuar se shitësi i tyre është i panjohur, të drejtën e shitjes e bartë komuna në territorin e së cilës ndodhet banesa. " ndërsa par 3 parsheh se " Në rastet nga paragrafi 1. i këtij neni, bartësi i së drejtës banesore, i parashtron kërkesë për blerjen e banesës organit të autorizuar të administratës komunale në territorin e së cilës gjendet banesa." Kjo për faktin se gjatë ekzistimit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e deri në Mars të vitit 1999 shumë subjekte ekonomike kanë zhvilluar veprimtari në Kosovë dhe rrjedhimisht kanë pasur edhe prona banesore.

Kjo mbulon pjesën e dhënësve të banesave të cilët ose janë shuar ose janë dislokuar jashtë territorit të Kosovës e posaqërisht vlenë për subjektet ekonomike të cialt nuk janë regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bisneseve në Kosovë.

Rrjedhimisht nëse nuk mund të gjindet subjekti dhënës i banesës kërkesa duhet drejtuar Komunës përkatëse ku gjende prona.

3.11 Afati i paraqitjes së propozimeve

Kërkesa për blerjen e banesës, duhet të dorëzohet në afat prej dy (2) vitesh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kurse kontrata e shitjes së banesës duhet të lidhet në afat prej tre (3) muajsh, nga dita e paraqitjes së kërkesës për blerjen e banesës. Sipas nenit 2 të Ligji nr. 08/1-011 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-247, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 10 / 22 mars 2022, Prishtinë, nenit 7 të ligjit bazik, pas paragrafit 3, shtohet paragrafi i ri 3a, me tekstin si në vijim: 3a. **Ministri me vendim mund ta vazhdojë afatin e përcaktuar në paragrafin 3, të këtij neni për dy (2) herë radhazi dhe afatet e vazhduara nuk mund ta tejkalojnë dymbëdhjetë (12) muaj secili.** Ky vendim i Ministrisë ka qenë në fuqi deri më 7 Prill 2022. Ministria mund të nxjerr Vendim tjetër për zgjatjen e afatit tjetër pa pas nevojë të dërgoi në Kuvend për Miratim

Aktualisht nëse Ministria përkatëse ose Qeveria e Kosovës si propozuese nuk kërkon shtyrjen e mandatit, këto sqarime vlejné vetëm për propozimet që janë në procedurë e sipër, ndërsa deri në vazhdimin e këtij mandati, propozimet janë të pas afatshme, pasi afati ka përfunduar me 7 prill 2024.

3.12 Procedura e shitjes

Sipas termave të këtij ligji, procedura e shitjes zhvillohet me kërkesë të bartësit të të drejtës së shfrytëzimit tek bartësi i të drejtës së pronësisë e cila kërkesë mund të pranohet dhe të arrihet marrëveshja për blerësin në kushtet e këtij Ligji, dhe të noterizohet. Nëse në afati e paraparë me ligj, bartësi i së drejtës pronësore (AKP, Komuna ose subjekti prkstsë publik ose ihs shoqeorë nuk përgjigjet, procedura vazhdon pranë Gjykatës, në procedurë jo kontestimore, me kërkesë për lëshuarjën e vendimit i cili zëvendëson kontratën e shitblerëj. Në rats të kontestimit të subjekteve për pronësi dhe të frejtës shfrytëzim osde midis propozuesve, çështja duhet të zgjidhet në procedur kontestimore.

Këto sqarime kanë dhënë për fakti se pau shterur kërkesa dhe afati tek dhënësi i banesës (pronari) kërkesa është e parakohshme dhe duhet hedhet si e pa lejuart.

3.13 Kur bartësi i pronësis e aprovon kërkesën

Nëse subjekti bartësi i pronsiës e aprovon kërkesën atëherë, përllogaritet çmimi blerës në kushtet e paracaktuara me Ligjin aktual dhe lidhet kontrata e cila nënshkruhet në zyre noteriale.

Përpara nënshkrimit të kontratës duet zbatuar neni 13 Ligjit aktual

- Paragrafi 1 parasheh se "Para nënshkrimit të kontratës për shitjen e banesës, shitësi është i detyruar që të kërkojë nga Agjencia Kosovare për Prona, që të vërtetojë se a

është ushtruar ndonjë kërkesë për atë banesë në Drejtorinë për Çështje Pronësore Banesore e themeluar me rregulloren e UNMIK-ut 1999/23, dhe 2000/60, apo në Agjencinë Kosovare për Prona e themeluar me rregulloren të UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar dhe e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

- Paragrafi 2, i cili parasheh se "Nëse Agjencia Kosovare për Prona apo trashëgimtarë i saj vërteton se për banesën që është objekt i shitjes, është ushtruar kërkesë në institucione nga paragrafi 1. i këtij neni, detyrohet që shitësit t'ia dërgojë kopjen e certifikuar të vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, përkatësisht të Komisionit të Kosovës për Kërkesa Pronësore, që shitësi duhet ta respektojë.
- Paragrafi 3, parasheh se "Banesat të cilat janë objekt i konfliktit të së drejtës banesore nuk mund të shiten deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm të gjykatës apo institucionit tjetër kompetent".

Procedura sipas këtij ligji është e ndikuar direkt nga vendimet eventuale të ish Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore, dhe më vonë Komisionit Kosovarë të Kërkesave pronësore, për së paku dy arsye. E para, nëse objekt propozimi është banesa e cila është në shqyrtim në këtë komision ose është referuar në gjykatë për zgjidhje nuk mund të aprovohet propozimi deri në përfundim të mandatit. E dyta dhe shumë e rëndësishme për këtë procedurë është Vendimet e komisionit të cilat kanë konfirmuar të drejtën e shfrytëzimit para dhe me 24.03.1999, nuk mund të vihen në pyetje dhe të ndryshohet bartësi i së drejtës së shfrytëzimit përveç me vendim të Komisionit të lrtëpërmendur

3.14 Kur bartësi i pronisë nuk e aprovon kërkesën

Nëse bartësi refuzon ose nuk lidhë kontratë brenda afatit të paraparë në paragrafin 3. të këtij neni, apo edhe hesht deri në përfundim të afatit të paraparë me ligj, blerësi e fiton të drejtën që në procedurën jashtëkontestimore të kërkojë nga gjykata kompetente që të nxjerr aktvendim i cili e zëvendëson kontratën,

Gjykata zbaton procedurën jo kontestimore dhe pasi të konstatoi se janë zbatuar në përpikmeri dispozitat e Ligjit lidhur me kërkesë dhe refuzimin ose heshtjen e shitësit lidhur me kërkesën,

- Vërteton subjektin e autorizuar për propozim (duhet parë se propozuesi është bartës i së drejtës në shfrytëzim, bashkëshort ose anëtar i familjes në kuptim të nenit 3.1.7 të Ligjit
- Objektin (banesa a është me të drejtë shfrytëzimi sipas ligjit që do të thotë ka të drejtën e shfrytëzimit në kohën e pa caktuar dhe sipas nenit 11 të Ligjit mbi Mardhenjet Banesore që dë të thotë Vendimi i ndarjes, kontrata e shfrytëzimit dhe posedimi,)
- cakton sipas nevojës çmimin blerës në zbatim të formulës së paraparë në nenin 17 ndërsa në zbatim të kushteve si në nenin 18 dhe 19 të ligjit (tek ekspertiza për përllogaritjen e çmimit zbatohet në mënyrë strikte formula e llogaritjes së vlerës, vjetërsisë, lirimëve dhe pronës shoqëruese nëse ka si psh garazhe apo bodrume etj.
- adminstron provat dhe merr ktvendimit me te cilin zevendesohet kontrata mbi shiteblerjen e banesës.

Blerësi fiton të drejtën e pronësisë mbi banesën, pas zbatimit të kontratës ose të aktvendimit të gjykatës, me rastin e regjistrimit të banesës në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme. Organi Komunal i kadastrit është i obliguar ta regjistroi pronën mbi bazën e marrëveshjes noteriale të palëve ose vendimit e gjykatës pasi të jetë i formës së prerë.

Gjykata Supreme e Kosovës këtë proces e kontrollon me zbatimin të dispozitave të ligjit nr. 03/l-007 për procedurën jokontestimore, konkretisht neni 27.1 ku parasheh se " në procedurën jokontestimore në të cilën vendoset mbi çështjet statusore, banesore dhe lidhur me kompensimin për paluajtshmërinë e eksproprijuar, mund të përdoret revizioni kundër aktvendimit të shkallës së dytë që ka marrë formë të prerë, " në çështjet juridike të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni revizioni lejohet nën kushtet e caktuara me ligjin për procedurën kontestimore, po qe se me ligj nuk është paraparë ndryshe".

Nga praktika e kësaj gjykate, por edhe nga kërkesat e vazhdueshme që ka pranuar nga gjykatat dhe gjyqtarët e niveleve më të ulta, Gjykata Supreme e vlerëson me interes trajtimin e kësaj çështje.

3.15 Gjetjet e Gjykatës Supreme në praktikën gjyqësore

Përmes rasteve të mëposhtme, ju sjellim praktikën gjyqësore dhe gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës me qëllim të sqyrtimit të dhe unifikimit të praktikës në raste të ngjashme.

Blerja e filluar dhe e pa perfunduar para 24 marsit 1999.- Gjykata Supreme e Kosovës në vëshrim të praktikës gjyqësore ka gjetur se gjykata kanë vendosur në kushte të njëjta, në mënyra të ndryshme në propozimet e paraqitura gjykatave para se të hyj në fuqi Ligji nr. 04/l-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 01 / 12 janar 2012, Prishtinë. Në rastet e gjetura Gjykata kanë zbatuar -Ligji për Banimin ("Službeni glasnik RS", br. 50/92, 76/92, 84/92) me ndryshime deri në vitin 1999 i cili ka qenë jashtë aplikimit për faktin se me Rregullorën e UNMIK-ut 2000/60 është pezulluar neni 3 i Ligjit mbi mardhënjat banesore dhe bartësit e të drejtës pronësore (dhënësit e banesave) nuk kanë mundur të disponojnë në asnjë mënyrë me banesat shoqerore pas hyrjes në fuqi të Rregullorës. Në disa raste kanë njohur pronësinë në banesat ne të cilat ka pas kontratë për blerje afatgjate me këste dhe nuk janë paguar këstet, ose struktura e ndërtuar ka qenë me bashkim të punës dhe të mjeteve e që në vetë vete ngërthen kushtimisht edhe përfundimin e objektit. *Shih percaktimin e juridiksionit përjashtues.*

3.16 Pretendimet për të drejtat e fituara nga dhënesit e banesave pas 24 marsit 1999 sidomos në organe paralele apo të pasluftës

Në disa raste gjykatat në këtë procedurë kanë vlerësura kontrata e shitblerës të lidhura në kundërshtim me ligjin në fuqi si psh, lidhur me organat paralele të Ndërmarjeve publike apo vërteura tek gjykata paralele. Gjykata nuk duhet të vlerësojnë të drejtat banesor pas 24.03.1999 për faktin se kjo e është përjashtuar nga Jurisiksioni i gjykatave të rregullta sipas nenin 1.2 të UNMIK/REG/1999/23 parashihet se "Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale,

Drejtoria merr dhe regjistron kategoritë e mëposhtme të kërkesve që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të dhe pas përpunimit ja referon Komisionit". Neni 2.1 UNMIK/REG/1999/23 përcakton se "Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("Komisioni") është organ i pavarur i Drejtorisë, i cili i zgjidh mosmarrëveshjet private jotregtare që kanë të bëjnë me pronën banesore të cilat ia parashtrojnë Drejtoria. Prandaj vendimmarrja e gjykatave në këtë periudhë kohore ka qenë jashtë juridiksionit. Si të tilla në rastet shembull, Gjykata Supremë i ka prishur aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët duke sygjeruar që të caktojnë se a është vendosur çështja nga Komisioni përkatës apo është fare pa uridiksion.

3.17 Konstatimi i ekzistimit të drejtës banesore me vendim të KKPB

Rastet e gjetura më shpesh janë kur gjykatat vendosen për të drejtën e shfrytëzimit në kundërshtim me Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, që në praktikë i bie se propozuesit e kanë të aprovuar nga Komisioni kthimin e oposedimit i cili si kategori e kërkesave (c) ishin ato Kërkesa të personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore, para datës 24 Mars 1999, e që tani nuk kanë atë pronë në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht²⁸. Personat fizik duhej që kur paraqet kërkesë ai/ajo: - *ka pasur të drejtë pronësore (d.m.th. të drejtën e pronësisë, të drejtën e banimit apo të drejtën e ligjshme të posedimit) mbi pronën e banimit para 24 Marsit 1999; dhe - humbjen e posedimit të pronës në rrethanat e krijuara nga fushata ajrore e NATO-së; dhe - që ai apo ajo nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta e tij/saj pronësore.*

Prandaj me rastin e shqyrtimit të propozimeve për blerjen e banesave, propozuesit që kanë të konfirmuar të drejtën e shfrytëzimit dhe që i plëotësojnë kushtet e parapara me ligjin aktual, kanë një bazë ligjore për aprovim të propozimit. Dilema rreth juridiksionit është e qartë. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk ka kompetencë për çështjet e banesave shoqërore për faktin se banesat nuk janë asete të ndërmarrjeve shoqërore dhe nuk janë administruar nga Agjencia. Të gjitha të drejta e ndërmarrjeve kanë kaluar te Agjencia.

3.18 Praktika gjyqësore

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil. CN.nr.43/17 (pjesët nga ky aktgjykim janë dhënë me qëllim të njoftuarit me procedurën jokontestimore që zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë)

Propozuesi nga Vushtrria, përmes të autorizuarit të tij, me anë të propozimit ka kërkuar nga gjykata të nxjerr aktvendim i cili zëvendëson kontratën e shitblerjes ndaj kundërpropozuesit Qeveria e Kosovës-Ministria e Puneve të Brendshme në Prishtinë.

²⁸ [Knut Rosandhaug - Margaret Cordial](#) "Post-Conflict Property Restitution: The Approach in Kosovo and Lessons Learned for Future International Practice" Kapitulli 4: Category and Nature of Claims and Claim Intake

Kunderpropozuesja ne seance pergatitore permes te autorizuarit nga MD-Avokatura Shteterore Shefqet Hasimi ka deklaruar se e kundershtojme propozimin per blerje te baneses apo zevendesimin e kontrates mbi shiteblerjen e baneses, per faktin se kerkesa e propozuesit eshte refuzuar nga komisioni i kunderpropozueses, nga provat ne shkresat e lendes nuk konstatohet se kush eshte shfrytezues i kesaj banese, nuk konstatohet se kjo banese a eshte ne ndonje procedure kontestuese mes pretenduesve tjere lidhur me kete prone, prandaj, mbi keto dhe arsye tjera ka propozuar qe te refuzohet i pabazuar propozimi.

Në seancë dhe në fjalën përfundimtare te dorezuar me shkrim i autorizuari i propozuesit deklaroi se: Mbetem pran propozimit te parashtuar, edhe një herë theksoj se propozimi i plotësor ne tersi kushtet dhe kriteret për blerjen e banesës pasi qe i njëjti te drejtën banesore sepse ka lidhur kontratë për dhënien ne shfrytëzim te banesës si dhe kontratë për shfrytëzim te banesës me Ndërmarrjen Banesore, e qe janë kushte thelbësore për fitimin e te drejtës banesore. Me tutje i autorizuari i propozuesit deklaroi se dhënësi-pronari i banesës ka qen i obliguar qe ta njoftoj bartësin e te drejtës banesore ne afat 3 mujor nga hyrja ne fuqi e Ligjit për Shitjen e Banesave për te cilin ekziston e drejta banesore, mirëpo ne rastin konkret nuk ka vepruar konform këtij ligji, arsyeje kjo qe propozuesit ja mundëson kërkesën për blerjen e se drejtës banesore nga ana e gjykatës, po ashtu ne bazë te ekspertizës është bërë vlerësimi i banesës, andaj konsideroj se duhet prurë aktvendim me te cilin do te konstatohet se ekziston e drejta për blerjen e banesës ne favor te propozuesit konform ekspertizës e cila është pjese shkresave te lendes. Shpenzimet e procedues i kërkoj ne shume totale prej 957.58 euro.

Përfaqësuesi i kundërpropozueses nga MD-Avokatura Shteterore Nazmije Aliu ne seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare te dorezuar me shkrim deklaroi se: Mbetem ne tersi pran deklarimeve dhe propozimeve te gjertanishme, pasiqe, komisioni i kunderpropozueses me rastin e shqyrtimit te kerkeses nr. 73/14-MPB te dt: 24.01.2014, ka refuzuar kerkesen e propozuesit per blerje te baneses, dhe se me aktvendimin e leshuar nga ish Qeveria e Republikes se Serbise-Komisioni per çeshtje Banesore ne Beograd me nr. 04.nr.360-4816/97-94, dt:16.12.1997, i njejti eshte obliguar te lidhe kontrate me ish BVI-ne per banim, te cilin kusht i njejti asnjehere nuk e ka permbushur, ashtu qe, i njejti nuk i ka plotesuar kushtet ligjore per te kerkuar nxjerrjen e aktvendimi per zevendesimin e kontrates mbi shiteblerjen e baneses sipas nenit 3, pika 1.6 te Ligjit nr. 04/L-061 per Shitjen e Banesave ne te cilen ekziston e Drejta Banesore, prandaj, mbi bazen e te gjitha ketyre, propozoj qe i njejti propozim te refuzohet i pabazuar dhe mbetet ne fuqi vendimi nr. 73-14, dt: 04.03.2014. Lidhur me shpenzimet e procedues nuk eshte deklaruar.

Nuk eshte kontestues fakti qe Qeveria e Republikes se Serbise-Ministria e Puneve te Brendshme dhe ish Ndermarrja Shoqerore Banesore “Kosova” me seli ne Vushtrri kane lidhur kontrate per shiteblerje te dy banesave dhe ate baneses nr. 7, kati I-re me sip. Prej 76.24 m2 dhe baneses nr. 22, kati IV-te me sip.prej 71,96 m2 (banesa objekt propozimi),kontrata me nr. 511, dt: 31.03.1997, ku edhe eshte paguar çmimi i teresishem prej 474,240 dinare per dy banesat objekt shiteblerje.

Nuk eshte kontestues fakti qe propozuesi ka pas të drejtë të shfrytëzimit në kohë të pacaktuar.

Nuk është kontestues fakti që propozuesi nuk ka arritur të bëjë bartjen e të drejtës së pronësive në banesën objekt i propozimit dhe me kërkesën e drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 73/14, dt: 24.01.2014, ka kërkuar blerjen e banesës objekt i propozimit, mirepo e njëjta është refuzuar nga ana e kunderspropozueses me arsyetimin se mungon kontrata e vlefshme për shfrytëzimin e banesës.

Nuk është kontestues fakti që në banesën objekt i propozimit të njëjten pas luftës e ka shfrytëzuar personi i tretë Sadik Xhema, i cili me vendimin e vertetur të lëshuar nga Komisioni i Drejtorisë për Çështje Pronësore Banësore është urdheruar ta liroj banesën në fjalë.

Gjykata, mbi bazën e arsyeve të dhëna më lartë, konstatoi se është jokontestues fakti se propozuesi, ka qenë bartëse e të drejtës së shfrytëzimit ku ky fakt vërtetohet përmes aktvendimit mbi shfrytëzimin e banesës 34.nr.360-4186/97-94, dt:16.12.1997 i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Serbisë dhe nga kontrata mbi qiranë e banesës në kohë të pacaktuar e lidhur me dt: 30.12.1997, ndërmjet propozuesit dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë-Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kundër propozuesja Qeveria e Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme nuk i ka ofruar kurrfarë përgjigje me shkrim e as kontratë për shitblerje dhe ka refuzuar kërkesën pikërisht sipas saj në mungesë të një kontrate të vlefshme për ndarjen e banesës, andaj duke u mbështetur mbi këtë bazë propozuesi iu ka drejtuar gjykatës me propozim për nxjerrjen e aktvendimit që zëvendëson kontratën e shitblerjes.

Gjykata konform sugjerimeve të gjykatës së shkallës së dytë si dhe duke u bazuar në ligjin nr.04/L-061, për Shitblerjen e Banësave, konkretisht konform nenit 7 par.7 i cili nën parasheh se “Shitësi është i detyruar që në afat prej (3) muajve, nga hyrja në fuqi e ligjit, të informoj bartësin e të drejtës banësore, përkatësisht shfrytëzuesin e banesës për të drejtën e tij të përcaktuar në këtë nen”, e në rastin konkret në shkresat e lënës nuk ka dëshmi që ndonjë herë kundër propozuesi e ka njoftuar tani propozuesin për shitjen e banesës, andaj propozuesi konform dispozitës së lartcekur si pasojë e mungesës së njoftimit për shitjen e banesës nga kundërpropozuesja, ka vepruar brenda afati kur ka ushtruar kërkesë për shitblerjen e banesës me dt. 12.01.2015, e rrjedhimisht edhe e aprovoj propozimin e propozuesit si të bazuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në lidhje me lartësinë e çmimit gjykata u bazua në mendimin e ekspertit financiar dhënë me shkrim e që në ekspertizë është dhënë shuma e cila duhet të paguhet përnjëherë, pas plotësimit të kushteve ligjore si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenin 223.1 dhe 240 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore si dhe në nenin 7 pika 4 dhe 7 të Ligjit për Shitjen e Banësave në të cilat ekziston e drejta banësore.

Gjykata me rastin e vendosjes, pati parasysh edhe pretendimet e perfaqësueses së kunderspropozueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, mirepo, të njëjtat i refuzoi të pabazuara, për faktin se aktvendimi mbi dhenien në shfrytëzim dhe kontrata për shfrytëzimin

e baneses se cekur me larte e objekt i propozimit, jane tituj juridik qe e kualifikojne propozuesin si bartes te se drejtes banesore, e cila eshte konfirmuar edhe me pergjigjjen e dhene nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit dhe Agjensioni Kosovar Per Krahasim dhe Verifikim te Prones ne pergjigjjet e tyre me shkrim te dt: 28.02.2018 dhe ajo e dt; 01.03.2018, ku kane vertetuar faktin se propozuesit nga ish Qeveria e Serbise-Ministria e Puneve te Brendshme dhe Komisioni per Çeshtje Pronesore-Banesore i eshte ndare banesa objekt i ketij propozimi dhe i njejtj ka qene ne shfrytezim me qira per kohe te pacaktuar i baneses ne fjala, dhe paraqitet si bleser potencial i baneses ne fjale me kundervleren e paguar te konstatuar me ekspertize financiare.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.426/2009, datë 29.02.2021

Nga shkresat e lëndës del se me aktvendimin nr.3561 datë 12.9.1977, propozuesit i është dhënë në shfrytëzim banesa e cila gjendet në Prishtinë, në lagjen Dardania SU 1/5 në sipërfaqe të përgjithshme prej 61,43 m2. Propozuesi me BVI-në për banim dhe lokal afarist në Prishtinë ka lidhur kontratën nr.1193/8126 datë 26.9.1977 për shfrytëzimin e banesës. Më datë 4.2.1993 i është drejtuar kundërpropozuesit me kërkesë për blerjen e banesës, në bazë të së cilës ka lidhur kontratën nr.061611/93 datë 10.3.1993. Propozuesit me kontratë i është caktuar çmimi blerës në shumë prej 19.148.395 dinarë, në 480 këste mujore. Propozuesi ka paguar 76 këste, ndërsa pjesa tjetër i ka mbetur papaguar për shkak të rrethanave të krijuara në Kosovë. Me propozim ka propozuar që gjykata me marrjen e aktvendimit të zëvendëson kontratën për blerjen e banesës.

Gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se propozimi i propozuesit është i bazuar, dhe duke u bazuar në mendimin e ekspertit ka caktuar çmimin e blerjes së banesës në shumë prej 119,61 €, të cilën shumë propozuesi është obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit.

Gjykata e shkallës së dytë në tërësi ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke refuzuar ankesën e kundërpropozuesit si të pabazuar, dhe aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se tani për tani nuk mund të pranohet një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancave më të ulët, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktvendimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, të cilat janë të natyrës absolute dhe si pasojë paraqesin bazën për prishjen e aktvendimit të gjykatave të instancave më të ulët.

Shkeljet thelbësore të procedurës kontestimore qëndrojnë në faktin se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë për caktimin e çmimit për blerjen e banesës është bazuar në mendimin e ekspertit financiar, i cili llogaritjen e çmimit kontraktues e ka bërë mbi bazën e çmimit të vërtetuar me kontratën e theksuar, ndërsa nuk ka marrë për bazë nenin 5 të Kontratës mbi blerjen e banesës, e lidhur në mes ish PTT dhe propozuesit, në të cilën është paraparë që kushtet e ndërruara të mënyrës së pagesës do të përcaktohen sipas ditës në të cilën kanë veçjt kushtet në ditën e

ushtrimit të kërkesës për ndërrimin e mënyrës së pagesës, dhe kushtet e ndërrimit do të përcaktoheshin me lidhjen e një aneks kontrate. Ngase, gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë marrë për bazë përmbajtjen e dokumenteve – kontratës për shitblerjen e banesës, kushtet përcaktuara në kontratë, si prova relevante për gjykimin e drejtë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se janë të bazuara pretendimet e revizionit se aktvendimi i kundërshtuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e cekura, të angazhojë ekspertin e lëmisë përkatëse i cili mendimin e tij do ta bazojë në bazë të gjitha provave ekzistuese në lëndë, kushtet e parapara me rastin e lidhjes së kontratës për shitblerje, dhe mbi bazën e përlllogaritjes së revalorizimit, kamatës dhe konvertimeve përkatëse, mbi gjendjen e datës së ushtrimit të kërkesës për ndërrimin e mënyrës së kërkesës, duke pasur parasysh edhe thëniet tjera të revizionit, të marrë një vendim të ligjshëm.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr. 355/2019, datë 18.11.2019

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi në propozimin e datës 14.07.2014, ka kërkuar nga gjykata që të merr aktvendim i cili do ta zëvendëson kontratën mbi blerjen e banesës, e përshkruar si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar, e cila banesë i është dhënë në shfrytëzim me qira propozuesit, respektivisht paraardhësit të tij, i ndjeri babai i propozuesit, në bazë të Aktvendimit të Komunës së Prizrenit nr.04/4-360-85-19 të datës 14.11.1980, respektivisht në bazë të kontratës mbi dhënie në shfrytëzim me nr.1469 e datës 24.08.1981, duke theksuar se kundër pozuesja në afat ligjor nuk iu është mundësuar që të vërtetohet çmimi i blerjes së banesës, e as lidhja e kontratës mbi shitblerjen e banesës.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit ka vërtetuar se në mes të palëve nuk është kontestuese fakti se propozuesi është bartës i së drejtës së banimit në banesën lëndore, ndërsa kundër propozuesi në këtë rast Komuna e Prizrenit është bartëse e të drejtës së disponimit mbi të njëjtën, bazuar në vendim-kontratën mbi dhënie në shfrytëzim të banesës familjare nr.1469 të datës 24.08.1981 dhe se propozuesi ka parashtruar kërkesën për blerjen e banesës së kundër propozuesit dhe atë në afat ligjor ku kundër propozuesi i është përgjigjur propozuesit se i njëjti mund ti drejtohet gjykatës themelore për realizimin e të drejtës së tij lidhur me blerjen e banesës. Lartësinë e çmimit të banesës lëndore gjykata e ka vërtetuar në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë dhe vlerësues Liman Mustafa nga Prizreni e datës 07.03.2016, i cili duke vepruar sipas dispozitave të neneve 16, 17 dhe 18 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore Nr.04/L-061, ka bërë vlerësimin e çmimit kontraktues dhe të blerjes së banesës në fjalë e cila gjendet në Prizren në "Lakuriqi verior", rr "Sami Koka" F/1-44, e në sipërfaqe të tërësishme prej 40.00m², e që sipas llogaritjes së çmimit nga ana e tij, çmimi kontraktues i banesës është në shumë të përgjithshme prej 400 euro. Gjykata ia ka falur besimin e plotë kësaj ekspertize ngase sipas vlerësimit të saj është punuar në mënyrë profesionale me shpjegime të mjaftueshme për të vërtetuar çmimin e banesës lëndore. Andaj gjykata e shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes është bazuar në

dispozitat e neneve 9.3, 16, 17, 18, 20 dhe 21 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore Nr.04/L-061. Në bazë administrimit të provave ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, duke ia aprovuar propozimin propozuesit, e si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimimit në tersi e ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, andaj ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e kundër propozueses. Gjykata Supreme e Kosovës, dike u nisur nga gjendja e këtillë e çështjes ka gjetur ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e të paditurit. Aktgjykimi i goditur në këtë pjesë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare. Në arsyetimin e aktgjykimit të goditur janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejt të kësaj çështjeje juridike të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë. Parashtrimet në revizion nuk e vejnë në pyetje ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të cilat kishin me kontestuar ligjshmërinë e aktgjykimit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ashtu si pa bazë theksohet në revizion. Gjykata Supreme nuk e ka pranuar pretendimin në revizion

Kjo Gjykatë nuk i mori për bazat pretendimet e ngritura në revizion përkitazi me shumën e gjykuar në emër të kompensimit për blerjen e banesës në shumë prej 400.00 €, të vërtetuar nga eksperti vlerësues Liman Mustafa nga Prizreni i datës 07.03.2016, e që është kundërshtuar në tërësi sa i përket vlerësimit me pretendim se shumta e vlerësuar është shumë e ulët dhe se ky vlerësim nuk është në harmoni me dispozitat ligjore pasi që një vlerësim i tillë nuk përkon me gjendjen reale dhe të çmimit në atë zonë sepse banesa në fjalë gjendet në qytet dhe çmimi është më i lartë se sa është përcaktuar nga ana e ekspertit vlerësues, pasi që kjo pjesë e qytetit është pjesë e urbanizuar dhe e rregulluar me plan të detajuar urbanistik dhe me infrastrukturë dhe se në rast konkret vlerësimi i banesës kontestuese është dashur të bëhet në bazë të Rregullores për aplikimin e tatimit mbi pronën e paluajtshme në Komunën e Prizrenit me nr. 01/011-219796, e cila është aprovuar nga e paditura, ku janë caktuar çmimet e tregut për të gjitha zonat tatimore. Me marrjen e provës me super ekspertizë do të caktohej çmimi dhe vlera reale e banesës kontestuese. Pretendimet e këtilla nga kjo Gjykatë u refuzuan si të pabazuara për arsye se ndërsa lartësinë e çmimit të banesës e ka vërtetuar me ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë dhe vlerësues Liman Mustafa, ku çmimi i përgjithshëm i banesës lëndore është përcaktuar në shumë prej 400 euro, ku këtë ekspertizë edhe kjo gjykatë e vlerëson se është punuar në mënyrë profesionale me shpjegime të mjaftueshme për të vërtetuar çmimin e banesës lëndore, sipas Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore Nr.04/L-061. Kundër propozuesja në seancën e mbajtur më 03.05.2016, nuk e ka kundërshtuar propozimin e propozuesit për blerjen e banesës por vetëm raportin e ekspertit vlerësues, mirëpo nuk ka bërë propozim që të caktohet eksperti tjetër vlerësues për të vërtetuar çmimin real të kësaj banese ashtu si pohon në revizion kështu që për lëshimet e veta nuk mund ta fajësoj gjykatën pasi që vetë kundër propozuesja ka propozuar që gjykata të vendos në bazë të diskreditonit të saj sipas ligjit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme nuk qëndron pretendimi e ngritura në revizion se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika (n) dhe përmban mangësi për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet. Aktvendimi i goditur nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, aktvendimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të duhura, për provat e administruara dhe për besueshmërinë e tyre.

Prandaj, referuar shkaqeve të paraqitjes së revizionit Gjykata Supreme çmon se nuk rezultojnë shkaqe të tilla që e bëjnë aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë të cenueshëm, pasi që aktvendimi është marrë me respektim të ligjit procedural dhe material dhe si i tillë është i ligjshëm.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.145/2020 datë 12 maj 2020

Nga shkresat e lëndës del se propozuesja M. Sh. ka paraqitur propozim për blerjen e banesës, në pronësi shoqërore e cila gjendet në Kaçanik në rrugën “ ... , me sipërfaqe prej 56.98m². Pronari i banesës, Komuna e Kaçanikut me vendimin e vet 01-... ka refuzuar kërkesën dhe e ka udhëzuar palën në procedurë jokontestimore në gjykatën kompetente. M. Sh., përmes të autorizuarit i kishte paraqitur propozim Gjykatës kompetente me të cilin kishte kërkuar që përmes aktvendimit i cili e zëvendëson kontratën e shitblerjes ti njihej e drejta e blerjes së banesës pas refuzimit të kësaj të drejte nga ana e Komunës së Kaçanikut. Gjykata kishte zhvilluar procedurë dhe kundërpropozuesja, Komuna e Kaçanikut e kishte kundërshtuar prapë propozimin me arsyetimin se kontrata e shitblerjes e prezantuar nga propozuesja nuk është gjetur në arkivat e Gjykatës në Ferizaj. Pas shqyrtimit të provave, midis tjerash edhe të Vendimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore e Banesore HPCC/D/113/2004/C datë 16 Prill 2004 që i referohet Kërkesës DS201041, Vendimit të ndarjes së banesës nr. ... të datës 1 Mars 1994 dhe kontratës së qirasë të lidhur në mes të propozueses dhe Komunës së Kaçanikut-Fondit për rregullimin e tokës ndërtimore dhe rrugëve, nr ... datë 17 Prill 1995 dhe duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë mbi bazën e provave dhe deklarimeve të palëve, gjeti se ndarja e banesës shfrytëzuesit aktual, Z. Sh. nga..., me aktvendimin 02 Nr..., të datës 5 Korrik 1990 është e ligjshme dhe për këtë arsye refuzoi si të pabazuar propozimin e propozuesës si në dispozitivin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurë ankimore aprovoi në tërësi si të bazuara në ligj qëndrimet e Gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se aktvendimi nuk përmban shkelje të pretenduara dhe ka mjaftueshëm arsyetim adekuat për vendimin e marr nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata Supreme i vlerësoi si të bazuara thëniet e paditëses në revizion për shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2.n, të LPK-së, kjo nga se të dy aktvendimet e përmendura nuk kanë dhënë arsye për faktet vendimtare të rëndësishme për gjykim të drejtë në këtë çështje juridike të cilat kanë të bëjnë me atë se nuk është sqaruar se cilat janë implikimet e Vendimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore , çfarë është vlefshmëria e të

drejtës së shfrytëzimit të banesës dhe konfirmimit të së drejtës së shfrytëzimit të banesës me këtë vendim, arsyet për mospjesëmarrje të personit tjetër, Z. Sh..., nga Kaçaniku, si shfrytëzues aktual i banesës lëndore, në procedurën para Komisionit dhe pse ky person nuk e ka kundërshtuar kërkesën e propozuesës. Mungesa e dhënies së arsyeve për këto fakte me relevancë juridike bënë që arsyetimi i këtyre aktvendimeve të jetë i mangët ndërsa si pasojë e kësaj shkelje procedurale, tani për tani është herët të flitet për zbatim të drejtë të së drejtës materiale.

Gjykata është marrë me validitetin e kontratës së shitblerjes, e në rastin konkret është jo relevante sepse po të ishte e vlefshme kontrata e shitblerjes, nuk do të zhvillohej procedura para gjykatës për vërtetim të drejtës së pronësisë. Gjykata nuk ka marrë në shqyrtim Vendimin e Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banësore të themeluar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK. Prandaj është dashur të sqaroi se cilat janë implikimet e vendimit të këtij Komisioni, duke u bazuar në juridiksionin ekskluziv të organeve të formuara nga UNMIK lidhur me banesat. (Shih 2.1 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 i cili definon se "Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banësore ("Komisioni") është organ i pavarur i Drejtorisë, i cili i zgjidh mosmarrëveshjet private jo tregtare që kanë të bëjnë me pronën banësore të cilat ia parashtron Drejtoria).

Nëse kemi në konsiderim faktin se me Vendimin e Komisionit të Kërkesave Pronësore e Banësore HPCC/D/113/2004/C datë 16 Prill 2004 që i referohet Kërkesës DS201041 është konstatuar se propozuesja ka pas posedim të ligjshëm dhe se është urdhëruar kthimi i posedimit, atëherë Gjykata është dashur të vërtetojë faktin e të drejtës së shfrytëzimit të banesës në momentin e humbjes së posedimit. Kjo për arsye se me përkufizimet e nenit 1.2 nën-pika c e Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parashihet se "Kërkesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banësore para datës 24 Mars 1999, e që tani nuk kanë atë pronë në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht, bien në kompetencë të Komisionit.

Po ashtu ka paqartësi rreth pjesëmarrjes në procedurë në Drejtorinë Banësore kur thuhet se kur propozuesja ka paraqit kërkesë në Drejtoriatin për Çështje Pronësore dhe Banësore askush nuk është përgjigjur në kërkesë, ndërsa në shkresat e lëndës del se dhënësi i banesës i ka lejuar të shfrytëzojë banesën lëndore Z. Sh. nga Kaçaniku. Prandaj është e pa qartë se si ka mundësi që banesa është në shfrytëzim të banuesit aktual dhe nuk janë shfrytëzuar mjetet ligjore në deponimin e palës dhe pjesëmarrja në procedurë. Qëndrimi i Gjykatës së revizionit është se pavarësisht se a është e paligjshme kontrata e shitblerjes, kjo nuk e bën vetvetiu të paligjshme të drejtën e shfrytëzimit të propozueses. Propozuesja ka respektuar procedurën sipas nenit 7 të Ligjit nr. 04/l-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banësore dhe me asnjë provë nuk është kontestuar e drejta e shfrytëzimit dhe nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme se pse është refuzuar propozimi i propozueses.

Gjykata e shkallës së parë fare nuk e ka shqyrtuar ligjshmërinë e të drejtës së shfrytëzimit të banesës e cila është esenciale për lejimin e shitjes sipas Ligjit për shitjen e banesave, pra kusht për të blerë një banesë shoqërore është ekzistimi i ligjshëm i të drejtës së shfrytëzimit mbi bazën e të drejtës banësore ose qirasë.

Prandaj në procedurën e përsëritur, Gjykata Themelore duhet të deklarohet rreth vlefshmërisë së të drejtës së shfrytëzimit së banesës, konfirmimit të drejtës së posedimit me Vendimin HPCC/D/113/2004/C datë 16 Prill 2004 që i referohet Kërkesës DS201041, arsyet e mospjesëmarrjes në procedurën para komisionit-përse nuk e kanë kundërshtuar kërkesën e M. Sh. as Komuna e Kaçanikut e as shfrytëzuesi momental Z. Sh. Mbi këto baza pasi të merr në konsiderim gjetjet e Gjykatës Supreme, të vendos meritorisht lidhur me propozimin.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.357/2024

Nga shkresat e lëndës, rrjedh se propozuesi, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 09.03.2016, ka ushtruar propozim për nxjerrjen e aktvendimit me të cilin e zëvendëson kontratën mbi shitblerjen e banesës dy dhomash, nr. 21, kati i IV-të, llamella 3, me sipërfaqe të përgjithshme prej 64,70 m², në lagjen "Dardania" në Prishtinë, ndaj kundër propozueses Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë.

Kundër propozuesja, Komuna e Prishtinës, është palë përgjegjëse, sipas nenit 10 paragrafi 1. të Ligjit për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore nr. 04/L-061, ku parashihet se për banesat, për të cilat është vërtetuar se shitësi i tyre është i panjohur, të drejtën e shitjes e bartë komuna në territorin e së cilës ndodhet banesa. Në përgjigjen me shkrim, të ushtruar ndaj propozimit të propozueses të njëjtin e ka kundërshtuar në parim, me arsyetimin se propozuesi ka lidhë kontratë me ish Drejtorinë Regjionale për Zhvillim të Republikës së Serbisë por të njëjtin nuk ia ka bashkangjitur si provë propozimit.

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të përgjigjes në propozim, shqyrtimit të shkresave të lëndës, jashtë shqyrtimit gjyqësor, ka nxjerr aktvendimin e ankimuar, duke e refuzuar në tërësi propozimin e propozuesit si të pabazuar. Në arsyetimin e saj lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë, ka deklaruar se me rastin e vendosjes nuk ia fali besimin vendimit mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim nr. 168/6, të dadës 15.03.1999, i lëshuar nga Drejtoria Regjionale e Serbisë në bazë të cilit propozuesi pretendon se janë përmbushë kushtet ligjore për blerjen e banesës, ngase vërtetohet dhe është fakt notor se nga vendimi i lëshuar nga Komisioni i Kërkesave Pronësore e Banesore HPCC/D/164/2004/C, i datës 09.12.2004, kërkesa e propozuesit është hedhur poshtë, dhe gjithashtu marrë për bazë edhe faktin se propozuesi në kërkesën e tij ka pranuar faktin se i njëjti asnjëherë nuk ka qenë në posedim të banesës lëndore objekt i propozimit.

Lidhur me bazën ligjore, për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 7 par.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore nr. 04/L-061, si dhe nenit 399 par.1 të LPK-së, dhe mbi bazën e gjendjes së vërtetuar del se propozimi i propozuesit është i pathemeltë, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës është vendosur në bazë të nenit 29, par.3 të Ligjit për Procedurë Jokontestimore.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimit në tërësi e ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, andaj ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e kundër propozueses.

Gjykata e shkallës së dytë, kishte gjetur se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, me vendosje të drejtë dhe ligjshme, ka vepruar drejtë, kur propozimin e propozuesit e ka refuzuar si të pa bazuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës, pas përgjigjes në propozim nga kundër propozuesja, ka rezultuar se propozuesi Budimir Gjorgjeviç me datën 16.03.1999, kishte lidhë kontratë mbi ndarjen e banesës sipas vendimit nr. 168/6, të datës 15.03.1999 të Drejtorisë Regjionale për Zhvillim të Republikës së Serbisë, mirëpo, nga vendimi i lëshuar nga Komisioni i Kërkesave Pronësore e Banesore, HPCC/D/2004/C, i datës 09.12.2004, respektivisht pika 9 e këtij vendimi, konstatohet se propozuesi asnjëherë nuk e ka marrë apo pas të drejtën e posedimit në banesën lëndore, dhe këtë fakt e ka pranuar edhe propozuesi në procedurën e udhëhequr tek Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore, dhe të njëjtit edhe përkundër faktit se ka prezantuar vendime valide mbi ndarjen e banesës lëndore, propozuesi nuk ka arritur të dëshmojë faktin se në banesën lëndore ka pas të drejtën e posedimit, apo se ha hyrë ndonjëherë në posedim të saj, dhe mbi këtë bazë kërkesa e të njëjtit pranë agjencisë është refuzuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e këtille e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e propozuesit. Aktvendimi i goditur në këtë pjesë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare. Në arsyetimin e aktvendimit të goditur janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë. Parashtrimet në revizion nuk e vejnë në pyetje ligjshmërinë e aktvendimit të goditur.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate aktvendimi i goditur nuk përmban të meta të cilat kishin me kontestuar ligjshmërinë e aktvendimit, lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ashtu si pa bazë theksohet në revizion. Ligji i zbatueshmen në rastin konkret është Ligji Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore. Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqërore dhe publike për të cilat ekziston e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pacaktuar, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës si dhe mënyra e përcaktimit të çmimit shitës të banesës dhe shuarja e së drejtës banesore. Sipas neni 7 paragrafit 1 "Çdo bartës i së drejtës banesore, përkatësisht shfrytëzues i banesës në pronësi shoqërore apo publike, përveç në rastet nga neni 11 i këtij ligji, duhet të paraqesë kërkesë me shkrim për blerjen e banesës.

Në rastin konkret gjykata e instancës më të ulët drejtë kanë konstatuar se paraqitësi i propozimit nuk i plotëson kriteret e bartësit të së drejtës së shfrytëzimit të banesës shoqërore dhe prandaj duhet refuzuar propozimi për blerjen e banesës, në pronësi shoqërore. Vendimarrja e gjykatës së shkallës së parë është e drejtë bazuar në juridiksionin përjashtues të Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore të themeluar nga UNMIK –ut . Neni 1.2 i UNMIK/REG/1999/23, ku parasheh se "Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria merr dhe regjistron kategoritë e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të dhe pas përpunimit ja referon Komisionit. Ndërsa neni 2.1 UNMIK/REG/1999/23 përcakton se "Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("Komisioni") është organ i pavarur

I Drejtorisë, i cili i zgjidh mosmarrëveshjet private jo tregtare që kanë të bëjnë me pronën banesore të cilat ia parashtron Drejtoria. Në rastin konkret që lidhet me propozimin sidomos Komisioni ka vendosur për kërkesat e kategorisë c) e që kanë të bëjnë me persona fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit të pronën banesore para datës 24 Mars 1999, e që tani nuk kanë atë pronë në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht. Ky komision ka nxjerr Vendimin e vet HPCC/D/2004/C, të datës 09.12.2004, dhe në paragrafin 9 të këtij vendimi lidhur me kërkesën DS308576, të paraqitur nga propozuesi, thuhet se Budimir Gjorgjeviq, nuk ka qenë në posedim të kësaj banese dhe nuk i ka plotësuar kushte për kthimin e posedimit. Ky vendim, për sa i përket posedimit, para datës 24.03.1999, është i formës së prerë dhe sipas nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, "Vendimet përfundimtare të Komisionit të Kërkesave Pronësore Banesore, janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë".

Prandaj edhe Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se, duke ju referuar kësaj Rregulloreje dhe përkufizimit të Ligjit të atëhershëm në fuqi, personat fizik do të duhej ta kishin të drejtën e shfrytëzimit të banesës mbi bazën e Ligji mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 11/83, 29/86, 42/86), konkretisht sipas neni 11, të këtij Ligji ku parashihet se "qytetari e fiton të drejtën banesore nëse atij apo asaj i është ndarë banesa, të ketë lidhë kontrate shfrytëzimi me ndërmarrjen publike banesore dhe të ketë hyrë në banesë". Prandaj personat e cilët nuk e kanë pas një të drejtë banesore, nuk kanë të drejtën e blerjes së banesave shoqërore.

Përfundimisht, Gjykata Supreme e Kosovës, referuar pretendimeve të revizionit, çmon se nuk rezultojnë shkaqe të tilla që e bëjnë aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë të cenusshëm, pasi që aktvendimi është marrë me respektim të ligjit procedural dhe material dhe si i tillë është i ligjshëm. Me rastin e shqyrtimit të rregullsisë dhe ligjshmërisë së aktvendimit të goditur, kjo Gjykatë pati parasysh të gjitha pretendimet në revizionin, të cilat u treguan si të pa suksesshme dhe pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështjeje kontestuese.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev..nr.283/2021 datë 11.10.2022

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja në gjykatën e shkallës së parë më datën 30.09.2005, ka paraqitur padi ndaj të paditurve për lirimim e banesës. Gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësueses të autorizuar, ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie të punës te e paditura e parë në vendin e punës mjeke specialiste e Medicinës së Punës. Ashtu që paditëses nga baza e marrëdhënies së punës, e paditura e parë ia ka ndarë në shfrytëzim banesën katër dhomshe, e cila gjendet në Prishtinë, Rruga "Sremit", Lamella III, Hyrja IV, Kati 2, nr.3, në sipërfaqe prej 91,15 m². Në kohën kur i është ndarë në shfrytëzim banesa paditëses, kjo banesë ka qenë pronë e të paditurës së parë, nga baza e investimit të mjeteve për ndërtim sipas kontratës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë. Gjithashtu ka theksuar se paditësja e ka paguar çmimin kontraktues të banesës të paditurës së parë, në bazë të kontratës së shitblerjes, e cila kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me VR.nr. 672/99 e datës 09.03.1999. Paditësja konsideron se ajo e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të banesës në kohën

kur e ka lidhur kontratën me të paditurën e parë dhe ka shtuar se në banesë është vendosur i padituri i dytë në bazë të një kontrate të lidhur me të paditurën e parë. Padihtësia konsideron se dhënia e banesës kontestuese të paditurit të dytë nga e paditura e parë është bërë në kundërshtim me ligjin dhe se i padituri i dytë atë e shfrytëzon pa kurrfarë baze ligjore sepse sipas saj kontrata për shfrytëzimin e banesës, e lidhur me të paditurën e parë nuk ka vlerë juridike, prandaj i ka propozuar gjykatës që të vërtetoj se padihtësia është shfrytëzuese e banesës kontestuese dhe që ti detyroj të paditurit që padihtëses t'ia lirojnë banesën lëndore nga njerëzit dhe sendet, po ashtu të njëjtën, t'ia dorëzojnë në shfrytëzim. Pasi që sipas padihtëses e njëjta ka pas 25 vite, përvojë pune tek e paditura e parë, ashtu që në bazë të Ligjit mbi banim dhe Statutit, të paditurës së parë, si akt nënligjor, me vendimin nr. 1743 të datës 04.10.1994, padihtëses i është ndarë banesa kontestuese, siç shihet nga shkresat e lëndës dhe nga të cilat mund të vërtetohet se e paditura e parë, e ka bërë pagesën e pjesës së fundit të banesës ndaj BVI-së në Prishtinë, dhe atë në shumën prej 80,389.80 dinarë, me të cilën dëshmohet që banesa e blerë është paguar në tërësi nga e paditura e parë, nga kjo rezulton që padihtësia banesën e ka marrë në mënyrë legjitime nga e paditura e parë, është e vërtetë se padihtësia nuk ka hy në posedim të banesës por ajo nga shkaqet objektive, gjendjes së pasluftës nuk ka mundur të hyj në posedim edhe pse e njëjta ka tentuar të hyjë në banesë por është penguar nga uzurpuesit. Më tej ka shtuar se secili akt i të paditurës së parë pas marrjes së Vendimit nr. 1743 të datës 04.10.1994, lidhur me banesën kontestuese është i kundërligjshëm dhe pa bazë, ngase padihtësia këtë Vendim e ka marrë duke u respektuar të gjitha procedurat ligjore. Ashtu që veprimet e ndërmarra nga e paditura e parë dhe i paditurit i dytë siç është lidhja e Kontratës mbi qiranë, mbi bashkëpronësinë në banesë dhe participimi i pagesës, janë në kundërshtim me vendimin e ndarjes së banesës padihtëses. Me propozim për gjykatën, që të vërtetohet që padihtësia e ka të drejtën e shfrytëzimit të banesës lëndore dhe të obligohen të paditurat që të njëjtën të ia lirojnë padihtëses nga njerëzit dhe sendet. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallë së parë e ka aprovuar kërkesëpandinë e padihtëses si të bazuar ku ndër të tjera ka theksuar se: Rrjedhimisht, meqenëse padihtësia e ka të lidhur kontratën për blerjen e banesës kontestuese ajo sipas dispozitës së cituar përfaqëson bazën për fitimin e të drejtës së pronësisë në banesë prandaj asaj mbi këtë bazë i takon edhe e drejta që ta marrë në posedim banesën kontestuese. Kjo edhe për faktin sepse i padituri i dytë nuk ka arrit që të dëshmon nëse në banesën kontestuese ka fituar të drejta pronësore në bazë të dispozitave ligjore.

Gjykata i vlerësoj edhe kundërshtimet e të paditurve me të cilat kontestohet vlefshmëria e aktvendimit me të cilin banesa kontestuese i është ndarë padihtëses dhe vlefshmëria e kontratës për blerjen e banesës dhe konstatohet se këto veprime juridike nuk janë marrë në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Banimin i cili ka qenë në fuqi në kohën kur janë marrë ato.

Banesa në pronësi shoqërore ka mund të jepet në shfrytëzim vetëm në bazë të kontratës mbi qiranë e cila është dashtë të lidhet në formë të shkruar prandaj në rastin konkret nuk është dëshmuar nëse padihtësia ka pasur të lidhur kontratë në formë të shkruar me të paditurën e parë për dhënie e banesës kontestuese në shfrytëzim rezulton se asaj banesa kontestuese nuk i është ndarë në formën e paraparë me ligj.

Gjykata, erdhi në përfundim, se nga provat e administruara është vërtetuar se kontrata për blerjen e banesës kontestuese është lidh vetëm në bazë të kontratës për ndërtimin e banesës e cila si e

tillë nuk ka përfaqësuar bazë të mjaftueshme juridike për lidhjen e kontratës për blerje, mirëpo sipas vlerësimit të gjykatës pa marrë parasysh këto fakte për deri sa, vendimi Nr.1793 i datës 04.10.1994 është në fuqi dhe kontrata për blerjen e banesës kontestuese e lidhur në mes të paditurës së parë dhe paditëses të jetë në fuqi, këto janë prova të mjaftueshme që i japin të drejtë paditëses që ta kërkoj dorëzimin e banesës lëndore, në kushtet e parapara me ligj, prandaj për këtë arsye gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditëses, që ka të bëjë me njohjen e të drejtës së shfrytëzimit dhe dorëzimin-lirimin e banesës lëndore nga njerëzit dhe sendet.

Sa i përket vendosjes për të drejtën materiale, gjykata u bazua në nenin 17 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, me të cilën njihet e drejta e shfrytëzimit të pasurisë ose të drejtës jopersonale, që nënkupton përdorimin e frutave të pasurisë dhe të drejtave jopersonale dhe përfitimeve të tjera të parapara për përdorimin e këtyre pasurive dhe të drejtave jo personale në raport me nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore, pasi që të drejtën e shfrytëzimit paditësja e ka fituar me veprime juridike nga ana e të paditurës së parë, respektivisht me lëshimin e vendimit Nr.1793, i datës 04.10.1994, dhe i cili vendim nuk është kontestuar asnjëherë nga askush në asnjë procedurë apo nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural nga ana e të paditurës së parë për shfuqizimin e të njëjtit, andaj i njëjti prodhon efekt juridik.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin Ac.nr.546/2019, të datës 24.09.2020, i ka refuzuar si të pa themelta ankesat e të paditurve, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes, ka vlerësuar aktgjykimin e goditur dhe ka gjetur se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Me vlerësim të drejtë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike relevante për marrjen e vendimit të drejtë e të ligjshëm në këtë kontest, pasi që në rastin konkret është vërtetuar se paditësja ka vendimin nr.1793 i dr. 04.10.1994, dhe i njëjti është në fuqi pasi që ky vendim nuk është kontestuar asnjëherë nga askush në asnjë procedurë përkatësisht nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural nga ana e të paditurës së parë për shfuqizimin e të njëjtit, andaj edhe sipas kësaj gjykate i njëjti prodhon efekt juridik dhe njëherit është në fuqi edhe kontrata për blerjen e banesës kontestuese e lidhur në mes të paditurës së parë dhe paditëses. Prandaj, edhe kjo gjykatë vlerëson se për deri sa këto vendime janë në fuqi këto janë prova të mjaftueshme që japin të drejtën paditëses që të kërkoj vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit si dhe dorëzimin e banesës lëndore nga njerëzit dhe sendet, bazuar në dispozitat e neneve 17 të Ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore dhe nenin 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridiko pronësore.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 pika (n) të LPK, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 182.1 lidhur me nenin 194 dhe 204 të LPK, për të cilin shkak të dy aktgjykimet patjetër u deshtë të prishen.

Si me ankesë ashtu edhe me revizion kontestohet ligjshmëria e aktgjytimeve të gjykatave të instancës më të ulët, me arsyetim se aktgjykimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë

kontradiktor, nga mënyra e vendosjes dhe arsytet e dhëna, të cilin pretendim si të bazuar e pranor edhe kjo gjykatë.

Në aktgjykimin e shkallës së parë shkelja thelbësore e dispozitive të procedurës kontestimore, nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, qëndron për faktin se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, pasi që dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar është kontradiktor dhe kundërtshënës, në kundërshtim të plotë me vet arsyet e dhëna, si dhe provat në shkresat e lëndës.

Vendosja si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me arsyetimin e dhënë se “Banesa në pronësi shoqërore ka mund të jepet në shfrytëzim vetëm në bazë të kontratës mbi qiranë e cila është dashtë të lidhet në formë të shkruar prandaj në rastin konkret nuk është dëshmuar nëse paditësja ka pasur të lidhur kontratë në formë të shkruar me të paditurën e parë për dhënien e banesës kontestuese në shfrytëzim rezulton se asaj nuk është ndarë banesa kontestuese në formën e paraparë me ligj”, si dhe përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë, “se nga provat e administruara është vërtetuar se kontrata për blerjen e banesës kontestuese është lidh vetëm në bazë të kontratës për ndërtimin e banesës e cila si e tillë nuk përfaqësuar bazë të mjaftueshme juridike për lidhjen e kontratës për blerje, mirëpo sipas vlerësimit të gjykatës pa marrë parasysh këto fakte për deri sa, vendimi Nr.1793 i datës 04.10.1994, është në fuqi dhe kontrata për blerjen e banesës kontestuese e lidhur në mes të paditurës së parë dhe paditësës të jetë në fuqi, këto janë prova të mjaftueshme që i japin të drejtë paditësës që ta kërkoj dorëzimin e banesës lëndore, në kushtet e parapara me ligj, prandaj për këtë arsye gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditësës, që ka të bëjë me njohjen e të drejtës së shfrytëzimit dhe dorëzimin-lirimin e banesës lëndore nga njerëzit dhe sendet” ky arsyetim dhe ky përfundim i arritur, është i pa pranueshëm për Gjykatën Supreme, kjo për faktin se vlerësimi nëse paditësja i plotëson kushtet për të fituar të drejtën e shfrytëzimit konform dispozitive ligjore duhet të jetë i qartë, dhe duhet të vërtetohet qartë fakti nëse janë plotësuar kushtet ligjore për të fituar të drejtën e shfrytëzimit, dhe mbi cilën bazë është aprovuar kërkesëpadia, nuk mund që arsyetimi të jetë kontradiktor që në të njëjtën kohë vendimi Nr.1793 i datës 04.10.1994, i të paditurës së parë, të konstatohet se nuk përfaqëson bazë për fitimin e të drejtës së shfrytëzimit, dhe në të njëjtin të bazohet kërkesëpadia për vetë faktin se nuk është shfuqizuar.

Po ashtu ndonëse ka pasur kundërshtime sa i përket vërtetësisë së nënshkrimit të kontratës VR.nr. 672/99 e datës 09.03.1999, të vërtetuar në Gjykatën Komonale në Prishtinë, gjykata e shkallës së parë edhe pse i është drejtuar arkivit të kësaj gjykate, për sigurimin e kopjes së kontratës VR.nr. 672/99, e datës 09.03.1999, dhe ka marrë përgjigje nga zyrtarja e arkivës së gjykatës, se kopja e kontratës VR.nr. 672/99, e datës 09.03.1999, nuk gjendet në arkivin e kësaj gjykate. Mirëpo gjyqtari përkundër kësaj, nuk ka kërkuar nga arkivi i gjykatës librin -regjistritin e vërtetimit të kontratave të periudhës kur është vërtetuar kontrata, nga e cila edhe do të vërtetonte faktin nëse pretendimet për vërtetësinë e nënshkrimit të kontratave janë të bazuara.

Andaj duke marrë parasysh këto përfundime, vendosjen e bëjnë kontradiktore dhe në kundërshtim me nenin 160 të LPK-së, gjithashtu edhe me shkelje esenciale nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, për të cilën arsye ka pasur pretendime ankimore kundër aktgjykimit të shkallës së parë nga të paditurit, andaj gjykata e shkallës së dytë ka qenë dashtë ti trajtoj dhe ti evidentoj

këto shkelje, pasi paraqesin shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, për të cilat aktgjykimi ka qenë dashtë të priset, për të cilën shkelje gjykata e shkallës së dytë ka qenë dashtë që sipas pretendimeve në ankesë, dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta prish konform nenit 198.2 të LPK.

Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret për shkak të shkeljeve thelbësore të lartcekura, nuk mund të pranohet as aplikimi i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë, e pranuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë. Zbatimi i normave nuk mund të bëhet i kushtëzuar, ashtu siç ka bërë gjykata e shkallës së parë, dhe se gjykata duhet ta ketë parasysh se për krijimin e të drejtës së faktuar, siç është në rastin konkret me të drejtën e shfrytëzimit, duhet të vlerësohet nëse janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozita ligjore, po ashtu kjo vlen edhe sa i përket fitimit të drejtës së pronësisë, dhe aplikimin e dispozitave nuk duhet ta lidhë me rrethanat e tjera të cilat nuk mund ti ndryshojnë në asnjë rast plotësimin e kushteve të kërkuara me dispozita ligjore.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e lartpërmendura, duke i pasur parasysh edhe thëniet e tjera të ankesës dhe revizionit, ashtu që të trajtoj dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e palëve të parashtruara gjatë procesit gjyqësor. Ashtu që me rastin e vendosjes, të mund të vendoset pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, përmes administrimit të provave, dhe gjykata e shkallës së parë me rastin e përpilimit të aktgjykimit duhet të ketë kujdes që i njëjti të jetë në përputhje me nenin 160 të LPK-së, ashtu që vendimi të jetë i ligjshëm, dhe të përmbajë arsye për faktet vendimtare të vendosjes.

3.19 Konkluzione dhe rekomandime

Shiqar sipas legjislacionit ekzistues dhe me formimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, më vonë Agjencisë Kosovare të Privatizimit e cila ka juridiksion ekskluziv është e autorizuar për administrimin – duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidikimin – e ndërmarrjeve dhe asetëve të përkufizuara në këtë ligj, banesat në pronësi shoqërore dhe publike për shkak të natyrës dhe të përfshirjes të banuesve nuk e kanë cilësinë e asettit të ndërmarrjes dhe si të tilla janë destinuar për privatizim me Ligj të posaçëm.

Prandaj propozuesit kanë mundësinë e paraqitjes së kërkesave tek bartësit e të drejtës së pronës, Subjekti ekonomik, organi i administratës, komuna ose Agjencia e Privatizimit, dhe nëse në afatin kohor të paraparë me ligj nuk përgjigjen propozuesi i drejtohet gjykatës për nxjerrjen e vendimit që e zëvendëson kontratën e shitblerjes.

Në përgjithësi e drejta e banimit bie në korpusin e të drejtave themelore të njeriut dhe për këtë arsye këto lëndë janë të natyrës sensitive dhe si të tilla është me interes për publikun që të kryhen sa më shpejtë. Në këtë drejtim rekomandohet propozuesit të Ligjit përkatës që të gjenë modalitetet dhe të vazhdoj afatin e paraqitjes së propozimeve përtej datës 7 prill 2022.

Muhamet Rexha

4. VËSHTRIM I ASPEKTEVE JURIDIKE PROCEDURALE DHE MATERIALE NË KONTESTET PËR SHKAK TË PENGIM POSEDIMIT

4.1. Kuptimi, fitimi, mbrojtja, shuarja dhe çështjet tjera rreth posedimit

Sipas dispozitës së nenit 103 të Ligjit Për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, përkritazi me posedimin, përcaktohet se “ Personi i cili e ushtron pushtetin faktikë mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”. Me nenin 104 të këtij ligji, parashihet fitimi i posedimit, ashtu që, “posedimi në një send fitohet me krijimin e pushtetit faktikë mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes”.

Sa i përket çështjes së trashëgimit, me nenin 106 të LPDS-së, parashihet se “ Me vdekjen e poseduesit, posedimi kalon tek trashëgimtari ”. Ndërsa, lidhur me shuarjen e posedimit, sipas dispozitave të nenit 107.1 dhe 2 të këtij ligji, parashihet se “ Posedimi shuhet kur poseduesi heq dorë nga pushteti faktik mbi sendin ose në ndonjë mënyrë e humb pushtetin faktik”, përkatësisht, “ Posedimi nuk shuhet si rezultat i mos lejitimit të poseduesit për ushtrimin e kontrollit mbi sendin në një kohë të përkohshme ”. Po ashtu ky ligj flet edhe për Bashkë Posedimin, dhe me dispozitën e nenit 108 e definojnë “ Nëse disa persona e kanë bashkë posedimin në një send, e drejta e një personi për përdorimin e sendit në raport me të tjerët dhe mbrojtja individuale e poseduesit për posedimin e tij është e kufizuar me të drejtën e personave të tjerë për përdorimin e sendit ashtu siç është paraparë përdorimi ”. Me nenin 109.1 dhe 2 është paraparë posedimi jo i drejtpërdrejtë (i tërthortë), në të, thuhet “ Posedues jo i drejtpërdrejtë është personi i cili e jep posedimin e një sendi bazuar në një peng, qira, depozitë, marrëveshje ose raporte juridike të ngjashme që i japin personit tjetër të drejtën e posedimit të sendit për një kohë të caktuar “ respektivisht, “Nëse poseduesi i jo drejtpërdrejtë e merr posedimin e jo të drejtpërdrejtë nga personi i tretë bazuar në marrëdhëniet juridike të parapara në paragrafin 1, atëherë personi i tretë është posedues i tërthortë”.

Me dispozitën e nenit 110 të LPDS-së, është definuar posedimi pronësor, në të përcaktohet që “ Personi i cili e posedon një send që është pronë e tij, është posedues pronësor “. Me dispozitën e nenit 111 të këtij ligji, parashihen veprimet e kundërligjshme në posedim, kështu, në paragrafin 1 të këtij neni, thuhet “ Personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse provimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj”, ndërsa, me paragrafin 2 të këtij neni, thuhet se “ Posedimi i fituar si rezultat i pengimit të kundërligjshëm është me të metë. Pasardhësi i posedimit tillë duhet të pranojë të metën e posedimit, nëse ai ishte në dijeni për të metën apo ai është trashëgimtar i poseduesit”.

Për sa i përket mbrojtjes së posedimit, në nenin 112 të këtij ligji, parashihet “ Vetë ndihma e poseduesit”. Par.1 i këtij neni, përcakton se “ Poseduesi mund të përdorë forcën e arsyeshme për mbrojtje nga veprimet e paligjshme në pengimin e posedimit të tij, në qoftë se ndërhyrja është e atçastshme dhe janë ndërmarrë masat adekuate (proporcionale) për mbrojtje, menjëherë me

paraqitjen e ndërhyrjes (rrezikut), etj. Në këtë kuadër, më tutje, me dispozitat e nenit 113 të LPDS-së, parashihet edhe mbrojtja konkrete nga pengim posedimi, përkatësisht, Kërkesa kundër pengimit në posedim. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se “ Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta”. Me par.2 të këtij neni, përcaktohet se “ Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengesa në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”.

Po kështu, edhe për sa i përket shuarjes së kërkesës, me nenin 114 të këtij ligji, parashihet se “ Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 ditësh, pasi që poseduesi e merr dijeni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit”, nga rezulton se për paraqitjen e padisë, duhet të bëhet kujdes për afatin subjektiv (30 ditësh) dhe afatin objektiv (një vit).

Në kontekst të mëtejme të kësaj teme, konsiderojmë se është me interes dhe me rëndësi të theksohet fakti se në shkencë dhe në literaturën juridike në përgjithësi, flitet specifikisht edhe për objektin dhe subjektin e posedimit, për llojet e veçanta të posedimit, posedimin ligjor dhe jo ligjor, posedimin me mirëbesim dhe jo me mirëbesim, posedimin e drejtë dhe posedimin me të meta, paditë për mbrojtjen e posedimit etj.

4.2 Objekti i Posedimit

Nga se nuk është qëllimi i temës sonë, që këtu të flasim në mënyrë detaje për aspektet teorike, shkurtimisht theksojmë se në literaturën juridike, flitet se posedimi është pushtet faktik mbi sendet në qarkullim. Sendet jashtë qarkullimit, (rrugët publike, të mirat e përgjithshme në përdorim të përgjithshëm, etj) nuk mund të jenë objekt i posedimit, nga se, veç tjerash, ato janë nën regjim administrativo – juridik të posedimit dhe përdorimit. Në kontekstin e mësipërm, duhet pasur parasysh edhe legjislacionin në fuqi, në Republikën e Kosovës, si psh. Ligjin për Rrugët, etj).

4.3 Subjekti i Posedimit

Po ashtu, përkitazi me praktikën gjyqësore, duhet pasur parasysh edhe faktin se kush mund të jetë subjekt i posedimit. Subjekt i posedimit, pra, posedues i një sendi mund të jetë çdo person juridik dhe fizik. Dhe kur jemi këtu, në njërën anë, duhet vërejtur se në raport me disa sende, si subjekt i posedimit mund të lajmërohen të gjithë personat juridik dhe fizik, por, në anën tjetër, në raport me disa sende, vetëm disa kategori të personave juridik.

4.4 Posedimi ligjor dhe jo ligjor

Posedimi është ligjor nëse bazohet në bazën juridike të plotfuqishme, d.m.th. në punën juridike të vlefshme, e cila është e përshtatshme për fitimin e asaj të drejte të cilën poseduesi përkatës e ushtron.(me shitblerje, me këmbim, me dhuratë, etj). Përkundrazi, posedim jo ligjor, është ai

posedim që nuk bazohet në bazën juridike të plotfuqishme(uzurpuesi, vjedhësi, etj, janë posedues jo ligjor). Posedimi mund të jetë ligjor, por, jo me mirëbesim, (psh. kur blerësi e din apo sipas rrethanave duhet ta dijë se shitësi është vjedhës) ose, e kundërta, posedimi mund të jetë me mirëbesim, por jo ligjor (psh. Kontrata mbi shitblerjen është lidhur me pronarin, por është nul, e për këtë blerësi nuk ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë).

4.5 Posedimi me mirëbesim dhe jo me mirëbesim

Edhe në teorinë juridike, por edhe sipas konceptit ligjor (Ligji Për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Republikës së Kosovës – 2009, por, edhe LMTHPJ- i vjetri), flitet për posedimin me mirëbesim dhe jo me mirëbesim. Kështu, LPDTS, flet për të, në nenin 22, nenin 97 etj, në kontekst të çështjes së pronësisë, sikundër, edhe neni 72 i LMTHPJ, (por në kontekst të çështjes së posedimit), nga rezultojnë se, posedimi është me mirëbesim nëse poseduesi nuk din dhe nuk ka mundur të dijë se sendi të cilin e posedon (e mban) nuk është i tij. Lidhur me konceptin e ri ligjor, të çështjeve të sipër përmendura, shih pjesën II, kapitulli III dhe pjesa e IV e LPDS-së.

4.6 Posedimi i drejtë dhe me të meta

Themi se posedimi është me të meta kur ai është fituar me dhunë, mashtrim apo me keqpërdorim të besimit, pra, kur është fituar, siç thuhej në të Drejtën Romake me “ vi, clam, praecario”.

4.7 Mbrojtja e posedimit – paditë posedimore

Sikundër u theksua edhe më lartë, edhe Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Republikës së Kosovës, në nenin 112, duke folur për mbrojtjen e posedimit, flet për Vetëndihmën e poseduesit, por, në nenin 113 flet shprehimisht për kërkesën kundër pengimit të posedimit dhe nenin 114 për shuarjen e kërkesës, përkatësisht për afatin subjektiv dhe objektiv të parashtrimit të kërkesës, për të cilin u fol më lartë. Kështu, edhe në teorinë juridike, flitet për mbrojtjen e posedimit, paditë për mbrojtjen e posedimit - paditë posedimore. Në teorinë juridike, por edhe nga interpretimi i dispozitës së nenit 113 të këtij ligji, rezultojnë se cenimi i posedimit mund të bëhet në dy mënyra: Me privimin e poseduesit nga posedimi i sendit, në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht, me marrjen e sendit poseduesit, dhe me pengimin e posedimit. Marrja e sendit ndodh më shpesh kur është fjala për sendet e laujtshme, por, ndodh edhe kur është fjala për sendet e paluajtshme, d.m.th. kur poseduesi përjashtohet (zhveshët) në tërësi nga pushteti faktikë mbi sendin, duke krijuar pushtetin faktikë mbi sendin nga ana e poseduesit të ri faktikë (psh. vjedhësi, hyrja në banesën e huaj, deri sa mungon pronari a poseduesi etj).

Ndërsa, pengimi i posedimit, si kur është fjala për sendet e paluajtshme, ashtu edhe për sendet e laujtshme, shprehet në atë mënyrë që mund t’i pamundësohet plotësisht poseduesit ushtrimi i pushtetit faktikë mbi sendin, por, pa u krijuar pushteti faktikë i poseduesit të ri mbi sendin përkatës (psh. Kur dikujt tjetër i bëhet e pamundur kalimi apo arritja deri në paluajtshmërinë e cila është në posedim të tij). Pra, pengimi i posedimit më së shpeshti ka të bëjë me kufizimin dhe vështirësimin e ushtrimit të pushtetit faktikë të poseduesit të sendit, e që në praktikë, këto

raste janë të nduarnduarta, nga më të ndryshmet. (psh. gjatë punimit – livrimin të arës së vet – ngastrës së vet, kapërcen kufijtë e saj dhe livron edhe një pjesë të ngastrës fqinje...etj). Përveç kësaj, në praktikën gjyqësore civile, ka raste kur pengimi i posedimit bëhet edhe verbalisht (shqetësim psikik), kur dikush me kërcënim serioz i ndalon kalimin personit i cili deri atëherë ka kaluar përmes një rruge a paluajtshmërie tjetër. Nga këtu, por edhe sipas dispozitave të sipër përmendura ligjore, del se cenimi i posedimit i jep të drejtë poseduesit të sendit për ngritjen e padisë së posedimit, si kur është fjala për marrjen e sendit – përjash timin nga pushtimi faktikë të poseduesit të sendit, ashtu edhe kur është fjala për zvogëlimin apo vështirësimin (qoftë edhe në mënyrë verbale dhe psikike) e pushtetit të tij faktikë, pra, ai gëzon mbrojtje gjyqësore përmes përdorimit të padive posedimore. Ndërkohë që, kur është fjala për paditë posedimore, qysh nga koha e Romakëve (dhe nga e Drejta Romake), flitej për dy padi për mbrojtjen e posedimit ; padia për kthimin e sendit të marrë (që në të Drejtën Romake njihet si *interdictum recuperandae possessionis*) dhe padia për shkak të pengimit të posedimit (*interdictum retinende possessionis*), të cilat në fakt njihen (parashihen) edhe në nenin 113 të LPDS-së, të Republikës së Kosovës. Kur jemi këtu, po ashtu, duhet theksuar se, padia për mbrojtjen e posedimit, si ajo për kthimin e sendit të marrë, ashtu edhe ajo për shkak të pengimit të posedimit, sipas dispozitës së nenit 114 të LPDS-së, duhet të paraqitet në afatin prej 30 ditësh, nga dita kur poseduesi (paditësi) merr në dijeni për marrjen e sendit, përkatësisht, për pengimin e posedimit dhe për personin i cili e ka kryer pengimin dhe më së largu në afatin prej një viti, nga dita e pengimit dhe marrjes së sendit.

Pra, nga sa u sipër theksua, ekzistojnë dy afate, afati subjektiv dhe objektiv, dhe që të dyja afatet janë prekluzive, dhe gjykata mban llogari sipas detyrës zyrtare (*ex officio*). Në praktikë, por edhe në teorinë juridike, theksohet se me kalimin e afatit për ngritjen e padisë posedimore, nuk mundet më që të inicohet kontesti posedimor, por, në këto raste poseduesi (si paditësi) mund të ngrit padi petitore – pronësore. Këto padi pronësore, njihen edhe nga Ligji ynë për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore. Kështu, me nenin 93 është paraparë kërkesa për kthimin e sendit, ku thuhet “ Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi” (padia për kthimin e sendit – *actio rei vindicatio*).

Po ashtu, edhe me nenin 102, parashihet mundësia e paraqitjes së kërkesës për largimin dhe mos përsëritjen e cenimit, (padia negatore - *actio negatoria*). Pra, me fjalë të tjera, pas përfundimit të kontestit posedimor, u mor vesh se, palët mund të inicojnë kontestin e ri, kontestin pronësor, në të cilin, për dallim nga kontesti posedimor, do të shqyrtohen edhe çështjet juridike dhe siç ndodh edhe në praktikën gjyqësore, fituesi i kontestit pronësor mund të jetë edhe ai person, (ajo palë) që ka humbur kontestin posedimor, mirëpo, këtu konsiderojmë se nuk është në natyrën e shqyrtimit të temës tonë, që të shpjegojmë edhe më tej për çështjet e sipër përmendura.

4.8 Aspekte ligjore dhe procedurale juridike përkitazi me pengim posedimin- Disa çështje rreth kompetencës në kontestet për shkak pengimit të posedimit

Në Kreun XXVII, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, flitet për Procedurën në kontestet për shkak të pengimit të posedimit, dhe me nenin 478 të këtij ligji parashihet se “ Po që se në këtë kapitull nuk ekzistojnë dispozita të posaçme, në kontestet për shkak të pengimit të posedimit zbatohen dispozitat e tjera të këtij ligji”. Kështu, për sa i përket kompetencës, me nenin 19 të

LPK-së, parashihet se “ Secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore “. Me nenin 29 të këtij ligji parashihet kompetenca lëndore “ Në procedurë kontestimore gjykatat gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së vet lëndore të caktuar me ligj”. Ndërkohë, që me dispozitën e nenit 41.1 të LPK-së, ku flitet për kompetencën (territoriale ekskluzive) në kontestet lidhur me sendet e paluajtshme, përcaktohet “ Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengimit të posedimit mbi sendin e paluajtshëmetj, është ekskluzivisht kompetente gjykata në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria”. Ndaj, kur kemi të bëjmë me këtë lloj të kompetencës tokësore ekskluzive të ndonjë gjykate, duhet theksuar faktin se as palët nuk mundën të merren vesh për ndonjë kompetencë tokësore me marrëveshje, dhe ligjvënësi parashih këto raste në mënyrë taksative dhe shprehimore, siç edhe janë specifikuar në dispozitën e sipër përmendur ligjore.

Ndërkohë që, kur është fjala për kontestet për shkak të pengimit të posedimit mbi sendin e luajtshëm, duhet theksuar se vlejnjë rregullat për kompetencën territoriale të zgjedhur (elektive), kështu, me nenin 52 të LPK-së, përcaktohet se “ Për zgjidhjen e kontesteve për shkak të pengimit të posedimit mbi sendet e luajtshme është kompetente, përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale, edhe gjykata në territorin e të cilës është bërë pengimi”.

4.9 Procedura në kontestet për shkak të pengimit të Posedimit

Procedura në çështjet që kanë të bëjnë me pengimin e posedimit është procedurë e veçantë kontestimore, për të cilën janë paraparë me ligj rregulla të veçanta. Kështu përkitazi me këtë flasin dispozitat e neneve 478 deri 483 të LPK-së. Në kontekstin e mësipërm, me dispozitën e nenit 479 të LPK-së, është paraparë se “ Me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave, gjykata gjithmonë i kushton kujdes nevojës së zgjidhjes së ngutshme të kontesteve për shkak të pengimit të posedimit, por duke marrë parasysh natyrën e secilit rast konkret. Pra, këtyre rasteve, ligjvënësi u ka dhënë karakter urgjent dhe trajtim me prioritet, para lëndëve të cilat nuk janë të natyrës urgjente.

Për sa i përket çështjes së vendosjes, me dispozitën e nenit 480 të LPK-së, parashihet se “ Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin e fakteve dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përrjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përrjashtohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.

Prandaj, lidhur me këtë që u sipër theksua, duhet përmendur edhe praktikën gjyqësore e cila ka qëndrimin e artikuluar edhe më parë, se me padinë për shkak të pengimit të posedimit kërkohet mbrojtja ose rivendosja e gjendjes së fundit të posedimit të sendit. Me të, pra, kërkohet që të vërtetohet gjendja e fundit e posedimit, vërtetimi i ekzistimit të vet aktit të pengimit të posedimit të sendit, rivendosja e gjendjes para aktit të kryerjes së pengim posedimit dhe t’i ndalohet kryesit – të paditurit, ndërmarrjen e veprimit të njëjtë apo të ngjashëm në të ardhshmen.

Vendimi gjyqësor që merret lidhur me vendosjen e kontesteve për shkak të pengimit të posedimit, është në formë të aktvendimit. Me dispozitën e nenit 142.2 të LPK-së, parashihet se “Vendimet e gjykatës jepen në formë të aktgjykimit dhe aktvendimit“, kurse, me dispozitën e nenit 142.3, të këtij ligji, parashihet se “ Mbi kërkesëpadinë gjykata vendos me aktgjykim, kurse në procedurën sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit me aktvendim”.

4.10 Mjetet e goditjes së aktvendimit

Kundër aktvendimit të gjykatës lidhur me pengimin e posedimit, lejohet ankesa. Afati për paraqitjen e ankesës, kundër aktvendimit për shkak të pengimit të posedimit, sipas nenit 481.2 të LPK-së, është shtatë (7) ditor. Mirëpo, sipas dispozitës së nenit 481.4 të këtij ligji, kundër aktvendimit të dhënë në kontestet për shkak të pengimit të posedimit revizioni nuk është i lejuar. Ndërsa, nga Prokurori Kompetent i Shtetit mund të paraqitet Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë. Gjithashtu, sa i përket mjeteve të goditjes, kundër aktvendimit të sipër cekur, duhet theksuar se mund të paraqitet e Kërkesa për përsëritjen e procedurës, por nga shkaqe të kufizuara me ligj.

Kështu, me dispozitën e nenit 483 të LPK-së, parashihet se “ Përsëritja e procedurës së përfunduar me vendim të formës së prerë në kontestet për shkak të pengimit të posedimit lejohet vetëm nga shkaqet e përcaktuara në nenin 232 pika a) dhe b) të këtij ligji dhe vetëm brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën është bërë i formës së prerë aktvendimi përfundimtar ” (këto çështje të sipër cekura, më poshtë, do të ilustrohen me shembuj konkret nga praktika gjyqësore).

Nga këtu rezulton se me dispozitën e lartë cituar, përkitazi me kontestet e sipër cekura, parashihet se procedura e përfunduar me vendim të formës së prerë mund të përsëritet sipas propozimit të palës, në qoftë se “ palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore “ (neni 232 pika a), përkatësisht, “ në qoftë se në procedurën e përfunduar ka marrë pjesë si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose po që se palën me pa zotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, po që se ndjekja e çështjes në gjyq apo kryerja e veprimeve procedurale të caktuara nuk është lejuar më vonë nga pala “ (neni 232 pika b), pra, kërkesa e sipër cekur, nuk mund të paraqitet edhe nga shkaqet (a arsyet) tjera të parapara me dispozitat tjera të nenit 232, pikat c), d), e), f), g), të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

4.11 Aspekte rreth kontesteve për shkak të pengimit të posedimit nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.236/2024 dt.6.06.2024

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.431/2021 të dt.12.03.2024, refuzohet e pathemeltë ankesa e paditësve të lartë cekur, ndërsa, vërtetohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës C.N.nr.30/2020 dt.30.11.2020, me të cilin është hedhur poshtë si i palejuar propozimi për përsëritjen e procedurës i të autorizuarit të paditësve, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përsëritja e procedurës e përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë C.nr.215/2016 dt.15.02.2017.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, pala e paditësi Samir Kurtishaj, ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, siç thuhet në të, aktvendimet e atakuara të prishen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rishqyrtim dhe rivendosje apo që aktvendimet të ndryshohen dhe ankesa e paditësve të aprovet si e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 lidhur me nenin 230 të LPK, shkresave të lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve të revizionit ka gjetur se:

Revizioni i paditësit Samir Kurtishaj është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, nëpërmjet të autorizuarit të vet, më datën 18.04.2017, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës, me të cilin kanë kërkuar që të lejohet përsëritja e procedurës e përfunduar me aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë C.nr.215/2016 dt.15.02.2017. Propozimin për përsëritjen e procedurës paditësit e kanë mbështetur në nenin 232 pika g) të LPK-së, përkatësisht, pretendojnë se kanë siguruar provë të re, në bazë të së cilës mund të merret vendim më i favorshëm për ta. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës, rrjedh se, paraprakisht, procedura kontestimore është zhvilluar përkitazi me çështjen kontestuese të pengim posedimit, i cili kontest civil, midis këtyre palëve ndërgjyqëse, ka përfunduar me aktvendimin e formës së prerë, të sipër përmendur.

Nisur nga gjendja e këtyre të çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës, nëpërmjet gjyqtarit Individual, pas shqyrtimit të pretendimeve të propozimit të palës paditëse, për përsëritjen e procedurës dhe shqyrtimit të lejueshmërisë së propozimit për përsëritjen e procedurës, ka gjetur se propozimi për përsëritjen të procedurës, i parashtruar nga paditësit, është i pa lejuar, ndaj, me aktvendimin C.N.30/2020 dt.30.11.2020, në mbështetje të dispozitave të nenit 235, nenit 237, nenit 239, nenit 483 të LPK-së, të njëjtin e ka hedhur poshtë dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të tij.

Gjykata e shkallës së dytë, nëpërmjet trupit gjykues të përbërë nga tre gjyqtar, në procedurën ankimore, në tërësi e ka pranuar qëndrimin juridik të gjyqtarit të saj individual, si të drejtë dhe të ligjshëm, e ka refuzuar ankesën e palës së paditëse dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjyqtarit individual C.N.30/2020 dt.30.11.2020.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i bazuar dhe i pranueshëm qëndrimi juridik i gjyqtarit individual dhe i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit të

Kosovës, kur nga arsyet e sipër theksuara, kanë vendosur si në dispozitivin e aktvendimeve të tyre, përkatësisht, për hedhjen si të palejuar të propozimit të paditësve për përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktvendim të formës së prerë. Aktvendimet e tyre nuk janë të përfshira me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndaj, pretendimet e revizionit për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, nuk mund ta vënë në dyshim aktvendimin e goditur dhe si të tilla u konsideruan të pathemelta, ndërsa, aktvendimi i gjykatës së instancës më të ulët, është i drejtë.

Në kontekstin e mësipërm, shprehimisht, me nenin 483 të LPK-së, përcaktohet se “ Përsëritja e procedurës së përfunduar me vendim të formës së prerë në kontestet për shkak të pengim posedimit lejohet vetëm nga shkaqet e përcaktuara në nenin 232 pika a) dhe b) të këtij ligji, dhe vetëm brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën është bërë i formës së prerë aktvendimi përfundimtar ”. Në rastin konkret civil, sikundër rezulton nga shkresat e lëndës, kontesti për shkak të pengim posedimit është përfunduar me aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë C.nr.215/2016 dt.15.02.2017, kurse, propozimi për përsëritjen e procedurës është paraqitur duke u bazuar në pretendimin se janë siguruar prova të reja. Mirëpo, kur jeni këtu, sikundër del nga dispozita e sipër cituar, nuk mund të paraqitet propozimi për përsëritje të procedurës në kontestet e pengim posedimit me pretendimin se janë siguruar prova të reja, siç parashihet me nenin 232 par.1 pika g) të LPK-së. Ky mjet i jashtëzakonshëm juridik, u mor vesh, lejohet vetëm kur përmbushen konditat ligjore nga neni 232 pika a) dhe b) e LPK-së, gjë që, këtu nuk është ky rast.

Nga këtu dhe për arsyet e sipër përmendura, kjo Gjykatë, vlerëson se nuk qëndrojnë thënie të revizionit për shkeljet e pretenduara dhe si të tilla, ato janë të paqëndrueshme dhe të pa themelta, ndërsa, në rastin konkret, gjykata e instancës më të ulët, ka marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 lidhur me nenin 230 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi CML.nr.3/2021 dt.14.06.2021

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1469/19 dt.24.02.2021, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.890/18 dt.19.12.2019, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është vërtetuar se i padituri e ka kryer pengim posedimin në dëmin e paditësit, në atë mënyrë që pa autorizim, pa marrëveshje paraprake dhe pa pëlqimin e paditësit ka ndërtaur murin ndarës në mes të ngastrave kadastrale 1193/2 dhe 1193/5 (në posedim të paditurit), në njërën anë dhe ngastrës kadastrale 1193/1 (në pronësi dhe posedim të paditësit) në anën tjetër, me çka paditësi është depozeduar ose i është penguar e drejta e posedimit në një sipërfaqe prej 75 m² të ngastrës kadastrale 1193/1 më datën 16.11.2015, në vendin e quajtur “Gështenja” me kul.arë-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 345 m² ZK-Shtime. Me pjesën e

II-të të dispozitivit, detyrohet i padituri që në afat prej 3 ditësh ta rrënojë murin ndarës në pjesën e cila shtrihet në ngastrën kadastrale 1193/1 dhe të njëjtën ta kthejë në gjendje të mëparshme dhe sipërfaqen prej 75 m² nga ngastra e përmendur kadastrale të ia dorëzojë paditësit në posedim dhe shfrytëzim të qetë dhe të papenguar nën kanosjen e përbarimit të detyrueshëm. Me pjesën e III të dispozitivit, detyrohet i padituri që të përmbahet nga shqetësimet e mëtutjeshme të paditësit gjegjësisht nga ndërmarrja e çfardo veprimi lidhur me ndërtimin e murit ndarës në mes të ngastrave të përmendura më lartë pa pëlqimin e paditësit, gjegjësisht, pa njoftimin e organeve kompetente komunale të lëmisë së ndërtimit si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 823,60-euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, me kërcënim përbarimi.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe atij të gjykatës së shkallës së parë, në afat ligjor, Prokurori i Shtetit ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishen aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur në kuptim të nenit 251 të LPK, ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ekspertizës së gjeodezisë, shikimit në vend të ngjarjes, ndëgjimin e palëve ndërgjyqësore, ka vërtetuar se i padituri ka kryer pengim posedimin në dëm të paditësit në atë mënyrë që pa autorizim, pa marrëveshje paraprake dhe pa pëlqimin e paditësit ka ndërtuar murin ndarës në mes të ngastrave kad.1193/2 dhe 1193/5,(në posedim të paditurit), në njërin anë dhe ngas.kad.1193/1 (në pronësi dhe posedim të paditësit) në anën tjetër, me çka paditësi është deposeduar ose i është penguar e drejta e posedimit në një sipërfaqe prej 75 m² të ngas.kad.1193/1 më dt.16.11.2015,në v.q. "Gështenja", me kulturë arë-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 345 m², zk-Shtime.

Nga gjendja e këtyre faktike e vërtetuar dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 114, nenit 103, nenit 113.1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, gjykata e shkallës së parë, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ka vendosur si nën I, II dhe III të dispozitivit të aktvendimit të sajë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, në procedurën ankimore, e ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e të paditurit, ka pranuar konstatimet faktike si dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, dhe e ka vërtetuar aktvendimin e saj.

Në këtë gjendje të kësaj çështje juridiko-civile, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancës më të ulët nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, nga se sipas vlerësimit të kësaj gjykate gabimisht është zbatuar e drejta materiale për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Kjo për faktin se aktvendimet e gjykatave të shkallës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të dispozitës së nenit 114 të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat Tjera Sendore, nga se nuk është vlerësuar si duhet çështja e afatshmërisë së paraqitjes së padisë për pengim posedim.

Me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se i padituri e ka penguar paditësin në posedimin faktik në atë mënyrë që e ka ndërtuar murin ndarës në mes të ngastrave kadastrale, siç përshkruhet në dispozitiv të aktvendimit të saj. Padiësi në padi dhe në seancë gjyqësore ka parashtruar se për aktin e pengim posedimit ka kuptuar më datën 16.11.2015, ndërsa, padinë e ka paraqitur më datën 14.12.2015. Ndërkohë që, i padituri ka parashtruar se palaujtshmërinë nga paditësi e ka blerë në v.2008, ndërsa, murin kontestues e ka ndërtuar dy vite më vonë, d.m.th. në v.2010. Paraqitja e padisë për pengim posedim është e lidhur me afatin prekluziv sipas dispozitës së nenit 114 të LPDS, të cilin afat gjykata e vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Për arsyet e lartë përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Kosovës, është e bazuar për shkak se gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, nga se nuk kanë vërtetuar saktë dhe plotësisht datën, muajin dhe as vitin e kryerjes së aktit të pengimit të posedimit i cili fakt është i rëndësishëm, relevant, për të vërtetuar edhe afatin e paraqitjes së padisë në gjykatë, prandaj, u deshtë që të dy aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen.

Prandaj, nga këtu, në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet t'i mënjanojë të metat e sipërpërmendura, të vërtetojë se padia e paditësit a është paraqitur në afatin ligjor të paraparë me dispozitën e nenit 114 të LPDS-së, të vërtetojë me prova adekuate (dëshmitarë etj, - neni 7, 8, 319 i LPK-së) kohën e kryerjes së aktit të pengim posedimit dhe çështjet tjera lidhur me pengim posedimin konform nenit 480 të LPK-së, dhe më pas të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga arsyet e lartcekura, e në mbështetje të dispozitave të nenit 251 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi MLC.nr.4/2016 dt.14.03.2016

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4370/2015 të dt.18.12.2015 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, kurse, është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.318/11 dt.5.10.2015, me të cilin është rrefuzuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se e paditura me dt.23.05.2011 e ka penguar paditësin në posedimin e së drejtës së kalimit të përhershëm, nëpër pronën publike për t'u qasur në pronën e tije, të urdhërohet e paditura që menjëherë t'a kthejë gjendjen e mëparshme duke hequr qdo pengesë, të mos e penojë paditësin t'a shfrytëzojë pronën publike që të ketë qasje në rrugë nga prona e tij private.

Kundër aktvendimeve të gjykatës së shkallës së dytë dhe të shkallës së parë, padiësi ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të vendoset se aktvendimet e sipër përmendura janë të paligjshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paditësit është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës,rezultun se paditësi kundër aktvendimeve të gjykatës së shkallës së dytë dhe të shkallës së parë, me të cilat ishte vendosur për kontestin e pengim posedimit,kishte paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërkohë që, sipas dispozitës së nenit 246 të LPK-së është paraparë se “Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit nga neni 245 i këtij ligji ngritët nga prokurori publik(tani prokurori i shtetit),në pajtim me ligjin”.Nga kjo dispozitë ligjore,rrjedh se kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë(si mjet i jashtzakonshëm juridik)mund t’a parashtrojë ekskluzivisht prokurori i shtetit e jo paditësi a i padituri.Pra,prokuria shtetore ka kompetencë ekskluzive në lidhje me paraqitjen e këtij mjete juridik, ajo ka legjitimitetin real dhe procedural të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prandaj,nga arësyeja e sipër përmendur, Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së paditësit, u dashtë që ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.55/2016 dt.14.03.2016

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3195/2015 të dt.16.11.2015 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit kurse, është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.1078/14 dt.9.02.2015,me të cilin është miratuar kërkesëpadia e paditësit dhe është vërtetuar se i padituri e ka penguar paditësin në posedimin e lirë dhe të fundit faktik të paluajtshmërisë së tij ngas.kad.nr.423 ,fp.342 Zk Arbanë,ashu që me dt.11.08.2013,ka hapur derën e shtëpisë në drejtim të parcelës 423 dhe me këtë veprim e ka penguar paditësin në shfrytëzim dhe disponimin e lirë të paluajtshmërisë së tij, e ka obliguar të paditurin që menjëherë t’a mbyllë derën në murin e oborrit të shtëpisë në drejtim të parcelës 423 dhe të mos e shfrytëzojë të njëjtin për kalim dhe në të ardhmen të mos e pengojë paditësin në këtë apo ndonjë mënyrë tjetër si dhe t’i paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 800-euro.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës civile si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktvendimi i atakuar, të rrefuzohet kërkesëpadia e paditësit apo i njëjti të prishte dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 230 lidhur me nenin 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i të paditurit është i palejuar.

Sipas dispozitës së nenit 481 par.4 të LPK, kundër aktvendimit të marrë në kontestet për shkak të pengim posedimit revizioni nuk është i lejuar. Prandaj, duke qenë se, me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë është rrefuzuar ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar aktvendimi i shkallës së parë, i cili është marrë në procedurën për kontestet e pengim posedimit, sipas dispozitës ligjore të sipërcekur, rrjedh se revizioni në kontestet e pengim posedimit, nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218 të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 481 par.4 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.316/2016 dt.23.11.2016

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4946/2015 të dt.9.08.2016 është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurit, kurse, është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.287/15 dt.9.11.2015, me të cilin është miratuar kërkesëpadia e paditësit dhe është vërtetuar se i padituri me dt.27.03.2015 në orën 12,30 ka kryer aktin e pengim posedimit duke vendosur derën në dimensionin 140 x 24 në ngastrën kad. Nr.2580/2 në sipërfaqe prej 463m², sipas f.p.5897,ZK-Pejë, pronë e paditësit, duke e penguar paditësin dhe familjarët e tij në posedimin e lirë të pronës dhe qasjen e lirë të hyrjes kryesore të shtëpisë ashtu që detyrohet i padituri që të rivendos gjendjen e mëparshme duke larguar derën dhe t'i mundësojë paditësit lëvizjen e lirë në pronën e tij, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi nën kërcënim ekzekutimi të detyrueshëm dhe se secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktvendimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 230 lidhur me nenin 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:
Revizioni i të paditurit është i palejuar.

Sipas dispozitës së nenit 481 par.4 të LPK, kundër aktvendimit të marrë në kontestet për shkak të pengim posedimit revizioni nuk është i lejuar. Prandaj, duke qenë se, me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë është rrefuzuar ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, i cili është marrë në procedurën për kontestet e pengim posedimit, sipas dispozitës ligjore të sipër cekur, rrjedh se revizioni në kontestet e pengim posedimit, nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin t'a hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 481 par.4 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.196/2021 dt.25.05

A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë C.nr.83/2020 të dt.13.11.2020, është rrefuzuar si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të “Aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar juridikisht dhe Vërtetohet se me datë 23.07.2019 i padituri e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e lirë të së drejtës së posedimit të ngastrës kad.nr.625-0 në atë mënyrë se i ka mënjnauar shenjat e mexhës si dhe shufrat e hekurit të murit të themelit kufizues”. Me pjesën e II të dispozitivit, Detyrohet paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës ti paguajë të paditurit shumën prej 1007-euro.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë paditësi ka paraqitur revizion, me ç’rast nuk i specifikon shkeljet as të natyrës procedurale e as të natyrës materiale, me propozim që të “aprovohet revizioni si i bazuar në atë drejtim, siç thuhet në të, që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të hedhet jashtë fuqisë si dhe të nxjerrët vendim i ri nëpërmjet të cilit do të aprovohej kërkesëpadia e paditësit si me bazë ose lëndën do të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje”.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 230 lidhur me nenin 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore , gjeti se:

Revizioni i paditësit është i palejuar.

Sipas dispozitës së nenit 481 par.4 të LPK-së kundër aktvendimit të marrë në kontestet për shkak të pengim posedimit revizioni nuk është i lejuar. Përveç kësaj, për rastin konkret nuk ka vendim të gjykatës së shkallës së dytë, kurse, revizioni mund të paraqitet ekskluzivisht kundër

aktgjykimit, respektivisht, aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, pra, nuk mund të ketë revizion kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti mund të paraqitet vetëm kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin është vendosur në lidhje me ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, e jo edhe kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, siç ka bërë pala paditëse.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218 të LPK-së, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 230 dhe 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin t'a hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 481 par.4 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.291/2024 dt.9.07.2024

A r s y e t i m i

Me pjesën e parë të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.732/2022 dt.26.09.2023, aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, vërtetohet se i padituri që nga muaji prill i vitit 2022 e tutje, fillimisht me vendosjen e pengesave në rrugë në mes të ngastrës 136-3 ZK- Llozhan, siç janë drunjtë dhe zhavorr e më vonë edhe me kundërshtimin për shfrytëzimin e rrugës e cila kalon në ngastrën kadastrale e cila shtrihet përgjatë tërë anës veriore të parcelës 136-1 në distancë prej 14.74 cm, në drejtim lindje- perëndim në gjerësi prej 5.19 cm, në drejtim veri – jug me gjatësi prej 19.74 cm, nga ana jugore drejtim lindje – perëndim si dhe pika 4 deri 1 në gjerësi 3.98 cm, ana perëndimore drejtim jug – veri, ashtu që detyrohet i padituri të i heq pengesat dhe të ia mundësoi kalimin – shfrytëzimin e rrugës për hyrje në patundshmërinë e tij dhe të obligohet në të ardhmen nga përmbajtja e çdo veprimi që dërgon në pengim posedim dhe me pjesën e II të dispozitivit , secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7682/2023 të datës 8.04.2024, refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurit dhe vërtetohet aktvendimi i sipër përmendur i gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, të aprovohet revizioni dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë të anulohen si dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit, si dhe shkresave të lëndës, sipas nenit 218 par.2 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i të paditurit është i palejuar.

Me dispozitën e nenit 481.4 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore parashihet se kundër aktvendimit të marrë në kontestet për shkak të pengim posedimit revizioni nuk është i lejuar. Prandaj, duke qenë se, me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë është refuzuar ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, i cili është marrë në procedurën për kontestet e pengim posedimit, sipas dispozitës ligjore të sipër cekur, rezulton se revizioni në kontestet e pengim posedimit, nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2, pika d) të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221, lidhur me nenin 218 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi CML.nr.20/2017 dt.30.11.2017

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1053/17 datë 28.7.2017, refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurve: Musa Rexhep Grabanica, Isa Rexhep Grabanica, Avdullah Rexhep Grabanica, Avdurrahman Rexhep Grabanica, Nazim Rexhep Grabanica, Pajtim Rexhep Grabanica, Labinot Musa Grabanica, të gjithë nga Vushtrria, dhe është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri c.nr.260/2016 datë 31.1.2017, me të cilin, në par. 1 të dispozitivit të tij, aprovohet kërkesëpadia e paditësit Nazim sherif Grabanica, nga Vushtrria, dhe vërtetohet se të paditurit : Musa Rexhep Grabanica, Isa Rexhep Grabanica, Avdullah Rexhep Grabanica, Avdurrahman Rexhep Grabanica, Nazmi Rexhep Grabanica, Pajtim Rexhep Grabanica,

Labinot Musa Grabanica, të gjithë nga Vushtrria, e kanë penguar paditësin Nazmi Sherif Grabanica në shfrytëzimin e patundshmërisë, e cila evidentohet në fletën Treguese me nr. të protokollit 5761-parcela kadastrale 4430 z.k. Vushtrri. Në par. II të dispozitivit, urdhërohen të paditurit që të përmbahen nga akti i pengimit në posedim dhe iu ndalohej të paditurve që në të ardhmen ta pengojnë paditësin në shfrytëzimin e qetë të parcelës si nën pikën I të dispozitivit. Me par. III të dispozitivit, detyrohen të paditurit për të kompensuar shpenzimet e procedurës paditësit në shumë prej 653,90 € dhe atë për përpilim të padisë 101,40 €, për 3 përfaqësime të avokatit në seanca nga 135 €, një seancë të shtyrë shumë prej 67.50 €, për taksën për padi 40 € dhe për taksën për përpilim të aktvendimit 40 €. Me të njëjtin aktvendim në par. IV thuhet se ankesa nuk e pengon përmbahimin e këtij aktvendimi (neni 483 par. 3 i LPK), dhe afati për përmbushjen e detyrimeve është menjëherë me të pranuar të këtij aktvendimi.

Kundër aktvendimit të cekur më lartë, Prokurori i Shtetit të Kosovës, me kohë ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 247 par. 1 pika (a) lidhur me nenin 122 par. 1 dhe par. 2 pika 1 dhe (n) të LPK-së, me propozim që aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në seancën për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, Prokurori i Shtetit nuk i është përgjigjur ftesës së gjykatës edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, në pajtim me nenin 250 të LPK-së, mungesën nuk e ka arsyetuar kështu që gjykata seanca e ka mbajtur në mungesë të Prokurorit të Shtetit. Në seance prezent kanë qenë: paditësi ndërsa i autorizuari i tij av. Rexhep Kaçaniku nga Mitrovica, nuk i është përgjigjur ftesës së gjykatës edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, mungesën e ka arsyetuar. Po ashtu, prezent kanë qenë të paditurit si dhe i autorizuari i tyre av. Adem Bokshi nga Mitrovica.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 251 të Ligjit mbi procedurën kontestimore (LPK), ka gjetur se.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit e kanë penguar paditësin në shfrytëzimin e patundshmërisë e cila evidentohet në fletën treguese me nr. të protokollit 5761 parcela kadastrale 4430 ZK. Vushtrri dhe të urdhërohen të paditurit që të përmbahen nga aktet e pengimit në posedim dhe iu ndalohej të paditurve që në të ardhmen ta pengojnë paditësin në shfrytëzimin e qetë të parcelës lartcekur. Të paditurit e kanë kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Nga shkresat e lëndës rezulton se akti i pengimit të posedimit ka ndodhur me 30.6.2016.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimit në tërësi ka pranuar konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe e ka refuzuar si ta pabazuar ankesën e të paditurve dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike, ka gjetur se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, parashtruar nga Prokurori i Shtetit të Kosovës, nuk ka mbështetje ligjore në dispozitën e nenit 247 par. 1 nënparagrafin a) të LPK-së.

Gjykata e Revizionit shqyrton çështjet sipas kërkesës së mbrojtjes së ligjshmërisë dhe kufijtë e arsyeve dhe shkaqeve të goditura, të cilat i ka parashtruar Prokurori i Shtetit të Kosovës në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë (neni 251 të LPK). Kjo do të thotë se është i kufizuar ngushtë kufiri i vlerësimit të shkeljeve decidivisht të cekura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Dispozita e nenit 247 të LPK-së, rregullon shkaqet e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjes së ligjshmërisë. Sipas kësaj dispozite shkaqet për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë karakter taksativ dhe përkufizohen vetëm në disa shkelje, të cilat mund të shërbejnë si shkaqe për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Sipas dispozitës së nenit 247 par. 1 pika a) të LPK-së, Prokurori i Shtetit të Kosovës, mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore (neni 182 par. 2 pika (n) nënpar. (d,h,i dhe me të LPK-së), në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po që se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse ka pasur detyrë të mbajë seancën kryesore, po që se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontesti është në vazhdim apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore.

Krijimi i gjyqvarësisë si pasojë procedurale juridike është paraparë me dispozitën e nenit 262 par. 3 të LPK-së. Nëse një çështje ose jo në kuptim të kësaj norme është e gjykuar varet nga dy rrethana : nëse palët dhe objekti i kontestit në procedurën e re është identike me palët dhe objektin e kontestit në procedurën paraprake. Këto dy kushte duhen të plotësohen në mënyrë kumulative në mënyrë që të vijë në shprehje zbatimin i dispozitës së nenit 262 par. 3 të LPK-së. Identiteti i palëve ekziston atëherë kur edhe në procesin e ri paraqiten si subjekt palët e njëjta, ndërkaj identiteti objektiv ekziston atëherë, kur objekti i kontestit është i njëjtë në të dy paditë.

Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret nuk kemi gjyqvarësi, pasi që nuk ekziston identiteti palëve pasi që në padinë e dytë si paditës janë paraqitur edhe dy paditës tjerë Rexhep Grabanica dhe Labinot Musa Grabanica, të dy nga Vushtrria, të cilët paditës në kontestin e parë nuk kanë qenë të përfshirë. Po ashtu, në këtë kontest si palë paditëse nuk është përfshirë edhe Jakup Grabanica i cili ka qenë palë në kontestin e parë.

Përveç kësaj në rastin konkret nuk kemi asë identitetin e objektit .Kjo për faktin se, në padinë paraprake-të parë, C.nr.51/16 datë 19.5.16, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve: Musa Rexhep Grabanica, Isa Rexhep Grabanica, Avdullah Rexhep Grabanica, Avdurrahman Rexhep Grabanica, Nazim Rexhep Grabanica, dhe Jakup Grabanica që të gjithë nga Vushtrria, ku është kërkuar të vërtetohet se i padituri Nazim Sherif Grabanica, nga Vushtrria më datë 11 deri më datë 14.10.2014, një pjesë të parcelës kadastrale 4430 z.k. Vushtrri, në sipërfaqe prej 21.93m2, ka penguar paditësin në posedimin e lirë të kësaj paluajtshmërie, duke ua marrë nga posedimi këtë pjesë të paluajtshmërisë, dhe paditësit kanë kërkuar marrjen në posedim të kësaj pjese nga i padituri dhe kthimin në posedim paditësve.

Në kontestin e dytë që është objekt shqyrtimi, C.nr.260/2016 datë 31.1.2017, me pjesën e të dispozitivit, është aprovuar kërkesëpadia e paditësit, Nazim Sherif Grabanica, nga Vushtrria dhe është vërtetuar se të paditurit Musa Rexhep Grabanica, Isa Rexhep Grabanica, Avdullah Rexhep Grabanica, Avdurrahman Rexhep Grabanica, Nazmi Rexhep Grabanica, Pajtim Rexhep Grabanica, Labinot Musa Grabanica, të gjithë nga Vushtrria, e kanë penguar paditësin Nazim Grabanica,në shfrytëzimin e patundshmërisë e cila evidentohet në fletën treguese me nr. të protokollit 5761 - parcela kadastrale 4430 z.k. Vushtrri.Me pjesën e II të dispozitivit, urdhërohen

të paditurit që të përmbahen nga aktet e pengimit në posedim dhe iu ndalohet të paditurve që në të ardhmen ta pengojnë paditësin në shfrytëzimin e qetë të parcelës sipërcituar. Me pjesën III të dispozitivit, detyrohen të paditurit për të kompensuar shpenzimet e procedurës paditësit. Me pjesën e IV të dispozitivit, thuhet se ankesa nuk e pengon përmbahimin e këtij aktvendimi (neni 483 par. 3 të LPK-së), dhe afati për përmbahim është i menjëherë me të pranuarit të këtij aktvendimi.

Rrjedhimisht, nga të dhënat e të vërtetuara më lartë, rezulton se në këtë çështje nuk kemi të bëjmë me identitetin e palëve dhe objektit të kontestit, kjo nënkupton se në rastin konkret nuk kemi gjyqvarësi ashtu siç pa bazë theksohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Andaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë parashtruar nga Prokurori i Shtetit të Kosovës nuk ka mbështetje në dispozitën e nenit 247 par. 1 nënpar. (a) të LPK-së Këtë për faktin se aktvendimi kontestues nuk është përfshirë me shkelje të paraqitura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, prandaj kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar.

Nga sa u tha më sipër, me zbatimin e nenit 225 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi CML.nr.9/2016 dt.22.11.2016

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1637/2015 datë 7.3.2016, janë aprovuar si të bazuara ankesat e të paditurve Enver Dërmaku, Sami Dërmaku dhe të autorizuarës së të paditurit Sami Dërmaku, të gjithë nga Prishtina, ndërsa është ndryshuar aktvendimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për çështje civile, C.nr. 2483/09 datë 25.3.2014, ashtu që është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadiat e paditësit Veli Çitaku nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit Sami Dërmaku dhe Enver Dërmaku të dytë nga Prishtina, e kanë penguar paditësin në shfrytëzim të qetë dhe të papenguar të shtëpisë dhe oborrit të tij në Prishtinë, Aktashi 1 nr. 22, evidentuar si ngastër kadastrale nr. 2674/52 në vendin e quajtur "Lagjja e Muhaxherëve", e regjistruar sipas certifikatës UL-7191059-06440, zk Prishtinë, në atë mënyrë që në illim të muajit korrik 2006 e në vazhdim në paluajtshmërinë e tyre që kufizohet me nr. 24, e kanë bërë mbi ndërtimin e paluajtshmërinë e paditësit në Aktash 1 shtëpisë së tyre në distancës prej 1,35 m, nga shtëpia e paditësit, duke i qelë në mbindërtimin e vet 8 dritare me shikim kah shtëpia dhe hyrja në shtëpinë e paditësit, duke ia cenuar të njëjtit privatësinë në shfrytëzimin e lirshëm të shtëpisë familjare, hyrje-daljen e lirë si dhe pamjen e shtëpisë dhe të oborrit që e kishte pasur para ndërtimit të kësaj ndërtese dhe hapjes së këtyre dritareve dhe të urdhërohen të paditurit Sami dhe Enver Dërmaku që menjëherë ta evitojnë aktin e pengim posedimit, duke i mbyllur dritaret nga pika II e dispozitivit dhe që në të ardhmen të përmbahen nga çfarëdo akti të tillë apo të ngjashëm i pengim posedimit

dhe të obligohen të paditurit që në mënyrë solidare t'ia paguajnë paditësit shpenzimet procedurale në lartësi prej 603,60 €, dhe atë për përpilimin e padisë 78 €, për përfaqësim në katër seanca 405,60 €, për ekspert 100 €. Është vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës, brenda afatit ligjor ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë të priset dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Në seancën për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ka qenë prezent prokurori, ndërsa kanë prezantuar i autorizuari i paditësit, i padituri Sami Dërmaku dhe e autorizuar e tij Sadije Mjekiqi, avokate nga Prishtina.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të kundërshtuar sipas nenit 251 të LPK, ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi dhe të paditurit janë shfrytëzues të paluajtshmërië në kufij me njëra tjetrën, ashtu që paditësi shfrytëzon ngastrën kadastrale 2674/52, ndërsa të paditurit shfrytëzojnë ngastrën kadastrale 2674/51, të cilat ngastra gjenden në vendin e quajtur "Lagjja e Muhaxherëve", në Prishtinë. Në dy katet e mbi ndërtuara të paditurit kanë hapur 8 dritare me dimensione 1.40x0.80 m., nga 4 dritare për secilin kat, me pamje nga shkallët e hyrjes, në një dritare të paradhomës së shtëpisë dhe një pjesë të oborrit të paditësit.

Paditësi me padinë e paraqitur më 31.7.2006, ka pretenduar se të paditurit ia kanë cenuar privatësinë në shfrytëzimin e lirshëm të shtëpisë familjare, hyrjen-daljen e lirë si dhe pamjen e shtëpisë dhe të oborrit që e kishte pasur para ndërtimit të ndërtesës - shtëpisë së të paditurve. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.2483/09 datë 25.3.2014, ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe duke zbatuar nenet 70 dhe 75 të LMTHJP, ka vendosur si në dispozitivin e atij aktvendimi.

Në procedurën sipas ankesës gjykata e shkallës së dytë nuk e ka aprovuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aktin e pengim posedimit, nga fakti se nga shtëpia e paditësit e deri te shtëpia e të paditurve ka një distancës rreth 8 metra, ndërsa hapësira në mes të kufirit të paditësit dhe të paditurve është 1.35 metra, pastaj ka ndryshuar aktvendimin e ankimuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktvendimi.

Në bazë të nenit 251 të LPK, kur vendoset për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata do të kufizohet vetëm në ekzaminimin e pretendimeve që i thekson Prokurori i Shtetit në kërkesën e tij. Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës, aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë e ka kundërshtuar për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, ndërsa ka vlerësuar se në

mënyrë të gabuar janë zbatuar nenet 253, 261, 264 dhe nenit 113 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se neni 253 përcakton krijimin e servitutit sendor (kapitulli III); neni 261 përcakton nocionin e servitutit personal ndërsa neni 264 përcakton të drejtën e banimit, të cilat nene hyjnë në kapitullin IV (servitutet personale), ndërsa sipas kërkesëpadisë së paditësit çështja juridike nuk ka të bëjë me servitut sendor e as servitut personal, andaj në këtë drejtim kjo Gjykatë vlerëson se zbatimi i neneve të cekura nuk gjen aplikim në çështjen konkrete juridike.

Sa i përket aktit të pengimit në posedim, kjo Gjykatë pranoi si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë se në rastin konkret nuk ka pengim në posedim, duke pranuar si të bazuar të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë. Për më tepër, bazuar në ekspertizën e gjeodezisë, në fotografitë dhe provat tjera në shkresat e lëndës rezultojnë se distanca në mes dy shtëpive të palëve ndërgjyqëse është 8 metra dhe se shtëpitë lëndore nuk janë të kthyer ballë për ballë me njëra tjetrën, kështu që nuk mund të flitet për cenimin e privatësisë së paditësit me rastin e hyrjes - daljes në oborrin dhe shtëpinë e tij. Pengimi në posedim paraqet çdo veprim me vetëdije të personit të tret me të cilin mbajtësi i sendit është shqetësuar në mënyrën e deri atëherëshme të shfrytëzimit të atij sendi. Kur të paditurit kanë hapur dritaret kontestuese në murin e shtëpisë së tyre, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk kanë penguar paditësin në posedimin e lirshëm të oborrit dhe shtëpisë së tij, duke ia cenuar privatësinë me rastin e hyrjes - daljes në oborrin dhe shtëpinë e tij, ngase përveç faktit se në mes këtyre dy shtëpive ekziston një distancë e konsideruar prej 8 m. dhe se shtëpitë e palëve ndërgjyqëse nuk janë të kthyer ballë për ballë me njëra tjetrën, por edhe se pas hapjes së këtyre dritareve vëllimi fizik i posedimit të oborrit dhe shtëpisë së tij nuk është ngushtuar. I padituri hapjen e këtyre dritareve për shfrytëzimin e dritës dhe të ajrit nuk e ka bërë me qëllim të keqpërdorimit të së drejtës. Edhe pse në kuptim të nenit 7.1 të LPK-ës, paditësi ka pasur barrën e provës, ai nuk ka provuar se i padituri me rastin e ndërtimit të shtëpisë së tij ka hapur dritaret kontestuese duke bërë keqpërdorimin e të drejtës, duke mos pasur nevojë që për shfrytëzimin e dritës dhe ajrosjes t'i hapë këto dritare në murin e shtëpisë së tij. Për këto arsye kjo Gjykatë përfundon se me veprimet e të paditurve nuk është penguar në mënyrë të kundërligjshme paditësi në shfrytëzimin e qetë të oborrit dhe shtëpisë së tij, andaj gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit.

Pretendimi i Prokurorit i cekur në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se me urdhëresën e Drejtoratit të Inspekcionit Komunal të Ndërtimit 09.nr.354 – 3875 datë 4.3.2008, me të cilin është urdhëruar pala e paditur që t'i mbyllë dritaret nga ana e fqinjëve është plotësuar kushti ligjor nga neni 253 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Gjykata Supreme Kosovës vlerëson se në çështjen juridike në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me servitutin sendor, ngase kërkesëpadia e paditësit ka të bëjë me pengim posedim dhe gjykata duke zbatuar nenin 2.1 të LPK, vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 251 të LPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pjesë të shkëputura nga aktvendimi CML.nr.12/2016 dt.10.10.2016

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr. 3894/2014 datë 08.04.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit, dhe është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, C.nr. 25/2014 datë 20.08.2014, në të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit që të vërtetohet se i padituri më datë 16.02.2014, rreth orës 11:00, e ka penguar paditësin e shfrytëzimin e qetë të patundshmërisë së evidentuar si ngastër nr. 266/2, në vendin e quajtur "Zhutica", me sipërfaqe prej 0.60.00 ha, ZK Grackë e Vjetër, në atë mënyre që e ka lëvruar grurin e mbjellë nga paditësi, dhe që të urdhërohet i padituri që në të ardhmen paditësin mos ta pengojë në posedimin dhe shfrytëzimin e qetë të patundshmërisë së përshkruar më lartë, si dhe në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla dhe të ngjashme të pengim posedimit, me kërcënimin e përbarimit me dhunë. Pala paditëse është detyruar që të paditurit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 405.60 €.

Kundër aktvendimeve të lartpërmendura, Prokurori i Shtetit, me kohë ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të prishen të dy aktvendimet e lartpërmendura, dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë në kuptim të nenit 251 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe gjeti se:

Kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se nuk është kontestuese se, patundshmëria lëndore, në evidenca kadastrale në Drejtorinë për gjeodezi kadaster e pronësi, në Komunë të Lipjanit, evidentohet në emër të paditësit, dhe se sipas aktgjykimit të jo plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan C.nr.275/2011 datë 06.09.2013 është vërtetuar se i padituri është pronar i patundshmërisë lëndore, se i padituri në kohën e pretenduar nga paditësi, ka lëvruar patundshmërinë lëndore dhe e ka mbjell me misër edhe pse e njëjta patundshmëri nga ana e paditësit paraprakisht ka qenë e lëvruar dhe e mbjell me grurë, mirëpo gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave nga shkresat e lëndës, e sidomos pas dëgjimit të dëshmitarit Adem Zekës nga fshati Hallaq i Vogël ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet akti i pengimit në posedim, është e pabazuar, me arsyetim se paditësi nuk ka qenë në posedimin e fundit të qetë të patundshmërisë lëndore, por personi i tretë Adem Zeka i cili në

marrëveshje me të paditurin ka ushtruar pushtetin faktik në këtë patundshmëri duke e punuar dhe mbledhur frutat e saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore, për të njëjtat shkaqe e arsye të dhëna nga gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të autorizuarit të paditësit, dhe ka vërtetuar të njëjtin aktvendim, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk pranon si të bazuar qëndrimin juridik të dy gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me refuzimin e kërkesëpadsisë së paditësit, pasi që me këtë rast e drejta materiale gabimisht është zbatuar, dhe për pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të sigurt, kështu që të dy aktvendimet e lartpërmendura u desh doemos që të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Të dy gjykatat e shkallës më të ulët, vendimin e tyre e mbështesin kryesisht në dëshminë e dëshmitarit Adem Zeka, e cila dëshmi sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, nuk është e qartë dhe bindëse në masë të mjaftuar, kjo ngase i njëjti dëshmitar në njërën anë deklaroi se sipërfaqja që është e mbjellë me misër nga ana e të paditurit asnjëherë nuk është shfrytëzuar nga ky dëshmitar, ndërsa në anën tjetër i njëjti dëshmitar deklaroi se atij, paditësi i ka thënë se është duke i punuar edhe 60 ari tokë të paditësit. Megjithatë, në përgjithësi nga dëshmia e këtij dëshmitari rezultoi se ky dëshmitar asnjëherë nuk e ka punuar patundshmërinë lëndore, ndërsa në anën tjetër gjykatat e shkallës më të ulët e konstatojnë të kundërtën. Edhe dëgjimi i paditësit dhe i të paditurit është bërë shumë shkurtë rreth faktit kontestues se deri në lëvizimin e patundshmërisë lëndore nga ana e të paditurit, cili prej palëve ndërgjyqse ka qenë në posedimin e fundit dhe të qetë, kështu që Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se në një gjendje të tillë të çështjes, tani për tani e drejta materiale gabimisht është zbatuar, ngase për të gjykuar sipas kërkesëpadsisë së paditësit, përkritazi me faktet vendimtare për vërtetimin e pengimit në posedim, gjendja faktike ka mbetur e pavërtetuar në mënyrë të plotë.

Për këto arsye në rigjykim, gjykata e shkallës së parë do të evitojë të metat e lartpërmendura ashtu që përkritazi me faktet relevante lidhur me procedurën e pengimit në posedim do të dëgjoj rishtazi dëshmitarin Adem Zeka, sidomos në rrethanat se pasi që nga i padituri i është dhënë me qira sipërfaqja tokësore prej 3.17.00 ha, a i është dhënë me qira edhe sipërfaqja kontestuese e tokës, nëse nuk i është dhënë atëherë të vlerësohet se pse nuk i është dhënë dhe a nuk i është dhënë nga shkak se e njëjta ka qenë në posedim të paditësit. Pastaj, nëse i padituri ia ka dhënë me qira qiramarrësit Adem Zekës edhe këtë sipërfaqe kontestuese të tokës, për çfarë arsye të njëjtën gjatë vitit 2013 dhe 2014 ky qiramarrës nuk e ka punuar, apo arsyeja e mos punimit të saj nga ky qiramarrës është fakti se paditësi gjatë këtyre dy viteve këtë patundshmëri lëndore e paska punuar dhe kështu paska qenë në posedimin e fundit të qetë të saj deri kur i padituri e ka lëvruar këtë patundshmëri të cilën është jo kontestuese se paraprakisht e ka lëvruar paditësi dhe e ka mbjell me grurë. Nga vërtetimi i drejtë ju këtyre fakteve juridikisht të vlefshme varet drejt për drejt zbatimi i drejtë i së drejtës materiale me rastin e vendim marrjes sipas padsisë së paditësit.

Në këtë kontekst, gjykata e shkallës së parë do ti dëgjoj edhe palët procedurale, dhe do ti administroj edhe të gjitha provat tjera nga shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të drejtë të këtyre provave, në këtë çështje juridike do të vendos në mënyrë meritore.

Për arsyet e paraqitura më lartë, dhe në pajtimi me nenin 249 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nenad Lazic

5. SHPRONËSIMI DHE SHPRONËSIMI FAKTIK

5.1 Koncepti i shpronësimit

E drejta e pronës në përgjithësi, pra e drejta e pronësisë mbi paluajtshmërinë, është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe gjithashtu i nënshtrohet mbrojtjes me kushtetutë, ligje dhe akte ndërkombëtare. Megjithatë, kjo e drejtë si e tillë nuk është absolute dhe ka përjashtime të caktuara, situata kur pronarit të paluajtshmërisë i hiqet pronësia kundër vullnetit të tij. Kushtetuta e Kosovës në nenin 46 në paragrafin I garanton të drejtën e pronës, por në paragrafin III thotë “Shpronësimi është, pra, heqje e detyruar e të drejtave pronësore për interes publik dhe është formë e kufizimit të së drejtës pronësore”.

Sipas dispozitave të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, askujt nuk mund t'i hiqet prona, përveçse për interesin publik dhe në kushtet e parashikuara me ligj dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, sepse çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën e gëzimit të papenguar dhe të qetë të pasurisë së vet. Qëndrimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është se pronari ka të drejtën e gëzimit paqësor të pronës dhe se kjo e drejtë korrespondon me detyrën e përdoruesit perfundimtar të pronës së shpronësuar për të paguar kompensimin për pronën e marrë dhe të drejtën për të gëzuar atë.

Sistemet ligjore evropiane garantojnë se askush nuk mund të privohet nga e drejta e pronës përpara se t'i sigurohet kompensimi i drejtë. Kompensimi mund të përcaktohet në dy forma: në natyrë dhe në para. Forma natyrore nënkupton dhënien e një paluajtshmërie tjetër të përshtatshme si pronësi ose bashkëpronësi. Kur bëhet fjalë për pagesën në para, masa e kompensimit nuk mund të jetë më e ulët se vlera e tregut të pasurisë së paluajtshme që shpronësohet.

5.2 Shpronësimi formal dhe faktik

Në rast të shpronësimit formal, marrja e pasurisë bëhet në bazë të aktit juridik të shtetit, ndërsa në rast të shpronësimit faktik, marrja është e kundërligjshme sepse nuk ekziston një akt formal i shtetit në bazë të të cilit kryhet ajo.

Procedura e shpronësimit formal është e rregulluar me Ligjin për Shpronësimin dhe zhvillohet para organit administrativ, në nivel qendror apo lokal, varësisht se kush është përfituesi i shpronësimit. Pas përcaktimit të interesit të përgjithshëm dhe përcaktimit të masës së kompensimit, merret vendimi përfundimtar për shpronësimin. Rregullat e procedurës jokontestimore zbatohen kur ish-pronari i pasurisë së paluajtshme nuk është i kënaqur me kompensimin e përcaktuar me vendim të formës së prerë, andaj masa e dëmshpërblimit përcaktohet para gjykatës jokontestimore dhe përdoruesi përfundimtar urdhërohet që të paguaj kompensimin e specifikuar.

Në procedurën për përcaktimin e kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar, gjykata ka për detyrë të caktojë kompensimin e drejtë që të mos ketë pasurim të pajustificuar të pronarit të paluajtshmërisë dhe varfërim të përfituesit të shpronësimit ose anasjelltas.

Megjithatë, në praktikë, ka situata ku, kundër vullnetit të pronarit dhe pa një vendim formal të autoritetit kompetent, pronarit i hiqet mundësia që të vazhdojë të përdorë pronën e paluajtshme të së cilës është pronar formal, sepse mbi të është ndërtuar një ndërtesë, ose paluajtshmëria është sjellë në ndonjë mënyrë tjetër ne nje gjendje që nuk është e mundur të përdoret e njëjta.

Në rastin e shpronësimit faktik, nuk ekziston një aktvendim i plotfuqishem për shpronësim me të cilin shpronësohet pasuria e paluajtshme e një pronari të caktuar të paluajtshmërisë për shkak se nuk është kryer procedura e shpronësimit dhe gjykata civile është kompetente për të vendosur për shpronësim faktik sepse ka një kontest që duhet zgjidhur pasi pronarit i hiqet e drejta për gëzim të qetë të pronës.

Në rastin e shpronësimit faktik, pronari i pasurisë së paluajtshme ka të drejtë në kompensim që duhet t'i përgjigjet vlerës faktike të pasurisë së paluajtshme të shpronësuar, pra kufizimit të së drejtës ndaj saj. Privimi formal i të drejtave pronësore nënkupton heqjen e të drejtave pronësore në bazë të një akti juridik të autoritetit shtetëror ose një akti të karakterit të së drejtës private, pasojë e të cilit është shuarja e së drejtës së titullarit dhe mbi të njëjtin rast vendoset pronësia e shtetit ose e personave të tjerë juridikë ose fizikë. Format formale të privimit nga të drejtat pronësore përfshijnë shtetëzimin, konfiskimin dhe shpronësimin.

Shpronësimi është heqje e dhunshme e të drejtave pronësore për interes publik dhe është formë e kufizimit apo heqjes së të drejtave pronësore. Në varësi të faktit nëse është miratuar akt juridik i organit shtetëror për shuarjen e të drejtave pronësore të pronarit - bartësit të së drejtës pronësore mbi paluajtshmërinë dhe vendosjen e pronësisë shtetërore, ky kufizim i të drejtave pronësore, përkatësisht shpronësimi, mund të jetë formal ose faktik.

Në rast të shpronësimit faktik ose de facto, heqja e të drejtave pronësore nuk bazohet në vendim të marrë në përputhje me ligjin. Ajo ekziston kur shteti merr masa të caktuara si rezultat i të cilave bartësi i së drejtës në mënyrë efektive pengohet të vazhdojë të përdorë të drejtën e tij, d.m.th. ai de facto privohet nga mundësia për të gëzuar të drejtën e tij.

5.3 Shpronësimi formal - Procedura e shpronësimit

Me shpronësim formal marrja e pasurisë bëhet në bazë të aktit juridik të shtetit, ndërsa me shpronësim faktik marrja është e kundërligjshme sepse nuk ekziston asnjë akt formal i shtetit në bazë të të cilit kryhet ajo. Shpronësimi indirekt ekziston në rast se marrja e pasurisë kryhet pa akt juridik, pra marrja në fillim është e paligjshme, por më pas legalizohet me rregulloren për fitimin e pronësisë nga shteti.

Në të drejtën e brendshme, procedura e shpronësimit formal rregullohet me dispozitat e Ligjit për Shpronësimin, i cili përcakton përfituesit e shpronësimit, subjektin e shpronësimit dhe interesin publik për të cilin kryhet. Shpronësimi mund të bëhet për nevojat e Republikës së Kosovës, komunës, ndërmarrjes publike, partneritetit publiko-juridik ose në kushte të veçanta për nevojat e personit fizik (neni 14 i Ligjit për Shpronësimin).

Interesi publik në shpronësimin e pasurisë së paluajtshme përcaktohet me ligj ose me vendim të Qeverisë në përputhje me ligjin. Shpronësimi kryhet me qëllim të ndërtimit të objekteve ekonomike, banesore, komunale, arsimore, kulturore dhe të tjera të ngjashme me interes të përgjithshëm ose për krijimin e të drejtave të servitutit ose të drejtave të qirasë, siç rregullohet me nenin 4 të Ligjit për Shpronësimin. Pronat e paluajtshme që mund të shpronësohen janë toka, ndërtesa dhe objekte të tjera ndërtimore.

E drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme mund të hiqet ose kufizohet vetëm për interes publik të përcaktuar me ligj ose me vendim të Qeverisë.

Procedura për shpronësim fillon me propozimin e shfrytëzuesit të shpronësimit vetëm pasi të jetë përcaktuar interesi publik për shpronësimin e pronës së paluajtshme në përputhje me ligjin. Procedurës së shpronësimit i paraprin kryerja e veprimeve përgatitore (neni 5 i Ligjit për Shpronësimin), për të përcaktuar dobinë e një paluajtshmërie të caktuar për nxjerrjen e saj në shfrytëzim publik. Pronari i paluajtshmërisë duhet të jetë i informuar për kryerjen e këtyre veprimeve dhe ka të drejtën e kompensimit të dëmit nëse i njëjti është shkaktuar nga kryerja e këtyre veprimeve.

Pas kryerjes së veprimeve përgatitore, fillon procedura e shpronësimit dhe rregullohet me nenet 7-14 të Ligjit për Shpronësimin.

Fillon me paraqitjen e kërkesës për shpronësim, e cila duhet të ketë përmbajtje të caktuar dhe duhet të dorëzohet nga subjekti përkatës dhe kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacion përkatës, siç rregullohet me nenin 8 të Ligjit për Shpronësimin. Pas vendosjes për kërkesën për shpronësim, organi shpronësues publikon vendimin në mënyrën e përcaktuar me nenin 8 paragrafi VIII të Ligjit për shpronësim. Pas publikimit të këtij vendimi, fillon afati prej 30 ditësh për paraqitjen e komenteve dhe kundërshtimeve, dhe 15 ditë pas skadimit të këtij afati do të mbahet seanca publike, në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Shpronësimin.

Pas zbatimit të veprimeve të lartpërmendura, në afatin e ardhshëm prej 30 ditësh merret vendimi preliminar, i njëjti në mënyrën e përcaktuar me nenin 10 të Ligjit për shpronësim, i dorëzohet aplikuesit për shpronësim dhe palëve të interesuara, dhe me pas publikohet. Nëse nuk ka ankesa nga personat që kanë të drejtë të paraqesin të njëjtën, ose ankesat refuzohen nga gjykata kompetente. Brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të vendimit paraprak, afat i cili fillon 45 ditë pas hyrjes në fuqi të të njëjtit, organi shpronësues merr vendim përfundimtar për shpronësimin. Ky afat nuk vlen në rastin kur është paraqitur ankesë derisa gjykata kompetente të ketë marrë

vendim përfundimtar për të. Pas miratimit, vendimi përfundimtar publikohet dhe më pas hyn në fuqi.

Në bazë të vendimit përfundimtar bëhen ndryshimet përkatëse në kadastër dhe pasuria e paluajtshme i dorëzohet përfituesit të shpronësimit.

Pjesë përbërëse e Vendimit Përfundimtar është kompensimi I, pra shuma e kompensimit për ish-pronarin e pasurisë së paluajtshme. Sipas nenit 21 të Ligjit për Shpronësimin, shumën e kompensimit e përcakton Ministria e Financave, e cila është e obliguar të themelojë Zyrën për Vlerësimin e Pronës në kuadër të Departamentit të Tatimit në Pronë. Në punën e saj kjo zyrë mund të punësojë edhe ekspertë nga jashtë, nëse lind nevoja. Kompensimi i vendosur duhet të paguhet brenda dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar të Shpronësimit.

Ish-pronarët të cilët janë të pakënaqur me shumën e kompensimit të caktuar, mund ta kundërshtojnë atë në procedurë jokontestimore pranë gjykatës kompetente. Në atë situatë, gjykata ka detyrimin të përcaktojë një kompensim të drejtë, që është edhe çështje thelbësore e shpronësimit, dhe duhet të gjejë kritere me të cilat do të mbrohen të drejtat e të dyja palëve dhe interesat shoqërore dhe individuale. Kjo do të thotë që marrëdhëniet mes ish-pronarit të paluajtshmërisë dhe shfrytëzuesit të shpronësimit duhet të rregullohen në mënyrë që të mos ketë pasurim të pajustificuar të pronarit të paluajtshmërisë dhe varfërim të shfrytëzuesit të shpronësimit ose anasjelltas. E drejta e pronës mund të hiqet ose kufizohet vetëm për interesin publik të përcaktuar me ligj.

Shpronësimi, si formë e marrjes së detyruar ose kufizimit të së drejtës pronësore të pronarit të pasurisë së paluajtshme, kryhet me kompensim që, sipas Kushtetutës, nuk mund të jetë më i ulët se çmimi i tregut. Përfituesi i shpronësimit i paguan ish-pronarit të paluajtshmërisë së shpronësuar kompensimin, i cili përcaktohet në të holla sipas çmimit të tregut të paluajtshmërisë së shpronësuar dhe sipas rrethanave që kanë ekzistuar në momentin e marrjes së vendimit për kompensim.

Për përcaktimin e masës së dëmshpërblimit të drejtë, gjykata përcakton ekspertizën e duhur. Aktvendimi i marrë nga gjykata ka karakter dënues. Gjykata urdhëron përfituesin e shpronësimit t'i paguajë ish-pronarit kompensim monetar me një çmim të përcaktuar në vlerën e tregut të tokës bujqësore ose ndërtimore të shpronësuar. Duke pasur parasysh se aktvendimi i gjykatës urdhëron përbushjen e aktit, gjykata është e detyruar të caktojë afatin e ndarjes.

Gjykata përcakton në dispozitiv të aktvendimit se përfituesi i shpronësimit është i detyruar të paguajë kamatë për shumën e caktuar të kompensimit deri në pagesën përfundimtare të tij. Aktvendimi i gjykatës në procedurën për përcaktimin e dëmshpërblimit për paluajtshmërinë e shpronësuar, përveç vendimit për lartësinë e kompensimit për tokën bujqësore të shpronësuar, mund të përmbajë edhe vendimin për lidhjet e mundshme të paluajtshmërisë së shpronësuar, si p.sh. pemë, objekte të ndërtaura, të mbjella, etj.

Gjykata mund të marrë vendim për kompensimin e sendeve të mundshme nëse ato kanë ekzistuar në momentin e shpronësimit dhe nëse pronari i paluajtshmërisë së shpronësuar nuk ka abuzuar me të drejtën e pronësisë. Në atë rast aktvendimi përcakton shumën monetare që duhet të paguajë shfrytëzuesi i fundit i shpronësimit në emër të përmishteve, plantacioneve etj. Shpenzimet e procedurës i bartë përdoruesi përfundimtar sepse procedura zhvillohet në interes të tij.

''Pjesë përbërëse e vendimit përfundimtar për shpronësim është edhe shuma e përcaktuar e kompensimit për pasurinë e paluajtshme të shpronësuar ose pjesë të saj. Neni 16 i ligjit përkatës parashikon se pagesa bëhet nga organi i shpronësimit ose kërkuesi, përkatësisht nga përfutuesi i pritshëm i shpronësimit nëse ai ekziston.

Neni 36, paragrafi 8 i Ligjit për Shpronësimin e Pasurive të Paluajtshme parashikon detyrimin e organit shpronësues, përkatësisht kërkuesit ose shfrytëzuesit, që t'i paguajë ish-pronarit diferencën në masën që gjykata të konstatojë se vlera e paluajtshmërisë së shpronësuar është më e madhe se ajo e përcaktuar me vendim përfundimtar.

Në kuptim të dispozitave ligjore të lartpërmendura, del qartë se obligimi për të paguar kompensim shtesë për pronën e paluajtshme të shpronësuar i takon përfutuesit të shpronësimit, dhe se Qeveria e Kosovës është autoritet, d.m.th. në kuptim të ligjit në fjalë, organi që kryen procedurën e shpronësimit, kryen veprime teknike, faktike dhe juridike në situatat kur shpronësimi kryhet për të arritur interesa të rëndësishme publike dhe nacionale.

Për arsyen e cekur, nuk është e pranueshme që të detyrohet kundërpropozuesi i Qeverisë së Kosovës që t'i paguajë ish-pronarit diferencën në mes të vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë së shpronësuar dhe vlerës së përcaktuar në vendimin përfundimtar të Qeverisë së Kosovës, por me këtë obligim është dashur të ngarkohet përfutuesi i shpronësimit, në rastin konkret KOSTT. Qeveria e Kosovës legjitimohet pasivisht në pjesën që ka të bëjë me kontestimin e ligjshmërisë së vendimit të formës së prerë apo shumës së kompensimit të përcaktuar për pasurinë e paluajtshme të shpronësuar, por jo edhe kur bëhet fjalë për detyrimin për të paguar diferencën në mes të kompensimit të përcaktuar me aktin përfundimtar vendim dhe atë të përcaktuar në procedurë gjyqësore.

Ekstrakt nga vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 20/24 te dt. 28.05.2024.

5.4 Shpronësimi faktik

Shpronësimi faktik, (i plotë ose i pjesshëm) ekziston në rastet e ndërtimit të objekteve ose kryerjes së punëve në interes të përgjithshëm publik, kur i hiqet ose kufizohet plotësisht ose pjesërisht e drejta e pronës, pra e drejta për gëzimin paqësor të pronës me ligj ose personat fizik në pasuri të paluajtshme pa vendim të organit kompetent. Shpronësimi faktik më së shpeshti ndodh kur në një tokë ndërtohen rrugë, infrastruktura apo objekte të tjera me interes publik dhe të përgjithshëm, edhe pse më parë nuk është marrë vendim për shpronësim dhe nuk ka vendim – aktvendim.

Ndërtimi i një objekti me interes publik mbi pasurinë e paluajtshme të një personi rezulton në heqjen faktike të së drejtës pronësore, pavarësisht se e drejta pronësore e atij personi nuk i është hequr formalisht me vendim të organit kompetent në procedurën e parashikuar me ligj.

Shpronësimi faktik ndodh rregullisht kur në bazë të akteve planifikuese të njësisë së vetëqeverisjes lokale, në tokat e të tjerëve ndërtohen rrugë, infrastruktura ose objekte të tjera me interes publik, edhe pse nuk ka aktvendim për marrje te tokës. Kur një tokë është caktuar për rrugë me akt plan urbanistik të njësisë së vetëqeverisjes lokale, që nga ai moment ajo bëhet pasuri në pronësi publike me fuqinë e ligjit. Prandaj, njësia e vetëqeverisjes lokale është e detyruar të shpronësojë tokën që është kthyer në mjet pronësie publike - ta përjashtojë atë nga prona dhe gjendja e pronarit të mëparshëm dhe t'i paguajë atij kompensimin përkatës.

Në një situatë kur toka përvetësohet me ndërtimin e një objekti të planifikuar në përputhje me aktin e planifikimit dhe bëhet pronë publike me fuqinë e ligjit, bëhet transformimi i pronësisë dhe pronari i tokës së cilës de facto i është marre pasuria e paluajtshme nuk mund të pësojë pasojë të dëmshme sepse organi kompetent nuk ka kryer procedurën administrative dhe ka marrë aktvendim për shpronësimin e tokës nga pronësia e pronarit, i cili do të ishte bazë për pagesën e kompensimit për tokën e marre. Kur toka përvetësohet faktikisht, nuk është më e mundur kthimi i saj në pronësinë e pronarit (ose përdoruesit) të mëparshëm, as nuk mund të ushtrojë të drejtën e kompensimit në procedurën administrative, sepse nuk ka pasur shpronësim formal dhe mundësia e vetme e mbrojtjes juridike për pronarin është procedura kontestimore, si metodë bazë dhe e rregullt e mbrojtjes juridike.

Termi shpronësim faktik është adekuat dhe i saktë sepse është marrje faktike e pasurisë së paluajtshme pa vendimin e organit kompetent dhe procedurën e zbatuar.

'' Nisur nga gjendja faktike e deklaruar, gjykatat e instances më të ulët kanë pranuar kërkesën e paditësve për pagesën e dëmshpërblimit monetar për shpronësimin faktik të truallit që është në bashkëpronësi të paditësve, duke gjykuar se në një situatë ku toka është de facto e sjellë në qëllimin e synuar (pervetësuar), nuk është e mundur të kthehet në gjendjen e pronarit (përdoruesit) të mëparshëm dhe nuk është e mundur të merret dëmshpërblim në një procedurë tjetër sepse nuk ka pasur shpronësim formal, e vetmja mundësi e mbrojtjes ligjore ekziston përmes institutit të shpronësimit faktik.

Neni 1, paragrafi 1 i Protokollit të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut parashikon se çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën e gëzimit të papenguar të pasurisë së tij dhe se askujt nuk mund t'i hiqet prona e tij përveçse për interesin publik dhe në kushte të parashikuara me ligj dhe parimi i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare. Paragrafi 2 i të njëjtit nen parashikon se dispozitat e mëparshme nuk do të cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e shtetit për të zbatuar ligjet që i sheh të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pronës në përputhje me interesat e përgjithshme ose për të siguruar mbledhjen e taksave ose detyrimeve ose gjobave të tjera.

Neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton të drejtën e pronës, ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen thotë se “Askujt nuk mund t'i hiqet prona arbitrarisht”. Republika e Kosovës ose autoritetet publike të Republikës së Kosovës mund të shpronësojnë nëse është në përputhje me ligjin, nëse është e nevojshme ose adekuate për të arritur qëllimet publike ose për të mbështetur interesin publik, dhe për të cilën bëhet kompensimi adekuat i menjëhershëm ndaj personit ose personat të cilëve u shpronësohet pasuria. Paragrafi 4 i të njëjtit nen të Kushtetutës parasheh: “Për kontestet e shkaktuara me akt të Republikës së Kosovës ose të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, të cilat konsiderohen si shpronësim, vendos gjykata kompetente”.

Nga dispozita kushtetuese e sipërpërmendur, rezulton se marrja e lejuar e të drejtave pronësore, e cila nuk përbën shkelje të së drejtës së pronës, ekziston vetëm kur plotësohen dy kushte kumulative: të jetë bërë për interesin publik, të përcaktuar në bazë të të ligjit, dhe se është bërë me kompensim që nuk mund të jetë më i ulët se i tregut.

Ndërtimi i një objekti me interes publik në tokën e një personi rezulton me heqjen e të drejtave pronësore, pavarësisht se atij personi nuk i janë hequr të drejtat pronësore formalisht. Në një situatë të tillë, bëhet fjalë për një shpronësim faktik që ndodh kur në tokë ndërtohen rrugë, infrastrukturë apo objekte të tjera në interes publik, edhe pse nuk ka aktvendim për marrjen e tokës. Në një situatë kur, si në këtë rast, toka është përvetësuar dhe me forcën e ligjit ka kaluar në pronësi publike të të paditurve, pra ka kaluar nën administrimin e tyre, paditësit si pronarë të truallit nuk mund të pësojnë pasojë të dëmshme për shkakun se organet kompetente nuk kanë zbatuar procedurën e paraparë dhe ka marrë aktvendim për përjashtimin e tokës nga posedimi që do të ishte bazë për pagesën e kompensimit për tokën e përjashtuar”.

Ekstrakt nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 379/2020 i datës 08 mars 2022.

Shpronësimi faktik mund të shfaqet edhe si kufizim i të drejtave pronësore mbi pasurinë e paluajtshme duke përbërë të drejtën e servitutit mbi paluajtshmërinë e pronarit. Kur servituti bazohet në vendimin e organit shtetëror, në procedurë dhe në mënyrën e përcaktuar me Ligjin për Shpronësimin, shuma e kompensimit për shkak të uljes së vlerës së tregut të tokës (pronës shërbyese) mund të përcaktohet sipas dispozitave të Ligjit për Shpronësimin, ndërsa në rastet kur privimi ose kufizimi i së drejtës mbi pronën e paluajtshme kryhet pa vendim të organit shtetëror, dispozitat e Ligjit për shpronësim nuk zbatohen.

Në rastin e shpronësimit faktik, pronari i pasurisë së paluajtshme ka të drejtën e kompensimit që duhet të korrespondojë me vlerën reale të pasurisë përkatese të paluajtshme, përkatesisht në masën e kufizimeve të të drejtave të krijuara mbi të. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila përdor termin “shpronësim de facto”, në një numër të madh vendimesh shpreh qëndrimin se në rastin e shpronësimit faktik, duhet të arrihet një ekuilibër ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe të drejtës së individit për gëzimin paqësor të pasurisë së tij dhe se cenimi i së drejtës për gëzimin paqësor të pronës ekziston deri në momentin derisa të vendoset ekuilibri i interesave, gjë që në situatën e dhënë do të ndodhë vetëm kur pronari të kompensohet në mënyrë adekuate.

Ndërhyrja e shtetit në gëzimin paqësor të pronës duhet të bazohet në ligj dhe të justifikohet për interesin publik dhe ligjin.

Nëse bëhet fjalë për shpronësim faktik apo jo, gjykata duhet të ketë kujdes, sepse për ekzistimin e një shpronësimi faktik është e nevojshme që paluajtshmëria të jetë shpronësuar nga pronari pa u marrë vendim formal për shpronësim dhe kjo të jetë bërë në interes të publikut, pa vullnetin e pronarit.

'' Procedura për përcaktimin e interesit publik dhe zbatimin e shpronësimit, si dhe përcaktimin e kompensimit për pasurinë e paluajtshme të shpronësuar, rregullohet në detaje me Ligjin për Shpronësimin.

Mirëpo, në praktikë ndodh që kjo procedurë të mungojë, që autoriteti publik, qoftë në nivel lokal apo qendror, të përvetësojë tokë private, duke përmbushur disa interesa publike dhe e gjithë kjo të mos shoqërohet me një procedurë të përshtatshme, miratimin e një akti përkatës, as të mos i jepet ish pronarit kompensimi i duhur. Në rastet e përmendura bëhet fjalë për shpronësim faktik. Me fjalë të tjera, shpronësimi de facto ndodh në mënyrën që një autoritet publik merr pronën private të një qytetari për të ndërtuar një objekt me interes publik.

Para fillimit të çdo pune, organi kompetent është i detyruar të kryejë procedurën e shpronësimit dhe t'i paguajë pronarit privat dëmshpërblim për pronën e shpronësuar, kompensimi i së cilës nuk mund të jetë më i ulët se vlera e tregut të pronës së shpronësuar, por në praktikë, thjesht, ndonjëherë nuk ndodhë kështu.

Nëpërmjet institutit të shpronësimit faktik, pronarët e tokave mbrohen në raport me bashkitë dhe organet e tjera shtetërore që vetë ose nëpërmjet të tretëve organizojnë ndërtimin e të mirave publike dhe të tjera në tokë që nuk është shpronësuar zyrtarisht.

Megjithatë, në situatën konkrete nuk është kështu. Pasuria e paluajtshme në fjalë nuk është shndërruar në rrugë nga ana e te paditurit, por është bërë nga vetë paditësi, gjatë nënndarjes dhe bashkimit të paluajtshmërisë, pronar i së cilës ai ka qenë. Prandaj, në rastin konkret nuk ka asnjë interes publik që do ta shtynte të paditurin në kalimin e pasurisë së paluajtshme në fjalë nga toka bujqësore në tokë rrugore, por siç u tha tashmë, paditësi e ka bërë vetë. Fakti që i padituri ka asfaltuar pasurinë e paluajtshme në fjalë nuk është relevant në këtë rast konkret. Nuk ka shpronësim faktik nëse pronari i së drejtës së pronës me dëshirë heq dorë nga kompetencat e pronësisë, i udhëhequr nga realizimi i përfitimeve ekonomike që nuk mund t'i realizojë sërish, sepse kompensimi në rastin konkret do të përfaqësonte pasurim të pajustificuar. E thënë më thjeshtë, i padituri nuk ka paraparë që paluajtshmëria në fjalë të shërbejë si rrugë publike gjatë përgatitjes së planit hapësinor, por e njëjta pasuri e paluajtshme është shndërruar në rrugë nga vetë paditësi gjatë bashkimit dhe ndarjes së pasurisë së paluajtshme në pronësi të tij, ose pronar i së cilës ishte.

Lidhur me këtë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në këtë rast konkret nuk ka ndërhyrje të shtetit në gëzimin paqësor të pasurisë së paditësit dhe as autoritetet publike nuk do të përmbushnin ndonjë interes të përgjithshëm publik për qëllimin e të cilit do të ishte i nevojshëm shpronësimi i pronës së paluajtshme të kontestuar.

Për arsyen e cekur, në veprimet e të paditurit nuk ka shkelje të të drejtave pronësore të paditësit dhe as nuk ka shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura si me kushtetute ashtu edhe me konventa përkatëse evropiane, kështu që detyrimi i të paditurit për t'i paguar dëmshpërblimin paditësit do të ishte në kundërshtim me ligjin dhe, siç u tha tashmë, do të përfaqësonte një kompensim për pasurimin e pabazuar të paditësit. "

Nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 170/24 te dt. 17.07.2024.

5.5 Juridiksioni aktual i gjykatës

Në rastin e shpronësimit faktik, nuk ekziston një vendim i formës së prerë për shpronësim me të cilin shpronësohet paluajtshmëria e një pronari të caktuar të paluajtshmërisë si një nga parakushtet për zhvillimin e procedurës jokontestimore pranë gjykatës kompetente jokontestimore me qëllim të përcaktimit të kompensimit për pasurinë e paluajtshme të shpronësuar.

Gjykata civile kompetente për të vendosur për shpronësimin faktik. Në rastin e shpronësimit faktik, ekziston një mosmarrëveshje ndërmjet pronarit dhe njësisë së vetëqeverisjes lokale ose një pale të tretë për kompensimin e pasurisë së paluajtshme të uzurpuar ose të marrë. Për caktimin e dëmshpërblimit është përgjegjës gjykata civile, sepse në atë rast në procedurën kontestimore konstatohet nëse ka ndodhur shpronësim faktik për t'i ofruar mbrojtje juridike pronarit të paluajtshmërisë kur vetë njësia e vetëqeverisjes lokale ose nëpërmjet palëve të treta organizon ndërtimin e objekteve publike dhe të tjera infrastrukture në tokën që nuk është shpronësuar zyrtarisht dhe përcakton kompensimin për pronën e paluajtshme të marrë.

Duke pasur parasysh se marrëdhëniet pronësore juridike ndërmjet përfituesve të shpronësimit dhe pronarëve të pasurive të paluajtshme zgjidhen nga një gjykatë civile në rast mosmarrëveshjeje, kompensimi për pasurinë e paluajtshme të shpronësuar faktikisht vendoset nga një gjykatë civile dhe jo një gjykate (procedure) jokontestimore. Mirëpo, nëse organi administrativ ka marrë vendim për vendosjen e servitutit mbi pasurinë e paluajtshme për një periudhë të caktuar për interes publik, atëherë për masën e dëmshpërblimit është kompetente gjykata jokontestimore.

5.6 Shpronësimi faktik dhe vendosja e servitutit në bazë të ligjit

Në praktikën e gjykatave civile kontestohet nëse ishte shpronësim jo i plotë apo shpronësim faktik dhe cila gjykatë është e detyruar të vendosë për dëmshpërblimin në situatën kur është vërtetuar servituti real me faktin se kabllo e energjisë elektrike kalojnë sipër ngastrave

kadastrale të pronarëve, edhe pse procedura e shpronësimit nuk është kryer në mënyrën e paraparë me dispozitat e Ligjit për shpronësim, gjegjësisht kur këto ngastra nuk janë shpronësuar, as prona mbi to nuk është e kufizuar në procedurë dhe në mënyrën e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Shpronësimin.

Në rastin e sipërpërmendur, nuk bëhet fjalë për shpronësim jo të plotë, kur është vërtetuar një servitut real në lidhje me parcelat kadastrale mbi të cilat kalojnë kabllo të energjisë elektrike në rrugë ajrore, edhe pse nuk është kryer procedura e shpronësimit, d.m.th. , kur ngastrat në të cilat është konstituuar servituti sendor nuk janë shpronësuar dhe as pronësia e tyre nuk kufizohet në procedurë dhe në mënyrën e përcaktuar me Ligjin për Shpronësimin. Në situatën e sipërpërmendur bëhet fjalë për konstituimin e servitutit real juridik sipas dispozitave të nenit 51 të Ligjit mbi bazat e marrëdhënieve pronësore, jo për shpronësim faktik, pra për natyrën juridike të dëmshpërblimit që i përket pronarit të pronës shërbyese është e natyrës juridike reale. Kompensimi që i takon pronarit të pronës shërbyese në këtë rast e ka bazën në të drejtën reale sepse bëhet fjalë për konstituimin e servitutit sendor juridik, dhe jo mbi bazën e kompensimit për shkak të shpronësimit faktik.

5.7 Parashkrimi

Kërkesa për dëmshpërblim, në rastin e paluajtshmërisë së shpronësuar faktikisht, nuk parashkruhet, ashtu siç nuk parashkruhen të drejtat për mbrojtjen e të drejtave pronësore. Në të kundërt, parashkrimi i kërkesave për dëmshpërblim për pasuritë e paluajtshme të shpronësuara në rastin e shpronësimit formal, kur kompensimi është përcaktuar, por nuk është paguar, parashkruhet sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të detyrimeve.

‘‘ Shpronësimi, pavarësisht nëse përcaktohet nga ligji aktual apo ligji që ka qenë më parë në fuqi, është marrja e pasurisë së paluajtshme, në radhë të parë tokës në pronësi private dhe kalimi i saj në pronë shoqërore, me kompensimin e duhur ndaj ish-pronarit.

Nëse kalimi i tokës nga pronësi private në pronësi shoqërore ndodh pa një vendim përkatës të autoritetit kompetent, ky kalim konsiderohet shpronësim de facto. Në rastin konkret, bëhet fjalë për tokë që ka qenë dhe është ende në pronësi shoqërore para vitit 1999, kështu që nuk mund të bëhet fjalë për ndryshimin e pronarit, qoftë me shpronësim, qoftë me shpronësim faktik. Nga ana tjetër, nga provat e bashkangjitura, rezultojnë qartë edhe se paditësi ka qenë në proces të fitimit të të drejtës së përdorimit të përhershëm të lokalit që do të ndërtohej dhe të drejtës së shfrytëzimit të truallit nën objekt, por nuk ka dëshmi se ajo e ka fituar këtë të drejtë, as në çfarë faze ka qenë ndërtimi i objektit dhe nëse ka përfunduar dhe më pas është rënuar apo as që ka filluar ndërtimi. Është e padiskutueshme se i pandehuri është pasardhës ligjor i ish-Komunës së Pejës dhe se vendimet e autoriteteve ekzistuese të mëparshme dhe të drejtat e fituara me të njëjtat vendime e detyrojnë edhe të pandehurin. Rrjedhimisht, e drejta e paditësit për kompensimin e dëmit lind padiskutim nëse këto vendime janë anuluar në mënyrë të paligjshme, janë shfuqizuar ose efekti i tyre ka pushuar në ndonjë mënyrë tjetër. Mirëpo, në atë rast ka qenë e udhës që të parashtrrohet padia si e tillë dhe të kërkohet kompensimi i dëmit të pësuar nga paditësi si rezultat i veprimeve të autoriteteve të të paditurit, nëse konstatohet se veprimet kanë qenë të kundërligjshme.

Nuk mund të pranohet si rishikim i vlefshëm pretendimi se, gjatë procedurës, gjykata nuk ishte e lidhur me bazën ligjore të kërkesëpadisë, siç thuhet në padi, dhe se gjykata kishte mundësinë të zhvillonte procedurën sipas padisë për dëmshpërblim, pavarësisht se në padi si bazë juridike është cekur shpronësimi faktik. Kjo për faktin se këto dy baza juridike, përveç dallimit teorik, kërkojnë edhe veprime të ndryshme nga gjykata gjatë zbatimit të procedurës dhe krijojnë mundësi të ndryshme për paraqitjen e kundërshtimeve juridike procedurale dhe materiale.

Në kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shpronësimi faktik nuk ekziston mundësia e parashkrimit, ndërsa në kompensimin e dëmit të kryer nga organet shtetërore ekziston mundësia e parashkrimit dhe e njëjta rregullohet me dispozitat e neneve 360-370 LMD, ndërsa afatet e parashkrimit janë të përcaktuara në nenet 371-380 LMD, dhe rrethanat që ndikojnë në pezullimin dhe ndërprerjen e parashkrimit janë të përcaktuara në nenet 381-393 të LMD.

Prandaj, për arsytet e lartpërmendura, gjykatat e instancës më të ulët kanë qenë të detyruara të procedojnë sipas padisë, gjegjësisht bazës juridike në të cilën bazohet, pikërisht siç ka deklaruar paditësi në padi, pa mundësinë e zbatimit të nenit 2, paragrafi 2. LPK."

Ekstrakt nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 552/2020 e datës 21.03.2022.

5.8 Në vend të një përfundimi

Duke pasur parasysh situatat e lartpërmendura, dhe rëndësinë e shpronësimit, dhe mbi të gjitha nevojën për të gjetur një ekuilibër midis mbrojtjes së njëres prej të drejtave themelore të njeriut - të drejtës për pronë private, dhe nevojës që autoritetet të zbatojnë projekte me interes publik, të së mirës së përbashkët, nga praktika e deritanishme vërehet se nuk ka pasur probleme të mëdha në procedurën e shpronësimit, si për përcaktimin e interesit të përgjithshëm, ashtu edhe në zbatimin e fazave të tjera të procedurës së shpronësimit, me përjashtim të rasteve kur është fjala për përcaktimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme të shpronësuar, pra përcaktimin e masës së kompensimit që duhet t'u paguhet ish-pronarëve. Nëse jo të gjitha, atëherë pjesa dërrmuese e procedurave në gjykatë kanë të bëjnë me masën e kompensimit të ish-pronarëve për pasuri të paluajtshme të shpronësuar. Ka pasur situata ku dëmshpërblimi që është përcaktuar si i drejtë para gjykatës ka qenë shumë herë më i lartë se ai i përcaktuar me Aktin e Vlerësimit kur është nxjerrë Vendimi Përfundimtar.

Gjykatat kryesisht e bazuan vendimin e tyre në gjetjet e ekspertëve, dhe ekspertizat shumë shpesh ndryshonin në shumë mënyra, kështu që ishte e nevojshme të përcaktohet ekspertiza e një grupi ekspertësh. Këtu vihet re se gjykatat duhet të kenë një rol më aktiv dhe një qëndrim shumë më kritik në vlerësimin e këtyre provave, sepse provat e ekspertizës duhet të vlerësohen si të gjitha provat e tjera, si në raport me vetë konstatimin ashtu edhe në raport me provat e tjera të paraqitura.

"Me këtë gjendje të fakteve, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykatat e instancës më të ulët me rastin e marrjes së vendimit kontestues kanë zbatuar drejt të drejtën materiale, gjegjësisht dispozitat përkatëse të Ligjit për Shpronësimin, gjegjësisht nenet 15 dhe 22 të tij, duke marrë parasysh të gjitha elementet thelbësore dhe te nevojshme, si dhe kriteret e

përcaktuara me ligj, për përcaktimin e dëmit real që ka pësuar paditësi, si nga shpronësimi, ashtu edhe në pjesën e pashpronësuar të pasurisë në fjalë. Gjykata Supreme nuk do të deklarojë këtu kriteret dhe elementet e përcaktuara me Ligjin për Shpronësimin, në bazë të të cilave përcaktohet vlera e pasurisë së paluajtshme të shpronësuar, si dhe zvogëlimi i vlerës së pjesës së mbetur të pasurisë së paluajtshme për shkak të shpronësimit të pjesës, por që pas studimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ato janë zbatuar drejt nga palët e gjykatave të instancës më të ulët. Duke qenë se fakti i shpronësimit dhe i pasurisë së paluajtshme mbi të cilën është kryer është i pakontestueshëm, u desh të përcaktohet si kompensimi i drejtë për pjesën e shpronësuar të pasurisë së paluajtshme, ashtu edhe kompensimi për uljen e mundshme të vlerës së pjesës së pashpronësuar të pasurisë së paluajtshme, nëse ajo ekziston dhe është pasojë e shpronësimit.

Gjykata, për të konstatuar faktet për të cilat nuk ka njohuri eksperte, ose nuk i ka në masë të mjaftueshme, angazhon ekspertë. Mirëpo, roli i gjykatës nuk përfundon me angazhimin e ekspertit, duke marrë konstatimet e ekspertit si një fakt që nuk mund të verifikohet. Përkundrazi, gjykata vlerëson konstatimet e ekspertëve si dhe të gjitha provat e tjera, si individualisht ashtu edhe në lidhje me të gjitha provat e tjera. Gjykata, natyrisht, në këtë mënyrë nuk cenon personalitetin, njohuritë dhe ndërgjegjen e ekspertit, por vlerëson konstatimet e ekspertit dhe në fund, në përputhje me përfundimin e arritur, ia beson besimin ekspertit tërësisht ose pjesërisht. Përndryshe, pa një shqyrtim kritik të konstatimeve të ekspertit, si dhe të ndonjë prove tjetër, papritur do të përfundonim në një situatë ku vendimi merret nga eksperti, dhe gjyqtari vetëm përgatit një kopje me shkrim të të njëjtës dhe nënshkruan atë."

Nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 63/2023 dt. 16.06.2023.

Milena Djerić

6. PROCEDURA E GJYKATËS SUPREME NË NJË SITUATË KUR REVIZIONI TREGON DËSHTIMIN E GJYKATËS SË APELIT PËR TU PËRGJIGJUR NDAJ TË GJITHA PRETENDIMEVE ANKIMORE

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka krijuar dhe përsosur praktikën e veprimit dhe të vendosjes për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, në mënyrë që të ekzistojnë standardet e duhura për të drejtën për një vendim të arsyetuar në procedurën civile.

Shembulli më i mirë për këtë është aktgjykimi "Wagner dhe J. M. W. L. kundër Luksemburgut" nr. [76240/01](#) i datës 28.06.2007. Në aktgjykimin e lartpërmendur, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut theksoi se e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën e palëve për të paraqitur pretendime që i konsiderojnë të rëndësishme për çështjen e tyre. Dispozita e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e detyron autoritetin gjyqësor të shqyrtojë në detaje pretendimet, argumentet dhe provat e paraqitura nga palët pa paragjykim në lidhje me vlerësimin e rëndësisë së tyre. Shtrirja e detyrimit për të dhënë arsye sipas nenit 6 përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit të caktuar. Në rastin konkret, u theksua se kërkuetit parashtuan disa arsye ankimi në Gjykatën e Apelit vendas që do të hidhnin poshtë konsistencën e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe se Gjykata e Apelit vendase në aktgjykimin e saj të 6 korrikut 2000, nuk iu përgjigj atyre akuzave. Edhe pse gjykatave nuk mund t'u kërkohej të deklarojnë të gjitha arsyet për refuzimin e çdo argumenti të një pale, ato nuk janë të lira nga detyrimi për të kryer një shqyrtim të plotë të arsyeve dhe për t'iu përgjigjur kundërshtimeve themelore të ngritura nga pala. Kur, përveç kësaj, këto kundërshtime i referohen "të drejtave dhe detyrimeve" të garantuara me Konventën dhe protokollet e saj, gjykatat vendore janë të detyruara t'i shqyrtojnë këto kundërshtime me kujdes dhe vëmendje të veçantë. Gjykata e Apelit vendore nuk iu përgjigj ankesave të kërkuetve dhe Gjykata e Lartë e Kasacionit vendas mbështeti vendimin e Gjykatës së Apelit, kështu që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi se e drejta për një gjykim të drejtë, e parashikuar në nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, është shkelur.

E drejta për një gjykim të drejtë, e parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, për një kohë të gjatë është perceptuar nga publiku ynë kryesisht nga këndvështrimi i së drejtës për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Përqendrimi i publikut në atë segment të dispozitës së nenit 6 është plotësisht i kuptueshëm, duke pasur parasysh efikasitetin ose joefikasitetin e gjyqësorit vendas deri tani. Megjithatë, e drejta për një gjykim të drejtë përbëhet nga një sërë kompetencash të ndërlidhura, një prej të cilave është e drejta për një vendim gjyqësor të arsyetuar.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në bazë të praktikës së mëparshme gjyqësore, me rastin e padive të ngritura dhe procedurave të zhvilluara në lidhje me dispozitën e nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, krijoi standardet e gjykimin të arsyetuar, gjegjësisht:

1. Gjykatat/tribunalet janë të detyruara të deklarojnë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për vendimet, d.m.th. ata janë të detyruar të arsyetojnë veprimet e tyre duke arsyetuar vendimet e tyre.
2. Arsyet mbi të cilat bazohet aktgjykimi janë të përshtatshme nëse: a) u lejojnë palëve të ushtrojnë efektivisht të drejtën për mjet juridik dhe b) nëse bazohen në legjislacionin nacional në fuqi.
3. Gjykatat/tribunalet e revizionit janë të detyruara të korrigjojnë mangësitë në argumentimin e gjykatave të instancës më të ulët nëse një nga pretendimet kryesore të palës në procedurën e revizionit është se argumentimi i gjykatës/tribunalit të shkallës së parë është i papërshtatshëm, jo koherent ose kontradiktor.
4. Si rregull, gjykatat e revizionit duhet të vendosin për parashtresat kryesore të palëve nëse ato kanë qenë objekt diskutimi në shkallën e parë, pavarësisht nëse ato janë shprehur shprehimisht kur është parashtruar mjete juridik, dhe heshtja e gjykatës së revizionit nuk mund të interpretohet si refuzim i heshtur i kundërshtimit.
5. Aktgjykimi duhet të formulohet mjaft qartë që publiku ta kuptojë atë në masën e nevojshme për të ruajtur besimin e publikut në gjyqësor.
6. Konceptet e papërcaktuara juridike (standardet juridike) që nuk shtjellohen në mënyrë adekuate në vendim, dokumente normative apo në praktikën gjyqësore, pra përmbajtja e tyre nuk mund të përcaktohet me siguri, kanë efekt të kufizuar në procedurë në kuptimin që vendimi nuk mund të jetë tërësisht i bazuar në to.
7. Të gjitha çështjet kyçe të një çështjeje duhet të merren parasysh dhe kjo duhet të jetë e qartë nga vetë vendimi.
8. Gjykata/tribunali është i detyruar të shqyrtojë materialet, argumentet dhe provat e paraqitura nga palët, pavarësisht nga përshtypjet nëse të gjitha materialet, argumentet dhe provat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit.
9. Nëse parashtresat e palëve janë vendimtare për rezultatin e kontestit, përgjigja e gjykatës/tribunalit në nivel nacional duhet të tregohet shprehimisht në aktgjykim.
10. Kur ka një kërkesë nga një palë që ka të bëjë me të drejtat dhe liritë e garantuara me Konvente, gjykatat nacionale janë të detyruara ta shqyrtojnë kërkesën në detaje dhe me kujdes.
11. Arsyetimi i aktgjykimit duhet të përmbajë analizën e proporcionalitetit sa herë që objekt i aktgjykimit është rasti në të cilin të drejtat e njeriut cenohen me ndonjë masë shtetërore ose ekziston frika se të drejtat e njeriut do të cenohen.
12. Autoritetet shtetërore, duke përfshirë gjykatat/tribunalet, duhet të zbatojnë legjislacionin vendas në një mënyrë të parashikueshme dhe të qëndrueshme.
13. Në praktikën gjyqësore në nivel nacional, nuk duhet të ketë dallime të thella dhe afatgjata në vendime për çështje të njëjta apo të ngjashme.
14. Zbatimi i normave ligjore thelbësisht të ngjashme ndaj personave që i përkasin grupeve pothuajse identike duhet të jetë uniform, ashtu si duhet të ekzistojë një mekanizëm për të zgjidhur çdo mospërputhje.
15. Praktika e gjykatave më të larta në vend duhet të jetë konsistente në masën më të madhe të mundshme. Konsistenca nënkupton respektimin e parimit të sigurisë juridike, që

nënkupton kryesisht vendosjen në përputhje me vendimet e mëparshme të gjykatave të instancës më të lartë në rastet që janë të njëjta ose thelbësisht të ngjashme.

16. Ekzekutimi i aktgjykimit është pjesë përbërëse e gjykitimit dhe aktgjykimet përfundimtare dhe të ekzekutueshme duhet të zbatohen në praktikë.

Edhe pse Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut krijoi standardet e përmendura, shteteve u lihet e drejta të përcaktojnë dhe rregullojnë procesin e marrjes së vendimeve gjyqësore me rregulloret e tyre të brendshme, por diskrecioni i tyre nuk është absolut. Në botë ka një tendencë për të siguruar cilësi të lartë në hartimin dhe përpilimin e vendimeve gjyqësore.

Dispozitat e neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë aktgjykimet e tyre. Dispozita e nenit 31 të Kushtetutës parashikon të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm në përputhje me dispozitën e nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, dispozita e nenit 32 të Kushtetutës parashikon që çdo person ka të drejtë për të përdorur mjete juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat i mohojnë të drejtat ose interesat, në mënyrën e përcaktuar me ligj, ndërsa neni 54 i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast shkeljeje ose mohimi i një të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë, si dhe e drejta për masa ligjore efektive nëse konstatohet se ajo e drejtë është shkelur.

Për të realizuar të gjitha të drejtat e sipërpërmendura të palëve, çdo gjykatë, pavarësisht instancës apo shkallës, është e detyruar të synojë që, përveç faktit që një vendim duhet të jetë i ligjshëm dhe i drejtë, duhet edhe të jetë bindës. Pra, çdo vendim gjyqësor duhet të japë arsyetimin e duhur, Ligji për Procedurën Kontestimore në dispozitën e nenit 160 parasheh se çfarë arsyetimi duhet të ketë një aktgjykim. Paragrafi 4 i nenit të lartpërmendur parashikon se arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që kanë paraqitur dhe provat e propozuara, cilat nga ato fakte i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte dhe nëse i ka vërtetuar ato përmes provave, cilat prova i ka përdorur dhe si i ka vlerësuar ato, ndërsa paragrafi 5 parasheh që gjykata në mënyrë specifike thekson se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar kur vendos për kërkesat e palëve.

Jurisprudenca e Gjykatës Supreme është përcaktuese kur bëhet fjalë për arsyetimin e aktgjykimit, përkatësisht se çfarë përmbajtje duhet të ketë arsyetimi i vendimit gjyqësor në përputhje me paragrafët e lartpërmendur 4 dhe 5 të nenit 160 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjatë marrjes së vendimit në procedurën e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, duke shqyrtuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me arsyetimin e të njëjtave, në përputhje me deklaratat e revizionit, në disa raste Gjykata Supreme ka konstatuar se ka shkelje për shkak se arsyetimi i vendimit nuk është në pajtim me nenin 160 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në Lëndën Nr.: KI 72/12, 07.12.2012, thuhet, citat: “Përfundimisht, neni 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut] parashikon: Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në përputhje me vendimin gjyqësor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, kërkuesit kanë të

drejtë të marrin një vendim gjyqësor në përputhje me ligjin dhe vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)...”.

Duke pasur parasysh sa më sipër, është e qartë se gjykatat kanë detyrimin të arsyetojnë vendimet e tyre me baza të arsyeshme, procedurale dhe materiale. E drejta e arsyetimit të vendimeve gjyqësore kërkon një shpjegim me arsye të besueshme dhe të mirëndërtuara për vendimet në çdo rast individual. Prandaj, e drejta për gjykim të drejtë nënkupton të drejtën për një vendim të arsyetuar. Një nga funksionet themelore të një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, aktgjykimi i arsyetuar parashikon mundësinë e ankimit të palës, si dhe mundësinë e rishikimit të vendimit nga gjykatat e instancave më të larta. Kontrolli publik i administrimit të drejtësisë mund të kryhet vetëm me një vendim të arsyetuar. Gjithashtu, e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në përputhje me ligjin përfshin detyrimin e gjykatës që të arsyetojë vendimet e saj me baza të arsyeshme, si në planin procedural ashtu edhe në atë material. Dhënia e arsyeve kërkon shpjegime me arsye të besueshme dhe të ndërtuara ligjërisht për vendimet në çdo rast individual, të cilat duhet të përfshijnë edhe kriteret ligjore dhe elementet faktike që mbështesin vendimin. Aktgjykimi i Gjykatës do të cenojë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, nëse arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozita ligjore dhe një marrëdhënie logjike ndërmjet tyre.

Dispozita e nenit 176, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006) parasheh si në vijim: Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, palët mund të paraqesin ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga data e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, nëse ky ligj nuk parashikon ndonjë afat tjetër. Ankesa e paraqitur brenda afatit të parashikuar me ligj pengon marrjen e formës së prerë të aktgjykimit në pjesën e kundërshtuar me ankesë. Lidhur me ankesën kundër aktgjykimit vendose gjykata e shkallës së dytë.

Pala e cila e përdor ankesën si mjet kundërshtimi ka interes juridik dhe shpreson se me paraqitjen e ankesës gjykata kompetente e Apelit do të marrë një vendim më të favorshëm se ai që po e kundërshton me ankesë. Ankesa paraqet mjet juridik me të cilin pala shpreh pakënaqësinë e saj me vendimin e dhënë në çështjen e saj, dhe njëkohësisht paraqet kërkesë për zëvendësimin e tij me vendim ligjor dhe të drejtë për palën.

Sipas Ligjit aktual për Gjykatat, Gjykata e Apelit e Kosovës, përveç juridiksioneve tjera, ka juridiksionin më të rëndësishëm, që është të vendosë për të gjitha ankesat e parashtruara kundër vendimeve të gjykatave themelore. Në këtë mënyrë garantohet zbatimi i parimit që çdo çështje të shqyrtohet të paktën në dy shkalle apo nivele gjyqësore dhe shqyrtimi në shkallën e dytë të bëhet pas parashtrimit të mjetit juridik apo ankimit. Standardi bazë është që shqyrtimi i mjetit juridik ose ankesës në Gjykatën e Apelit duhet të përfshijë: si shqyrtimin e të drejtave procedurale ashtu edhe shqyrtimin e bazueshmërisë së çështjes, duke i mundësuar Gjykatës së Apelit të kryejë një shqyrtim formal dhe thelbësor për një çështje që tashmë është vendosur në shkallë të parë.

Gjykata kompetente e shkallës së parë pas pranimit të ankesës shqyrton nëse është paraqitur në afatin e paraparë me ligj, nëse është e plotë dhe e lejueshme, si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 186 paragrafi 1 të Ligjit per Procedurën Kontestimore.

Në ankesën e paraqitur pala është e detyruar, në përputhje me dispozitat e nenit 178, pika b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të deklarojë nëse konteston apo kundërshton tërësisht apo pjesërisht vendimin e shkallës së parë dhe në rast se pala nuk ka vepruar sipas nenit të lartpërmendur, ankesa kthehet në plotesim. Mirëpo, në praktikën aktuale gjyqësore, për ekonomizim të procedurës, ankesat nuk kthehen në plotesim, por gjykata e Apelit është e detyruar të vërtetojë ose të konstatojë, në bazë të interesit juridik të ankuesit për deklarimin e tij, nëse ankesa referohet në tërësi ndaj vendimit të shkallës së parë ose vetëm në pjesë të caktuara të tij. Në ankesë pala është e detyruar t'i tregojë arsyet pse e konteston vendimin e shkallës së parë. Arsyet për të cilat mund të kontestohet vendimi i shkallës së parë janë:

- a) zbatimi i rregullave procedurale, gjegjesisht shkelje të theksuara të dispozitave të procedurës kontestimore;
- b) konstatimi i gjendjes faktike, d.m.th. i gjendjes faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë, dhe
- c) zbatimi i së drejtës materiale në gjendjen faktike të konstatuar në gjykim, gjegjesisht zbatimi i gabuar i së drejtës materiale siç parashikohet në nenin 181, paragrafi 1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Cilat janë shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore?

Se cilat janë konkretisht shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, përcaktohet me dispozitën e nenit 182 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe çdo gjykatë është e detyruar të zbatojë në mënyrë të drejtë të gjitha rregullat procedurale të parapara me ligj. Megjithatë, jo të gjitha shkeljet e dispozitave procedurale janë të një rëndësie të njëjtë, disa shkelje të procedurës kontestimore konsiderohen shkelje të rëndësishme për të cilat është paraparë ankesë, dhe disa shkelje konsiderohen më pak të rëndësishme për të cilat nuk është paraparë ankesë. Edhe të gjitha shkeljet e rëndësishme nuk janë të një rëndësie të njëjtë. Disa nga shkeljet e rëndësishme cilësohen nga vetë ligji si ato që ndikojnë ose mund të ndikojnë gjithmonë në një vendim të gabuar. Këto janë shkelje absolutisht thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Ky përkufizim nuk zbatohet për shkeljet e tjera të lehta dhe për këtë arsye prokurori duhet të provojë besueshmërinë e rrethanave se ekziston një lidhje shkak-pasojë midis shkeljeve të dispozitave procedurale dhe mundësisë së marrjes së një vendimi të gabuar. Këto lloj shkeljesh quhen shkelje relativisht të rëndësishme. Megjithatë, gjëja më e rëndësishme që duhet ditur është se të dyja llojet e shkeljeve mund të anulohen aktgjykimin një një procedure kontestimore, si dhe veprimet procedurale të përfshira.

Për sa i përket aktgjyqimeve të bazuara në pranim dhe aktgjyqimeve të bazuara në terheqjen e kërkesepadise, ato mund të kundërshtohen për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, ose nëse deklarimi i pranimit ose terheqjes së kërkesepadise është bërë në lajthitje ose nën

ndikimin e dhunes ose mashtrimit në pajtim me dispozitën e nenit 181 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Kur ekziston një gjendje faktike e vërtetuar gabimisht, dhe kur një e vërtetuar jo plotësisht?

Një vërtetim i gabuar i gjendjes faktike ekziston kur ankuesi ose ankuesit pretendojnë se ai/ata mund të konfirmojë se një çështje e caktuar është shqyrtuar plotësisht, por se ka pasur gabime. Fakti vërtetohet gabimisht nëse në bazë të provave të marra gjykata bindet se ekziston edhe pse nuk ekziston dhe anasjelltas gabimisht vërtetohet gjendja faktike nëse gjykata në bazë të provave të marra konstaton se nuk ekziston, edhe pse në fakt ekziston. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike është zakonisht pasojë e një vlerësimi të gabuar të provave në dispozicion, ose e provave të pamjaftueshme, ose e zgjedhjes së gabuar të tyre për të vërtetuar një fakt, si dhe një shqyrtim i gabuar i fakteve ekzistuese se ekziston është një fakt tjetër, si dhe pasojë e qëndrimit të gabuar se një fakt është vërtetuar edhe pse në fakt nuk është bërë, apo mendimi i gabuar se ky fakt është i njohur.

Për shembull: Në bazë të provave në dispozicion, gjykata konstatoi se prona e kontestuar ishte në pronësi të paditësit, por në realitet paditësi nuk ishte pronar i pronës.

Gjendja faktike e vërtetuar jo plotësisht ekziston kur gjykata e ka përfunduar gjykimin para se çështja juridike të jetë përgatitur plotësisht për vendim, pra para se të vërtetohet fakti përfundimtar ose disa fakte. Është e rëndësishme që paditesi në ankesën e tij të përshkruajë saktë se pse mendon se gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht. Ai duhet të përmendë faktet që ai beson se nuk janë vërtetuar dhe pse, sipas tij, është e rëndësishme të jepet një mendim i drejtë ose korrekt.

Për shembull: Gjykata nuk ka vërtetuar fare se kush është pronar formal i pronës kontestuese dhe paditësi në padi pretendon se e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të mbajtjes së pronës kontestuese.

Shkelje e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk ka zbatuar një dispozitë të së drejtës materiale që është dashur të zbatojë, kur ka zbatuar një ligj që nuk është dashur ta zbatojë, si dhe një keqinterpretim i ligjit që nuk është në përputhje me kuptimin e saktë ose frymën e përgjithshme të ligjit. Rasti i tillë mund të lindë kur, pa marrë parasysh se gjykata zbaton drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe vërteton saktë dhe plotësisht gjendjen faktike, por në mënyrë të gabuar zbaton të drejtën materiale në bazë të së cilës ka vlerësuar bazën e padisë.

Shembull: Gjykata ka zbatuar dispozitat që e bëjnë kontratën kontestuese relativisht të pavlefshme dhe është dashur të zbatojë dispozitat që e bëjnë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurat, në praktikën gjyqësore të deritanishme është konstatuar se kur flitet për zbatimin e rregullave procedurale, pra për shkelje të theksuara të dispozitave të procedurës kontestimore, nuk ka paqartësi apo dilemë, megjithatë, ndonjëherë

është e vështirë të dallohet nëse bëhet fjalë për gjendje faktike të vërtetuar gabimisht apo për vlerësim të gabuar juridik të faktit të konstatuar në kontest.

Në praktikën e deritanishme gjyqësore, Gjykata e revizionit ose Supreme nuk anulon vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, por i modifikon ato, në një situatë kur gjendja faktike është vërtetuar plotësisht dhe saktë, me përjashtim të rastit kur gjykata e revizionit anulon vendimet e gjykatave më të ulëta për shkak të gjendjes faktike të konstatuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë, e cila ka lindur si rezultat i zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes (esenciale) të dispozitave të procedurës kontestimore.

Për shembull: zbatimi i gabuar i së drejtës materiale si bazë për rishikimin e vendimeve të instancës më të ulët ekziston kur gjykatat e instancave më të ulëta kanë paraqitur gjendjen e vërtetuar faktike sipas një norme materiale të zgjedhur gabimisht ose një norme që është shfuqizuar dhe ndryshuar, ose normen që duhej të zbatonte, ka keqinterpretuar.

Kur gjykata e shkallës së parë konstaton se ankesa është paraqitur brenda afatit, se është e plotë dhe e lejuar, ia dorëzon palës së kundërt për t'i dhënë përgjigje ankesës, pas marrjes së përgjigjes në ankesë ose me skadimin e afatit të paraparë për paraqitjen e ankesës, të gjitha shkresat e lëndës ia dorëzon gjykatës së shkallës së dytë për të vendosur për të njëjtën.

Para se të vendosë për ankesën, gjykata e shkallës së dytë, përkatësisht gjyqtari i vetëm, përgatit lëndën, përkatësisht raportin për shqyrtimin e lëndës para kolegjit të gjyqtarëve, i cili përbëhet nga tre gjyqtarë. Detyra e gjyqtarit raportues është të shqyrtojë lëndën dhe t'i paraqesë raport për të kolegjit të gjyqtarëve duke dhënë një shpjegim të hollësishëm të çështjes, pa dhënë qëndrimin e tij lidhur me bazueshmërinë apo pabazueshmërinë e ankesës së paraqitur. Pra, gjyqtari raportues përgatit një raport për shqyrtimin e lëndës në gjykatën e apelit, e cila gjykohet nga trupi gjykues prej tre gjyqtarësh. Gjyqtari raportues, nëse është e nevojshme, mund të kërkojë raport nga gjykata e shkallës së parë për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe mangësive të tjera të përmendura në ankesë, si dhe të kërkojë që për konstatimin e shkeljeve apo mangësive të tilla të bëhen hulumtimet e nevojshme. Detyra e gjyqtarit raportues është të shqyrtojë çështjen dhe të paraqesë një raport për të në një seancë të mbyllur ose të hapur të gjykatës, varësisht se si është vendosur. Gjykata e shkallës së dytë, në parim vendos për ankesën në një seancë me dyer të mbyllura, por mund të caktojë seancën për çështjet e mëposhtme:

- kur në procedurën e ankimit në gjykatën e shkallës së dytë paraqiten fakte dhe prova të reja lidhur me këto fakte. Pala mund të paraqesë fakte dhe prova të reja në pajtim me dispozitat e nenit 180 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe
- gjykata e shkallës së dytë do të caktojë shqyrtimin e menjëhershëm të çështjes nëse aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar dy herë dhe kur ankesa është paraqitur për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht ose jo të plotë, si dhe kur në seancën e trupit gjykues vlerësohet se

aktgjykimi kundër të cilit është paraqitur ankesa bazohet në shkelje të theksuara të procedurës kontestimore ose në gjendje faktike jo të plotë ose të vërtetuar gabimisht.

- gjykata e shkallës së dytë mund të caktojë seancë të menjëhershme kur vlerëson se duhet të merren të gjitha ose disa nga provat e paraqitura në gjykatën e shkallës së parë për konstatimin e gjendjes faktike. Në këtë rast gjykata e shkallës së dytë vendos nëse seanca do të jetë e hapur apo e mbyllur. Në praktikën gjyqësore janë të pakta rastet kur gjykata e shkallës së dytë ka hapur seancë në një situatë të tillë.

Dispozita e nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashikon që gjykata e Apelit e shqyrton aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është kundërshtuar me ankesë, brenda kufijve të shkaqeve të cekura në ankesë, duke i kushtuar vëmendje sipas detyrës zyrtare zbatimit të së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga dispozita e nenit 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e këtij ligji. Gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare kujdeset për zbatimin e së drejtës materiale në gjykatën e shkallës së parë, por edhe për disa shkelje të rëndësishme të procedurës kontestimore.

Me rastin e vendosjes për ankesën e paraqitur, gjykata e shkallës së dytë, në bazë të dispozitave të nenit 195, paragrafi 1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore, mund të:

1. hedh poshtë ankesën si të pasafatshme, të paplotë ose të papranueshme;
2. anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe të hedh poshtë padinë;
3. anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në gjykatën themelore për rigjykim;
4. refuzojë ankesën si të pabazuar dhe konfirmojë aktgjykimin e kundërshtuar;
5. të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë.

Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, do të thotë se gjykata e shkallës së dytë e kontrollon aktgjykimin e shkallës së parë vetëm në atë pjesë të përmendur në ankesë. Gjegjësisht, shpesh ndodh që aktgjykimi i shkallës së parë të ketë vendosur për disa kërkesa në të njëjtën kohë dhe që për disa kërkesa pala ka pasur sukses në kontest, por në raport me të tjerat jo. Pjesa e aktgjykimit, të cilën asnjëra palë nuk e ka ankimuar, merr formë të prerë - ligjërish të detyrueshme. Nëse në ankesë nuk thuhet se cilës pjesë i referohet (cila pjesë e aktgjykimit kontestohet), konsiderohet se pala ka bërë ankesë kundër asaj pjese të aktgjykimit në të cilën ka qenë i pasuksesshëm.

Tani le të kthehemi te arsyet e paraqitjes së ankesës që përmendëm në rreshtat e mëparshëm. Kur bëhet fjalë për materialet e mbledhura faktike, zbatohet rregulli se gjykata e shkallës së dytë është e lidhur me gjendjen faktike të konstatuar në procedurën e shkallës së parë. Kjo praktikisht do të thotë se nëse aktgjykimi nuk kundërshtohet për shkak të fakteve të vërtetuara gabimisht, kjo pjesë e aktgjykimit as nuk do të merret parasysh nga gjykata e shkallës së dytë. Nga ana tjetër, gjykata e shkallës së dytë merr parasysh zbatimin e së drejtës materiale, pra korrektësinë e zgjedhjes së normës juridike, edhe kur asnjëra nga palët nuk e ka cekur në ankesë ose thënë në fjalorin juridik, sipas detyrës zyrtare.

Për sa i përket shkeljeve procedurale (shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore), situata nuk është krejtësisht e thjeshtë. Së pari, ka shkelje procedurale që ligjvënësi i supozon në mënyrë të pakundërshtueshme se kanë rezultuar në një vendim të gabuar. Ligjvënësi numëroi në mënyrë numerative ato shkelje që gjykata e shkallës së dytë i merr parasysh sipas detyrës zyrtare, edhe kur asnjë palë nuk i vë në dukje. Bëhet fjalë për shkelje veçanërisht të rënda që cenojnë parimet elementare procedurale apo të drejtat e garantuara me kushtetutë, pra interesin publik.

Shkeljet e procedurës që gjykata e shkallës së dytë merr parasysh sipas detyrës zyrtare parashikohen në dispozitat e nenit 182 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe ato janë:

- a) në qoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në qoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore;
- b) në qoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor;
- c) në qoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet, respektivisht me vendim të gjykatës ka qenë i përjashtuar ose me rastin e dhënies se vendimit ka marrë pjesë personi i cili nuk e ka cilësinë e gjyqtarit;
- d) në qoftë se gjykata sipas prapsmit të palëve gabimisht ka vendosur se është e kompetencës lëndore;
- e) në qoftë se është vendosur për kërkesën sipas padisë të ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj;
- f) në qoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër;
- g) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar vendimin e vetë në disponimin e palejueshëm të palëve, (neni 3 paragrafi 3);
- h) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata ka nxjerr aktgjykim për shkak të pohimit, mosbindjes, mungesës, heqjes dorë nga kërkesëpadija, ose pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor;
- i) në qoftë se ndonjëherë nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë;
- j) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet;
- k) në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë;

- l) në qoftë se është vendosur për kërkesën për të cilën vazhdon procedura apo për të cilën më parë është nxjerr aktgjykimi i formës së prerë, ose prej të cilit paditësi njëherë ka hequr dorë ose për të cilin është lidhur pajtimi gjyqësor;
- m) në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore;
- n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;
- o) në qoftë se me aktgjykim është tejkalluar kërkesëpadia.

Gjithashtu, ka shkelje procedurale për të cilat ligjvënësi nuk supozon se kanë rezultuar në marrjen e një vendimi të paligjshëm. Këto janë shkelje të tilla që mund të kishin ndikuar në korrektësinë e vendimit, por jo domosdoshmërisht. Bëhet fjalë për shkelje të lehta, ekzistenca e të cilave shqyrtohet në çdo rast konkret dhe gjithmonë vetëm me kërkesë të palëve.

Nëse gjykata e shkallës së dytë konfirmon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, atëherë në arsyetimin e vendimit të saj do të japë arsyet pse nuk i ka pranuar si të bazuara pretendimet ankimore, pra arsyet. Duhet theksuar se është e mjaftueshme që gjykata e shkallës së dytë t'i referohet arsyeve të aktgjykimit të shkallës së parë për të mos i përsëritur ato në aktgjykimin e shkallës së dytë. Në anën tjetër, nëse gjykata e shkallës së dytë e ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, atëherë duhet të tregojë arsyet për të cilat është dashur të anulohet. Duke përmendur shkeljet procedurale për të cilat gjykata e shkallës së dytë është dashur të anulojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në arsyet e aktvendimit të shkallës së dytë duhet të ceket dispozita konkrete e procedurës kontestimore që është shkelur dhe në çfarë mënyre është shkelur, si dhe në çfarë mënyre është e mundur të hiqet kjo shkelje e procedurës.

Gjykata e shkallës së dytë mund ta anulojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta hedhë padinë e paditësit nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 198 të Ligjit për procedurën kontestimore. Gjegjësisht, gjykata e shkallës së dytë vepron në këtë mënyrë nëse gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar supozimet procedurale që kanë të bëjnë me vetë palët. Kushtet e parashikuara në nenin e sipërpërmendur janë:

- nëse kërkesa për të cilën është marrë vendimi është në juridiksionin e gjykatës,
- nëse ka ndërvarësi,
- nëse çështja është gjykuar (ekzistenca e një aktgjykimi të formës së prerë),
- nëse paditësi ka hequr dorë nga kërkesëpadia (aktgjykimi i bazuar në heqjen dorë nga kërkesëpadia),
- nëse ka marrëveshje gjyqësore.

Kushtet ose situatat e përmendura i referohen rasteve kur gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar supozimet procedurale lidhur me juridiksionin ose objektin e mosmarrëveshjes.

Gjykata e shkallës së dytë e refuzon padinë edhe në rastet e mëposhtme:

- nëse në procedurën para gjykatës së shkallës së parë, një person që nuk mund të jetë palë në procedurë ka vepruar si paditës ose i paditur;
- nëse personi juridik nuk përfaqësohej nga një person i autorizuar, ose nëse personi pa zotësi juridike nuk përfaqësohej nga një përfaqësues ligjor,
- nëse përfaqësuesi ligjor ose ai me prokurë nuk ka pasur kompetencat e nevojshme për të monitoruar çështjen në gjykatë, ose nëse bëhet fjalë për kryerjen e veprimeve të veçanta procedurale, përkatësisht nëse veprimet e caktuara të kryera në procedurë nuk janë miratuar nga vetë pala.

Gjykata e shkallës së dytë mund ta prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta kthejë çështjen në të njëjtën gjykatë për rigjykim në përputhje me dispozitat e nenit 197 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, nëse konstaton se ekziston një nga shkaqet e përmendura më poshtë në ankesë:

- nëse në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata ka nxjerrë aktgjykim në bazë të njohjes ose aktgjykim të bazuar në heqjen dorë nga kërkesëpadia;
- nëse njërës nga palët nuk i jepet mundësia për të marrë pjesë në seancë për shkak të një akti të kundërligjshëm, e sidomos për shkak të mosftesës në mënyrë të rregullt, dhe një procedurë e tillë ndikon në marrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë;
- nëse gjykata merr aktgjykim pa shqyrtimin kryesor të çështjes ligjore;
- nëse në marrjen e një aktgjykimi ka marrë pjesë një gjyqtar, i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet nga gjykimi. Në disa situata, kur gjykata e shkallës së dytë prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e kthen çështjen në të njëjtën gjykatë në rigjykim, mund të urdhërojë shqyrtimin e çështjes nga një gjyqtar tjetër.

Gjatë rigjyqimit, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë të caktojë seancën (seancë përgatitore ose kryesore), për të kryer të gjitha veprimet kontestimore dhe për të shqyrtuar të gjitha çështjet kontestuese të urdhëruara dhe të ngritura nga gjykata e shkallës së dytë në vendimin e saj. Procedura e rishqyrtimit përbën një njësi të vetme me të cilën është nxjerrë aktgjykimi i prishur. Në të njëjtën kohë, palët mund të kryejnë të gjitha veprimet procedurale, duke përfshirë edhe ato në dispozicion që kanë pasur të drejtë t'i kryejnë në procedurën e parë.

Gjykata e shkallës së dytë gjithashtu mund ta refuzojë ankesën e paraqitur si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nëse konstaton se nuk ka arsye për ta kundërshtuar aktgjykimin, e as arsyet që kujdeset sipas detyrës zyrtare (të parapara në dispozitë të nenit 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore). Në rastet kur gjykata e shkallës së dytë konstaton se ankesa është e pabazuar, konfirmon menjëherë vendimin (aktgjykimin) e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë mund të ndryshojë ose modifikojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në përputhje me dispozitat e nenit 201 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Gjykata e shkallës së dytë, në seancën e trupit gjykues ose në bazë të shqyrtimit të drejtpërdrejtë të çështjes kryesore, me aktgjykim e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë, nëse konstaton se ekziston një nga shkaqet e përmendura më poshtë në ankesë:

- nëse ka konstatuar se ka shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, përveç atyre të përcaktuara në dispozitat e nenit 197 të Ligjit për procedurë kontestimore;
- nëse në seancën e trupit gjykues, për shkak të vlerësimit të ndryshëm të dosjeve dhe provave të marra në mënyrë indirekte, ka konstatuar gjendje faktike të ndryshme nga ajo e aktgjykimit të shkallës së parë;
- nëse pas shqyrtimit të menjëhershëm të çështjes, në bazë të provave të reja, ose në bazë të riparimit të provave para gjykatës së shkallës së parë, konstaton një gjendje faktike të ndryshme nga ajo që përmban aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë;
- nëse konsideron se gjendja faktike e përfshirë në aktgjykimin e shkallës së parë është konstatuar drejt, por e drejta materiale është zbatuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë;
- nëse konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë ka tejkaluar kërkesëpadinë, ashtu që u njoh më shumë se sa kërkohej nga padia.

Në bazë të dispozitave të nenit 203 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë në dëm të paditësit, nëse ankesën e ka bërë ai, e jo i padituri. Rregulli i ndalimit "reformatio in peius".

Nëse gjykata e shkallës së dytë vendos ndryshimin e vendimit të shkallës së parë, është e nevojshme të theksohen arsyet e ndryshimit në ankesë, si dhe të trajtohen shkeljet e procedurës që mund të eliminohen në seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë. Duke qenë se gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare monitoron zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, nuk është i rrallë rasti që edhe gjykata e shkallës së dytë të ndryshojë sipas detyrës zyrtare vendimin e gjykatës së shkallës së parë kur gjendja faktike ka qenë plotësisht dhe saktë e vërtetuar, është zbatuar gabim e drejta materiale. Në rast të tejkalimit të kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së dytë nuk do të mund ta ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë sipas detyrës zyrtare, sepse nuk e ka një detyrim të tillë kur bëhet fjalë për shkeljen e tejkalimit të kërkesëpadisë.

Në të kundërtën, gjykata e shkallës së dytë, duke vendosur për ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë, është e obliguar që t'i sqarojë të gjitha pretendimet e ankesës që kanë rëndësi vendimtare. Nga kjo rezulton se shpjegimi i aktgjykimit të shkallës së dytë duhet të përmbajë arsyet pse gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë ose e ka anuluar ose ndryshuar atë. Me fjalë të tjera, arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së dytë, përkatësisht i aktvendimit, duhet të përmbajë një përgjigje për arsyet e ankesës, në mënyrë që të shihet se cilat baza ankimore janë miratuar nga ajo gjykatë, dhe pse, dhe cilat jo dhe pse. Meqenëse në ankesë ekziston mundësia e evidentimit të arsyeve që nuk janë të rëndësishme nga aspekti i objektit të mosmarrëveshjes, gjykata e shkallës së dytë ka detyrimin të vlerësojë vetëm pretendimet

ankimore, përkatësisht arsyet që janë të rëndësishme, përcaktuese nga aspekti i objektit të kontestit.

Dispozita e nenit 204 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parasheh që në arsyetimin e aktgjykimit gjykata e shkallës së dytë duhet të vlerësojë pretendimet e ankesës që kanë qenë vendimtare për miratimin e tij. Të gjitha rregullat që zbatohen për vendimin e gjykatës së shkallës së parë zbatohen në parim edhe për vendimin e gjykatës së shkallës së dytë, por me disa specifika. Në hyrje të vendimit duhet të përshkruhet shkurtimisht përmbajtja e ankesës, në dispozitiv përshkruhet procedura për marrjen e vendimit, ndërsa në arsyetim përshkruhet vlerësimi i pretendimeve të paditësit dhe arsyet e procedurës së vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së dytë.

Krahas mundësisë së ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ekziston edhe mundësia e ankimit kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë. Dispozita e nenit 206 paragrafi 1 i Ligjit për procedurën kontestimore parasheh se kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankesa, përveç nëse me këtë ligj parashikohet ndryshe, ndërsa paragrafi 2 i nenit të përmendur të të njëjtit ligj shprehimisht parasheh se nuk lejohet ankesë e veçantë dhe se aktvendimi i shkallës së parë mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër vendimit me të cilin përfundon procedura në gjykatën e shkallës së parë. Ankesa e parashtruar në afatin e paraparë me ligj e ndërpret ekzekutimin e aktvendimit, përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe në pajtim me dispozitat e nenit 207 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Për sa i përket procedurës së vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ankesën kundër aktvendimit, dispozitat e nenit 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore parashikojnë procedurën e vendimmarrjes për ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë mund të vendosë për ankesën kundër aktvendimit në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

- duke refuzuar ankesën si jo të paraqitur në kohë (pasafatshme),
- duke refuzuar ankesën si të pa lejuar;
- duke refuzuar ankesën si të pabazuar dhe duke vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë;
- duke pranuar ankesën dhe duke ndryshuar aktvendimin e kontestuar;
- me anulimin e aktvendimit të kontestuar dhe kur është e nevojshme duke e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë.

6.1 Gjetje nga praktika e Gjykatës Supreme

Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, si dhe praktikën ekzistuese gjyqësore, lind pyetja: si është e mundur që gjykata e shkallës së dytë të mos vendosë për të gjitha ose disa prej pretendimeve të theksuara ankimore?

Një nga arsyet e shpeshta të përmendura në revizion, i cili përfaqëson një mjet të jashtëzakonshëm juridik, të paraqitur nga një palë për shkak të shkeljes së ligjit, është pretendimi se gjykata e shkallës së dytë nuk i ka marrë plotësisht ose nuk është marrë fare me pretendimet e theksuara në ankesë dhe as në vendimin e saj në arsyetimin nuk i ka cekur arsyet lidhur me këtë. Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurës, Gjykata Supreme është në pozitë shumë të pafavorshme, veçanërisht pas shqyrtimit të plotë të dosjeve dhe shqyrtimit të pretendimeve të theksuara. Pothuajse në të gjitha situatat e kësaj natyre, Gjykata Supreme ndonjëherë detyrohet të anulohet vetëm vendimin e shkallës së dytë, nëse është e mundur, ose të dyja vendimet e instancës më të ulët, sepse lëshimi i bërë nga gjykata e shkallës së dytë më së shpeshti i referohet fakteve vendimtare ose zbatimin e se drejtes materiale.

Në disa raste, gjykata e shkallës së dytë pranon gjendjen faktike të konstatuar me vendimin e shkallës së parë, si dhe zbatimin e së drejtës materiale, por nuk ka vlerësuar pretendimet esenciale ankimore dhe as nuk i ka theksuar arsyet që ka marrë parasysh në arsyetimin e aktgjykimit të saj.

Në raste të tjera, gjykata e shkallës së dytë nuk ka pranuar një zbatim specifik të së drejtës materiale në gjendjen faktike të konstatuar, ka bërë ndryshim apo modifikim të vendimit të shkallës së parë, por nuk ka vlerësuar pretendimet e rëndësishme ankimore dhe as nuk ka theksuar arsyet që ka marrë parasysh.

Në arsyetimet e vendimeve të caktuara të shkallës së dytë, ndonjëherë mungojnë deklaratat nëse gjykata e shkallës së dytë i ka vlerësuar fare pretendimet e theksuara të ankesës, nëse po, pse i ka vlerësuar disa si të pabazuara ose të bazuara, dhe as gjykata e shkallës së dytë nuk jep arsye të qarta dhe të mjaftueshme.

Në disa raste, kur çështja është shumë komplekse, më së shpeshti theksohet një ankesë në të cilën specifikohen bazat e theksuara të ankesës, si dhe jepet një shpjegim se pse dhe në çfarë i sheh ankuesi, kështu që është e paqartë pse gjykata e shkallës së dytë nuk merret me pretendimet e theksuara në ankesa dhe as nuk jep ndonjë shpjegim.

Nga ana tjetër, në disa raste, gjykata e shkallës së dytë largohet nga kornizat ankimore të përcaktuara me ankesë, dhe trajton çështje që nuk janë ngritur në ankesë dhe e trajton atë në mënyrë shumë të detajuar dhe të saktë, duke dhënë një shpjegim të gjerë, pa u marrë fare me pretendimet e theksuara në ankesë.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të theksohet si në vijim: ka ndodhur në disa raste që gjykata e shkallës së dytë, duke vendosur për ankesën e paraqitur, e ka refuzuar ankesën e parashtruar si të pasafatshme, duke theksuar në arsyetimin se ankesa është paraqitur jashtë afatit të paraparë me ligj. Pas kësaj, me paraqitjen e revizionit, parashtruesi i revizionit atakon vendimin e gjykatës së shkallës së dytë për shkaqe procedurale dhe Gjykata Supreme, pas shikimit të plotë të shkresave të lëndës, konstaton se gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka përcaktuar datën e marrjes së vendimit të shkallës së parë dhe datën e dërgimit të ankesës me postë rekomande, si dhe datën e pranimit të ankesës në gjykatë. Duke shqyrtuar afatshmërinë e ankesës së paraqitur, gjithmonë është e nevojshme të konstatohet nëse aktgjykimi (d.m.th.,

vendimi) është pranuar në mënyrën e duhur, nëse i është dorëzuar palës sipas rregullave të dorëzimit, d.m.th. nëse pala ka qenë e njoftuar në mënyrë të rregullt për datën e marrjes së aktgjykimit. Më pas, nëse pala e ka paraqitur ankesën me postë rekomande, si datë e pranimit të ankesës merret data e shënuar në vulën e faturës së postës dhe jo data e shënuar në vulën e pranimit të gjykatës. Nëse pala e paraqet ankesën personalisht ose drejtpërdrejt në gjykatë, atëherë si datë e pranimit të ankesës merret data që figuron në vulën e pranimit të gjykatës.

Më pas, në disa raste ka ndodhur që kundër vendimit të shkallës së parë janë parashtruar disa ankesa në kohë nga disa aplikues të ndryshëm, dhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka vendosur për të gjitha ankesat dhe as nuk ka dhënë arsyetime se pse nuk e ka bërë këtë. Gjykata e shkallës së dytë është e detyruar të vendos për të gjitha ankesat me një vendim, në të kundërtën shkel dispozitat e procedurës kontestimore.

Rregulli i ndalimit "reformatio in peius" është një rregull që ndonjëherë nuk ndiqet nga gjykatat e shkallës së dytë. Është qëndrim unik që aktgjykimi nuk mund të ndryshohet në dëm të palës që ka bërë ankesë, nëse vetëm ajo ka bërë ankesë. Që do të thotë: nëse të dyja palët janë ankuar kundër aktgjykimit në tërësi, atëherë ky ndalim nuk ekziston. Ndalimi i tejkalimit të aktgjykimit të shkallës së parë në dëm të palës që ka qenë e vetmja që është ankuar kundër tij bazohet në faktin se pala kundërshtare është e kënaqur me aktgjykimin dhe se p.sh. i padituri në pjesën akorduese ka pranuar të kryejë një veprim të caktuar ose të përmbahet nga një veprim i caktuar, d.m.th si i tillë i padituri i pranon një të drejtë paditësit, ashtu që në atë pjesë aktgjykimi ka marrë formë të prerë dhe nuk mund të kontestohet më nga ankesa, dhe as gjykata e shkallës së dytë nuk mundet në bazë të ankesës së paditësit të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë me të cilën është pranuar pjesërisht kërkesa dhe ta refuzojë në tërësi kërkesën e paditësit edhe nëse ka konsideruar se aktgjykimi është i parregullt. Në të njëjtën situatë ndodhet edhe i padituri kur si ankimes i vetëm bën ankesë kundër pjesës akorduese të aktgjykimit të shkallës së parë, sepse edhe atëherë gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë në dëm të tij duke e detyruar atë për të njëjtën arsye për të cilën aktgjykimi i shkallës së parë ka refuzuar paditësin. Gjykata e shkallës së dytë nuk do të mund ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë në dëm të palës që ka bërë ankesë, por kjo nuk do të thotë se nuk do të mund ta anulojë atë pjesë të aktgjykimit (dhe ta kthejë çështjen në rigjykim) ose konfirmojë atë. Kjo çështje lidhet me interesin juridik të palëve, interesi juridik është çështje e së drejtës materiale, andaj duhet pasur parasysh se pala që ka pasur sukses në kontest nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës.

Referim në arsyetimet e vendimeve të Gjykatës Supreme

Aktvendim Rev.nr.15/2015, dt. 11.05.2015

Arsyetim

“Për momentin, Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, pasi që sipas mendimit të saj aktgjykimi i

kontestuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë kanë të bëjnë me shkelle esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore e paraparë me nenin 182.2 pika n) të LPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nuk është vërtetuar gjendja faktike, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë në bazë të shkelles esenciale të paraparë me nenin 182.1, në lidhje me nenin 194 të LPK, për këtë arsye të dy aktgjykimet e përmendura duhej të ishin anuluar. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur kronologjinë e provave të paraqitura dhe faktet me të cilat i ka vërtetuar ato, por nuk ka dhënë vlerësim se cilat faktet vendimtare janë vërtetuar dhe mbi çfarë e mbështet vlerësimin e saj, kur në lidhje me faktet vendimtare ka kontradikta ndërmjet asaj që thuhet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjes së provës në formë të shkruar, mbi të cilën mbështetet aktgjykimi, si dhe ndërmjet provave të paraqitura.....”.

Aktvendim Rev.nr.394/2023 dt. 19.10.2023

Arsyetim

“Sipas të dhënave nga shkresat e lëndës, rezulton gjendja faktike si në vijim: Paditësi ka qenë i punësuar për kohë të pacaktuar tek i padituri në pozitën: Montues, me datë 16.04.2019, paditësi është lënduar në punë gjatë kryerjes së detyrave të punës, gjegjësisht ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe mbi këtë bazë ka kërkuar kompensim nga i padituri. Ky fakt është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 63/2020 të datës 06.04.2020. me të cilin është refuzuar revizioni i paraqitur nga avokati i të paditurit. Gjykata e shkallës së parë, duke pasur parasysh aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk u angazhua në vërtetimin e gjendjes faktike, por duke ndjekur urdhrin dhe udhëzimet e dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin e lartpërmendur, u fokusua dhe është marrë me çështjet kontestuese, për shkak të të cilave lënda konkrete është prishur dhe është kthyer në rigjykim dhe vendosje. Gjykata e shkallës së parë ka konfirmuar shkallën dhe llojin e shkelleve të paditësit në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe dëshmisë së ekspertizës, sipas vlerësimit të ekspertëve të caktuar nga gjykata, paditësi në këtë aksident ka pësuar lëndime të rënda fizike me pasojë të përhershme.

Për përcaktimin e shkallës dhe intensitetit të dëmtimeve të pësuar nga paditësi, është angazhuar një neurokirurg ekspert dhe një ekspert psikiatër, të cilët në ekspertizën e tyre kanë deklaruar se paditësi ka pësuar lëndime fizike të karakterizuara si të rënda dhe si pasojë e të cilave ka pësuar dhimbje fizike me intensitet të madh që ka zgjatur 4 -5 orë, më pas ka vazhduar si dhimbje me intensitet të mesëm për muajin e ardhshëm dhe në formën e dhimbjes me intensitet të ulët ekziston edhe sot. Ngjarja kritike në fjalë i ka shkaktuar paditësit frikën e intensitetit shumë të lartë për 30 minuta, si dhe frikën e paaftësisë që ka qenë me intensitet të lartë prej dy javësh dhe një frikë dytësore nga intensiteti mesatar ekziston edhe sot. Paditësi ka pasur ulje të përhershme të aktivitetit jetësor të shprehur në përqindje 45%, dhe ka pasur gjithashtu një rënie të përhershme të aktivitetit të punës në përqindje 50%, për shkak të dëmtimeve të mësipërme, paditësi kishte nevojë për ushqim të shtuar për 4 muaj, ndihmë dhe kujdes nga të tjerët për 6 muaj, trajtim spa dhe rehabilitim spitalor për 2 x 1 muaj (në vitin e parë) dhe trajtim periodik fizioterapi, i cili ende

vazhdon. Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, gjykata e shkallës së parë vendosi në mënyrën e përcaktuar më parë në dispozitiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së avokatit të të pandehurit, pjesë e aktgjykimit të shkallës së parë, pika b) e paragrafit I. të dispozitivit i cili i referohet kompensimit të dëmit material për shpenzimet e trajtimit dhe rehabilitimit të banjës klimatike, si dhe në pjesën e aktgjykimit të shkallës së parë, paragrafi II. dispozitivit lidhur me shumën për shpenzimet e procedurës, e anuloi dhe i ktheu gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe vendosje, ndërsa në pjesën tjetër vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankesës ai nuk ka shpjeguar pse ka vendosur të anulojë disa pika të aktgjykimit të shkallës së parë dhe ta kthejë atë në rigjykim, përkatësisht nuk ka vepruar sipas dispozitës së nenit 198 paragrafi 4. të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili përcakton, citat: “Në pjesën ku arsyetohet aktvendimi, me të cilin anulohet aktgjykimi i shkallës së parë, duhet theksuar se cilat dispozita të procedurës kontestimore janë shkelur dhe në çfarë konsiston ajo shkelje”. Më pas, nuk ka shpjeguar pse ka vendosur të konfirmojë disa pika të paragrafit I të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, dhe në këtë mënyrë nuk ka vepruar sipas dispozitave të nenit 200 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili përcakton, citoj: “Gjykata e shkallës së dytë refuzon ankesën si të pabazuar dhe e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë, nëse konstaton se nuk ka arsye për prishjen e aktgjykimit dhe nuk ka arsye për të cilat vepron sipas detyrës zyrtare”.

Gjykata e Apelit e Kosovës vërtetoi pikat a), c) dhe d) të paragrafit I të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, duke dhënë një shpjegim shumë të shkurtër dhe të përgjithshëm për pikën a) e cila i referohet shumës së përcaktuar në emër të ushqyerjes së shtuar, si dhe pika c) që i referohet shumës së përcaktuar në emër të ndihmës dhe kujdesit të dikujt tjetër ndaj një pale të tretë. Sa i përket pikës d) që i referohet shumës së specifikuar në emër të, citim “trajtimit të përkohshëm të vazhdueshëm fiziatrik (për gjithë jetën)”, nuk e përmend fare. Pozicioni i përmendur është shumë i paqartë dhe konfuz, sidomos duke marrë formulimin e tij, citim: “trajtim i përkohshëm i vazhdueshëm i fiziatrisë (për gjithë jetën)”, si mund të jetë diçka në të njëjtën kohë: edhe e përkohshme, edhe e vazhdueshme, edhe për gjithë jetën?

Mangësitë e lartpërmendura tregojnë se gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e kontestuar nuk ka paraqitur arsye të vlefshme dhe të mjaftueshme për vlerësimin e pretendimeve esenciale ankimore të avokatit të të pandehurit, të cilat ai tani pjesërisht i përsërit në përmbajtjen e revizionit të tij, dhe të cilën e vë në dukje edhe avokati i paditësit në revizionin e paraqitur, i cili pengon verifikimin e rregullsisë së zbatimit të së drejtës materiale nga gjykatat e instancës më të ulët.

Pasi që gjykata e shkallës së dytë nuk arriti t'i sqarojë të gjitha faktet me rëndësi për marrjen e vendimit të drejtë lidhur me kërkesëpadinë, Gjykata Supreme e Kosovës, duke zbatuar dispozitat e nenit 224, paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore, e anuloi aktgjykimin e shkallës së dytë dhe lëndën ia ktheu gjykatës së shkallës së dytë dhe të njëjtit kolegji për rigjykim.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë do të sqarojë të gjitha rrethanat e lartpërmendura me rëndësi për marrjen e vendimit në këtë çështje juridike, të cilat theksohen në këtë aktvendim dhe

do të marrë një vendim të ri ligjor mbi kërkesëpadinë me zbatimin e duhur të së drejtës materiale”.

Aktvendim Rev.nr.298/2024 dt. 25.07.2024

Arsyetim

“Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se objekt i kontestit konkret sipas padisë së paraqitur më 27.09.2017: shpërblimi i dëmit, gjatë procedurës paditëse ka plotësuar dhe sqaruar kërkesëpadinë. Në mes palëve ndërgjyqëse nuk kontestohet se ka ndodhur një aksident trafiku në të cilin paditësja ka pësuar lëndime fizike, gjegjësisht i është shkatëruar dëm material dhe jo material, nuk kontestohet as baza juridike. Mosmarrëveshja ndërmjet palëve është shuma e të hollave për dëmin material dhe jomaterial. Gjykatat e instancave më të ulëta i bazuan pretendimet e tyre, përkatësisht vendimet e tyre, në bazë të një shikimi në gjetjet dhe mendimet e ekspertëve të caktuar nga gjykata në profesionin mjekësor, ekspertëve të punës dhe ekspertëve për vlerësimin e lartësisë së shumës. Në revizion, revizori (parashtruesi i revizionit) thekson si një nga arsytet kryesore që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë vepruar në bazë të propozimit të tij, të cilin e ka theksuar gjatë procedurës në gjykatën e shkallës së parë, si dhe ankesës pas vendimit të shkallës së parë, pra që të ftohen në shqyrtimin kryesor ekspertët që kanë bërë ekspertizën e tyre për të sqaruar dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të gjykatës dhe palëve. Pas shikimit të shkresave të plota të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se pretendimi specifik i theksuar i revizionit ishte i bazuar. Eksperti i vetëm i caktuar nga gjykata që mori pjesë në seancën gjyqësore është eksperti i punës i cili ka dhënë konstatimin dhe mendimin e tij më 22.06.2019, dhe që mori pjesë në seancën e mbajtur më 09.03.2020. Lidhur me lëndimet, llojet e lëndimeve, dhimbjet e vuajtura, vuajtjet e frikës, ekspertët mjekësorë nuk kanë qenë të pranishëm në asnjë nga seancat e mbajtura gjyqësore dhe nëse palët ndërgjyqëse kanë kërkuar praninë e tyre, edhe përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit ka shprehur kundërshtime me shkrim për ekspertizën nga ana e ekspertit në lëminë e mjekësisë. Është fakt se në njërin nga seancat, avokati i paditësit ka tërhequr propozimin për të dëgjuar ekspertin ortoped, por kjo nuk cenon detyrimin e gjykatës për të vepruar sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitat e nenit 352 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sidomos në një situatë kur pala e kundërt konteston ekspertizën e ekspertit në fjalë.

Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata Supreme vlerëson se, së pari, mendimi i ekspertit nuk është marrë sipas rregullave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar sipas detyrës zyrtare të konstatojë gjendjen e saktë faktike, me paraqitjen e provave duke lexuar konstatimet dhe mendimin e ekspertit, si dhe duke dëgjuar ekspertin, duke vepruar sipas nenit 362, paragrafi 1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore, ku përcaktohet se eksperti ftohet gjithmonë në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes.

Gjatë procedurës para gjykatave të instancave më të ulëta, si dhe në ankesë, u theksuan të gjitha pretendimet specifike të lartpërmendura të revizionit. Dispozita e nenit 8, paragrafët 1 dhe 2 të

Ligjit për Procedurën Kontestimoree, parashikon: Cilat fakte do të konsiderohen të vërtetuara dhe cilat jo, vendose vetë gjykata në bazë të vlerësimit të kujdesshëm dhe të ndërgjegjshëm të provave, por edhe në bazë të rezultateve të gjithë procedurës. Gjykata me ndërgjegje dhe kujdes shqyrton secilën provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku. Gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë vepruar në përputhje me nenin 8 të përmendur të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Duke zbatuar sa më sipër në një rast konkret dhe duke pasur parasysh arsyetimin e gjykatave të instancave më të ulëta për konkluzionin se pretendimi është pjesërisht i justifikuar, Gjykata Supreme konstaton se arsyetimi i vendimeve të instancave më të ulëta vështirë se mund të vlerësohet si ligjërishit i pranueshëm, sepse nuk jep arsye relevante dhe bindëse për vlerësimin se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, arsyetimi i dhënë në këtë mënyrë i aktgjykimeve të kontestuara nuk i plotëson standardet e gjykimit të drejtë të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në përgjigje të të gjitha pyetjeve të lartpërmendura, gjykatat e instancave më të ulëta nuk u deklaruan apo arsyetuan vendimet e tyre, sipas detyrës zyrtare. Të metat e përmendura janë të një natyre të tillë që kërkojnë anulimin e aktgjykimeve të instancave më të ulëta, pa qenë në gjendje të angazhohet Gjykata Supreme në verifikimin e pretendimeve të tjera të revizionit, si dhe verifikimin e rregullsisë së zbatimit të së drejtës materiale nga ana e gjykatave të instancave më të ulëta.

Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët duhet të anulohen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe vendimmarrje. Në procedurën e përsëritur, të gjitha pyetjet dhe faktet e lartpërmendura do të vërtetohen në mënyrë të padyshimtë. Gjithashtu, do të vërtetohen fakte të tjera të rëndësishme, si dhe do të zbatohet e drejta materiale përkatëse në gjendjen faktike të konstatuar dhe do të merret një vendim ligjor dhe i drejtë”.

Afrim Shala

7. KTHIMI I ÇËSHTJEVE NË RIGJYKIM

Pjesa e I-rë

7.1 Shqyrtime të përgjithshme në lidhje me kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet penale

Duke u bazuar në nenin 103, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 25, paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat,²⁹ Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor dhe ka juridiksionin për gjithë territorin e Republikës së Kosovës.³⁰ Si autoriteti më i lartë gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës³¹ në procedurë penale ka kompetencë të vendosë në lidhje me:

- 1) kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit,³²
- 2) ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Gjykatën Supreme të Kosovës, sipas paragrafit 1 të nenit 407 të KPP-së,³³
- 3) ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin apo kur paraburgimi caktohet për herë të parë nga kjo Gjykatë³⁴ dhe
- 4) çështje të tjera të parapara me ligj.³⁵

Është e rëndësishme të theksohet se Gjykata Supreme e Kosovës shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji të përbërë prej (3) gjyqtarëve, me përjashtim kur me ligj parashihet ndryshe.³⁶ Gjithashtu, për dallim nga organizimi i brendshëm i gjykatave themelore dhe i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duhet të bëhet e qartë se kolegji prej tre (3) gjyqtarëve i Degës Penale i Gjykatës

²⁹ Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat i datës 23.11.2018.

³⁰ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, "Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile", Prishtinë, 2023, fq.6.

³¹ Neni 26, paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat.

³² Neni 419, paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale i datës 17.08.2022 (në vijim: KPP), pastaj, nenet 431, 435, etj.

³³ Në nenin 407, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës në rastet kur:

1.1. Gjykata e Apelit e Kosovës shqipton dënim me burgim të përjetshëm ose vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore me të cilin është shqiptuar dënim i tillë;

1.2. Gjykata e Apelit e Kosovës pas shqyrtimit vërteton ndryshe gjendjen faktike nga gjykata themelore dhe aktgjykimin e bazon në gjendjen e tillë faktike të vërtetuar; ose

1.3. Gjykata e Apelit e Kosovës ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin.

³⁴ Neni 374, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. i KPP-së.

³⁵ Neni 26, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7. i Ligjit për Gjykatat.

³⁶ Neni 28, paragrafi 2 i KPP-së dhe neni 25, paragrafi 6 i Ligjit për Gjykatat. Kështu, p.sh. në nenin 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë është parashikuar se urdhrat gjyqësor për përgjim apo për hyrje në objekte dhe urdhrat për përgjim emergjent i lëshon një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Supreme të Kosovës i shqyrton dhe gjykon të gjitha çështjet penale, duke përfshirë këtu çështjet penale të gjykuara nga Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti për të Mitur, Departamenti Special dhe Divizioni Penal i Departamentit të Përgjithshëm i gjykatave të lartcekura.³⁷

Nga statistikat e publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës³⁸ rezulton se përqindja më e madhe e çështjeve penale që shqyrtohen dhe gjykohen në Gjykatën Supreme të Kosovës inician sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Arsyet për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm juridik, janë të përcaktuara në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

- 1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;
- 1.2. në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 i këtij Kodi; ose
- 1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.”

Mirëpo, përtej këtyre arsyeve, është e rëndësishme që të theksohet se duke u bazuar në nenin 440 të KPP-së, mjetet e jashtëzakonshme juridike, përkatësisht kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqiten edhe në bazë të të drejtave të siguruara me KPP dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ose Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.³⁹

Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendim e hedh kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse kërkesa është e papranueshme ose janë plotësuar kushtet nga neni 434, paragrafi 2 i KPP-së. Në të kundërtën, kopjen e kërkesës ia dërgon palës tjetër, e cila në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës mund të paraqesë përgjigje në kërkesë.⁴⁰ Nëse Gjykata Supreme e Kosovës nuk e hedh kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, atëherë e njëjta duhet që të vlerëson dhe të vendos në lidhje me meritat e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Në këtë drejtim, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës është vërejtur se mund të paraqiten këto situata:

- 1) që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë;
- 2) që të aprovohet/refuzohet pjesërisht kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ose
- 3) që të aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

³⁷ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.7.

³⁸ <https://www.gjyqesori-rks.org/>

³⁹ SHALA, AFRIM: Po aty, fq.7-8.

⁴⁰ Neni 435, paragrafi 2 i KPP-së.

Në rastet kur kemi disa të pandehur/dënuar për vepra penale të ndryshme apo të njëjta dhe janë paraqitur disa kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, atëherë për secilën kërkesë për mbrojtje të të ligjshmërisë veç e veç mund të paraqiten tre (3) situatat e lartcekura.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim e refuzon si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kur vërteton se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilën pretendon paraqitësi i kërkesës, ose kur kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, nga nenet 386 dhe 432, paragrafi 2 të KPP-së.⁴¹ Ndërsa, nëse Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;

1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose

1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.⁴²

Në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit, pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është *“qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”*.⁴³

Gjatë vitit 2023, Zyra e Kryeprokuroorit të Shtetit kishte paraqitur disa kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit/dënuarit, duke propozuar ndryshimin, përkatësisht anulimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me pretendimin se bëhet fjalë për *“vendime gjyqësore qartazi të papërshtatshme ose të bazuara në gabime të rënda”*.

Gjyqtarët e Degës Penale të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjatë shqyrtimit dhe analizimit paraprak të këtyre çështjeve penale dhe duke i pasur në konsideratë ndryshimet që ka pësuar tani KPP në lidhje me situatat e lartcekura, vitin e kaluar kanë mbajtur disa takime për të vlerësuar nëse është e nevojshme që të inicohet juridiksioni incidental në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjyqtarët e Degës Penale të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke përfshirë edhe anëtarët e kolegjeve të rasteve përkatëse, pas takimeve të mbajtura kanë vlerësuar se në këtë rast është e domosdoshme që të inicohet juridiksioni incidental në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ngase është parë e nevojshme që të vlerësohet nëse dispozita ligjore e nenit 438, paragrafi 2 të KPP-së (që i referohet kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur në dëm të të pandehurit) është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ndërsa një interpretim i tillë është vlerësuar se është i rëndësishëm për të vendosur edhe në këto çështje penale.

⁴¹ Neni 437 i KPP-së.

⁴² Neni 438, paragrafi 1 i KPP-së.

⁴³ Neni 438, paragrafi 2 i KPP-së.

Në këtë mënyrë dhe për arsyt e cekura më lart, është iniciuar juridiksioni incidental dhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, është kërkuar që të sqarohen disa çështje të rëndësishme, e në mesin e tyre edhe pyetja si në vijim: “nëse vendosja në dëm të të pandehurit, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të Kryeprokurorit të Shtetit, me mjet të jashtëzakonshëm juridik, bazuar në dispozitën e nenit 438, paragrafi 2 të KPP-së, është në harmoni apo jo, me parimet dhe dispozitat kushtetuese, si dhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së?”.⁴⁴

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me Aktgjykimin në rastet e bashkuara Nr. të lëndës KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, të datës 15.07.2024, sipas kërkesës së Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar kësaj çështje penale, me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, ka konstatuar se formulimi “*përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”, i paragrafit 2 të nenit 438 të KPP-së, nuk është në kundërshtim me nenin 34 (“E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër”) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (“E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy here”) të Protokollit nr.7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).⁴⁵

Duke e pasur parasysh se tani një mundësi e tillë është risi në KPP, kurse në anën tjetër, në dispozitat ligjore të KPP-së nuk është sqaruar se kur “*vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm*” ose “*i bazuar në gabim të rëndë*”, atëherë do t’i mbetet praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës që të definojë këto nocione, gjithnjë duke i pasur në konsideratë specifikat e rasteve konkrete, si dhe duke ju referuar edhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Varësisht se në cilën gjykatë kthehet çështja në rigjykim, në vijim të këtij punimi janë trajtuar çështje që ndërlidhen me kthimin e rasteve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe kthimin e rasteve në rigjykim në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

7.2 Arsyet për kthimin e çështjes në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë

Siç është theksuar edhe më parë, nëse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, atëherë varësisht nga rrethanat e secilit rast veç e veç, përveç tjerash, Gjykata Supreme e Kosovës merr aktgjykim me të cilin në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore. Siç shihet, aktgjykimet e gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, mund të anulohen:

- 1) Në tërësi ose
- 2) Pjesërisht.

⁴⁴ Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.343/2023, i datës 22.07.2024.

⁴⁵ https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2024/07/ko_114_23_ko192_23_ko227_23_ko229_23_agj_shq.pdf

Për t'u kthyer çështja në rigjykim në gjykatën themelore, përkatësisht në gjykatën e shkallës së parë, atëherë duhet që Gjykata Supreme e Kosovës të anulohë si aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, ashtu edhe aktgjykimin e gjykatës themelore.⁴⁶

Nëse janë anuluar vetëm pjesërisht aktgjykimet e gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, atëherë procedura penale në gjykatën themelore zhvillohet për atë pjesë të aktakuzës që ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykimit.⁴⁷ Anulimi i pjesërishtëm i aktgjykimeve të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës bëhet vetëm kur pjesët e posaçme të këtyre aktgjykimeve mund të veçohen pa ndonjë pasojë për gjykim të drejtë.

Në parim, shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 i KPP-së ose shkeljet tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor janë arsye për anulimin e aktgjykimit gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe kthimin e çështjes në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.⁴⁸

Mirëpo, përveç konstatimit të shkeljeve të lartcekura, për t'u anuluar aktgjykimet e gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe kthyer çështja në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë duhet që të përmbushet edhe një 1 (një) kusht që është parashikuar në nenin 402, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, e cila dispozitë ligjore aplikohet përshtatshëmrisht edhe në procedurën e vendosjes sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, përveç konstatimit të shkeljeve të lartcekura, anulimi i aktgjykimeve të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës do të mund të vjen në shprehje, vetëm në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të KPP-së, dispozitë ligjore kjo që e rregullon ndryshimin e aktgjykimeve të lartcekura. Pra, me fjalë të tjera, sipas kësaj dispozite ligjore, anulimi i aktgjykimeve të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës mund të bëhet vetëm në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të ndryshojë këto aktgjykime, për shkak të specifikave të rasteve përkatëse dhe natyrës së shkeljeve ligjore që janë përfshirë këto aktgjykime.

Megjithatë, duhet theksohet se sipas dispozitave ligjore të KPP-së, jo çdo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale është arsye për anulimin e aktgjykimit të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Njëra prej ndryshimeve, përkatësisht risive të KPP-së është pikërisht ky aspekt i kufizimit të arsyeve për anulimin e aktgjykimeve të gjykatave të lartcekura. Kështu, në nenin 403, paragrafët 2 dhe 3 të KPP-së janë parashikuar situatat kur Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore, edhe pse bëhet fjalë për disa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ndërsa këto dispozita ligjore aplikohen përshtatshëmrisht edhe me rastin e vendosjes në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Përveç kufizimit të arsyeve për anulimin e aktgjykimeve, tjetër risi e KPP-së që i referohet kësaj çështje, në rastet kur është vendosur që të kthehen çështjet në rigjykim, është edhe parashikimi i detyrimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, përkatësisht Gjykatës Supreme të Kosovës për të

⁴⁶ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, "Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile", fq.9.

⁴⁷ Neni 439, paragrafi 1 i KPP-së.

⁴⁸ SHALA, AFRIM: *Po aty*, fq.10

paraqitur në mënyrë të qartë arsyet dhe bazat se pse nuk kanë mundur që të procedojnë sipas nenit 403 të KPP-së, përkatësisht se pse nuk kanë mundur që të ndryshojnë aktgjykimet, në vend se t'i anulojnë.

Gjithashtu, duhet theksuar se në rastet kur anulohen aktgjykimi i gjykatës themelore dhe i Gjykatës së Apelit të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, atëherë në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës duhet të shënohen dispozitat ligjore të shkelura dhe në çka konsistojnë shkeljet, në pajtim me nenin 384 të KPP-së.

Duke u bazuar në nenin 439, paragrafi 2 të KPP-së, nëse është vendosur që të anulohen aktgjykimet e gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, atëherë gjykatat në fjalë detyrohen t'i ndërmarrin të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojnë të gjitha çështjet për të cilat e ka paralajmëruar Gjykata Supreme e Kosovës.

Anulimi i aktgjyqimeve dhe kthimi i çështjeve në rigjykim, kohët e fundit ka qenë një temë dhe shqetësim që është ngritur vazhdimisht nga opinioni i gjerë dhe shoqëria civile në vendin tonë, por edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, për shkak të vonesave që po shkaktohen në trajtimin e serishëm të çështjeve nga gjykatat. Si duket kjo ka qenë arsye që ka ndikuar që tani në dispozitat ligjore të KPP-së, siç është thënë edhe më lart, ligjdhënësi ka parashikuar që “jo çdo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale të jetë shkak për anulimin e aktgjyqimeve”, si dhe ka parashikuar “detyrimin që në aktgjykimin me të cilin kthehet çështja në rigjykim të paraqiten arsye në mënyrë të qartë se pse gjykata e instancës më të lartë nuk ka mundur që ta ndryshojë aktgjykimin, në vend se ta anulojë”.

Pas prezentimit të të dhënave statistikore në lidhje me kthimin e çështjeve në rigjykimin në gjykatat themelore, në vijim të këtij punimi janë elaboruara disa çështje më tipike që kanë qenë arsye që Gjykata Supreme e Kosovës të vendos anulimin e aktgjyqimeve të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, gjatë periudhës kohore 2023-2024. Për secilën prej këtyre çështjeve që do të elaborohen do të prezantohen edhe raste nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës, duke i sqaruar mandej qëndrimet e kësaj Gjykate sa i përket këtyre situatave.

7.3 Arsyet për kthimin e çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë

Nëse një çështje penale është shqyrtuar në gjykatën themelore si gjykatë e shkallës së parë, atëherë ajo çështje mund të shqyrtohet në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëse palët, personat tjerë apo përfaqësuesit e tyre kanë paraqitur ankesë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Andaj, shqyrtimi i një çështje penale nga Gjykata e Apelit të Kosovës është vetëm një mundësi, kuptohet nëse palët, personat tjerë apo përfaqësuesit e tyre paraqesin ankesë ndaj një vendimi të gjykatës themelore.⁴⁹ Kështu, një çështje penale mund të marrë epilog përfundimtar edhe pa u

⁴⁹ SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2010, fq. 85. Paraqitja e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është vetëm një mundësi e personave të autorizuar, por nuk është edhe detyrim i tyre. Se a do të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit në procedurë penale apo jo, kjo varet nga vullneti i tyre. Madje, kjo nuk është detyrim ligjor i Prokurorit të Shtetit që të paraqes ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin i akuzuari është liruar nga akuzat, siç nuk është detyrim as paraqitja e ankesës nga mbrojtja (i akuzuari dhe/ose mbrojtësi) në rastet kur i akuzuari shpallet fajtor.

shqyrtuar fare nga Gjykata e Apelit e Kosovës dhe kjo mund të ndodhë, përveç tjerash, edhe në dy (2) situata:

Së pari, një situatë e tillë mund të vjen në shprehje në rastet kur nuk është paraqitur fare ankesë kundër vendimit (aktgjykimit/aktvendimit) të gjykatës së shkallës së parë dhe një vendim i tillë është bërë i formës së prerë, pa u shqyrtuar fare nga Gjykata e Apelit e Kosovës. Në praktikën tonë gjyqësore kjo ndodhë zakonisht tek rastet që përfundojnë me marrëveshje për pranimin e fajësisë, me ndërmjetësim, disa situata në procedurën ndaj të miturve, tek rastet që kanë përfunduar me aktgjykim për dhënien e urdhrin ndëshkimor, nëse nuk është paraqitur kundërshtim,⁵⁰ etj.

Së dyti, në rastet kur nuk është paraqitur fare ankesë kundër vendimit (aktgjykimit/aktvendimit) të gjykatës së shkallës së parë, por është paraqitur vetëm mjet i jashtëzakonshëm juridik (p.sh. kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë). Edhe në këto raste që nuk janë të rralla në praktikën tonë gjyqësore, çështja penale mund të marrë epilog përfundimtar pa u trajtuar fare nga Gjykata e Apelit e Kosovës, nëse është refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Arsyet për kthimin e çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë, përkatësisht në Gjykatën e Apelit të Kosovës janë në parim disa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që do të trajtohen në vijim të këtij punimi.

Bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës, çështjet mund të kthehen në rigjykim në Gjykatën e Apelit të Kosovës, përveç tjerash, edhe në këto dy (2) situata:

1. Nëse është paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë vetëm ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës⁵¹ dhe konstatohet se një vendim i tillë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat për shkak të natyrës së shkeljes, detyrimisht imponojnë nevojën e kthimit të rastit në rigjykim në këtë Gjykatë dhe
2. Nëse është paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj vendimit të gjykatës së themelore dhe vendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, mirëpo konstatohet se vetëm vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat për shkak të natyrës së shkeljes, detyrimisht imponojnë nevojën e kthimit të çështjes në rigjykim në këtë Gjykatë, përkatësisht në gjykatën e shkallës së dytë.

⁵⁰ Neni 496 i KPP-së.

⁵¹ Në lidhje me këtë çështje, është e rëndësishme që të theksohet se në nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se “*Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon*”.

7.4 Të dhënat statistikore lidhur me kthimin e çështjeve në rigjykim

Këshilli Gjyqësor i Kosovës⁵² me vendimin KGJK.nr.292/2021, të datës 18 tetor 2021, ka miratuar Planin Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar 2022-2024.⁵³

Qëllimi i këtij plani është rritja e efikasitetit, cilësisë dhe eficiency së gjyqësorit në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Me këtë plan lëndëve të korrupsionit dhe të krimit të organizuar u caktohet prioritet absolut.

Ndërsa, me vendimin KGJK.nr.241/2022, të datës 31 maj 2022, KGJK-ja ka miratuar Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, lidhur me Efikasitetin dhe Priorizimin e Lëndëve brenda Sistemit Gjyqësor. Ky plan ka për objektiv rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit në trajtimin e lëndëve, forcimin e kapaciteteve të gjyqësorit në trajtimin e numrit të madh të lëndëve që hyjnë në kuadrin e lëndëve me prioritet të lartë, sigurimin e procedurës së drejtë gjyqësore, si dhe përcaktimin e kriterëve të priorizimit të natyrës së caktuar të lëndëve.

Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 ka për qëllim adresimin dhe zgjidhjen e lëndëve që janë me prioritet, përfshirë lëndët më të vjetra se 24 muaj, lëndët e kthyera në rigjykim, lëndët të cilat janë me prioritet të lartë sipas ligjeve përkatëse, si dhe lëndët e tjera të cilat ekzistojnë nëpër gjykata, e për të cilat duhet të ndërmerren veprime të përshpejtuara.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e këtyre planeve strategjike për sistemin gjyqësor në Republikën e Kosovës, KGJK-ja, me vendimin KGJK.nr.397/2022, të datës 20 tetor 2022, ka themeluar Komisionin për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, si dhe Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024, i cili përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Siç është theksuar edhe më lart, ndër fokuset kryesore që e ka Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 janë edhe lëndët e kthyera në rigjykim, kurse me qëllim të vlerësimit të gjendjes me lëndë të tilla, Komisioni i lartcekur ka siguruar të dhëna për sa i përket këtyre rasteve për vitin 2023 dhe së fundmi kishte hartuar një raport të cilin e kishte dorëzuar në KGJK.

Andaj, në vijim të këtij punimi do të paraqiten të dhënat në formë të grafikëve për Gjykatën Supreme të Kosovës, në Degën Civile, Degën Administrative dhe Degën Penale, sa i përket mënyrës së vendosjes, duke përfshirë këtu edhe lëndët e kthyera në rigjykim.

⁵² Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vijim do të paraqitet: KGJK.

⁵³ <https://www.gjyqesori-rks.org/planet-strategjike/>




Tabela nr.1 - Degët Civile dhe Administrative në Gjykatën Supreme të Kosovës

Nga të dhënat e paraqitura në Tabelën nr.1, shihet që në Degën Administrative të Gjykatës Supreme të Kosovës gjatë vitit 2023, në **8%** të rasteve të shqyrtuara është vendosur që të prishen (anulohen) vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta, duke i kthyer rastet në rigjykim, ndërsa në Degën Civile të Gjykatës Supreme të Kosovës, në **15.2%** të rasteve të shqyrtuara është vendosur që të prishen (anulohen) vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta, duke i kthyer rastet në rigjykim.

8 %	Kthimi në rigjykim i rasteve administrative
11.9%	Kthimi në rigjykim i rasteve civile




Tabela nr.2 - Dega Penale në Gjykatën Supreme të Kosovës

Nga Tabela nr.2, shihet që sa i përket Degës Penale të Gjykatës Supreme të Kosovës, rezulton se gjatë vitit 2023, në **4.6%** të rasteve të shqyrtuara, janë anuluar vetëm aktgjykimet (aktvendimet) e Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke i kthyer rastet në rigjykim në këtë gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, ndërsa **11.9%** të rasteve të shqyrtuara, janë anuluar aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe të gjykatave themelore, duke i kthyer rastet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4.6%	Kthimi i rasteve penale në rigjykim në Gjykatën e Apelit të Kosovës
11.9%	Kthimi i rasteve penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë

Në vazhdim janë të paraqitura të dhënat në formë të grafikëve për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në rastet kontestimore, përmbarimore, administrative, në departamentin special, në departamentin për krime të rënda, në departamentin për të mitur dhe në divizionin penal.




Tabela nr.3. - Divizioni Civil, Administrativ dhe Përmbarimore në Gjykatën e Apelit të Kosovës

Nga Tabela nr.3., shihet që në Gjykatën e Apelit të Kosovës, 125 lëndë ose 14% e rasteve administrative janë kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë; 281 lëndë ose 17% e rasteve përmbarimore janë kthyer në rigjykim, kurse 1266 lëndë ose 18% e rasteve kontestimore janë kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

14%	Kthimi në rigjykim i rasteve administrative
17%	Kthimi në rigjykim i rasteve përmbarrimore
18%	Kthimi në rigjykim i rasteve kontestimore




Tabela nr. 4. - Departamenti Special, për Krime të rënda, për të Mitur dhe Divizioni Penal në Gjykatën e Apelit të Kosovës

Nga Tabela nr.4., shihet që në Divizionin Penal, 114 lëndë ose 7% e rasteve janë kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë; në Departamentin për të Mitur, 11 lëndë ose 8% e rasteve janë kthyer në rigjykim; në Departamentin për Krime të Rënda, 80 lëndë ose 12% e rasteve janë kthyer në rigjykim, kurse në Departamentin Special, 8 lëndë ose 15% të rasteve janë kthyer në rigjykim.

7%	Divizioni Penal
8%	Departamenti për të Mitur
12%	Departamenti për Krime të Rënda
15%	Departamenti Special

Pas analizave dhe vlerësimeve të bëra, Komisioni për monitorimin, vlerësimin dhe raportim të planeve strategjike, kishte konsideruar se si Gjykata e Apelit e Kosovës, ashtu edhe Gjykata Supreme e Kosovës, do të duhej që ta shqyrtojnë mundësinë që nëse një rast fillimisht ka qenë

te një gjyqtar referues në Gjykatën e Apelit të Kosovës (Gjykatën Supreme të Kosovës) edhe ai rast është kthyer në rigjykim, në momentin kur ai rast kthehet përsëri në Gjykatën e Apelit e Kosovës (Gjykatën Supreme të Kosovës) për vendosje të serishme, atëherë t'i ndahet gjyqtarit të njëjtë referues ose kolegjit të njëjtë dhe atë për së paku dy (2) arsye:

Së pari, gjyqtari referues ose kolegji i mëparshëm janë më të njohur me rastin që është kthyer fillimisht në rigjykim, ndërsa

Së dyti, një zgjidhje e tillë do të mund të shpinte që të kthehet një numër sa më i vogël i rasteve, pasi që gjyqtari referues ose kolegji i gjyqtarëve do të jenë paraprakisht të vetëdijshëm se nëse vendosin që ta kthejnë rastin në rigjykim, atëherë rastin e njëjtë do të duhej që ta trajtojnë përsëri, nëse një rast i tillë atakohet me ankesë apo mjet të jashtëzakonshëm.

Gjithashtu, Komisioni për monitorimin, vlerësimin dhe raportim të planeve strategjike kishte vlerësuar se duke e pasur parasysh se me KPP është paraparë mundësia që edhe të ndryshohet aktgjykimi, pavarësisht që bëhet fjalë për shkelje të caktuara esenciale të dispozitave të procedurës penale, atëherë do të duhej që të shqyrtohet mundësia që Gjykata e Apelit e Kosovës ta shfrytëzoi këtë mundësi që të ndryshoj aktgjykimin, në mënyrë që lëndët të kthehen sa më pak në rigjykim, ndërsa i njëjti standard do të duhej të vlente edhe për Gjykatën Supreme të Kosovës.

7.5 Nëse aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 të KPP-së

7.5.1 Dispozitat ligjore

Neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. i KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

“Sipas propozimit të palëve, shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet vetëm ajo shkelje e cila ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë, në rastet kur aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 të këtij Kodi”.

7.5.2 Komentim i shkurtër i dispozitës ligjor të lartcekur

Sipas zgjidhjes së përcaktuar me këtë dispozitë ligjore, kjo shkelje, përbëhet nga këto elemente:

- 1) Është shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit e Kosovës vetëm sipas propozimit të palëve, pra nuk është shkelje për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare;
- 2) Duhet që aktgjykimi të mos hartohet në pajtim me nenin 369 të KPP-së dhe
- 3) Konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, vetëm nëse një shkelje e tillë ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë.⁵⁴

⁵⁴ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.77.

Kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale ka të bëjë me pa rregullësitë formale të aktgjykimit dhe përbën shkeljen më të shpeshtë në praktikën gjyqësore, për të cilën shkelje, gjykatat më të larta i anulonin aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë.⁵⁵

Siç është theksuar edhe më lart, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale ekziston në rastet kur aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim 369 të KPP-së dhe një gjë e tillë duhet të ndikojë në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë. Pra, për të ekzistuar kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, duhet që në mënyrë kumulative të përbushën këto dy (2) kushte dhe një gjë e tillë duhet të vlerësohet në secilin rast veç e veç.

Në këtë mënyrë, për të vlerësuar nëse bëhet fjalë për këtë shkelje, është e nevojshme që të analizohet dhe elaborohet neni 369 i KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar përbajtja dhe forma me shkrim e aktgjykimit. Në nenin 369, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se *“Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin e shpallur. Aktgjykimi përfshinë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin”*.

Kjo dispozitë ligjore përcakton strukturën e aktgjykimin dhe specifikon çështjen e njëjtësisë së aktgjykimit të përpiluar me shkrim me aktgjykimin e shpallur.

Me aktgjykim, si vendimi më i rëndësishëm në procedurë penale, sipas rregullit zgjidhet çështja penale në mënyrë meritore.

Aktgjykimi është njëri nga tri format e mundshme të vendimeve që merren nga gjykata gjatë procedurës penale, krahas aktvendimit dhe urdhrit. Sipas nenit 469, paragrafi 1 të KPP-së, në procedurën penale vendimet merren *“në formë të aktgjykimit, të aktvendimit dhe të urdhrit”*. Vetëm gjykata mund ta marrë aktgjykimin, kurse aktvendimin mund ta marrë edhe prokurori i shtetit, ndërsa urdhrin mund marrin edhe organet e tjera publike që marrin pjesë në procedurë penale.⁵⁶

Siç do të shohim edhe më poshtë, aktgjykimi është vendim gjyqësor i cili merret dhe shpallet në emër të popullit dhe njëherit, përfaqëson zbatimin e kodit penal në një rast konkret. Nëpërmjet tij zbatohen masat e shtrëngimit shtetëror kundër atyre që është vërtetuar se kanë kryer ndonjë vepër penale. Aktgjykimi i formës së prerë e ka fuqinë e ligjit për çështjen konkrete penale që është zgjidhur me të dhe si i tillë është i detyrueshëm për të gjithë.⁵⁷ Dhënia e aktgjykimit, pra është e drejtë ekskluzive e gjykatës. Me të bëhet formimi faktik dhe juridik i çështjes penale, ndërsa ai jepet pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.⁵⁸

⁵⁵ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: *Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar*, fq. 902.

⁵⁶ Neni 469, paragrafi 2 të KPP-së.

⁵⁷ Vendimi përfundimtar i gjykatës është sinteza e gjykimit dhe përfaqëson zgjidhjen e çështjes në themel mbi bazën e provave të administruara në shqyrtim gjyqësor. Ai shpreh bindjen e gjyqtarëve për ekzistencën ose jo të faktit, për fajësinë e të pandehurit dhe për shkallën e rrezikshmërisë së tij shoqërore. Kjo bindje duhet të përputhet me kërkesat e ligjit penal, të atij material dhe procedural. Në bazë të nenit 380 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, për marrjen e vendimit, gjykata përdorë vetëm provat që janë marrë ose janë verifikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. ISLAMI, HALIM; HOXHA, ARTAN; PANDA, ILIR: *Procedura penale, Komentar*, Tiranë, 2003, fq. 496.

⁵⁸ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2016, fq.387.

Në rastet kur i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga neni 242, paragrafi 2 të KPP-së, atëherë merr aktvendim për miratimin e pranimit të fajësisë dhe procedon me shqiptimin e dënimit, e caktton seancën sipas nenit 356 të këtij Kodi për të përcaktuar çështje që janë të rëndësishme për shqiptimin e dënimit⁵⁹ ose e pezullon shqiptimin e dënimit deri në përfundimin e bashkëpunimit nga i pandehuri me prokurorin e shtetit. Në këto situata, mandej merret aktgjykim pas përfundimit të shqyrtimi fillestar dhe një aktgjykim i tillë bazohet mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe të miratuar nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues.⁶⁰

Duke u bazuar në nenin 369, paragrafi 1 të KPP-së, aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin e shpallur.⁶¹ Pra, aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë identik me aktgjykimin të cilin e ka shpallur gjykata. Gjithashtu, edhe aktgjykimi i shpallur nga gjykata duhet të jetë në përputhje, përkatësisht identik me dispozitivin e aktgjykimit të shënuar në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor.⁶²

7.5.3 Pjesët përbërëse të aktgjykimit

Sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 369, paragrafi 1 të KPP-së, aktgjykimi duhet të përfshinë : **hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin.**⁶³

Pjesa hyrëse

Hyrja e aktgjykimit përfshin: shënimin se aktgjykimi merret në emër të popullit,⁶⁴ emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar dhe nëse ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ditën e shqyrtimit gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit,

⁵⁹ SHALA, AFRIM: Disa aspekte praktike të seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin, Revista shkencore juridike “*Opinio Juris*”, Prishtinë, 2016, fq. 1-8.

⁶⁰ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.78.

⁶¹ Shpalljen e aktgjykimit e rregullon neni 365 i KPP-së.

⁶² Neni 315, paragrafi 1 të KPP-së.

⁶³ Gjithashtu, pjesë përbërëse e aktgjykimit duhet të jetë edhe “*Udhëzimi për të drejtën në ankesë*”. Shih nenin 369, paragrafët 5 dhe 6 dhe nenin 473, paragrafi 3 të KPP-së. Udhëzimi për të drejtën në ankesë përmban këshilla juridike se kundër aktgjykimit lejohet paraqitja e ankesës, nga palët dhe personat tjerë të autorizuar, sipas nenit 381 të KPP-së, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes aktgjykimit. Ankesa duhet që t’i dorëzohet gjykatës themelore në numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën dhe për palën tjetër.

⁶⁴ Në Republikën e Shqipërisë, gjykatat i japin vendimet “*Në emër të Republikës*” (Neni 146, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 112, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë). Në Republikën e Kroacisë, aktgjykimi merret dhe shpallet “*Në emër të Republikës së Kroacisë*” (neni 117, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kroacisë, si dhe neni 366, paragrafi 2 dhe neni 376, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kroacisë), kurse në Mbretërinë e Holandës, aktgjykimi merret “*Në emër të Mbretit*” (neni 554, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale).

mbrojtësit, mbrojtësit të viktimave ose përfaqësuesit të viktimës të cilët kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, datën e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe datën e përpilimit të aktgjykimit.⁶⁵

Dispozitivi i aktgjykimit

Dispozitivi i aktgjykimit përfshin: të dhënat personale të të akuzuarit dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprë penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuzë për atë veprë apo me të cilin refuzohet aktakuza.⁶⁶

“Të dhëna personale” përfshijnë informacionin personal si vijon: emrin, mbiemrin, emrin e qytetit të lindjes ose vendbanimit, funksionin publik të të pandehurit nëse ka dhe numrin personal. Kur numri personal nuk është në dispozicion, atëherë në vend të tij mund të përdoren data e lindjes, emri i nënës prind dhe vendlindja.

Të dhënat personale shtesë, ashtu siç kuptohet ky term nga ligjet tjera, mund të shtohen vetëm nëse është e nevojshme për të shpjeguar rrethanat kontekstuale të veprave penale.⁶⁷

Është e rëndësishme që të theksohet se përveç numrit personal, datës së lindjes, emrit të prindërve dhe vendlindjes, publikimi i të dhënave të tjera personale të lartcekura, nuk konsiderohet shkelje e privatësisë, për shkak të interesit të publikut për një gjyqësor të hapur dhe publik.⁶⁸

Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 364 të KPP-së, ndërsa kur ai është liruar nga akuzë ose akuzë është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar, vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike, nëse një kërkesë e tillë është paraqitur.

Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:

1. Veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;
2. Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit;
3. Vendimin për konfiskimin e pasurisë së specifikuar;
4. Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike;
5. Taksën për Programin e Kompensimit të Viktimave sipas ligjit në fuqi; dhe

⁶⁵ Neni 369, paragrafi 2 i KPP-së.

⁶⁶ Sipas neni 361 të KPP-së, me aktgjykim ose refuzohet akuzë, ose i akuzuari lirohet nga akuzë, ose shpallet fajtor. Kur akuzë përfshin disa vepra penale, në aktgjykim shënohet nëse dhe për cilën veprë është refuzuar akuzë, apo nëse dhe për cilën veprë i akuzuari lirohet ose shpallet fajtor. Andaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore ekzistojnë këto katër (4) forma të aktgjykimit : 1) aktgjykim refuzues; 2) aktgjykim liruës; 3) aktgjykim fajësues dhe 4) variante të kombinuara të këtyre aktgjykimeve. Aktgjykim i fajësues është një nocion më i gjerë se sa aktgjykim i dënues, pasi që në vetë ngërthen edhe aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor, por që është liruar nga dënimi, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK-së.

⁶⁷ Neni 369, paragrafi 12 të KPP-së.

⁶⁸ Neni 369, paragrafi 13 i KPP-së.

6. Aktgjykimi gjithashtu duhet të theksojë nëse aktgjykimi i formës së prerë duhet të shpallet në shtyp, radio ose televizion.⁶⁹

Nëse nuk është bërë kërkesë për seancën për caktimin e dënimit⁷⁰ nga prokurori i shtetit, i akuzuari ose mbrojtësi i tij, gjykata në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor gjithashtu shënon:

1. Dënimin e shqiptuar të akuzuarit, duke përfshirë edhe dënimin alternativ nga Kodi Penal ose lirimin nga dënimi;
2. Vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm në lartësinë e dënimit;
3. Urdhrin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të kryesve të varur nga droga dhe alkooli;
4. Kur i akuzuari dënohet me gjobë, në aktgjykim shënohet afati kur duhet paguar gjoba dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës kur gjoba forcërisht nuk mund të arkëtohet.

Siç është theksuar edhe më lart, në nenin 369, paragrafi 4 të KPP-së është parashikuar se kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 364 të këtij Kodi, ndërsa, në nën-paragrafin 11., paragrafi 1 të këtij neni është parashikuar se gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal.

Pikërisht ky element i dispozitivit të aktgjykimit dënuës ka qenë njëri prej pretendimeve që është paraqitur mjaft shpesh në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe është trajtuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, andaj edhe si i tillë, është vlerësuar se është e rëndësishme që të elaborohet më hollësisht. Kjo edhe për faktin se pikërisht ky element i dispozitivit të aktgjykimit dënuës ka qenë arsye për anulimin e disa aktgjykimeve nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe kthimin e rasteve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.⁷¹

Pra, bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata duhet që në dispozitivin e aktgjykimit dënuës të shënon veprën për të cilën shpallet fajtor i akuzuari, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal.

Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.⁷²

Secila vepër penale në vete posedon elementet e saja, të cilat ndahen në dy (2) grupe:

- 1) Elemente themelore apo të përgjithshme të veprës penale dhe

⁶⁹ Neni 364, paragrafi 1 i KPP-së.

⁷⁰ Seanca për caktimin e dënimit është rregulluar më hollësisht me dispozitat ligjore të nenit 356 të KPP-së.

⁷¹ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, "Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile", fq.81-82.

⁷² Neni 7 i KPRK-së.

- 2) Elemente të posaçme të veprës penale.
- 1) Elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale janë:
 - a) Veprimi i njeriut;
 - b) Kundërligjshmëria;
 - c) Përcaktueshmëria e veprës penale në ligj dhe
 - d) Përgjegjësia penale e kryesit.

Çdo veprim apo mosveprim, për t'u konsideruar veprë penale, duhet të posedojë në mënyrë kumulative të gjitha këto elemente. Të gjitha këto elemente së bashku përbëjnë anatominë e veprës penale dhe çdonjëri prej tyre është pjesë e strukturës së veprës penale. Këto elemente e përbëjnë të ashtuquajturën **“figurë të përgjithshme të veprës penale”**.⁷³ Me gjithë faktin se vepra penale përbëhet prej këtyre katër (4) elementeve themelore, vepra penale është unike, një tërësi, ngase vetëm tërësia e tyre formon kuptimin e plotë social dhe juridik. Për nga rëndësia e tyre shoqërore dhe juridike, të gjitha këto elemente janë të njëjta. Së këndejmi, nëse mungon njëri prej këtyre elementeve, vepra penale nuk mund të ekzistojë. Pra, të gjitha këto elemente janë pjesë konstituive të çdo veprë penale. Varësisht se prej çfarë këndi vështrohen, elementet themelore të veprës penale mund të ndahen në dy (2) grupe :

1. Elemente objektive dhe
2. Elemente subjektive.

Në grupin e elementeve objektive bëjnë pjesë: veprimi i njeriut (veprimi me pasojën e shkaktuar); kundërligjshmëria dhe përcaktueshmëria e veprës penale në ligj, ndërsa, në grupin e elementeve subjektive bën pjesë vetëm përgjegjësia penale e kryesit (fajësia).⁷⁴

2) Elementet e posaçme të veprës penale janë ato elemente që nuk janë të përbashkëta për të gjitha veprat penale, por që paraqiten te disa vepra penale dhe janë elemente që ndikojnë që një veprë penale të dallohet prej një veprë tjetër penale.⁷⁵ Elementet e posaçme të veprës penale ndryshe emërtohen edhe si **”tipare të veprës së caktuar penale”** dhe njëherazi tërësia e elementeve të veprës penale të caktuar e përbëjnë **“figurën e veprës penale”**, që specifikohet në nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së. Ndërsa, elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale duhet të shprehen te çdo veprë penale dhe ato në fakt e sajojnë kuptimin e përgjithshëm të veprës penale. Nga kjo del se, përderisa elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale (veprimi, kundërligjshmëria etj.), duhet të shprehen te çdo veprë penale, elementet e posaçme janë tipare apo janë karakteristikë e veprës penale të caktuar dhe këto shprehen krahas elementeve të përgjithshme. Pra, çdo veprë penale i posedon elementet e veta të posaçme, që shprehen krahas elementeve të përgjithshme dhe që bëjnë që një veprë penale të dallohet nga vepra tjetër penale.

⁷³ SHALA, AFRIM: *Hyrje në të drejtën penale*, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023, fq. 60.

⁷⁴ SHALA, AFRIM: *Hyrje në të drejtën penale*, fq. 51.

⁷⁵ SHALA, AFRIM: *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, Gjilan, 2010, fq. 27.

Figura e veprës penale sajohet duke përcaktuar elementet e posaçme veç e veç dhe duke bërë sintetizimin dhe përgjithësimin e tyre në dispozitën e caktuar penalo-juridike. Kështu, p.sh. vepra penale “*Grabitja*”, nga neni 317, paragrafi 1 i KPRK-së, përbëhet prej këtyre elementeve:⁷⁶

- 1) Kryesi duke e përdorur forcën apo kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër;
- 2) E përvetëson;
- 3) Pasurinë e luajtshme;
- 4) Të personit të tillë dhe
- 5) Me qëllim që t’i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme.

Vepra penale “*Marrja e rryshfetit*”, nga neni 421, paragrafi 1 i KPRK-së, përbëhet prej këtyre elementeve:

- 1) Personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj;
- 2) I cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë,
- 3) Kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë,
- 4) Në mënyrë që personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

Ose vepra penale “*Vjedhja*”, nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së, përbëhet prej këtyre elementeve:

- 1) marrja;
- 2) e pasurisë së tjetrit;
- 3) pasuria të jetë vlerësuar në shumën prej pesëdhjetë (50) euro dhe
- 4) me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ose për personin tjetër.⁷⁷

Pra, me figurë të veprës penale kuptojmë të gjitha elementet e posaçme të një vepre penale. Andaj, edhe shtrohet pyetja se çka kuptojmë me elemente të posaçme të veprës penale konkrete?

Elementet e posaçme të veprës penale të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale janë ato elemente që nuk janë të përbashkëta për të gjitha veprat penale, por që paraqiten te disa vepra penale dhe që e dallojnë një vepër penale prej një vepre tjetër penale. Çdo vepër penale i posedon elementet e veta të posaçme. Në raport me elementet e përgjithshme, elementet e posaçme të veprës penale në fakt janë një lloj konkretizimi i elementeve të përgjithshme. Pa përcaktimin e elementeve të posaçme nuk mund të bëhet kualifikimi ose cilësimi i veprës penale.⁷⁸

Sikurse elementet e përgjithshme, edhe elementet e posaçme të veprës penale, mund të ndahen në dy (2) grupe :

⁷⁶ SHALA, AFRIM: *Hyrje në të drejtën penale*, fq. 51-52.

⁷⁷ SHALA, AFRIM: *Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale)*, Prishtinë, 2021 (bashkautor), fq. 120.

⁷⁸ SHALA, AFRIM: *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, fq. 27.

- 1) Elemente të karakterit objektiv dhe
- 2) Elemente të karakterit subjektiv.

Elementet e karakterit objektiv - Njëri ndër elementet e figurës së veprës penale të caktuar, i natyrës objektive është **veprimi i kryerjes së veprës penale konkrete**. Çdo vepër penale e parashikuar në pjesën e posaçme të KPRK-së nënkupton ndërmarrjen e një veprimi të caktuar.

Veprimi i kryerjes së veprës penale mund të jetë i natyrave të ndryshme, kështu p.sh.

- gjuajtja me armë, te vepra penale “*Vrasja*”, nga neni 172 i KPRK-së,
- marrja e pasurisë së huaj, te vepra penale “*Vjedhja*”, nga neni 313 i KPRK-së,
- kryerja e aktit seksual me paraardhës apo pasardhës, te vepra penale “*Marrëdhëniet seksuale brenda familjeve*”, nga neni 236 i KPRK-së, etj.

Në të gjitha këto raste, ekziston veprimi i kryerjes, mirëpo veprimi i kryerjes është i natyrës së ndryshme dhe si rezultat i kësaj, një vepër penale dallohet prej veprës tjetër penale, p.sh. gjuajtja me armë, marrja e sendit të huaj, kryerja e aktit seksual me paraardhës apo pasardhës, janë veprime të kryerjes së veprës penale të caktuar. Meqë këto veprime janë të ndryshme, atëherë bëjnë që edhe veprat penale të jenë të ndryshme.

Element tjetër i natyrës objektive i figurës së veprës penale është edhe **pasoja**. Në disa raste për të ekzistuar vepra penale konkrete, duhet që të ekzistojë pasoja e caktuar. Pasoja e veprës penale, në disa raste është element që e dallon një vepër penale prej veprës tjetër penale. Pasoja e veprës penale mund të jetë e natyrave të ndryshme, kështu p.sh.

- te vepra penale “*Privimi i kundërligjshëm nga liria*”, nga neni 193 i KPRK-së, pasoja qëndron në privimin e kundërligjshëm të një personi nga liria;
- te vepra penale “*Asgjësimi ose dëmtimi i pasurisë*”, nga neni 321 i KPRK-së, pasoja qëndron në asgjësimin, dëmtimin apo bërjen të papërdorshme të pasurisë së personit tjetër;
- te vepra penale “*Vrasja*”, nga neni 172 i KPRK, pasoja qëndron në privimin e një personi tjetër nga jeta, etj.

Në të gjitha këto raste pasojat e veprave penale janë të ndryshme dhe si rezultat i kësaj bëjnë që të jenë të ndryshme edhe veprat penale.⁷⁹

Në disa raste një vepër penale dallohet prej një vepre tjetër penale, varësisht nga fakti se në çfarë mënyre është kryer vepra penale. Pra, **mënyra e posaçme e kryerjes së veprës penale** është element që e dallon një vepër penale prej veprës tjetër. Kështu, element që e dallon veprën penale “*Vrasja*”, nga neni 172 i KPRK-së nga vepra penale “*Vrasja e rëndë*”, nga neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. i KPRK-së, është mënyra e kryerjes së veprës penale. P.sh. nëse personi A. e privon nga jeta personin B. në mënyrë mizore apo dinake, atëherë në veprimet e personit A. qëndrojnë elementet e veprës penale “*Vrasja e rëndë*”, nga neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK-së, e jo të veprës penale “*Vrasja*”, nga neni 172 i KPRK-së.

Po ashtu, edhe **vlera e objektit të mbrojtur** në të drejtën penale mund të jetë rrethanë vendimtare për ta kualifikuar një vepër penale. Kështu, nëse personi A. e vjedh një send që ka vlerë mbi pesë mijë (5000) Euro dhe personi A. ka vepruar me qëllim të përvetësimit të sendit me vlerë të tillë, atëherë në veprimet e personit A. qëndrojnë elementet e veprës penale “*Vjedhja*

⁷⁹ SHALA, AFRIM: *Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional*, fq. 121.

e rëndë”, nga neni 315, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së, e jo të veprës penale “Vjedhja”, nga neni 313, paragrafi 1 të KPRK-së. Pra, këto dy vepra penale dallojnë në mes vete, edhe për shkak të vlerës së sendit të vjedhur.

Në rastet e tjera, për të ekzistuar vepra penale e caktuar, është e nevojshme që të jenë përdorur **mjetet e caktuara**. Kështu, vepra penale “Peshkimi i kundërligjshëm”, nga neni 353, paragrafi 2 të KPRK-së, ekziston nëse kryesi peshkon duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese.

Te disa vepra penale është i nevojshëm që veprimi të jetë ndërmarrë gjatë **kohës së caktuar**. Kështu, vepra penale “Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë”, nga neni 250 i KPRK-së, mund të kryhet vetëm gjatë kohës së epidemisë; “Krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me Konventat e Gjenevës”, nga neni 144 i KPRK-së mund të kryhen vetëm gjatë kohës së luftës (konfliktit të armatosur), etj.

Edhe **vendi i kryerjes së veprës penale**, mund të jetë element konstituiv i veprës penale. Kështu, vepra penale “Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare”, nga neni 140 i KPRK-së mund të kryhet në vendet rreth kufirit ose vijës kufitare të Republikës së Kosovës, përveç në kufirin ose vendkalimet e autorizuara kufitare.

Cilësia e caktuar personale e kryesit apo marrëdhënia e caktuar, janë tipare të një varg veprash penale, kështu që këto vepra penale mund t’i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara apo që gjenden në raporte të caktuara. Veprat penale të cilat mund t’i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara apo që gjenden në marrëdhënie të caktuar, ndryshe quhen edhe si “*delicta propria*”. Në këtë aspekt, disa vepra penale mund t’i kryejnë vetëm “personat zyrtarë” (neni 194, 195, 198, 414, 416, 417, 418, 421, etj.) apo “personat përgjegjës” (neni 279, 284, 285, etj.), “mjeku” (neni 254, 255, etj), “farmacisti” (neni 258, etj), “gjyqtari” (neni 425, etj.), “dëshmitari” (neni 384), etj. Kurse, disa vepra tjera mund t’i kryejnë vetëm personat që gjenden në marrëdhënie të caktuar, “marrëdhënie familjare”, (neni 182 paragrafi 2, etj.), etj. Ose, veprën penale “Vrasja e foshnjeve gjatë lindjes”, nga neni 176 i KPRK-së, mund ta kryejë vetëm “nëna”, e cila gjendet në raporte personale me viktimen - foshnjën.

Gjithashtu, edhe **cilësia personale e viktimës** mund të jetë element konstituiv i një vepre penale. Kështu, vepra penale “Vrasja e rëndë”, nga neni 173, paragrafi 1, nën-paragrafët 1. dhe 2. të KPRK-së, ekziston nëse privohet nga jeta fëmija përkatësisht gruaja shtatëzënë.

Përveç këtyre, në pjesën e posaçme të KPRK-së, janë parashikuar edhe shumë elemente tjera të natyës objektive.

Elementet e karakterit subjektiv - Për ekzistimin e disa veprave penale duhet që te kryesi i veprës penale të manifestohen edhe elemente të karakterit subjektiv. Në këtë aspekt, rëndësi të posaçme ka qëllimi dhe motivi i kryesit, të cilat duhet të ekzistojnë në momentin e kryerjes së veprës penale.

Për ekzistimin e disa veprave penale duhet që ato të jenë kryer me **qëllim të caktuar**. Vepra penale “Vjedhja”, nga neni 313, paragrafi 1 i KPRK-së, ekziston vetëm nëse personi A. e merr automjetin e personit B. me qëllim të përvetësimit të tij për vete ose për personin tjetër. Nëse personi A. automjetin e personit B. nuk e ka marr me këtë qëllim, por vetëm sa për t’i kryer disa punë në qytetet tjera, atëherë do të ekzistojnë vepra penale “Marrja në posedim e pasurisë së

luajtshme”, nga neni 319 i KPRK-së. Pastaj, vepra penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, nga neni 390 i KPRK-së, konsiderohet se është kryer vetëm nëse falsifikimi i dokumentit është bërë me qëllim që ai dokument të përdoret si i vërtetë.

Në disa raste edhe **motivi** është parashikuar si element konstituiv i veprës së caktuar penale. Në këtë drejtim, vepra penale “*Vrasja e rëndë*”, nga neni 173, paragrafi 1, nën-paragrafi 110 i KPRK-së, ekziston vetëm nëse kryësi e privon nga jeta personin tjetër i motivuar në bazë kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit, etj.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, gjykata duhet që në aktgjykim të shënon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme veprën penale për të cilën shpallet fajtor i akuzuari, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës ligjore përkatëse të KPRK-së.

Përveç kësaj, në dispozitiv të aktgjykimit duhet shënuar edhe emërtimi ligjor i veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit. Njëherit, këto dy (2) elemente, vepra penale, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe emërtimi ligjor i veprës penale, së bashku me dispozitat e ligjit penal, janë pjesë tejet të rëndësishme të dispozitivit të aktgjykimit.⁸⁰

Emërtimi ligjor i veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal janë të ndërlidhura në mes vete dhe trajtohen së bashku, andaj edhe si të tilla nuk duhet të jenë në kundërshtim njëra me tjetrën. Kështu, p.sh. te vepra penale “*Vrasja*”, nga neni 172 i KPRK-së, emërtimi ligjor i veprës penale është “*Vrasja*”, kurse dispozita e ligjit penal është neni 172 i KPRK-së, në të cilën është parashikuar kjo vepër penale. Apo, te vepra penale “*Vjedhja*”, nga neni 313 i KPRK-së, emërtimi ligjor i veprës penale është “*Vjedhja*”, kurse dispozita e ligjit penal është neni 313 i KPRK-së, në të cilën është parashikuar kjo vepër penale.

Gjithashtu, dispozitivi i aktgjykimit duhet të përfshijë edhe dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit ose lirimim nga dënimi, si dhe vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm në lartësinë e dënimit.⁸¹

Në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata duhet që të precizojë në mënyrë të qartë llojin e dënimit të cilin ja ka shqiptuar të akuzuarit dhe kohëzgjatjen e tij apo shumën e dënimit me gjobë, duke përfshirë këtu edhe mënyrën e ekzekutimit.

Po ashtu, në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata duhet të shënon edhe vendimin për konfiskimin e pasurisë së specifikuar, vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike, taksën për Programin e Kompensimit të Viktimave sipas ligjit në fuqi, nëse aktgjykimi i formës së prerë duhet të shpallet në shtyp, radio ose television dhe urdhrin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të kryesve të varur nga droga dhe alkooli, ndërsa

⁸⁰ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.88.

⁸¹ Llogaritja e paraburgimit, arrestit shtëpiak dhe çdo periudhe të heqjes së lirisë lidhur me veprën penale bëhet duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së. Në këtë drejtim, për qëllime të llogaritjes: një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim dhe njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë janë të barabartë. Ndërsa, sipas nenit 57 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, një (1) ditë paraburgim barazohet me një (1) ditë e gjysmë burgim.

nëse është shqiptuar dënimi me gjobë, atëherë në aktgjykim, atëherë shënohet afati kur duhet paguar gjoba dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës kur gjoba forcërisht nuk mund të arkëtohet.⁸²

Kurse, në rastet rastet e veprave penale në bashkim,⁸³ atëherë sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 369, paragrafi 5 të KPP-së, në rastin e gjykimin të veprave penale të tilla, gjykata në dispozitivin e aktgjykimin shënon dënimet e shqiptuara për secilën vepër penale, e pastaj dënimin për të gjitha veprat në bashkim.⁸⁴

Të gjitha këto elemente që u paraqiten më lart duhet që të shënohen në dispozitiv të aktgjykimin në mënyrë të qartë dhe kuptueshme. Përndryshe, kur dispozitivin i aktgjykimin nuk përmban këto elemente, të cilat është dashur të shënohen apo në dispozitivin të aktgjykimin nuk janë shënuar dhe specifikuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme këto elemente, ndërsa kjo ndikon në marrjen e një aktgjykimin të ligjshëm dhe të drejtë, atëherë një gjë e tillë paraqet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 27. lidhur me nenin 369, paragrafët 3, 4 dhe 5 të KPP-së.⁸⁵

7.6 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e dispozitivin të aktgjykimin

Çështja e dispozitivin të aktgjykimin është trajtuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore.

Në shumë raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, është vërejtur se çështja e dispozitivin të aktgjykimin është ndërlidhur edhe me çështjen e arsytimit, e cila temë do të trajtohet në vijim.

Sidoqoftë, në vijim do të paraqiten disa raste që kanë të bëjnë me këtë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që ndërlidhet me dispozitivin e aktgjykimin, ndërsa disa raste tjera me dispozitivin dhe arsytimin e aktgjykimin:

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.273/2024, i datës 16.05.2024

A K T G J Y K I M

Me aprovimin si të bazuar të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit N.A., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.1054/2019, i datës 06.11.2023

⁸² Neni 364 i KPRK-së.

⁸³ Bashkimi i veprave penale ekziston atëherë kur kryesi kryen dy apo më shumë vepra penale, për të cilat në të njëjtën kohë zhvillohet procedura penale dhe për të gjitha veprat penale të kryera shqiptohet një dënim unik. Nga kjo shihet se për t'u konsideruar se ekziston bashkimi i veprave penale, duhet të përmbushen këto kushte në mënyrë kumulative: që të jenë kryer dy apo më shumë vepra penale; që këto vepra të jenë kryer nga i njëjti person dhe që për këto vepra kryesi të mos ketë qenë i dënuar më parë. Më gjerësisht lidhur me këtë temë, shih: SHALA, AFRIM: *Hyrje në të drejtën penale*, fq. 159-166.

⁸⁴ Në nenin 76 të KPRK-së janë përcaktuar rregullat për shqiptimin e dënimeve për bashkim të veprave penale.

⁸⁵ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, "Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile", fq.88-89.

dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1654/2023, i datës 12.03.2024, ashtu që kjo çështje penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.1054/2019, i datës 06.11.2023, i dënuari N.A., është shpall fajtor për shkak të veprës penale “Vjedhja e shërbimeve”, të parashikuar me nenin 314 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej njëmijepesëqind (1,500) euro, të cilin dënim është detyruar që ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa në rast se i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43, paragrafi 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do të shndërrohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë do të llogaritet një (1) ditë të dënimit me burgim.

Është detyruar i dënuari N.A., që të dëmtuarës KEDS - Distrikti në Ferizaj, t’ia kompensojë dëmin material të shkaktuar në shumë prej nëntëmbëdhjetëmijegjashtëqindkatër-mbëdhjetë euro e pesë cent (19.614,05 euro), në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Është detyruar i dënuari N.A. që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej njëzetë (20) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1654/2023, e datës 12.03.2024, e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, vetëm sa i përket vendimit lidhur me dënimin, ashtu që për shkak të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, të dënuarit N.A., i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej shtatëqind (700) euro, të cilën i dënuari është detyruar që ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, kurse në pjesën tjetër, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka mbetur i pandryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit N.A., avokati Jakup Ramadani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar, ashtu që këto aktgjykime të anulohen, ndërsa kjo çështje penale t’i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit N.A., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës

penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 4, 6 dhe 7 të KPP-së.

Fillimisht është e rëndësishme që të theksohet se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk rezulton që të jenë të paraqitura të gjitha veprimet inkriminuese në mënyrë të qartë, bazuar në shkresat e lëndës, në veçanti nuk është sqaruar mjaftueshëm se si është kryer kjo veprë penale, cilat pajisje janë shfrytëzuar dhe në çka konsiston lajthimi në këtë rast, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafi 4 lidhur me nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së.

Gjithashtu, në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së është parashikuar se “Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit”, kurse në paragrafin 7 të këtij neni, është parashikuar se “Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij”.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar duke u bazuar në këto dispozita ligjore, pasi që në pjesën e arsyetimit nuk janë paraqitur arsye të qarta dhe të kuptueshme se mbi bazën e cilave prova, gjykata në fjalë ka konstatuar shumën e dëmit të shkaktuar, si dhe nuk ka arritur që të paraqes arsye të mjaftueshme në lidhje me vendimin përkitazi me kërkesën pasurore juridike, por që është mjaftuar vetëm duke e cekur dispozitën ligjore të nenit 462, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së.

Gjithashtu, në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të lartcekur shihet që gjykata e shkallës së parë vetëm i ka listuar disa prova materiale, mirëpo nuk ka arritur që të bëjë ndonjë vlerësim dhe analizim të këtyre provave në raport me provat tjera, ashtu siç është parashikuar në nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së, siç nuk ka arritur as që të përcaktojë se cilat fakte janë vërtetuar përmes këtyre provave.

Në anën tjetër, edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka arritur që të evitojë të metat e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, përveç tjerash, edhe për faktin se gjykata në fjalë nuk ka vlerësuar, shqyrtuar dhe arsyetuar pretendimet thelbësore të paraqitura në ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ashtu siç është parashikuar në nenin 404, paragrafi 1 të KPP-së.

Kështu, në këtë aspekt, gjykata e shkallës së dytë nuk e ka vlerësuar dhe shqyrtuar fare pretendimin e mbrojtësit në lidhje me shqyrtimin e mundësisë së caktimit të një eksperti nga fusha e energjisë elektrike për të përcaktuar dhe llogaritur dëmin në këtë rast.

Andaj, në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë sqaruar dhe arsyetuar

mjaftueshëm as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke paraqitur në mënyrë të qartë të gjitha veprimet inkriminuese, në veçanti duke sqaruar mjaftueshëm se si është kryer kjo vepër penale, cilat pajisje janë shfrytëzuar dhe në çka konsiston lajthimi në këtë rast, ndërsa më pastaj të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, në veçanti sa i përket çështjes së dëmit të shkaktuar dhe vendimit lidhur me kërkesën pasurore juridike, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Gjithashtu, për shkak të specifikave të rastit konkret, gjykata e shkallës së parë do të duhej që të shqyrton mundësinë e caktimit të një eksperti nga fusha e energjisë elektrike për të sqaruar aspekte të caktuara që ndërlidhen me dëmin, të cilat me të drejtë janë theksuar edhe nga mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.16/2024, i datës 16.01.2024

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit A.J., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan P.nr.174/2022 i datës 20.02.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.526/2023 i datës 18.09.2023 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, me aktgjykimin P.nr.174/2022 e datës 20.02.2023, të dënuarin A.J. e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 50 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumë prej 20 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.526/2023 e datës 18.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Shpëtim Sadiku nga Lipjani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.07/2024 e datës 10.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet në kërkesë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, meqë gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin të saj nuk ka paraqitur arsyetim me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit.

Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim të plotë, por në aktgjykimin e saj vetëm është bërë përshkrimi i mbrojtjes së të dënuarit dhe dëshmisë së dëshmitares- të dëmtuarës pa vlerësuar fare besueshmërinë e deklarimeve të tyre. Për më tepër, nuk është paraqitur arsyetim përkitazi me mos dëgjimin e ekspertit mjeko-ligjor, përkundër faktit se bazuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 14.12.2022 i njëjti ishte planifikuar të dëgjohet në shqyrtimin e datës 19.01.2023, mirëpo në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk është dhënë arsyetim se pse nuk u dëgjua eksperti në shqyrtimet gjyqësore në vijim të këtij procesi dhe me këtë të i mundësohej edhe palës tjetër përkatësisht mbrojtjes së të dënuarit të parashtrroj pyetje përkitazi me rrethanën se si ka ardhur eksperti deri tek përfundimi lidhur me ekspertizën mjeko-ligjore përkitazi me natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore të pësuar nga ana e të dëmtuarës dhe posaçërisht faktin se ekspertizën e tij e ka mbështetur duke u bazuar vetëm në fotografitë e të dëmtuarës dhe pa dokumentacion tjetër mjekësor, pretendime këto të theksuara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në këtë aspekt i rëndësishëm është edhe fakti se nuk është i njohur burimi e as data e fotografisë së të dëmtuarës dhe kjo duke u bazuar në shkresat e lëndës del se vepra penale pretendohet se

është kryer me datë 17.11.2022, e dëmtuara rastin e ka paraqitur me datë 08.02.2022, kurse fotografitë përkitazi me lëndimet trupore i ka prezantuar gjatë marrjes në pyetje në polici, gjegjësisht me datë 21.08.2022 e që të gjitha këto aspekte nuk janë shqyrtuar dhe arsyetuar mjaftueshëm me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu mos dëgjimi i dëshmitarëve Haxhi Hysenaj dhe Fazli Hysenaj del të jetë bërë në interpretim të gabuar të dispozitave të procedurës penale, meqë dispozita e nenit 127 të KPP-së ka përcaktuar lirimin e dëshmitarëve nga detyrimi për të mos dëshmuar në raport me të pandehurin dhe jo të dëmtuarën dhe kjo duke pasur parasysh se dëshmitarët dhe i dënuari nuk kanë lidhje për të cilat do të mund të liroheshin nga detyrimi për të dëshmuar në këtë çështje penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsyetim përkitazi me faktin se cilat ishin veprimet konkrete të të dënuarit në vazhdimësi, përveç se në dispozitivin e aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë është potencuar fjala në vazhdimësi dhe i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale të kryer në vazhdim, megjithatë përshkrimi i veprimeve të të dënuarit përqendrohet vetëm në përshkrimin e veprimeve të tij gjatë datës 17.11.2021, pra nuk ka përshkrim të veprimeve të të dënuarit në vazhdimësi (siç potencohet në përshkrimin e dispozitivit të aktgjyimit) që do të mund të cilësonin veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Për më tepër, neni 77 i KPRK-së ka përcaktuar kushte të posaçme për tu trajtuar një veprë penale në vazhdim, mirëpo për këtë aspekt nuk është dhënë arsyetim nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe kjo mënyrë e përshkrimit të dispozitivit të aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë paraqet një disharmoni mes përshkrimit të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjyimit dhe është në kundërshtim me shkresat e lëndës, meqë në shkresat e lëndës del se i dënuari veprimin inkriminues e ka kryer vetëm me datën e përshkruar kurse veprimi i tij përshkruhet si vazhdimësi. Përtej kësaj, gjykata e shkallës së parë duhet pasur parasysh faktin se veprat penale kundër jetës dhe trupit nuk është e mundur të kryhen në vazhdim, meqë çdo cenim i integritetit trupor paraqet veprë të posaçme penale, andaj edhe cilësimi juridik se vepra penale është kryer në vazhdim bie ndesh me natyrën e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor.

Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimin i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë. Për më tepër, shkeljet e theksuara më lart e vënë në dyshim edhe gjendjen faktike pasi që nuk është vërtetuar saktësia e fakteve vendimtare dhe nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjyimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje. Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligshëm në këtë çështje penale juridike.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.430/2022, i datës 17.01.2023

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit P.P., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.184/2021, i datës 11.10.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.81/2022, i datës 13.10.2022, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit P.P., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i lartcekur i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.12. lidhur me nenin 370, paragrafët 4 dhe 7 të KPP-së, si dhe me shkelje të ligjit penal, nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 14. të KPP-së, ndërsa këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Në këtë drejtim, nga shkresat e lëndës shihet se nga veprimet kryese të veprës penale të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk rezultojnë të jetë caktuar në mënyrë të qartë shuma e dobisë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme ose shuma e dëmit të shkaktuar, edhe për kundër faktit se i dënuari P.P., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 335, paragrafi 2 të KPRK-së, ku shuma e dobisë pasurore apo dëmit të shkaktuar është element themelor i figurës së kësaj vepre penale.

Në nenin 335, paragrafi 2 të KPRK-së, është parashikuar se kjo formë e rëndë e veprës penale të mashtrimit kryhet “Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezultojnë me dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëme në vlerë prej 10.000 (dhjetë mijë) Euro apo më shumë..”. Pra, nga kjo dispozitë ligjore shihet se për t’u konsideruar se është kryer kjo formë e veprës penale të mashtrimit, përveç elementeve tjera që e përbëjnë figurën e kësaj vepre penale, duhet që edhe shuma e dobisë pasurore të kundërligjshme ose dëmit të shkaktuar të jetë prej 10.000 (dhjetë mijë) Euro apo më shumë.

Në nenin 370, paragrafi 4 të KPP-së, është parashikuar se “Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 364 të këtij Kodi...”, kurse, në nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, është parashikuar se “Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal...”.

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se gjykatat, në aktgjykimet me të cilat të dënuarit shpallen fajtor, duhet të shënojnë, përveç tjerash, edhe veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPRK-së.

Ndërsa, në rastin konkret nuk është vepruar në këtë mënyrë, pasi që në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë shënuar të gjitha faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale mashtrimi, nga neni 335, paragrafi 2 të KPRK-së, për të cilën edhe është shpallur fajtor i dënuari P.P.. Kjo për faktin se në aktgjykimin në fjalë nuk është theksuar dhe konstatuar një element themelor i figurës së kësaj vepre penale, e që është shuma e dobisë pasurore të kundërligjshme ose dëmit të shkaktuar prej 10.000 (dhjetëmijë) Euro apo më shumë, pavarësisht faktit se në këtë rast bëhet fjalë për një paluajtshmëri, vlera e të cilës nuk është përcaktuar.

Po ashtu, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, rezulton se mbrojtësi i të dënuarit, si gjatë pjesës hyrëse, ashtu edhe gjatë fjalës përfundimtare, e ka ngritur si pretendim faktin se dëshmitari M.P. është shpallur fajtor me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë P.nr.126/2018, për deklaramë të rreme të dhëna në këtë lëndë, mirëpo nga arsyetimi i këtij aktgjykimi nuk rezulton që të jetë vlerësuar dhe arsyetuar një rrethanë e tillë. Duhet theksuar se një rrethanë e tillë nuk është vlerësuar dhe arsyetuar mjaftueshëm as nga gjykata e shkallës së dytë, pavarësisht faktit se një gjë e tillë kishte qenë edhe pretendim në ankesën e mbrojtësit të të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Në anën tjetër, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor dhe nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vendosur që të lexohen deklaratat e dëshmitarëve D.P. dhe M.P., mirëpo nuk është e qartë dhe nuk është arsyetuar mjaftueshëm një gjë e tillë, përkatësisht nëse leximi i deklaratave të këtyre dy dëshmitarëve është bërë në harmoni me nenin 338, paragrafi 2 të KPP-së dhe nëse këta dy dëshmitarë janë ftuar në mënyrë të rregullt konform sipas dispozitave përkatëse të KPP-së (Kapitulli XXVII). Kjo për faktin se dëshmitarët në fjalë e kanë vëlla të dënuarin P.P., andaj edhe sipas nenit 127, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. të KPP-së dhe duke e pasur parasysh natyrën e kësaj vepre penale, të njëjtit janë dëshmitarë të liruar nga detyrimi për të dëshmuar.

Në këtë mënyrë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të ligjit penal, siç është theksuar edhe më lart dhe këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, duke e kthyer këtë çështje penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitoj të gjitha shkeljet e lartcekura, duke i ndërmarr veprimet përkatëse procedurale dhe pas administrimit të serishëm të provave, të marrë një vendim, i cili duhet të përpilohet dhe arsyetohet në mënyrën e parashikuar me ligj.

7.7 Arsyetimi i aktgjykimit

Arsyetimi i aktgjykimit është pjesë tejet e rëndësishme e aktgjykimit dhe në të, gjykata duhet që të përfshijë arsyet mbi bazën e të cilave e ka dhënë aktgjykimin. Në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së, është parashikuar se *“gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të*

aktgjykimit". Kjo nënkupton që në arsyetim të aktgjykimit duhet të paraqiten arsye për fajësinë e të akuzuarit, veprën penale, dispozitat përkatëse ligjore, dënimet, konfiskimin, paraburgimin, shpenzimet e procedurës penale, si dhe çështjet tjera më specifike që do të paraqiten më poshtë.⁸⁶

Paraqitja e arsyeve ka të bëjë me arsyet faktike dhe juridike. Arsyetimi i anës faktike mbështetet në çmuarjen e lirë të provave, ku gjykata duhet që të analizojë çdo provë veç e veç, duke përfshirë tërësinë e tyre, raportin ndërmjet provave dhe të shprehet qartë se cilat prova dhe për çfarë arsyesh i ka pranuar ose nuk i ka pranuar.⁸⁷ Kurse, arsyetimi i anës juridik i referohet interpretimit dhe konkretizimit të dispozitave ligjore përkatëse.

Gjendja e vërtetuar në dispozitiv të aktgjykimit patjetër duhet të arsyetohet, duke e parashtruar procesin logjik nëpërmjet të të cilit është arritur deri te bindja e caktuar. Në këtë drejtim, sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 369, paragrafi 7 të KPP-së, gjykata duhet që të paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë duhet të vlerëson saktësinë e provave kundërtënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, në arsyetimin e aktgjykimit duhet që gjykata në mënyrë të veçantë të vlerësojë:

- a) saktësinë e provave kundërtënëse,
- b) arsyet e mos miratimit të propozimit konkret të palëve dhe
- c) arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike.

Me fjalë të tjera, arsyetimi i aktgjykimit duhet të jep sqarime për krejt atë që është vendosur në dispozitiv. Posaçërisht duhet të theksohet se cili fakt dhe rrethanë me çfarë prove është provuar, e jo vetëm shkurtimisht të numërohen provat e të paraqitet përmbajtja e tyre.⁸⁸

Në rastet kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.⁸⁹ Në nenin 70, paragrafët 2 dhe 3 të KPRK-së, janë parashikuar rrethanat të cilat gjykata duhet t'i marrë parasysh gjatë matjes së dënimit, si rrethanat rënduese, ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Sipas këtyre dispozitave ligjore, përveç këtyre rrethanave që janë cekur në mënyrë taksative, gjykatës i është dhënë mundësia që në çdo rast konkret të marrë parasysh edhe rrethana të tjera, të cilat mund të ndikojnë që të caktohet një dënim më i rreptë apo më i butë. Në kuadër të këtyre rrethanave, gjenden rrethanat objektive, që i referohen veprës penale dhe rrethanat subjektive, që i referohen kryesit. Me rrethana rënduese kuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i rëndë brenda kufijve të parashikuar

⁸⁶ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, "Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile", fq.105.

⁸⁷ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: *Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar*, fq. 864.

⁸⁸ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, fq. 396.

⁸⁹ Neni 369, paragrafi 8 i KPP-së.

me ligj për atë vepër penale, ndërsa me rrethana lehtësuese kuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i butë, gjithashtu brenda kufijve të përcaktuar me ligj.⁹⁰

Të gjitha rrethanat, si rënduese, ashtu edhe ato lehtësuese, të cilat janë marrë për bazë nga gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim duhet që të paraqiten në arsyetim të aktgjykimit.

Gjithashtu, gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim më të rëndë se dënimi i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin, të shqiptojë dënim alternativ ose masën për trajtim të detyruar rehabilitues ose konfiskimin e pasurisë së fituar përmes kryerjes së veprës penale.

Sa i përket çështjes së konfiskimit, aktgjykimi duhet të përmban arsyetimin për konfiskimin e secilit send për të cilën urdhërohet konfiskimi dhe arsyetimin për secilin send për të cilën nuk urdhërohet konfiskimi.

Në rastet kur i akuzuari lirohet nga akuza, në arsyetim veçanërisht shënohet arsyeja e paraparë në nenin 363 të KPP-së, mbi bazën e të cilit është marrë aktgjykimi lirues, kurse, në arsyetimin e aktgjykimit me të cilin refuzohet akuza, gjykata nuk e vlerëson çështjen kryesore, por kufizohet vetëm në arsyet e refuzimit të akuzës.⁹¹

Në anën tjetër, edhe vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës në çështjet penale, përveç tjerash duhet të përmbajnë edhe pjesën e arsyetimit, në të cilën pjesë duhet që të paraqiten arsye përkitazi me vendosjen e saj, me qëllim që të bindën palët, personat tjerë të interesuar dhe opinioni i gjerë për drejtshmërinë e vendosjes së çështjes nga kjo gjykatë.

Arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, qoftë i aktgjyqimeve apo aktvendimeve, duhet të fokusohet, në rend të parë, në vlerësimin e pretendimeve të ankesës.⁹²

Krahas kësaj, arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duhet të fokusohet edhe në dhënien e vlerësimeve lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore, të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Përmbajtja e arsyetimit, në masë të madhe varet edhe nga lloji i vendimit gjyqësor që është marrë.⁹³

Duke u bazuar në këto që u theksuar në lart dhe në nenin 404, paragrafi 1 të KPP-së, në arsyetimin e vendimit (aktgjykimit dhe aktvendimit), Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vlerëson:

- 1) Pretendimet e ankesës dhe
- 2) Shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare.

Sa i përket çështjes së parë, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vlerëson të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë.

⁹⁰ SHALA, AFRIM: *Hyrje në të drejtën penale*, fq. 259-260.

⁹¹ Neni 369, paragrafët 10-11 të KPP-së.

⁹² Në nenin 404, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se “*në arsyetim të aktgjykimit apo të aktvendimit, Gjykata e Apelit të Kosovës vlerëson pretendimet e ankesës dhe tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare*”.

⁹³ HAJDARI, AZEM : *Komentari i Kodit të Procedurës Penale*, fq. 971.

Megjithatë, është e rëndësishme që të theksohet se Gjykata e Apelit e Kosovës nuk detyrohet që të shqyrtojë në hollësi çdo pohim të ankesës.⁹⁴ Se në çfarë mase dhe niveli duhet që të vlerësohen pretendimet e ankesës, kjo varet nga rrethanat dhe specifikat e secilit rast veç e veç.

Duke e pasur parasysh arsyetimi i vendimeve gjyqësore duhet të trajtohet edhe nga aspekti i të drejtave të njeriut. Në këtë aspekt, e drejta për një proces të rregullt nga neni 6 i KEDNj-së përfshin edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se një aspekt i tillë është trajtuar mjaftueshëm nga praktika gjyqësore e GJEDNj-së dhe e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka theksuar se gjykatat janë të detyruara “*që t’i tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsytet në të cilat i kanë bazuar vendimet e tyre*”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsytet e dhëna duhet të jenë të mbështetura në ligjin e aplikueshëm.⁹⁵

Ndërsa, sa i përket çështjes së dytë, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që t’i tregojë edhe shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare.

Bazuar në nenin 394, paragrafi 1 të KPP-së, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të shqyrton detyrës zyrtare nëse ekzistojnë shkelje e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafi 1 të KPP-së ose nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

Arsyetimi i aktgjykimit është shumë i rëndësishëm dhe kualiteti i vendimeve gjyqësore varet nga kualiteti i arsyetimit.⁹⁶

Arsyetimi i aktgjykimit ju mundëson palëve, përfaqësuesve të tyre dhe publikut të gjerë që të njohet me arsytet se pse gjykata ka vendosur në një mënyrë të caktuar.

Rëndësia e arsyetimit shihet edhe nga fakti se mos hartimi i aktgjykimit me dispozitat ligjore që i referohen arsyetimit të aktgjykimit, nga neni 369, paragrafi 1 dhe 6-11 të KPP-së paraqet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, e cila shkelje në shumë raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës ka qenë arsye për anulimin e aktgjykimeve dhe kthimin e rastit në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Arsyetimi i aktgjykimit duhet shikuar edhe si detyrë të gjykatës që buron nga dispozitat ligjore të brendshme, por nga praktika gjyqësore e GJEDNj-së, siç do të elabrohet edhe në vijim të këtij punimi.

GJEDNj-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka theksuar se “*vendimet e gjykatave duhet të paraqesin në mënyrë adekuate arsytet mbi të cilat ato janë bazuar*”.

⁹⁴ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, fq. 966.

⁹⁵ Rasti KII114/22 me parashtrues Valdet Dumani, aktgjykimi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i datës 24.04.2023. Gjithashtu, shih: Rastin “*Hadjianastassiou kundër Greqisë*”, aktgjykimi i datës 16.12.1992, paragrafi 33.

⁹⁶ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.107.

Njëkohësisht, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, çështjen e arsyetimit të vendimit gjyqësor duhet shikuar edhe nga aspekti i të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor i përcaktuar me nenin 6, paragrafi 1 të KEDNj-së.

Tani arsyetimi i vendimeve gjyqësore përbën një standard në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, si pjesë e të drejtës për një proces të rregullt, sipas së cilit interesat e drejtësisë nuk mund të arrihen nëse vendimi gjyqësor nuk është i arsyetuar.

Detyrimi për të paraqitur arsye në një vendim gjyqësor siguron të drejtën për një proces transparent dhe siguron publikun që vendimi gjyqësor nuk është arbitrar dhe është në harmoni me parimet kushtetuese dhe ligjore.

Gjithashtu, vendimet gjyqësore të arsyetura i shërbejnë qëllimit për t'u demonstruar palëve se janë dëgjuar, si dhe i detyrojnë gjyqtarët që arsyetimet e tyre t'i bazojnë në argumente objektive. Vendimi gjyqësor i arsyetuar është i rëndësishëm edhe për faktin se përmes tij i mundësohet çdo personi që ta shfrytëzojë të drejtën në ankesë, duke ju referuar edhe arsyeve që janë paraqitur në atë vendim.

Megjithatë, duhet theksuar se detyrimi i gjykatave që të paraqesin arsye në vendimet përkatëse gjyqësore, nuk nënkupton përgjigje të hollësishme në çdo argument.

Vëllimi dhe shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshon varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast veç e veç.⁹⁷

Janë argumentet thelbësore të palëve që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.⁹⁸

Në shtetet e së drejtës anglosaksone, me rastin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore zbatohet metoda e ashtuquajtur "IRAC".

Gjyqtarët gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore, përmes kësaj metode, i strukturojnë, organizojnë dhe i trajtojnë çështjet, si ligjore, ashtu edhe faktike, duke përdorur një metodologji dhe analizë e cila kalon nëpër disa etapa apo faza.

IRAC është një shkurtesë e fjalëve "*Issue, Rule, Application, Conclusion*", që në gjuhën shqipe përkthehet "*Çështja/Problemi, Rregullat/Dispozitat, Aplikimi/Zbatimi dhe Konkuzioni/Përfundimi*".

Një metodë e tillë e të shkruarit dhe arsyetuarit të vendimeve gjyqësore përdoret edhe në disa gjykata ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe GjEDNj-në, si dhe nga disa gjykata kushtetuese të shteteve të ndryshme.⁹⁹

⁹⁷ Rasti "*Hadjianastassiou kundër Greçisë*", aktgjykimi i datës 16.12.1992, paragrafi 33.

⁹⁸ Rasti "*Hiro Balani kundër Spanjës*", aktgjykimi i datës 09.12.1994, paragrafi 27; Rasti "*Van de Hurk kundër Holandës*", aktgjykimi i datës 19.04.1994, paragrafi 61; Rasti "*Higgins dhe të tjerët kundër Francës*", aktgjykimi i datës 19.02.1998, paragrafi 42, etj.

⁹⁹ Në përgjithësi, kjo metodë e të shkruarit dhe arsyetuarit të vendimeve gjyqësore zbatohet edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. <https://gjk-ks.org/vendimet/>

Sipas kësaj metode, procesi i të shkruarit dhe arsyetuarit të vendimeve gjyqësore, në parim, kalon nëpër këto katër (4) etapa apo hapa:

Së pari, duhet që të identifikohet çështja apo problemi që duhet të adresohet dhe zgjidhet;

Së dyti, duhet që të identifikohen rregullat apo dispozitat ligjore (kushtetuese) që janë të rëndësishme zgjidhjen e çështjes apo problemit;

Së treti, duhet që të analizohet dhe përcaktohet nëse elementet e rregullave, përkatësisht dispozitave ligjore aplikohen ndaj fakteve të çështjes përkatëse gjyqësore dhe

Së katërti, duhet të paraqiten konkluzionet apo përfundimet në lidhje me aspektet e vendimmarrjes në çështjen e caktuar gjyqësore.

7.7 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e arsytimit të aktgjykimit

Çështja e arsytimit të aktgjykimin është trajtuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore.

Në vijim do të paraqiten disa raste që kanë të bëjnë me këtë shkëlqje esenciale të dispozitave të procedurës penale që ndërlihet me arsytimin e aktgjykimit.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.683/2023, i datës 28.12.2023.

A K T G J Y K I M

Me aprovimin si të bazuar të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të të dënuarit S.B., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Vushtrri, P.nr.403/2020, i datës 30.03.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.585/2023, i datës 02.11.2023 dhe kjo çështje penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Vushtrri, P.nr.403/2020, i datës 30.03.2023, i dënuari S.B., është shpall fajtor për shkak të veprës penale “Lëndimi i rëndë trupor”, nga neni 186, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.1. të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 26.12.2016 deri më datën 15.02.2017, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 15.02.2017 deri më datën 15.03.2017, të dënuarit S.B. do t’i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Është detyruar i dënuari S.B. që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumë prej njëzetë (30)

euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.585/2023, e datës 02.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit S.B., avokatit Ekrem Salihu, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- i dënuari S.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.7. lidhur me nën-paragrafin 2.1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP); shkeljes së ligjit penal, nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.2. dhe 1.4. të KPP-së dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, duke propozuar që këto aktgjytime të anulohen, ndërsa kjo çështje penale t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.403/2023, e datës 22.12.2023 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit S.B., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të të dënuarit S.B., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6 dhe 8 të KPP-së.

Siç është theksuar edhe më parë, i dënuari S.B. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Lëndimi i rëndë trupor”, nga neni 186, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.1. të KPRK-së dhe ndaj tij, për shkak të kryerjes së kësaj veprë penale është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatjen e përcaktuar më lart.

Në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së është parashikuar se “Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsytet për çdo pikë të aktgjykimit”, kurse në paragrafin 8 të këtij neni, është parashikuar se “Kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit”. Gjithashtu, është e rëndësishme që të theksohet se në nenin 3, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se “Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës”.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar duke u bazuar në këto dispozita ligjore, pasi që pjesën e arsyetimit nuk janë paraqitur arsye të qarta dhe të kuptueshme se pse janë vlerësuar si rrethana rënduese disa rrethana që nuk është dashur të trajtohen si të tilla, e që rrjedhimisht kjo pjesë e arsyetimit është kundërthënëse.

Kështu, në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të lartcekur shihet që gjykata e shkallës së parë e ka marrë për bazë si rrethanë rënduese faktin: *“...sjelljen e mëparshme të kryesit, pasi që i njëjti është recidivist dhe nga informatat që dalin nga dosja e tij, i njëjti figuron si i dyshuar për më shumë se 18 vepra penale të natyrave të ndryshme”*.

Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë është dashur që të jetë më e qartë në lidhje me të kaluarën e të dënuarit S.B. dhe se nuk është dashur që të marrë parasysh faktin se i dënuari është i dyshuar edhe për disa raste të tjera, pasi që një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, i cili parim është i garantuar edhe me nenin 31, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se vetëm aktgjykimet e formës së prerë me të cilat është shpallur fajtor i dënuari, nën rrethana të caktuara dhe nën supozimin e përbushjes së kushteve të caktuara, mund të merren për bazë si rrethana rënduese me rastin e matjes së dënimit, por nuk duhet të merret në konsideratë fakti se i dënuari paska qenë i dyshuar për disa vepra penale, pasi që kjo nuk do të thotë se i njëjti edhe është fajtor për këto vepra penale.

Në lidhje me këtë çështje, është e rëndësishme që të theksohet se edhe në nenin 70, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.13. të KPRK-së është parashikuar se *“Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh, por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese: - ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar”*, ndërsa në nenin 19, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6. të KPP-së është parashikuar se *“Person i dënuar konsiderohet personi i cili me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale”*.

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të rëndësishme që rikujton se në nenin 69, paragrafi 4. të KPRK-së është parashikuar se *“Kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer vepër penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur”*.

Gjithashtu, në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të lartcekur shihet që gjykata e shkallës së parë e ka marrë për bazë disa rrethana rënduese e në mesin e tyre edhe *“intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht integritetin trupor të të dënuarit”*, mirëpo sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, një aspekt i tillë në këtë rast konsiderohet element themelor i figurës së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari S.B., andaj edhe si e tillë nuk mund të vlerësohet edhe si rrethanë rënduese.

Dhe në fund, arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është abstrakt dhe i pakuptueshëm edhe sa i përket rrethanave tjera rëndësuese, pasi që nuk është sqaruar mjaftueshëm se në çka konsiston *“shkallën e përgjegjësisë penale”* dhe *“rrethanat në të cilat është kryer vepra”*, të cilat janë konsideruar si rrethana rënduese me rastin e matjes së dënimit.

Andaj, në këtë mënyrë, duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, kjo pjesë të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është e paqartë dhe nuk është në harmoni me dispozitat ligjore të paraqitura më lart.

Në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa të anulohen

aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë sqaruar dhe arsyetuar mjaftueshëm as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin fillestar dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.659/2023, i datës 27.12.2023

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit I.H., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti i Përgjithshëm P. nr.411/2023 të datës 07.07.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1094/2023 të datës 05.10.2023 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.411/2023 të datës 10.07.2023, i dënuari I.H., është shpallur fajtor për veprën penale mos përfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditëve, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 23.05.2023. I dënuari është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 € dhe në fondin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 €, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në contest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1094/2023 e datës 05.10.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit, avokate Blerina Dërmaku, nga Gjiilani, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështje të kthehet në rigjykim.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.385/2023 e datës 20.12.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar për arsytet si në vijim:

Aktgjykimi i shkallës së parë bazuar në referatin e paraqitura nga mbrojtësja e të dënuarit, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.7 të KPP-së, meqë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 369 par.8 të KPP-së e cila ka përcaktuar se: *“Kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit”*.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ka çmuar si rrethanë rënduese fakte të pakonfirmuara lidhur me dënimet e të dënuarit dhe të cilat nuk kanë referencë të qartë fillimisht se a janë vendime të formës së prerë dhe pastaj se për çfarë natyre të lëndëve bëhet fjalë. Përtej kësaj, si rrethanë rënduese është çmuar edhe elementi i veprës penale për të cilin i dënuari është shpallur fajtor dhe është dënuar, meqë si rrethanë rënduese është potencuar fakti se i dënuari nuk ka respektuar vendimin gjyqësor edhe pse është element i veprës penale mos përfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, ashtu që me këtë rrethanë rënduese gjykata e shkallës së parë ka dyfishuar rrethanat rënduese në dëm të të dënuarit.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penale juridike.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.700/2023, i datës 23.01.2024

A K T G J Y K I M

Me aprovimin si të bazuar të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit D.XH., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.130/2022, i datës 14.02.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.277/2023, i datës 10.11.2023 dhe kjo çështje penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.130/2022, i datës 14.02.2023, i dënuari D.XH., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale *“Lëndimi i lehtë trupor”*, nga neni 185, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nëntë (9) muajve, të cilin dënim do ta mbajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa në kuptim të nenit 79, paragrafi 1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar, të dënuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, duke filluar nga data 24.06.2022 deri më datën 23.07.2022.

Është detyruar i dënuari D.XH. që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50) euro dhe në emër të taksës për kompensimin e

viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Është konfiskuar brisku me ngjyrë të zezë me mbishkrimin “*Browing*”, me teh 10 cm, i cili pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate, duke u konstatuar me procesverbal i cili duhet t’i bashkangjitet kësaj lënde penale.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.277/2023, e datës 10.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit D.XH., avokatit Elmi Qerimi, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit D.XH., avokatit Elmi Qerimi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi, nën-paragrafi 1.12 lidhur me nenin 370, paragrafët 6 dhe 8 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që këto aktgjytime të anulohen, ndërsa kjo çështje penale t’i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.414/2023, e datës 29.12.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit D.XH., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenet 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit D.XH., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6 dhe 7 të KPP-së.

Në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së është parashikuar se “*Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsytet për çdo pikë të aktgjykimit*”, kurse në paragrafin 7 të këtij neni, është parashikuar se “*Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsytet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsytet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij*”.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar duke u bazuar në këto dispozita ligjore, pasi që në pjesën e arsytimit nuk janë paraqitur arsye të qarta dhe të mjaftueshme për të gjitha pika e aktgjykimit, si dhe nuk janë vlerësuar dhe arsyetuar në mënyrën provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe propozimet e mbrojtjes në lidhje me administrimin e provave të tjera.

Arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, jo vetëm që është i mangët sa i përket çështjeve të lartcekura, por në pjesën dërmuese të tij, sidomos pjesa e paraqitjes së përmbajtjes së provave, është një përshkrim, përkatësisht kopjim në mënyrë detale i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

Nga kjo pjesë e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që është përshkruar në tërësi procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, duke i përshkruar në tërësi edhe pyetjet që janë parashtruar ndaj dëshmitarëve nga ana e mbrojtësit, prokurorit të shtetit, të dëmtuarit dhe kryetarit të trupit gjykues. Përveç kësaj, është përshkruar në tërësi deklarimi i dëshmitarëve në mënyrë të njëjtë siç është paraqitur në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor dhe më pastaj, është konstatuar se palët përkatëse, konkretisht i dëmtuari dhe i akuzuari nuk kanë pyetje tjera për dëshmitarët përkatës.

Një mënyrë e tillë e përshkrimit të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor fillon nga faqja e 4-të e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, për të vazhduar deri faqen 9-të të kësaj pjese të arsyetimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo mënyrë e shkrimit të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë duke e përshkruar në tërësi procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor (ndryshe e ashtuquajtur metodë “*copy-paste*”), nuk është në harmoni me dispozitat e lartcekura ligjore, andaj edhe si e tillë është e papranueshme.

Nga shkresat e lëndës, por edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, i datës 23.12.2022, shihet se mbrojtësi i të dënuarit kishte paraqitur propozim që të angazhohet një ekspert nga lëmia e psikologjisë, duke e pasur parasysh faktin se i dënuari më datën 17.06.2022 kishte mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, ndërsa më datën 24.06.2022, ishte kryer vepra penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor.

Në këtë mënyrë, mbrojtësi kishte pretenduar se i dënuari D.XH. nuk e kishte patur koeficientin e inteligjencës së mjaftueshme krahas moshës së tij, që për të cilën, i njëjti më vonë edhe kishte mbajtur disa seanca tek psikologu, ku lidhur me këtë aspekt, gjykatës ju kanë prezantuar edhe raportet mjekësore.

Mirëpo, nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk rezulton që një propozim i tillë i mbrojtësit të jetë arsyetuar dhe vlerësuar në mënyrë e duhur.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e refuzimit të një propozimit të tillë të mbrojtësit, nuk është dashur që të mjaftohet vetëm me një konstatim dhe arsyetim të thjeshtë në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, por që është dashur që me një përkushtim maksimal ta vlerëson një propozim të tillë, për të përcaktuar më pastaj, nëse në këtë rast mundet apo nuk mundet që të zbatohet neni 16 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë shqyrtuar as me aktgjykimin

e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.188/2019, i datës 15.10.2019

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit B.H., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, P.nr.181/2017 datë 14 shkurt 2019 dhe ai i Gjykatës së Apelit në Prishtinë PA1.nr. 403/2019 datë 21 maj 2019, kurse çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri P.nr.181/2017 datë 14 shkurt 2019, i pandehuri B.H. është shpall fajtor për veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, parashikuar me nenin 414 par.1 të KPRK, për të cilën është gjykuar me dënime me kusht, ashtu që i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, ekzekutimi i të cilit është shtyrë për një (1) vit me kusht që i pandehuri pa plotfuqishmërisë së aktgjykimit brenda këtij afati të mos kryejë veprën penale.

Në procedurën ankimore sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit aktgjykimi i lartcekur është vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PA1.nr.403/2019 datë 21 maj 2019.

Kundër këtyre aktgjykimeve ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit, avokati A.D., për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza.

Ndaj kërkesës së mbrojtësit të dënuarit është përgjigjur Prokurori i Shtetit me parashitjen me shkrim KMLP.II.nr.138/2019 datë 8 korrik 2019 me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkrësat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

-Kërkesa është e bazuar.

Janë të bazuara pretendimet e theksuara në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuara me nenin 384 par.1 nënpar.1.12 të KPP, sepse ato janë të pakuptueshme, kontradiktore, nuk përmbajnë arsye për faktet relevante, kurse arsyet e dhëna në to janë në kundërshtim me përmbajtjen e deklaratave të dhëna në procedurë.

Kështu, i dënuari B.H. është shpall fajtor për veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, nga neni 414 par.1 të KPRK sepse “Me 17.04.2014 në fshatin N., komuna e V., ka heq shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar e cila është venë me qellim të sigurimit të vijës ndarëse mes parcelave kadastrale, ashtu që i pandehuri ka hequr kunjin i cili ka qenë i vendosur në parcelën nr.987 duke e vendosur disa metra larg vendit ku kishte qenë i vendosur me parë, dhe atë në prezencën e gjyqtarit B.F. dhe ekspertit të gjeodezisë B.D.”. Sipas shkresave të lëndës nuk rezulton kontestues fakti se ngjarja ka ndodh me 17.04.2014 në fshatin N. të V., kur gjykata respektivisht gjyqtari i çështjes B.F., se bashku me ekspertin e gjeodezisë B.D. dhe personat tjera të autorizuar ka dal në vend ngjarje sipas procedurës kontestimore në mes të paditësit J.B., kundër të paditurve M.M. e B.H. për shkak të vërtetimit të se drejtës së përparësisë në blerje. Kurse, procedura është iniciuar sipas shënimit zyrtar të gjyqtarit B.F. Sipas këtij shënimi del “se pas përfundimit të seancës dhe nënshkrimit të procesverbalit nga palët dhe përfaqësuesit e tyre, i padituri i dytë (tani i dënuari) B.H. pa leje të gjykatës ka hequr hunjin-kunjin e vendosur në parcelën 987 duke e goditur disa metra larg vendit ku ishte vendosur, ashtu që ky veprim ka sjellë provokimin e palës kundërshtare dhe personave të tretë që janë shfrytëzues faktik të parcelave 988 e 984 në fshatin N.”.

Rezulton se gjyqtari i çështjes i cili e ka përpiluar shënimin zyrtar nuk është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit në polici dhe hetime por vetëm në shqyrtimin gjyqësor, i cili nder të tjera ka deklaruar“ sa i kujtohet ka qenë duke hyrë në veturën zyrtare kur B1. një kunjë (hunjë) të cilin e ka vendos ekspertin në çfarë mënyrë nuk e din por i kujtohet se i pandehuri e ka hequr kunjin dhe ka filluar të tensionohet situata edhe ashtu e tensionuar. Kur i kemi thënë se do të bëjmë shënim zyrtar për heqjen e shenjës palët janë larguar. Sa i kujtohet kur e ka heqë kunjin nuk e ka parë, por dikush nga palët e ka lajmëruar ngase në atë moment ka qenë i orientuar nga rasti e jo nga shenja. Në pyetjen e parashtruar se në bazë të skicës së vendit të ngjarjes ku ka qenë i vendosur kunji i hequr ka deklaruar se nuk mund të thotë asgjë rreth vendit të ngjarjes”.

Dëshmitari B.D., është dëgjuar në polici dhe shqyrtimin gjyqësor dhe në dëshminë e tij nuk e pohon faktin se tani i dënuari e ka hequr kunjin që është vendosur nga ai por ka hequr një hu të vendosur në vendin ku kanë luajtur me top.

Në këtë çështje janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve edhe përfaqësuesi i të dënuarit në procedurën kontestimore avokati Z.A., policët që kanë asistuar në vend ngjarje S.S. e G.B. dhe vëllai i të paditurit – tani të dënuarit Q.H., të cilët në dëshmitë e tyre të dhëna në shqyrtimin gjyqësor e mohojnë faktin se i dënuari ditën e ngjarjes ta ketë hequr kunjin e vendosur nga eksperti.

Sipas arsyeve të dhëna në aktgjykimin e shkallës së parë veprimet inkriminuese të tani të dënuarit gjykata i ka vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve B.F., B.D., Z.A., S.G., G.B. e Q.H. Në fakt

gjykata e shkallës së parë vetëm ka përshkruar në mënyrë narrative deponimet e tyre pa bërë kurrfarë analize të tyre se perse konsideron se nga dëshmitë e tyre është vërtetuar se tani i dënuari është ekzekutor i veprës penale dhe në veprimet e tij qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Për me tepër, gjykata në arsyetim thekson se dëshmitari B.F., ka deklaruar atë çka ka konstatuar në shënimin zyrtar dhe as që e përmend dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor e cila ndryshon nga konstatimet e tij në shënimin zyrtar, e as që e analizon këtë kundërtënie.

Konform dispozitave ligjore, obligim i gjykatës është që të vlerësojë ekzistimin ose mosekzistimin e fakteve, dhe në këtë drejtim ajo nuk është e kufizuar me rregulla formale. Por, sipas dispozitës së nenit 370 par.7 të KPP është detyrë e gjykatës që të paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Ajo gjithashtu në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërtënesë, arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij. Kështu nuk ka vepruar gjykata e shkallës së parë, dhe të njëjtën gjë e ka bërë edhe shkalla e dytë duke e pranuar arsyetimin e shkallës së parë.

Në fakt, mos arsyetimi i aktgjykimit konform kësaj dispozite paraqet shkelje esenciale absolute të dispozitave procedurale, gjë që aktgjykimet i kanë juridikisht të paqarta për vlerësim të mëtejshëm, për çka ato u anuluan dhe çështja ju kthye gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet t'i evitohet shkeljet e lartcekura duke e administruara edhe një herë provat e kësaj çështje të cilat duhet t'i vlerësojë konform dispozitës së nenit 370 par.7 të KPP me theks të veçantë të vlerësimit të tyre në drejtim të faktit se a është ekzekutor i veprës penale dhe në veprimet e tij a përbushen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar dhe pastaj varësisht nga rezultati i vlerësimit të marrë vendim në këtë çështje penalo-juridike.

7.8 Komente përmbledhëse

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe duke ju referuar dispozitave ligjore të trajtuara më lart, si dhe praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së mund të nxjerrim këto konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1. Konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. i KPP-së, e cila shqyrtohet sipas propozimit të palëve, nëse aktgjykimi nuk është hartuar sipas nenit 369 të KPP-së dhe një gjë e tillë ka ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.
2. Në nenin 369 të KPP-së është përcaktuar përmbajtja dhe forma e aktgjykimit, të cilin dispozitë ligjore duhet ta kenë në konsideratë gjyqtarët gjatë hartimit me shkrim të aktgjykimit, pasi që mos hartimi i aktgjykimit sipas këtyre dispozitave ligjore, përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të theksuar më lart.

3. Dispozitivi i aktgjykimit duhet të përfshin të gjitha të dhënat e parashikuara në nenin 369, paragrafët 3-5 dhe në nenin 364 të KPP-së. Në veçanti, gjyqtarët me rastin e shqyrtimit të rasteve, si dhe marrjes dhe hartimit me shkrim të aktgjykimeve duhet t'i kushtojnë rëndësi elementit të parashikuar në nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 të KPP-së, që ka të bëjë me veprën penale për të cilën shpallet fajtor i pandehuri, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPRK. Siç është theksuar edhe më parë, ky element i dispozitivit të aktgjykimit ka qenë arsye që në disa raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës janë anuluar aktgjykimet e instancave më të ulta.
4. Gjithashtu, një pjesë shumë e rëndësishme e aktgjykimit është edhe arsyetimi. Siç është theksuar edhe më parë, në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së, është parashikuar se *“gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit”*. Kjo nënkupton që në arsyetim të aktgjykimit duhet të paraqiten arsye për fajësinë e të akuzuarit, veprën penale, dispozitat përkatëse ligjore, dënimet, konfiskimin, paraburgimin, shpenzimet e procedurës penale, si dhe çështjet tjera të rëndësishme. Gjatë hartimit me shkrim të aktgjykimit, në arsyetimin e aktgjykimit duhet që gjyqtarët në mënyrë të veçantë të vlerësojnë:
 - a) saktësinë e provave kundërthënëse,
 - b) arsyet e mos miratimit të propozimit konkret të palëve dhe
 - c) arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike.Me fjalë të tjera, arsyetimi i aktgjykimit duhet të jep sqarime për krejt atë që është vendosur në dispozitiv, andaj edhe një aspekt i tillë duhet të jetë në vëmendjen e posaçme të gjyqtarëve gjatë hartimit me shkrim të aktgjykimit. Posaçërisht duhet të theksohet se cili fakt dhe rrethanë me çfarë prove është provuar, e jo vetëm shkurtimisht të numërohen provat e të paraqitet përmbajtja e tyre, pa bërë një vlerësim dhe analizim të provave. Në rastet kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

Pjesa e II-të

7.9 Pjesëmarrja në shqyrtim gjyqësor e gjyqtarit i cili është dashur të përjashtohet

Dispozitat ligjore

a) Neni 38, paragrafi 2 i KPP-së

Bazat për përjashtimin e gjyqtarëve

“Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal. Megjithatë, gjyqtari nuk përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale si anëtar i kolegjit shqyrtues”.

b) Neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. i KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

“Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale që njihet sipas detyrës zyrtare apo propozimit të palëve konsiderohet nëse:

- në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet sipas neneve 38-42 të këtij Kodi”.

7.10 Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Përjashtimi i gjyqtarit është një institut i procedurës penale që shpie në përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i rastit përkatës. Arsyet dhe bazat mbi të cilat përjashtohet gjyqtari janë të natyrave të ndryshme dhe ato mund të jenë të karakterit objektiv dhe subjektiv. Arsyet me natyrë subjektive kanë të bëjnë me bindjet subjektive të gjyqtarit ose me paragjykimet të cilat gjyqtari mund t’i ketë lidhur me lëndën apo palët që janë të përfshira në atë lëndë. Në këto raste, gjyqtari mund të ketë paragjykimet për fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit, vërtetësinë apo pavërtetësinë e ndonjë prove, rrethanat e kryerjes së veprës penale, etj. Këtu duhet të jenë në pyetje paragjykimet të cilat mund t’i ketë shprehur gjyqtari apo supozohen në bazë të sjelljeve të tij. Në anën tjetër, arsyet apo shkaqet me natyrë objektive janë ato shkaqe të cilat realisht ekzistojnë dhe si të tilla mund të provohen pa ndonjë vështirësi.¹⁰⁰

Arsyet apo shkaqet e përjashtimit të gjyqtarit sipas KPP-së ndahen në dy (2) grupe:

- 1) Arsyet apo shkaqet të cilat detyrimisht sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit, ndryshe i ashtuquajtur *“përjashtimi i detyrueshëm”* dhe
- 2) Arsyet apo shkaqet të cilat mund të sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit, ndryshe i ashtuquajtur *“përjashtimi fakultativ”*.

Arsyet apo shkaqet të cilat detyrimisht sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit janë të parashikuara në nenin 38, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së (*“përjashtimi i detyrueshëm”*),¹⁰¹ kurse ato të cilat mund të sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit janë të parashikuara në nenin 38, paragrafi 3 të KPP-së (*“përjashtimi fakultativ”*).¹⁰²

¹⁰⁰ HAJDARI, AZEM : *Komentari i Kodit të Procedurës Penale*, Prishtinë, 2016, fq. 96.

¹⁰¹ Në nenin 38, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se *“Gjyqtari përjashtohet nga shqyrtimi i rastit kur: është vetë palë apo i dëmtuar me veprën penale e cila është subjekt i rastit konkret gjyqësor; është bashkëshort, bashkëshort jashtëmartesor, ish – bashkëshort, person në afri gjimie në vijë të drejtpërdrejtë të çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, prokurorin e shtetit, të dëmtuarin ose viktimën ose mbrojtësin e viktimave apo përfaqësuesin e viktimës; është kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij, prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit ose viktimës; në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si prokuror, mbrojtës, mbrojtës i viktimave apo përfaqësues i viktimës ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert; ekziston konflikti i interesit siç përcaktohet me legjisllacionin përkatës”.*

¹⁰² Në nenin 38, paragrafi 2 të KPP-së është parashikuar se *“Gjyqtari gjithashtu mund të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rast konkret, nëse përpos rasteve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, paraqiten rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij”.*

Dallimi i ndërmjet këtyre dy (2) grupeve të arsyeve apo shkaqeve konsiston në atë se në rastin e parë të përjashtimit, këto arsye apo shkaqe janë të parashikuara në mënyrë taksative dhe kanë karakter absolut, që do të thotë se nëse paraqiten të njëjtat, atëherë gjyqtari duhet të përjashtohet nga gjykimi i çështjeve penale konkrete, pavarësisht se a e kanë kërkuar një gjë të tillë palët, apo jo. Përndryshe shkelja e kësaj ndalese, përkatësisht gjykimi i një çështje penale, edhe pse kanë ekzistuar këto arsye apo rrethana sipas nenit 39, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për përjashtimin e gjyqtarit, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale.¹⁰³

Gjyqtari duhet që posa të mësojë se ekziston ndonjë arsye për përjashtim nga neni 38, paragrafët 1 ose 2 të KPP (“*përjashtimi i detyrueshëm*”), të ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë të njofton kryetarin e gjykatës, i cili sipas procedurave apo rregullave të brendshme të gjykatës cakton zëvendësimin e tij.¹⁰⁴

Kurse, grupi i dytë i arsyeve apo shkaqeve të cilat mund të sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit (“*përjashtimi fakultativ*”) janë të përcaktuara me një formulim të përgjithshëm dhe kanë një veprim relativ, për dallim nga grupi i parë.

Në nenin 39, paragrafi 2 të KPP-së janë parashikuar situatat kur gjyqtari duhet të përjashtohet nga gjykimi për shkak të pjesëmarrjes në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal (“*përjashtimi i detyrueshëm*”). Sipas kësaj dispozite ligjore, gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal.¹⁰⁵

Në këtë dispozitë ligjore nuk është sqaruar se në çka konsiston pjesëmarrja në procedurë të mëhershme në të njëjtin rast penal, mirëpo një gjë e tillë është trajtuar në disa raste nga praktika gjyqësore në vend, por edhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ, siç do të paraqiten në vijim.¹⁰⁶

Në anën tjetër, me fjalinë e fundit të paragrafit të lartcekur, është përcaktuar se megjithatë, gjyqtari nuk përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtin çështje penale si anëtar i kolegjit shqyrtues.¹⁰⁷ Pra, nëse gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës kanë qenë të përfshirë në procedurat e mëparshme vetëm si anëtar i kolegjit shqyrtues, atëherë të njëjtit nuk do të përjashtohet nga shqyrtimi i rastit.

¹⁰³ SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2010, fq. 101; SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: *Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar*, fq. 162.

¹⁰⁴ Neni 39, paragrafi 1 i KPP-së.

¹⁰⁵ Edhe pse në këtë dispozitë ligjore nuk është parashikuar shprehimisht, arsyet e tilla do të vlejnjë edhe për përjashtimin e gjyqtarit zëvendësues, duke i pasur parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë që ka, bazuar në nenet 284 dhe 293, paragrafi 1 të KPP-së.

¹⁰⁶ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.14.

¹⁰⁷ Kolegji shqyrtues është kolegji i përbërë prej tre (3) gjyqtarëve i cili formohet nga departamenti i njëjtë ose nga gjykata themelore për të shqyrtuar dhe vendosur mbi një kundërshtim ose ankesë kundër urdhrit ose aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake (neni 19, paragrafi 121. i KPP-së). Përndryshe, autorizimet e kolegjit shqyrtues janë të parashikuara më hollësisht edhe në nenin 418 të KPP-së.

Përfshirja e gjyqtarit nga gjykimi i rastit përkatës për shkak të pjesëmarrjes në procedura të mëparshme në të njëjtin rast penal ndërlidhet edhe me paanësisë së tij dhe një aspekt i tillë është trajtuar mjaftueshëm edhe nga GjEDNJ-ja.

Në këtë drejtim, GjEDNJ-ja ka sqaruar se paanësia e gjyqtarit në raste të tilla, duhet të shqyrtohet në bazë të dy (2) kritereve apo testeve:

- 1) *Testi subjektiv* që ka të bëjë me bindjet dhe sjelljet personale të një gjyqtari, duke nënkuptuar që një gjyqtar mund të ketë pasur paragjykime personale apo anshmëri në lidhje me rastin konkret dhe
- 2) *Testi objektiv* që ka të bëjë me konstatimin nëse vetë përbërja e gjykatës ka ofruar garancione të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim.¹⁰⁸

Sa i përket testit objektiv, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, situatat në kuadër të të cilave mund të ngritën çështje lidhur me mungesën e paanshmërisë mund të jenë:

- 1) *Të natyrës funksionale* dhe
- 2) *Të natyrës personale*.

Mungesa e paanshmërisë funksionale ndërlidhet me ushtrimin e funksioneve të ndryshme brenda një procesi gjyqësor nga i njëjti gjyqtar ose lidhjeve të natyrës hierarkike apo të ndonjë natyre tjetër në mes të gjyqtarit dhe palëve tjera në një proces të caktuar gjyqësor.

Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, këto situata të natyrës funksionale, përveç tjerash mund të përfshijnë situatat kur në të njëjtin rast janë ushtruar funksione të ndryshme nga i njëjti gjyqtar. Në këtë drejtim, GjEDNJ-ja ka theksuar se vlerësimi nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të procedurës gjyqësore mund të ketë rezultuar me paanësinë e tij, duhet të vlerësohet nga rasti në rast dhe një gjë e tillë varet nga specifikat e secilit rast. Me fjalë të tjera, GjEDNJ-ja e ka bërë të qartë që situatat e tilla në kuptim të vlerësimit të paanësisë së një gjyqtari i cili ka vepruar edhe në procedura të mëparshme në të njëjtin rast, duhet të vlerësohet në çdo rast veç e veç, duke i pasur parasysh rrethanat specifike të secilit rast.¹⁰⁹

Edhe pse ushtrimi i funksioneve të ndryshme në një proces gjyqësor nga gjyqtari i njëjti paraqet kategori të çështjeve të natyrës funksionale dhe janë të rëndësishme për vlerësimin e paanshmërisë së një gjykate, në raste të tilla, në parim, GjEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se ka

¹⁰⁸ Në rastin “*Korzeniak kundër Polonisë*”, aktgjykimi i datës 10.01.2017, paragrafi 46, GjEDNJ-ja ka theksuar se “*Është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim te publiku. Për këtë qëllim, neni 6 i KKEDNJ-së kërkon që një gjykatë sa i përket përgjegjësisë së saj të jetë e paanshme. Paanshmëria normalisht nënkupton mungesën e paragjykimit dhe një gjë e tillë mund të testohet në mënyra të ndryshme. Gjykata ka bërë kështu dallimin midis “një qasje subjektive” - që do të thotë, përpjekje për të konstatuar bindjen personale ose interesin e një gjyqtari të caktuar në një çështje të caktuar - dhe “një qasje objektive” - që do të thotë, duke përcaktuar nëse ai ose ajo ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë aspekt*”. Qëndrim të njëjti, GjEDNJ-ja ka theksuar edhe në rastet “*Piersack kundër Belgjikës*”, aktgjykimi i datës 01.10.1982, paragrafi 30; “*Grievies kundër Mbretërisë së Bashkuar*”, aktgjykimi i datës 16.12.2003, paragrafi 69, etj.

¹⁰⁹ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.15.

dyshime legjitime për një paanshmëri të tillë, mirëpo dyshimet e tilla duhet të jenë objektivisht të justifikueshme dhe të vlerësohen nën dritën e rrethanave të secilit rast veç e veç.¹¹⁰

Sa i përket vlerësimit të dyshimeve të tilla në paanshmëri kur një gjyqtar ka ushtruar shumë funksione në të njëjtën çështje, GjEDNJ-ja ka theksuar se dy (2) kategori të çështjeve janë të rëndësishme:

Së pari, një vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet specifikave të ligjit që janë të aplikueshme në një rast konkret dhe

Së dyti, duhet të vlerësohet ndërlidhja në mes të aspekteve përmbajtësore të cilat i ka shqyrtuar gjyqtari i njëjtë në faza të ndryshme të procedurës të rastit përkatës, në mënyrë që më pastaj të konstatohet nëse aspekte të tilla do ta vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit në fjalë.¹¹¹

Pra, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, për të konstatuar nëse ushtrimi i funksioneve të ndryshme në një proces gjyqësor nga ana nga gjyqtari i njëjtë mund të shpie në paanësinë e tij, duhet të vlerësohet në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore që zbatohen në lidhje me atë rast, si dhe gjithashtu duhet të vlerësohet edhe aspekti përmbajtësor i vendimeve të cilat i ka marrë gjyqtari në faza të ndryshme të procedurës, ndërsa një gjë e tillë duhet të bëhet, duke i pasur parasysh rrethanat specifike të secilit rast veç e veç. Kështu, në rastin "*Hauschildt kundër Danimarkës*", aktgjykimi i datës 24.05.1989, paragrafët 51-53, GjEDNJ-ja kishte theksuar "...vetëm fakti që një gjyqtar gjykues apo gjyqtar i apelit ka marrë gjithashtu vendime në procedurë paraprake, duke përfshirë ato në lidhje me paraburgimin, nuk mund të konsiderohet në vetevetë, si shkak për të justifikuar frikën për paanshmërinë e gjyqtarit në fjalë...". "...Megjithatë, rrethanat e veçanta të një rasti të caktuar mund të jenë të tilla që japin një përfundim tjetër...". Në çështjen në fjalë, "gjyqtari Larsen, i cili kishte marrë pjesë në nëntë (9) nga vendimet për të vazhduar paraburgimin, ishte mbështetur veçanërisht në nenin 762(2) të ligjit danez, e cila dispozitë ligjore kërkonte që gjyqtari duhet të bindet se ekziston një "dyshim i konfirmuar veçanërisht" se i akuzuari ka kryer vepra penale për të cilat dyshohet, përkatësisht gjyqtari duhet të jetë i bindur se ka "një shkallë shumë të lartë qartësie" për sa i përket çështjes së fajit. Kështu, ndryshimi midis çështjes që gjyqtari duhet të zgjidhë gjatë caktimit/vazhimit të paraburgimit dhe çështjes që ai do të duhet të zgjidhë gjatë marrjes së aktgjykimit është i vogël".

Prandaj, GjEDNJ-ja ishte e mendimit se në rrethanat e çështjes, paanshmëria e gjykatës në fjalë mund të dukej e hapur për dyshime dhe se frika e kërkuesit në këtë drejtim mund të konsiderohet objektivisht e justifikuar, kështu që edhe mbi bazën e kësaj, kishte konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së.

Përndryshe, duhet theksuar se pjesëmarrja e një gjyqtari në shqyrtim gjyqësor (dhe fillestar) i cili është dashur të përjashtohet përbën shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, shkelje kjo e cila për shkak të rëndësisë së madhe që ka, trajtohet jo vetëm sipas propozimit të palëve, por edhe sipas detyrës zyrtare ("*Ex officio*").

¹¹⁰ Në lidhje me këtë dimension, shih rastin "*Korzeniak kundër Polonisë*", aktgjykimi i datës 10.01.2017, paragrafët 51, 52, etj.

¹¹¹ Rasti "*Warsicka kundër Polonisë*", aktgjykimi i datës 16.01.2007, paragrafi 40; "*Tozicska kundër Polonisë*", aktgjykimi i datës 24.07.2012, paragrafi 36, etj.

Një shkelje e tillë sipas nenit 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, vjen në shprehje në rastet kur pavarësisht se është dashur që përjashtohet, sipas neneve 38-42, gjyqtari ka marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor (dhe fillestar), ndërsa nuk kemi një aktvendim për përjashtimin e gjyqësor. Kjo për faktin se nëse gjyqtari është përjashtuar me aktvendimin e kryetarit të gjykatës, mirëpo, nëse pavarësisht kësaj, ai ka marrë pjesë në shqyrtim. gjyqësor (dhe fillestar), atëherë bëhet fjalë për shkeljen tjetër esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 11. të KPP-së.

Gjithashtu, për shkak të rëndësisë së saj dhe duke ju referuar dispozitave ligjore të KPP-së, pjesëmarrja në shqyrtim gjyqësor (dhe fillestar) e gjyqtarit që është dashur të përjashtohet, është shkelje e asaj natyre që detyrimisht imponon nevojën e anulimit të aktgjyqimit dhe kthimin e rastit në rigjykim.¹¹²

Instituti juridik i përjashtimit të gjyqtarit zbatohet edhe në procedurën ndaj të miturve. Me dispozitat ligjore të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM)¹¹³ nuk është parashikuar në mënyrë shprehimore procedura e përjashtimit dhe se në cilat raste duhet përjashtohet gjyqtari, qoftë si gjyqtar për të mitur, anëtarë i trupit gjykues për të mitur apo anëtarë i kolegjit për të mitur. Meqenëse me dispozitat ligjore të KDM-së nuk është parashikuar procedura e përjashtimit dhe në cilat raste përjashtohet gjyqtari, atëherë në lidhje me këto çështje duhet që përshtatshmërisht të zbatohen dispozitat ligjore të KPP-së, duke u bazuar në nenin 6 të KDM-së. Në nenin 6 të KDM-së është parashikuar zbatimi subsidiar i ligjeve tjera. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore *“Ndaj kryesit të mitur të veprës penale dhe fëmijëve viktimë apo dëshmitarë, në procedurën penale, në çështjet të cilat nuk janë rregulluar ndryshe me këtë Kod, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe dispozitat tjera penalo juridike”*.

Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart rezulton se dispozitat ligjore të KPP-së sa i përket procedurës së përjashtimit të gjyqtarit dhe rastet e përjashtimit duhet të zbatohen përshtatshmërisht edhe në procedurën ndaj të miturve, pasi që me dispozitat ligjore të KDM-së nuk janë rregulluar këto çështje.

7.11 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e pjesëmarrjes në shqyrtimin e rastit të gjyqtarit i cili është dashur që të përjashtohet

Çështja e pjesëmarrjes në shqyrtimin e rastit të gjyqtarit i cili është dashur që të përjashtohet ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kështu, në vijim do të paraqiten dy (2) raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë çështja e pjesëmarrjes së gjyqtarit në shqyrtimin e rastit, i cili është dashur që të përjashtohet.

¹¹² SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.18.

¹¹³ Kodi nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, i datës 14.09.2018.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.249/2024, i datës 15.05.2024.

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit B.Rr., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.517/2023 i datës 05.10.2023 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.50/2022 të datës 14.06.2023, të dënuarin B.Rr., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Ushtrimi i ndikimit”, nga neni 431, paragrafi 1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata do t’ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë e dënimit me burgim do të barazohet me njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 21.02.2019 deri më datën 21.05.2019, të dënuarit B.Rr., do t’i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.

Ndaj të dënuarit B.Rr. është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të profesionit në institucionet publike në kohëzgjatje prej një (1) viti, duke e llogaritur nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Është vendosur që telefoni i markës “*Samsung*” t’i kthehet të dënuarit, kurse është konfiskuar shuma e të hollave prej dhjetë (10) eurove.

I dëmtuari A.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Është detyruar i dënuari B.Rr., që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind (100) euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.517/2023 e datës 05.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit B.Rr., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit B.Rr., avokati Ahmet Gjinovci, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. lidhur me nenin 38, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t’i anulon aktgjykimet e lartcekura, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.nr.139/2024 e datës 24.04.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.Rr., të aprovohet si e bazuar, duke konsideruar se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. lidhur me nenin 38, paragrafi 2 të KPP-së, pasi që në këtë çështje penale, në përbërje të kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë ka marrë pjesë gjyqtari X.X., i cili gjithashtu si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë, dy herë radhazi ka marrë pjesë si kryetar i trupit gjykues në aktgjykimet PKR.nr.58/2019, të datës 16.10.2019 dhe PKR.nr.54/2020, të datës 28.10.2020.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, e duke mos u lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve tjera të cekura në kërkesë, gjen se qëndron fakti se gjyqtari X.X., nuk është dashur që të jetë anëtarë i kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë, pasi që i njëjti si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë, e ka gjykuar dy herë këtë çështje penale në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues. Kjo nga fakti se me dispozitën e nenit 39, paragrafi 2 të KPP-së, është parashikuar se “Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal. Megjithatë, gjyqtari nuk përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale si anëtar i kolegjit shqyrtues”. Rrjedhimisht, sipas dispozitës së paragrafit 2, të nenit 39 të KPP-së, gjyqtari përjashtohet në rastet kur ka marrë pjesë në procedurat e mëparshme në të njëjtin rast penal, siç është situata me rastin konkret, ku gjyqtari në fjalë, i cili kishte qenë pjesë përbërëse e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë, kishte qenë paraprakisht dy herë kryetar i trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë, pasi që kjo çështje penale ishte kthyer në rigjykim.

Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga ky fakt e duke mos u lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve tjera, meqenëse përbërja e gjykatës së shkallës së dytë nuk ka qenë në pajtim me ligjin dhe se në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk kanë mundur të jenë pjesë e kolegjit, konstaton se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, e cila shkelje për shkak të natyrës së saj, detyrimisht e ka kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së dytë dhe kthimin e kësaj çështje në rigjykim në këtë gjykatë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet të mënjanojë shkeljen e cekur dhe pasi që të vlerësojë pretendimet ankimore, të vendos në mënyrë meritore.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.127/2023, i datës 18.05.2023.

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit dhe të mbrojtësit të të dënuarit Xh.K., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1000/2020 i datës 01.02.2021, dhe çështja i kthehet gjykatës së njëjtë në rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.1934/2018 e datës 10.09.2020, e ka shpallur fajtor të dënuarin Xh.K., për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK, dhe për këto vepra i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 500 (pesëqindtë) €, të cilin dënim është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € të gjobës do ti llogaritet një ditë me burgim. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore - juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko - civil. I dënuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko - ligjore shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1000/2020 e datës 01.02.2021, ka aprovuar pjesërisht ankesën e përfaqësueses së të dëmtuarës, avokates I.I., dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket sanksionit penal, ashtu që të dënuarin Xh.K. për veprën penale sipas dispozitivit I të aktgjykimit të shkallës së parë, e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, ndërsa për veprën sipas dispozitivit II të aktgjykimit të shkallës së parë, me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) €, duke ia shqiptuar dënimin unik me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) €, të cilin dënim është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në pjesën tjetër aktgjykimi ka mbetur i pa ndryshuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- Prokurori i Shtetit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që kërkesa të aprovohet dhe sipas detyrës zyrtare të konstatohet se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPPK, të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor;

- Mbrojtësi i të dënuarit Xh.K., avokat E.R. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 të KPPK, me propozim që kërkesa të aprovohet dhe pjesërisht të anulohet aktgjykimi sa i përket pjesës së aprovuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së njëjtë për rivendosje apo ta ndryshoj aktgjykimin dhe ekzekutimi i dënimit të shtyhet.

Gjykata Supreme të Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi se:

-kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e të Prokurorit të Shtetit dhe mbrojtësit të të dënuarit Xh.K., janë të e bazuara.

Gjykata Supreme i vlerëson të bazuara pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit dhe të prokurorit të shtetit, sepse në rastin konkret kryetari kolegjit në shkallë të dytë, ashtu siç vërtetohet nga shkresat e çështjes ka qenë gjyqtari X.X., i cili përndryshe është bashkëshort i përfaqësues së të dëmtuarës, av. I.I. Kjo përbënë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPPK, sepse në shqyrtim gjyqësor ka marr pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet. Pra, në rastin konkret sipas dispozitës së nenit 39 par.1 nënpar.1.2 të KPPK, “gjyqtari përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur është bashkëshort...”.

Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë duhet të ketë parasysh vërejtjet të kësaj gjykate dhe të eliminoj shkeljen e cekur.

7.12 Komente përmbledhëse

Në rastin Pml.nr.249/2024, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit dhe kishte anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, duke e kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë. Në këtë rast, mbrojtësi i të dënuarit kishte pretenduar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ishte marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 12. të KPP-së, meqë në përbërje të kolegjit ka marrë pjesë gjyqtari i cili më parë kishte qenë kryetar i trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë, pra sipas të njëjtës çështje penale.

Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar se një pretendim i tillë i mbrojtësit të të dënuar ishte i bazuar, duke konsideruar se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 12. të KPP-së, sepse në kolegjin e gjykatës së shkallës së dytë kishte marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet.

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës mund të nxjerrën edhe këto konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1) Se përbërja e rregullt e gjykatës është një kusht i domosdoshëm (“*sine qua non*”) dhe kusht paraprak që do të mundësonte vlerësimin e mëtejshëm të pretendimeve tjera nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Siç shihet edhe nga aktgjykimet e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në shkeljen e konstatuar, nuk kishte vlerësuar mandej shkeljet tjera të pretenduara, meqenëse përbërja e gjykatës nuk kishte qenë në pajtim me ligjin, përkatësisht se në marrjen e aktgjykimit kishte marrë pjesë gjyqtari i cili ka qenë dashur të përjashtohet.

2) Se marrja pjesë në kolegjin e gjykatës së shkallës së dytë e gjyqtarit që është dashur të përjashtohet, ka qenë arsye që ka kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të kësaj gjykate dhe kthimin e çështjes në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.

7. 13 Mos sigurimi i përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilën i akuzuari nuk e kupton

Dispozitat ligjore

a) Neni 14, paragrafët 3, 4, 5 dhe 8 të KPP-së

Gjuhët dhe shkrimi

“I pandehuri, i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ka të drejtë në përkthim të cilësisë së mjaftueshme në mënyrë që të garantohet paanshmëria e procedurës, veçanërisht për të siguruar që ai ka njohuri të rastit kundër tij dhe është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes.

I pandehuri, i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ka të drejtën e përkthimit për komunikim me mbrojtësin e tij, nëse ai nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e të pandehurit:

- 4.1. kur i pandehuri merret në pyetje;
- 4.2. gjatë cilësdos seance dëgjimore; ose
- 4.3. kur paraqet parashtrësë me shkrim ose ankesë.

Personi nga paragrafi 2, 3 dhe 4 i këtij neni njoftohet për të drejtën e tij në përkthim. Ai mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore. Nëse personi është i pandehur, heqja dorë e tillë bëhet pasi ai të ketë marrë këshilla ligjore paraprake ose nëse ka njohuri të plota për pasojat e heqjes dorë të tillë dhe që heqja dorë është e qartë dhe e dhënë vullnetarisht. Njoftimi për këtë të drejtë dhe deklarata e pjesëmarrësit ose të pandehurit shënohet në procesverbal.

Të pandehurit dhe personit i cili është në vuajtje të dënimit i cili nuk e kupton gjuhën e procedurës duhet siguruar, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtrësave, në tërësi ose pjesërisht, varësisht nga fakti nëse ato janë relevante për qëllimin e mundësisimit të të pandehurit ose personit që është në vuajtje të dënimit të ketë njohuri të rastit kundër tij, në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë, ose dokumenteve të tjera të cilat janë thelbësore për të siguruar që ai të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes dhe të sigurohet paanshmëria e procedurave”.

b) Neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 14. të KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

“Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale që njihet sipas detyrës zyrtare apo propozimit të palëve konsiderohet nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në një gjuhë të cilën i akuzuari nuk e kupton dhe nuk është siguruar përkthimi”.

7.14 Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Përveç dispozitave të lartcekura ligjore, fillimisht duhet theksuar se çështja e përdorimit të gjuhës është e rregulluar edhe me dispozita tjera si vendore, ashtu edhe ndërkombëtare.

Kështu, me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar se cilat janë gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, kurse me Ligjin për përdorimin e gjuhëve¹¹⁴ janë rregulluar në mënyrë më detaje shumë çështje që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve. Në anën tjetër, nëse i referohemi procedurës penale, atëherë është e nevojshme që të theksohet se në nenin 3, paragrafi 3/a të KEDNj-së, është parashikuar se *“Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

*a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishe, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij”.*¹¹⁵

Përdorimi i gjuhës konsiderohet njëra nga të drejtat themelore të të pandehurit në procedurë penale, që garantohet me shumë akte juridike.

Sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 14, paragrafi 3 të KPP-së, nëse i pandehuri nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ai ka të drejtë në përkthim të cilësisë së mjaftueshme në mënyrë që të garantohet paanshmëria e procedurës, veçanërisht për të siguruar që ai ka njohuri të rastit kundër tij dhe është në gjendje të ushtrijë të drejtën e tij të mbrojtjes.

Në lidhje me gjuhën e procedurës, duhet përmendur edhe nenin 14, paragrafi 1 të KPP-së, në të cilin është parashikuar se *“Gjuha dhe shkrimet që mund të përdoren në procedurë penale janë gjuha shqipe dhe serbe, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj”.*

Gjithashtu, edhe në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar se *“Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj”.*

Kurse, në nenin 12 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve thuhet se *“Gjuhët zyrtare përdoren në mënyrë të barabartë në procedurat gjyqësore. Gjykatat dhe organet për ndjekje penale, si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale dhe në procedurat e tjera gjyqësore, sigurojnë që çdo person që merr pjesë në procedurat penale, si dhe në procedura të tjera gjyqësore mund të përdorë gjuhën zyrtare të cilën ai/ajo e zgjedh”.*

Mandej, në nenin 13 të Ligjit të lartcekur është parashikuar *“Gjykatat zhvillojnë procedurat në gjuhën zyrtare apo në gjuhët zyrtare të zgjedhura nga palët në procedura. Me kërkesën e palës*

¹¹⁴ Ligji Nr.02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, i datës 27.07.2006.

¹¹⁵ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.26-27.

në procedura, pajisjet duhet të sigurohen për përkthim simultan, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën. Gjykatat mund të sigurojnë pajisjet për përkthim simultan të procedurave, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, atëherë kur konsiderojnë se procedurat të jenë në interesin e përgjithshëm publik”.

Bazuar në këto dispozita ligjore rezulton se nëse i pandehuri nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ai ka të drejtë në përkthim të cilësisë së mjaftueshme, kjo me qëllim që të garantohet paanshmëria e procedurës, veçanërisht për të siguruar që ai ka njohuri të rastit kundër tij dhe është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes.

Përveç që gëzon të drejtën e përdorimit të gjuhës së vetë në procedurë penale, i pandehuri, i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ka të drejtën edhe të përkthimit për komunikim me mbrojtësin e tij, nëse mbrojtësi nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e të pandehurit:

- kur i pandehuri merret në pyetje;
- gjatë cilësdo seance dëgjimore; ose
- kur paraqet parashtrësë me shkrim ose ankesë.¹¹⁶

I pandehuri duhet të njoftohet për të drejtën e tij në përkthim, mirëpo ai mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore, ndërsa një gjë e tillë bëhet pasi ai të ketë marrë këshilla ligjore paraprake ose nëse ka njohuri të plota për pasojat e heqjes dorë dhe që heqja dorë është e qartë dhe e dhënë vullnetarisht. Njoftimi për këtë të drejtë dhe deklarata e të pandehurit shënohet në procesverbal.¹¹⁷

Gjithashtu, të pandehurit dhe personit i cili është në mbajtje të dënimit i cili nuk e kupton gjuhën e procedurës duhet siguruar, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtrësave, në tërësi ose pjesërisht, varësisht nga fakti nëse ato janë relevante për qëllimin e mundësisimit të të pandehurit ose personit që është në vuajtje të dënimit të ketë njohuri të rastit kundër tij, në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë, ose dokumenteve të tjera të cilat janë thelbësore për të siguruar që ai të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes dhe të sigurohet paanshmëria e procedurave.¹¹⁸

Të gjitha organet shtetërore që veprojnë në procedurë penale janë të detyruara që ta njoftojnë të pandehurin për të drejtën e tij që ta përdorë gjuhën e tij, nëse nuk e kupton gjuhën e procedurës dhe një gjë e tillë duhet të konstatohet edhe në procesverbalin e seancës përkatëse.¹¹⁹

Nëse i pandehuri nuk e kupton gjuhën e procedurës, atëherë të gjitha organet shtetërore janë të detyruara të njëjtit t’ia sigurojnë përkthimin e cilësisë së mjaftueshme, ndërsa këtë do të mund ta bëjë vetëm një përkthyes profesionist.

Përndryshe, duhet theksuar se konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në një gjuhë të cilën i pandehuri nuk e kupton dhe nuk është siguruar përkthimi.

¹¹⁶ Neni 14, paragrafi 4 i KPP-së.

¹¹⁷ Neni 14, paragrafi 5 i KPP-së.

¹¹⁸ Neni 14, paragrafi 8 i KPP-së.

¹¹⁹ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.27.

Edhe pse neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. i KPP-së i referohet vetëm shqyrtimit gjyqësor, një shkelje e tillë do të konsumohej, edhe në rastet kur shqyrtimi fillestar apo shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve, nga neni 247 i KPP-së janë mbajtur në një gjuhë të cilin e pandehuri nuk e kupton dhe nuk është siguruar përkthimi.

Sigurisht se një shkelje e tillë do të vjen në shprehje, edhe nëse gjatë seancave të kolegjit apo shqyrtimeve pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, të pandehurit i është mohuar një e drejtë.

Edhe GjEDNj-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore i ka kushtuar një rëndësi të madhe të drejtës së të pandehurit që të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjykatë, sipas nenit 6, paragrafi 3/e të KEDNj-së.

GjEDNj-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka konstatuar shkelje të nenit të lartcekur, pikërisht për shkak të mos respektimit të kësaj të drejte nga ana e autoriteteve gjyqësore të shteteve përkatëse.¹²⁰

7.15 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos sigurimit të përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilin i akuzuari nuk e kupton

Çështja e mos sigurimit të përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilin i akuzuari nuk e ka kuptuar ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Kështu, në vijim do të paraqiten disa raste, ku objekt i shqyrtimit ka qenë çështja e mos sigurimit të përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilin i akuzuari nuk e ka kuptuar:

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.314/2024, i datës 27.05.2024

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit dhe të dënuarit V.P., të paraqitura kundër aktgjykitimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.500/2023 të datës 06.10.2023, dhe çështja i kthehet kësaj gjykate me qëllim të dorëzimit të aktgjykitimit të gjykatës së shkallës së dytë në gjuhën e tij amtare.

¹²⁰ Shih rastet: “*Borizeck kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 19.12.1989, paragrafi 40; “*Hermi kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 16.10.2006, paragrafi 68; “*Sejdovic kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 01.03.2006, paragrafi 89; “*Kamasinski kundër Austrisë*”, aktgjykimi i datës 19.12.1989, paragrafi 79; “*Tabai kundër Francës*”, vendimi nr. 73805/01, i datës 17.02.2004, etj. Në rastin “*Kamasinski kundër Austrisë*”, aktgjykimi i datës 19.12.1989, paragrafi 79, GjEDNj-ja ka bërë të qartë të drejtën e të pandehurit “*për t’u informuar menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzës ndaj tij*” dhe se “*Një i pandehur që nuk e njej gjuhën e gjykatës, në fakt mund të vihet në disavantazh, nëse nuk i sigurohet edhe një përkthim me shkrim i aktakuzës në një gjuhë që ai e kupton*”.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, *me aktgjykimin* P.nr.132/2023 të datës 07.07.2023, të dënuarin V.P. e ka shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.9 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohen e kaluar në paraburgim nga data 28.10.2022 e tutje. Si dhe dënim me gjobë në shumën prej 3000 (tremijë) euro të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i dënuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprjë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoi me dënim me burg, ku një ditë burgimi do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë. I dënuari është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të kimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro. Të dënuarit njëherit i ka shqiptuar dënim plotësues dhe atë i ka konfiskuar substancën narkotike të llojit marihuanë dhe tetrahidrokanabinol (THC) në peshë prej 9295.7 gram, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.500/2023 e datës 06.11.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit V.P., avokati Dejan Vasiq nga Mitrovica, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 432 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së, konkretisht aplikimit të gabuar të nenit 70 par.3 pikat 3.3, 3.6, 3.8, 3.9 dhe 3.12 të KPRK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës ta ndryshojë dhe të dënuarit të i zbut dënimet e shqiptuara, ose aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë ta anulojë dhe çështjen t'ia kthen në rigjykim e rivendosje, si dhe i dënuari Vladan Petranović, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesë ta aprovojë si të bazuar dhe të njëjtin ta liroj nga dënimi me burg pasi që është student dhe është punësuar.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.177/2024 e datës 23.05.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar të dënuarit në gjuhën serbe, përkatësisht i përkthyer në gjuhën e tij amtare të cilën e flet.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pa shqyrtuar pretendimet tjera të theksuara në kërkesë del se pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit është i bazuar, ngase bazuar në pretendimin e paraqitur por edhe shkresat e lëndës del se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar në gjuhën serbe të dënuarit, me ç'rast është shkëlur e drejta e tij e që rezulton të jetë shkelje e përcaktuar me dispozitën e nenit 384 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 14 par. 8 të KPP-së, pretendime këto të theksuara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 14 par. 8 të KPP-së, me ç'rast është përcaktuar se: "Të pandehurit dhe personit i cili është në vuajtje të dënimit i cili nuk e kupton gjuhën e procedurës duhet siguruar, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtrësive, në tërësi ose pjesërisht, varësisht nga fakti nëse ato janë relevante për qëllimin e mundësimit të të pandehurit ose personit që është në vuajtje të dënimit të ketë njohuri të rasti kundër tij, në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë, ose dokumenteve të tjera të cilat janë thelbësore për të siguruar që ai të jetë në gjendje të ushtrijë të drejtën e tij të mbrojtjes dhe të sigurohet paanshmëria e procedurave. Dokumentet thelbësore përfshijnë çdo vendim i cili e privon personin nga liria, çdo aktakuzë dhe çdo aktgjykim."

Andaj, nga interpretimi i dispozitës së lartë cekur dhe shkresat e lëndës del se të dënuarit aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar në gjuhën e tij amtare dhe nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për kthimin e çështjes me qëllim dorëzimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë të përkthyer në gjuhën e të dënuarit, përkatësisht në gjuhën serbe, meqë me këtë rast përveç nenimit të dispozitave të lartë cekura del se janë cënuar edhe e drejta e garantuar e përdorimit të gjuhës sipas nenit 30 par.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 par.3 nënpar."e" të KEDNJ.

Nga këto arsye kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në këtë pjesë u aprovua dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me vërejtje se duhet të eliminohen shkeljet e cekura dhe gjykata e shkallës së dytë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.654/2023, i datës 15.12.2023

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit X.C., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i përgjithshëm P.nr.1233/2022 i datës 16.01.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Departamenti i përgjithshëm PA1.nr.356/2023 të datës 22.08.2023 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i përgjithshëm P.nr.1233/2022 të datës 16.01.2023 i dënuari X.C. është shpallur fajtor për veprën penale ngacmimi nga neni 182 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 par.1 e 2 e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.11.2022 më datë 16.01.2023. I dënuari është obliguar të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, si dhe taksën për kompensimit e viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Pala e dëmtuar Luljeta Kryeziu për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.356/2023 e datës 22.08.2023, me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të të dënuarit e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm përkritazi me vendimin mbi dënimin ashtu që të dënuarin X.C., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 4 (katër) muaj në të cilin do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 11.11.2022 deri më datë 16.01.2023, ndërsa në pjesët tjera aktgjykimi i ankimuar mbetet i pa ndryshuar.

Kundër këtyre aktgjyqimeve kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit X.C., avokati Gent Gjini nga Prizreni, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale në të drejtën në përkthyes ex officio, kapitulli i III i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, si dhe shkeljet e ligjit nr.03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi si të bazuar këtë kërkesë dhe t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthehej në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.380/2023 e datës 13.12.2023, ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit X.C., av. Gent Gjini, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoj se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se janë të bazuara pretendimet e paraqitura se gjatë procedurës penale dhe nga ana e dy gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.4 të KPP-së.

Nga shkresat e lëndës konkludohet se i dënuari gjatë mbajtjes së shqyrtimit fillestar përkundër faktit se është deklaruar se i përket komunitetit rom, dhe nuk është njoftuar me dispozitat e nenit 14 par.1, 2 dhe 5 të KPP-së dhe pas këtyre njoftimeve të i ipet mundësia të deklarohet përkritazi me faktin se a ka nevojë për përkthim apo ka njohuri të mjaftueshme gjuhëve në të cilat zhvillohet procedura penale. Ngjashëm edhe gjatë seancës së kolegjit në gjykatën e shkallës së dytë nga procesverbali i PA1.nr.356/2023 të datës 22.08.2023 rezulton se i dënuari nuk është njoftuar fare

lidhur me të drejtat e tij dhe me këtë i është mohuar deklarimi i mëtejshëm përkitazi me përdorimin e gjuhës së të dënuarit.

Pasi që i dënuari, nuk është pyetur rreth kësaj çështje dhe i është mohuar përdorimi i gjuhës së tij në seancën e shkallës së parë dhe të dytë dhe përcjellja e seancave në gjuhën që ai e kupton, është bërë shkelje e të drejtave të cilat të dënuarit sipas dispozitës së nenit 384 par.1 nënpar.1.4 të KPP-së, e gjithashtu edhe e drejta e garantuar e përdorimit të gjuhës sipas nenit 30 par.4 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 6 par.3 nënpar.”e” të KELDNJ dhe tutje e etabluar edhe përmes vendimeve të GJELDNJ - Gjykatës së Strasburgut në rastin *Hermi & Italisë* ishte theksuar fakti se: “...njohuritë gjyqësore të të pandehurit janë jetike, sidomos duke pasur parasysh natyrën e veprës penale dhe kompleksitetin e komunikimeve të adresuara për të pandehurin...”, si dhe në rastin *Luedicke, Belkacem dhe Koç & Gjermanisë*, me ç’rast është vendosur standardi së përdorimi i gjuhës është i karakterit absolut, “... përkthimi është absolut kur konstatohet se personi nuk mund të kuptoj ose flet gjuhën e përdorur në gjyq dhe nuk mund të ketë asnjë përjashtim ose pezullim të kësaj të drejte...”. Kurse bazuar në shkresat e lëndës dhe posaçërisht procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore të dy instancave gjyqësore del se këto garancione nuk i janë ofruar të pandehurit që të deklarohet përkitazi me njohuritë e gjuhëve në të cilat zhvillohet procedura penale dhe pas këtij deklarimit të tij të vazhdohet me shqyrtimin gjyqësor apo të sigurohet prania falas e përkthyesit gjyqësor në gjuhën e tij.

Nga këto arsye kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në këtë pjesë u aprovua dhe konform nenit 438 par.1.2 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me vërejtje se duhet të eliminohen shkeljet e cekura, andaj në seancë të dënuarit të i mundësohet deklarimi për njohjen e gjuhëve në të cilat zhvillohet procedura penale dhe nëse nuk njeh këto gjuhë të i sigurohet përkthyesi dhe pas kësaj të vazhdohet me shqyrtimin gjyqësor.

7.16 Komente përmbledhëse

Në rastet e paraqitura më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve, pasi që kishte konstatuar se aktgjykimi i kundërshtuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar se meqë të dënuarit i është mohuar përdorimi i gjuhës së tij dhe përcjellja e seancës gjyqësore në gjuhën e tij, atëherë kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe kjo shkelje kishte qenë arsye e mjaftueshme për t’i aprovuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe për t’i kthyer rastet në rigjykim.

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe duke ju referuar praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, si dhe dispozitave ligjore të trajtuara më lart, mund të nxjerrën këto konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1) Se të pandehurit i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës t’i sigurohet e drejta e përdorimit të gjuhës së tij dhe një gjë e tillë t’i mundësohet përmes një përkthimi të cilësisë së mjaftueshme, në mënyrë që të garantohet paanshmëria e procedurës, veçanërisht për të siguruar që ai ka njohuri të rastit kundër tij dhe është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes;

- 2) Që të pandehurit i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, t'i mundësohet përkthimi për komunikim me mbrojtësin e tij, nëse mbrojtësi nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e të pandehurit;
- 3) Se të gjitha organet shtetërore që veprojnë procedurë penale janë të detyruara që ta njoftojnë të pandehurin për të drejtën që të ketë ndihmën e një përkthyesi pa pagesë, kur nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ndërsa një gjë e tillë edhe të konstatohet në procesverbal të seancës gjyqësore dhe
- 4) Mos sigurimi i përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilin i pandehuri nuk e kupton, konsiderohet shkelje e të drejtave të të pandehurit dhe njëkohësisht edhe shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale e cila ka për pasojë edhe anulimin e aktgjyqimit dhe kthimin e rastit në rigjykim.

7.17 Mbajtja e shqyrtimit gjyqësor pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj

Dispozitat ligjore

Neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 13. i KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

“Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale që njihet sipas detyrës zyrtare apo propozimit të palëve konsiderohet nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj”.

7.18 Komentim i shkurtër i dispozitës ligjore të lartcekur

Kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale vjen në shprehje në rastet kur shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj. Pra, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale ekziston në rastet kur në shqyrtim gjyqësor nuk marrin pjesë personat e caktuar, të cilët janë të detyruar që të marrin pjesë sipas ligjit.

Me ligj në kuptim të shkeljes së lartcekur do të duhej kuptuar ato dispozita ligjore që parashohin detyrimin e personave të caktuar për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor.¹²¹

Natyrisht, se në rend të parë, bëjnë pjesë dispozitat ligjore të KPP-së, mandej, dispozitat ligjore të KDM-së, të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale,¹²² etj.

Rrjedhimisht, si parakusht ose supozim për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor paraqitet edhe prania e subjekteve themelore të procedurës penale.¹²³

¹²¹ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.56.

¹²² Ligji nr.04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale i datës 31.08.2011.

¹²³ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, fq. 371.

Në nenin 282, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se *“Në shqyrtim gjyqësor thirret i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, i dëmtuari ose viktimia dhe mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës, si dhe përkthyesi. Dëshmitarët dhe ekspertët e propozuar nga prokurori i shtetit në aktakuzë dhe nga i akuzuari sipas nenit 250 të këtij Kodi thirren po ashtu në shqyrtimin gjyqësor”*.

Kurse, në paragrafin 6. të nenit të lartcekur, është parashikuar se *“Me kërkesë të Avokatit të Popullit, Avokati i Popullit gjithashtu njoftohet për shqyrtimin gjyqësor me qëllim të monitorimit të procedurës penale në kufijtë e autorizimeve të tij”*.

Mirëpo, pavarësisht faktit se gjykata është e detyruar që t'i ftojë personat e theksuar më lart, në situata të caktuara të parashikuara në mënyrë shprehimore me dispozita ligjore, shqyrtimi gjyqësor mund të mbahet edhe pa prezencën e disa prej këtyre prej personave.

Megjithatë, prania e prokurorit të shtetit në shqyrtim gjyqësor është e detyrueshme dhe është parakusht për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor në çdo rast. Në rast të mos ardhjes së prokurorit të shtetit, atëherë detyrimisht duhet që të shtyhet shqyrtimi gjyqësor dhe duhet që të njoftohet kryeprokurori i prokurorisë përkatëse.

Në këtë drejtim, në nenin 301 të KPP-së është parashikuar se *“Kur prokurori i shtetit nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor të caktuar në bazë të aktakuzës së prokurorit të shtetit, shqyrtimi gjyqësor shtyhet dhe për këtë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e njofton kryeprokurorin e prokurorit të shtetit”*.

Përndryshe, mbajtja e shqyrtimit gjyqësor pa prezencën e prokurorit të shtetit përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 13. të KPP-së. Jo vetëm që përbën shkelje eseciale të dispozitave të procedurës penale, por mbajtja e shqyrtimit gjyqësor pa pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së konsiderohet edhe shkelje e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, nga neni 6 § 1 të KEDNJ-së.¹²⁴

Duke u mbështetur në rëndësinë që ka pjesëmarrja e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor, ligjdhënësi kur është në pyetje mungesa e tij ka parashikuar disa zgjidhje ligjore.

Në parim, prania e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor është e detyrueshme, përveç rasteve kur ndaj tij zbatohen dispozitat ligjore të gjykimit në mungesë.

Pa paragjykuar nenin 303 të KPP-së (*“Gjykimi në mungesë”*),¹²⁵ kur i akuzuari i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e arsyeton mungesën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për të akuzuarin lëshon urdhërarrest në pajtim me nenin 173 të KPP-së. Kur i akuzuari nuk mund të silltet menjëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të silltet me forcë ose në të kundërtën nxjerr aktvendim për pezullimin e procedurës penale, derisa i akuzuari të sjellët në gjykatë. Kur i akuzuari e arsyeton mungesën para arrestimit të tij, gjyqtari

¹²⁴ Rasti *“Krivoshapkin kundër Ruisisë”*, aktgjykimi i datës 27.04.2011, paragrafët 44-46; Rasti *“Ozerov kundër Ruisisë”*, aktgjykimi i datës 18.08.2010, paragrafët 55-58, etj.

¹²⁵ Çështja e gjykimit në mungesë do të trajtohet në mënyrë të veçantë në vijim të këtij punimi.

i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e revokon urdhërarrestin. Shqyrtimi gjyqësor rifillon kur arrestohet i pandehuri.¹²⁶

Në anën tjetër, nëse në shqyrtim gjyqësor nuk paraqitet mbrojtësi i thirrur me rregull dhe për arsye e mosardhjes nuk e njofton gjykatën posa të ketë mësuar për ato, ose nëse mbrojtësi lëshon shqyrtimin gjyqësor pa lejen e gjyqtarit të vetëm gjykues apo të trupit gjykues, gjykata kërkon menjëherë nga i akuzuari që të angazhojë mbrojtës tjetër. Nëse i akuzuari nuk e bën këtë, kurse caktimi i mbrojtësit nuk mund të bëhet pa e dëmtuar mbrojtjen, shqyrtimi gjyqësor shtyhet.¹²⁷

Në rastet tjera, me dispozitat përkatëse ligjore është parashikuar edhe mbrojtja e detyruar, kështu që në këto raste, në shqyrtim gjyqësor duhet që të marrë pjesë edhe mbrojtësi i të akuzuarit.¹²⁸

Edhe pse në nenin 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, nuk është theksuar në mënyrë shprehimore, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale vjen në shprehje edhe në rastet kur shqyrtimi fillestar është mbajtur pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj. Kjo për faktin se dispozitat ligjore të i referohen shqyrtimit gjyqësor në situata të caktuara aplikohen përshtatshmërisht edhe në shqyrtim fillestar, nëse me dispozitat ligjore që i referohen shqyrtimin fillestar nuk është parashikuar ndryshe.¹²⁹

Në nenin 236, paragrafi 6 të KPP-së, është parashikuar se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton prokurorin e shtetit, të pandehurit, mbrojtësit e tyre, palën e dëmtuar ose viktimën dhe mbrojtësin e viktimave ose përfaqësuesin e viktimës për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

Siç shihet, tani me dispozitat ligjore të KPP-së për dallim nga Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale është parashikuar në mënyrë shprehimore që për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar duhet të njoftohet edhe pala e dëmtuar ose viktimë dhe mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës.

Kurse, në nenin 240, paragrafi 1 të KPP-së, është parashikuar se gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit.

Megjithatë, sipas nenit 240, paragrafi 2 të KPP-së, pala e dëmtuar ose viktimë dhe mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës njoftohen për seancën e shqyrtimit fillestar dhe ata kanë të drejtë të jenë të pranishëm, por mungesa e tyre nuk është pengesë për mbajtjen e seancës.

Gjithashtu, në shqyrtim gjyqësor duhet që të marrin pjesë edhe dëshmitarët dhe ekspertët, megjithëse në KPP është parashikuar mundësia që në situata të caktuara, të mbahet shqyrtimi

¹²⁶ Neni 302, paragrafi 1 i KPP-së.

¹²⁷ Neni 304, paragrafi 1 i KPP-së.

¹²⁸ Neni 56, paragrafi 1 i KPP-së. Sipas kësaj dispozite ligjore, i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste: 1.1. nga marrja në pyetje për herë të parë e deri në përfundim të procedurës penale me vendim të formës së prerë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paafte që të mbrohet vetë me sukses; 1.2. nga arrestimi, gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim; 1.3. nga momenti i marrjes në pyetje për herën e parë për vepër penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim; 1.4. në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm; 1.5. në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë; ose 1.6. në të gjitha rastet kur i akuzuari gjykohet në mungesë sipas nenit 303 të këtij Kodi.

¹²⁹ SHALA, AFRIM : *Doracaku i gjyqtarëve për procedurën penale*, Prishtinë, 2015, fq. 97-98, (Bashkautor).

gjyqësor edhe pa prezencën e dëshmitarëve dhe të ekspertëve, duke lexuar deklaratimet e tyre të mëparshme.¹³⁰

Në procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore, përveç personave të cilët duhet të thirren, në shqyrtimin gjyqësor duhet të thirren edhe ekspertit ose psikiatri nga institucioni i kujdesit shëndetësor të cilit i është besuar kryerja e ekzaminimit psikiatrik mbi aftësinë mendore të të akuzuarit. Bashkëshorti/ja e të pandehurit dhe prindërit e tij ose prindërit adoptees, gjithashtu njoftohen për shqyrtimin gjyqësor.¹³¹

Eksperti duhet të jetë i pranishëm edhe në procedurën penale ndaj personave të cilët kanë kryer vepër penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës.¹³²

Është e rëndësishme që të theksohet se sipas dispozitat ligjore të KDM-së, i mituri, mbrojtësi dhe prokurori i shtetit për të mitur duhet të jenë të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor. Përveç personave të paraparë me dispozitat ligjore të KPP-së, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, përfaqësuesi i organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesi i shërbimit sprovues thirren në shqyrtimin gjyqësor. Mosparaqitja e personave të tillë nuk e pengon gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor.¹³³

Edhe në procedurën penale që zhvillohet ndaj madhorve për vepra penale të kryer ndaj fëmijëve sipas nenit 108 të KDM-së duhet që për shqyrtim gjyqësor të ftohen dhe të marrin pjesë edhe disa persona tjerë.

Kështu, në nenin 112, paragrafi 4 të KDM-së është parashikuar se nëse fëmija ndaj të cilit është kryer vepra penale sipas nenit 108 të KDM-së merret në pyetje si viktimë apo dëshmitar, marrja e tillë në pyetje zbatohet më së shumti dy (2) herë. Marrja në pyetje për herë të dytë bëhet me ndihmën e psikologut dhe udhëheqet nga ana e gjyqtarit kompetent. Në pamundësi të sigurimit të psikologut, marrja në pyetje zbatohet nga ana e gjyqtarit kompetent, pa prezencën e tij. Pra, në raste të tilla paraqitet nevoja që për shqyrtim gjyqësor të ftohet edhe një psikolog, me ndihmën e të cilit do të bëhet marrja në pyetje të fëmiut që shtë viktimë e veprave penale nga neni 108 i KDM-së.

Kurse, në paragrafin 6. të nenit të lartcekur është parashikuar se *“Fëmiu si viktimë e veprës penale duhet të ketë përfaqësues të autorizuar në të gjitha fazat e procedurës penale”*.

Në anën tjetër, përveç personave të theksuar më lart, në shqyrtimin gjyqësor për shkak të peshës së madhe që ka duhet të jenë vazhdimisht të pranishëm gjyqtari i vetëm gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues, anëtarët e trupit gjykues, procesmbajtësi dhe gjyqtari zëvendësues.¹³⁴ Për prezencën e tyre dhe për nevojën që trupi gjykues të jetë i përbërë në përputhje me ligjin, duhet që të kujdeset gjyqtari i vetëm gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues.

¹³⁰ Neni 335 i KPP-së.

¹³¹ Neni 513, paragrafi 2 i KPP-së.

¹³² Në nenin 503, paragrafi 3 të KPP-së është parashikuar se gjykata vendos për zbatimin e masës së trajtimit të detyrueshëm për rehabilitimin e kryesve të varur nga alkooli ose nga droga pas dëgjimit të mendimit të ekspertit dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtjes. Mendimi i ekspertit duhet t'i analizojë mundësitë për trajtimin e të pandehurit.

¹³³ Neni 65, paragrafët 1. dhe 2. të KDM-së

¹³⁴ Paragrafët 1. të neneve 292 dhe 293 të KPP-së.

Mirëpo, duhet qartësuar se në rastet kur në shqyrtim gjyqësor nuk ka qenë i pranishëm gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, anëtarët e trupit gjykues apo gjyqtari zëvendësues, atëherë kjo përbën shkelje tjetër esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së.¹³⁵

7.19 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj

Çështja e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj, ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore.

Kështu, në vijim do të paraqiten disa raste që kanë të bëjnë me këtë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale:

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.350/2020, i datës 24.12.2020

A K T G J Y K I M

Me aprovimin si të bazuar të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të miturit E.K., ndërsa sipas detyrës zyrtare për të miturin H.G., anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, PM.nr.100/2022, i datës 31.05.2023 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAM.nr.77/2023, i datës 07.08.2023, ndërsa kjo çështje penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për të Mitur, PM.nr.100/2022, të datës 31.05.2023, ndaj të miturve: E.K. dhe H.G., është shqiptuar masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve. Organit të kujdestarisë i janë caktuar detyra si në vijim: mbikëqyrja e edukimit të të miturve dhe lehtësimin e qasjes në aftësimin profesional dhe në punësim. Organi i kujdestarisë është detyruar që t'i raportoj gjykatës përkritazi me ekzekutimin e vendimit gjyqësor së paku çdo tre (3) muaj. Shpenzimet e procedurës është vendosur që të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës, kurse e dëmtuari M.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PAM.nr.77/2023, e datës 07.08.2023, i ka refuzuar si të papabuzuara ankesat e mbrojtësve të të miturve: E.K. dhe H.G., ndërsa e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të miturit E.K., avokati Egzon Qovanaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të

¹³⁵ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, "Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile", fq.62.

procedurës, shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që kërkesa të pranohet si e bazuar, ndërsa këto aktvendime të ndryshohen ose të anulohen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.300/2023, e datës 04.10.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të miturit E.K., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe nenit 71 të Kodit të Drejtësisë për Mitur (KDM), si dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatojë se:

- kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësi i të miturit E.K., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se me aktvendimet e lartcekura janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP, ngase shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, duke ju referuar prindit të të miturit dhe se në këtë rast, duke u bazuar në nenin 27, paragrafi 1 të KDM-së është dashur që të dëgjohet edhe prindi i të miturit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë konstatojë se pretendimet e mbrojtësit të të miturit Elez Kabashi janë të bazuara.

Kjo për faktin se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së lidhur me nenet 6; 27; 42, paragrafi 1; 46 dhe 65, paragrafi 2 të KDM-së, ndërsa kjo shkelje nuk është evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Siç shihet edhe nga shkresat e lëndës, sa i përket mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, nuk janë ftuar dhe nuk kanë prezantuar prindërit e të miturve, pavarësisht se me urdhrin për caktimin e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023, është vendosur që të ftohen edhe prindërit e të miturve, por që nga shkresat e lëndës nuk rezulton që të njëjtit të jenë njoftuar në mënyrë të rregullt.

Nga shkresat e lëndës, shihet se ftesat për pjesëmarrje në seancën e shqyrtimit gjyqësor i janë dërguar Prokurorisë Themelore në Prizren, Shërbimit Sprovues të Kosovës, Qendrës për Punë Sociale, të dëmtuarit, të miturve dhe mbrojtësve të tyre, mirëpo prindërve të të miturve nuk ju kanë dërguar ftesa për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, edhe pse një gjë e tillë është parashikuar në dispozitat përkatëse të KDM-së.

Kështu, në nenin 42, paragrafi 1 të KDM-së është parashikuar se *“Prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari kanë të drejtë ta shoqërojnë të miturin në të gjitha procedurat dhe nga ata mund të kërkohet që të marrin pjesë nëse kjo është në interes të të miturit”*, në nenin 46, paragrafi 1 të KDM-së është parashikuar se *“Ftesa për pjesëmarrjen e të miturit në procedurë i dorëzohet personalisht dhe përmes prindit, prindit adoptues ose kujdestarit të tij”*, kurse në nenin 65, paragrafi 2 të KDM, është parashikuar se *“Përveç personave të paraparë me dispozitat e Kodit të procedurës penale, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, përfaqësuesi i organit të*

kujdestarisë dhe përfaqësuesi i shërbimit sprovues thirren në shqyrtimin gjyqësor. Mosparaqitja e personave të tillë nuk e pengon gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor”.

Andaj, bazuar në këto dispozita ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se prindërit e të miturve duhet që të thirren në shqyrtim gjyqësor, mirëpo mos paraqitja e paarsyeshme e tyre nuk do të pengonte gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor.

Ndërsa në rastin konkret, nga shkresat e lëndës nuk rezulton që prindërit e të miturve të jenë thirrur në mënyrë të rregullt për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, e aq më parë, kur në rastin konkret, ndaj të miturve: E.K. dhe H.G., është shqiptuar masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë, pa i dëgjuar fare prindërit e të miturve, ashtu siç parashihet në nenin 27, paragrafi 1 të KDM-së.

Në këtë mënyrë, duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të miturit E.K., ndërsa sipas detyrës zyrtare edhe për të miturin H.G., ndërsa vendosi që të anulohen aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë evituar as me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë shkeljet e lartcekura, duke i ftuar në mënyrë të rregullt të gjithë personat, duke përfshirë këtu edhe prindërit e të miturve, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore të KDM-së, ndërsa më pastaj të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar në nenin 397 dhe në nenin 436, paragrafi 2. të KPP-së (“*Beneficium Cohæsionis*”) lidhur me nenin 6 të KDM-së, sipas detyrës zyrtare ka vendosur edhe në dobi të të miturit H.G., edhe pse i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, pasi që arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të miturit E.K., nuk janë të natyrës personale.

7.20 Komente përmbledhëse

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe duke ju referuar dispozitave ligjore të trajtuara më lart, mund të nxjerrën këto konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1. Konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. i KPP-së, në rastet kur shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj.

2. Kjo shkelje bënë pjesë në kuadër të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për të cilat gjykata kujdeset sipas propozimit të palëve, por edhe sipas detyrës zyrtare.¹³⁶
3. Për shkak të natyrës së saj, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, ndikon edhe në anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e rastit në rigjykim.
4. Është e nevojshme që të theksohet edhe fakti se për shkak të peshës dhe rëndësisë së kësaj shkelje, në rastin e lartcekur, duke e aplikuar institutin juridik “*Beneficium Cohesionis*”, Gjykata Supreme e Kosovës, sipas detyrës zyrtare, kishte vendosur edhe për të miturin tjetër, edhe pse i njëjti nuk kishte ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke i anuluar aktgjykimet në tërësi, pasi që nga shkresat e lëndës kishte rezultuar as ata nuk kanë pasur mbrojtës gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Pjesa e III-të

7.21 Gjykimi në mungesë (“Trial in Absentia”)

Dispozitat ligjore -Neni 303 i KPP-së

1. I akuzuari është i pranishëm në:

1.1. shqyrtimin fillestar, dhe

1.2. shqyrtimin kryesor.

2. I akuzuari konsiderohet se heq dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor në rrethanat e mëposhtme:

2.1. kur i akuzuari ka qenë i pranishëm në seancë fillestare dhe është informuar për datën e shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në pajtim me nenin 280 dhe 282 të këtij Kodi, apo gjatë ndonjë seance tjetër gjyqësore dhe i akuzuari është njoftuar për detyrimin për të qenë i pranishëm për gjykim dhe se gjykimi mund të vazhdojë nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim; ose

2.2. Ka qenë i pranishëm në gjykim, por më pas nuk është paraqitur në seancat gjyqësore pasuese dhe është informuar për datën e re të shqyrtimit kryesor në pajtim me nënparagrafin 2.1 të këtij neni.

3. Në rast se i akuzuari nuk paraqitet në ndonjë rrethanë nga nën-paragrafi 2.1 ose 2.2 të këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse i akuzuari mungon vullnetarisht pas seancës dëgjimore të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni dhe i akuzuari përfaqësohet nga mbrojtësi.

4. Për të vendosur nëse do të mbajë gjykimin në mungesë të të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mban seancë dëgjimore për të përcaktuar përse i akuzuari mungon dhe për të vlerësuar çdo sqarim apo dëshmi nëse i akuzuari ka vendosur vullnetarisht të mungojë në gjykim. Në veçanti, në marrjen e këtij vendimi, gjyqtari i vetëm

¹³⁶ Neni 394, paragrafi 1 i KPP-së.

gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr parasysh nëse janë bërë përpjekje të arsyeshme për të gjetur të akuzuarin.

5. Nëse Gjykata, në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni përcakton që i akuzuari vullnetarisht ka vendosur që të mungojë në gjykim, gjykata për të vendosur nëse do të mbajë gjykimin në mungesë të të akuzuarit gjithashtu shqyrton nëse përmbushet ndonjë prej kushteve të mëposhtme:

5.1. vështirësinë e shtyrjes së gjykimit, veçanërisht në gjykimet që përfshijnë shumë të akuzuar;

5.2. barrën mbi prokurorin e shtetit për vijimin e dy gjykimeve që përfshijnë dëshmi të përbashkëta të të bashkëpandehurve; dhe

5.3. nëse vonesa do t'i vë dëshmitarët e prokurorisë në rrezik ose vështirësi të konsiderueshme.

6. Në rast të gjykimit të mbajtur sipas paragrafit 2 të këtij neni, gjykata bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar të pandehurin lidhur me aktgjykimin. Mirëpo, nëse gjykata nuk është në gjendje ta njoftojë të pandehurin për shkak të mungesës së tij, mbrojtësi ka të drejtë të bëjë ankesë ndaj aktgjykimit në emër të të pandehurit sipas nenit 383 të këtij Kodi. Kur vepron ashtu, mbrojtësi tregon se ai ka marrë parasysh interesin më të mirë të të akuzuarit. Dispozitat e nenit 380 të këtij Kodi në lidhje me afatin zbatohen përshtatshmërisht.

7. Në rastet e veprave penale të përcaktuara në nenin 104 të Kodit Penal, gjykimi në mungesë mund të mbahet edhe pa u plotësuar kriteret e parapara në këtë nen për praninë e të akuzuarit, nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues bindet se janë bërë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar të akuzuarin për shqyrtimin gjyqësor dhe për ta siguruar praninë e tij. Në këtë rast, i akuzuari përfaqësohet nga mbrojtësi gjatë tërë procedurës penale, derisa aktgjykimi të merr formën e prerë. Nenet 11 dhe 56 të këtij Kodi në lidhje me mbrojtjen e detyrueshme zbatohen përshtatshmërisht.

8. Përpjekjet e arsyeshme në kuptimin e paragrafëve 6 dhe 7 të këtij neni përfshijnë procedurat sipas neneve 172 dhe 173 të këtij Kodi dhe një fushatë informative të plotë, duke e thirrur të akuzuarin të dorëzohet në juridiksionin e gjykatës. Poashtu, ftesa së bashku me aktakuzën publikohen në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit, gjykatës që zhvillon procedurën dhe në gazetën zyrtare, duke i bërë thirrje të të akuzuarit të dorëzohet. Njoftimet e tilla i bëjnë thirrje çdo personi që ka informacion relevant për vendndodhjen e të akuzuarit që t'ia komunikojë atë informacion policisë.

9. Personi i gjykuar sipas paragrafit 7 të këtij neni ka të drejtë në rigjykim të pakushtëzuar, automatik e të plotë sipas kërkesës.

7.22 Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Njëra prej ndryshimeve më të rëndësishme të KPP-së, është edhe parashikimi i mundësisë së mbajtjes së gjykimit në mungesë.¹³⁷ Si parim, nuk do të mund të zbatohet procedura penale në përgjithësi dhe nuk do të mund që të mbahet shqyrtimi gjyqësor, në veçanti, në rastet kur në të nuk merr pjesë i akuzuari. Mirëpo, ngjashëm sikur në legjislacionet e disa vendeve të tjera,¹³⁸ edhe në Republikën e Kosovës është parashikuar mundësia, që nën kushte të caktuara të mbahet gjykimi në mungesë, përkatësisht që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në mungesë të të akuzuarit.

Kështu, në nenin 303 të KPP-së është parashikuar mundësia e mbajtjes së gjykimit në mungesë, ku janë përcaktuar kushtet që duhet plotësuar dhe procedura që duhet respektuar.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se gjykimi në mungesë duhet kuptuar si përjashtim dhe në asnjë mënyrë si rregull, meqë gjykimi në prezencë të të akuzuarit, gjithmonë i ka përparësitë e veta në raport me një gjykim në mungesë.¹³⁹

Për dallim prej disa vendeve tjera, KPP-ja ka akceptuar një standard të ri të mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor edhe përmes platformave virtuale,¹⁴⁰ andaj edhe mbi bazën e kësaj, mund të konstatohet se gjykimi në mungesë nënkupton rastet kur procedura penale zhvillohet në mungesë të të akuzuarit, qoftë në mënyrë fizike, apo qoftë në mënyrë virtuale.

Nëse i analizojmë dispozitat e tërësishme të KPP-së, atëherë shohim që përveç gjykimit në mungesë sipas nenit 303 të KPP-së, është parashikuar edhe gjykimi në mungesë për shkak të përjashtimit të të akuzuarit nga seanca e shqyrtimit gjyqësor. Në nenin 297, paragrafi 2 të KPP-

¹³⁷ Gjykimi në mungesë, nën supozimin e përmbushjes së kushteve të caktuara, ka qenë i lejuar dhe i parashikuar edhe me legjislacionin e mëparshëm të procedurës penale në Republikën e Kosovës. Kështu, me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale ishte parashikuar se “në rastet e hetimit, akuzës dhe shqyrtimit gjyqësor të të pandehurve që supozohen të kenë kryer vepra penale kundër të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe të Drejtës Ndërkombëtare Penale, në periudhën janar 1990 deri në qershor 1999, derogohen dispozitat në nenet e mëposhtme sa i përket pjesëmarrjes së të dyshuarit/akuzuarit në procedurën penale”. Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore, gjykimi në mungesë mund të vinte në shprehje vetëm për vepra penale të caktuara të kryera në periudhën e caktuar kohore. Në këtë kontekst, siç është theksuar edhe më lart, gjykimi në mungesë mund të zbatohet vetëm kur kemi pasur të bëjmë “me vepra penale kundër të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe të Drejtës Ndërkombëtare Penale, kryera në periudhën janar 1990 deri në qershor 1999”, por jo edhe për vepra penale tjera. Bazuar në dispozitat ligjore të ligjit të lartcekur, gjykimi në mungesë ishte një përjashtim nga rregullat e përgjithshme të procedurës penale dhe duhej të ishte i lidhur me qëllimin e luftës ndaj pandëshkueshmërisë së krimeve të lartcekura, të kryera në territorin e Republikës së Kosovës, kur të pandehurit nuk mund të vihen në dispozicion, përkatësisht të pandehurit nuk mund të sillleshin para autoriteteve të shtetit tonë, sipas parimeve të bashkëpunimit ndërkombëtar. Pra, me fjalë të tjera, gjykimi në mungesë nuk ishte rregullë, por përbente përjashtim, në situatat e caktuara, kur të pandehurit nuk mund të sillleshin para autoriteteve të Republikës së Kosovës, sipas parimeve të bashkëpunimit ndërkombëtar.

¹³⁸ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (neni 352); Ligji i Procedurës Penale të Republikës së Kroacisë (neni 322); Kodi i Procedurës Penale të Malit të Zi (neni 324), etj. Edhe Italia është njëri prej vendeve që në legjislacionin e tij e parashikon mundësinë e mbajtjes së gjykimit në mungesë për të gjitha veprat penale. Prania e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor konsiderohet e drejtë e të akuzuarit, por jo edhe detyrim i tij. Gjykimi në mungesë zbatohet në rastet kur vërtetohet se i akuzuari e ka pranuar njohimin dhe nuk ka shkaqe që e justifikojnë mungesën e tij. Italia është dënuar disa herë nga GjEDNJ-ja për shkak të mos respektimit të nenit 6 të KEDNJ-së që ndërlihdet me gjykimin në mungesë!

¹³⁹ Gjykimi në mungesë nuk mund të zbatohet ndaj të miturve. Në nenin 40, paragrafi 2 të KDM-së është parashikuar se “I mituri nuk mund të gjykohet në mungesë”.

¹⁴⁰ Neni 281, paragrafët 3-11 të KPP-së.

së, është parashikuar një mundësi e tillë e përjashtimit të të akuzuarit nga seanca e shqyrtimit gjyqësor, nëse i njëjti e prish rendin dhe e ofendon dinjitetin e gjykatës.

Në anën tjetër, duke u bazuar në nenin 303 të KPP-së, atëherë mund të konstatojmë se në këtë dispozitë ligjore janë parashikuar dy (2) variante të gjykimit në mungesë:

- 1) Gjykimi në mungesë në formën standarde dhe
- 2) Gjykimi në mungesë në rastet e veprave penale nga neni 104 i KPRK-së.¹⁴¹

Siç do të shohim në vijim, këto dy (2) variante të gjykimit në mungesë dallojnë në mes vete sa i përket kushteve për mbajtjen e gjykimit dhe për praninë e të akuzuarit, procedurës që zhvillohet, veprave penale që janë objekt i aktakuzës dhe të drejtës për të kërkuar rigjykim.

1) Gjykimi në mungesë në formën standarde - Në nenin 303, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se i akuzuari është i pranishëm në shqyrtim fillestar dhe në shqyrtimin gjyqësor. Kurse, në paragrafin 2 të nenit 303 të KPP-së janë parashikuar situatat se kur konsiderohet se i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor, e që është njëri prej kriterëve vendimtare për të mundur që të mbahet gjykimi në mungesë.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe në dispozitat tjera të këtij neni, mund të konstatojmë se gjykimi në mungesë në formën standarde, nën supozimin e përbushjes së kushteve tjera, mund të mbahet vetëm në shqyrtim gjyqësor, por jo edhe në shqyrtim fillestar. Pra, në raste të tilla, nëse është bërë fjalë për gjykimin në mungesë në formën standarde, i pandehuri duhet që të jetë prezent gjatë shqyrtimit fillestar, në mënyrë që më pastaj, të ekziston mundësia e mbajtjes së gjykimit në mungesë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Siç është theksuar edhe më lart, njëri prej kriterëve vendimtare për të vendosur nëse mund të mbahet gjykimi në mungesë ndërlidhet me faktin nëse **“i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor”**.

Në këtë mënyrë në paragrafin 2 të nenit 303 të KPP-së janë përcaktuar disa situata përmes të cilat konsiderohet se i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor. Kështu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se i akuzuari konsiderohet se heq dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor në rrethanat e mëposhtme:

2.1. Kur i akuzuari ka qenë i pranishëm në seancë fillestare dhe është informuar për datën e shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në pajtim me nenin 280 dhe 282 të këtij Kodi, apo gjatë ndonjë seance tjetër gjyqësore dhe i akuzuari është njoftuar për detyrimin për të qenë i pranishëm për gjykim dhe se gjykimi mund të vazhdojë nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim; ose

2.2. Ka qenë i pranishëm në gjykim, por më pas nuk është paraqitur në seancat gjyqësore pasuese dhe është informuar për datën e re të shqyrtimit kryesor në pajtim me nënparagrafin 2.1 të këtij neni.

Në të dyja këto situata, ligjdhënësi ka parashikuar se i akuzuari konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor, nëse ka marrë pjesë në seanca të caktuara gjyqësore dhe është njoftuar paraprakisht për detyrimin për të qenë i pranishëm për

¹⁴¹ Neni 303, paragrafi 7 i KPP-së.

gjykim, përkatësisht në seancat e ardhshme gjyqësore dhe se gjykimi mund të vazhdojë, nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim. Me fjalë të tjera, pjesëmarrja në ndonjë seancë përkatëse gjyqësore dhe njoftimet e lartcekura janë kritere për të përcaktuar se i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor.

Situata nga nën-paragrafi 2.1., vjen në shprehje në rastet kur i akuzuari ka qenë i pranishëm në shqyrtim fillestar dhe është informuar për datën e shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në pajtim me nenin 280 dhe 282 të këtij Kodi, apo gjatë ndonjë seance tjetër gjyqësore dhe i akuzuari është njoftuar për detyrimin për të qenë i pranishëm për gjykim dhe se gjykimi mund të vazhdojë nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim.

Kurse, siutata nga nën-paragrafi 2.2., vjen në shprehje në rastet kur i akuzuari ka qenë i pranishëm në gjykim, përkatësisht në ndonjë seancë të shqyrtimit gjyqësor, por më pas nuk është paraqitur në seancat gjyqësore pasuese dhe është informuar për datën e re të shqyrtimit kryesor në pajtim me nën-paragrafin 2.1 të këtij neni.

Nëse eventualisht i akuzuari nuk paraqitet në ndonjërin prej seancave të lartcekura, atëherë është detyrë gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues që të cakton një seancë dëgjimore për të përcaktuar nëse i akuzuari mungon vullnetarisht dhe ka hequr dorë nga e drejta e për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor.¹⁴² Në këtë seancë të caktuar, përveç tjerash, duhet që të marrë pjesë edhe mbrojtësi i të akuzuarit.

Gjithashtu, duke u bazuar në paragrafin 4 të nenit 303 të KPP-së, për të vendosur nëse do të mbajë gjykimin në mungesë të të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mban seancë dëgjimore për të përcaktuar përse i akuzuari mungon dhe për të vlerësuar çdo sqarim apo dëshmi nëse i akuzuari ka vendosur vullnetarisht të mungojë në gjykim. Në veçanti, në marrjen e këtij vendimi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr parasysht nëse janë bërë “përpjekje të arsyeshme për të gjetur të akuzuarin”.

Po ashtu, nëse gjykata, në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni përcakton që i akuzuari vullnetarisht ka vendosur që të mungojë në gjykim, gjykata për të vendosur nëse do të mbajë gjykimin në mungesë të të akuzuarit gjithashtu shqyrton nëse përmbushet ndonjë prej kushteve të mëposhtme:

- vështirësinë e shtyrjes së gjykimit, veçanërisht në gjykimet që përfshijnë shumë të akuzuar;
- barrën mbi prokurorin e shtetit për vijimin e dy gjykimeve që përfshijnë dëshmi të përbashkëta të të bashkëpandehurve; dhe
- nëse vonesa do t'i vë dëshmitarët e prokurorisë në rrezik ose vështirësi të konsiderueshme.¹⁴³

Nëse është mbajtur gjykimi në mungesë në formën standarde, atëherë gjykata duhet që të bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar të pandehurin lidhur me aktgjykimin. Mirëpo, nëse gjykata nuk është në gjendje ta njoftojë të pandehurin për shkak të mungesës së tij, mbrojtësi ka të drejtë të bëjë ankesë ndaj aktgjykimit në emër të të pandehurit sipas nenit 383 të këtij Kodi. Kur vepron

¹⁴² Neni 303, paragrafi 4 i KPP-së.

¹⁴³ Neni 303, paragrafi 5 i KPP-së.

ashtu, mbrojtësi tregon se ai ka marrë parasysh interesin më të mirë të të akuzuarit. Dispozitat e nenit 380 të këtij Kodi në lidhje me afatin zbatohen përshtatshëmrisht.¹⁴⁴

Në paragrafin 8 të nenit 303 të KPP-së është parashikuar se përpjekjet e arsyeshme në kuptimin e paragrafëve 6 dhe 7 të këtij neni përfshijnë procedurat sipas neneve 172 dhe 173 të këtij Kodi dhe një fushatë informative të plotë, duke e thirrur të akuzuarin të dorëzohet në juridiksionin e gjykatës. Poashtu, ftesa së bashku me aktakuzën publikohen në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit, gjykatës që zhvillon procedurën dhe në gazetën zyrtare, duke i bërë thirrje të të akuzuarit të dorëzohet. Njoftimet e tilla i bëjnë thirrje çdo personi që ka informacion relevant për vendndodhjen e të akuzuarit që t'ia komunikojë atë informacion policisë.

2) Gjykimi në mungesë në rastet e veprave penale të përcaktuara në nenin 104 të KPRK-së - Siç është theksuar edhe më lart, përveç formës standarde të gjykimit në mungesë, në nenin 303 të KPP-së është parashikuar edhe gjykimi në mungesë në rastet e veprave penale të përcaktuara në nenin 104 të KPRK-së

Në nenin 104 të KPRK-së janë parashikuar këto vepra penale: gjenocidi, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen dhe vepra penale vrasja e rëndë.

Në rastet e vepra penale të tilla, gjykimi në mungesë mund të mbahet edhe pa u plotësuar kriteret e parapara në këtë nen për praninë e të akuzuarit, nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues bindet se janë bërë "përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar të akuzuarin për shqyrtimin gjyqësor dhe për ta siguruar praninë e tij". Në këtë rast, i akuzuari përfaqësohet nga mbrojtësi gjatë tërë procedurës penale, derisa aktgjykimi të merr formën e prerë. Nenet 11 dhe 56 të këtij Kodi në lidhje me mbrojtjen e detyrueshme zbatohen përshtatshëmrisht.¹⁴⁵

Në paragrafin 9 të nenit 303 të KPP-së është parashikuar se personi i gjykuar për vepra penale të larcckura ka të drejtë në rigjykim të pakushtëzuar, automatik e të plotë sipas kërkesës.

Përndryshe, duhet theksuar se edhe me Direktiven nr.2016/343 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 09.03.2016, mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë të pranishëm në gjykimin në procedurë penale, është parashikuar mundësia e mbajtjes së gjykimit në mungesë.¹⁴⁶

Në nenin 8, paragrafi 2 të kësaj Direktive është parashikuar se Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që një gjykim që mund të rezultojë në një vendim mbi fajësinë ose pafajësinë e një të dyshuari ose personi i akuzuar mund të mbahet në mungesë të tij, me kusht që:

- (a) i dyshuari ose personi i akuzuar është informuar, në kohën e duhur, për gjykimin dhe për pasojat e mosparaqitjes; ose
- (b) i dyshuari ose personi i akuzuar, pasi është informuar për gjykimin, përfaqësohet nga një avokat, i cili ishte i emëruar ose nga i dyshuari ose i akuzuari ose nga shteti.

Sipas paragrafit 4 të nenit të lartcekur, kur Shtetet Anëtare parashikojnë mundësinë e mbajtjes së gjykimeve në mungesë, por nuk është e mundur të respektohen kushtet e parapara në

¹⁴⁴ Neni 303, paragrafi 6 i KPP-së.

¹⁴⁵ Neni 303, paragrafi 7 i KPP-së.

¹⁴⁶ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32016L0343>

paragrafin 2 të këtij neni për shkak se i dyshuari ose i akuzuari nuk mund të gjendet, pavarësisht përpjekjeve të arsyeshme që janë bërë, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që megjithatë vendimi mund të merret dhe zbatohet. Në raste të tilla, Shtetet Anëtare sigurojnë që kur të dyshuarit ose të akuzuarit janë të informuar për vendimin, veçanërisht kur ata janë kapur, ata gjithashtu informohen për mundësinë për të kundërshtuar vendimin dhe të drejtën për një gjykim të ri ose për një mjet tjetër juridik.

Përndryshe, aspekte të rëndësishme në lidhje me gjykimin në mungesë janë të parashikuara dhe rregulluara edhe me Konventën e Këshillit të Evropës për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Aktgjykimeve Penale të datës 28.05.1970.¹⁴⁷

Gjykimi në mungesë është trajtuar edhe nga GjEDNJ-ja, e cila në disa raste nga praktika gjyqësore ka sqaruar se mungesa e të akuzuarit në një proces gjyqësor nuk është në vetëvete e papajtueshme me nenin 6 të KEDNJ-së, kuptohet nëse përmbushen edhe disa kushte tjera.

Kështu, GjEDNJ-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore thekson se është e vështirë të përfytyrohet se si do të mund t'i ushtronte një i akuzuar të drejtat që i garantohen atij shprehimisht nga neni 6 § 3 c), d) dhe e) i KEDNJ-së konkretisht të drejtën që “*të mbrohet vetë*”, “*të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët*” dhe “*të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq*”, po qe se ai nuk është i pranishëm në procesin e tij. Detyrimi për t'i garantuar të akuzuarit të drejtën për të qenë i pranishëm në sallën e gjyqit është prej elementeve thelbësore të nenit 6 të KEDNJ-së.¹⁴⁸ Ndonëse një procedurë që zhvillohet në mungesë të të pandehurit nuk është në vetvete e papajtueshme me nenin 6 të KEDNJ-së, përbën sidoqoftë mohim të drejtësisë, nëse i pandehuri i dënuar në mungesë (“*in absentia*”) nuk mund të fitojë më pas të drejtën që një juridiksion të vendosë sërish, pasi ta ketë dëgjuar atë, rreth bazueshmërisë faktike dhe juridike të akuzës, ndërkohë që nuk është vërtetuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjyq e për t'u mbrojtur, apo që ai ka pasur qëllimin për t'u shmangur drejtësisë.¹⁴⁹

Duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që një gjykim në mungesë të konsiderohet i rregullt dhe legjitim, duhet të plotësohen garancitë procedurale të mëposhtme:

- 1) Duhet që i akuzuari të jetë informuar për procedurën dhe për të duhet të vërtetohet se i akuzuari ka pasur njohuri reale;
- 2) Duhet vërtetuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjyq e për t'u mbrojtur;
- 3) Të akuzuarit duhet t'i jepet e drejta për t'u paraqitur në gjykatë në çdo moment dhe të kërkojë rigjykim;
- 4) I akuzuari duhet të përfaqësohet nga një mbrojtës i kualifikuar;

¹⁴⁷ <https://rm.coe.int/1680072d3b>

¹⁴⁸ Rasti “*Hermi kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 18.10.2006, paragrafët 58-59; Rasti “*Sejdovic kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 01.03.2006, paragrafi 81; Rasti “*Colozza kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 12.02.1985, paragrafi 27, etj.

¹⁴⁹ Rasti “*Sejdovic kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 01.03.2006, paragrafi 82; Rasti “*Colozza kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 12.02.1985, paragrafi 29; Rasti “*Krombach kundër Francës*”, aktgjykimi i datës 13.02.2001, paragrafi 85; Rasti “*Somogyi kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 10.11.2004, paragrafi 66. etj.

- 5) Duhet të tregohet qartë se i akuzuari është në arrati dhe jo thjeshtë se ai nuk mund të lokalizohet, etj.

7.23 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe e Gjykatës së Apelit të Kosovës në lidhje me gjykimin në mungesë

Në praktikën tonë gjyqësore, gjykimin në mungesë nuk është zbatuar në numër të madh të rasteve, andaj, edhe në këtë arsye në vijim të këtij punimi do të paraqiten disa raste të tilla të cilat janë shqyrtuar nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe Gjykata e Apelit e Kosovës, të cilat kanë konstatuar mos zbatim në mënyrë të duhur të dispozitave ligjore që i referohen gjykimit në mungesë, të cilat janë konsideruar edhe si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat mandej edhe kanë kushtëzuar në anulimin e aktgjytimeve të kundërshtuara dhe kthimin e çështjeve penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.179/2024, i datës 26.03.2024 i Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.191/2022 e datës 16.05.2023, të dënuarin M. B. e kishte shpallur fajtor për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 2 të KPRK-së, ndërsa në këtë rast ishin zbatuar dispozitat ligjore të institutit të “gjykimit në mungesë”, pasi që shqyrtimi gjyqësor ishte mbajtur në mungesë të të akzuarit, i cili edhe ishte gjykuar në mungesë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.378/2023 e datës 21.12.2023, e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kishte paraqitur mbrojtësi i të dënuarit M. B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cila kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimet e kundërshtuara të i anulon dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim ose aktgjykimet të ndryshohen dhe të dënuarit të i shqiptoj dënim më të butë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.104/2024 e datës 19.03.2024, kishte propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, pasi që i kishte shqyrtuar shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi kishte vlerësuar pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, kishte konstatuar se kërkesa është e bazuar.

Gjykata Supreme të Kosovës, kishte vlerësuar se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të bazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, përmbajnë shkelje

esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1 lidhur me nenin 303, paragrafi 2 të KPP-së, meqë gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore përkitazi me gjykimin në mungesë të të dënuarit.

Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për zbatimin e gjykimit në mungesë vetëm pjesërisht ka respektuar dispozitën ligjore të nenit 303, paragrafët 2 dhe 4 të KPP-së dhe të cilat kanë përcaktuar se: “I akuzuari konsiderohet se heq dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor në rrethanat e mëposhtme: 2.1. kur i akuzuari ka qenë i pranishëm në seancë fillestare dhe është informuar për datën e shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në pajtim me nenin 280 dhe 282 të këtij Kodi, apo gjatë ndonjë seance tjetër gjyqësore dhe i akuzuari është njoftuar për detyrimin për të qenë i pranishëm për gjykim dhe se gjykimi mund të vazhdojë nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim; ose 2.2. Ka qenë i pranishëm në gjykim, por më pas nuk është paraqitur në seancat gjyqësore pasuese dhe është informuar për datën e re të shqyrtimit kryesor në pajtim me nën-paragrafin 2.1 të këtij neni, 4. Për të vendosur nëse do të mbajë gjykimin në mungesë të të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mban seancë dëgjimore për të përcaktuar përse i akuzuari mungon dhe për të vlerësuar çdo sqarim apo dëshmi nëse i akuzuari ka vendosur vullnetarisht të mungojë në gjykim. Në veçanti, në marrjen e këtij vendimi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr parasysh nëse janë bërë përpjekje të arsyeshme për të gjetur të akuzuarin”.

Duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura dhe procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 24.04.2023, me ç’rast është marrë aktvendimi për mbajtjen e gjykimit në mungesë del se vetëm pjesërisht janë plotësuar kushtet ligjore për zbatimin e gjykimit në mungesë.

Duke marrë për bazë shkresat e lëndës dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë rrjedh se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë i ka përfunduar të gjitha veprimet e përcaktuara me dispozitat e neneve 172 dhe 173 të KPP-së, mirëpo për tu realizuar gjykimi në mungesë dhe në zbatim të nenit 303, paragrafët 2 dhe 4 të KPP-së, është e detyrueshme që të gjitha kushtet e përcaktuara të përmbushen në mënyrë kumulative dhe atë:

- përcaktimi i faktit se cila ishte arsyeja e mungesës së të akuzuarit e aspektit subjektiv apo objektiv dhe
- gjithashtu që i akuzuari paraprkishtë gjatë një seance (qoftë fillestare apo gjyqësore) që kishte marrë pjesë do të duhej të njoftohej se mungesa e tij gjatë shqyrtimeve të ardhshme gjyqësore mund të vazhdoj me gjykim në mungesë, përkatësisht shqyrtimi gjyqësor do të mbahet pa prezencën e tij.

Pra, siç del nga shkresat e lëndës i akuzuari nuk ka pasur mundësi të deklarohet për arsyen e mungesës së tij dhe gjithashtu nuk ka qenë i njoftuar se gjykimi kundër tij mund të vazhdohet pa prezencën e tij, kushte këto të domosdoshme për të zbatuar gjykimin në mungesë të përcaktuara sipas dispozitave ligjore të përshkruara më lartë.

Gjykata Supreme e Kosovës kishte vlerësuar se gjykimi në mungesë duhet parë si përjashtim dhe në dritën e faktit se mungesa e të akuzuarit cenon disa të drejta të tij të garantuara si pjesë e një procesi të rregullt gjyqësor, andaj në dritën e këtij parimi është e domosdoshme që kriteret për aplikimin e gjykimit në mungesë të plotësohen në tërësi sipas dispozitave të procedurës

penale dhe po ashtu të drejtat e të akuzuarit të respektohen edhe në dritën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe KEDNJ-së.

Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, kishte vlerësuar se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1. lidhur me nenin 303, paragrafi 2 të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.

Gjykata Supreme e Kosovës kishte udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që në rigjykim duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo-juridike.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi PAKR.nr.409/2003, i datës 02.10.2023, i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.203/2018, e datës 27.05.2023, ishte shpallur fajtor i akuzuari H.T., për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”, nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit ishte shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 1.000 (njëmijë) Euro, si dhe për shkak të veprës penale “Kanosja” nga neni 185, paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për të cilën vepër penale, ndaj të akuzuarit ishte shqiptuar dënimi me kusht.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit H.T., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që ankesa e ushtruar të aprovohet, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale t’i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.379/2023, e datës 13.07.2023, kishte propozuar që ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kolegji i kësaj gjykatë në kuptim të nenit 394 të KPP-së, kishte vlerësuar ankesën e ushtruar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe kishte ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të tjera të cilat kushtëzojnë anulimin e tij.

Kolegji i Gjykatës së Apelit të Kosovës kishte vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit H.T., dhe sipas detyrës zyrtare, përkritazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 të KPP-së, e për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPP-së. Nga shkresat e lëndës është evidente se gjykata e shkallës së parë në procesverbalin e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 08.01.2019, në kohën kur ka qenë në fuqi Kodi i Procedurës Penale, nr.04/L-123, të datës 13.12.2012, e ka mbajtur shqyrtimin fillestar, mirëpo

Kodi i Procedurës Penale, Kodi nr.08/L-032, të datës 14.07.2022, është hyrë në fuqi me datën 17.02.2023, atëherë parashtrohet si çështje që veprimet të cilat janë ndërmarrë me datën 08.01.2019, a kanë qenë më të favorshëm apo të disfavorshme për të akuzuarin, sepse mbajta e shqyrtimi fillestar, si dhe seancave të tjerë konsiston në respektimin e dispozitave të cilat janë në favor të akuzuarit, sepse edhe ligji na obligon që të respektohet gjithnjë dinjiteti i të akuzuarit. Në rastin konkret, nëse i hedhet shikimi dhe vlerësimi i dispozitës ligjore nga neni 303 të KPP-së, rezulton se për të mbajtur një gjykim në mungesë, i akuzuari duhet të jetë në shqyrtimin fillestar apo në shqyrtimin kryesor dhe se i njëjti nëse nuk paraqitet në fazat e tjera të zhvillimit të procedurës, duhet të heq dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtime gjyqësore në rrethana të më poshtme të parapara në nenin 303, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1. të KPP-së: “kur i akuzuari ka qenë i pranishëm në seancën fillestare dhe është informuar për datën e shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues, ose kryetari i trupit gjykues në pajtim me nenin 280 dhe 282 të KPP-së, apo gjatë ndonjë seance tjetër gjyqësore dhe i akuzuari është njoftuar për detyrimin për të qenë i pranishëm për gjykim, gjykimi mund të vazhdojë nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim”, që nënkupton se në rastin konkret nuk është ezauruar e gjithë përmbajtja në dispozitën përkatëse ligjore, për çka edhe ndërlihet drejtpërdrejt me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse prania e të akuzuarit duhet të jetë domosdoshmërisht prezente, nëse nuk është respektuar tërë procedura e mbajtjes së gjykimeve pa prezencën e të akuzuarit, apo gjykimi në mungesë. Po ashtu, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, rezulton se nuk është bërë ekspertizë përkitazi me armën sikurse që shkruan në dispozitiv të aktgjykimit, se e njëjta ka qenë shkrepës, pasi që nuk është vërtetuar se cila ka qenë marka e armës, se bie në kategorinë e armëve, apo jashtë kategorisë së armëve, se a ka qenë funksionale në ditën e kryerjes së veprës penale, se a është e përdorur edhe në ndonjë rast tjetër, që është me rëndësi që të verifikohen të gjitha këto çështje për të pasur një pasqyrë më të drejtë. Pasi që aktgjykimi përfshihet me këto shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, natyrisht që i njëjti ndërlihet edhe me shkeljet e ligjit penal, që rezulton se edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj është dashur që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet, kurse në ri procedurë gjykata e shkallës së parë pas pranimit të këtij aktvendimi duhet të eliminojë vërejtjet për tu futur në shqyrtim gjyqësor, që të plotësohen kushtet e parapara ligjore, nga neni 303 të KPP-së për gjykime në mungesë, të bëhet ekspertiza e armës, nga ana e institutit të balistikës forenzike, e sipas rrjedhës së procedurës, të nxjerrë edhe prova të tjera, e më pastaj të vendos çështjen penale.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi PAKR.nr.426/2003, i datës 19.10.2023, i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.93/2021, e datës 01.06.2023, të akuzuarin V.Sh. e kishte shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë kishte paraqitur mbrojtësja e të akuzuarit V.Sh., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurë penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.396/2023, e datës 18.07.2023, kishte propozuar që ankesa e paraqitur të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, pasi i kishte shqyrtuar shkresat e lëndës, duke u bazuar në nenin 394 të KPP-së dhe pasi i kishte vlerësuar pretendimet ankimore, kishte gjetur se ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit është e bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke e analizuar aktgjykimin e ankimuar dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare, kishte konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ishte përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.10. dhe paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1. të KPP-së, të pretenduara nga seancë të kolegjit edhe nga mbrojtësja e të akuzuarit dhe të cilat kanë kushtëzuar anulimin e detyrueshëm të aktgjykimin të ankimuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës kishte gjetur se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se në arsyetimin nuk janë paraqitur arsyet e qarta dhe konkrete kur gjykata e shkallës së parë kishte marrë aktgjykim në mungesë me të cilin të akuzuarin e kishte shpallur fajtor për shkak të veprës penale të lartcekur.

Rrjedhimisht, nga arsyetimi i aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se i akuzuari V.Sh., ishte ftuar në mënyrë të rregullt për seancat gjyqësore të datave 22.09.2021 dhe 18.10.2021, por që ftesave nuk i është përgjigjur, ashtu që ndaj të njejtimit më datën 21.11.2021, ishte lëshuar urdhërarrest. Nga njoftimi që është pranuar nga Policia e Kosovës, Stacioni Policor në Viti, ishte konstatuar se lidhur me urdhërarrestin për datën 20.12.2021, është konstatuar se i njejtimit nuk gjendet në shtëpi. Ndërsa, më tutje, si në faqen 3, ishte konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara me nenin 303, paragrafi 4 të KPP-së, pasi që gjykata ka shterrur të gjitha mundësitë për sigurimin e prezencës së të akuzuarit në seancë dhe që lidhur me mbajtjen e gjykimin në mungesë është pajtuar edhe prokurori i shtetit, por që mbrojtësi i të akuzuarit ka kundërshtuar mbajtjen e gjykimin në mungesë, duke konsideruar që nuk janë plotësuar kushtet ligjore, ashtu që gjykata me aktvendim procedural ka vendosur që gjykimi në këtë çështje penale të mbahet në mungesë të të akuzuarit V.Sh.

Gjykata e Apelit e Kosovës, përkritazi me gjykimin në mungesë, kishte rikujtuar se dispozita ligjore e nenit 303 të KPP-së, përcakton si në vijim:

“I akuzuari është i pranishëm në: 1.1. shqyrtimin fillestar, dhe 1.2. shqyrtimin kryesor”.

Gjykata e Apelit e Kosovës kishte vërejtur se me shiqimin e shkresave të lëndës, kishte rezultuar se i akuzuari nuk ishte i pranishëm në shqyrtim gjyqësor, ashtu siç kishte konstatuar për këtë pjesë edhe gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar.

Ndërsa, në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar se “I akuzuari konsiderohet se heq dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor në rrethanat e mëposhtme: 2.1. kur i akuzuari ka qenë i pranishëm në seancë fillestare dhe është informuar për datën e shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në pajtim me nenin 280 dhe 282 të këtij Kodi, apo gjatë ndonjë seance tjetër gjyqësore dhe i akuzuari është njoftuar për detyrimin për të qenë i pranishëm për gjykim dhe se gjykimi mund të vazhdojë nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim”.

Përkitazi me këtë kusht - kërkesë ligjore, Gjykata e Apelit e Kosovës kishte vërejtur se nga procesverbali i shqyrtimit fillestar, të datës 12.05.2021, pra njoftimi i të akuzuari për datën e shqyrtimit gjyqësor dhe paralajmërimin se gjykimi mund të vazhdojë nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet në gjykim, këtë kërkesë ligjore gjykata e shkallës së parë nuk e kishte përmbushur.

Ndërsa, në paragrafin 3 të nenit të lartcekur është parashikuar se: “Në rast se i akuzuari nuk paraqitet në ndonjë rrethanë nga nën-paragrafët 2.1 ose 2.2 të këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse i akuzuari mungon vullnetarisht pas seancës dëgjimore të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni dhe i akuzuari përfaqësohet nga mbrojtësi”.

Gjithashtu, Gjykata e Apelit e Kosovës kishte vërejtur se nga shkresat e lëndës një obligim i tillë ligjor nuk ishte konsumuar nga gjykata e shkallës së parë, për faktin se gjykata nuk ka vepruar konform kërkesave të kësaj dispozite ligjore në atë mënyrë që në një seancë dëgjimore të vlerësojë çdo sqarim apo dëshmi para se të merr vendim për mbajtjen e gjykimit në mungesë, në mënyrë që më pas të shqyrtoj nëse përmbushen edhe ndonjë prej kushteve të parapara sipas paragrafit 5 të këtij neni, e cila dispozitë ligjore përcakton si në vijim: “5.1. vështirësinë e shtyrjes së gjykimit, veçanërisht në gjykimet që përfshijnë shumë të akuzuar; 5.2. barrën mbi prokurorin e shtetit për vijimin e dy gjykimeve që përfshijnë dëshmi të përbashkëta të bashkëpandehurve; dhe 5.3. nëse vonesa do t'i vë dëshmitarët e prokurorisë në rrezik ose vështirësi të konsiderueshme”.

Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës, meqenëse gjykata e shkallës së parë nuk kishte dhënë arsyet përkitazi me këto fakte vendimtare, kishte gjetur se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 10 lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.1. të KPP-së, meqë janë zbatuar gabimisht dispozitat e lartcekura ligjore të KPP-së, por edhe për shkak të moszbatueshmërisë së kërkesave ligjore nga dispozitat përkatëse të gjykimit në mungesë e që si të tilla kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, prandaj, në rrethana të tilla, aktgjykimi i ankimuar detyrimisht ishte anuluar dhe çështja ishte kthyer në rigjykim.

7.24 Komente përmbledhëse

Siç është theksuar edhe më parë, në nenin 303 të KPP-së, janë parashikuar dy (2) variante të gjykimit në mungesë:

- 1) Gjykimi në mungesë në formën standarde dhe
- 2) Gjykimi në mungesë në rastet e veprave penale nga neni 104 i KPRK-së.

Këto dy (2) variante të gjykimit në mungesë dallojnë në mes vete sa i përket kushteve për mbajtjen e gjykimit dhe për praninë e të akuzuarit, procedurës që zhvillohet, veprave penale që janë objekt i aktakuzës dhe të drejtës për të kërkuar rigjykim.

Njëri prej kriterëve vendimtare për të vendosur nëse mund të mbahet gjykimi në mungesë ndërlidhet me faktin nëse “i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor”.

Në këtë mënyrë në paragrafin 2 të nenit 303 të KPP-së janë përcaktuar disa situata përmes të cilat konsiderohet se i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor. Te të gjitha këto situata, ligjdhënësi ka parashikuar se i akuzuari konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor, nëse ka marrë pjesë në seanca të caktuara gjyqësore dhe është njoftuar paraprakisht për detyrimin për të qenë i pranishëm për gjykim, përkatësisht në seancat e ardhshme gjyqësore dhe se gjykimi mund të vazhdojë, nëse i akuzuari vullnetarisht nuk paraqitet për gjykim. Me fjalë të tjera, pjesëmarrja në ndonjë seancë përkatëse gjyqësore dhe njoftimet e lartcekura janë kriterë për të përcaktuar nëse i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor.

Në fund, është e rëndësishme të rikujtohet fakti se gjykimi në mungesë duhet kuptuar si përjashtim dhe në asnjë mënyrë si rregull, meqë gjykimi në prezencë të të akuzuarit, gjithmonë i ka përparësitë e veta në raport me një gjykim në mungesë.

7.25 Mos njoftimi lidhur me seancën e kolegjit në Gjykatën e Apelit të Kosovës

Dispozita ligjore-Neni 390, paragrafi 1 i KPP-së

“Kur të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burgim apo kur ka pretendime që shtrohen për shqyrtim të fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë apo pafajësinë, njoftimi për seancën e kolegjit i dërgohet, Prokurorit të Apelit, të dëmtuarit dhe mbrojtësit të tij apo përfaqësuesit të viktimave, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij”.

7.26 Komentim i shkurtër i dispozitës së lartcekur ligjore

Fillimisht, duhet theksuar se Gjykata e Apelit e Kosovës vendimet në lidhje me ankesat e paraqitura kundër vendimit të gjykatës së themelore në çështjet penale i merr në seancë të kolegjit ose në shqyrtim.

Kështu, në nenin 391, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se “Gjykata e Apelit merr vendim në seancë të kolegjit ose në shqyrtim”. Se a do ta mbahet shqyrtimi në Gjykatën e Apelit të Kosovës apo jo, një të e tillë vendoset në seancën e kolegjit.¹⁵⁰

Në anën tjetër, varësisht nga fakti se a njoftohen palët dhe personat tjerë në lidhje me seancën e kolegjit, seanca e kolegjit mund të mbahet në dy (2) mënyra:

¹⁵⁰ Neni 391, paragrafi 2 i KPP-së.

- 1) Pa njoftimin e palëve ose të personave tjerë ose
- 2) Me njoftimin e palëve dhe personave tjerë të caktuar.

Rasti i parë, përkatësisht mbajtja e seancës së kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës pa njoftimin e palëve ose të personave tjerë mund të vjen në shprehje në rastet kur kjo Gjykatë vendos që t'i hudh si të pasafatshme¹⁵¹ ose të palejuar ankesat e paraqitura.¹⁵² Pra, në raste të tilla, është parashikuar mundësia që Gjykata e Apelit e Kosovës ta mbajë seancën e kolegjit pa i njoftuar palët, nëse ankesat e paraqitura hudhën si të pasafatshme apo të palejuara.¹⁵³

Rasti i dytë, përkatësisht mbajtja e seancës së kolegjit me njoftimin e palëve dhe të personave tjerë të caktuar vjen në shprehje në rastet kur të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burgim apo kur ka pretendime që shtrohen për shqyrtim të fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë apo pafajësinë. Pra, njoftimi për seancën e kolegjit, i palëve dhe personave tjerë të caktuar vjen në shprehje në dy (2) situata:

- 1) Në rastet kur gjykata themelore të akuzuarit i ka shqiptuar dënim me burgim dhe
- 2) Në rastet kur ka pretendime që shtrohen për shqyrtim të fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit.

Në raste të tilla, për seancën e kolegjit duhet të njoftohen prokurori i Prokurorisë së Apelit, i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij apo përfaqësuesi i viktimave, i akuzuari dhe mbrojtësit të tij.¹⁵⁴

Në qoftë se i akuzuari i cili gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit dëshiron të merr pjesë në seancë të kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, atëherë, pjesëmarrja i mundësohet atij.¹⁵⁵

Përndryshe, mosardhja e palëve ose e ankuesve të tjerë të njoftuar me rregull nuk e pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Në raste të tilla, duhet të konstatohet se palët dhe personat apo ankuesit tjerë siç thuhet të jenë “njoftuar me rregull”. Njoftimi në mënyrë të rregullt është një institut juridik që përfshirë një mori të dispozitave ligjore që i referohet dorëzimit të njoftimit palëve dhe personave të tjerë. Këto dispozita ligjore gjenden në KPP (nenet 474-484), por edhe në ligje tjera, p.sh. Ligjin për Procedurën Kontestimore.¹⁵⁶

¹⁵¹ Në nenin 399 të KPP-së është parashikuar se “Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të pasafatshme kur konstaton se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor”. Sipas nenit 380, paragrafi 1 të KPP-së, kundër aktgjykimit të marrë nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Pra, afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit është tridhjetë (30) ditë nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.

¹⁵² Në nenin 400 të KPP-së është parashikuar se “Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankesë ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj”.

¹⁵³ RASIMI, RASIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, Prishtinë, 2023, fq.152.

¹⁵⁴ Neni 390, paragrafi 1 i KPP-së.

¹⁵⁵ Neni 390, paragrafi 2 i KPP-së.

¹⁵⁶ Neni 483 i KPP-së.

Kur i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës ose të vendqëndrimit, seanca e kolegjit mund të mbahet edhe pa njoftimin e të akuzuarit.¹⁵⁷ Megjithatë, një gjë e tillë mund të vjen në shprehje vetëm në rastet kur organet kompetente që e kanë zhvilluar procedurën penale dhe gjykatat themelore e kanë njoftuar paraprakisht të akuzuarit për detyrimin e tij që çdo ndërrim të adresës apo vendqëndrimit ta njoftojnë gjykatën dhe ta kenë njoftuar për pasojat e mos përmbushjes së këtij detyrimi.¹⁵⁸

Kështu, p.sh. në nenin 152, paragrafi 1 të KPP-së parashikuar detyrimi i prokurorit të shtetit që gjatë marrjes së deklaratës në procedurë paraprake ta informon të pandehurin për detyrimin e tij për të njoftuar për çdo ndryshim adrese ose për çdo qëllim ndryshimi të vendqëndrimit.

Madje, në nenin 172, paragrafi 4 të KPP-së është parashikuar se *“Gjatë kohëzgjatjes së procedurës, i pandehuri duhet menjëherë ta njoftojë gjykatën për çdo ndryshim të adresës së tij ose për qëllimin e ndryshimit të vendqëndrimit. I pandehuri njoftohet për këtë detyrim në rastin e marrjes në pyetje për herë të parë ose me rastin e dorëzimit të aktakuzës dhe njëkohësisht paralajmërohet për pasojat e mos përmbushjes së detyrimit siç është paraparë me këtë Kod”*.

Gjithashtu, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet t'i përkujton palët për detyrimet e tyre që, deri në përfundim të procedurës, të njoftojnë gjykatën për çdo ndryshim të adresës.¹⁵⁹

Në fund, duhet theksuar se edhe pas shpalljes së aktgjykimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që t'i përkujton palët për detyrimet e tyre që, deri në përfundim të procedurës, të njoftojnë gjykatën për çdo ndryshim të adresës.¹⁶⁰

Çështja e njoftimit për të marrë pjesë në seancën e kolegjit të një gjykate të apelit është trajtuar gjerësisht edhe nga këndvështrimi i të drejtës për një proces të rregullt, nga neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së.¹⁶¹

Në lidhje me këtë çështje, tani më GjEDNJ-a ka një praktikë të konsoliduar, pasi që në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka trajtuar në hollësi këtë aspekt të së drejtës për një proces të rregullt.

Kështu, GjEDNJ-ja thekson se *“Parimi se seancat duhet të mbahen në publik përfshin të drejtën e të akuzuarit për të dhënë dëshmi personalisht në gjykatën e apelit dhe nga ky këndvështrim, ky parim ndjek synimin për të garantuar të drejtat e mbrojtjes së të akuzuarit”*.¹⁶²

Sipas qëndrimeve të GjEDNJ-së, *“megjithëse, pjesëmarrja fizike e të pandehurit nuk e ka të njëjtën rëndësi vendimtare për një seancë pranë gjykatës së apelit, ashtu siç e ka rëndësinë*

¹⁵⁷ Neni 390, paragrafi 1 i KPP-së.

¹⁵⁸ RASIMI, RASIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.153.

¹⁵⁹ Neni 367, paragrafi 3 i KPP-së.

¹⁶⁰ Neni 367, paragrafi 3 i KPP-së.

¹⁶¹ RASIMI, RASIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.154.

¹⁶² Shih rastin *“Tierce dhe të tjerët kundër San Marinos”*, aktgjykimi i datës 25.07.2000, paragrafi 94; Rasti *“Colozza kundër Italisë”*, aktgjykimi i datës 12.02.1985, paragrafët 27-29, etj.

*pjesëmarrja e tij në një seancë gjyqësore, mënyrë në të cilën zbatohet neni 6 i KEDNj-së, varet nga veçoritë specifike të procedurave përkatëse dhe duhet të merret parasysh edhe tërësia e procedurave në rendin juridik të brendëshëm dhe rolin që ka gjykata e apelit”.*¹⁶³

Gjithashtu, GjEDNj-ka ka sqaruar se “kur gjykata e apelit është kompetente për të modifikuar, përfshirë rritjen e dënimit të shqiptuar nga gjykata e shkallës më të ulët dhe kur procedurat e palët mund të ngrenë çështje që përfshijnë një vlerësim të personalitetit dhe karakterit të të akuzuarit dhe gjendjes së tij shpirtërore në kohën e kryerjes së veprës penale, e cila e në një procedurë të tillë me rëndësi vendimtare për të akuzuarin, atëherë është thelbësore për drejtësinë procedurale që të akuzuarit t’i mundësohet të jetë i pranishëm në seancë dhe t’i jepet mundësia për të marrë pjesë në të”.

7.27 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos njoftimin për seancën e kolegjit në Gjykatën e Apelit të Kosovës

Çështja e mos njoftimit në lidhje me seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kështu, në vijim do të paraqiten disa raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë pikërisht kjo çështje.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.76/2024, i datës 26.02.2024

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit M. G., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1142/2023, i datës 14.12.2023 dhe kjo çështje penale i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.456/2023, të datës 11.07.2023, i dënuari M. G., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Kanosja” nga neni 181, paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa konform neni 79 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar, të dënuarit do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20.05.2023. E dëmtuara A. Q., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Është detyruar i dënuari M. G., që të paguan taksën për kompensimin e viktimave të krimit në shumë

¹⁶³ Rasti “*Hermi kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 18.10.2006, paragrafi 60; Rasti “*Ekbatani kundër Suedisë*”, aktgjykimi i datës 26.05.1988, paragrafi 30, etj.

¹⁶⁴ Rasti “*Lacadena Calero kundër Spanjës*”, aktgjykimi i datës 22.02.2012, paragrafi 38; Rasti “*Dondarini kundër San Marinos*”, aktgjykimi i datës 06.10.2004, paragrafi 27, etj.

prej njëzet (20) euro dhe paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1142/2023, e datës 14.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësja e të dënuarit M. G., avokatja Shqipe Ramushi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke propozuar që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe çështja t'i kthehet kësaj gjykate në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.44/2024, e datës 07.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit M. G., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi shqyrtojë shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoi se:

- kërkesa është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë pretendimin e mbrojtëses së të dënuarit M. G., konstatoi se aktgjykimin i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 390, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës, shihet se seanca e kolegjit në gjykatën e shkallës së dytë është mbajtur më datën 14.12.2023, ndërsa në këtë seancë nuk ka marrë pjesë i dënuari M. G., edhe pse nga shkresa e lëndës shihet se ndaj tij me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë është vazhduar paraburgimi derisa sa aktgjykimin të bëhet i formës së prerë.

Në këtë rast, nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë që gjykata e shkallës së dytë të ketë bërë përpjekje për ta siguruar prezencën e të dënuarit M. G. në seancë të kolegjit, edhe pse gjykata në fjalë lehtësisht ka mundur ta vëren se i dënuari gjenden nën masën e paraburgimit.

Në këtë mënyrë, rezultojnë që i dënuari M. G., nuk është njoftuar në mënyrë të rregullt për seancën e kolegjit që është mbajtur në gjykatën e shkallës së dytë më datën 14.12.2023, ndërsa duke marrë për bazë faktin se ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim me burgim, atëherë bazuar në nenin 390, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, është dashur që i njëjti të njoftohet në mënyrë të rregullt për seancën e kolegjit, duke e pasur parasysh se ndaj të dënuarit ishte vazhduar paraburgimi me aktvendim të gjykatës së shkallës së parë.

Përndryshe, mos njoftimi i palëve për seancën e kolegjit, përveç që përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuar më lart, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paraqet edhe shkelje të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për raste të tilla, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kl.nr.104/2016 të datës 29.05.2017, është konstatuar se (bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut), garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafët 1 dhe 3. të Konventës, vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. E drejta për mbrojtje, sipas dispozitës së lartcekur të Konventës, përfshin të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, si dhe të drejtën e të akuzuarit që të jetë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë. Duke mos ia mundësuar të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me akuzën penale kundër tij, sipas konkludimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në anën tjetër, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në disa raste nga jurisprudenca e saj e ka trajtuar në hollësi çështjen e njoftimit të të akuzuarit për pjesëmarrje në seancë pranë gjykatës së apelit, duke e konsideruar këtë aspekt si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt, nga neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (çështja “*Tierce dhe të tjerët kundër San Marinos*”, aktgjykimi i datës 25.07.2000; çështja “*Hermi kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 18.10.2006; çështja “*Ekbatani kundër Suedisë*”, aktgjykimi i datës 26.05.1988, etj.).

Në këtë mënyrë, bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj edhe si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit M. G., ndërsa e anuloi këtë aktgjykim, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Shkelja esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilën është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është e asaj natyre që nuk ka mundur që të evitohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që e njëjta ka qenë arsye që ka imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në këtë gjykatë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet që ta evitoj shkeljen e cekur më lartë, duke i njoftuar me rregull palët dhe avokaten mbrojtëse për datën dhe orën e mbajtjes së seancës së kolegjit dhe më pastaj, të shqyrtoj pretendimet në kuadër të ankesës së paraqitur dhe të merr një vendim meritor.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.476/2023, i datës 09.10.2023

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës të mbrojtësit të të dënuarit A.L. për mbrojtje të ligjshmërisë, anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.340/2023, i datës 18.05.2023 dhe kjo çështje penale i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - dega në Kaçanik, P.nr.360/2021, të datës 18.01.2023, i dënuari A.L., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370, paragrafi 8 lidhur me paragrafët 6 e 1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Të dënuarit i është ndaluar drejtimi i automjetit i të gjitha kategorive, është detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shumën prej njëqindeshtatëdhjetë (170) euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej njëqindpesëdhjetë (150) euro, dhe shumën prej njëzet (20) euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëzet (20) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.340/2023 e datës 18.05.2023, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit A.L., avokati Hasan Jashari nga Prishtina, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), që shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të anulojë aktgjykimet e lartcekura dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosije, ose aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshojë, ndërsa të dënuarit t'i shqiptoi një sanksion më të ultë.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.286/2023, e datës 19.09.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A.L., av. Hasan Jashari, të aprovet si e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit pasi shqyrtojë shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi vlerësojë pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë pretendimin e mbrojtësit të të dënuarit A.L., ndërsa pa i vlerësuar pretendimet tjera, konstatojë se aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 390, paragrafi 1 të KPP-së.

Nga shkresat e lëndës, shihet se seanca e kolegjit në gjykatën e shkallës së dytë është mbajtur më datën 18.05.2023, mirëpo, i dënuari A.L., njoftimin e ka pranuar më datën 28.05.2023. Një gjë e tillë vërtetohet nga "Urdhëresa" për caktimin e seancës së kolegjit dhe nga "Njoftimi" që i është dërguar palëve dhe avokatit në fjalë, ku shihet se seanca e kolegjit është caktuar për datën 18.05.2023.

Në këtë mënyrë, rezulton që palët nuk janë njoftuar për seancën e kolegjit që është mbajtur në gjykatën e shkallës së dytë më datën 18.05.2023, ndërsa duke e pasur parasysh, se ndaj të dënuarve janë shqiptuar dënime me burgim, atëherë duke u bazuar në nenin 390, paragrafi 1 të KPP-së, është dashur që palët dhe avokati mbrojtës të njoftohen për seancën e kolegjit.

Mos njoftimi i palëve dhe avokatit mbrojtës për seancën e kolegjit, përveç që përbën shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale të theksuar më lart, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paraqet edhe shkelje të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për raste të tilla, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, K1.nr.104/2016 të datës 29 maj 2017, është konstatuar se (bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut), garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafët 1 e 3. të Konventës, vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. E drejta për mbrojtje, sipas dispozitës së lartcekur të Konventës, përfshin të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, si dhe të drejtën e të akuzuarit që të jetë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë. Duke mos ia mundur të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me akuzën penale kundër tij, sipas konkludimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në këtë mënyrë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj, edhe si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit A.L., ndërsa e anuloi këtë aktgjykim, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Shkelja esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilën është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është e asaj natyre që nuk ka mundur që të evitohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që e njëjta ka qenë arsye që ka imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në këtë gjykatë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet që t'i evitoj shkeljet e cekura më lartë, duke i njoftuar me rregull palët dhe avokatin mbrojtës për datën dhe orën e mbajtjes së seancës së kolegjit dhe më pastaj, të shqyrtoj pretendimet në kuadër të ankesave të paraqitura dhe të merr një vendim meritore.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.85/2024, i datës 28.02.2024

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit J. Sh., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1167/2023, i datës 04.12.2023 dhe kjo çështje penale i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, dega në Kamenicë, P.nr.239/2022, të datës 31.07.2023, i dënuari J. Sh., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “*Mashtrimi*” nga neni 335, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej tre (300) euro, të cilën dënim do ta paguan në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në të kundërtën, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që njëzet (20) euro të dënimit me gjobë do të llogariten me një (1) ditë të dënimit burgim.

Gjithashtu, ndaj të dënuarit J. Sh., është shqiptuar edhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit, konform nenit 44 të KPRK-së, është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej tetëqind (800) euro, të cilën dënim do ta paguan në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në të kundërtën, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që njëzet (20) euro të dënimit me gjobë do të llogariten me një (1) ditë të dënimit me burgim. E dëmtuara A. I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Është detyruar i dënuari J. Sh., që të paguan paushallin gjyqësor në shumë prej njëzet (20) euro dhe taksën për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1167/2023, e datës 04.12.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjiilan dhe ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- i dënuari J. Sh., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke propozuar që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe çështja t’i kthehet kësaj gjykate në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.51/2024, e datës 14.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit J. Sh., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi shqyrtojë shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoi se:

- kërkesa është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimin e të dënuarit J. Sh., konstatoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 390, paragrafin 1 të KPP-së. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës, shihet

se seanca e kolegjit e gjykatës së shkallës së dytë e datës 04.12.2023, është mbajtur pa i njoftuar paraprakisht palët dhe përfaqësuesit e tyre për këtë seancë.

Në këtë rast, nga shkresat e lëndës nuk rezulton që gjykata e shkallës së dytë t'i ketë njoftuar për seancën e kolegjit palët dhe mbrojtësin e të dënuarit, edhe pse ka qenë e detyruar që ta bëjë një gjë të tillë, për faktin se mbrojtësi i të dënuarit J. Sh., avokati Refik Basha, në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka ngritur edhe pretendime për shqyrtim të fakteve dhe ligjit që ndërlidhen me aspektet e pafajësisë së të dënuarit. Andaj, edhe bazuar në nenin 390, paragrafi 1 të KPP-së, gjykata e shkallës së dytë është dashur që t'i njoftojë palët dhe përfaqësuesit e tyre për seancën e kolegjit, pasi që në këtë rast, kemi të bëjmë me pretendime që shtrohen për shqyrtim të fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me pafajësinë e të dënuarit.

Përndryshe, mos njoftimi i palëve për seancën e kolegjit, përveç që përbën shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale të theksuar më lart, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paraqet edhe shkelje të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për raste të tilla, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kl.nr.104/2016 të datës 29.05.2017, është konstatuar se garantitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafët 1 dhe 3. të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. E drejta për mbrojtje, sipas dispozitës së lartcekur të Konventës, përfshin të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, si dhe të drejtën e të akuzuarit që të jetë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë. Duke mos ia mundur të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me akuzën penale kundër tij, sipas konkludimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në anën tjetër, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në disa raste nga jurisprudenca e saj e ka trajtuar në hollësi çështjen e njoftimit të të akuzuarit për pjesëmarrje në seancë pranë gjykatës së apelit, duke e konsideruar këtë aspekt si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt, nga neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (çështja "*Tierce dhe të tjerët kundër San Marinos*", aktgjykimi i datës 25.07.2000; çështja "*Hermit kundër Italisë*", aktgjykimi i datës 18.10.2006; çështja "*Ekbatani kundër Suedisë*", aktgjykimi i datës 26.05.1988, etj.).

Në këtë mënyrë, bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj edhe si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të të dënuarit J. Sh., ndërsa e anuloi këtë aktgjykim, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Shkelja esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilën është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është e asaj natyre që nuk ka mundur që të evitohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që e njëjta ka qenë arsye që ka imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në këtë gjykatë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet që ta evitoj shkeljen e cekur më lartë, duke i njoftuar paraprakisht palët dhe përfaqësuesit e palëve për datën dhe orën e mbajtjes së seancës së kolegjit, ndërsa më pastaj, të shqyrtoj pretendimet në kuadër të ankesave të paraqitura dhe të merr një vendim merititor.

7.28 Komente përmbledhëse

Në çështjet e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke i kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë, ndërsa arsye për kthimin e çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë kishte qenë fakti se të pandehurit dhe/ose mbrojtësit e tyre nuk ishin ftuar fare për seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës shihet se mos njoftimi për seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në raste të caktuara, përveç që përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe shkelje të drejtës në gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të KEDNj-së.

Për raste të tilla, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kl.nr.104/2016 datë 29 maj 2017, është konstatuar se bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, garantitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafët 1 e 3 të KEDNj-së, vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. E drejta për mbrojtje, sipas dispozitës së lartcekur të Konventës, përfshin të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, si dhe të drejtën e të akuzuarit që të jetë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë. Duke mos ia mundësuar të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me akuzën penale kundër tij, sipas konkludimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me KEDNj.

7.29 Mos dërgimi i kopjes së ankesës palëve të tjera për të paraqitur përgjigje në ankesë

Dispozitat ligjore-Neni 388, paragrafët 1, 3 dhe 4 të KPP-së

“Ankesa kundër aktgjykimit paraqitet në gjykatën e cila ka nxjerr aktgjykimin”.

“Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës. Sapo të marrë përgjigjen, gjykata do të vazhdojë në pajtim me nenin 377, paragrafin 3 këtij Kodi”.

“Kjo gjykatë i përcjell ankesën, përgjigjën dhe shkresat tjera përkatëse në gjykatën që është kompetente për shqyrtimin e ankesës”.

7.30 Komentim i shkurtër i dispozitave të lartcekura ligjore

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore, përkatësisht në nenin 388, paragrafi 1 të KPP-së, nëse palët dhe personat tjerë të autorizuar vendosin që të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit, atëherë duhet që ankesa të paraqitet apo të dorëzohet në gjykatën e cila e ka nxjerr aktgjykimit ndaj të cilit paraqitet ankesa.

Fillimisht është e rëndësishme që të theksohet se njëri ndër parimet kryesore të procedurës penale është padyshim parimi kontradiktor, i cili shprehet përmes premisë *“audiatur et altera pars”*, sipas së cilit gjykata në çështjet penale ka për detyrë që gjatë zhvillimit të procedurës penale, para se të marrë vendim lidhur me çështje të caktuara, çdo herë të dëgjojë edhe palën tjetër.¹⁶⁵

Në procedurën sipas ankesës, ky parim i procedurës penale realizohet në atë mënyrë që gjykata e shkallës së parë para se t’ia dërgojë ankesën gjykatës së shkallës së dytë, duhet që një kopje të ankesës t’ia dërgoj edhe palës tjetër, e cila në afat prej tetë (8) ditëve ka të drejtë që të paraqesë përgjigje në ankesë.

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka, ky parim i procedurës penale është trajtuar dhe nga GjEDNJ-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore, me ç’rast edhe mos respektimi i këtij parimi, në situata të caktuara është konsideruar edhe shkelje e nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, përkatësisht të drejtës për një proces të rregullt.¹⁶⁶

Përndryshe, siç është theksuar edhe më lart, në nenin 388, paragrafi 3 të KPP-së është parashikuar se *“Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës”*.¹⁶⁷

Me dërgimin e ankesës palës tjetër, kjo e fundit njoftohet me pretendimet e paraqitura në ankesë dhe ka të drejtë që të paraqesë përgjigje në ankesë, duke paraqitur kundër argumente, me qëllim të përfaqësimit sa më të drejtë të të drejtave dhe interesave në procedurë penale.¹⁶⁸

Përveç që është detyrim për gjykatën për t’ia dorëzuar ankesën palës tjetër, kjo njëkohësisht është edhe e drejtë e palëve tjera, e cila e drejtë është e ndërlidhur edhe me të drejtën e saj për të paraqitur përgjigje në ankesë.

¹⁶⁵ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, fq. 93; SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 164.

¹⁶⁶ GjEDNJ-ja në rastin *“Brandstetter kundër Austrisë”*, aktgjykimi i datës 28.08.1991, paragrafet 67-69, kishte theksuar se *“E drejta për një gjykim kontradiktor do të thotë, në një çështje penale, që si prokurorisë, ashtu edhe mbrojtjes duhet t’i jepet mundësia të kenë njohuri dhe komente mbi dosjet dhe provat e paraqitura nga pala tjetër. Janë të mundshme mënyra të ndryshme në të cilat ligji kombëtar mund të sigurojë që kjo kërkesë është përmbushur. Megjithatë, cilado metodë të zgjidhet, ajo duhet të sigurojë që pala tjetër do të jetë e vetëdijshme për pretendimet që janë paraqitur dhe do të ketë një mundësi reale për të komentuar mbi to. Në rastin konkret, asnjë kopje e parashtrësive të Prokurorit të Lartë Publik nuk i është dërguar parashtruesit dhe se ai nuk ishte i informuar as për paraqitjen e tyre”*.

¹⁶⁷ Në nenin 423 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, përgjigja në ankesë emërtohet *“Apel kundërshtues”*. Në paragrafin 1 të këtij nenit është parashikuar se *“Pala që nuk ka bërë ankim brenda afatit mund të bëjë apel kundërshtues brenda pesë ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për apelin e palës tjetër”*.

¹⁶⁸ RASIMI, RASIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë*, *“Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”*, fq.163.

Përndryshe, dështimi për ta përbushur këtë detyrim (“mos dorëzimi i ankesës palëve tjera”) përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafi 2, nënparagrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenin 388, paragrafi 3 të KPP-së, pasi që një shkelje e tillë ndikon ose mund të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.¹⁶⁹

Paraqitja e përgjigjes në ankesë nuk është detyrim për palët tjetra, por kjo është vetëm një mundësi që të deklarohen lidhur me pretendimet që janë paraqitur në ankesë.¹⁷⁰ Një gjë e tillë mund të vërtetohet edhe nga vetë përmbajtja e dispozitës ligjore të nenit 388, paragrafi 3 të KPP-së është parashikuar se “Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda ...”.

E drejta e paraqitjes së përgjigjes në ankesë i takon vetëm palëve tjera. Për dallim nga Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale, i cili në nenin 388, paragrafin 2 kishte përcaktuar se një kopje e ankesës është dashur që t’i dërgohet “palëve kundërshtare”, të cilët edhe kanë pasur të drejtë që të paraqesin përgjigje në ankesë, tani sipas dispozitave ligjore të KPP-së, një kopje e ankesës duhet që t’i dërgohet “palëve tjera” të cilat kanë të drejtë që të paraqesin përgjigje në ankesë. Andaj, sipas kësaj zgjidhje ligjore që është akceptuar në KPP, nga një kopje e ankesës duhet që t’i dërgohet palëve tjera, e jo vetëm palëve kundërshtare, siç ka qenë e parashikuar me Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale.

Përgjigja në ankesë duhet të dërgohet në gjykatën themelore e cila e ka marrë aktgjykimin brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës. E drejta e dhënies së përgjigjes në ankesë ekziston pavarësisht faktit se në çfarë shtetshkëqish është bazuar ankesa. Paraqitja e përgjigjes në ankesë i jep mundësi Gjykatës së Apelit që vendimmarrjen e saj lidhur me ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta bëjë në mënyrë sa më objektive.¹⁷¹

Afati për paraqitjen e përgjigjes në ankesë është tetë (8) ditë dhe fillon të llogaritet nga dita e nesërme pas pranimit të ankesës.¹⁷²

¹⁶⁹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.44, të datës 18.07.2000, ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.239, të datës 23.06.1999, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është lënë në fuqi një vendim i Gjykatës së Apelit në Durrës. Gjykata Kushtetuese, kishte vendosur që të shfuqizojë vendimin dhe dërgimin e çështjes në rishqyrtim me këtë arsytim: Nga materialet e dosjes rezultoi se nuk ka asnjë dokument apo veprim që të vërtetojë se të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, t’i jetë komunikuar rekursi i ushtruar nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit në Durrës. Në këtë mënyrë është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 414 të KPP-së në të cilën shprehet se “*Akti i ankimit u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që e ka dhënë vendimin*”. Duke mos u përbushur ky detyrim ligjor, të pandehurit nuk i është dhënë mundësia që të dijë se çështja e tij do të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë dhe njëkohësisht të dëgjohet e të mbrohet rreth parashtrimeve të bëra nga prokurori në rekursin e tij. Mohimi të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur përbën shkelje me karakter kushtetues, të cilat e bëjnë procesin jo të rregullt, në kuptim të nenit 42, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Cituar sipas: LUARASI, ALEKS: Kodi i procedurës penale me praktikë gjyqësore, Tiranë, 2002, fq. 243-245.

¹⁷⁰ SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 165.

¹⁷¹ HAJDARI, AZEM : Komentar i Kodit të Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, fq. 944.

¹⁷² Në nenin 445, paragrafi 2 të KPP-së është parashikuar se “*Ora ose dita kur është bërë dorëzimi, njoftimi apo kur ka ndodhur ngjarja që konsiderohet si fillim i afatit nuk llogaritet në afat, por për fillim të afatit merret ora apo dita e parë vijuese*”.

Ankesa kundër aktgjykimi i dërgohet palëve tjera për përgjigje, vetëm pasi gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të konstatojë se ankesa është e afatshme dhe e lejuar.

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues konstaton se ankesa është e paafatshme ose palejuar, atëherë e hedh me aktvendim dhe fare nuk i dërgohet palëve tjera.

Në nenin 388, paragrafi 2 të KPP-së është parashikuar se “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës së shkallës së parë e hedh ankesën me aktvendim:

2.1. Si të paafatshme kur konstatohet se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor; ose

2.2. Si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj”.

Me dispozitat ligjore të KPP-së nuk është rregulluar në mënyrë shprehimore përmbajtja e përgjigjes në ankesë. Megjithatë, meqë përgjigja në ankesë është lloj i parashtresës në procedurë penale, atëherë edhe gjithçka që duhet të ketë çdo parashtresë, duhet të ketë edhe përgjigja në ankesë.¹⁷³

Në radhë të parë, përgjigja në ankesë duhet të përmbajë argumente me të cilat hedhen poshtë pretendimet e ankuesit të cilat i ka paraqitur në ankesë.¹⁷⁴

Duke qenë se përgjigja në ankesë i mundëson palëve tjera që të deklarohen lidhur me ankesën, përmbajtja e përgjigjes në ankesë sillet parimisht në kufijtë e pretendimeve ankimore, me qëllim që ato të kontestohen, mbështeten ose tregohen më ndryshe nga ato të paraqitura në ankesë. Për këtë arsye, në procedurën lidhur me ankesën vendohet lidhur me ankesën dhe jo lidhur me përgjigjen në ankesë.¹⁷⁵

Nëse palët tjera kanë paraqitur përgjigje në ankesë, atëherë gjykata themelore duhet që nga një (1) kopje të përgjigjes në ankesë t’ia dërgojë ankuesit. Në nenin 388, paragrafi 3, fjalia e dytë e KPP-së është parashikuar se “Sapo të marrë përgjigjen, gjykata do të vazhdojë në pajtim me nenin 377, paragrafin 3 këtij Kodi”, kurse në nenin 377, paragrafi 3 të KPP-së është parashikuar se “Përgjigja paraqitet në gjykatë themelore, e cila ia dërgon përgjigjen palës tjetër”. Kjo tani konsiderohet risi në KPP, pasi që me Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale nuk ka qenë e nevojshme dhe as që ka qenë detyrë e gjykatës themelore që kopjen e përgjigjes në ankesë t’ia dërgojë ankuesit.

Pasi të jetë paraqitur përgjigja në ankesë ose pasi të kalojë afati për përgjigje (nëse nuk është paraqitur përgjigje në ankesë), gjykata themelore duhet që t’ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë, përkatësisht Gjykatës së Apelit të Kosovës për vendosje ankesën, përgjigjen në ankesë (nëse ka) dhe shkresat tjera. Një gjë e tillë është parashikuar në nenin 388, paragrafi 4 të KPP-së, sipas së cilës “Kjo gjykatë i përcjell ankesën, përgjigjen dhe shkresat tjera përkatëse në gjykatën që është kompetente për shqyrtimin e ankesës”.

¹⁷³ RASIMI, RASIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.164.

¹⁷⁴ SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 168.

¹⁷⁵ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, fq. 920.

7.31 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos dërgimit të kopjes së ankesës palëve të tjera për të paraqitur përgjigje në ankesë

Çështja e mos dërgimit të kopjes së ankesës palëve tjera ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kështu, në vijim do të paraqiten disa raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë pikërisht kjo çështje.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.261/2024, i datës 15.05.2024

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit A.A., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.695/2023 të datës 30.01.2024, sa i përket veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe çështja penale i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin nr.2022:216914 të datës 06.10.2023 (pika I. e dispozitivit), të dënuarit A.A., e ka shpallur fajtor për shkak veprës penale “Mundësimi ose detyrimi në prostitucion”, nga neni 234, paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa në dënimin e shqiptuar do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20.10.2022 deri më datën 17.07.2023, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 17.07.2023 deri më datën 11.09.2023. Gjithashtu, ndaj të dënuarit A.A. është shqiptuar edhe dënim me gjobë në shumë prej njëmijë (1.000) euro, të cilin dënim i dënuari është detyruar që të paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse dënimin nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara me nenin 43, paragrafi 3 të KPRK-së, atëherë dënimin me gjobë do të ekzekutohet në atë mënyrë që i dënuari për çdo njëzetë (20) euro të papaguar, do ta mban nga një (1) ditë burgim.

Është detyruar i dënuari A.A., që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Ndërsa, duke u bazuar në nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë (pika II. e dispozitivit), i dënuari A.A., është liruar nga akuza për shkak të veprës penale “Dhunimi”, nga neni 227, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.1. të KPRK-së dhe veprës penale “Shantazhi”, nga neni 329, paragrafi 1 të KPRK-së.

E dëmtuara A.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil, kurse shpenzimet e procedurës sa i përket këtyre dy veprave penale do të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.695/2023 e datës 30.01.2024 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndërsa e ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket veprave penale për të cilat i dënuari A.A. është liruar nga akuza dhe sa i përket këtyre veprave penale, çështja penale është kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjithashtu, me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit të Kosovës është aprovuar si e bazuar ankesa e të dëmtuarës A.S., ndërsa është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket dënimit të shqiptuar me burgim, ashtu ndaj të dënuarit Arlind Axhami, për shkak të veprës penale “Mundësimi ose detyrimi në prostitucion”, nga neni 234, paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së për të cilën është shpallur fajtor është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve, kurse pjesa tjetër e aktgjykimit lidhur me dënimin me gjobë për këtë veprë penale ka mbetur e pandryshuar.

Ndërsa, është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të dënuarit A.A., përkitazi me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Kundër këtyre aktgjytimeve, përkitazi me pjesën dënuese, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari A.A., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t’i anulon aktgjykimet e lartcekura, duke e kthyer çështjen në rigjykim apo këto aktgjytime të ndryshohen, duke e liruar të dënuarin nga akuza.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.nr.146/2024 e datës 02.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit A.A., të aprovet si e bazuar, duke konsideruar se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që mbrojtjes nuk i është dorëzuar një kopje e ankesës së të dëmtuarës A.S., në mënyrë që t’ju ipet mundësia e paraqitjes së përgjigjes në ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe në përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesë, pretendimi i të dënuarit për mos dërgimin e ankesës së palës së dëmtuar është i bazuar, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, kundër të cilit është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është marrë pa informimin e të mbrojtjes lidhur me pretendimet e parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në dispozitën e nenit 388, paragrafi 3 të KPP-së, lidhur me procedurën për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda 8 (tetë) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës.

Sapo të marrë përgjigjen, gjykata do të vazhdojë në pajtim me nenin 377, paragrafi 3 të këtij Kodi.

Siç rezulton nga shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë, me rastin e pranimit të ankesës së palës së dëmtuar, nga një kopje të kësaj anekse nuk ja ka dërguar mbrojtjes, ndërsa seanca e kolegjit pranë gjykatës së shkallës së dytë, në të cilën janë shqyrtuar ankesat e paraqitura kundër aktgjykimit të shkallës së parë, është mbajtur pa ju dhënë mbrojtjes mundësia e paraqitjes së përgjigjes në ankesë, e që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që ka për pasojë edhe anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë vetëm sa i përket pikave II. dhe III. të dispozitivit, që ndërlidhen me veprën penale për të cilën i dënuari A.A. është shpallur fajtor.

Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se njoftimi i mbrojtjes përkitazi me ankesat nënkupton mundësinë për tu informuar me përmbajtjen e tyre, përkatësisht me këtë mundësohet që i dënuari dhe mbrojtësi i tij të kenë mundësi të njafueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe mundësinë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me ankesat. Andaj, edhe rrjedhimisht, në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2. të KPP-së lidhur me nenin 388, paragrafi 3 të KPP-së, të cilat shkelje kanë ndikuar në të drejtat e të mbrojtjes të garantuara sipas dispozitave të KPP-së dhe të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 6 (“E drejta për një proces të rregullt”) të Konventës për të Drejtat e Njeriut.

Nga arsyet e cekura më lartë del se aktgjykimi i shkallës së dytë (pikat II. dhe III. të dispozitivit) që ndërlidhet me veprën penale për të cilën i dënuari A.A. është shpallur fajtor është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat aktgjykimin në fjalë si të tillë e bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm, për çka ka qenë nevoja që i njëjti të anulohet në këtë pjesë dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim në pajtim me nenin 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 2. të KPP-së.

Gjykata e shkallës së dytë, me rastin e rigjykimit duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e sipër cekura dhe pas evitimit të shkeljeve, të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm, duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve që dalin nga ankesat e paraqitura nga pala e dëmtuar dhe nga mbrojtësi i të dënuarit.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.372/2023, i datës 06.09.2023

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit A.G., aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1053/2022 të datës 12.06.2023 anulohet dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.1428/22 të datës 30.06.2022, të dënuarin A.G., e ka shpallur fajtor për shkak veprës penale

“Sulm ndaj personit zyrtar gjatë detyrës zyrtare”, nga neni 402, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim konform neni 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të dënuarit dhe mbrojtësit të tij, zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2,000) Euro, të cilin dënim do ta paguaj në katër (4) këste mujore, më së largu deri më datën 5 të muajit vijues, ndërsa mundësia e pagesës me këste revokohet, nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet, atëherë do të zëvendësohet me dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë do të caktohet nga një (1) ditë burgim.

Në dënimin e shqiptuar me gjobë do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 10.05.2022 deri më datën 09.06.2022, ashtu që një (1) ditë e kaluar në paraburgim do t'i barazohet me njëzet (20) Euro të gjobës.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA.1.nr.1053/2022 të datës 12.06.2023, e ka aprovuar pjesërisht ankesën e prokurorisë dhe ka ndryshuar aktgjykimin P.nr.1428/22 të datës 30.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që për veprën penale “Sulm ndaj personit zyrtar gjatë detyrës zyrtare”, nga neni 402, paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së, gjykata e dënon me dënim me gjobë në shumë prej 5,000 (pesë mijë) Euro, të cilën shumë i dënuari duhet ta paguaj në afat prej tre (3) muajve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, në të cilin do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.05.2022 deri më datën 09.06.2022, ndërsa pjesët tjera të aktgjykimit mbeten të pa ndryshuara. Me të njëjtin aktgjykim është hedhur si e palejuar ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarës H.L..

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit A.G., avokat Hajzer Salihu, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe për shkak të lartësisë së sanksionit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe ta lë në fuqi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.225/2023 e datës 31.07.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të neni 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesë, pretendimi i mbrojtësit të dënuarit për mos dërgimin e ankesave të prokurorit dhe të palës së dëmtuar tek i dënuari është i bazuar, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, kundër të cilit është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është marrë pa informimin e të dënuarit lidhur me ankesat.

Bazuar në dispozitën e neni 388, paragrafi 3 të KPP-së, lidhur me procedurën për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë i dërgon një kopje të ankesës palëve të

tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda 8 (tetë) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës. Sapo të marrë përgjigjen, gjykata do të vazhdojë në pajtim me nenin 377, paragrafi 3 të këtij Kodi.

Siç rezulton në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë, me rastin e pranimit të ankesave nga prokurori dhe pala e dëmtuar, nga një kopje të këtyre ankesave nuk i ka dërguar tek palët tjera, ndërsa kolegji penal i gjykatës së shkallës së dytë, në të cilën janë shqyrtuar ankesat e ushtruara kundër aktgjykimit të shkallës së parë, është mbajtur pa përgjigjen e palëve, gjegjësisht të dënuarit dhe mbrojtësit të tij, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për pasojë duhet të ketë anulimin e tij.

Njoftimi i të dënuarit përkritazi me ankesat nënkupton mundësinë për tu informuar me përbajtjen e tyre, përkatësisht me këtë mundësohet që i dënuari të ketë mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe mundësinë të paraqes pretendimet e tij lidhur me ankesat. Ashtu që rrjedhimisht, në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.2. të KPP-së dhe të cilat shkelje kanë ndikuar në të drejtat e të dënuarit të garantuara sipas dispozitave të KPP-së dhe të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me neni 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (e drejta për një gjykim të drejtë) të KEDNJ-së.

Nga arsyet e cekura më lartë del se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat aktgjykimin e shkallës së dytë si të tillë e bëjnë të paqëndrueshëm, të mangët për çka ka qenë nevoja që i njëjti të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rivendosije në pajtim me nenin 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 të KPP-së.

Gjykata e shkallës së dytë, me rastin e rivendosijes duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e sipër cekura dhe pas evitimit të shkeljeve, të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm, duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve që dalin nga ankesat.

7.32 Komente përmbledhëse

Siç shihet, në çështjet e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke i kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë, përkatësisht në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa arsye për kthimin e çështjeve penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë kishte qenë fakti se palëve tjera nuk i është dërguar ankesa për të pasur mundësi mandej që të paraqesin përgjigje në ankesë.

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës shihet se mos dërgimi i ankesës palëve tjera, përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenin 388, paragrafi 3 të KPP-së, pasi që një shkelje e tillë ndikon ose mund të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Përveç që përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, mos dërgimi i ankesës palëve tjera, ka për pasojë edhe me shkeljen e parimit kontradiktor, si njëri prej parimeve kryesore të procedurës penale, si dhe shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së dhe me një mori vendimesh të GjEDNJ-së.

7.33 Mos vendosja në lidhje me të gjitha ankesat e paraqitura

Dispozita ligjore- Neni 398, paragrafi 3 i KPP-së

“Gjykata e Apelit vendos për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim”.

7.34 Komentim i shkurtër i dispozitës së lartcekur ligjore

Shpeshherë në praktikën tonë gjyqësore kemi pasur raste kur janë paraqitur disa ankesa ndaj aktgjykimit apo aktvendimit njëjtë të gjykatës themelore. Në situata të tilla, Gjykata e Apelit të Kosovës është duhet që t'i shqyrtojë dhe të vendos për të gjitha ankesat e paraqitura kundër aktgjykimit apo aktvendimit të njëjtë. Për të gjitha këto ankesa, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vendos me një vendim dhe një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në nenin 398, paragrafi 3 të KPP-së.¹⁷⁶

Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Gjykata e Apelit vendos për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim”.

Varësisht nga mënyra e vendosjes dhe rrethanat specifike të rastit, në lidhje me ankesat e paraqitura, Gjykata e Apelit e Kosovës vendos me aktgjykim ose me aktvendim. Në nenin 398 deri 403 të KPP-së janë parashikuar situatat se kur Gjykata e Apelit e Kosovës vendos me aktgjykim dhe kur vendos me aktvendim.

Siç është theksuar edhe më lart, e rëndësishme është që për të gjitha ankesat e paraqitura ndaj një aktgjykimi, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vendos me një vendim.

Një mënyrë e tillë e vendosjes me një vendim për të gjitha ankesat e paraqitura kundër të njëjtit aktgjykim apo aktvendim është në funksion të sigurisë juridike, vendosjes së unike të rastit, si dhe të trajtimit të barabartë të të gjitha palëve.

Bazuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastet kur për disa ankesa është dashur që të vendoset me aktvendim (p.sh. nëse ankesat janë paafatshme ose të palejuara, etj.), kurse për disa ankesa tjera është dashur që të vendoset me aktgjykim (p.sh. nëse ankesat janë të pabazuara), atëherë për të gjitha këto ankesa, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet të vendoset me një aktgjykim, si një vendim i vetëm.

7.35 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos vendosjes së të gjitha ankesave me një vendim

Çështja e mos vendosjes së të gjitha ankesave me një vendim nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.

¹⁷⁶ RASIMI, RASIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.148.

Kështu, në vijim do të paraqitet një (1) rast nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë pikërisht kjo çështje.

Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.401/2022, i datës 10.11.2022

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit H.K., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr. 195/2024 të datës 22.04.2024 dhe çështja i kthehet gjykatës së njëjtë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.720/2023 e datës 22.12.2023, të dënuarin H.K. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 140 (njëqindekatërdhjetë) ditëve dhe i cili dënim me pëlqimin e tij i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 2500 (dymijepesëqind) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 200 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale, shumë prej 30 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumë prej 50 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, kurse të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.195/2024 e datës 22.04.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit H.K., avokati Prek Kola nga Gjakova, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.210/2024 e datës 13.06.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Mirëpo, duke u bazuar në shkresat e kësaj lënde del se gjykata e shkallës së dytë nuk ka shqyrtuar fare ankesën e të dënuarit H.K. e cila ankesë ishte paraqitur gjithashtu vetëm përkitazi me vendimin për sanksionin penal. Andaj, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 398, par.3 të KPP-së se gjykata e shkallës së dytë vendosë për të gjitha ankesat e paraqitura në të njëjtin aktgjykim, atëherë se me këtë rast kjo gjykatë kishte shkelur këtë dispozitë ligjore duke anashkaluar në tërësi

ankesën e të dënuarit. Për më tepër, del se mos trajtimi i kësaj ankese të jetë shkelje e natyrës kushtetuese dhe gjithashtu cenim i të drejtave të garantuara sipas KELDNJ të cilat gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në vendin tonë.

Në rigjykim, Gjykata e Apelit duhet të evitojë shkeljet e konstatuara më lartë posaçërisht të trajtoj edhe një herë ankesat e paraqitura e më pas të merr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke pasur parasysh edhe pretendimet e paraqitura në kërkesa.

7.3.12 Komente përmbledhëse

Siç shihet, në çështjen e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke e kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë, ndërsa arsye për kthimin e çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë kishte qenë fakti se kjo gjykatë nuk kishte vendosur me një vendim për të gjitha ankesat e paraqitura kundër aktgjykimit të njëjtë të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht nuk kishte vendosur edhe për ankesën e të dënuarit, e cila kishte qenë në shkresa të lëndës. Në këtë mënyrë, është konstatuar se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të lartcekura të dispozitave të procedurës penale, të cilat edhe e kanë kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, pa u shqyrtuar fare pretendimet tjera.

Bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart dhe duke ju referuar aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme të Kosovës mund të nxjerrën këto dy (2) konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

- 1) Se gjykata e shkallës së dytë, përkatësisht Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vendos me një vendim për të gjitha ankesat e paraqitur kundër vendimit të njëjtë dhe
- 2) Se mos vendosja në këtë mënyrë, përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që mund të ketë për pasojë anulimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Rasim Rasimi

8. DISA ÇËSHËTJE TË RËNDËSISHME NË LIDHJE ME SISTEMIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR

Pjesa e I-rë

8.1. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me sistemin e drejtësisë për të mitur

Sistemi i drejtësisë për të mitur është pjesë integrale e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës dhe se i njëjti garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,¹⁷⁷ si dhe me legjislacionin tjetër vendor.¹⁷⁸ Përveç këtyre, sistemi i drejtësisë për të mitur garantohet edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, standarde këto të përfshira në akte juridike ndërkombëtare dhe të zbatueshme drejtpërdrejtë në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës si: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor.¹⁷⁹

Përveç këtyre, janë miratuar edhe një numër një sërë dokumentesh tjera nga organizata të ndryshme ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë për të mitur, siç janë:

- Rregullat Standard Minimum i Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (ndryshe të njohura edhe si “Rregullat e Pekinit”, 1985);
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (ndryshe të njohura si “Rregullat e Havanës”, 1990);
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të rinjve (ndryshe të njohura si “Udhëzimet e Riadit”, 1990);
- Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me Masat e Mosarrestimit (ndryshe të njohura si “Rregullat e Tokios”, 1990);
- Udhëzime për veprim ndaj fëmijëve në sistemin e drejtësisë penale – Aneks i Rezolutës 1997/30 të OKB mbi Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (ndryshe të njohura si “Udhëzimet e Vienës”), etj.

Në këtë mënyrë, Republika e Kosovës ka krijuar një bazë të gjerë juridike me përfshirjen e instrumenteve juridike ndërkombëtare në legjislacionin vendor dhe me këtë mund të themi se

¹⁷⁷ Neni 50 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹⁷⁸ Kodi nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, i datës 14.09.2018 (në vijim: KDM); Ligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i datës 27.06.2019, etj.

¹⁷⁹ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, 2021, fq. 356.

¹⁷⁹ Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, 2021, po aty.

kemi një mbulim të plotë të çështjeve të fëmijëve sipas standardeve më të mira ndërkombëtare për respektimin dhe sigurimin e të drejtave të fëmijëve.¹⁸⁰

Për shkak të specifikave që ka sistemi i drejtësisë për të mitur, ka një numër të madh pjesëmarrësve (institucioneve) që marrin pjesë në drejtësinë për të mitur, ngase duke u mbështetur në përvojat më të mira ndërkombëtare në trajtimin e të miturit dhe në administrimin e sistemit të drejtësisë për të mitur, pjesëmarrja e gjerë e institucioneve dhe personave të tjerë le për të kuptuar se kur është në pyetje fëmija, atëherë çdokush ka obligim për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave që kanë fëmijët, e posaçërisht kur ndaj tyre zhvillohet ndonjë procedurë.¹⁸¹

Legjislatiioni bazë i sistemit të drejtësisë për të mitur (*Ligj Organik*) është Kodi i Drejtësisë për të Mitur, i cili përmban dispozita të natyrës materiale, procedurale, të masave dhe dënimeve të zbatueshme ndaj të miturve, procedurën e ndërmjetësimit për të mitur, si dhe mbrojtjen e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktime dhe të dëmtuar.

KDM rregullon veprimin ndaj të miturit si kryes i veprës penale, fëmijëve dhe të miturve si pjesëmarrës në procedurë, organeve të cilat zbatojnë procedurën penale dhe ekzekutimin e masave dhe dënimeve ndaj kryesit të mitur të veprës penale, si dhe mbrojtjen e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktime dhe të dëmtuar nga vepra penale.¹⁸²

KDM, gjithashtu garanton edhe respektimin e të të drejtave dhe lirive të tyre parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare në sistemin e drejtësisë, duke u bazuar në: respektimin e drejtave të njeriut dhe të lirive themelore; ndalimin e diskriminimit në çfarëdo baze; prezumimin e pafajësisë; respektimin e drejtave të fëmijës që në mënyrë të lirë të shprehin mendimin e vet; evitimin e kufizimit të lirisë personale të miturve në masë më të madhe të mundshme; nxitjen dhe dhënien e përparësisë zbatimit të masave edukuese kundrejt dënimit me burg; promovimit dhe respektimit të qasjes miqësore si dhe të mënyrës së veprimit ndaj të miturve duke i dhënë përparësi edukimit dhe risocializimit; dhënien e rëndësisë së veçantë aftësisimit dhe specializimit nëpërmjet qasjes multidisiplinore dhe bashkëpunimit institucional.

Duke u bazuar në nenin 4, paragrafët 1 dhe 2 të KDM-së, interesi më i mirë duhet të jetë konsiderata mbizotëruese gjatë gjithë procedurës dhe veprimeve që ndërmerren ndaj fëmijut dhe të miturit dhe se sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.

¹⁸⁰ Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, 2021 (bashkautor), fq. 356.

¹⁸¹ PO ATY.

¹⁸² PO ATY.

8.2 Karakteristikat e dënimit me burgim për të mitur

Duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ndaj kryesve të mitur të veprave penale sipas nevojës duhet të shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, duke i dhënë përparësi masave dhe sanksioneve alternative në relacion me sanksionet penale. Megjithatë, në shkencën e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore është konstatuar se në të gjitha rastet nuk është e mundur që të ushtrohet një luftë e suksesshme e kriminalitetit të të miturve vetëm me shqiptimin e këtyre masave.

Andaj, edhe në Republikën e Kosovës, ngjashëm sikur edhe në shtetet tjera të regjionit dhe të Evropës, është parashikuar mundësia që ndaj të miturve të shqiptohet edhe dënimi me burgim për të mitur.

Dënimi me burgim për të mitur mund të shqiptohet vetëm përjashtimisht dhe vetëm për llojet më të rënda të veprave penale, nëse plotësohen kushtet përkatëse ligjore.

Është e rëndësishme që të theksohet dënimi me burgim për të mitur, si dhe dënimet tjera që parashihen nënin 12, paragrafi 2 të KDM-së, mund të shqiptohen vetëm ndaj të miturit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë mbi moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet. Pra, dënimet mund të shqiptohen vetëm ndaj kategorisë së të miturve të rritur, ndërsa në asnjë mënyrë ndaj të miturve të rinjë.¹⁸³

Kohëzgjatja e çfarëdo mase apo dënimi të shqiptuar duhet të përcaktohet me vendim të gjykatës në pajtim me dispozitat ligjore të KDM.

Sipas nenit 33 të KDM, qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin, risocializimin dhe në zhvillimin e kryerësit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësitë profesionale dhe në zhvillimin e duhur personal. Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin. Në nenin 34 të KDM, është parashikuar se gjykata mund të shqiptojë dënimin me burgim për të mitur ndaj kryerësit të mitur i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushë gjashtëmbëdhjetë (16) vjet dhe ka kryer vepër penale të dënueshme me mbi pesë (5) vite burgim, në rastet kur shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte adekuate për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe shkallës së përgjegjësisë penale.

Kohëzgjatja e burgimit për të mitur nuk mund ta kalojë maksimumin e burgimit të paraparë për veprën penale por mund të jetë më i ulët se minimumi i burgimit të paraparë për veprën penale. Në anën tjetër, burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se gjashtë (6) muaj as më shumë se pesë (5) vjet dhe shqiptohet në muaj dhe vite të plota. Përjashtimisht,

¹⁸³ “I mitur i ri” është personi i cili i ka mbushur katërmëdhjetë (14) vjet, por nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, kurse “i mitur i rritur” është personi i cili i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, por nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet - neni 3, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.3. dhe 1.4. i KDM-së.

maksimumi i burgimit për të mitur është dhjetë (10) vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, ose kur i mituri ka kryer së paku dy (2) vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë (10) vjet.

Pjesa II-të

8.3 Disa raste të të miturve nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe aspekte të rëndësishme lidhur e procedurën ndaj të miturve

Në vijim të këtij punimi, janë paraqitur disa raste të të miturve nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, në të cilat si do të shihet janë trajtuar shumë çështje të rëndësishme nga fusha e drejtësisë për të mitur.

-Çështja e mbajtjes ose jo të seancës së kolegjit në Gjykatën e Apelit të Kosovës në rastet kur ndaj të miturit është shqiptuar masa edukative e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.380/2024, i datës 26.06.2024

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti për të Mitur, PM.nr.16/2024, të datës 29.04.2024, për shkak të veprave penale të theksuara më lart, ndaj të miturve: U. K. dhe K. I., është shqiptuar masa edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë në kohëzgjatje prej një (1) viti, me detyrime të veçanta që të miturit të përmbahen nga çfarëdo kontakti me të dëmtuarën dhe shqetësimin e saj. Është detyruar organi i kujdestarisë në Kamenicë që t'i raportoj gjykatës përkritazi me ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor së paku çdo tre (3) muaj. Shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kurse e dëmtuara A.A., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PAM.nr.58/2024, të datës 29.05.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të miturve: U. K. dhe K. I., ndërsa e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të miturit K. I., avokatja Sh. R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke propozuar që aktvendimi në fjalë të anulohet dhe kjo çështje penale t'i kthehet në rivendosje të njëjtës gjykatë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.218/2024, e datës 19.06.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të miturit K. I., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe nenit 71 të KDM-së, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësja e të miturit K. I., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që ka qenë e detyruar që t'i njoftojë të miturit dhe mbrojtësit e tyre për seancën e kolegjit, e që një gjë e tillë, përveç shkeljeve të lartcekura, përbën edhe mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj).

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shikoi dhe analizoi shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk është përfshirë me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç pretendon mbrojtësja e të miturit K. I..

Në këtë aspekt, fillimisht duhet sqaruar se me dispozitën e nenit 70, paragrafi 2 të KDM-së, është parashikuar se gjykata e shkallës së dytë, duke e ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë mund të shqipton dënim me burgim ose masë edukative institucionale, vetëm në rastet kur pranë kësaj gjykate mbahet shqyrtimi.

Ndërsa, me dispozitat tjera ligjore të KDM-së nuk është rregulluar në mënyrë shprehimore çështja e njoftimit ose jo të të miturit dhe mbrojtësit të tij në lidhje me mbajtjen e seancës së kolegjit të Gjykatës së Apelit e Kosovës, në rastet kur shqyrtohet ankesa e mbrojtjes e paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin është shqiptuar masa edukative e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë dhe në veçanti, në rastet kur nuk shqiptohet dënim me burgim apo masë edukative institucionale.

Andaj, bazuar në nenin 6 të KDM-së (“Zbatimi subsidiar i ligjeve tjera”), në rastet e tilla, duhet kërkuar zgjidhje përkatëse, duke aplikuar përshtatshërisht dispozitat e KPP-së, si kod i cili e rregullon procedurën penale pranë gjykatës së shkallës së dytë. Megjithatë, nëse i analizojmë dispozitat e KPP-së, atëherë shohim se seanca e kolegjit pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, kur është fjala për “ankesën kundër aktvendimit” është fakultative, përkatësisht nuk është obligative (neni 414, paragrafi 1 i KPP-së) dhe në situata të tilla duhet aplikuar përshtatshërisht nenin 390 të KPP-së (neni 414, paragrafi 3 i KPP-së).

Ndërsa, duke u bazuar në nenin 390 të KPP-së, atëherë rezulton se seanca e kolegjit pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, mund të mbahet në dy (2) mënyra:

- 1) Duke i njoftuar palët dhe përfaqësuesit e tyre me seancën e kolegjit dhe
- 2) Duke mos i njoftuar palët dhe përfaqësuesit e tyre me seancën e kolegjit.

Bazuar në nenin 390, paragrafi 1 të KPP-së, palët dhe përfaqësuesit e tyre njoftohen për seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në dy (2) situata:

- 1) *Së pari*, nëse të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burgim dhe
- 2) *Së dyti*, kur në ankesën e paraqitur ka pretendime ankimore që ndërlidhen me shqyrtimin e fakteve dhe të ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit.

Pas shikimit të shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në rastin konkret, nuk vjen në shprehje asnjëra prej situatave të lartcekura për t'i njoftuar palët dhe përfaqësuesit e tyre në lidhje me seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Kjo për faktin se ndaj të miturve nuk është shqiptuar dënim me burgim për të mitur, kurse në anën tjetër, në rastin konkret, në ankesat e mbrojtësve të të miturve: U. K. dhe K. I., nuk janë paraqitur pretendime në lidhje me shqyrtimin e fakteve dhe të ligjit për të bërë vlerësim lidhur fajësinë apo pafajësinë e të miturve, pasi që edhe ashtu të miturit e kanë pranuar fajësinë, por që në ankesat e mbrojtësve të të miturve janë paraqitur vetëm pretendime në lidhje me masën edukative të shqiptuar, e cila nuk është masë e karakterit institucional.

Përndryshe, duhet theksuar se edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNj), në disa raste nga jurisprudenca e saj ka sqaruar se prezenca personale e të pandehurit në gjykatën e shkallës së dytë nuk ka të njëjtën rëndësi, si prezenca e tij në gjykatën e shkallës së parë. Mënyra se si zbatohet neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("E drejta për një proces të rregullt") në kuptim të prezencës së të pandehurit pranë gjykatës së shkallës së dytë varet nga specifikat e procedurës penale përkatëse dhe se duhet pasur parasysh edhe tërësinë e procedurës penale të zhvilluar në kuadër të rendit të brendshëm juridik, si dhe rolin që ka gjykata e shkallës së dytë (rasti "*Hermi kundër Italisë*", aktgjykimi i Dhomës së Madhe, i datës 18.10.2006, paragrafi 60; rasti "*Kamasinski kundër Austrisë*", aktgjykimi i datës 19.12.1989, paragrafi 106; rasti "*Ekbatani kundër Suedisë*", aktgjykimi i datës 26.05.1988, paragrafi 27; rasti "*Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*", aktgjykimi i datës 02.03.1987, paragrafi 56, etj.).

Në këtë mënyrë, duke i pasur parasysh specifikat e rastit konkret të paraqitura më lart, kornizën aktuale ligjore, mandej, rolin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, si dhe duke u bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNj-së, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe referuar nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë, vetëm kur prindi nuk është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit dhe kur një masë e tillë është në interesin më të mirë të të miturit

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.73/2023, i datës 17.03.2023

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për të Mitur, PM.nr.460/2021, të datës 3 qershor 2022, ndaj të miturve: T.S. dhe B.B., është shqiptuar masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Është urdhëruar Organi i Kujdestarisë-Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, që ta mbikëqyr edukimin

e të miturve, të ofroj zgjedhje të mundshme që të miturit të vazhdojnë tutje shkollimin. Gjithashtu, gjykata i ka caktuar të miturve detyrimin që të vijojnë shkollimin, të përmbahen nga kontakti me personat për të cilët prindi dhe organi i kujdestarisë vlerësojnë se mund të kenë ndikim negativ në ta, si dhe të mos vizitojnë vende të caktuara për të cilat prindi dhe organi i kujdestarisë konsiderojnë se kanë ndikim negativ në ta. Konform nenit 68 paragrafi 7 të KDM-së, janë liruar plotësisht nga detyrimi për t'i paguar shpenzimet procedurës penale. I dëmtuari E.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PAM.nr.147/2022, të datës 27 dhjetor 2022, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të miturve, ndërsa e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të miturit T.S., avokatja B.H., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që ta aprovon si të bazuar këtë kërkesë, ndërsa aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohen, ashtu që ndaj të miturit të shqiptohet masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit apo të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.45/2023, të datës 27 shkurt 2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të miturit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe nenit 71 të KDM-së, si dhe pasi i vlerësoj pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoj se:

- kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësja e të miturit T.S., avokatja B.H., në kërkesën e saj për mbrojtjen e ligjshmërisë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ndaj të miturit ka shqiptuar një masë shumë të rëndë, duke mos vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese të cilat qëndrojnë në anën e të miturit e të cilat do të ndikonin në marrjen e një vendimi më të drejtë për të miturin. Rrethanat lehtësuese si: shkalla e ulët e përgjegjësisë, pranimi i fajësisë nga ana e të miturit, pendimi i thellë i tij, vlerësimi më i drejtë i Anketës Sociale me numër 17772/AS-848/2021 të datës 5 nëntor 2021, në të cilën thuhet se i njëjti është i dëgjueshëm, i shoqërueshëm, i dashur, ka sjellje dhe raporte të mira me anëtarët e familjes dhe rrethin social, se kjo situatë ka qenë gjendje kalimtare dhe e pa dëshiruar edhe nga ana e të miturit, i cili ka treguar në vazhdimësi gjatë gjithë procedurës pendimin e tij të thellë për rastin e ndodhur. Drejtori i shkollës ka deklaruar se i mituri ka qenë djalë i sjellshëm në shkollë dhe asnjëherë nuk ka qenë i dhunshëm. I mituri më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është anëtarë i AK "AAA", si valltarë e po ashtu ndjek kursin për sint dhe kitarë. I mituri është regjistruar si nxënës në një shkollë tjetër dhe i ka shkëputur kontaktet me shoqërinë e vjetër. Është i rregullt në mësim dhe është i angazhuar gjatë tërë ditës në ambientin shkollor. Nuk është vlerësuar fare as raporti psikologjik për të miturin, i cili është duke i ndjekur vizitat psikologjike të psikologja. Mbrojtja konsideron se edhe masa edukative - mbikëqyrja e shtuar nga ana e

prindit, nga neni 25 i KDM, do të arrinte qëllimin e zhvillimit të përgjegjësisë së tij personale dhe parandalimin për kryerjen e veprave penale nga ana e të miturit, e po ashtu do të ishte më shumë në interesin e të miturit, në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në të ardhmen.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimet e mbrojtëses së të miturit janë të bazuara, për faktin se gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar masën edukative ndaj të miturit, duke mos i respektuar dispozitat përkatëse ligjore të KDM, ndërsa këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vlerësuar anketën sociale, si dhe rrethanat tjera kur ka vendosur që ndaj të miturve të shqiptojnë masën edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e organit të kujdestarisë, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Duke u bazuar në nenin 27, paragrafi 1 të KDM, gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë, vetëm kur prindi nuk është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit dhe kur një masë e tillë nuk është në interesin më të mirë të të miturit.

Nga anketa e zhvilluar me të miturin, del se familja e të miturit kanë kushte të mira ekonomike dhe të ardhura të mjaftueshme për jetesë të mirë, me rekomandimin e psikologut prindi i të miturit ia ka ndërruar shkollën në mënyrë që ta largojë nga shoqëria e mëparshme, i mituri frekuenton një shkollë private ku është nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 5 pas dite dhe se në këto kushte dhe rrethana edhe me mbikëqyrjen e shtuar nga ana e prindit do të mund të arrihej rehabilitimi dhe risocializimi, si dhe zhvillimi adekuat i të miturit.

Në këtë mënyrë, nga anketa sociale e ShSK, por edhe nga shkresat tjera të lëndës, rezulton se prindërit e të miturit T.S. janë në gjendje të ushtrojnë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit, andaj edhe nën këto rrethana, ndaj të miturit nuk mund të shqiptohet mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë.

Duke u bazuar në gjitha rrethanat nga anketa sociale, por edhe nga shkresat tjera të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit është një masë adekuate dhe në interesin më të mirë të të miturit, ashtu siç parashihet edhe në nenin 13, paragrafi 1 të KDM dhe në nenin 3, paragrafi 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, gjë që me të drejtë edhe theksohet edhe në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kjo masë është adekuate, duke e pasur parasysh, përveç tjerash, edhe llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit T.S., nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet që e kanë nxitur të njëjtin për të kryer veprën penale, edukimin e tij në këtë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, si dhe faktin se ndaj tij nuk është shqiptuar më parë ndonjë masë edukative.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se përmes masës edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, do të kontribuohet në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të të miturit T.S., me qëllim të zhvillimit të përgjegjësisë së tij personale dhe parandalimit për kryerjen e veprave penale nga ana e tij.

Nga anketa sociale e ShSK, si dhe nga shkresat tjera të lëndës, shihet se arsytet për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në dobi të të miturit T.S., shkojnë edhe në dobi të të miturit B.B., i cili nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në nenin 436, paragrafi 2 të KPP, sipas detyrës zyrtare ka vendosur që edhe ndaj të miturit B.B., të shqiptohet masa e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, pasi që është konstatuar se prindërit e tij janë në gjendje që të ushtrjnë mbikëqyrjen e shtuar ndaj tij, në njërin anë.

Kurse, në anën tjetër, duke i pasur parasysh edhe rrethanat personale dhe familjare, mandej nivelin e zhvillimit psikologjik të të miturit, karakterin dhe prirjet e tij, motivet që e kanë nxitur të njëjtin për të kryer veprën penale, edukimin e tij në këtë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, si dhe faktin se ndaj tij nuk është shqiptuar më parë ndonjë masë edukative apo dënim, atëherë masa edukative e mbikëqyrjes së shtuar do të jetë në interesin më të mirë të tij.

-Çështja e caktimit të ekspertit për të vlerësuar zhvillimin psikologjik të madhorit të ri dhe hartimi i arsytimit me të ashtuquajturën metodë “copy-paste”

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.700/2023, i datës 23.01.2024

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.130/2022, i datës 14.02.2023, i dënuari D.X., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Lëndimi i lehtë trupor”, nga neni 185, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nëntë (9) muajve, të cilin dënim do ta mbajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa në kuptim të nenit 79, paragrafi 1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar, të dënuarit do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, duke filluar nga data 24.06.2022 deri më datën 23.07.2022.

Është detyruar i dënuari D.X. që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50) euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Është konfiskuar brisku me ngjyrë të zezë me mbishkrimin “*Browing*”, me teh 10 cm, i cili pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate, duke u konstatuar me procesverbal i cili duhet t’i bashkangjitet kësaj lënde penale.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.277/2023, e datës 10.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit D.X., avokatit E.Q., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit D.X., avokatit E.Q., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi, nën-paragrafi 1.12 lidhur me nenin 370, paragrafët 6 dhe 8 të KPP-së dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që këto aktgjykime të anulohen, ndërsa kjo çështje penale t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.414/2023, e datës 29.12.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit D.X., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit D.X., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i paqartë dhe kundërrthënës me arsyetimin, kurse në arsyetimin e aktgjykimit në fjalë vetëm është bërë një përshkrim i tërësishëm i deklaratave dhe asgjë tjetër, duke mos paraqitur në mënyrën e duhur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit.

Gjithashtu, pretendohet se nuk është lejuar, përkatësisht është refuzuar propozimi i mbrojtësit që të angazhohet ekspert nga lëmia e psikiatrisë dhe psikologjisë, me qëllim që të bëhet testi i inteligjencës për të dënuarin D.X., sepse i njëjti më datën 17.06.2022, ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, kurse më datën 24.06.2022, ka ndodhur rasti që është objekt i aktakuzës, ku me atë rast mbrojtja ka pretenduar se i dënuari në momentin e kryerjes së veprës penale nuk e ka pasur koeficientin e inteligjencës të mjaftueshëm krahas moshës dhe nuk ka mundur që të kontrolloj veprimet, sepse gjendjen emocionale e pasur shumë të rënduar, meqë atë ditë edhe i ka vdekur prindi, kështu që ka mbetur pa përkujdesin e prindit dhe ka filluar trajtimet te psikologu, ku ka mbajtur disa seanca.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit D.X., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6 dhe 7 të KPP-së.

Në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së është parashikuar se “Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit”, kurse në paragrafin 7 të këtij neni, është parashikuar se “Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij”.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar duke u bazuar në këto dispozita ligjore, pasi që në pjesën e arsyetimit nuk janë paraqitur arsye të qarta dhe të mjaftueshme për të gjitha pika e aktgjykimit, si dhe nuk janë vlerësuar dhe arsyetuar në mënyrën provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe propozimet e mbrojtjes në lidhje me administrimin e provave të tjera.

Arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, jo vetëm që është i mangët sa i përket çështjeve të lartcekura, por në pjesën dërmuese të tij, sidomos pjesa e paraqitjes së përmbajtjes së provave, është një përshkrim, përkatësisht kopjim në mënyrë detale i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

Nga kjo pjesë e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që është përshkruar në tërësi procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, duke i përshkruar në tërësi edhe pyetjet që janë parashtruar ndaj dëshmitarëve nga ana e mbrojtësit, prokurorit të shtetit, të dëmtuarit dhe kryetarit të trupit gjykues. Përveç kësaj, është përshkruar në tërësi deklarimi i dëshmitarëve në mënyrë të njëjtë siç është paraqitur në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor dhe më pastaj, është konstatuar se palët përkatëse, konkretisht i dëmtuari dhe i akuzuari nuk kanë pyetje tjera për dëshmitarët përkatës.

Një mënyrë e tillë e përshkrimit të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor fillon nga faqja e 4-të e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, për të vazhduar deri faqen 9-të të kësaj pjese të arsyetimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo mënyrë e shkrimit të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë duke e përshkruar në tërësi procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor (ndryshe e ashtuquajtur metodë “*copy-paste*”), nuk është në harmoni me dispozitat e lartcekura ligjore, andaj edhe si e tillë është e papranueshme.

Nga shkresat e lëndës, por edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, i datës 23.12.2022, shihet se mbrojtësi i të dënuarit kishte paraqitur propozim që të angazhohet një ekspert nga lëmia e psikologjisë, duke e pasur parasysh faktin se i dënuari më datën 17.06.2022 kishte mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, ndërsa më datën 24.06.2022, ishte kryer vepra penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor.

Në këtë mënyrë, mbrojtësi kishte pretenduar se i dënuari D.X. nuk e kishte pasur koeficientin e inteligjencës së mjaftueshme krahas moshës së tij, që për të cilën, i njëjti më vonë edhe kishte mbajtur disa seanca tek psikologu, ku lidhur me këtë aspekt, gjykatës ju kanë prezantuar edhe raportet mjekësore.

Mirëpo, nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk rezulton që një propozim i tillë i mbrojtësit të jetë arsyetuar dhe vlerësuar në mënyrën e duhur.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e refuzimit të një propozimit të tillë të mbrojtësit, nuk është dashur që të mjaftohet vetëm me një konstatim dhe arsyetim të thjeshtë në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, por që është dashur që me një përkushtim maksimal ta vlerëson një propozim të tillë, për të përcaktuar më pastaj, nëse në këtë rast mundet apo nuk mundet që të zbatohet neni 16 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë shqyrtuar as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjyqimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

-Çështja e zbatimit subsidiar të ligjeve tjera dhe e vlerësimit të pranimit të fajësisë nga ana e të miturit

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.352/2023, i datës 22.08.2023

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për të Mitur, PM.nr.33/2023, të datës 05.04.2023, ndaj të miturit L.B., është shqiptuar masa edukative dërgimi në institucionin edukativo-korrektues në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve, e cila masë do të ekzekutohet pasi që ky aktvendim të bëhet i formës së prerë, në të cilën masë, të miturit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 12.01.2023 e tutje. I mituri është liruar plotësisht nga detyrimi për të paguar shpenzimet e procedurës e të cilat do të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. I dëmtuari E.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest

civil. Me aktvendim të veçantë, të miturit i është vazhduar masa e paraburgimit, derisa sa aktvendimi i lartcekur të bëhet i formës së prerë.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PAM.nr.56/2023, të datës 08.06.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të miturit L.B., ndërsa e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të miturit L.B., avokati F.K., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që ta aprovon si të bazuar këtë kërkesë, ndërsa aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë të anulohen dhe lënda të kthehet në rivendosje apo këto aktvendime të ndryshohen, përkritazi me cilësimin juridik të veprës penale nga “Vrasja” e mbetur në tentativë në veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor”.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.213/2023, të datës 19.07.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të miturit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe nenit 71 të KDM-së, si dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të miturit L.B., në kërkesën e tij thekson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që i njëjti nuk përmban të dhënat sipas neneve 364 dhe 369 të KPP-së dhe kjo gjykatë nuk ka vepruar në pajtim me nenin 68, paragrafi 3 të KDM-së, me të cilën dispozitë ligjore është parashikuar se në aktvendimin për shqiptimin e masës edukative, gjykata duhet të përcaktoj përkthimin e veprës penale dhe rrethanat që e arsyetojnë shqiptimin e masës.

Gjithashtu, mbrojtësi i të miturit e konteston edhe pranimin e fajësisë, duke pretenduar se i mituri është dashur që të informohet detajisht për të gjitha pasojat e mundshme të pranimit të fajësisë dhe rrethanat tjera lidhur me pranimin e fajësisë. Nisur fillimisht nga fakti se i mituri në seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë, ndërsa, në seancën tjetër të shqyrtimit gjyqësor të datës 31.03.2023, e ka pranuar fajësinë, mund të konstatohet se i mituri nuk e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ndërsa pas kësaj, është dashur që përsëri të lexohet propozimi nga ana e prokurorit të shtetit.

Në fund, mbrojtësi i të miturit e konteston edhe veprën penale “Vrasja” e mbetur në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke konsideruar se nuk janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale, pasi që nuk ka pasur dashje për ta kryer këtë vepër penale.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi dhe analizoi pretendimet e mbrojtësit të të miturit L.B., konstatoi se aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as nuk është shkelur ligji penal në dëm të të miturit.

Në radhë të parë, është e nevojshme që të theksohet se si aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, në të gjitha pjesët e tyre janë përpiluar sipas dispozitave përkatëse ligjore, janë të kuptueshëm dhe nuk janë kundërtëhënës në asnjë pikë. Duke ju referuar pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës fillimisht e sheh të nevojshme që të sqaron se në procedurën ndaj të miturve zbatohen dispozitat ligjore të KDM-së dhe dispozitat e këtij Kodi, kanë përparësi në raport me dispozitat e ligjeve dhe kodeve tjera.

Dispozitat e ligjeve dhe kodeve tjera në procedurën ndaj të miturve zbatohen përshtatshmërishtë dhe vetëm për çështjet të cilat nuk janë rregulluar ndryshe me KDM, ndërsa një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në nenin 6 të këtij Kodi. Kështu, në këtë dispozitë ligjore që emërtohet “Zbatimi subsidiar i ligjeve tjera”, është parashikuar se “Ndaj kryesit të mitur të veprës penale dhe fëmijëve viktimë apo dëshmitarë, në procedurën penale, në çështjet të cilat nuk janë rregulluar ndryshe me këtë Kod, përshtatshmërishtë zbatohen dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe dispozitat tjera penalo juridike”.

Andaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore, edhe sa i përket çështjes së përbajtjes së aktvendimit për shqiptimin e masës edukative ndaj të miturit, përparësi kanë dispozitat ligjore të KDM-së në raport me dispozitat ligjore të KPP-së.

Në nenin 68, paragrafi 3 të KDM-së është parashikuar se “Gjyqtari për të mitur ose trupi gjykyes për të mitur me aktvendim shqipton masën edukative për të miturin. Në dispozitiv të aktvendimit ceket vetëm urdhri për masën edukative dhe çfarëdo mase tjetër ose dënimi në Pjesën e dytë, Kapitulli VIII të këtij Kodi, por i mituri nuk shpallet fajtor për veprën penale të përshkruar në propozimin e prokurorit. Arsyetimi i aktvendimit përmban përshkrimin e veprës penale dhe rrethanat të cilat e arsyetojnë shqiptimin e masës edukative”.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, në dispozitiv të aktvendimit (për dallim nga dispozitivi i aktgjykimit sipas KPP-së) duhet të ceket urdhri për masën edukative, ndërsa përshkrimi i veprës penale dhe rrethanat të cilat e arsyetojnë shqiptimin e masës edukative paraqiten në arsyetim të aktvendimit përkatës.

Në këtë mënyrë është vepruar edhe në rastin konkret, ku në dispozitiv të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë është cekur masa edukative që është shqiptuar ndaj të miturit, kurse në pjesën e arsyetimit (faqja 2) është bërë përshkrimi i veprave penale.

Sa i përket pranimit të fajësisë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur ndonjë shkelje të dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë institut juridik.

Kështu, pas shikimit dhe analizimit të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 31.03.2023, si dhe shkresave tjera të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pranimi i fajësisë nga

ana e të miturit L.B., është bërë ashtu siç është parashikuar në nenin 242, paragrafët 1.-6. të KPP-së dhe nenin 68, paragrafi 6 të KDM.

Në këtë rast, bazuar në shkresat e lëndës, shihet se i mituri L.B. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë; pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i mituri pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës; se pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban propozimi për shqiptimin e masës edukative, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër, si dhe propozimi për shqiptimin e masës edukative nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjithashtu, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor nuk rezulton që i mituri L.B. dhe mbrojtësi i mëparshëm, avokati G.C., të kenë pasur ndonjë vërejtje në aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është aprovuar pranimi i fajësisë.

Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se i mituri ka të drejtë që të pranojë fajësinë në cilëndo seancë të shqyrtimit gjyqësor dhe vetëm fakti se në seancën e paraprake nuk e ka pranuar fajësinë, nuk mund të jetë arsye për refuzimin e pranimi të fajësisë gjatë seancave të mëpastajshme të shqyrtimit gjyqësor.

Nëse i mituri e pranon fajësinë, edhe pse në seancën e paraprake të shqyrtimit gjyqësor, nuk e kishte bërë një gjë të tillë, atëherë nuk është e domosdoshme që përsëri të lexohet propozimi nga ana e prokurorit të shtetit, siç pretendon mbrojtësi në kërkesë, nëse një gjë e tillë është bërë në seancën e kaluar të shqyrtimit gjyqësor.

Në anën tjetër, ashtu siç parashihet edhe në nenin 404, paragrafi 1 të KPP-së, në arsyetimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë janë vlerësuar të gjitha pretendimet e ankesës dhe janë treguar shkeljet e ligjit të cilat janë shqyrtuar sipas detyrës zyrtare.

Përveç që nuk janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, me aktvendimet e lartcekura nuk është shkelur as ligji penal në dëm të të miturit L.B., pasi që veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale “Vrasje” të mbetur në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 23 të KPRK-së, për të cilën edhe i mituri e ka pranuar fajësinë.

Në lidhje me këtë aspekt dhe për të konfirmuar se në këtë rast bëhet fjalë për vepër penale “Vrasja” e mbetur në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së (e jo vetëm lëndim të lehtë, siç pretendon mbrojtësi) është e rëndësishme dhe e mjaftueshme që të paraqitet përshkrimi i veprimeve kryerëse, nga të cilat shihet se i mituri L.B., ditën kritike, me dashje që të privoj nga jeta të dëmtuarin E.B., e ka goditur gjashtë (6) herë me thikë dhe atë: dy (2) herë mbrapa shpine në anën e majtë dhe në fund të shpinës afër boshit kurrizor; dy (2) herë në të dy (2) krahët dhe dy (2) herë në këmbë. Andaj, pavarësisht faktit se i dëmtuari E.B., ka pësuar vetëm lëndime trupore, vetë goditja me thikë gjashtë (6) herë në pjesë të ndryshme të trupit, siç është

paraqitur më lart dhe duke i pasur parasysh edhe rrethanat tjera të rastit konkret, tregojnë që dashja e të miturit L.B. ka qenë për ta privuar nga jeta të dëmtuarin në fjalë, gjë për të cilën i mituri edhe e ka pranuar fajësinë.

Në fund, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe janë vlerësuar të gjitha rrethanat relevante që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të masës edukative dërgimi në institucionin edukativo-korrektues, rrethana këto që kanë të bëjnë si me kryesin e mitur, ashtu edhe me veprën penale në përgjithësi.

Me rastin e shqiptimit të kësaj mase edukative, nga shkresat e lëndës shihet se interesi më i mirë i të miturit L.B. ka qenë konsiderata mbizotëruese, ashtu siç parashihet në nenin 4, paragrafët 1 dhe 2 lidhur me nenin 13, paragrafi 1 të KDM-së dhe nenin 3, paragrafi 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

-Vlerësimi i rrethanave përkatëse me rastin e shqiptimit të masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.479/2023, i datës 10.10.2023

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për të Mitur, PM.nr.53/2022, të datës 10.03.2023, ndaj të miturës A.O., është shqiptuar masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve. Verifikimin e ekzekutimit të kësaj mase do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës - Zyra Rajonale në Gjakovë. Shpenzimet e procedurës është vendosur që të paguhet nga mjetet buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kurse e dëmtuara S.H., nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PAM.nr.54/2023, e datës 15.06.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të miturës A.O., ndërsa e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të miturës A.O., avokati B.H., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, me propozim që kërkesa të pranohet si e bazuar, ndërsa aktvendimet e lartcekura të modifikohen duke e liruar të miturën nga akuza, ose aktvendimet e njëjta të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.289/2023, e datës 18.09.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të miturës A.O., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe nenit 71 të Kodit të Drejtësisë për Mitur (KDM), si dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatojë se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të miturës A.O., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se me aktvendimet e lartcekura janë marrë me shkelje të dispozitave të KDM-së, pasi nëse merren parasysh të gjitha rrethanat që janë vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, atëherë masa edukative e shqiptuar ndaj të miturës është jo adekuate.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtojë dhe analizojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatojë se me aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë shkelur dispozitat ligjore të KDM-së sa i përket shqiptimit të masës edukative, siç pretendon mbrojtësi i të miturës.

Kjo për faktin se në aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe janë vlerësuar të gjitha rrethanat relevante që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të masës edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, rrethana këto që kanë të bëjnë si me kryesën e mitur, ashtu edhe me veprën penale dhe raportet me palën e dëmtuar.

Kështu, nga shkresat e lëndës shihet se me rastin e shqiptimit të masës edukative, si rrethana lehtësuese janë marrë për bazë sjelljet korrekte të të miturës me organet e drejtësisë, është hera e parë që kishte rënë ndesh me ligjin, moshën e saj të re, është nxënëse i rregullt në shkollë, ka të përfunduar klasën e IX me sukses të shkëlqyeshëm, nuk është konsumuese e alkoolit, duhanit apo substancave tjera abuzive, si dhe premtimin e prindërit dhe gatishmërinë e tij që të miturën ta ketë nën mbikëqyrje më të shtuar.

Përveç këtyre, nga shkresat e lëndës, shihet janë vlerësuar edhe të dhënat nga anketa sociale, siç janë: rrethanat personale dhe familjare, mandej niveli i zhvillimit psikologjik të të miturës, karakteri dhe prirjet e saj, edukimi i saj në këtë fazë, mjedisi dhe rrethanat e jetës së saj, gjendja ekonomike të të miturës, fakti se ndaj saj nuk është shqiptuar më parë ndonjë masë edukative apo dënim, jeton me hallën dhe babin, halle ngase nëna e saj që nga viti 2014 jeton në Gjermani, sepse është e divorcuar, ndërsa prindi i të miturës ka deklaruar se sjelljet e tilla të të miturës nuk do të përsëriten në të ardhmen.

Gjithashtu, me rastin e shqiptimit të kësaj mase edukative, nga shkresat e lëndës shihet se interesi më i mirë i të miturës ka qenë konsiderata mbizotëruese, ashtu siç parashihet në nenin 4, paragrafët 1 dhe 2 lidhur me nenin 13, paragrafi 1 të KDM-së dhe nenin 3, paragrafi 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Duke u bazuar në të gjitha këto rrethana, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se në këtë rast nuk bëhet fjalë për ndonjë shkelje të dispozitave ligjore të KDM-së, pasi që masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit është një masë e drejtë dhe e ligjshme, si dhe përmes saj do të kontribuohet në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të të miturës, me qëllim të zhvillimit të përgjegjësisë së saj personale dhe parandalimit për kryerjen e veprave penale nga ana e saj. Andaj, edhe duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e lartcekura, masa edukative e qortimit gjyqësor ndaj të miturës Albana Qorri nuk do të ishte adekuate dhe do të ishte e pamjaftueshme për të arritur qëllimet e lartcekura.

- Nuk lejohet paraqitja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj aktvendime me të cilat është refuzuar si i pabazuar propozimi për rishqyrtimin e masës edukative institucionale

- Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.2/2022, i datës 18.01.2022.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PM.nr.2162/2018 e datës 25.10.2021, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të miturit L.Z., për rishqyrtimin e masës edukative institucionale.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PNM.nr.1129/2021 të datës 17.11.2021 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të miturit, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka parashtruar mbrojtësi i të miturit, avokati E.B., për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 432, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1. dhe 1.3. të KPP-së, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar dhe të anulohen aktvendimet e kundërshtuara dhe çështja të kthehet për rigjykim dhe rivendosje.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën e datës 10.01.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësi të dënuarit të hudhet si e papranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 435, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

- kërkesa është e papranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur kundër aktvendimeve të kundërshtuara është e papranueshme, për faktin se sipas dispozitës së nenit 432, paragraf 1 të KPP-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë. Ndërsa, sipas dispozitës së nenit 432, paragrafi 4 të KPP-së, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit. Kurse, në rastin

konkret, nuk është fjala për procedurën penale, por për procedurën e ekzekutimit të masës edukative dërgimi në institucionin edukativo korrektues, andaj për një vendim i cili nuk është marrë në procedurë penale dhe për këtë arsye nuk është përmbushur kushti i lartcekur për lejueshmërinë e paraqitjes së këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Për arsyen e cekur më lart, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u hodh si e palejueshme në kuptim të nenit 435, paragrafi 2 të KPP-së.

-Fëmija, si viktimë e ndejshme, element i figurës së veprës penale

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.519/2022, i datës 16.01.2023.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur, PM.nr.24/2022, të datës 23 qershor 2021, ndaj të miturit L.S., është shqiptuar masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Verifikimin e ekzekutimit të kësaj mase do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës, Zyra Rajonale në Gjilan. Shpenzimet e procedurës është vendosur që të paguhen nga mjetet buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PAM.nr.80/2022, të datës 12 dhjetor 2022, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të miturit L.S., ndërsa e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të miturit L.S., avokati G.M., për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që ta aprovon si të bazuar këtë kërkesë, ndërsa aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohen apo të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.313/2022, të datës 30 dhjetor 2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të miturit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe nenit 71 të KDM-së, si dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të miturit L.S., avokati G.M., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se me aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë është shkelur ligji penal, pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprë penale sulmi nga neni 184, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.

Gjithashtu, mbrojtësi i të miturit pretendon se kualifikimi i juridik i veprës penale nuk është bërë në mënyrën e duhur, pasi që nuk është specifikuar nën-paragrafi përkatës, si dhe nuk kemi të bëjmë me viktimë të ndjeshme, për faktin që në këtë çështje penale, përveç të dëmtuarit, edhe i

mituri është fëmijë. Kështu që, në situata të tilla, si viktimë e ndjeshme do të konsiderohej në rastet kur madhori ka kryer një veprë penale ndaj fëmijës.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoj dhe analizoj pretendimet e mbrojtësit të të miturit, konstatoj se me aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk është shkelur ligji penal në dëm të të miturit. Kjo për faktin se veprimet kryerëse të të miturit L.S., të përshkruara në dispozitiv të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë i përbëjnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale sulmi nga neni 184, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.

Në paragrafin 1 të nenit 184 të KPRK është parashikuar se formën themelore e veprës penale sulmi, e kryen “Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër...”, kurse në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet “Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme...”.

Në paragrafin 39 të nenit 113 të KPRK është parashikuar se viktimë e ndjeshme, përveç tjerash është edhe “viktima e veprës penale e cila është fëmijë”, ndërsa në paragrafin 22 të këtij neni është parashikuar se “fëmijë konsiderohet personi i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet”.

Nga përshkrimi i veprimeve kryerëse rezulton se i mituri L.S., më datën 24 shkurt 2022, rreth orës 17:00 minuta, në oborrin e shkollës “XXX”, në fshatin “AAA”, komuna e Kamenicës, e kishte përdorur forcën ndaj të dëmtuarit V.R., nga i njëjti fshat, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje në mes të fëmijëve A.A., B.N. dhe V.R. (persona nën moshën 14 vjet) dhe të miturit L.S. kishte ardhur deri te konflikti fizik, ku E.S., fillimisht kishte pasur konflikt verbal me V.R., pastaj konflikti verbal është shndërruar në konflikt fizik, me ç’rast i mituri L.S. e ka sulmuar dhe e ka goditur me grusht në qafë të dëmtuarin V.R., me çka tek viktima ka shkaktuar shqetësim emocional.

Duke u bazuar në këto veprime kryerëse, rezulton se në këtë rast janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale sulmi nga neni 184, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 KPRK, pasi që i mituri L.S., në mënyrën, vendin dhe kohën e përshkruar më lart e kishte sulmuar të dëmtuarin V.R., i cili konsiderohet viktimë e ndjeshme, pasi që është fëmijë, përkatësisht person nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjet.

Gjykata Supreme e Kosovës thekson se forma e rëndë e veprës penale sulmi nga neni 184, paragrafi 3 të KPRK, konsiderohet se është kryer në rastet kur sulmi është kryer ndaj viktimës së ndjeshme, pavarësisht faktit se kryesi a është madhor apo i mitur.

Siç është theksuar edhe më lart, në nenin 184, paragrafi 1 të KPRK është parashikuar se këtë veprë penale e kryen “Kushdo...”, që do të thotë se këtë veprë penale mund ta kryej secili person, pavarësisht se a është madhor apo i mitur (vepra penale këto ndryshe të ashtuquajtura “*delicta communia*”), për dallim p.sh. prej veprës penale bashkësisht jashtëmartesore me personin nën

moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 240, paragrafi 1 të KPRK, të cilën mund ta kryej vetëm personi madhor (vepra penale këto ndryshe të ashtuquajtura “*delicta propria*”).

Në fund, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se pavarësisht faktit që nuk është theksuar “nën-paragrafi 3.1.” i paragrafit 3 të nenit 184 të KPRK, kualifikimi juridik i veprës penale i bërë nga gjykata e shkallës së parë nënkupton se bëhet fjalë për këtë nën-paragraf. Kjo për faktin në rastin konkret, vepra penale është kualifikuar sulmi nga neni 184, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, ndërsa nën-paragrafi 3.1. i paragrafit 3 të nenit të lartcekur i referohet vetëm paragrafit 1. të këtij neni. Andaj, në këtë aspekt është e qartë se veprimet kryerëse të të miturit kualifikohen edhe sipas nën-paragrafit 3.1. të KPRK.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Nëse veprimet e të miturit janë ndërmarrë në gjendje të afektit mendor

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.263/2023, i datës 12.06.2023.

Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PM.nr.24/2022 të datës 09.11.2022, të miturit B.S., për veprat penale vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.4 të KPRK i ka shqiptuar masën edukative dërgimi në institucionin edukativo korrektues në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, në të cilën masë do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 01.11.2021 deri më datë 07.11.2021, përkatësisht prej datës 07.12.2021 deri më datë 29.01.2022. Ndërsa, të miturit A.A., B.B. dhe C.C. për kryerjen e veprës penale secili veç e veç pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, të miturit D.D. dhe E.E., për veprën penale secili veç e veç mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK dhe të miturve: A.A., B.B., C.C., D.D. dhe E.E., iu ka shqiptuar secilit veç e veç masën edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e cila masë do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi. Detyrohet shërbimi Sprovues i Kosovës-Zyra Regjonale në Gjakovë që të bëjë verifikimin e ekzekutimit të kësaj mase dhe tu ofroj ndihmën e nevojshme prindërve. Shpenzimet e procedurës penale për të gjithë të miturit bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PAM.nr.161/2022 e datës 08.02.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ankesën e mbrojtësve të miturve B.S. dhe Mërgim Mazreku, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi të miturit B.S., avokati I.I., për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktvendimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.156/2023 e datës 06.06.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të miturit B.S. në kërkesë pretendon se, të dy aktvendimet si ai i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë të përfshirë me shkelje të ligjit penal dhe se cilësimi juridik i veprës penale është i papranueshëm pasi që të dy gjykatat vlerësimin ligjor për cilësimin juridik të veprës e kanë bërë në mënyrë të gabuar pasi që, nëse vlerësohen drejtë rrethanat se si ka ardhur deri tek incidenti në ditën kritike, rezulton se në veprimet e të miturit nuk qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK. Më tutje, në kërkesë të mbrojtësit theksohet se në veprimet e të miturit mund të qëndrojnë elementet e veprës penale të kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore apo në veprimet e të njëjtit mund të konsumohen dhe të trajtohen si veprime të kryera në mbrojtje të nevojshme nga neni 12 i KPRK. Tutje, theksohet se gjykata ka administruar si provë edhe ekzaminimin psikiatrik rreth shëndetit mendor për të miturin, ku konstatimi përfundimtar i ekspertëve është se aftësia e të miturit për të gjykuar dhe vepruar drejtë, në ditën kritike ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale, e që nënkupton se në rastin konkret kanë dominuar emocionet dhe jo arsyeja.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimet e mbrojtësit të miturit se aktvendimet e kundërshtuara ai i gjykatës së shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë të përfshirë me shkelje të ligjit penal janë të pabazuara.

Nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësit se aktvendimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje të ligjit penal sa i përket cilësimit juridik të veprës penale, për faktin se gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor, kanë vlerësuar drejtë se në veprimet e të miturit B.S. janë manifestuar elementet qenësore të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor.

Gjykata e shkallës së parë përkitazi me këtë pretendim të mbrojtjes për cilësimin juridik të veprës penale ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm të qartë dhe të plotë me të cilin arsyetim të gjykatës pajtohet edhe kjo gjykatë, për faktin se me provat e administruara është vërtetuar se i mituri B.S. paraprakisht kishte qenë i përgatitur për këtë përlëshje, pastaj i njëjti kishte qenë i para përgatitur me posedimin e thikës në xhep, po ashtu nuk ka qenë vetëm sepse me të kanë qenë edhe shokët e tij të cilët nuk e kanë mohuar se kanë qenë me te ditën kritike dhe kanë pas mjete të tjera të forta, pastaj faktin se i njëjti nuk është sulmuar nga i dëmtuari S., por nga i mituri S.G., si dhe faktin se therjet tjera pas therjes së parë në krah janë bërë me gjakftohtësi, i njëjti e ka therur më pas të dëmtuarin në mushkëri dhe pjesë të tjera vitale.

Pra, nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes se në veprimet e të miturit mund të qëndrojnë elementet e veprës penale të kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore apo në veprimet e të njëjtit mund të konsumohen dhe të trajtohen si veprime të kryera në mbrojtje të nevojshme por kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë fare për ekzistimin e vrasjes në tentativë në gjendje të afektit mendor. Tronditja e fortë mendore konsiderohet atëherë kur shkaktohet një gjendje e jashtëzakonshme psikike, me q, rast kryesi, pa gjykuar në mënyrë kritike, vendos në qastë (aty për aty) të kryejë veprën, ngase më parë ka qenë i fyer apo i sulmuar nga viktima. Tronditja në kuptim të kësaj dispozite është ajo që prek thellë ndjenjën e dinjitetit të personit, sulmi dhe fyerja duhet të jenë, sipas mënyrës dhe intensitetit të tilla që mund të sjellin të akuzuarin në gjendje të tronditjes së fortë, pra jo çdo fjalosje, fyerje apo sulm. Kjo për arsye se në zhvillimin e kësaj ngjarje nuk janë plotësuar kushtet për tu konsideruar se në veprimet e të miturit mund të qëndrojnë elementet e veprës penale vrasje në tentativë në gjendje të afektit mendor, e aq më pak të mbrojtjes së nevojshme siç pretendohet nga ana e mbrojtësit të miturit.

Edhe në raportin mbi gjendjen e shëndetit mendor të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, në të cilin është konstatuar se për shkak të moshës së tij të mitur, aftësia e tij mendore për të gjykuar dhe vepruar drejtë ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale, për çka edhe gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vlerësuar tek rrethanat lehtësuese me rastin e matjes dhe shqiptimit të masës edukative, por se vepra është kryer në gjendje të afektit apo tronditjes së fortë mendore, është në kundërshtim me provat e administruara dhe të elaboruara më lartë.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

-Në procedurën gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit për veprë penale të kryer si i mitur, gjykata mund të shqiptojë ndonjë masë ose dënim në pajtim me nenin 12 të kdm.

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.657/2023, i datës 22.12.2023.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PM.nr.74/2016 të datës 31.07.2023, të miturit tani madhor M.M. dhe D.D., i ka shpallur fajtor për veprën penale grabitje nga neni 255 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 e lidhur me nenin 23 të KPRK dhe të njëjtëve ju ka shqiptuar secilit veç e veç dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 15 (pesëmbëdhjetë) muajve, në të cilin dënim ua ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 20.08.2009 deri me datë 03.12.2010, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Janë obliguar të miturit tani madhor që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej 100 € dhe për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej 50 €. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PAKR.nr.589/2023 e datës 01.11.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ankesat e mbrojtësve të miturve tani madhor, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

-mbrojtësi të miturit tani madhor D.D., avokati S.P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljeve të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe të miturin tani madhor D.D. ta liroj nga përgjegjësia penale apo aktgjykimet të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.383/2023 e datës 18.12.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

-mbrojtësi i të miturit tani madhor D.D., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, pretendon se, aktgjykimet e kundërshtuara përbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403, paragrafi 1, nën paragrafi 1.12 të KPP, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten si dhe me arsyetimin e të njëjtit, nuk përmban arsye të qarta në masë të konsiderueshme është kundërrthënës, ku për faktet vendimtare ka kundërrthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve. Aktgjykimi është i përfshirë edhe me shkelje tjera esenciale sepse dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim të plotë me arsyetimin, në dispozitiv theksohet se i mituri duke vepruar në bashkëkryerje me të miturin tjetër të ketë bërë planin dhe mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale, duke i ndarë rolet në veprimet e tyre, më pastaj theksohet se i mituri me të miturit tjerë me armë në dorë ta kenë drejtuar në drejtim të viktimës dhe nga ajo të kenë kërkuar para.

Pretendohet më tutje në kërkesë se ekziston edhe shkelja e dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, për faktin se me provat e administruara lidhur me këtë çështje penale gjykatat e instancave në të ulëta në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike meqë nuk kanë arritur që me provat e administruara të vërtetojnë pa mëdyshje përshkrimin faktik të kësaj çështje penale, meqë veprimet e të miturit tani madhor assesi nuk gjejnë sajimin e elementeve që sajojnë figurën e veprës penale për të cilën i njëjti është shpall fajtor dhe është gjykuar. Thekson se shkelja e dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur konsiston në faktin se i mituri tani madhor ka arritur moshën 32 vjeçare dhe nën supozimin se e ka kryer këtë vepër penale, sipas mendimit të mbrojtjes ai do të duhej të dënohej më së largu deri në moshën 23 vjeçare, për faktin se në nenin 16, paragrafi 2 të KDM, thuhet se masa ose dënimi i shqiptuar mund të zgjasë deri sa personi të arrij moshën 23 vjeçare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të miturit tani madhor se aktgjykimet e kundërshtuara ai i gjykatës së shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë të

përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të Kodit të Drejtësisë për të Mitur janë të pabazuara.

Aktgjykimet e kundërshtuara janë të qarta, të kuptueshme dhe nuk përmbajnë kundërbërje me vetveten ose me arsyet e paraqitura. Përshkrimet e dhëna në arsyetimin e aktgjykimeve të kundërshtuara me kërkesë përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërbërje. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë është i qartë i kuptueshëm dhe konkret si dhe në përputhshmëri të plotë me arsyetimin, përpilimi i të cilëve është bërë në konform dispozitave të nenit 369, paragrafi 4 lidhur me nenin 364 të KPP-së, ku janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën i mituri tani madhor është shpall fajtor. Në arsyetimet e këtyre aktgjykimeve të kundërshtuara me kërkesë janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale duke u bazuar në dispozitat e nenit 369, paragrafi 6 të KPP-së, ku gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit si ato faktike edhe ato juridike.

Aktgjykimet e kundërshtuara janë bazuar në prova të ligjshme dhe të pranueshme të cilat si të tilla janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, me që rast gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta, për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga ana e të miturit tani madhor D.D..

Përkritazi me pretendimin e mbrojtësit se me këtë rast është shkelur edhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur, për faktin se i mituri tani madhor ka arritur moshën 32 vjeçare dhe nën supozimin se e ka kryer këtë vepër penale, sipas mendimit të mbrojtjes ai do të duhej të dënohej më së largu deri në moshën 23 vjeçare, në pajtim me nenin 16, paragrafi 2 të KDM-së ku thuhet se masa ose dënimi i shqiptuar mund të zgjasë deri sa personi të arrij moshën 23 vjeçare, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, ky pretendim është i pabazuar.

Gjykatat e instancës më të ulët kanë vepruar drejt kur të miturin tani madhor e kanë shpall fajtor për veprën penale të grabitjes nga neni 255, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe 23 të KPRK dhe e kanë gjykuar duke aplikuar dispozitën ligjore të Kodit të Drejtësisë për të Mitur nga neni 15, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 i këtij Kodi, në të cilën dispozitë nga paragrafi 1 parashihet se “Në procedurën gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit për vepër penale të kryer si i mitur i rritur, gjykata mund të shqiptojë ndonjë masë ose dënim në pajtim me nenin 12 të këtij Kodi. Kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 13 të këtij Kodi merren parasysh bashkë me kohën që ka kaluar nga kryerja e veprës penale.

Sipas paragrafit 3 të këtij neni, thuhet përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në vend të burgimit për të mitur, gjykata shqipton burgim ose dënim me kusht ndaj madhorit i cili ka mbushur moshën njëzetetë (23) vjet në kohën e procedurës gjyqësore, nën kushtet e parapara në këtë Kod, prandaj pretendimi se ndaj të miturit tani madhor është dashtë të aplikohet neni 16, paragrafi 2 i KDM, është i pabazuar për faktin se ky nen aplikohet në procedurën gjyqësore ndaj madhorit të ri për vepër penale të kryer si madhor i ri sipas paragrafit 1 të Këtij neni, kurse në

rastin konkret nuk bëhet fjalë për procedurë gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit të ri por procedura gjyqësore është zhvilluar ndaj madhorit sipas nenit 15, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KDM.

Nga arsyet e cekura më lart, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Mos prezenca e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje të të miturit përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.164/2021, i datës 16.06.2021.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PM.nr.45/2018 të datës 01.02.2021, ndaj të miturit E.E. është shqiptuar masa edukuese mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindërve në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, për veprën penale “Vjedhje e rëndë” nga neni 327, paragrafi 2.2. lidhur me paragrafin 1.1. dhe nenin 31 të KPRK-së. Shërbimi Sprovues i Regjionit të Mitrovicës është urdhëruar mbikëqyrja e ekzekutimit të kësaj mase. Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale bijnë në barë të mjeteve buxhetore të gjykatës, ndërsa për realizimin e kërkesës pronësore juridike, i dëmtuari është udhëzuar në kontestin civil.

Në procedurën ankimore, me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.15/2021 të datës 12.04.2021, është refuzuar ankesa e mbrojtësit të miturit, ndërsa aktvendim i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të miturit, avokati K.O., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ose që procedura penale ndaj të miturit të pushohet.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.103/2021 të datës 12.05.2021, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi se:

-kërkesa është e bazuar.

Në kërkesë, në mes tjerash, pretendohet se i mituri në procedurën para policisë, është marrë në pyetje pa prezencën e mbrojtësit dhe në këtë mënyrë i është mohuar e drejta në mbrojtje. Në procedurën para gjykatës, gjykata ka anashkaluar këtë shkelje dhe i ka besuar policëve-dëshmitarëve R.M. dhe H.X. të cilit e kanë dërguar të miturin në vendin e ngjarjes dhe sërish pa prezencën e mbrojtësit nga ai kanë kërkuar t’iu tregoj vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, duke marrë këto dëshmi si bazë për gjetjen se i mituri është kryes i saj. Në këtë mënyrë,

me neglizhimin e të drejtës me mbrojtje me avokat, aktvendimi është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e cila nuk është eliminuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se pretendimi është i bazuar, pasi që nga shkresat e lëndës dhe aktvendimet e kundërshtuara rezultojnë se nuk ka qenë kontestuese se në vendin dhe kohën e cekur janë ndërmarr veprimet inkriminuese, sepse për këtë tregojnë të gjitha provat materiale dhe ato formale-deklarata e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve të dëgjuar.

Megjithatë, sa i përket asaj se kush është kryes i veprës penale, nga këto shkresa rrjedh se i mituri gjatë tërë procedurës ka mohuar të ketë qenë kryes i saj, me përjashtim të deklaratës së dhënë në stacionin policor 09.08.2018, në të cilën ka pranuar kryerjen e veprës penale dhe në kërkesën e policisë ka shkuar në vendin e ngjarjes, duke treguar vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale. Nga ky procesverbal rezultojnë se i mituri nuk ka pasur mbrojtës. Konform dispozitës së nenit 43, paragrafi 1 të KDM-së, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, i mituri duhet të ketë mbrojtës që nga fillimi e deri në përfundim të procedurës, ndërsa konform paragrafi 2 të këtij neni, në rastet kur i mituri, përfaqësuesi ligjor ose anëtar i familjes së tij nuk angazhohen mbrojtës, gjyqtari për të mitur ose organi kompetentë që e zbaton procedurën, emëron një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.

Në rastin konkret i mituri e as personat tjerë nuk kanë angazhuar mbrojtësin e as që organi i cili ka zhvilluar procedurën ka angazhuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare. Në këtë mënyrë të miturit i është shkelur e drejta në mbrojtës dhe kjo ka ndikuar në marrjen e vendimit të ligjshme dhe të drejtë., sepse kjo ka qenë deklaratë e vetme për identitetin e kryesit.

Duhet të ceket se arsyet e dhëna në aktvendimin e shkallës së dytë se “i mituri është marrë në pyetje pa prezencën e mbrojtësit, por në prezencën e nënës së tij, mirëpo, një deklaratë e tillë e të miturit nuk është marrë për bazë me rastin e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë, pasi që me provat tjera është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i mituri e ka kryer veprën penale e cila i është vënë në barë” janë të paqarta dhe në kundërshtim me përmbajtjen e aktvendimit të shkallës së parë nga i cili rezultojnë se i njëjti është bazuar ekskluzivisht në këtë deklaratë, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 12 të KPP-së.

Për shkak se që të dy aktvendimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga dispozitat e cekura më lart, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmerisë ishte e bazuar, si e tillë u aprovua dhe u vendos që aktvendimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, në të cilën shkelja duhet të mënjanohet dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave që do të administrohen , të merret vendim i ligjshëm.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmerisë ishte e bazuar dhe konform neni 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.501/2023, i datës 17.10.2023.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për të Mitur, PM.nr.100/2022, të datës 31.05.2023, ndaj të miturve: E.K. dhe H.G., është shqiptuar masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve. Organit të kujdestarisë i janë caktuar detyra si në vijim: mbikëqyrja e edukimit të të miturve dhe lehtësimin e qasjes në aftësimin profesional dhe në punësim. Organi i kujdestarisë është detyruar që t'i raportoj gjykatës përkritazi me ekzekutimin e vendimit gjyqësor së paku çdo tre (3) muaj. Shpenzimet e procedurës është vendosur që të paguhet nga mjetet buxhetore të gjykatës, kurse e dëmtuari M.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PAM.nr.77/2023, e datës 07.08.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të miturve: E.K. dhe H.G., ndërsa e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të miturit E.K., avokati E.Q., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që kërkesa të pranohet si e bazuar, ndërsa këto aktvendime të ndryshohen ose të anulohen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.300/2023, e datës 04.10.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të miturit E.K., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe nenit 71 të Kodit të Drejtësisë për Mitur (KDM), si dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatojë se:
- kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësi i të miturit E.K., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se me aktvendimet e lartcëkura janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP, ngase shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, duke ju referuar prindit të të miturit dhe se në këtë rast, duke u bazuar në nenin 27, paragrafi 1 të KDM-së është dashur që të dëgjohet edhe prindi i të miturit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë konstatojë se pretendimet e mbrojtësit të të miturit Elez Kabashi janë të bazuara.

Kjo për faktin se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së lidhur me nenet 6; 27; 42, paragrafi 1; 46 dhe 65, paragrafi 2 të KDM-së, ndërsa kjo shkelje nuk është evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Siç shihet edhe nga shkresat e lëndës, sa i përket mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, nuk janë ftuar dhe nuk kanë prezantuar prindërit e të miturve, pavarësisht se me urdhrin për caktimin e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023, është vendosur që të ftohen edhe prindërit e të miturve, por që nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë që të njëjtit të jenë njoftuar në mënyrë të rregullt.

Nga shkresat e lëndës, shihet se ftesat për pjesëmarrje në seancën e shqyrtimit gjyqësor i janë dërguar Prokurorisë Themelore në Prizren, Shërbimit Sprovues të Kosovës, Qendrës për Punë Sociale, të dëmtuarit, të miturve dhe mbrojtësve të tyre, mirëpo prindërve të të miturve nuk ju kanë dërguar ftesa për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, edhe pse një gjë e tillë është parashikuar në dispozitat përkatëse të KDM-së.

Kështu, në nenin 42, paragrafi 1 të KDM-së është parashikuar se *“Prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari kanë të drejtë ta shoqërojnë të miturin në të gjitha procedurat dhe nga ata mund të kërkohej që të marrin pjesë nëse kjo është në interes të të miturit”*, në nenin 46, paragrafi 1 të KDM-së është parashikuar se *“Ftesa për pjesëmarrjen e të miturit në procedurë i dorëzohet personalisht dhe përmes prindit, prindit adoptues ose kujdestarit të tij”*, kurse në nenin 65, paragrafi 2 të KDM, është parashikuar se *“Përveç personave të paraparë me dispozitat e Kodit të procedurës penale, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, përfaqësuesi i organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesi i shërbimit sprovues thirren në shqyrtimin gjyqësor. Mosparaqitja e personave të tillë nuk e pengon gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor”*.

Andaj, bazuar në këto dispozita ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se prindërit e të miturve duhet që të thirren në shqyrtim gjyqësor, mirëpo mos paraqitja e paarsyeshme e tyre nuk do të pengonte gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor.

Ndërsa në rastin konkret, nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë që prindërit e të miturve të jenë thirrur në mënyrë të rregullt për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, e aq më parë, kur në rastin konkret, ndaj të miturve: E.K. dhe H.G., është shqiptuar masa edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë, pa i dëgjuar fare prindërit e të miturve, ashtu siç parashihet në nenin 27, paragrafi 1 të KDM-së.

Në këtë mënyrë, duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të miturit E.K., ndërsa sipas detyrës zyrtare edhe për të miturin H.G., ndërsa vendosi që të anulohen aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë evituar as me aktvendimin

e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë shkeljet e lartcekura, duke i ftuar në mënyrë të rregullt të gjithë personat, duke përfshirë këtu edhe prindërit e të miturve, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore të KDM-së, ndërsa më pastaj të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar në nenin 397 dhe në nenin 436, paragrafi 2. të KPP-së ("*Beneficium Cohesionis*") lidhur me nenin 6 të KDM-së, sipas detyrës zyrtare ka vendosur edhe në dobi të të miturit H.G., edhe pse i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, pasi që arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të miturit E.K., nuk janë të natyrës personale.

-Mbajtja e seancës së kolegjit në gjykatën e apelit të kosovës, pa i njoftuar të miturit, përfaqësuesit e tyre dhe mbrojtësit

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.60/2024, i datës 29.02.2024.

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për të mitur, me aktvendimin PM.nr.31/2022 datë 18 shtator 2023, të miturit: D.J. dhe D.J.1, për veprat penale sulm, parashikuar me nenin 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 185 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK, secilit veç e veç ju ka shqiptuar masën edukative – mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Në procedurën ankimore sipas ankesave të mbrojtësve të miturve D.J e D. J.1, Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur përkritazi me ankesat, me aktgjykimin PAM.nr.117/23 datë 16 nëntor 2023, i ka refuzuar ato si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër aktvendimeve të lartcekura ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të miturit D.J. avokati A.K., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve, me propozim që kërkesa të aprovohet aktvendimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim, apo të ndryshohen ashtu që ndaj të miturit të shqiptohet masa edukative – qortimi gjyqësor dhe i mituri të lirohet nga shpenzimet procedurale.

Ndaj kërkesës së mbrojtësit të të miturit është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën me shkrim KMLP.II.nr.33/2024 datë 31 janar 2024, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të miturit ndër të tjera thekson se në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës nuk ia ka dhënë të drejtën dhe mundësinë të miturit dhe përfaqësuesit të tij që të dëgjohet në mënyrë që çështja shqyrtohet drejtësisht në një proces të rregullt nga gjykata në kuptim të nenit 12 par.2 të Konventës mbi të drejtat e fëmijëve dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Nga shkresat e lëndës rezulton se të miturve: D.J. dhe D.J.1, secilit veç e veç ju është shqiptuar masa edukative – mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kanë ushtruar ankesa mbrojtësit e të miturve për të gjitha bazat ankimore, kurse gjykata e shkallës së dytë e ka mbajtur seancën e kolegjit pa i njoftuar palët për seancë, me arsyetimin se palët nuk janë njoftuar për seancë meqë ndaj të miturve nuk është shqiptuar dënim me burgim për të mitur apo masë institucionale efektive.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka shkelur dispozitën e nenit 390 par.1 të KPP, e cila dispozitë zbatohet edhe për seancën e kolegjit për të mitur në shkallë të dytë. Sipas kësaj dispozite kur të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burgim apo kur ka pretendime që shtrohen për shqyrtime të fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë apo pafajësinë, njoftimi për seancë të kolegjit i dërgohet Prokurorit të Apelit, të dëmtuarit dhe mbrojtësit të tij apo përfaqësuesit të viktimave, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Në rastin konkret pavarësisht faktit se ndaj të miturve nuk është shqiptuar dënim me burgim për të mitur apo masë institucionale efektive, ankesat e parashtruara janë bërë edhe për shqyrtim të fakteve dhe ligjit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të miturve, prandaj konform dispozitës së nenit 390, par.1 të KPP, gjykata është dashur t'i njoftoj të miturit, përfaqësuesit e tyre dhe mbrojtësit, shkelje kjo që ka mundur të ndikojë në mos marrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, për çka kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë u pranua si e bazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë u anulua, kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së dytë për rigjykim.

Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë obligohet ta mënjanojë shkeljen e lartpërmendur, e pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

-Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.615/2013, i datës 29.11.2023.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PM.nr.51/2018 e datës 21.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e mbrojtësit të të miturit U.M., për pushimin e procedurës penale dhe tërheqjes së letër rreshtimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PN.nr.1304/2023 e datës 26.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të miturit U.M., avokat S.R. dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të miturit U.M., avokati S.R., për shkak të shkeljeve esenciale të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoi kërkesën si të bazuar, aktvendimet e kundërshtuar t'i ndryshojë lidhur me të mbrojturin e tij – të mitur tani madhor U.M. dhe të urdhëroi tërheqjen e letër-rreshtimit të urdhëruar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.357/2023 e datës 23.11.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësi të të miturit U.M., avokat S.R., të hudhet si e pajëuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 435 par.1 dhe par.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme.

Gjykata Supreme vlerëson se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur kundër aktvendimeve të lartpërmendura është e papranueshme për faktin se, sipas dispozitës së nenit 432 par.1 të KPP-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë. Ndërkaq, sipas dispozitës së nenit 432 par.4 të KPP-së, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

Në rastin konkret, nuk është fjala për vendim të marrë gjatë procedurës penale e që ka përfunduar me formë të prerë, por për kërkesë për pushimin e procedurës penale dhe tërheqjes së letër-rreshtimit, andaj, bëhet fjalë për një vendim i cili nuk është marrë në procedurë penale dhe për këtë arsye nuk është përmbushur kushti i lartë cekur për lejueshmërinë e paraqitjes së këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Mejreme Memaj

9. NDRYSHIMI I AKTGJYKIMEVE TË INSTANCAVE ME TË ULËTA

Shqyrtim i shkurtër përkitazi me kompetencat e Gjykatës Supreme lidhur me institutet “beneficium cohaesionis” dhe “reformatio in peius”

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është i vetmi mjet juridik në kuadër të mjeteve të jashtëzakonshme juridike për mes të cilës mund të ndryshohen aktgjykimet e instancave me të ulëta, ngase me kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit kërkohet që aktgjykimi i formës së prerë të ndryshohet vetëm sa i përket vendimit lidhur me dënimin.

Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në seancë të kolegjit. Me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë Gjykata Supreme kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon, por duhet gjithmonë të ketë parasysh favoret ndaj të pandehurit që dalin nga institutet “beneficium cohaesionis” dhe “reformatio in peius”- nenit 436 i KPP

9.1 Institutet “beneficium cohaesionis” dhe “reformatio in peius”

Këto institute zbatohen në procedurën penale lidhur me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike dhe janë paraparë në dobi të pandehurit.

Pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë, procedura penale vazhdohet në shkallë të dytë vetëm po qe se palët ushtrojnë ankesë, ngase gjykata e shkallës së dytë asnjëherë zyrtarisht nuk vendos për ndonjë çështje të gjykatës së shkallës së parë, pra, procedura vazhdon në shkallë të dytë vetëm po qe se vendimi i shkallës së parë ankimohet nga personat e autorizuar për paraqitje të ankesës.

Kurse, personat e autorizuar për paraqitje të ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë këtë mund të bëjnë brenda afatit prej tridhjetë (30) nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, dhe të drejtë ankesë kanë prokurori i shtetit, i akuzuari, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit, i dëmtuari ose viktimat dhe mbrojtësi i viktimave apo përfaqësuesi i viktimës.

Vlen të theksohet se gjykimi në shkallë të dytë është stad i veçantë i procedurës penale që dallon nga gjykimi i shkallës së parë, ngase e karakterizojnë metoda tjera dhe specifika, dhe një nga specifikat apo karakteristikat e kësaj procedurë qëndron në faktin se në këtë stad të procedurës vijnë në shprehje e institutet e lartcekura.

Kështu, sipas *dispozitës së nenit 397 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)* “kur me rastin e paraqitjes së ankesës së cilitdo të pandehur, gjykata e shkallës së dytë çmon se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të pandehurit, e që nuk janë të natyrës personale, shkojnë në dobi edhe të ndonjërit nga të bashkëpandehurit i cili nuk ka paraqitur ankesë ose nuk e ka paraqitur në atë drejtim, gjykata vepron sipas detyrës zyrtare sikurse ankesa e tillë të ishte paraqitur edhe nga bashkëpandehuri”.

Pra, instituti “beneficium cohaesionis” apo beneficioni i bashkëngjitjes” është paraparë me kodin e procedurës penale dhe qëllimi i këtij benefiti qëndron në faktin se gjykata është e detyruar që dobitë për të cilat ka konstatuar që ekzistojnë për të pandehurin i cili ka përdorur mjetin juridik, t’i zbatojë edhe ndaj të pandehurve tjerë edhe pse ata nuk kanë paraqitur mjet juridik ose jo në atë drejtim.

Pra, ky institut vjen në shprehje kur shumë persona janë përfshirë me një procedurë penale dhe ndaj tyre është dhënë një aktgjykim, dhe ndonjëri nga të pandehurit me sukses ka ushtruar ankesë kundër atij aktgjykimi, kurse, ka për qëllim sigurimin e barazisë së të pandehurve para ligjit për rrethana të njëjta që nuk janë të natyrës personale.

Me rastin e marrjes së aktgjykimit në shkallë të dytë, në parim çështja penale konsiderohet si çështje e gjykuar, sepse aktgjykimi merr formë të prerë. Mirëpo, në raste të caktuara kodi i procedurës penale parasheh tri shkallëshmerinë apo mundësinë e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së dytë. Sipas dispozitës së nenit 407 par.1 të KPP ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së dytë mund të paraqitet në Gjykatën Supreme kur:

1.1. Gjykata e Apelit shqipton dënim me burgim të përjetshëm ose vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore me të cilin është shqiptuar dënim i tillë;

1.2. Gjykata e Apelit pas shqyrtimit vërteton ndryshe gjendjen faktike nga gjykata themelore dhe aktgjykimin e bazon në gjendjen e tillë faktike të vërtetuar; ose

1.3. Gjykata e Apelit ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të pandehurin.

Ajo çka e karakterizon procedurën penale në shkallë të tretë është fakti se ajo është e njëjtë me procedurën në shkallë të dytë, pra përshtatshëmrisht aplikohen dispozitat që vlejné për procedurën ankimore në shkallë të dytë, por për dallim nga procedura në shkallë të dytë në shkallë të tretë nuk mund të mbahet shqyrtim.

Por, është e rëndësishme të theksohet se instituti “beneficium cohaesionis” vjen në shprehje edhe në këtë fazë të procedurës penale-neni 407 par.4 i KPP.

Ankesa si mjet i rregullt përveç që paraqitet kundër aktgjykimit të shkallës së parë, dhe në raste të caktuara kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, mund të paraqitet edhe kundër aktvendimeve. Në fakt kundër aktvendimeve ose urdhrave të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kundër aktvendimeve ose urdhrave tjera të gjykatës themelore, palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur, në pajtim me nenin 411 të këtij kodi mund të paraqesin ankesë, me përjashtim kur me dispozitat e këtij kodi shprehimisht nuk lejohet ankesë e tillë. Kurse, vetëm ndaj aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk lejohet ankesë.

Në të vërtetë, është e rëndësishme të theksohet se edhe në procedurën ankimore sipas ankesës së paraqitur kundër aktvendimit vjen në shprehje instituti “beneficium cohaesionis” – neni 416 par.8 i KPP

Madje, ky institut vjen në shprehje edhe tek mjetet e jashtëzakonshme juridike respektivisht kërkesa për mbrojtje të ligjshëmrisë. Kështu, sipas dispozitës së nenit 436 par.2 të KPP-kur gjykata supreme e Kosovës vërteton se shkaqet për të cilat ka marrë vendim në dobi të pandehurit ekzistojnë edhe për ndonjërin nga të bashkëpandehurit që nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtje

të ligjshmërisë, vepron sipas detyrës zyrtare sikurse kërkesa e tillë të ishte paraqitur nga personi i tillë.

Instituti **“refermatio in peius - moskeqësimi i pozitës së të pandehurit”**, po ashtu është një beneficion që në procedurën penale i shkon në favor të pandehurit. Kështu, sipas nenit **395 të KPP- në qoftë së është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të pandehurit, aktgjykimi sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.**

Sipas këtij instituti gjykata e mjetit juridik nuk mund ta keqësojë pozitën e të pandehurit duke e ndryshuar në dëm të tij aktgjykimin e kundërshtuar me ankesë e cila është paraqitur në favor të tij.

Gjykata nuk është e lidhur me këtë institut po që se përveç ankesës në dobi të pandehurit ekziston edhe ankesa në dëm të tij. Ndaj me këtë institut i pandehuri sigurohet se, me mjetin juridik të përdorur në dobi të vet, nuk do ta keqësojë pozitën e vet. Pra, moskeqësimi i pozitës së të pandehurit ka të bëjë me situatën kur kundër aktgjykimit është paraqitur ankesa vetëm në dobi të pandehurit, me ç’ rast aktgjykimi nuk mund të ndryshohet në dëm të tij sa i përket cilësimit juridik të veprës penale ashtu edhe sa i përket sanksionit penal.

Vlen te theksohet se ankesa e paraqitur vetëm në dobi të pandehurit përveç beneficionit të bashkëngjitjes dhe ndalesës se moskeqësimit të pozitës së të pandehurit përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe sanksionin penal, e ka edhe një benifit apo dobi për të pandehurin në procedurën ankimore, në rastet kur paraqitet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike apo shkeljes së ligjit penal, që dallon nga ky institut. Ky benifit është efekti shtesë i ankesës, sepse në raste të tilla, ankesa përfshin edhe ankesën kundër vendimit lidhur me dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe konfiskim - neni 396 i KPP-së. Pra, në rastet kur në dobi të dënuarit paraqitet ankesë për shkak të gjendjes faktike, apo shkeljes së ligjit penal dhe nuk kundërshtohet vendimi për dënim atëherë konsiderohet se ankesa është paraqitur edhe kundër vendimit për dënim, nëse është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues konsiderohet se është paraqitur kundër këtij vendimi dhe në rast se kemi të bëjmë me konfiskim konsiderohet se është paraqitur edhe kundër vendimit të konfiskimit. Pra, gjykata e shkallës së dytë është e obliguar që sipas detyrës zyrtare ta shqyrtoj ankesën sikurse ajo të ishte paraqitur kundër vendimit për dënim, vendimit për trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe konfiskim.

Ajo që e karakterizon këtë institut apo ndalesë është fakti se vlen si me rastin e vendosjes përkitazi me mjetin juridik ashtu edhe kur vendoset në rigjykim deri te i cili ka ardhur në bazë të ankesës se paraqitur në dobi të pandehurit.

Kështu, për shembull ne rast se ndaj aktgjykimit të shkallës së parë është paraqitur ankesë vetëm nga mbrojtësi i të pandehurit, dhe gjykata e shkallës së dytë duke vendosur përkitazi me ankesën e aprovon atë, por, e anulon aktgjykimin e shkallës së parë atëherë gjykata e shkallës së parë në rigjykim është e obliguar që ta respektojë këtë institut apo ndalesë, pra, nuk mund ta keqësojë pozitën e të pandehurit sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimit për dënim. Kjo madje parashihet shprehimisht me ligj kështu sipas dispozita e nenit 406 par.4 të KPP (dispozitë kjo që i referohet procedurës së rigjykimit në gjykatën themelore sipas aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë) me rastin e marrjes së aktgjykimit të ri, gjykata themelore detyrohet në ndalesën e paraparë në nenin 395 të KPP.

Në fakt ndalesa “reformatio in peius apo moskeqësimi i pozitës se të pandehurit“, ka karakter absolut, ngase po qe se krijohen kushtet për zbatimin e tij ai vlen deri sa të përfundon procedura penale në atë çështje.

Kjo ndalesë vlen edhe në rastet kur gjykata e shkallës së dytë vendos lidhur me ankesën e paraqitur kundër aktvendimeve të shkallës së parë-neni 416 par.8 i KPP, dhe vlen edhe në procedurën penale në shkallë të tretë në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesën e paraqitur ndaj aktgjykimit të shkallës së dytë. Vlen të theksohet se për dallim prej kodeve të mëparshme të procedurës, tani me kodin e procedurës penale që është në fuqi që nga 17.02.2023, nuk parashihet shprehimisht që ndalesa “reformacion in peius” vlen edhe në këtë stad të procedurës. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se në këtë stad të procedurës përshtatshmerisht zbatohen dispozitat që vlejné në procedurën ankimore në gjykatën e apelit është me se e kuptueshme se kjo ndalesë vjen në shprehje edhe në këtë stad të procedurës jo vetëm me rastin e vendosjes së ankesës se paraqitur vetëm në dobi të pandehurit, por edhe kur vendoset në rigjykim deri të i cili ka ardhur në bazë të ankesës se paraqitur në dobi të pandehurit.

Kjo ndalesë vjen në shprehje edhe tek kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. Kështu, me kod shprehimisht parashihet se kur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë paraqitet në dobi të pandehurit, Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes detyrohet me ndalesën e paraparë me nenin 395 të këtij kodi (nenit 436 i KPP). Po ashtu, në qoftë se aktgjykimi i formës së prerë anulohet sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur në dobi të pandehurit, me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykata detyrohet në ndalesën e paraparë me nenin 395 të këtij kodi.

9.2 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me ndalesën “reformacion in peius” dhe zbatimin e institutit “beneficium cohaesionis”

Në praktiken gjyqësore nuk janë të rralla rastet kur aktgjykimet e instancave me te ultë janë ndryshuar për shkak të shkeljes së ndalesës së “reformatio in peius” qoftë nga gjykata e shkallës së parë qoftë nga ajo e shkallës së dytë, por nuk janë të rralla rastet kur Gjykata Supreme e aplikon beneficionin e bashkëngjitjes.

Kështu, në këtë përmbledhje do të paraqiten dy raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës ku objekti shqyrtimi ka qenë shkelja e institutit “reformatio in peius”, dhe aktgjykimet e formës së prerë janë ndryshuar si pasojë e shkeljes së këtij instituti, dhe një rast ku Gjykata Supreme e ka aplikuar beneficionin e bashkëngjitjes.

Në rastin e parë gjykatat kanë shkelur këtë parim sa i përket vendimit për dënim, kurse në rastin e dytë lidhur me cilësimin juridik dhe kjo është bërë pasi që Gjykata Supreme i ka kthyer çështjet në rigjykim sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kurse, tek rasti i beneficionit të bashkëngjitjes kjo Gjykatë i ka anuluar aktgjykimet e kundërshtuara me kërkesë edhe për të bashkëpandehurin i cili nuk ka ushtruar kërkesë për faktin se aktgjykimi i shkallës së parë përkritazi me vendimin për dënim nuk ishte arsyetuar fare për të dobi të pandehurit.

- *Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi Pml.nr.281/2024*

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës së mbrojtësit të dënuarit Sh. L. për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ëPKR.nr.4/2024 datë 5 shkurt 2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda PAKR.nr.143/2024 datë 12 prill 2024 ndryshohet vetëm sa i përket vendimit për dënim, ashtu që Gjykata e Supreme e Kosovës të dënuarin për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 28 të KPRK për të cilën është shpall fajtor e gjykon me katër (4) vite e dy (2) muaj burgim, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2023 e tutje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.132/2023 datë 11 gusht 2023, të pandehurin Sh. L., e ka shpall fajtor për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 28 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2023 e tutje.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.546/2023 datë 19 tetor 2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit dhe aktgjykimin e lartcekur e ka ndryshuar vetëm sa i përket vendimit për dënim, ashtu që të pandehurin për veprën penale për të cilën është shpall fajtor e ka gjykuar me katër (4) vite e dy(2) muaj burgim, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2023 e tutje. Ankesa e prokurorit është refuzuar, kurse ajo e të dëmtuarit nuk është shqyrtuar.

Kundër aktgjykimeve të lartcekura kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit dhe kjo Gjykatë me aktgjykimi Pml.nr.579/2023 datë 6.12.2023, e ka aprovuar kërkesën e mbrojtësit dhe aktgjykimet janë anuluar dhe çështja është kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin PKR.nr.4/2024 datë 5 shkurt 2024, të pandehurin Sh. L., e ka shpall fajtor për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.3 lidhur me nenin 28 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2023 e tutje.

Në procedurën ankimore, sipas ankesës së prokurorit dhe mbrojtësit të pandehurit Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur përkitazi me ankesat me aktgjykimin PAKR.nr.143/2024 datë 12 prill 2024, i ka refuzuar ankesat si të pabazuara dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Ndaj aktgjykimeve të lartcekura, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit, avokati Florim Shefqeti, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të aprovet kërkesa si e bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.158/2024 datë 13 maj 2024, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është pjesërisht e bazuar.

Vlen të theksohet se pretendimet e mbrojtësit se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk janë të bazuara. Siç del nga shkresat e lëndës i dënuari është akuzuar për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, parashikuar me nenin 173 par.1 nënpar.1.3 të KPRK. Në seancën fillestare datë 22.03.2023, mbrojtësi bazuar në dokumentacionin mjekësor – fletë lëshimin nr.418 datë 27.07.2022 dhe shkresat tjera mjekësore kishte kërkuar që të behet ekspertiza psikiatrike e të dënuarit, të cilën kërkesë gjykata e kishte aprovuar. Sipas ekspertizës të bëre nga grupi prej katër ekspertëve të Institutit të Psikiatriisë Forenzike të Kosovës rezulton se i dënuari nuk vuan nga çrregullimi i kualitetit psikotik, nuk ka prapambetje mendore dhe në momentin e kryerjes së veprës penale për të cilën ngarkohet, aftësia e të kuptuarit dhe kontrollit të veprimeve të veta ka qenë e ruajtur. Po ashtu, rezulton se ekspertet kanë pas në dispozicion dokumentet mjekësor në të cilat thirret mbrojtësi në kërkesë. Pastaj, në seancën e radhës pasi që i dënuari është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet e tij në procedurë, e ka pranuar fajësinë dhe mbrojtësi është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të dënuarit.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes për këtë gjykatë nuk është e qartë se në çka e mbështet pretendimin mbrojtësi se nuk është vlerësuar në masë të duhur përgjegjësia penale e të dënuarit, dhe i njëjti është dashtë të dërgohet në trajtim të detyrueshëm mjekësor-konform dispozitës së nenit 506 të KPP, kur kihet parasysh fakti se nuk kemi të bëjmë me një person të paafitë mendërisht që në kohen e kryerjes së veprës penale lëngonte nga ndonjë sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme apo person me aftësi të zvogëluar mendore, e duke pasur parasysh këtë as gjendja shëndetësore nuk mund të trajtohet si rrethanë posaçërisht lehtësuese, prandaj pretendimet në këtë drejtim kjo gjykatë i konsideron jo serioze dhe krejtësisht të pabazuara.

Kurse, pretendimet sa i përket shqiptimit të dënimit nga gjykata e shkallës së dytë në rigjykim, e që kanë të bëjnë me bazën ligjore të zbatimit të ligjit penal kjo gjykatë i vlerësoj si të bazuara, për këto arsye:

Siç del nga shkresat e lëndës fillimisht i dënuari me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë PKR.nr.132/2023 datë 11 gusht 2023, është gjykuar me pesë (5) vite burgim. Në procedurën ankimore aktgjykimi i lartcekur është ndryshuar nga gjykata e shkallës së dytë sipas ankesës së mbrojtësit të dënuarit vetëm sa i përket vendimit për dënim, ashtu që ajo gjykatë të dënuarin për veprën penale për të cilën është shpall fajtor e ka gjykuar me katër (4) vite e dy(2) muaj burgim, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.01.2023 e tutje, ankesa e prokurorit është refuzuar, kurse ajo e të dëmtuarit nuk është shqyrtuar.

Aktgjykimet e lartcekura kjo gjykatë me aktgjykimin Pml.nr.579/2023 datë 6.12.2023 i ka anuluar dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim në shkallë të parë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Në rigjykim i dënuari përsëri me aktgjykimin PKR.nr.4/2024 datë 5 shkurt 2024, shpallet fajtor dhe dënohet me pesë (5) vite burgim, kurse gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin PAKR.nr.143/2024 datë 12 prill 2024, duke vendosur përkritazi me ankesën e prokurorit dhe mbrojtësit të dënuarit i refuzon ato si të pabazuara dhe aktgjykimin e shkallës së parë e vërteton.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se në rigjykim është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, respektivisht është shkelur parimi “referomacio in peus” sepse i dënuari është dënuar me dënim me të rëndë në rigjykim. Në këtë rast është shkelur dispozita e nenit 439 par.4 i KPP. Sipas par.1 të këtij neni në qoftë se aktgjykimi i formës së prerë anulohet dhe lënda kthehet për gjykim të ri, procedura merr për bazë aktakuzën e mëparshme ose atë pjesë të saj që ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykimit. Sipas par.4 të të njëjtit nen me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykata detyrohet me ndalesën e paraparë me nenin 395 të këtij kodi (dënim dhe ricilësimi i veprës penale nuk mund të ndryshohet në dëm të tij). Pra, gjykata e shkallës së dytë duke e vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë e ka shkel parimin e lartcekur- respektivisht ligjin penal në dëm të dënuarit.

Vlen të theksohet se për veprën penale për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 173 par.1 nënpar.1.3 të KPRK për të cilën është gjykuar i dënuari parashihet dënimi jo me pak se dhjetë vite burgim ose me burgim të përjetshëm. Në rastin konkret vepra ka mbetur në tentativë dhe sipas dispozitës së nenit 28 par.3 të KPRK-së, personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet, sikur ta kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet. Kurse, sipas dispozitës së nenit 71 të KPRK, gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit, kur ligji e parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet, kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë që qëllimi i dënimit mund të arrihet dhe me shqiptimin e dënimit me të butë ose në rastet kur kryesi e pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë. Sipas dispozitës së nenit 72 të KPRK kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 të KPRK nëse për veprën penale për të cilën është paraparë si masë me e ultë dënimi me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet, dënimi mund të zbutet deri në pesë (5) vjet. Meqë i dënuari, e ka pranuar fajësinë gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 72 të KPRK e ka gjykuar me pesë vite burgim, kurse gjykata e shkallës së dytë e ka ulë dënimin në katër (4) vite e dy (2) muaj burgim, pra, gjykata e shkallës së dytë e ka shkel ligjin penal në favor të dënuarit – neni 385 par.1 nënpar.1.5 të KPP, sepse e ka ulur dënimin nën minimumin e veçantë.

Mirëpo, pavarësisht faktit se gjykata e shkallës së dytë e ka shkelur ligjin penal në favor të dënuarit, pasi që është anuluar aktgjykimi i formës së prerë, në rigjykim me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykatat detyrohen me ndalesën e paraparë me nenin 395 të këtij kodi (dënimi dhe ricilësimi i veprës penale nuk mund të ndryshohet në dëm të tij), pra, gjykata e shkallës së dytë nuk ka mundur të veprojë në dëm të dënuarit, prandaj kjo gjykatë e aprovoj kërkesën në këtë pjesë dhe i ndryshojë aktgjykimet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

• *Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi Pml.nr.193/2024*

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit Xh. Sh., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, P.nr.145/2022 datë 19

prill 2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i përgjithshëm PA1.nr.1045/2023 datë 18 dhjetor 2023 ndryshohet vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimit për dënim, ashtu që Gjykata e Supreme e Kosovës gjen se në veprimet e të dënuarit Xh. Sh. të përshkruara në dispozitivin të aktgjykimit formohen elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK, dhe për këtë veprë e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 1000(njëmijë)€, dhe urdhëron që ky dënim mos ekzekutohet me kusht, që i dënuari në afat prej një (1) viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të mos kryej veprë penale.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, me aktgjykimin P.nr.145/2022 datë 19 prill 2023, të pandehurin Xh. Sh., e ka shpall fajtor për veprën penale, lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, i cili me pëlqimin e të pandehurit konform dispozitës së nenit 47 të KPRK i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej një mijë e gjashtë (1600)€. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë gjobën, atëherë do të ekzekutohet dënimi me burgim.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr. 1045/2023 datë 18 dhjetor 2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit, kurse e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjytimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit avokati Agron Kryeziu, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësor, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Ndaj kërkesës së mbrojtësit është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën me shkrim KMLP.II.nr.112/2024 datë 26 mars 2023, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është pjesërisht e bazuar.

Mbrojtësi në kërkesë pretendon se në këtë çështje janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur por pretendon se me asnjë provë nuk është argumentuar fakti se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale dhe e tërë akuza është ngritë në bazë të supozimeve të dëmtuarit. Në rigjykim nuk është vepruar sipas sugjerimeve të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, vetëm është ndryshuar baza ligjore e veprës penale nga lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 në lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së duke shkelur të drejtën e të pandehurit dhe dëgjimit të dëmtuarit dhe policit hetues për të vërtetuar faktin se ku ka mbetur boks i hekurit si provë në të cilën është thirrur gjatë 11 seancave gjyqësore , por

gjyqtari i çështjes kalon në fjalën përfundimtare dhe e shpall aktgjykimin. Ndërsa, këto shkelje nuk janë trajtuar as nga gjykata e shkallës së dytë veçanërisht ndryshimi i bazës ligjore nga ana e prokurorit dhe atë pas pesë viteve.

Vlen të theksohet se pretendimet e mbrojtësit përkitazi me bazën ligjore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale i referohen bazës ligjore - vërtetimi i gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për të cilën bazë kërkesa nuk mund të ushtrohet – neni 432 i KPP) ngase kontestohen gjendja e fakteve, dhe këto pretendime nuk qenë objekt shqyrtimi nga ana e kësaj gjykate.

Kurse, pretendimet sa i përket cilësimit të veprës penale në rigjykim, e që kanë të bëjnë me bazën ligjore të zbatimit të ligjit penal kjo gjykatë i vlerësoj si të bazuara, për këto arsye:

Siç del nga shkresat e lëndës i dënuari me akuzë është akuzuar për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK. Përkitazi me këtë vepër penale nga gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin P.nr.125/2019 datë 31.01.2022, është shpall fajtor dhe gjykuar, i cili aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë PA1.nr.441/2022 datë 23.06.2022.

Aktgjykimet e lartcekura kjo gjykatë me aktgjykimin Pml.nr.315/2022 datë 17.08.2022 i ka anuluar dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim sipas detyrës zyrtare për faktin se kishte dyshime se a ishte vërtetuar elementi cilësues i veprës penale nga par.2 i nenit 188 - mjeti që mund të shkaktojë lëndim të rënd trupor (goditja me boks të hekurit).

Në rigjykim prokurori në fillim të shqyrtimit gjyqësor sipas vërejtjeve të kësaj gjykate dhe bazuar në dëshminë e të dëmtuarit e kishte ricilësuar veprën penale në lëndim të lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.14 të KPRK, dhe pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin P.nr.145/2022 datë 19 prill 2023 për veprën penale të lartcekur e ka dënuar me 90 ditë burgim, i cili me pëlqimin e të dëmtuarit i është zëvendësuar me gjobë në shumë prej njëmijë e gjashtëqind (1600)€, i cili aktgjykim është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin PA1.nr.1045/2023 datë 18 dhjetor 2023.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes kjo gjykatë vlerëson se në rigjykim është shkelur ligji penal në dëm të dëmtuarit respektivisht është shkelur parimi “referomacio in peus” sepse vepra penale është ricilësuar në një vepër penale me të rëndë sesa ajo për të cilën ishte akuzuar dhe shpall fajtor i dënuari. Kështu, për veprën penale për të cilin i dënuari fillimisht është akuzuar dhe shpall fajtor- lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK është paraparë dënimi deri në tri (3) vjet burgim, kurse për veprën penale të ricilësuar në rigjykim e për të cilën edhe është shpall fajtor i dënuari, nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK parashihet dënimi me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet. Meqë, minimumi i dënimit është i përcaktuar me 3 muaj del se i dënuari është shpall fajtor për një vepër penale me të rëndë. Në këtë rast është shkelur dispozita e nenit 439 par.4 i KPP. Sipas par.1 të këtij neni në qoftë se aktgjykimi i formës së prerë anulohet dhe lënda kthehet për gjykim të ri, procedura merr për bazë aktakuzën e mëparshme ose atë pjesë të saj që ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykitimit. Sipas par.4 të të njëjtit nen me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykata detyrohet me ndalesën e paraparë me nenin 395 të këtij kodit (dënim dhe ricilësimi i veprës penale nuk mund të ndryshohet në dëm të tij). Pra, ricilësimi i veprës penale dhe shpallja fajtor për këtë vepër penale është bërë në dëm të dëmtuarit.

Duke pasur parasysh të lartcekurat, në kontekst të vlerësimit të provave të administruara në këtë çështje juridiko penale kjo gjykatë i vlerësoj veprimet e të dënuarit në raport me të dëmtuarin dhe gjeti se nuk është argumentuar fakti se i dëmtuari është goditur me boks nga i dënuari, por nga provat e administruara del se është goditur me grusht, për çka edhe veprimet e të dënuarit i cilësoj si vepër penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK.

Ndërsa, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i kanë vlerësuar gjykatat me rastin e matjes së dënimit veçanërisht faktin se vepra penale është ricilësuar në një vepër penale dukshëm me të butë dhe nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë e gjatë, kurse nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë të dhëna se i dënuari ka ra ndesh me ligjin, kjo gjykatë të dënuarit për veprën penale të ricilësuar sipas kësaj gjykate, i shqiptoj dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të tij, dhe se me të do të mund të ndikohet në parandalimin e tij nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij, por edhe në parandalimin e të tjerëve nga kryerja e veprave penale, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK.

- ***Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi Pml.nr.494/2024***

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit E. Xh. për mbrojtjen e ligjshmërisë, e sipas detyrës zyrtare edhe për dënuarin M. B., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i përgjithshëm, P.nr.1058/2021 datë 23 shkurt 2022, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1163/2022 datë 25 prill 2024, dhe çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i përgjithshëm, P.nr.1058/2021 datë 23 shkurt 2022 të dënuarit E. Xh. e M. B., për veprën penale falsifikimi i dokumenteve në vazhdimësi, parashikuar me nenin 390 par.3 lidhur me par.2 lidhur me nenin 31 e 77 të KPRK-së, janë gjykuar secili me nga dhjetë (10) muaj burgim, në të cilin dënim të dënuarit E. i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej 9.01.2020 deri me 31.01.2020, kurse të dënuarit M. prej 24.10.2019 deri me 23.12.2019, dhe dënim me secili në shumë prej 2000 (dymijë) €, të cilën janë obliguar që ta paguajnë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën të njëjtat do tu zëvendësohen me dënime me burgim ashtu që në një ditë burgimi do tu llogariten nga 20 € të gjobës.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1163/2022 datë 25 prill 2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të dënuarve.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit E. Xh., avokati G. R. (i angazhuar në këtë fazë), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës kërkesën ta aprovojë, ashtu që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.288/2024 datë 12 gusht 2024 ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, par.1 lidhur me nenin 436, par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë pretendon se aktgjykimi i shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 pika 1.10 të KPP, sepse aktgjykimin i mungon plotësisht arsytimi. Me tej mbrojtësi citon arsyetimin e faqes 6 të aktgjykimin të shkallës së dytë dhe pretendon se kemi të bëjmë me një arsyetim gjeneral nga i cili nuk thuhet asnjë fjalë e vetme për të mbrojturin e tij, përveç arsyetimit të gjykatës lidhur me veprimet e të dënuarit M. B.. Sipas mbrojtësit nuk është thënë asnjë fjalë e vetme lidhur me shkeljen e nenit 262 të KPP, faktin se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban arsye për faktet vendimtare dhe a është dëshmia e dëshmitarit D. M. e dhënë në procedurë e pranueshme, kur kihet parasysh fakti se i njëjti në këtë procedurë ka pasur dy role si dëshmitar dhe si i akuzuar. Kurse, sipas mbrojtësit edhe tek arsytimi i vendimit për dënim nuk përmendet fare emri i të mbrojturit të tij sikurse te mos ishte fare subjekt në këtë procedurë penale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e lartcekura janë të bazuara. Është e evidente se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1, nënpar.1.10 të KPP, ngase i mungon plotësisht arsytimi përkritazi me të dënuarin E. Xh. ashtu siç me të drejtë pretendon mbrojtësi në kërkesë. Por, me rastin e shqyrtimit të kërkesës përkundër faktin se mbrojtësi e kundërshton vetëm aktgjykimin e shkallës së dytë kjo gjykatë ka vërejtur se edhe aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje nga neni 384 par.2, nënpar.2.7 të KPP ngase nuk është hartuar konform nenit 369 të KPP-së përkritazi me vendimin për dënim.

Për shkak të rëndësisë së vendimit mbi dënimin ligji mbi procedurën penale obligon shprehimisht gjykatën që në arsyetimin e aktgjykimin t'i shtrojë rrethanat që i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Kështu, sipas dispozitës së nenit 369 par.8 të KPP kur i akuzuari dënohet me burgim, arsytimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë me veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim me të rëndë nga ai i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo heqë dënimin, të shqiptoj dënim alternativ apo ndonjë masë ose të konfiskohet dobia pasurore e fituar me vepër penale.

Kështu, nga arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë del se gjykata fare nuk e ka arsyetuar vendimin e shqiptuar ndaj të dënuarve, me çfarë është udhëhequr dhe çfarë rrethanash ka pasur parasysh me rastin e caktimit të dënimit, prandaj, aktgjykimi i shkallës së parë si i tillë është juridikisht i paqëndrueshëm, i pa qenë dhe as që ka mund të vlerësohet nga gjykata e shkallës së dytë kur nuk janë dhëne arsye në këtë pjesë, kurse çuditërisht gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se *“gjykata e shkallës së parë drejt i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, madje ka cituar rrethana që as që janë konstatuar dhe vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë”*.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet t’i evitoj shkeljet e theksuara, t’i administrojë edhe një herë provat e propozuara, e pastaj pas vlerësimit të drejtë dhe logjik të secilës provë veç e veç dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën të merret vendim në këtë çështje juridiko penale.

Kjo gjykatë bazuar në nenin 397 dhe nenin 436 par.2 të KPP (*beneficium cohaesionis*), sipas detyrës zyrtare e anuloi aktgjykimin edhe përkitazi me të dënuarin M. B. sepse arsyet të cilat ka marrë vendim në dobi të dënuarit E. Xh. nuk janë të natyrës personale.

Në fakt kjo gjykatë nuk ka mund ta anulojë aktgjykimin vetëm përkitazi me të dënuarin E.XH që ka ushtruar kërkesë ngase bëhet fjalë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat nuk mund të ndahen, dhe anulimi i pjesshëm do të kishte për pasojë gjykimin e drejtë në këtë çështje juridiko penale.

9.3 Konfiskimi i pasurisë që është dobi pasurore e veprës penale dhe mjetit të veprës penale

Është parim juridik i përgjithshëm se askush se nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme. Veprat penale të cilat derivojnë dobi pasurore janë të shumta, prandaj është parashtruar çështja që kjo dobi pasuror apo ky përfitim të merret, për çka kjo çështje është rregulluar me ligjin penal. Sipas kësaj dispozite dobia pasurore merret nga secili që atë dobi e ka fituar. Kjo ka të bëjë para se gjithash me kryerësin e veprës penale, por edhe me bashkezekutorin, ndihmësin, shtytësin, pra, dobia pasurore merret edhe nga personat tjerë në të cilët ajo dobi është bartur apo u është dhënë në ruajtje. Bazë e aplikimit është realizim i parimit se me sjellje kundërligjore nuk mund të fitohen të drejta.

Baza e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale është rregulluar me kodin penal respektivisht - nenin 92 të KPRK. Sipas par.1 të kësaj dispozite pasuria ose mjeti që është përfituar me vepër penale konfiskohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Sipas par.2 të të njëjtit nen kur konfiskimi nuk është i mundur në pajtim me par.1 të këtij neni, gjykata urdhëron kryerësin e veprës për të paguar një shumë të barasvlershme ose gjykata do të konfiskojë çdo pasur të të pandehurit me vlerë të barasvlershme siç është përcaktuar me kodin e procedurës penale. Pra, me këtë dispozitë përpos që përcaktohet baza ligjore e konfiskimit të dobisë pasurore, përcaktohet se si të veprohet në rastet kur kryerësit nuk është e mundur të i konfiskohet dobia pasurore.

Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale nuk ka për qëllim vetëm të bëjë të pamundshëm fitimin pasuror me kryerje të veprës penale, por edhe të mbrojë edhe pasurinë e qytetarëve kur ajo është dëmtuar me vepër penale

Për tu konfiskuar dobia pasurore e përfituar me vepër penale se pari duhet kuptuar se çka nënkuptohet me konfiskim dhe çka nënkupton dobia pasurore, çka ajo përfshin.

Me përkufizimin që përcaktohet me kodin e procedurës penale konkretisht nenit 19 par.1 nënpar.1.35 të KPP konfiskimi nënkupton konfiskimin e përhershëm të pasurisë, i urdhëruar me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente në pajtim me këtë kod.

Kurse, sipas nënpar.1.39 të të njëjtit nen me dobi pasurore të veprës penale nënkuptohet:

-pasuritë e fituara drejtpërdrejtë nga veprimet që përbëjnë vepër penale;

-të hollat e fituara drejtpërdrejtë nga veprimet që përbëjnë vepër penale;

-dobia e tërthortë: çfarëdo pasurie e cila është transformuar apo konvertuar, në tërësi apo pjesërisht, në pasuri tjetër, përfshirë riinvestimin e mëpastajmë apo transformimin e fitimeve të drejtpërdrejta. Gjithashtu përfshin të ardhurat apo dobitë tjera që rrjedhin nga vepra penale, apo nga pasuria në të cilën apo me të cilën dobitë e tilla janë transformuar, konvertuar apo përzier;

-të hollat e fituara në mënyrë të tërthortë si rezultat i veprimeve që përbëjnë vepër penale, përfshirë por pa u kufizuar në interesin apo rritjen e vlerës për shkak të kursit të këmbimit valutor, dhe mjetet e fituara në mënyrë të tërthortë nuk do të mund të krijoheshin pa të hollat e përshkruara në nënparagrafin 1.39.2. të këtij neni;

-pasuritë e blera me të hollat të cilat janë fituar në mënyrë të tërthortë në pajtim me nënparagrafin 1.39.4. të këtij neni;

-qfarëdo përparësie materiale që rrjedh si rezultat, apo në lidhje me veprën penale për të cilën personi është shpallur fajtor; ose

- nëse të hollat të cilat janë dobi pasurore e veprës penale përzihen me të hollat të cilat nuk janë dobi pasurore e veprës penale, cilado shumë e cila mund të konfiskohet dhe e cila është e barabartë apo më e ultë se shuma e dobisë pasurore konsiderohet dobi pasurore e veprës penale.

Me kodin e tanishëm penal që ka hyrë në fuqi në vitin 2019 nuk parashihet konfiskimi si dënim plotësues dhe as marrja e sendit, për dallim nga kodi penal i vitit 2013. Në fakt, vlen të theksohet se kodi penal i vitit 2013 në mënyrë taksative e numronte konfiskimin si dënim plotësues, por nuk bënte fjalë për të si dënim plotësues, ndersa, kur flitej për secilin dënim plotësues veç e veç bënte fjalë për marrjen e sendit – neni 69 i KPRK-së.

Sipas kësaj dispozite sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat ishin rezultat i kryerjes së veprës penale konfiskoheshin. Pra, ekzistonin tri grupe të sendeve të cilat sipas kësaj dispozite (e cila është shfuqizuar) mund të merreshin:

- a. Sendet që janë përdorë për kryerjen e veprës penale;
- b. Sendet që janë dedikuar për kryerjen e veprës penale
- c. Sendet që janë rezultat i veprës penale

a) Sendet që janë përdor për kryerjen e veprës penale (instrumenta sceleris) ishin të gjitha ato sende me të cilat kryerësi është sherbyer me rastin e kryerjes së veprës penale me të cilat e ka kryer veprën pra, sendi i cili është në raport të caktuar kauzal me veprën e kryer. Sende të tilla janë armët me të cilat kryhen vrasjet, mjetet me të cilat janë falsifikuar paratë (letra, ngjyra, makinat dhe mjetet e tjera për kryerjen e kësaj vepre.

b) Sendet të cilat janë dedikuar për kryerjen e veprës penale ishin ato me të cilat kryerësi ka pasur për qëllim të kryejë veprën penale. Pra, këto janë sende të cilat kryerësi i ka siguruar, aftësuar apo i ka mbaruar por të cilat nuk i ka përdorur. Marrja e ketyre sendeve vinte në shprehje kur kryesi me sigurimin apo aftësimin e mejeve për kryerjen e veprës penale ka realizuar veprimin përgatitor ndëshkues, por edhe në rastin kur kryesi ka kryer ndonjë vepër penale mirëpo nuk e ka përdorur sendin e dedikuar për kryerje. Në raste të tilla gjykata në çdo rast duhet të përcaktojë se a ka qenë pikërisht fjala për sende të cilat kanë qenë të dedikuara për kryerjen e veprës penale. Sende të tilla mund të jenë psh. armët e ndryshme, revolja, pushka, mandej mjetet të cilat shërbejnë për evitimin e pengesave si qelësat, kallauzët, vegla të ndryshme. Ajo që i përcakton këto sende nuk është natyra e tyre por qëllimi i përdorimit të tyre.

c) Sendet që janë rezultat i veprës penale (producta selaris) konsideroheshin paratë e vjedhura, droga e prodhuar, dokumentet e falsifikura, shkresat pornografike.

Sipas pikëpamjes sime apo këndvështrimit tim tani me kodin penal mungon baza ligjore e konfiskimit të sendeve të përdorura apo të dedikuara apo qe janë rezultat i veprës penale. Sepse me kodin e tanishëm, neni 92 i Kodit emertohet “*konfiskimi i mjeteve dhe dobisë pasurore të veprave penale*”, por par.1 i referohet pasurisë ose mjetit që është përfitur me vepër penale, madje është mjaft e diskutueshme edhe terminologjia që i referohet këtij kapitulli (VII)-

“Konfiskimi i instrumentalitet dhe dobisë pasurore të veprave penale”. Në të vërtetë bazë ligjore për konfiskimin e sendeve të përdorura në kryerjen e veprës penale tani është vetëm kodi i procedurës penale.

Pavarësisht kësaj, tani me kodin e ri të procedurës penale sendet që përdoren në kryerjen e veprës penale përkufizohen si mjet i veprës penale, e që sipas nenit 19 par.1 nënparë1.38 të KPP mjet i veprës penale nënkupton:

-Pasuritë e përdorura për kryerjen e ndonjë veprimi në drejtim të veprës penale, përfshirë pasurinë e përdorur për të udhëtuar në apo nga vendi në të cilin është kryer ndonjë element i veprës penale, pavarësisht nëse mjetet e transportit janë përshtatur për të lehtësuar kryerjen e veprës penale ose jo;

- Pasuria e cila ka ofruar strehimin e nevojshëm për kryerjen e veprimit në mbështetje të veprës penale, përfshirë, por pa u kufizuar në sendet e përdorura për strehimin e personave të trafikuar, narkotikëve, apo substancave tjera ilegale;

- Pasuritë e përdorura, në tërësi apo pjesërisht, për të financuar ndonjë veprim apo veprime në mbështetje të veprës penale; ose

-Pasuritë, në tërësi apo pjesërisht, të nevojshme për të lehtësuar ndonjë veprim në mbështetje të veprës penale.

Pra, kjo dispozitë ka përcaktuar kriteret lidhur me mjetin e veprës penale respektivisht se kur një send konsiderohet se është përdorur në kryerjen e veprës penale, e që në çdo rast është çështje faktike e cila vlerësohet nga gjykata varësisht nga provat që ofron prokurori.

Para se gjykata të mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë që ishte mjet, prokurori i shtetit duhet ta provojë në shqyrtimin gjyqësor se pasuria ishte mjet i veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar- neni 270 i KPP. Mirëpo, nese pasuria që është mjet i veprës penale i takon një pale të tretë, pasuria mund të konfiskohet vetëm nëse pasuria ka qenë dhuratë e njiollosur ose pala e tretë e dinte ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorur si mjet.

Vlen të theksohet fakti se dobia pasurore e fituar me vepër penale konfiskohet pas dënimit të të pandehurit për vepër penale (neni 269 i KPP), madje me këtë dispozitë përcaktohet se në rastet kur ndonjë pasuri tërësisht apo pjesërisht nuk është në dispozicion atëherë kryerësi detyrohet të paguajë shumën e të hollave apo vlerën monetare, e cila i përgjigjet dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Mirëpo, e rëndësishme është se para se gjykata të mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë që është dobi pasurore, prokurori i shtetit e provon në shqyrtimin gjyqësor se pasuria është dobi pasurore e veprës penale për të cilën është dënuar- neni 271 i KPP.

Nuk janë të rralla rastet kur kryerësi dobinë pasurore të fituar me vepër penale ta bartë në persona tjerë në formë dhurate apo në ndonjë formë tjetër por edhe tek anëtarët e familjes. Për këtë arsye me ligj është paraparë se dobia pasurore mund të konfiskohet edhe kur bartet tek personat tjerë.

Për tu konfiskuar dobia pasurore që është bartë tek personat tjerë duhet plotësuar kushti që ajo pasuri e transferuar të jetë dhuratë e njiollosur. Kodi i procedurës penale respektivisht neni 19 par.1 nënpar.1.40 i KPP me dhuratë të njiollosur nënkupton:

-pasuritë e transferuara palës së tretë, që janë mjet apo dobi pasurore e veprës penale, kurdo pas datës së kryerjes së veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar, për kundërshtëpërblim vlera e së cilës nuk ishte dukshëm më e ulët se vlera e tregut në kohën e transferimit. Pavarësisht nga çmimi i paguar, personi ka marrë dhuratë të njollosur nëse e ka ditur ose është dashur të dyshonte se pasuria ishte mjet ose dobi pasurore e veprës penale ose nëse pala e tretë e ka ditur ose është dashur të dyshonte se qëllimi i transferimit ose blerjes ishte të shmanget konfiskimi;

Pala e tretë mund të jetë si person fizik ashtu edhe juridik.

Nga ajo që u tha me lartë del se pasuria që i nenshtrohet konfiskimit është **dobia pasurore e fituar me vepër penale, mjeti i veprës penale dhe dhurata e njollosuar**, që kjo pasuri sipas kodit të procedurës penale është emertuar si pasuri e specifikuar - nenpar.1.36 i nenit 19 të KPP

Edhe tek pasuria që është dhuratë e njollosur, para se gjykata ta urdherojë konfiskimin prokurori i shtetit duhet ta provojë në shqyrtimin gjyqësor se pasuria është dhuratë e njollosur

Kurse, e rëndësishme është se gjatë shqyrtimit gjyqësor prokurori i shtetit, i pandehuri dhe pala e tretë që pretendon se ka interes juridik mbi pasurinë e specifikuar kanë mundësinë që të bëjnë parashtrësia dhe të paraqesin prova, të marrin në pyetje dëshmitarë dhe të paraqesin prova në mbështetje apo në kundërshtim të ndonjë kërkesë, apo të paraqesin prova në gjykatë nga eksperti i kualifikuar financiar lidhur me konstatimet faktike nga gjykata- neni 274 i KPP.

9.4 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me konfiskimi i pasurisë që është dobi pasurore e veprës penale dhe mjetit të veprës penale

Në praktiken gjyqësore ka raste kur aktgjykimet e instancave me të ultë janë ndryshuar për shkak së konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale dhe mjeti i veprës penale nuk është bërë konform dispozitave ligjore për çka sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë janë kthyer qoftë dobia pasurore apo mjeti i veprës penale.

Në vijim do të paraqiten dy raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës ku objekti shqyrtimi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka qenë dobia pasurore e fituar me vepër penale dhe mjeti i veprës penale.

Në rastin e parë i dënuari e kishte pranuar fajësinë, por i ishin konfiskuar shuma prej 300€ si dobi pasurore e fituar me vepër penale, por përkundër faktit se me akuzë prokurori kishte propozuar konfiskimin e tyre nuk kishte ofruar prova se janë përfituar si rezultat i kryerjes së veprës penale.

Në rastin e dytë, behet fjalë për konfiskimin e automjetit që i takonte personit të të tretë, e që në të vërtetë ishte përdorur për kryerjen e veprës penale, por, automjeti ishte marrë me qira nga kompania për dhënie me qira të automjeteve me seli në Sllovaki, dhe pala e tretë që i takonte automjeti nuk ishte dëgjuar në gjykatë edhe përkundër kërkesës që ia kishte bërë me shkrim gjykatës për kthim të automjetit. Prokurori kishte kërkuar konfiskimin e tij si mjet që është përdorur për kryerjen e veprës penale, por meqë nga shkresat e lëndës (as nga akuzat) nuk rezultonte asnjë indikacion se automjeti i marrë ë me qira ka qenë dhuratë e njollosur ose pala e tretë e dinte ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorur si

mjet, Gjykata Supreme i ka ndryshuar aktgjykimet në pjesën konfiskuese sa i përket këtij automjeti.

- ***Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi Pml.nr.655/2023***

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së mbrojtësit të dënuarit N. B., ndryshohet aktgjykimi i i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i krimeve të Rënda, 2023:004928 datë 18 korrik 2023 dhe ai i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.569/2023 datë 13 tetor 2023 vetëm në pjesën konfiskuese ashtu që mjetet monetare në shumë prej 300(treqind)€ dhe atë bankënota prej 200€ me numër serik NB3405185154 dhe bankënota prej 100€ me numër serik RB4755816869, i kthehen të dënuarit.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i krimeve të Rënda 2023:004928 datë 18 korrik 2023, i dënuari N. B. për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267 par.1 të KPRK, është gjykuar me pesë (5) vite burgim, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 5.01.2023 e tutje, dhe dënim me gjobë në shumë prej 4000 (katërmijë)€. Në rast se i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë apo nuk mundet i njëjti do t'i zëvendësohet me burgim ashtu që në një ditë burgimi do t'i llogariten 20€ të gjobës. Ndaj të dënuarit janë konfiskuar 40 qese plastike me substancë narkotikë të llojit “marihuanë” me peshë të përgjithshme prej 42.506 (katër dhjetë e dy e pesëqind e gjashtë) kg, si objekt i veprës penale; mjetet monetare në shumë prej 300(treqind)€ dhe atë bankënota prej 200€ me numër serik NB3405185154 dhe bankënota prej 100€ me numër serik RB4755816869 si mjete të fituara me kryerjen e veprës penale; vetura e markës “VË Passat 3C”, me targa 01-766-QD, çelësi dhe leja e qarkullimit të automjetit si dhe një telefon mobil i llojit “Iphone 13”, me numër IMEI 356706920666577, me sim kartelë 049-166-662 si mjete të kryerje së veprës penale.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të dënuarit me aktgjykimin PAKR.nr.569/2023 datë 13 tetor 2023 e ka refuzuar atë si të pabazuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit avokati Tahir Rrecaj, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohet një dënim me i butë, dhe ti kthehen sendet e konfiskuara.

Ndaj kërkesës se mbrojtësit është përgjigjur Prokurori i Shtetit me parashtrësën KMLP.II. nr.381/2023 datë 13 dhjetor 2023 me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkrësat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa është pjesërisht e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësi pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje të ligjit penal, nga neni 385 lidhur me nenin 387 par.1 e 2 të KPRK, lidhur me nenin 69, 70, 71 e 72 të kodit penal, sepse, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, qëllimin e dënimit, peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit, nuk e kanë caktuar drejtë sanksionin penal ndaj të mbrojturit të tij, dhe po ashtu nuk i kanë zbatuar fare dispozitat mbi zbutjen e dënimit, që ka pasur për pasojë që dënimi i shqiptuar me burgim të jetë tepër i rëndë dhe jo proporcional, ndërsa edhe vendimi mbi konfiskimin e sendeve është bërë me shkelje të dispozitave të nenit 287 par.5 të KPRK, sepse sendet e konfiskuar nuk janë përfitur me vepër penale dhe nuk janë mjete për prodhim, shpërndarje apo transport të substancave narkotike që janë objekt shqyrtimi. Gjykatat me rastin e marrjes së vendimit për dënim, nuk i kanë vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese të cilat kanë qenë të shumta në anën e të mbrojturit të tij si: pranimi i fajësisë, pendimi i thellë për veprimet e tij, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër penale, moshën e tij të re, e posaçërisht faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale. Nuk është vlerësuar si rrethanë lehtësuese mungesa e dëmit, kurse janë mbivlerësuar rrethanat rënduese. Sipas mbrojtjes dashja drektë për kryerjen e kësaj vepre penale është element qenësor që përbën figurën e kësaj vepre penale, e përfshirë brenda minimumit dhe maksimumit të dënimit të paraparë për këtë vepër penale dhe nuk mund të merret si rrethanë rënduese. Kurse, gabimisht është vlerësuar si rrethanë rënduese fakti se i mbrojturi i tij me parë ka qenë i dënuar, sepse asnjëherë me parë nuk ka qenë i dënuar për vepra penale të narkotikëve, por për dy vepra tjera penale. Vetëm në rastet kur personi i akuzuar, edhe me parë ka kryer vepra të njëjta penale merret si rrethanë rënduese një fakt i tillë, e që në rastin konkret kjo nuk ekziston. Edhe rrezikshmëria e lartë shoqërore e veprës penale nuk ka mundur të trajtohet si rënduese kur kihat parasysh fakti se narkotikët e llojit “marihuane” hyjnë në grupin e narkotikëve të butë, nuk paraqesin rrezik të lartë për shëndetin dhe jetën e përdoruesve të tyre dhe ky lloj i narkotikëve është legalizuar për kultivim dhe përdorim në shumë vende të botës, kurse edhe sasia e narkotikut është mbivlerësuar si rrethanë. Pranimi i fajit është rrethanë posaçërisht lehtësuese dhe me ndikim vendimtar për zbutjen e dënimit, kurse dënimi i shqiptuar nuk është në pajtim me politikën ndëshkimore për raste të tilla nga gjykatat vendore.

Sa i përket pjesës konfiskuese mbrojtësi në kërkesë pretendon se vendimi mbi konfiskimin është tërësisht i pabazuar. Te mbrojturit të tij i janë konfiskuar mjete monetare në shumë prej 300€, automjeti i markës “VÉ Passat 3C”, me targa 01-766-QD, çelësi dhe leja e qarkullimit të automjetit, si dhe një telefon mobil i llojit “IPHONE 13”, me numër IMEI 356706920666577, me SIM kartel nr.049/166662, si mjete të kryerje së veprës penale. Mirëpo, sipas mbrojtësit prokurori i shtetit gjatë fazës së hetimeve nuk e ka vërtetuar se parat janë mjete të fituara me kryerje të veprës penale, dhe nuk ka asnjë provë të vetme se këto para janë përfitur me kryerje të veprës penale aq me tepër kur i mbrojturi i tij nuk ka arritur që t'i vë në qarkullim narkotikët, pra, t'i shes, dhe rrjedhimisht del pa asnjë mëdyshje se këto para nuk janë rezultat i i veprës penale. Pastaj, për tu konsideruar një automjet si mjet i kryerjes së veprës penale, automjeti duhet të ri dizajnohet për këtë qëllim. Në automjete, zakonisht punohet një “bunker” në një vend të përshtatshëm ku nuk mund të vërehet lehtë, pa një kontroll të detajuar, dhe aty vendosen me qëllim fshehje, sendet e ndaluara. Në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur, ngase narkotikët që janë objekt shqyrtimi janë gjetur në pjesën e pasme prapa ulëses së shoferit. Po ashtu, gjykata gabimisht ka gjetur se telefoni mobil i llojit “IPHONE 13”, është mjet i kryerjes së veprës penale, ngase asnjë provë e bashkangjitur akuzës nuk vërteton se ky telefon është përdor për kryerje të

veprës penale për të cilën është shpall fajtor, disa sms-ve të cilave iu referohet prokuroria nuk vetëtojnë se ato kanë çfarëdo lidhje me kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e lartcekura përkitazi me shkelje të ligjit penal sa i përket vendimit për dënim nuk janë të bazuara. Vendimi mbi dënimin mund të kundërshtohet me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në kuadër të shkeljes së ligjit penal vetëm në rast se gjykatat me rastin e marrjes së vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale kanë tejkaluar kompetencat ligjore e që paraqet shkelje të ligjit penal (neni 385 par.1 nënpar.1.5 i KPP).Gjykata i tejkalon kompetencat ligjore kur shqipton dënimin i cili nuk mund të shqiptohet nën minimumin e veçantë ose mbi maksimumin apo shqipton lloj tjetër të dënimit i cili nuk mund të shqiptohet për atë vepër penale. Në rastin konkret gjykatat kanë shqiptuar dënim me burgim në kuadër të minimumit dhe maksimumit të dënimit me burgim që parashihet me ligj për veprën penale për të cilën i dënuari është shpall fajtor.

Pastaj, vendimi mbi dënimin mund të kundërshtohet me kërkesë edhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase gjykata kur cakton dënim me burgim duhet të jep arsye për të gjitha rrethanat të cilat i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit veçanërisht duhet të jep arsye se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim me të rëndë se dënimi i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin, të shqiptojë dënim alternativ ose masën për trajtim të detyruar rehabilitimi ose të konfiskohet dobia pasurore e fituar me vepër penale. Mirëpo, mbrojtësi në këtë drejtim nuk i kundërshton aktgjykimet për shkak se gjykatat nuk kanë dhënë arsye përkitazi me faktet vendimtare për dënimin e shqiptuar, por për faktin se i kanë nënvlerësuar rrethanat lehtësuese, kurse gabimisht i kanë vlerësuar ato rënduese. Qëndron fakti se disa nga rrethanat rënduese janë vlerësuar gabimisht (dashja, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale sepse janë rrethana që vlerësohen dhe kihen parasysh me rastin e matjes së dënimit por nuk mund të trajtohen rënduese), por ky fakt është pa ndikim në ligjshmërinë e vendimit, ngase përkundër këtij fakti ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim me burgim në kuadër të minimumit dhe maksimumit të paraparë ligjor, për veprën penale për të cilën është gjykuar (neni 267 par.1) parashihet dënim me gjobë dhe burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vit. Pastaj, pavarësisht faktit se i dënuari e ka pranuar fajësinë dhe rrethanave tjera lehtësuese të cekura në kërkesë konform dispozitës së nenit 71 të KP është në diskrecion të gjykatës që të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj. Kurse, a është adekuat apo ne proporcion me peshën e veprës penale dënimi i shqiptuar në kuadër të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të konstatuara dhe vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë është çështje që mund të kundërshtohet me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë dhe vetëm shkalla e dytë ka diskrecion që ta ndryshoj vendimin në këtë drejtim, por vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit nuk mund të kundërshtohet me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, prandaj pretendimet në këtë drejtim kjo Gjykatë i konsideron si të pabazuara.

Kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësit sa i përket pjesës konfiskuese përkitazi me automjetin e konfiskuar. Siç del nga aktgjykimet e kundërshtuara automjeti “VË Passat 3C”, është konfiskuar si mjet për kryerjen e veprës penale. Kurse, sipas dispozitave të kodit të procedurës penale që ka hyrë në fuqi me 17 shkurt 2023 e që ishte në fuqi edhe në kohën kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur përkitazi me këtë çështje, mjet i veprës penale (neni 19 nënpar.1.38.1,38.2,1.38.3)– nënkupton: pasuritë e përdorura për kryerjen e

ndonjë veprimi në drejtim të veprës penale, përfshirë pasurinë e përdorur për të udhëtuar në apo nga vendi në të cilin është kryer ndonjë element i veprës penale, pavarësisht nëse mjetet e transportit janë përshtatur për të lehtësuar kryerjen e veprës penale ose jo; pasuria e cila ka ofruar strehimin e nevojshëm për kryerjen e veprimit në mbështetje të veprës penale, përfshirë, por pa u kufizuar në sendet e përdorura për strehimin e personave të trafikuar, narkotikëve, apo substancave tjera ilegale; pasuritë e përdorura, në tërësi apo pjesërisht, për të financuar ndonjë veprim apo veprime në mbështetje të veprës penale; pasuritë, në tërësi apo pjesërisht, të nevojshme për të lehtësuar ndonjë veprim në mbështetje të veprës penale pra, sipas kësaj dispozitë nuk kërkohet që mjeti i transportit të ri dizajnohet për këtë qëllim, kurse nga transkriptet e sms-ve del se ky telefon është përdorur për kryerjen e veprës penale, prandaj pretendimet në këtë drejtim kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara.

Kurse, pretendimet përkitazi me mjetet monetare të cilat janë konfiskuar si mjete të fituara me kryerje të veprës penale kjo gjykatë i vlerëson si të bazuara. Në fakt nga provat në bazë të të cilave është ngritë akuza nuk rezulton se mjetet monetare janë përfitur nga kryerja e veprës penale, prandaj kjo gjykatë e aprovoj kërkesën në këtë drejtim dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- ***Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi Pml.nr.384/2023***

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës së mbrojtëset të dënuarit A. Rr. për mbrojtje të ligjshmërisë ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.17/2022 datë 7 tetor 2022 dhe ai i Gjykatës së Apelit të Kosovës, APS.nr.47/2022 datë 19 prill 2023 vetëm përkitazi me pjesën konfiskuese, ashtu që vetura “Audi A4”, avant karvan, me targa sllovaqe Nr.853-KP, ngjyrë hiri me numër të shasisë ĘAUYYYFJ5JA217564, libreza e kësaj veture dhe çelësi i saj, i kthehen kompanisë “FENRIR S.R.O.”

I. Kërkesa e mbrojtësit të dënuarit A. Rr. në pjesët tjera dhe ato të mbrojtësve të të dënuarve A. B., S. R., F. R. refuzohen si të pabazuara.

II. Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së tretë (dëmtuar)-FENRIR S.R.O, hedhet si e palejuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.17/2022 datë 7 tetor 2022, të pandehurit T.S., A. B., S. R., F. R. dhe A. Rr. i ka shpall fajtor për shkak se si bashkekzekutor e kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK, kurse të pandehurin A. B. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPP, për të cilën i ka gjykuar:

-T. S. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej tri (3) viteve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.12.2020 deri me 7.10.2022, dhe me gjobë në shumë prej 5000 (pesëmijë)€, të cilën gjobë është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit apo me pëlqimin e tij mund ta paguajë edhe me këste;

-A. B. për veprën e parë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) viteve e tetë(8) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 21.12.2020 deri me 7.10.2022, dhe dënime me gjobë në shumë prej 2500 (dy mijë e pesëqind) €, për veprën e dytë penale e ka gjykuar me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)€ dhe konform dispozitës së nenit 76 par.2 nënpar.2.2 të KPRK e ka gjykuar me dënim unik me gjobë në shumë prej 3000(tremijë)€, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit apo me pëlqimin e tij mund ta paguajë edhe me këste;

-S. R. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) viteve e tetë (8) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 16.12.2020 deri me 7.10.2022, dhe dënime me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë)€, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit apo me pëlqimin e tij mund ta paguajë edhe me këste;

-F. R. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve e gjashtë (6) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.12.2020 deri me 30.11.2022, dhe dënime me gjobë në shumë prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) €, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit;

-A. Rr. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) viteve e tetë (8) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 12.12.2020 deri me 7.10.2022, dhe dënime me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë)€, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit apo me pëlqimin e tij mund ta paguajë edhe me këste;

Konform dispozitës së nenit 92, 115, 282, 283 e 284 të KPP të pandehurve ju janë konfiskuar:

- sasia e narkotikut e llojit “marihuanë” me peshë të përgjithshme prej 47796.03.025 gram

-të pandehurit T.S. i janë konfiskuar para të gatshme 3x100€ me numër serik UB3088698032; EA685013617 dhe EA2491143283; para të gatshme 1x50 me numër serik MD 1969642178; para t; gatshme 1x20 me numër serik UD5310264852; para të gatshme 1x20 franga zvicerane me numër serik 15M3328912; para të gatshme 1x10 franga zvicerane me numër serik 16C0607794; para të gatshme një dollar; një telefon “Samsung 6S”- ngjyrë; e zezë; me kartelë IPKO; një telefon “Samsung 10S”- ngjyrë e zezë, pa kartelë; çelësi i veturës 689-KS-510; librezë e veturës CRA 1173592 në emër të Arif Bektshit; dy kontrata-autorizime të veturave; vetura e tipit “Ford” me targa 689 -KS- 510, ngjyrë e bardhë, me numër të sasisë ËFOUXXTTPU5B14539 në emër të Arfi Bektshit;

-të pandehurit F. një telefon “IPHONE”- ngjyrë e zezë me numër të IPKO-së 049457-204; një telefon “Nokia” i zi; një çelës i veturës Opel Vectra, me targa 693-KS-351; para të gatshme 4x20 me numër serik UC443424886, NA3903762718, UE5536208645 dhe EC1912639616; para të gatshme 1x10 me numër serik YA3542806871; para të gatshme 4x20 me numër serik UC4434243886, NA3903762718, UE5536208645 dhe EC1912639616; para të gatshme 1x5 me numër serik NB2012776848; IPKO; vetura Opel Vectra B18 karvan, ngjyrë hiri me targa 693-KS-351, me numër të sasisë ËOLOJBF35x7056431 dhe me numër të librezës 1179575;

-të pandehurit A.RR., para të gatshme 3x100€ me numër serik NA5214051316, EA7051080628, UB3078112583; para të gatshme 1x200€, me numër serik UC7041821158; para të gatshme 3x5 me numër serik NC6410415329, NC4825038266 dhe MA152563427; libreza e veturës “Audi A4 Avant”- karvan me targa të Sllovakisë nr.853-KP, ngjyrë hiri me nr. DKJ93052; polisa e sigurimit me nr.3410978, dhe numër serik 4480007-180; një çelësi i veturës “Audi” nr.853-KP; vetura “Audi A4- avant”- karvan, me targa sllovaqe dhe numër të shasisë ĚAUZZZF45JA217564; Iphone 12, me numër IMEI 356692115871505;

-të pandehurit A.B., një armë gjahu- dy tytshë me numër serik 158231, 32 copë fishek të kalibrave të ndryshëm.

Aktgjykimi i lartcekur në procedurën ankimore me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti special APS.nr.47/2022 datë 19 prill 2023 është ndryshuar sipas ankesave të mbrojtësve të pandehurve T. S., F. R. e A. Rr.dhe sipas detyrës zyrtare vetëm përkitazi me pjesën konfiskuese dhe të pandehurit T. S. i janë kthyer sendet e konfiskuara si: para të gatshme 3x100€ me numër serik UB3088698032; EA685013617 dhe EA2491143283; para të gatshme 1x50 me numër serik MD 1969642178; para të gatshme 1x20 me numër serik UD5310264852; para të gatshme 1x20 franga zvicerane me numër serik 15M3328912; para të gatshme 1x10 franga zvicerane me numër serik 16C0607794; para të gatshme një dollar; një telefon “Samsung 6S”- ngjyrë; e zezë; me kartelë IPKO; një telefon “Samsung 10S”- ngjyrë e zezë, pa kartelë; çelësi i veturës 689-KS-510; libreza e veturës CRA 1173592 në emër të A. B.; dy kontrata-autorizime të veturave; vetura e tipit “Ford” me targa 689 –KS- 510, ngjyrë e bardhë, me numër të sasisë ĚFOUXXTTPU5B14539 në emër të A. B.; të pandehurit F. R. para të gatshme 4x20 me numër serik UC4434243886, NA3903762718, UE5536208645 dhe EC1912639616; para të gatshme 1x5 me numër serik NB2012776848; kurse të pandehurit A. Rr. i janë kthyer para të gatshme 3x100€ me numër serik NA5214051316, EA7051080628, UB3078112583; para të gatshme 1x200€, me numër serik UC7041821158; para të gatshme 3x5 me numër serik NC6410415329, NC4825038266 dhe MA152563427. Ankesat e mbrojtësve të pandehurve në pjesët tjera janë refuzuar si të pabazuara, po ashtu është refuzuar si e pabazuar edhe ankesa e prokurorit dhe ato të mbrojtësve të pandehurve A. B. dhe S. R..

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të dënuarit A. B. avokati Mentor Neziri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që kërkesa të aprovohet, aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim apo të ndryshohen apo të ndryshohen ashtu që i dënuari të shpallet fajtor për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale nga enni 267 par.2 të KPRK dhe ndaj tij të shqiptohet një dënim me i butë kurse të lirohet nga akuza për veprën penale nga neni 366 par.1 të KPRK;

-mbrojtësi i të dënuarit F. R. avokati Taulant Aliu, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë;

-mbrojtësi i të dënuarit S. R., avokati Granit Ramadani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësor me propozim që kërkesa të

aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë;

-mbrojtësi i të dënuarit A. Rr. avokati Ramiz Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë;

-mbrojtësi i palës së dëmtuar FENRIR S.R.O me nr.51762978, avokati Nebih Troshupa, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet, aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen sa i përket pjesës konfiskuese përkitazi me automjetin Audi A4 Avant, dhe në këtë pjesë çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë.

Ndaj kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë është përgjigjur Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.231/2023 datë 7 gusht 2023 me propozim që kërkesa e mbrojtësit të dëmtuarës të hedhet si e papranueshme, kurse kërkesat e mbrojtësve të dënuarve të refuzohen si të pazabuarra.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

- kërkesat e mbrojtësve të dënuarve A. B., S. e F. Ri nuk janë të bazuara, kërkesa e të dënuarit A. Rr. është e bazuar vetëm sa i përket pjesës konfiskuese, kurse, kërkesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës FENRIR S.R.O nuk është e lejuar.

a) pretendimet e mbrojtësve në kërkesa lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vlerësimi i kësaj gjykate përkitazi me to.

Mbrojtësi i të dënuarit A. B. në kërkesë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar me nenin 384 par.1 nënpar.1.8, 1.10 e 1.12 të KPP, sepse në arsyetimi të aktgjyqimeve gjykatat nuk kanë paraqitë arsye për çdo pikë të aktgjykimit përkitazi me të mbrojturin e tij, nuk janë paraqitë qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara apo të pavërtetuara, e në mënyrë të veçantë nuk është bërë vlerësimi lidhur me saktësinë e provave kundërhënëse dhe arsyet të cilat janë bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike - veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të dënuarit. Gjykata e shkallës së parë përkitazi me të mbrojturin e tij tërësisht e ka bazuar aktgjykimin në mbrojtjen e të dënuarit Fidan të dhënë në polici dhe prokurori i cili ka qenë shumë kontrovers dhe e ka mohuar në shqyrtimet gjyqësore dhe me këtë është shkelur dispozita ligjore e nenit 262 par.2 të KPP-së. Me tej mbrojtësi citon dëshmitë e dëshmitarëve të këtij rasti si dëshminë e E.B, A.S, F.B, K.H, të ekspertes së balistikës Shaha Shala dhe mbrojtjet e të dënuarve me pretendim se gjykatat nuk i kanë vlerësuar drejt mbrojtjet e të dënuarve në raport me provat e administruara.

Përkitazi me këtë bazë ligjore pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve S.R e F.R janë të njëjta. Kështu, këta mbrojtës pretendojnë se është shkelur dispozita e nenit 384 e KPP-së sepse aktgjykimet janë bazuar në prova të papranueshme, ngase si prova kryesore lidhur me vendosjen janë marrë përgjimet telefonike dhe prokuroria dhe gjykata nuk ju kanë ofruar provë se të njëjta janë lejuar siç e parasheh kodi i procedurës penale. Gjatë shqyrtimeve gjyqësore kanë kërkuar që

t'i lejohet dëgjimi i audio përgjimeve por kjo kërkesë nuk është marrë parasysh dhe kanë pasur qasje vetëm në transkriptimin e tyre nga policia. Gjykata vendimin e saj e ka bazuar në deklaratën e të dënuarit F.R. të dhënë në polici, kurse në të njëjtën deklaratë i njëjti nuk është i njoftuar se është i liruar nga dëshmia në raport me prindin e tij, kurse konform nenit 128 par.1 nënpar.1.2 të KPP – deklarata është e papranueshme kur personi është i liruar nga dëshmia, por nuk është vënë në dijeni për këtë ose shprehimisht nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë, apo kur udhëzimi dhe heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal.

Kurse, mbrojtësi i të dënuarit A.RR pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar me nenin 384 par.1 nënpar.1.9, 1.10 dhe par.2 pika 2.4, 2.5, 2.6 e 2.7 të KPP-së, sepse dispozitivit e aktgjykimit janë të pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyetimin e tyre, në to nuk janë paraqit arsyet lidhur me faktet vendimtare. Ka kundërtënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimet e aktgjyqimeve dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës. Aktgjykimet nuk janë përpilua konform dispozitës së nenit 369 të KPP-së dhe mbështeten në prova të papranueshme, dhe si të tilla janë të paligjishme.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e lartcekura nuk janë të bazuara. Vlen të theksohet se mbrojtësi i të dënuarit A. B. edhe pse i kundërshton aktgjykimet e kundërshtuara për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga arsyetimi del se e konteston gjendjen faktike, për të cilën bazë kërkesa nuk mund të paraqitet, ngase kontestohen konkludimet e gjykatave në bazë të provave të administruara. Kurse, mbrojtësi i të dënuarit A.RR në ketë drejtim vetëm parafrazon dispozitat ligjore (nenin 384 par.1 nënpar.1.9, 1.10) por nuk jep arsye se ku manifestohen këto shkelje. Megjithatë, kjo gjykatë i vlerësoj ato dhe gjeti se janë të pabazuara. Aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të pretenduara në kërkesa, ngase në arsyetimin e tyre janë paraqitur arsye të duhura dhe të drejta mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridiko-penale, ato kanë mbështetje në prova të administruara dhe janë arsyetuar drejt dhe plotësisht në pajtim me nenin 370 par.7 të KPP-së, kështu që arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë për qëndrimin dhe vlerësimin e saj përkritazi me provat e administruara dhe mbrojtjet e të dënuarve si të drejta i ka aprovuar edhe shkalla e dytë dhe si të tilla i aprovon edhe kjo Gjykatë. Ndërsa, a e ka bazuar gjykata vendimin e saj në deklaratën e dhënë të të dënuarit F. në polici dhe prokurori do të behet fjalë në kuadër të pretendimeve përkritazi me shkeljen e ligjit penal

Kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve S.R e F. R dhe A.RR se aktgjykimet mbështeten në prova të papranueshme. Në fakt këto pretendime jo vetëm që janë të pabazuara por edhe të paqarta sepse nuk mund të kuptohet se në çka konsistojnë ato. Konform dispozitës së nenit 436 par.1 të KPP kjo gjykatë me rastin e vendosjes mbi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon, por nuk mund të supozoj se çka ka dashur të thotë paraqitësi i kërkesës. Konform dispozitave ligjore nenit 251 par.2 të KPP provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky kod ose dispozita të tjera të ligjit parashikojnë kështu. Mbrojtësit në kërkesa nuk theksojnë se cilat prova janë të papranueshme dhe me rastin e marrjes së tyre cila dispozitë është shkelur. Kurse, nga fakti se nuk ju është lejuar dëgjimi i audio përgjimeve dhe kërkesa e tyre është refuzuar nuk mund të pretendohet se ato janë të papranueshme, ngase me dispozita ligjore nuk parashihet një gjë e tillë. Në fakt përgjimet siç del nga shkresat e lëndës janë marrë konform dispozitave ligjore, dhe meqenëse audio përgjimet janë transkriptuar dhe mbrojtësit i kanë pas në dispozicion është fare pa rendësi fakti se gjykata

ka refuzuar propozimin e tyre që të dëgjohen audio përgjimet. Ndërsa, është krenjtësisht i pabazuar pretendimi se është shkelur dispozita e nenit 128 par.1 nënpar.1.2 të KPP, sepse i dënuari Fidan nuk është njoftuar se është i liruar nga dëshmia në raport me prindin e tij, ngase kjo dispozitë vlen për dëshmitarët e jo edhe për të pandehurit, i pandehuri Fidan në polici dhe prokurori nuk është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, por e ka dhënë mbrojtjen e tij si i pandehur, për çka kjo gjykatë pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim i konsideron edhe jo serioze. Në fakt konform dispozitës së nenit 122 par.3 të KPP-së informatat e dhëna nga i pandehuri mund të përdoren si dëshmi në gjykatë, por, sa këto informata janë të mbështetshme respektivisht provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi është çështje që vlerësohet nga Gjykata.

b) pretendimet e mbrojtësve përkritazi me shkeljet e ligjit penal dhe vlerësimi i kësaj gjykatë përkritazi me këto pretendime

Mbrojtësi i të dënuarit A.B përkritazi me këtë bazë ligjore pretendon se është shkelur ligji penal dëm të dënuarit pasi që ai nuk ka ndërmarr kurrfarë veprimesh që do të mund të konsideroheshin veprime inkriminuese që përmbushin elementet e veprës penale nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Nga deklaratat e të bashkakuarve del se i dënuari ka pas kontakt vetëm me të dënuarin T., kurse me S. e F. nuk ka pas raporte të mira për shkak të problemeve familjare, dhe ai inkriminohet vetëm në bazë të deklaramit të dënuarit Fidan në polici dhe prokurori. Sipas këtij mbrojtësi gjykatat e kanë shkel ligjin penal në dëm të këtij të dënuari kur e kanë shpall fajtor për veprën penale të armëmbajtjes, nga neni 366 par.1 të KPRK-së për shkak se eksperti i balistikës ka deklaruar se arma ka qenë jofunksionale dhe është dashur që të behet riparimi i saj për tu bërë funksionale dhe arma ka qenë e vjetër dhe nuk ka pjesë që e njëjta të riparohet për shkak se është e modelit të vjetër dhe pjesët për këtë armë mundtë gjinden vetëm në Turqi. Ky mbrojtës në kuadër të shkeljes së ligjit penal e kundërshton edhe vendimin për dënim, me pretendim se nuk janë vlerësuar drejt rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe po të ishin vlerësuar drejt pretendon se do të shqiptohej një dënim me i butë.

Edhe përkritazi me këtë bazë ligjore pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve S.R e F.R janë të njëjta. Kështu, në kërkesa theksohet se me asnjë provë relevante nuk është vërtetuar se të dënuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallë fajtor, sepse nga vetë aktgjykimi dhe arsyetimi nuk formohen elementet qenësore për ekzistimin e kësaj vepre penale. Të dënuarit nuk i kanë konsumuar elementet e kësaj vepre penale ngase narkotikun nuk e kanë shpërnda, ble dhe as nuk e kanë shitur dhe transportuar. Sipas mbrojtësit të dënuarit Fidan i mbrojturi i tij vetëm e ka transportuar duke shfrytëzuar mendjelehtësinë dhe moshën e re nga personat që janë përballur edhe me herët me këso vepra penale me të cilët është bashkakuar. Po ashtu në kuadër të kësaj baze ligjore këta mbrojtës i kundërshtojnë edhe vendimet e shqiptuara.

Kurse, mbrojtësi i të dënuarit A.Rr. përkritazi me këtë bazë pretendon se është shkelur ligji penal në dëm të mbrojturit të tij për shkak se i mbrojturi i tij ka mundur të shpallet fajtor për veprën penale ndihmë nga neni 33 të KPRK në kryerjen e veprës penale nga neni 267 par.1 të KPRK. Sipas këtij mbrojtësi edhe konfiskimi i veturës se tij është bërë në kundërshtim me nenin 92 të KPRK sepse, sipas këtij neni mund të konfiskohet vetëm pasuria e përfutur me veprë penale.

Edhe përkritazi me këtë bazë ligjore mbrojtësit e të dënuarve nuk kanë dhënë arsye të qarta se në çka konsistojnë këto shkelje, kurse arsyet e dhëna në kërkesa i referohen gjendjes së fakteve, ngase, cilave prova dhe pse gjykata ua ka falë besimin, e cilave jo, madje qoftë ai edhe i gabuar

ka të bëjë me gjendjen faktike, për të cilën bazë kërkesa nuk mund të ushtrohet, mirëpo, meqë gjendja faktike e determinon edhe zbatimin e ligjit penal kjo gjykatë i vlerësoj ato dhe gjeti se e nuk e venë në dyshim saktësinë e fakteve të vërtetuar me aktgjykime respektivisht janë të pabazuara.

Vlen të theksohet se pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve se nuk është provuar se të mbrojturit e tyre kanë kryer veprën penale nuk janë të bazuara. Nga shkresat e lëndës del se të dënuarit janë njohur mes veti me përjashtim të A.RR. I dënuari T. të dënuarin A. e ka djalë halle, S. e ka djalë F., kurse A. e ka dhëndër S..

Nga provat e administruara, dëshmitë e dëshmitarëve, masat e fshehta teknike –të përgjimit dhe vëzhgimit dhe provat tjera të theksuara me detajisht në aktgjykimin e shkallës së parë dhe vet mbrojtja e të dënuarve del qartë se sasia e narkotikut e llojit marihuanë në peshë prej 47 kg është siguruar në Maqedoni dhe është sjellë në Kosovë nga persona të panjohur fillimisht në fshatin Lubishtë dhe prej këtij fshati deri në Prishtinë. Personi që nga personat e panjohur e kishte siguruar sasinë e narkotikut ishte T., personi që e kishte transportuar këtë sasi të narkotikut me veturë prej fshatit Lubishtë deri në Prishtinë ishte F., dhe personi që duhej t'i dorëzohej sasia e narkotikut ishte A.. Transporti i kësaj sasive të narkotikut deri në Prishtinë është berë nën përcjelljen edhe të dënuarve A. B. dhe S. R.. Nga përgjimet telefonike vërtetohet se të dënuarit kanë vepruar në bashkëkryerje në këtë ngjarje, fillimisht ishinn marrë vesh i dënuari Tair me të dënuarin Arifi, e pastaj me të dënuarin S. e F., dhe me 12.12.2020 rreth orës 19:30 në oborrin e SHSKUK respektivisht në parkingun e Entit Higjienik janë zënë në flagrancë tre të dënuarit T. S., F. R. e A. Rr., derisa po e bartnin sasinë e narkotikut nga vetura “Opel Vectra” në veturën “Audi”, të cilën e ka vozitur i dënuari A.

Në kuadër të kësaj gjendje faktike kjo gjykatë vlerëson se janë tërësisht të pabazuara pretendimet se nuk është provuar se të dënuarit e kanë kryer veprën penale. Qëndron fakti se i dënuari F. e ka pranuar veprën penale në polici dhe prokurori, por të pabaza janë pretendimet se gjykata e ka mbështet aktgjykimin në pranimin e këtij të dënuari, sepse gjendja faktike sikurse me lartë është vërtetuar nga provat materiale – masat e fshehta të përgjimit – bisedat e përgjuara telefonike në mes të dënuarve, dëgjimi i dëshmitarëve dhe mbrojtja e të gjithë të dënuarve, dhe konkludimet e gjykatave përkitazi me përgjegjësen penale të të dënuarve i mbështet edhe kjo gjykatë, dhe meqë gjykatat në këtë drejtim janë dhënë arsye të qarta të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë nuk e shih te nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimë në këtë drejtim.

Pretendimet e mbrojtësittë dënuarit A se në veprimet e këtij të dënuari qëndrojnë elementet e veprës penale të ndihmës në veprën penale nga neni 267 par.2 të KPP-së janë të pabazuara. Kjo për faktin se sipas dispozitës së nenit 33 par.2 të KPRK-së ndihma për të kryer veprë penale përfshin, por nuk kufizohet në dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënie në dispozicion të mjeteve të kryerjes së veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehtë provat e kryerjes se veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

Duke pasur parasysh faktin se sasia e narkotikut ishte e dedikuar për t’ju dorëzuar të dënuarit A, dhe në telefonin e tij kishte pranuar një foto të vend parkimit në oborrin e QKUK-së nga një numër slllovak dhe gjatë pranimit të sasisë së narkotikut është zënë kjo gjykatë bazuar në dispozitën e lartcekur vlerëson se as që mund të behet fjalë për ndihmë në kryerjen e veprës penale për të cilën është shpall fajtor.

Kjo gjykatë i vlerësoj si të pazabazura edhe pretendimet e mbrojtësit A. B. sa i përket veprës penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Nuk është kontestues fakti se arma e gjetur tek shtëpia e të dënuarit A. ka qenë jo funksionale, mirëpo nga ky fakt nuk mund të pretendohet se i dënuari nuk mund të shpallet fajtor për këtë vepër penale. Kjo për faktin se sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertës së balistikës Sh. Sh. e cila është dëgjuar edhe në shqyrtimin gjyqësor arma edhe pse ka qenë e bllokuar dhe jo funksionale, nuk i ka funksionuar siguresa e cila e liron mekanizmin goditës, e njëjta me ndërrimin e pjesëve të dëmtuara, ndërrimin komplet të mekanizmit të këmbëzës ka mund të behet funksionale. Kurse, sipas ligjit për armë nr/05/L-022 - armë e çaktivizuar apo jofunksionale janë armët e kategorisë A,B,C dhe D, pjesët thelbësore të të cilave janë bërë në mënyrë të përhershme dhe të papërshtatshme për përdorim përmes çaktivizimit, duke siguruar se të gjitha pjesët thelbësore të armës janë bërë në mënyrë të përhershme jofunksionale dhe të pamundshme për t'u lëvizur, zhvendosur dhe për t'u modifikuar që do t'ia mundësonte armës për t'u riaktivizuar. Procedurat teknike dhe kërkesat e shënjitimit për çaktivizim duhet të vërtetohen nga organi kompetent. Kurse, sipas par. 3 nënpar 3.4 të këtij ligji nuk konsiderohen armë ato të cilat janë bërë të papërdorshme (të çaktivizuara) në mënyrë të përhershme, përmes zbatimit të procedurave teknike të cilat janë të përcaktuara nga organi kompetent.

Pra, duke pasur parasysh faktin se arma nuk ka qenë jofunksionale në mënyrë të përhershme pa bazë pretendohet se i dënuari është dash të lirohet nga akuza për këtë vepër penale.

Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit A. Rr. përkitazi me konfiskimin e veturës se të mbrojturit të tij janë të bazuara. Në të vërtetë edhe pse mbrojtësi thirret vetëm në nenin 92 të Kodit Penal pretendimet në këtë drejtim janë të bazuara për këto arsye:

Nuk rezulton kontestues fakti se vetura "Audi A4"- Avant karvan me targa të regjistrimit të Sllovak NR-853-K, ngjyrë hiri, është përdorur nga i dënuari A. për kryerjen e veprës penale, dhe me akuzë është propozuar që kjo veturë të konfiskohet si mjet që është përdorur për kryerjes e veprës penale. Mirëpo, në rastin konkret nga shkresat e lëndës del se kjo veturë nuk është në pronësi të të dënuarit, por është në pronësi të palës së tretë – kompanisë së FENRIR CARS me seli në Sllovakia nga e cila i dënuari e kishte marrë veturën me qira, një fakt i tillë theksohet edhe në aktgjykimin e shkallës së parë.

Por, sipas dispozitës së nenit 270 par.2 të Kodit të Procedurës Penale, nëse pasuria që është mjet i takon një pale të tretë, pasuria konfiskohet nëse: pasuria ka qenë dhuratë e njoollsur ose pala e tretë e dinte ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorur si mjet. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë indikacion se vetuar e marrë me qira (fakti se vetura është marrë me qira nga i dënuari nga kompania FENRIR.S.R.O vërtetohet edhe nga kërkesa e kësaj kompanie që ia ka bërë gjykatës për kthimin e veturës, e të cilës ia ka bashkëngjite edhe kontratën për qira, e të cilën kërkesë gjykata fare nuk e ka vlerësuar) ka qenë dhuratë e njoollsur ose pala e tretë e dinte ose mund të kishte dyshuar në mënyrë të arsyeshme se pasuria është përdorur si mjet. Prandaj, kjo gjykatë e aprovoj kërkesën e mbrojtësit në këtë drejtim dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlen të theksohet se pretendimet në kërkesat e mbrojtësve të dënuarve sa i përket vendimit për dënim nuk qenë objekt shqyrtimi ngase përkitazi me ketë bazë ligjore nuk mund të ushtrohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

9.4 Parashkrimi

Parashkrimi është institut shumë i rëndësishëm juridik, i cili është paraparë me legjislacionin penal të Kosovës, dhe përmes të cilit pamundësohet ndjekja penale si dhe ekzekutimi i sanksionit penal pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore, qoftë nga koha e kryerjes së një veprë penale (parashkrimi i ndjekjes penale) qoftë nga koha e shqiptimit të dënimit dhe mosekzekutimit të tij (parashkrimi i ekzekutimit të dënimit).

Për shkak të faktit se përmes këtij instituti pamundësohet ndjekja penale si dhe ekzekutimi i sanksionit penal, në çdo fazë të procedurës gjykatore dhe organet tjera të ndjekës dhe të ekzekutimit të sanksioneve penale sipas detyrës zyrtare duhet ta kenë parasysh këtë institut.

Kodi Penal i Kosovës, në nenin 99 e 101 ka paraparë parashkrimin. Koha që duhet të kalojë për tu arritur parashkrimi njihet si afat i parashkrimit. Kështu, sipas dispozitës së nenit 99 par.1 të Kodit Penal – nëse shprehimisht parashihet ndryshe me këtë kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme:

- 1.1. tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përgjithshëm;
 - 1.2. njëzet (20) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë (10) vjet burgim;
 - 1.3. pesëmbëdhjetë (15) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim;
 - 1.4. dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (3) vjet burgim;
 - 1.5. gjashtë (6) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (3) vjet burgim;
 - 1.6 katër (4) nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (3) vjet burgim;
2. Kur ligji parasheh me shumë se një dënim për një vepër penale, afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë.

Me këtë dispozitë janë përcaktuar afatet relative të cilat llogariten në bazë të dënueshmërisë së veprave penale, kurse, afati absolut është dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit relativ (neni 101 par.8 i KP). Pra, afati relativ i parashkrimit llogaritet në bazë të dënimit që parashihet për veprat penale, për shembull për veprën penal të vrasjes, nga neni 172 të KPRK parashihet dënim me burgim jo me pak se pesë (5) vite, dhe meqë në rastet kur maksimumi i dënimit nuk përcaktohet atëherë merret maksimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim që nënkupton se maksimumi i dënimit për veprën penale të vrasjes është 25 (njëzet e pesë) vite, dhe për këtë vepër afati relativ i parashkrimit sipas dispozitës së lartcekur është njëzet (20) vite, kurse afati absolut dyzet (40) vite.

Afat i parashkrimit relativ fillon të rrjedhë apo llogaritet nga dita kur është kryer vepra penale, kurse, kur vepra penale kryhet ndaj personit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, afat i

parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita kur viktimi të këtë mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet- neni 100 par.2 i KPRK.

Afati i parashkrimit është specifik tek vepra penale e vazhduar dhe ajo permanente. Tek vepra penale e vazhduar afati i parashkrimit fillon të ecë nga dita kur është ndërmarrë veprimi i veprës penale të fundit e cila bën pjesë në veprën penale të vazhduar. Te veprat penale permanente afati i parashkrimit fillon të ecë nga dita kur pushon gjendja e kundërligjshme.

E rëndësishme është se parashkrimi ndërpritet me çdo veprim procedural i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer (vlen te theksohet se kallëzimi penal nuk e ndërpret parashkrimin), ndërsa nuk ndërpritet nëse vepra nuk ndiqet për shkak të mungesës së kërkesës së autorizimit për të bërë ndjekjes ose për shkak të mungesës së kërkesës nga ana e shtetit të huaj për ndjekjen (neni 101 par 5 e 6 i KPRK).

Siç është thënë edhe me lartë parashkrimi i ekzekutimit të dënimit konsiston në atë se pas kalimit të kohës së paraparë me ligj, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet.

Kështu, me dispozitën e nenit 101 par.1 të Kodit Penal përcaktohet se përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet pasi të kenë kaluar:

- 1.1. tridhjetë (30) vjet nga dënimi me burgim të përjetshëm;
 - 1.2. njëzetë (20) vjet nga dënimi me mbi dhjetë (10) vjet burgim;
 - 1.3. pesëmbëdhjetë (15) vjet nga dënimi me mbi pesë (5) vjet burgim;
 - 1.4. dhjetë (10) vjet nga dënimi me mbi tri (3) vjet burgim;
 - 1.5. gjashtë (6) vjet nga dënimi me mbi një (1) vit burgim; dhe
 - 1.6. katër (4) vjet nga dënimi me burgim deri në një (1) vit apo dënimi me gjobë.
2. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve ndërpritet kur personi i dënuar nuk paraqitet ose nuk dorëzohet për mbajtjen e dënimit me burgim.

Edhe tek ekzekutimi i dënimeve sikurse tek ndjekja penale kemi afatin relativ dhe absolut, dhe dispozita e lartcekur i referohet afatit relativ i cili llogaritet në bazë të dënimit të shqiptuar me burgim, e jo në bazë të dënimit që parashihet për veprën penale, kurse afati absolut është dyfishi i kohës se afatit të parashkrimit relativ (neni 101 par.8 i KPRK).

Sipas kodit penal afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, e në rast se dënimi alternativ është revokuar, parashkrimi fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin merr formën e prerë, kurse nëse dënimi zbutet me falje apo me vendim të gjykatës sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, koha e fillimit të parashkrimit caktohet sipas dënimit të ri, derisa llogaritja e parashkrimit bëhet sipas dënimit fillestar, dhe po ashtu afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit(neni 103 i KPRK).

Sipas kodit penal instituti i parashkrimit vlen edhe për dënimet plotësuese dhe masat e trajtimit të detyrueshëm. Për shkak të specifikave të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet me to afatet e parashkrimit nuk janë të njëjta.

Kështu, sipas kodit penal dënimet plotësuese nuk do të ekzekutohen kur të kenë kaluar pesë (5) vjet nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilin shqiptohet ato, kurse masat e trajtimit të detyrueshëm nuk do të ekzekutohen kur të kenë kaluar tre (3) vjet nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilin është shqiptuar masa.

Për parashkrimin e dënimit me burg për të mitur vlejnjë dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të mitur, duke pasur parasysh se procedura ndaj të miturve është specifike. Sipas nenit 103 të këtij kodi dënimi i shqiptuar me burg për të mitur nuk mund të ekzekutohet kur kalojnë:

- 1.1. dhjetë (10) vite nga dënimi i formës së prerë me dënim me burg për të mitur mbi pesë (5) vite;
- 1.2. pesë (5) vite prej dënimit të formës së prerë me dënim me burg për të mitur mbi tre (3) vite;
- 1.3. tre (3) vite nga dënimi i formës së prerë me dënim me burg për të mitur mbi një (1) vit;
- 1.4. dy (2) vite nga forma e prerë e dënimit me dënim me burg për të mitur deri në një (1) vit.

Vlen të theksohet se instituti i parashkrimit të ndjekjes penale dhe ekzekutimit të dënimit parimisht vlen për të gjitha veprat penale, por, ka një përjashtim në këtë drejtim dhe i vetmi përjashtim janë veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare, siç janë gjenocidi, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, ose vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen dhe vepra penale e vrasjes së rëndë (neni 104 i KPRK)

9.5 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me parashkrimin

Meqë instituti i parashkrimit ka të bëjë me ligjin penal, nuk janë të rralla rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë i ndryshon aktgjykimet e instancave me të ultë për shkak se arrijtes së parashkrimit relativ apo absolut.

Në vijim do të paraqitet një rast nga praktika gjyqësore që kjo Gjykatë me rastin e vendosjes përkitazi me kërkesën i ka ndryshuar aktgjykimet e instancave me të ultë për shkak të cilësimit të veprës penale, , por që e ka refuzuar akuzën për shkak se për veprën penale të ricilësuar kishte arritur parashkrimi absolut.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi Pml.nr.120/2024**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit L. M., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- dega në Lipjan, P.nr.19/202023 datë 3 prill 2023, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.687/2023 datë 10 janar 2024, ashtu që kjo Gjykatë, veprimet e të dënuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë i cilëson si veprë penale tregti e ndaluar, nga neni 305 par.1 të Kodit Penal të Kosovës (i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale), dhe ndaj të dënuarit e refuzon akuzën për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale konform dispozitës së nenit 362 par.1 nënpar.1.3 Kodit të Procedurës Penale(KPP) lidhur me nenin 106 par.1 nënpar.1.5 të KPK, për shkak se:

“Me 01.10.2013, në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, në fshatin Vrellë, komuna e Lipjanit, i pandehuri ka udhëtuar në linjën Staboll-Zagreb-Prishtinë, ka bartur me vete 7 çanta me gjithsej 171 kg, ka deklaruar medikamente 31.875 copë stimulant seksual të llojeve “Cretor”, 600x28=16.800 copë, “Kam Gra”, 1400x7-9.800 copë, “Kamagra Tableta”, 385x7= 2.625 copë, “Ec Pills tablet”- 2400x1=2400 copë, “Endksan ampul”, 50x1=50 copë, “Ondan Setran”, 20x10=200 copë, i pandehuri me dashje pa autorizim dhe pa licencë, pa leje të importit ka bërë bartjen e mallit i cili është në kundërshtim me ligjin, në vlerë të përgjithshme prej 72.518.75€.

- me çka kishte për të kryer veprën penale tregti e ndaluar, parashikuar me nenin 305 par.1 të KPK”.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore

-në pjesën konfiskuese aktgjykimi ngel i pandryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, me aktgjykimin P.nr.93/2005 datë 3 prill 2023, e ka shpallur fajtor të pandehurin L. M., për veprën penale tregti e ndaluar, nga neni 305 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili me pëlqimin e të pandehurit konform nenit 47 të KPK i është zëvendësuar me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë)€, i cili do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në të kundërtën dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që në një ditë burgimi do t'i llogariten 20€ të gjobës.

Të pandehurit i janë konfiskuar 7 çanta me medikamente me peshë gjithsej 171 kg, dhe atë 31.875 copë stimulant seksual të llojeve “Cretor”, 600x28=16.800 copë, “Kam Gra”, 1400x7-9.800 copë, “Kamagra Tableta”, 385x7= 2.625 copë, “Ec Pills tablet”- 2400x1=2400 copë, “Endksan ampul”, 50x1=50 copë, “Ondan Setran”, 20x10=200 copë.

Ky aktgjykim, sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit, është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr. PA1.nr.687/2023 datë 10 janar 2024.

Kundër këtyre aktgjyqimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit, avokati Hekuran Haxhimusa, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që vepra penale për të

cilën është shpall fajtor i dënuari të ricilësohet sipas par.1 të nenit 305 të KPRK, dhe të refuzohet akuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Ndaj kërkesë së mbrojtësit të të dënuarit është përgjigjur Prokurori i Shtetit me parashtrësën me shkrim KMLP.II.nr.70/2024 datë 23.02.2024, me propozim që kërkesa të refuzohet e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, par.1 lidhur me nenin 436, par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme me aktgjykimet e kundër të cilave është paraqitur kërkesa është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, ngase aplikimi i ligjit penal kur i dënuari L. M. është shpall fajtor dhe gjykuar për veprën penale tregti e ndaluar, parashikuar me nenin 305 par.2 lidhur me par.1 të KPK, nuk është i drejtë pamarre parasysht se i dënuari e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk është i drejtë konstatimi i Gjykatës së shkallës së parë se i dënuari e ka kryer veprën penale tregti e ndaluar, nga neni 305 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal. Sipas përkufizimit ligjor par.2 të këtij neni, kjo veprë penale ekziston atëherë kur kryesi i veprës penale nga par.1 i këtij neni ka organizuar rrjetin e shitësve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumë prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000)€.

Ndërsa, në përshkrimin e veprimeve inkriminuese të të dënuarit theksohet “ Me 1.10.2013, në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, në fshatin Vrellë, komuna e Lipjanit, i pandehuri ka udhëtuar në linjën Staboll-Zagreb-Prishtinë, ka bartur me vete 7 çanta me gjithsej 171 kg, ka deklaruar medikamente 31.875 copë stimulant seksual të llojeve “Cretor”, 600x28=16.800 copë, “Kam Gra”, 1400x7-9.800 copë, “Kamagra Tableta”, 385x7= 2.625 copë, “Ec Pills tablet”-2400x1=2400 copë, “Endksan ampul”, 50x1=50 copë, “Ondan Setran”, 20x10=200 copë, i pandehuri me dashje pa autorizim dhe pa licencë, pa leje të importit ka bërë bartjen e mallit i cili është në kundërshtim me ligjin, në vlerë të përgjithshme prej 72.518.75€”.

Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj Gjykate nga ky përshkrimi nuk rezulton se i dënuari ka organizuar rrjetin e shitësve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumë prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000)€. Në fakt nga shkresat e lëndës, respektivisht provat në bazë të të cilave është ngritë akuza rezulton pa mëdyshje se i dënuari kishte sjellë në aeroportin e Prishtinës medikamentet e lartcekura në shumë e lartcekur të cilat i kishte raportuar për zhdoganim por të cilat i janë konfiskuar ngase nuk kanë qenë të licencuara për import në shtetin tonë, veprime këto që i përgjigjen veprës penale tregti e ndaluar, nga neni 305 par.1 të KPRK, prandaj, kjo gjykatë veprimet e të dënuarit i cilësojë si veprë penale, tregti e ndaluar, nga neni 305 par. 1 të KPRK.

Kurse, duke pasur parasysht veprën penale të ricilësuar dhe kohën kur është kryer kjo veprë del s në rastin konkret lidhur me këtë veprë penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Kështu, sipas kodit penal (të vitit 2013) që ishte në fuqi në kohën e kryerje së veprës penale, për veprën penale, nga neni 305 par.1 të KPRK, parashihej dënimi me burgim prej tre muaj deri në tre vjet, kurse sipas nenit 106 par.1 nënpar.1.1 të këtij kodi ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre vjet nga kryerja e veprës penale me më shumë se një (1) vit

burgim (ndalesa reale), kurse sipas nenit 107 par.8 të kodit ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute). Duke pasur parasysh kohën e kryerjes së veprës penale (1.10.2013) del se që nga që nga koha e kryerjes së veprës penale (1.10.2013) e gjer te marrja e aktgjykimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë (3 prill 2023) kanë kaluar me shumë së **gjashtë** vite, prandaj kjo gjykatë e refuzoj akuzën sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

9.6 Konkluzionet

1. Siç është paraqitur edhe më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka sqaruar se në cilat raste duhet që palët - të miturit dhe përfaqësuesit e tyre që të njoftohen me seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ndërsa në rastin Pml.nr.380/2024, nuk ka qenë e domosdoshme një gjë e tillë. Kjo për faktin se në këtë rast, ndaj të miturve nuk është shqiptuar dënim me burgim për të mitur, kurse në anën tjetër, në ankesat e mbrojtësve të të miturve: U. K. dhe K. I., nuk janë paraqitur pretendime në lidhje me shqyrtimin e fakteve dhe të ligjit për të bërë vlerësim lidhur fajësinë apo pafajësinë e të miturve, pasi që edhe ashtu të miturit e kanë pranuar fajësinë, por që në ankesat e mbrojtësve të të miturve janë paraqitur vetëm pretendime në lidhje me masën edukative të shqiptuar, e cila nuk është masë e karakterit institucional. Përndryshe, është theksuar se edhe GJEDNj-ja, në disa raste nga jurisprudenca e saj ka sqaruar se prezenca personale e të pandehurit në gjykatën e shkallës së dytë nuk ka të njëjtën rëndësi, si prezenca e tij në gjykatën e shkallës së parë. Mënyra se si zbatohet neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“E drejta për një proces të rregullt”) në kuptim të prezencës së të pandehurit pranë gjykatës së shkallës së dytë varet nga specifikat e procedurës penale përkatëse dhe se duhet pasur parasysh edhe tërësinë e procedurës penale të zhvilluar në kuadër të rendit të brendshëm juridik, si dhe rolin që ka gjykata e shkallës së dytë (rasti “*Hermi kundër Italisë*”, aktgjykimi i Dhomës së Madhe, i datës 18.10.2006, paragrafi 60; rasti “*Kamasinski kundër Austrisë*”, aktgjykimi i datës 19.12.1989, paragrafi 106; rasti “*Ekbatani kundër Suedisë*”, aktgjykimi i datës 26.05.1988, paragrafi 27; rasti “*Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*”, aktgjykimi i datës 02.03.1987, paragrafi 56, etj.).
2. Njëra prej masave edukative që mund të shqiptohen ndaj të miturve është edhe “Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë”. Në rastin Pml.nr.73/2023, Gjykata Supreme e Kosovës ka sqaruar se duke u bazuar në nenin 27, paragrafi 1 të KDM, gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë, vetëm kur prindi nuk është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit dhe kur një masë e tillë nuk është në interesin më të mirë të të miturit. Nga anketa e zhvilluar me të miturin, kishte rezultuar se familja e të miturit kanë kushte të mira ekonomike dhe të ardhura të mjaftueshme për jetesë të mirë, me rekomandimin e psikologut, prindi i të miturit ia ka ndërruar shkollën në mënyrë që ta largojë nga shoqëria e mëparshme, i mituri frekuenton një shkollë private ku është nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 5 pas dite dhe se në këto kushte dhe rrethana edhe me mbikëqyrjen e shtuar nga ana e prindit do të mund të arrihej rehabilitimi dhe risocializimi, si dhe zhvillimi adekuat i të miturit. Në këtë mënyrë, nga

- anketa sociale e ShSK, por edhe nga shkresat tjera të lëndës, kishte rezultuar se prindërit e të miturit T.S. janë në gjendje të ushtrojnë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit, andaj edhe nën këto rrethana, ndaj të miturit nuk mund të shqiptohet mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë.
3. Gjithashtu, në rastin Pml.nr.700/2023, është sqaruar mjaftueshëm çështja e mundësisë së caktimit të ekspertit për të vlerësuar zhvillimin psikologjik të madhorit të ri dhe është trajtuar edhe çështja e hartimit të arsytimit të aktvendimeve duke e përdorur të ashtu quajturën metodë “Copy-paste”, pa një vlerësim dhe analizim të mirëfilltë të shkresave të lëndës.
 4. Një tjetër aspekt që është trajtuar në rastin Pml.nr.352/2023, ka të bëjnë me zbatimin subsidiar të ligjeve tjera në procedurën penale ndaj të miturve, ashtu siç është parashikuar në nenin 6 të KDM, ku është sqaruar në rastet kur situata të caktuara nuk janë rregulluar me dispozitat ligjore të KDM-së, atëherë duhet zbatuar ligjet tjera, përkatësisht Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe dispozitat tjera penalo juridike.
 5. Njëra prej çështjeve tejet të rëndësishme që është trajtuar në rastin Pml.nr.479/2023, i referohet vlerësimit të rrethanave përkatëse me rastin e shqiptimit të masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, ku është sqaruar se si duhet që këto rrethana të vlerësohen dhe padyshim se një gjë e tillë më së miri do të mund të bëhet përmes Anketës Sociale të ShSK-së.
 6. Gjykata Supreme e Kosovës në rastin Pml.nr.2/2022, duke vendosur në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kishte konstatuar se një mjet i tillë juridik nuk lejohet ndaj aktvendimeve me të cilat është refuzuar si i pabazuar propozimi për rishqyrtimin e masës edukative institucionale, duke paraqitur edhe arsyet për një qëndrim të tillë.
 7. Kurse, në rastin Pml.nr.519/2022, është sqaruar mjaftueshëm se në çka konsiston viktimia e ndjeshme, sidomos rastin e tillë, kur viktimia e ndjeshme është element i figurës së veprës penale.
 8. Tjetër aspekt që është trajtuar dhe sqaruar në rastin Pml.nr.263/2023, ka të bëjë me gjendjen e afektit mendor të të miturit në kohën kur është dyshuar se e ka kryer veprën penale, e cila i është vënë në barrë.
 9. Përveç këtyre, në rastin Pml.nr.657/2023, Gjykata Supreme e Kosovës ka sqaruar situatën se çfarë masa dhe dënime mund të shqiptohen ndaj të madhorit për vepër penale të kryer si i mitur, duke ju referuar nenit 12 të KDM-së.
 10. Në rastin Pml.nr.164/2021, Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se mos prezenca e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje të të miturit përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ndërsa një shkelje e tillë kishte ndikuar që detyrimisht të anulohen vendimet e kundërshtuara dhe rasti të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
 11. Kurse, në rastin Pml.nr.501/2023, Gjykata Supreme e Kosovës kishte sqaruar se prindërit e të miturve duhet që të thirren në shqyrtim gjyqësor, mirëpo mos paraqitja e paarsyeshme e tyre nuk do të pengonte gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor.
 12. Në anën tjetër, në rastin Pml.nr.60/2024, Gjykata Supreme e Kosova ka theksuar se meqë ankesat e parashtruara janë bërë edhe për shqyrtim të fakteve dhe ligjit lidhur me fajësinë

apo pafajësinë e të miturve, atëherë, Gjykata e Apelit e Kosovës është dashur që për seancën e kolejit t'i njofton të miturit, përfaqësuesit e tyre dhe mbrojtësit.

13. Dhe në fund, Gjykata Supreme e Kosovës, në rastin Pml.nr.615/2023, kishte sqaruar se sipas dispozitës së nenit 432,paragrafi 1 të KPP-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë. Ndërkaq, sipas dispozitës së nenit 432, paragrafi 4 të KPP-së, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit, andaj edhe mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të miturit ishte hedhur si e papranueshme.



Gjykata Supreme e Kosovës Pallati i Drejtësisë – Lagjja "Prishtina e Re"

Prishtinë

T1: +383 (0) 38/200 18775

T1: +383 (0) 38/200 18779

Email: gjykatasupreme@rks-gov-net